

Viti XXXIV nr. 79

EDUKATA ISLAME

REVISTË
SHKENCORE
KULTURORE
ISLAME



Prishtinë, 2006

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXV nr. 79 / 2006

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXV nr. 79 – 2006

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,

Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimimi,

Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha

Korrektor: Skender Rashiti

Ballina: Shyqyri Nimani

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXV nr. 79 / 2006

Prishtinë
2006

EDITORIALI

Qemajl Morina

IBNU HALDUNI THEMELUES I SOCIOLOGJISË MODERNE

Me rastin e 600 vjetorit të vdekjes së shkencëtarit të madh
arab -Ibnu Haldunit (732-808 H - 1332-1406)

"El-Mukaddima" (Hyrja) në historinë universale, të cilën ai e kishte konceptuar dhe formuluar si filozofi të historisë, është, pa dyshim, vepra më madhështore e llojit të vet, që është shkruar ndonjë herë në ndonjë kohë dhe në ndonjë vend nga një mendje njeriu." Arnold J.Toynbee, historian i madh i shekullit njëzet

(A study of history, vol.III, Royal Institute of International Affairs and Oxford University Press. P.321-322)

Hyrje

600 vjetori i vdekjes së ibnu Haldunit filloi në Tunizi përkujtua në muajin mars 2006 me një simpozium ndërkombëtar, ku morën pjesë 90 studiues nga vende të ndryshme të botës. Ndërkohë, është paraparë që vetëm në Tunizi të organizohen 540 manifestime të niveleve të ndryshme, që do të vazhdojnë gjatë tërë vitit në qytetet të ndryshme të Tunizisë. Manifestime do të mbahen edhe në vende të tjera, ku jetoi

dhe veproi ibnu Halduni, si në Egjipt, Marok, Spanjë dhe Siri. Por, manifestime të ndryshme do të organizohen edhe në vende të tjera si në Jordani, Francë, etj., si ekspozita të librave e të dorëshkrimeve të tij, të cilat janë tubuar posaçërisht për këtë rast. Këtu do të përmendnim edhe shfaqjen e dramës, të përgatitur nga regjisori i njohur i Tunizisë, Izuddin el-Medeni për ibnu Haldunin, me të cilën do ta hapet festivali i Kartaxhenës . Kjo është një vepër madhështore, që i kushtohet jetës së ibnu Haldunit, periudhës së jetës së tij në Tunizi dhe në Marok, që ishte përplot të papritura. Me këtë rast do të bëhet edhe hapja e shtëpisë muze në kryeqytetin e Tunizisë në Tunis, ku lindi ibnu Halduni, si dhe mejtepi në të cilin i bëri hapat e parë në drejtim të diturisë. Tunizia pretendon se këtë e meriton meqenëse ibnu Halduni është lindur në atë vend, kurse Kajroja, si vendi në të cilin ibnu Halduni kaloi pjesën e fundit të jetës dhe vdiq e u varros aty, do ta përkujtojë këtë datë të rëndësishme historike pothuaj në të njëjtën mënyrë.

Ibnu Halduni është personalitet i shquar në lëmin e historisë jo vetëm myslimane, por edhe të asaj botërore. Ky është njëri prej atyre personaliteteve, që më së shumti kontribuoi në mirëkuptimin e qytetërimeve gjashtë shekuj më parë. Për ta njohur më mirë veprimtarinë e tij, ne së pari po japim shkurtazi disa shënime për jetën e veprën e tij.

Biografia

Ibnu Halduni rrjedh nga një familje intelektualësh dhe politikanësh. Ai bëri përpjekje që të dy këtotribute të të parëve të vet t'i bashkojë në personalitetin e tij. Por, ai shkëlqeu në lëmin e kulturës më shumë se në të gjithë lëmenjtë e tjerë.¹

Emri i tij është Abdurrahman ibn Muhamed, por në tërë botën është i njohur me emrin **ibnu Haldun**. Prindërit e tij janë nga një fis arab i Jemenit, që ishin vendosur në Andaluzi në periudhën e hershme të vendosjes së pushtetit mysliman në Spanjë, në shekullin e tetë.

¹ Ibn Khaldoun, Abdurrahman M., Mokaddimat ibn Khaldoun, Ed.Darveesh al-Javadi, al-Maktaba al-Asriyah, Sidon-Beirut,1995

Familja e tij, që kishte pasur poste të larta në Andaluzi, ishte shpërngulur në Tunizi pas rënies së Seviles në fillim të Reconcuistes, kah mesi i shekullit të trembëdhjetë. Nën sundimin e dinastisë Hafside, disa nga anëtarët e familjes së tij mbanin disa poste politike. Babai i ibnu Haldunit dhe gjyshi i tij ishin tërhequr nga jeta politike dhe i ishin bashkuar radhëve të mistikëve².

Ibnu Halduni është lindur në Tunizi më 1 ramazan 732 sipas vitit Hixhri apo më 27 maj 1332. Ndërsa vdiq në Kajro më 25 ramazan 808 Hixhri apo 17 mars 1406 në moshën 74 vjeçare. Është varrosur në varrezat e mistikëve jashtë portës Bab En-n asrr në lagjen Abbasije të Kajros³.

Ibnu Halduni ishte pajisur me edukatë tipike tradicionale të rangut dhe të statusit të familjes së tij. Mësimet e para kishte marrë tek babai i tij, i cili ishte i pajisur me dije të nivelit të lartë. Në moshën më të re, ashtu siç ishte traditë tek arabët dhe myslimanët, kishte mësuar përmendsh Kur'anin, kishte mësuar gramatikën, sheriatin, hadithin, retorikën, filologjinë si dhe poezinë.

Te mistiku, matematicienti dhe filozofi Al-Abili kishte mësuar matematikë, logjikë dhe filozofi, ku kishte rënë në kontakt edhe me veprat e Averrosit (ibnu Ruzhdit), Avicenes (ibni Sinas), Raziut dhe Al-Tusit. Në të gjitha këto shkenca, ibnu Halduni kishte fituar njohuri të gjera si dhe dëshmi adekuate për këto. Në autobiografinë e tij të mëvonshme, ai nuk i përmend emrat e këtyre dijetarëve, të cilët ishin mësuesit e tij të parë. Në moshën 17 vjeçare ai humb të dy prindërit nga një epidemi që kishte përfshirë Tunizinë.⁴

Sociologu i njohur egjiptian Dr. Ali Abdul Vahid Vafi, në librin e tij: "Abdurrahman ibnu Haldun"⁵, jetën shumë të begatshme kultur-

² Ibn Khaldoun, The Muqaddimah, An Introduction to History, Tr.Franz Rpsenthal, Bollingen Series XLIII, Princeton University Press, Princeton, 1967 3 Vols.

³ Dafi Naz Kadhim, Fie dh-dhikra el sittumie ala rehil inbi Khaldun....., Xheridetu Eshsherkul Avsat, El-adad,9970, 16 maris 2006, London.

⁴ Muhammad Hozein, Ibn Khaldoun his life and Work 1332-1406, www.philosophy.com/ik/klf.htm

⁵ Maktabat Misr, Kajro, 1962

ore, shkencore, letrare dhe politike të këtij dijetari të madh e ndan në katër periudha kryesore.

Periudha e parë përfshin moshën e fëmijërisë që fillon prej lindjes së tij më 732 h(1332) e deri më 751h(1350), dhe vazhdon deri me njëzet vjet të jetës së tij, që i kaloi në Tunizi. Gjatë kësaj periudhe ai mësoi përmendsh Kur'anin dhe mori bazat e para të njohurive të tij, nga babai i vet, në mejtepin e lagjes apo në shkollat e asaj kohe.

Periudha e dytë ishte koha e angazhimit të tij në poste administrative dhe politike. Kjo periudhë zgjat prej vitit 751h (1350) deri më 776h (1374), që përfshin një periudhë prej 25 vjetësh të jetës së tij, të cilat i kaloi duke shëtitur pothuajse nëpër të gjitha vendet e Magrebit, të cilat përfshijnë Tunizinë, Marokun dhe Algjerinë e sotme, si dhe disa vende të Andaluzisë. Çështjet administrative dhe ato politike ia kishin marrë pjesën më të madhe të kohës gjatë kësaj periudhe.

Periudha e tretë është periudha e përkushtimit të ibnu Haldunit në shkrimin e veprave. Kjo periudhë fillon nga viti 776h (1374) deri në vitin 784h (1384). Pjesën e parë të kësaj periudhe ai e kaloi në pallatin e Ibnu Selamit në Algjeri.⁶

Ndërkohë që pjesën tjetër e kaloi në Tunizi. Gjatë kësaj periudhe, u përqendrua tërësisht në përpilimin e librit të tij të njohur "*Kitabu-l'ibari wa Divani-l-Mubtadai wa l-Khabar fi Ayyam al-'arabi va al-'Ajam va-l-Barabar va man 'Asarahum min dhevil es-Sultani-l-Akbar*" (Libri mbi të dhënat e fillimit të ndodhive që nga koha e arabëve, persianëve dhe berberëve si dhe mbi sundimtarët e tyre më të mëdhenj". Ky libër, në pjesën e parë, përfshin "*El-Mukaddimen*" (Hyrja), apo e përkthyer në anglisht "*Prolegomena*",⁷ veper kjo e cila e bëri ibnu Haldunin të pavdekshëm në mesin e historianëve, sociologëve dhe filozofëve.

Periudha e katërt përfshin periudhën e angazhimit të ibnu Haldunit në profesionin e arsimit, të edukimit dhe të jurisprudencës.

⁶ Ibn Khaldun, (1332-1395C.E.).www.ummah.net/history/scholars/KHALDUN.html

⁷ Ibn Khaldun-Ëikipedia, the free encyclopedia, http://en.wikipedia.org/wiki/Ibn-Khaldun

Kjo periudhë përfshin 24 vjetët e fundit të jetës së tij prej vitit 784h (1382) deri më 808h (1406), që i kaloi në Egjipt.

Nga ngjarjet më të rëndësishme, të cilat i përmend Dr. Ali Abdul Vahid Vafi, që kanë të bëjnë me këtë periudhë, është takimi i tij me komandantin e njohur të tatarëve Timurlengun jashtë mureve të Damaskut. Në kampin e Timurlengut, me të cilin zhvilloi biseda të gjata, ibnu Halduni qëndroi 35 ditë.⁸

Një ngjarje tjetër, e cila kishte lënë gjurmë të thella në jetën e ibnu Haldunit, pa mëdyshje, ishte vdekja tragjike e gruas dhe e fëmijëve të tij pas fundosjes së anijes më të cilën ata kishin udhëtuar nga Tunizi për në Egjipt në afërsi të limanit të Aleksandrisë. Me këtë rast ibnu Halduni, për veç familjes së tij, kishte humbur edhe shumë dorëshkrime, të cilat familja e tij ia kishte sjellë nga Tunizia. Kjo tragjedi kishte ndodhur në kohën kur ibnu Halduni ishte në moshën 55 vjeçare.

Veprat:

Ibnu Halduni ishte personalitet që u shqua në shumë fusha të shkencës dhe të kulturës të shoqërisë së asaj kohe. Ai në veprat e tij trajtoi tema historike, sociologjike, politike, ekonomike, fetare, gjeografike, filozofike etj.

Vepra kryesore e ibnu Haldunit është: “*Kitab al-‘ibar va divan al-Mubtada’ va al-habar fil ‘ay-yam al-‘Arab va al’Agam va al-Barabar va man asarahum min dhavil as-sultan al-akbar*” (Libri mbi të dhënat e fillimit të ndodhive që nga koha e arabëve, persianëve dhe berberëve si dhe mbi sundimtarët e tyre më të mëdhenj).

Pjesa më e madhe e këtij libri i është kushtuar historisë së berberëve. Në pjesën tjetër të librit ai u përqendrua në atë që ai e quan “histori universale”. Libri në tërësi është i ndarë në 7 vëllime.⁹ Vëllimi i parë që quhet “*Mukaddimah*” (Hyrje), mund të konsiderohet libër i veçantë. Paraqet pikëpamjet e ibnu Haldunit, rreth themelimit të shtetit, të ngritjes, të zhvillimit dhe më në fund të rënies së tij. Ky është kontri-

but origjinal i ibnu Haldunit dhe në njëfarë mënyre burim i patejkalueshëm në literaturën e filozofisë, të historisë dhe të sociologjisë. Qëllimi kryesor i kësaj vepre monumentale ishte të identifikojë faktorët psikologjikë, ekonomikë dhe sociologjikë të cilët mund të kontribuojnë në avancimin e qytetërimit njerëzor. Në këtë kontekst, ai analizoi dinamizmin e marrëdhënieve grupore “al-‘Asabiyya” dhe i jep një shtyrje zhvillimit të qytetërimit dhe parashtron pikëpamjet e veta mbi në ngritjen dhe rënien e shteteve të ndryshme. Këtë e ilustron me ngjarjet që kishin ndodhur në kohën e tij në disa pjesë të Afrikës Veriore ku jetonin berberët.

Kjo pjesë e Mukadimas u bë libër i pavarur dhe tejet i rëndësishëm edhe gjatë jetës së autorit. Pjesët e tjera të librit kanë të bëjnë me historinë arabe, me sunduesit e atëhershëm myslimanë, sunduesit evropianë, historinë e vjetër të arabëve, të çifutëve, të grekëve, të romakëve, të persianëve etj., historinë islame, historinë e Egjiptit dhe atë të Afrikës Veriore, e në veçanti atë të berberëve si dhe të fiseve të tjera që jetonin në atë pjesë të botës.

Vëllimi i fundit, që njihet me titullin “*Al-Tasrif*”, ka të bëjë me vetë jetën e autorit dhe flet në mënyrë pak më të zgjeruar. Shumë historianë arabë janë të mendimit se ibnu Halduni është autori i parë arab që në mënyrë shkencore dhe gjithëpërfshirëse shkruan autobiografinë e tij.¹⁰

Edhe pse “*Mukaddima*” konsiderohet kryevepra e ibnu Haldunit, ibnu Halduni la pas vetes edhe një numër veprash të tjera. Në moshën 19 vjeçare shkroi veprën “*Lubabu al-Muhassal*”, që ishte një koment mbi teorinë teologjike të Raziut, të cilën e shkroi në Tunizi nën mbikëqyrjen e mësuesit të tij al-Abilit. Në vitin 1373 shkroi një vepër mbi misticizmin me titull “*Sifatu as-sail*”. Në kohën, kur ishte në shërbim të sulltanit të Granadës, Muhamedit V, shkroi një vepër me tematikë nga lëmi i logjikës.

Ibnu Halduni ishte i njohur dhe i çmuar shumë nga shkencëtarët evropianë. Vepra e tij “*Al-Mukaddima*” ishte përkthyer në disa gjuhë

⁸ www.muslimphilosophy.com/ik/klf.htm

⁹ <http://en.wikipedia.org/wiki/Ibn-Khaldun>

¹⁰ <http://www.ummah.net/history/scholars/KHALDUN.html>

evropiane dhe kishte shërbyer si një udhërrëfyes jo vetëm në lëmin e sociologjisë, por edhe në shkenca të tjera. Ajo që vlen të përmendim në kontekstin e sotëm tek Ibnu Halduni është ideja e tij për bashkëpunimin e kulturave dhe të qytetërimeve të ndryshme, e jo për konfrontimin e tyre ashtu siç po flitet dhe shkruhet në kohën në të cilën po jetojmë ne.

Kështu shohim historianin britanik Arnold J. Toynbee, i cili e vlerëson “*Mukaddimen*” vepër madhështore të llojit të tillë që ndonjëherë është shkruar nga ndonjë mendje njeriu në ndonjë kohë dhe në ndonjë vend”.

Ndërkohë Bernard Lewis e përshkruan Ibnu Haldunin ‘si historian më të madh të arabëve si dhe ndoshta historian më të madh të Lindjes së Mesme’.¹¹

Andaj edhe manifestimet me rastin e 600 vjetorit të vdekjes së Ibnu Haldunit janë dëshmia më e mirë se ai me idetë dhe veprat e tija nuk i përkiste vetëm një populli apo një vendi, por disa popujve dhe disa vendeve. Këtë më së miri dëshmon së organizimi i ekspozitës për Ibnu Haldunin në Sevile të Spanjës në pallatin mbretëror ku mori pjesë edhe mbreti i Spanjës dhe përfaqësues nga të gjitha vendet arabe. Ndërkohë që këtë vit në Paris, në qendrën e kulturës së Evropës, do të bëhet përrurimi i përkthimit të gjitha veprave të Ibnu Haldunit në gjuhën frënge, të botuara nga Shtëpia e njohur Botuese “Galimar”.

Për shkak të peshës që ka Ibnu Halduni, do të ishte mirë që një manifestim sado modest të organizohej edhe në Kosovë.

Qemajl Morina

IBN KHALDUN – THE FOUNDER OF MODERN SOCIOLOGY

* On the 600th anniversary of the death of Ibn Khaldun (732-808 H - 1332-1406)

“The Muqaddimah, the introduction to universal history, which was conceived by Ibn Khaldun as the philosophy of history, is undoubtedly the greatest work of its kind that has ever been created by any mind in any time or place”. Arnold J. Toynbee – distinguished historian of the XX century.

(A study of history, vol. III, Royal Institute of International Affairs and Oxford University Press. P.321-322)

Introduction

The 600th anniversary of the death of Ibn Khaldun was marked in March 2006 with the organization of an international symposium, which was attended by 90 participants from different countries of the world. 540 manifestations will be organized in Tunisia alone. Similar manifestations will be organized in other countries as well (places in which Ibn Khaldun lived and worked – Egypt, Morocco, Spain and Syria). Further manifestations will be organized in other countries such as Jordan and France (presentations of his books and manuscripts). Furthermore, a play has been prepared on the life of Ibn Khaldun, by Izuddin el-Medeni, a distinguished Tunisian producer. The play will open the Carthage festival. It is a magnificent piece, which is dedicated to the life of Ibn Khaldun in Tunisia and Morocco. On this occasion, the house in which he was born will be turned into a museum as well as the maktab in which he made his first steps towards knowledge. Similar manifestations will be held in Cairo, the place in which Ibn Khaldun spent the last years of his life and in which he was buried, to mark this important historical date.

¹¹ The Arabs in History, 1950, page 160.

كمال مورينا

إبن خلدون مؤسس علم الاجتماع الحديث

(بمناسبة مرور ستمائة سنة من وفاته ١٣٣٢-١٤٠٦/٨-٨٠٨-٧٣٢)

(خلاصة البحث)

"إن المقدمة هي بلا شك اعظم عمل من نوعه وضعه عقل واحد في أي زمان و مكان" آرولد تونبي مؤرخ بريطاني.

ان ذكرى مرور ستمائة سنة من وفاة إبن خلدون بدأ ي شهر مارس بتونس العاصمة بعقد مؤتمر دولي حيث تجمع أكثر من ٩٠ باحثا و دارسا من مختلف انحاء العالم و حسب ما ذكر فان في تونس وحده قد تقرر ان يتم تنظيم حوالي ٥٤٠ احتفالا على المستويات المختلفة خلال هذا العام. كما سيتم تنظيم احتفالات بهذه المناسبة في عدة دول أخرى مثل: مصر و المغرب و سوريا و أسبانيا و الاردن و فرنسا إلخ حيث سيتم تنظيم معارض للكتب و المخطوطات و عرض ترجمة كتب إبن خلدون إلى لغات أجنبية. و هنا يجدر بالذكر عرض مسرحية عن حياة ابن خلدون بمدينة القرتاج بتونس. كما سيتم فتح متحف للبيت الذي ولد و عاش فيه إبن خلدون و كذلك الكتاب الذي درس فيه.

Orhan Bislimaj

“EHLU’S-SUNNETI VE’L XHEMAATI” (Pasuesit e Sunnetit dhe bashkësisë) (أهل السنة و الجماعة)

Epiteti (lekabu) “Ehlu’s-Sunneti ve’l xhemaati” و أهل السنة الجماعة që do të thotë “pasuesit e Sunnetit dhe bashkësisë”, përbëhet prej dy njejësive (mufredejini):

E para është: “**es-sunnetu**”, kurse e dyta është “**el-xhemaatu**”. Për ta definuar krejt përbërjen, patjetër duhet që të definohen veç e veç të dy njejësat.

“**Es-sunnetu**” në aspektin gjuhësor është ‘**et-tarikatu**’ – rrugë, ndërsa ajo këtu e ka kuptimin:

الأخذ بما ثبت عنه صلي الله عليه و سلم ظاهرا و باطنا

في القول و العمل و الاعتقاد

“*pranimi i asaj që është vërtetuar nga Pejgamberi s.a.v.s. i aspektit të jashtëm dhe të brendshëm në thëniet e tij, në vepra dhe në besim*”¹

Kjo është njëra prej domethënieve terminologjike të fjalës “*es-sunnet*”, ndërkohë që ekzistojnë edhe versione të tjera plotësuese dhe kompletuese të këtij nocioni, varësisht se në cilin prizëm studiohet.

Ndërsa “*el-xhemaatu*” në aspektin gjuhësor (lugaten) do të thotë: عدد كل شئ و كثرته – **numri i çdo gjëje dhe kuantiteti i madh i tij**². Po ashtu kjo fjalë nënkupton: طائفة من الناس يجمعها غرض واحد – **një grup (komunitet, parti, fraksion) të njerëzve të cilët i bashkon një synim i vetëm / i njëjtë**³

Sipas domethënies së parë, pra, عدد كل شئ و كثرته – **numri i çdo gjëje dhe shuma e madhe e tij**, fjala “*el-xhemaatu*” e ka domethënien: “*shumicë*”. Do me thënë: “*ndjekësit e Sunnetit (të Pejgamberit a.s.) dhe shumicës*, ndërsa sipas domethënies së dytë:

طائفة من الناس يجمعها غرض واحد – **një grup (komunitet, parti, fraksion) të njerëzve të cilët i bashkon një synim i vetëm/i njëjtë**” ajo e ka domethënien: “**bashkësi**”, sepse fjala ‘bashkësi’ konsiston shoqëri-në e cila është e bashkuar, unike dhe e papërçarë. Do të thotë: “*ndjekësit e Sunnetit (të Pejgamberit a.s.) dhe bashkësisë*”.

Ndërkaq, dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth përkufizimit të domethënies së fjalës “**el-xhemaatu**” në aspektin terminologjik (istilahan). Ata kanë disa thënie:

Është thënë se: ‘*el-xhemaatu*’ janë **sahabët** (es-sahabetu). Thuhet: ‘*el-xhemaatu*’: janë **dijetarët** (اهل العلم). Imam Termidhiu thotë **se komentimi i ‘el-xhemaatu’ te dijetarët nënkupton fukahenjtë, dijetarët dhe muhad-dithinët** (اهل الفقه و العلم و الحديث). Thuhet: “*el-xhemaatu*” është ai që e ka akceptuar (pranuar) të vërtetën edhe në qoftë se ata të cilët janë të rrokur për të janë të pakët” (ألجماعة ما وافق الحق و لو قل المتمسكون به), sikurse ka thënë Ibnu Mes’udi: “**xhemaati është ai i cili e ka akceptuar të vërtetën po qoftë edhe që nuk ka tjetër përpos teje**” وحدك أجماعة ما وافق الحق و لو كنت

² <http://www.islamweb.net/ver2/archive/readArt.php?lang+A&id+66723> (“esh- shebeke-tu’l islamijetu” rubrika: ‘ardu’l mekalat’ e datës: 13.12.2004)

³ Ibrahim Mustafa, Ahmed hasen Ez-Zejjat, Hamid Abdul Kadir, Muhamed Alijun-Nexhar, “*El mu’xhemu’l vesit*”, pjesa e parë dhe e dytë, Darud-da’veti, 1989/1410, Stamboll, Turqi, shkronja ‘xh’, f.135.

¹ <http://www.islamweb.net/ver2/archive/readArt.php?lang+A&id+66723> (“esh- shebeke-tu’l islamijetu” rubrika: ‘ardu’l mekalat’ e datës: 13.12.2004)

Nuajm bin Ham-mad ka thënë: **Kur “xhemaati” prishet, pra shkatërrohet, atëherë e ke obligim që ta ndjekësh atë xhemaat sipas asaj derisa që ai ka qenë ende pa u prishur, edhe në qoftë se je i vetëm, ti vërtet je xhemaat**

إذا فسدت الجماعة فعليكم بما كانت عليه الجماعة قبل أن تفسد

و إن كنت وحدك فإنك أنت الجماعة

Thuhet: ‘el-xhemaatu’ është: **shumica absolute e një shoqërie (es-sevadu’l a’dham) të cilët e ndjekin një imam, i cili gjykon sipas sheriatit dhe që është i larguar nga ndjekja e dëshirave, epsheve dhe risisë**

هي ألسواد الأعظم المجتمعون علي إمام يحكم بالشرع و بجانب الهوي و البدعة⁴

Këto janë domethëniet bazë të fjalës ‘el-xhemaatu’. Natyrisht se ekzistojnë edhe komentime tjera suplementare të nocionit ‘el-xhemaatu’, porse këto që u potencuan në masë tejet të duhur përbëjnë përfshirjen parimore të këtij nocioni.

Nga sa u pa më lart përdorimi i fjalës ‘el-xhemaatu’ në kontekst të përbërjes “ehlus-sunneti vel xhemaati”, bart mundësinë e përdorimit të saj në njërin prej kuptimeve të mundshme.

Pa dyshim, se moskonsensusi i dijetarëve rreth precizimit dhe përcaktimit se çka në të vërtetë përfshin ky nocion, pra, ‘el-xhemaatu’, ashtu si u parashtrua më lart, legalizon mundësinë e komentimit kontekstual të tij.

Dijetarët që ndjekin vijën konservatore, pa hezitim thonë se fjala ‘el-xhemaat’, ka të bëjë me sahabët dhe jo me dikë tjetër. Ata këtë e kanë thjesht një përdorim rutinë, dhe jo tjetër. Me këtë dhe forma të tjera, ata e justifikojnë konservatorizmin e tyre doktrinar, se me që ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’ posedojnë epitetin e grupit (xhemaatit) i cili duhet të ndiqet dhe respektohet, mundohen që këtë përbërje me çdo kusht ta vënë në shërbim të tyre. Pa dyshim se ky është vetëm një

qëndrim provincial dhe i njëanshëm, prandaj dhe nuk përbën kurrfarë rëndësie në shkencë.

Është më se e vërtetë se të gjithë dijetarët kanë mundur të thonë se me fjalën “el-xhemaatu” janë për qëllim sahabët. Sepse secili prej myslimanëve, në kuptimin gjithëpërfshirës të tyre, i admiron ata dhe është i bindur se e ndjek rrugën e tyre, dhe kështu ndjek rrugën e Resulullahit s.a.v.s.. Mirëpo, ata duke i ndenjtur besnik interpretimit shkencor kanë paraparë në mënyrë të barabartë për fjalën ‘el-xhemaatu’ edhe domethënie tjera simotra të kësaj. Ndërkohë që kjo nuk e zbeh fare, të vërtetën e ndjekjes së rrugës së sahabëve.

Do të thotë, aq sa kemi të drejtë që të themi se me fjalën ‘el-xhemaatu’ janë sahabët, po aq kemi të drejtë të themi se me këtë fjalë është për synim: ai që është i rrokur për të vërtetën edhe nëse është një person. Pastaj, po aq kemi të drejtë të mendojmë se me fjalën ‘el-xhemaatu’ është për qëllim apo synohet: **‘es-sevadu’l a’dham’**: shumica absolute e shoqërisë së një kohe etj. Përcaktimi bëhet sipas elaborimeve të gjithanshme.

Mirëpo, duke e marrë parasysh kohën kur është themeluar ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’, përkatësisht kur fjala ‘el-xhemaatu’ ka gjetur përdorim në këtë përbërje, del përfundimi se me këtë fjalë, nga aspekti i emërimit, por jo nga i cilësimit, më së paku mund të jenë për qëllim sahabët. Vetë parashikimi i domethënies të tjera për fjalën ‘el-xhemaat’, e bën të qartë se kjo fjalë në kontekstin kohor kur është paraqitur në opinionin e gjerë të myslimanëve, nuk ngjason që t’i ketë për përcaktim sahabët. Qëllimi është për nga koha kur, fjala ‘el-xhemaatu’ fillon të përdoret në këtë përbërje të kontekstit “ehlus-sunneti vel xhemaati”, sepse siç do ta shohim në vijim fjala ‘el-xhemaat’ me këtë konotacion nuk është përdorur në kohën e Resulullahit s.a.v.s. e as në shekullin e parë hixhrij.

⁴ <http://www.islamweb.net/ver2/archive/readArt.php?lang+A&id+66723> (“esh-shebeke-tu’l islamijetu” rubrika: ‘ardu’l mekalat’ e datës:13.12.2004)

Domethënia e asociimit të fjalës ‘el-xhemaatu’ në sahabët

Asociimi i fjalës ‘el-xhemaatu’ në korrelacion me sahabët në përbërjen doktrinare të epitetit “ehlus-sunneti vel xhemaati”, mund të vështrohet nga dy aspekte:

1. Nga aspekti vertikal, i cili nënkupton **cilësimin** dhe
2. Nga aspekti horizontal, i cili nënkupton **përcaktimin- identifikimin**.

- Nga aspekti vertikal, sipas të cilit ‘el-xhemaatu’, simbolizon vazhdimin apo lidhshmërinë e gjeneratave të më vonshme me pararendësit e tyre sahabët, rreth artikullimit të tërësisë doktrinare të bazave të besimit nëpër kohë, gjeneratë pas gjenerate, deri në Ditën e Kijametit, e në pajtueshmëri të plotë të artikullimit të tyre sipas frymës së sahabëve, atëherë kjo fjalë **asocon plotësisht në sahabët**, sepse ato parime të besimit që janë transmetuar nga Pejgamberi a.s., gjegjësisht nga sahabët, po ato janë edhe të gjeneratave tjera me radhë që i kanë ndenjur apo do t’i qëndrojnë besnikë transmetimit të tyre dhe që myslimanët i kanë akceptuar apo do t’i akceptojnë me kabul-pranim, grup i cili në gjeneratat e mëvonshme (pas shekullit III sipas hixhretit) do të njihet me epitetin “*ehlus-sunneti vel xhemaati*”.

Në këtë relacion, asociimi i fjalës ‘el-xhemaatu’ në sahabët, është e karakterit **cilësues apo përshkrues**, e jo *identifikues* apo *përcaktues*. Që do të thotë se ‘ehlus-sunneti vel xhemati’ janë ata që mbajnë rrugën e drejtë, rrugën e Resulullahit s.a.v.s dhe të shokëve të tij në sferën e akaidit (besimit). Atribuimi i fjalës ‘el-xhemaat’, me sahabët, është për shkak se sahabët janë të denjë apo janë “emblemë” që i bartin dhe i gërshetojnë cilësimet me të cilat më vonë do të karakterizohet ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’, sikurse janë: “*el-ferkun-naxhijetu*” – grupi i shpëtuar, pastaj “*et-taifetul mensuretu*” - grupi i ndihmuar, dhe të tjera, por jo se kjo fjalë në aspektin teknik ka të bëjë me sahabët në relacionet kohore, kur dihet se ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’ me këtë përbërje të plotë është formuar pas kohës së sahabëve. Sikur ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’ me këtë përbërje të plotë, të ishte themeluar

në kohën e sahabëve, atëherë nuk do të vinte në shprehje absolutisht përdorimi i alternativave të domethënieve tjera të kësaj fjale, porse do të thuhej se me të janë për qëllim sahabët, dhe me këtë nuk ka kush që nuk do të pajtohej. Mirëpo, ja që realiteti bën që për këtë fjalë të parashihen dhe domethënie të tjera.

Pra, me “*ehlus-sunneti vel xhemaati*” është për qëllim konkluzë e dispozitës së subjektit, në këtë rast e shprehur përmes sahabëve, si njerëz që identifikojnë ‘simbolikën’ e transmetimit korrekt të besimit të drejtë nga Resulullahi s.a.v.s kurse

- Nga aspekti horizontal, sipas të cilit ‘el-xhemaatu’ identifikon orientimin doktrinar të masës së gjerë të myslimanëve në përmasat globale të botës islame, në periudha të caktuara historike, kah një drejtim apo shkollë e caktuar akaidore, del se **kjo fjalë nuk i asocon sahabët**, por duke e sintetizuar aspektin e parë, e identifikon krahun e “ehlus-sunnetit” që përbëhet nga ndjekësit e Ebu’l Hasen El-Esh’arij-ut dhe Ebu Mensur El-Maturidijut, sikurse do të diskutojmë në vijim.

Prandaj, ky aspekt, është objekt i vështrimit të fjalës ‘el-xhemaatu’ në kuadër të përbërjes “ehlus-sunneti vel xhemaatit”, si dhe është **aspekti i përcaktimit të përdorimit të tij** në literaturën shkencore dhe jo aspekti i parë.

Sepse, sipas aspektit të parë, ekziston mundësia kur një mysliman (zakonisht i shtresës së gjerë), i artikulon bazat e besimit në pajtim të plotë me mënyrën se si i kanë interpretuar sahabët, por thotë me vetëdije të plotë se është pjesëtar që i takon ta zëmë ‘havarixhëve’ apo një grupi që sipas dijetarëve nuk konsiderohet brenda ‘ehlus-sunnetit vel xhemaatit’. Ky mysliman, për shkak se artikullimin e bazave të besimit e ka të drejtë, mirëpo në mënyrë të pavetëdijshme (rutinore) dhe të pajustificueshme identifikohet si simpatizues i një sekti, apo për shkak të imitimit, i tilli, është kushtimisht “ehlus-sunneti vel xhemaati” vetëm sipas aspektit të parë, pra, sipas *cilësimit* doktrinar të tij, por jo edhe sipas *përcaktimit* apo *emërtimit*. Mirëpo, sikur ai të dëshmojë se është ndjekës i njërit prej grupeve që bëjnë pjesë në “ehlus-sunneti vel xhemaati” e të cilat do t’i potencojmë pak më vonë, atëherë i tilli, konsiderohet pjesëtar i “ehlus-sunnetit vel xhemaatit” edhe sipas aspektit

të parë edhe sipas aspektit të dytë. Pra, edhe sipas *cilësimit* edhe sipas *përcaktimit*.

Po ashtu, ekziston mundësia, kur një mysliman thotë se e ndjek rrugën e sahabëve, ndërkohë që nuk e praktikon besimin e tyre, por e praktikon sipas fraksionit prapë ta zëmë “havarixh”, i tilli nuk është “ehlus-sunneti vel xhemaati”, as sipas *cilësimit*, e as sipas *përcaktimit*. Pra, as sipas mënyrës së parë e as sipas mënyrës së dytë.

Ndërsa, ai i cili deklaroi se është ndjekës i njërit prej grupeve pjesëtarë të ‘ehlus-sunnetit vel xhemaatit’, edhe nëse është me pozitë të ‘taklidit’ – imitimit, pa marrë parasysh se sa ka përgatitje profesionale për t’i ditur bazat e fesë, i tilli konsiderohet pjesëtar i “ehlus-sunnetit vel xhemaatit” edhe sipas **cilësimit** edhe sipas **përcaktimit**.

Kështu nga ky aspekt, do të ishte shumë vështirë, që të tërhiqet paralelja e cila vijëzon kornizat e përcaktimit të kësaj fjale.

Për këtë arsye e përmendëm më lart se objekt vështrimi i fjalës ‘el-xhemaatu’ në përbërjen ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’ është aspekti i dytë, pra, ai i *përcaktimit* apo *identifikimit*.

Në bazë të këtij elaborimi, fjala ‘**el-xhemaatu**’ asocon në sahabët, sipas *cilësimit*, që nënkupton “*bashkimin në bazat e besimit*”, por jo edhe sipas *përcaktimit* apo *identifikimit*. Sepse sikur të pranohej teza se kjo fjalë i asocon ata edhe sipas *përcaktimit* apo *identifikimit* atëherë, për gjeneratën e sahabëve do të konstatohej se ata janë: **‘ndjekësit e Sunnetit dhe vetvetes’**, gjë që kjo paraqet një paradoks.

Nga këtu na paraqitet nevoja për një analizë më të gjerë të përbërjes ‘ehlus-sunneti vel xhemaatu’, duke u fokusuar në:

1. **Definimin e formulimit “ehlu’s-sunneti ve’l xhemaati”**
2. **Koha kur u themelua “ehlu’s-sunneti ve’l xhemaati”, dhe**
3. **Kush bën pjesë në “ehlu’s-sunneti ve’l xhemaati”.**

Definicioni i “Ehlu-suneti ve’l xhemaati”

Ekzistojnë definicione të ndryshme rreth përbërjes ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’, varësisht nga orientimet ideologjike. Tjetër përkufizim japin ata që nuk e shohin si një objekt që duhet shkuar kah ai. Tjetër përkufizim japin ata që të gjithë të tjerët që nuk mendojnë sikur ata i hedhin në jobesimtar, e tjetër sigurisht jep ai i cili për një mysliman që beson bazat e imanit dhe të Islamit, druhet për ta gjykuar si jobesimtar.

Mirëpo, duke i pasur parasysh disa definicione, definicioni më kuptimplotë i mundshëm është ai që e ka dhënë Ibnu Es-Subkiu në “*Sherhu’l akidet’ibni’l Haxhib*” ku thotë:

إعلم أن أهل السنة و الجماعة كلهم قد إتفقوا علي معتقد واحد فيما يجب
و يجوز و يستحيل و إن إختلفوا في الطرق و المبادئ الموصلة لذلك

“Dije se ‘ehlus-suneti vel xhemaati’ janë të gjithë ata të cilët janë pajtuar për një besim të vetëm në fushat e domosdoshmërisë-obligueshmërisë, të lejueshmërisë dhe të pamundësisë, edhe në qoftë se kanë mospajtueshmëri në rrugët dhe principet që të çojnë tek ai (besimi i vetëm)⁵.

Ashtu sikurse shihet, ky definicion është mjaft adekuat, sepse të gjithë ata që besimin e kanë një, apo që bazat e besimit i kanë unikale, porse për ta vërtetuar atë përdorin rrugë dhe metoda të ndryshme, varësisht prej rrethanave, ata janë pjesëtarë të “ehlu’s-sunnetit ve’l xhemaati”. Ky definicion është që i druhet përgjegjësisë, kurse ka definicione të tjera të papërgjegjshme që shumicën e myslimanëve i konsiderojnë jashtë Islamit, me se dhe sipas tyre myslimanët kategorizohen si pakicë apo grupi më i vogël në botë, sepse ata që gjykojnë kështu janë një përqindje shumë e vogël e myslimanëve.

Ky term që nënkupton “ndjekësit e rrugës së të Dërguarit të Allahut dhe të bashkësisë së pasuesve të tij (as’habëve) në fushë të

⁵ Kemaludin Ahmed El Bejadij El Hanefij, “*Isharatu’l meram min ibarati’l imam*”, me tahkik të Jusuf Abdurr- Rrezak, botimi i parë, 1368/1949, Kajro, f. 298.

akaidit” (أهل سنة رسول الله و جماعة الأصحاب في باب العقائد)⁶ përdoret më shumë në formën e shkurtuar “*ithtarët e Traditës (pejgamberike)*” (**ehlu’s-sunne**). Disa herë, për të shprehur këtë koncept, përdoret edhe termi “*ithtarët e të Vërtetës*” (**ehlu’l hakk**).⁷

Kur u themelua epiteti “Ehlu’s-sun-neti ve’l xhemaati”?

Nuk ka diskutim se në kohën e Resulullahit s.a.v.s. nuk ka pasur përçarje të natyrës doktrinare në mesin e myslimanëve, sepse Pejgamberi a.s. ishte gjallë dhe jepte sqarim për çdo gjë. Në këtë kohë ndarje e shoqërisë ishte në katër grupe: **mumin-muslim** (besimtar-musliman), **munafik** (hipokrit), **mushrik** (politeist) dhe **kafir** (pabesimtar).⁸ Besimtarët ishin një grup në vete dhe nuk mund të flitej për ndasi të tyre brendapërbrenda vetvetes së tyre. Ata e përcillnin, e zbatonin dhe e respektonin çdo urdhër të Allahut të madhëruar, sqarim të Pejgamberit s.a.v.s. dhe nuk iu interesonte që të preokupohen për ndonjë çështje të besimit se a është ajo ashtu apo kështu. Kjo ishte absurd, ngase nuk mund të jepte dikush sqarime mbi sqarimet e Pejgamberit a.s. apo të nxitonte para tij. Ky veprim i sahabëve, për të gjallë të Pejgamberit a.s. dhe pas vdekjes së tij, nga dijetarët e mëvonshëm do të quhet si “**Ehlu-sunneti**”- *ndjekësit e Sunnetit*, por jo edhe “**Ehlu-sunneti vel xhemaati**” – *ndjekësit e Sunnetit dhe bashkësisë*, sepse shoqëria e myslimanëve të parë ishte një dhe nuk ekzistonte ndonjë ndarje mes sahabëve në baza doktrinare. Kur dihet se domethënia “ndjekës i bashkësisë” ka të bëjë kur ekzistojnë dy dhe më shumë grupe që kanë qasje të ndryshme doktrinare dhe njëri prej tyre fiton simpati më të madhe se të tjerët për shkak të qasjes më korrekte ndaj çështjeve me rëndësi në fe, me se dhe bëhet apo e fiton epitetin bashkësi (xhemaat-un), kundrejt grupit tjetër. Pra, një këso ndarje nuk kemi absolutisht për të gjallë të Pejgamberit s.a.v.s. sepse si thamë më lart gjithçka e

⁶ Shih: Et-Tafatazani, “*sherhu’l akaidi*”, f.16-17; “*sherhu’l mekasid*”, II, f.199; Esh-Shatibi, “*El-Muvafakat*”, IV, f.48-52, cituar sipas: Topaloglu, “*Hyrje në Kelam*”, po aty, fusnota - 1, f.111.

⁷ Topaloglu, “*Hyrje në Kelam*”, po aty, f.111.

⁸ Shih ajete: 6-16 të kaptinës El-Bekareh të Kur’anit.

sqaronte Pejgamberi a.s. Mirëpo, për të gjallë të tij dhe pas vdekjes së tij kemi “ehlu’s-sunnet” – ndjekës të rrugës së tij s.a.v.s.

Rrjedhimisht, sahabët kanë qenë vetë “Ehlu-suneti”, sepse e kanë ndjekur sunnetin e Pejgamberit s.a.v.s., edhe atëherë kur ndonjë veprim e kanë komentuar sipas rrjedhave kohore sikurse është rasti me Omerin r.a., i cili bie fetvanë (vendimin juridik) për pezullimin e fondit “**elmuell-lefetu kulubihim**” – që të mos derdhen mjete prej zekatit për përfitimin e zemrave të atyre që nuk janë myslimanë, ndërkohë që këtë nuk e ka bërë Pejgamberi s.a.v.s.. Por, kjo nuk do të thotë se Omeri r.a., për shkak të këtij interpretimi, ka dalë nga ndjekja e Sunnetit. Absolutisht. Kjo ka qenë një kërkesë e kohës dhe këtë racionalisht e ka shfrytëzuar Omeri r.a.

Kështu që, derisa nuk kemi ndarje në dy dhe më shumë pjesë të myslimanëve mbi bazën e konkluzioneve të **usulid-dinit** – bazave të fesë, nuk mund të bëjmë fjalë për përdorimin kontekstual të nocionit ‘el-xhemaatu’, por vetëm për fjalën **mysliman** apo **besimtar**. Me njërin prej këtyre dy emrave, e në raste të veçanta edhe me të dytë, është identifikuar gjenerata e parë. Sepse sikur fjala ‘el-xhemaat’ të mendohet se ka ekzistuar për të gjallë të Pejgamberit apo në kohën e sahabëve, kjo do të thoshte apriori pranimin e prezencës së përçarjes së tyre. Kjo nuk ka ndodhur.

Rrjedhimisht, vdekja e Pejgamberit a.s. sjell shkaqet e para për një ndarje të ardhshme të ymetit. Pas vdekjes së Resulullahit s.a.v.s. zënkat e para paraqiten se kush do të vijë në krye të shtetit Islam, por kjo gjë tejkalohet, dhe në fakt nuk mund të ndodhë ndonjë ndarje mes sahabëve, pa i mohuar aspiratat e hapura të disave për këtë post.

Pastaj, vrasja e halifit të tretë Osmanit, r.a., paraqet një ngjarje me rëndësi, të cilën, shumica dërrmuese e dijetarëve kur analizojnë shkaqet e ndarjes së ymetit në fraksione, këtë ngjarje e paraqesin si shkaktarin kryesor. Prej kësaj kohe, vazhdojnë luftërat e Aliut me Muaviun ashtu sikurse janë të njohura në histori, të cilat rezultuan me daljen në shesh të fraksioneve të para siç janë **havarixhët**, apo **harixhinjtë**, për t’u pasuar me **murxhitët**, **shiitët**, **xhehmitët** etj. Pastaj, debatet e hapura për **mëkatarin e madh**, ‘**kaderin**’ dhe ‘**kadan**’ e të tjera e të

tjera, pastaj **vrasja e hazreti Aliut, luftërat ndërmjet Talhasë dhe Zubejrit**, e kështu me radhë. Kostoja e këtyre ngjarjeve kishte rezultuar mbi të gjitha me:

1. *vëllavrasjen e dhjetëra mijë myslimanëve, e të gjithë në emër të Islamit, duke pretenduar se njëri është në të drejtë e tjetri jo, dhe*
2. *përçarjen e myslimanëve në shumë fraksione.*

Këto kohëra dhe ngjarje ishin elementet e para, të hapura që ndikuan në futjen e myslimanëve në një konfuzion dhe huti të thellë. Këtë e shtonte akoma më shumë depërtimi i kulturës dhe filozofisë helene. Të kësaj periudhe përmenden debatet e imamëve të mëdhenj sikurse janë Ebu Hanife r.a. Shafiju r.a. dhe të tjerë me predikuesit e mendimeve që kishin shtrembëruar nga rruga e vërtetë.

Në këtë vazhdë, vjen paraqitja e mu'tezilës në skenë, e cila paraqet një kapitull tejet të rëndësishëm në thellimin e këtij konfuzioni mes myslimanëve, pa marrë parasysh se në kohëra të caktuar kishin luajtur edhe rol konstruktiv duke rezistuar ndaj tendencave qëllimkëqija të kundërshtarëve të myslimanëve.

Këto ngjarje bënë që myslimanët të ndahen jo vetëm në dy grupe, por edhe më shumë. Pa dyshim se njëri prej këtyre shumë grupimeve ishte "*selefijje*" (tradicionalistët) e përbërë nga 'muhad-dithinët' dhe fukahenjtë, të cilët pikëpamjet e tyre rreth sqarimit të bazave të fesë i bazonin vetëm në '**nass**' (Kur'an dhe Sunnet), dhe mendjes nuk i jepnin kurrfarë pjesëmarrje. Ata quheshin "*ehlus-sunneti*" - ndjekësit e Sunnetit, por tanimë shoqëria myslimane ishte bërë pikë e pesë, dhe nuk e kishin të qartë se kënd duhet pasuar.

Duke filluar nga shekulli II hixhri, në botën islame, ndërsa nga njëra anë përhapeshin me rrugën e përkthimit dhe të veprave origjinale dituritë filozofike të mbështetura në mendje ('akl), nga ana tjetër kishte dalë në shesh Mu'tezile që gjithashtu i jepte shumë rëndësi mendjes dhe kishte filluar të përhapte pikëpamjet dhe opinionet e saj në fushë të akaidit. Besimi selefist që kishte bërë tipar (moto, devizë) të vetin lidhjen pas **nass**-it dhe nënshtrimin, përballë këtyre rrymave,

përballë pikëpamjeve mu'tezilite që posaçërisht tregonin potencial në një përhapje të shpejtë, tregohej, më në fund i pafuqishëm.⁹

Derisa në shekujt e parë mbretëronte besimi (akideja) e selefite në botën islame,"duke filluar nga shekulli II pas hixhretit, në kuptimin shkencor filluan të trajtësohen fraksionet sajuese (bid'atiste) dhe, pas shekullit III, u shfaqën fraksionet kelamiste të Ehli Sunnetit dhe u përhapën në të gjithë botën islame. Pas këtyre datave, përvetësuesit e besimit selefian qenë të pranishëm çdo shekull, por erdhën duke u pakësuar."¹⁰

Pra, mungimi i *selefijjes* për shkak të pafuqishmërisë së tyre që t'u përballojnë fuqishmërisë së argumenteve të fraksioneve bid'atiste, e veçantë të asaj të mutezilëve, bënë, që sikurse thotë dijetari i njohur Bekir Topaloglu, që "Në botën islame të ndihej nevoja për trajta të reja parashtrimi që, duke i mbetur, njëkohësisht, lidhur përcjelljes (nakl) në subjektet e themeleve të fesë (usulid-din), t'i jepnin rëndësi mendjes dhe, duke ndërthurur anët e mira të metodave të Selefite dhe Mu'tezilës, të mbeteshin brenda kuadrin të Ehl-i Sunnetit. Ata që iu përgjigjën kësaj nevojë dhe që përfaqësuan këtë rrymë të re që ne do të mund ta quajmë "Kelami i Ehli Sunnetit", ishin në Irak, Ebul Hasan El-Esh'ariju (v.324/936) dhe në Transoksani (Ma veraun-nehri), Ebu Mensur El-Maturidiu (v. 333/944)¹¹

Sikurse do të mësojmë, orientimet e këtyre dijetarëve, kishin një rrugë tejet të matur që penetronin ndërmjet teprimit dhe shkurtimit. Ndërmjet metodës së 'selefijes', e cila ishte tërësisht dështake për shkak të konservatorizmit të tepruar, në njërin anë, dhe ndërmjet mu'tezilës, e cila po ashtu ishte dështake duke i dhënë mendjes kompetencë më tepër sesa e bart ajo. Kështu, këta dijetarë, duke ndjekur një paralele të mesme, e duke u mbështetur në arsenalin tradicional, u fokusuan në diskualifikim e mu'tezilës, dhe pse jo edhe të mjerimit të selefijes, ndërsa duke mos u larguar dhe as tjetërsuar parimet e "*as'-habul kiramit*" dhe të tabiinëve. Metoda e tyre kishte një qasje, ashtu

⁹ Topaloglu, "*Hyrje në Kelam*", po aty, f.122-123.

¹⁰ Topaloglu, "*Hyrje në Kelam*", po aty, f.115.

¹¹ Topaloglu, "*Hyrje në Kelam*", po aty, f.123.

se si e kërkonte koha, por qëllimi final i fundamenteve ishte po ai i 'selefi salihit'. Prandaj, edhe në definicionin e domethënies së 'Eh-lus-sunnetit vel xhemaatit', që u cek më lart ndër të tjera është se rrugët dhe principet që çojnë te besimi i njëjtë dhe parimor mund të jenë të ndryshme, por jo edhe vetëbesimi.

Kjo bëri që këta dijetarë të marrin jehonë të madhe në masat e gjera të myslimanëve.

Faktikisht këtu vjen në shprehje mbështetja e fjalës 'el-xhemaatu' në përbërjen 'Eh-lus-Sunnet'. Do të thotë, orientimi i shumicës së myslimanëve kah Esh'ariju dhe kah Maturidiju, duke u transformuar në një bashkësi e cila ashtu sikurse përbënte pjesën dërrmuese të myslimanëve, ishte edhe kompakte në interpretimin e çështjeve të besimit sipas frymës së 'selefu salihit'. Ky kompaktivitet, me disa dallime të lehta periferike që megjithatë bashkohen në synim, mundësuan formimin e formulimit "**Eh-lu's-sunneti vel xhemaati** – ndjekësit e sunnetit dhe bashkësisë. Ngase plasaritjet mes myslimanëve duke u ndarë në shumë grupime në njërën anë dhe kolapsi i një gjendjeje konfuzioni, që i kishin futur mutezileja dhe selefije në anën tjetër, krijuan mundësinë e re, ku tubimi i masës kah mendimi i ri i Maturidiut dhe Esh'arijut, të formojë apo vejë në lëvizje nocionin "**el-xhemaatu**"- bashkësia.

Këta dy dijetarë, bazat e besimit ua kishin ofruar myslimanëve në mënyrë shumë korrekte dhe të unifikuar sipas Kur'anit, Sunnetit dhe konsensusit të sahabëve, ndërsa parashtrimi i tyre bëhej me një metodë që arsyet i jepte pjesëmarrjen e duhur, ndërmjet teprimit dhe shkurtimeve. Metoda e këtyre dy dijetarëve, ishte e vetmja e kohës që arriti edhe ta unifikojë:

1. **përmbajtjen e bazave të besimit** kundrejt poleve ekstreme të mutezilës dhe selefijes, por edhe që ta unifikojë
2. **masën e gjerë të myslimanëve** që kishin rënë pre e kontradiktave.

Ky parashtrim i unifikimit të bazave të besimit, që e sfidonte edhe *selefijen* edhe *mutezilen*, nga njëra anë dhe bashkimi i masave të gjera të myslimanëve në anën tjetër, e krijuan nocionin 'el-xhemaatu'- ba-

shkësia. Në këtë rast unifikimi apo bashkimi i bazave të besimit, dhe unifikimi apo bashkimi i pjesës dërrmuese të myslimanëve.

Ndërsa, kjo përputhet në çdo aspekt me të gjitha domethëniet gjuhësore dhe terminologjike, që janë potencuar më lart për fjalën 'el-xhemaat'.

Nga aspekti gjuhësor nëse themi se fjala 'el-xhemaat', e ka domethënien "**shumicë**", kjo është e vërtetë, sepse vërtet ky epitete, pra "Eh-lus-sunneti vel xhemaati", përbënte shumicën absolute të myslimanëve të asaj kohe. Nga ana tjetër, nëse themi se ajo e ka domethënien "**bashkësi**", dhe kjo është e vërtetë, sepse parashtrimi i bazave të besimit në mënyrë të unifikuar si dhe koncentrimi i besimtarëve drejt një përbashkimi, përbëjnë bashkësinë e vërtetë.

Ndërsa, nga aspekti terminologjik, nëse themi se me fjalën 'el-xhemaat' janë **sahabët**, kjo është e vërtetë, sepse besimi apo akideja e këtyre dy dijetarëve të mëdhenj është e njëjtë me të tyre, përpos se rruga dhe principet që çojnë deri tek ai, aty këtu mund të kenë ndonjë nuancë dallueshmërie që janë varur detyrimisht nga rrjedhat kohore, (sikurse bie fjala që ishte rasti i Omerit r.a. me pezullimin e pjesës së citatit "**el-muel-lefetu kulubihim**"), por assesi pa u larguar nga metoda e tyre.

Nëse thuhet se fjala 'el-xhemmat', **nënkupton atë i cili është rrokur për të vërtetën edhe nëse është një**, atëherë edhe kjo është e vërtetë, sepse ky drejtim ka filluar me iniciativa vetjake apo personale sikur që janë dijetarët Esh'ariu dhe Maturidiu.

Nëse thuhet se fjala 'el-xhemaatu' e ka kuptimin e "**Es-sevadu'l a'dham**" shumicës absolute të myslimanëve të një kohe të caktuar që e ndjekin një imam i cili gjykon me sheriat, edhe kjo është po ashtu e vërtetë, sepse masat e gjera që e ndiqnin Maturidiun, përbënin mazhorancën absolute të myslimanëve, prej se është formuar ky drejtim, pra, drejtimi i "Eh-lus-sunnetit vel xhemaatit", që nga fundi i shekullit të tretë dhe fillimi i shekullit IV hixhrij, e deri në ditët tona.

Këtë qëndrim, te ne, e mban edhe mr. Naim Tërnavë, i cili pasi bën një kronologji të shkencës së Kelamit Sunnij, nëpër kohëra, thotë:

“Më sipër theksuam se Esh’ariu dhe Maturidiu morën një qëndrim në mes të mësimëve të mteziles dhe të Ehli Sunnetit, që është një rrugë e matur në studimin dhe shqyrtimin e shumë çështjeve të besimit. Me këtë veprim ata arritën famë shumë të madhe në mesin e masës së gjerë të besimtarëve. Dijetarët e mëvonshëm drejtimin e tyre e emërtuan si “Ehli Sunneti vel xhemaati”, kurse dihet që tradicionalistët më herët u quajtën “Ehli-Sunnet”.¹²

Për këtë arsye dhe arsye të tjera konkludojmë se fjala ‘el-xhemaat’, përkatësisht, përbërja “**Ehlius-Sunneti vel xhemaati**” ekskluzivisht ka të bëjë me Maturidijun dhe Esh’arijun, kurse formulimi “**Ehlius-Sunneti**” i cili ka qenë i pranishëm deri në kohën e daljes në skenë të Maturidiut dhe Esh’ariut, të njohur tanimë prej masave të gjera si ‘Ehlius-sunneti velxhemaati’, ka të bëjë ekskluzivisht me ‘selefijen’ (tradicionalistët).

Këto dy dijetarë njëherësh, janë edhe themeluesit e shkencës së Kelamit Sunnij.

Maturidijje (maturidizmi) paraqet krahun e madh të kelamistëve të Ehlius-sunnetit që ndjekin rrugën e të Dërguarit të Allahut dhe të pasuesve të tij (as’habëve) në fushë të akaidit, por që gjatë parashtrimit dhe vërtetimit kanë përvetësuar metodën e kelamit. Krahun tjetër e formon Esh’arijje (esh’arizmi)¹³

Mirëpo, meqë “esh’arizmi dhe maturidizmi, megjithatë janë dy identitete të ndara, në raste të caktuara esh’arizmi e përfaqëson maturidizmin, sikurse është rasti kur “esh’arijje përmendet si antitezë e sajuesve (ehli bid’at), brenda saj nënkuptohet edhe Maturidijje”¹⁴. Sikundër, nga ana tjetër Maturidiju mbërthen më vete identitetin e “ehlius-sunnetit vel xhemaatit”, sikurse janë epitetet: **reisu ehlius-sunneti vel xhemaati** (رئيس أهل السنة و الجماعة) – kryetari i ‘ehlius-sunnetit vel xhemaatit’, pastaj **‘alemu’l huda** (علم الهدى) – shenjë e

udhëzimit në rrugën e drejtë, **imamu’l huda** (إمام الهدى) – prijatar i udhëzimit në rrugën e drejtë, etj.

Prandaj, shumica e dijetarëve mbajnë qëndrimin se “fjala bashkësi (xhemaat) e përdorur këtu, ashtu siç nënkupton **as’habi kiramin**, nënkupton edhe **shumicën dërrmuese të myslimanëve të çdo periudhe** (sevadi a’ dham), dijetarët muxhtehidë, ose bashkësinë e myslimanëve që i janë lidhur të njëjtit udhëheqës shteti”¹⁵

Sipas kësaj të vërtete, fjalën ‘el-xhemaatu’ në gjuhën shqipe mund ta përkthejmë si “**bashkësi**”, pra “**ndjekësit e Sunnetit dhe bashkësisë**”, ku kjo do ta sintetizonte në domethënie e saj në mënyrë korrekte, në radhë të parë:

1. **Aspektin vertikal** të saj, që konsiston **bashkësinë** e sahabëve, tabiinëve dhe tebei tabiinëve në bazat e besimit e të transmetuara dhe profilizuara në mënyrë besnike përmes themeluesve të Ehlius-Sunnetit vel xhemaatit, Esh’arijut she Maturidijut e deri në ditët tona; dhe së dyti:
2. **Aspektin horizontal** që konsiston “**es-sevadu’l a’dhami**”-shumicën absolute të myslimanëve të një periudhe (ku sipas këtij konteksti vjen në shprehje alternativa e përkthimit të fjalës ‘el-xhemaatu’ me “**shumicë**”). Ndërsa “**es-sevadu’l a’dhami**” është ai i cili e bashkon edhe
 - *bashkësinë e myslimanëve* në vijën vertikale të bazave të besimit, sepse bazat e besimit janë po ato që kanë qenë të sahabëve, por edhe
 - *shumicën e myslimanëve* në vijën horizontale, mbi bazën e kuantitetit, sepse në parim ‘ehlius-sunneti vel xhemaati’ prej themelimit të tyre nga koha e Esh’arijut dhe Maturidijut e deri më sot janë shumicë absolute e myslimanëve të mbarë botës.

Prandaj në bazë të këtij elaborimi, unë preferoj që fjala ‘el-xhemaatu’ në përbërjen ‘ehlius-sunneti vel xhemaati’, të përkthehet me “bashkësi”- ndjekësit e Sunnetit dhe bashkësisë”. Kjo mendoj është

¹² Naim Tërnavë “Fraksionet në Islam – akaidi – 4” boton Medreseja e Mesme Alaud-din e Prishtinës, Prishtinë, 1997, f.86.

¹³ Topaloglu, “Hyrje në Kelam”, po aty, f.122.

¹⁴ Topaloglu, “Hyrje në Kelam”, po aty, f.122.

¹⁵ Shih: Esh-Shatibi, “**El-i’tisam**”, II, f. 258-265, cituar sipas: Topaloglu, “Hyrje në Kelam”, po aty, f.111, fusnota 1.

më parësore, kurse nuk prish punë që të përkthehet edhe si “ndjekësit e Sunnetit dhe shumicës”.

Kush bën pjesë në “ehlu’s-sunneti ve’l xhemaati”?

(من هم أهل السنة و الجماعة؟)

Nga sa u tha, “Ehlu-sunneti vel xhemmaati” përbëhet prej dy grupeve kryesore: simpatizantëve të Ebi Hasan El-Esh’arijut dhe simpatizantëve të Ebi Mensur El-Maturidijut¹⁶

Prandaj, kur nocioni ‘Ehlu-sunneti vel xhemaati’ përgjithësohet (أطلق) me të synohen **esh’arinjtë** dhe **maturidinjtë**¹⁷.

Mirëpo, meqë secili besimtar duhet ta synojë unifikimin e masave të gjera të myslimanëve, krahas ndarjes së tyre në shumë grupime, dijetarët e mëvonshëm e kanë preferuar që nocioni ‘ehlu-sunneti vel xhemaati’ të përdoret për të gjithë ata myslimanë që bazat e besimit i kanë të njëjta, pra që janë unik në ato, porse mënyra për të arritur deri tek ai përmban rrugë të ndryshme.

Kështu në mënyrë të përgjithshme (bi’l-xhumleti), mbi bazën e induktimit, “**ehlu-sunneti vel xhemaati**” janë tre grupe:

Grupi i parë janë: ithtarët e hadithit (أهل الحديث) të cilët principet e tyre i mbështesin në argumentet e dëgjimit – Kur’ani, Sunneti dhe Ixhmai’

Grupi i dytë janë: ithtarët e vrojtimit racional (أهل النظر العقلي), e të cilët janë esh’arinjtë dhe hanefinjtë. Dijetari i esh’arinjve është Ebu’l Hasen El-Esh’ariju, ndërsa dijetari i hanefinjve është Ebu Mensur El-Maturidiju. Ata janë në pajtim të plotë për principet mendore për çdo çështje për të cilën nuk vjen argumenti i dëgjimit; për principet e dëgjimit në atë që vetëm mendja arrin ta njohë lejueshmërinë e saj, dhe për principet mendore dhe të dëgjimit në të gjitha të tjerat përveç tyre. Ata janë pajtuar në të gjitha çështjet e besimit, përpos në disa prej tyre.

Grupi i tretë janë: ithtarët e ndjesisë dhe zbulimit (أهل الوجدان و الكشف) dhe ata janë **sufinjtë**. Në fillim ata për principe të tyre i kanë principet e dy

grupeve të para, ndërsa në fund, ata për principe e kanë zbulimin-relevimin dhe inspirimin (الكشف و الإلهام).¹⁸

Sikurse duket, grupet që janë pjesëtarë të Ehlu-sunnetit vel xhemmaatit, përbëjnë shumicën e myslimanëve. Ky është një përcaktim real, pa pasur nevojë që të përfshihen me emra të veçantë edhe nën-grupet e tjera veç e veç, sikurse janë: *specialistët e leximit të Kur’anit, tefsirologët, pastaj dijetarët e sarfit* – morfologjisë, *nahvit* – sintaksës, *lugat-it-* lingvistikës etj. Mirëpo, të gjitha këta rreshtohen në njërin prej tri grupeve.

Me këtë përcaktim, nuk synohet të thuhet se grupet tjera nuk janë pjesëtarë të Islamit, porse me këtë dëshirohet të vihet në pah grupi i paalternativë në rrugën e drejtë dhe që duhet të ndiqet.

Sepse, askush nuk ka të drejtë që myslimanët t’i përjashtojë nga Islami. Mënyrat se si e konceptojnë atë, duhet parë si diçka që janë të pashmangshme. Për faktin se, ato kanë filluar të ekzistojnë menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit a.s. apo më saktë pas gjysmës së dytë të shekullit I. Në ato shekuj për të cilët Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë se janë më të mirët se të gjithë shekujt tjerë. Akuza për mohim të fesë ndaj një myslimani që i beson bazat e imanit dhe të islamit, është një dukuri tepër e rrezikshme në përgjegjësi.

Këtë më së miri e shpreh Imam Ebu’l Hasen El-Esh’ariju i cili thotë: “*Njerëzit pas (vdekjes së) Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem janë ndarë në mendime të ndryshme rreth shumë gjërave (eshjain kethiretin). Disa prej tyre, rreth këtyre gjërave, i kanë hedhur disa të tjerë në devijim (ضلل) duke u distancuar njëri nga tjetri, me se dhe u transformuan në fraksione kontradiktore (فرقا متباينين) dhe parti të shpërndara (أحزابا متشتتين).* **Mirëpo, Islami është ai që i tubon të gjithë ata dhe i pranon në gjirin e vet** (يجمعهم و يشتمل عليهم).”¹⁹

Sa u përket qëndrimeve ekstreme dhe përçarëse të konservativistëve ekstremë, të motivuara nga aspiratat injorante sikurse ai i Uthej-

¹⁸ El Bejadij El Hanefij, “*Isharatu’l meram...*”, po aty, f. 298.

¹⁹ El-Esh’arij, El-Imam Ebi’l Hasen Alij bin Ismail “*Kitabu mekalati’l islamijine ve ihtilafi’l musal-line*” me korrektim të Hellmut Ritter, botimi i tretë, 1400 h / 1980, pa vend botimi, f. 1-2.

¹⁶ Naim Tërnavë “*Fraksionet në Islam...*” po aty, f.85.

¹⁷ El Bejadij El Hanefij, “*Isharatu’l meram...*”, po aty, f. 298.

minit ku thotë se: "esh'arinjtë, maturidinjtë dhe të tjerë nuk janë prej "ehli Sunnetit ve'l xhemaatit"²⁰, më se dhe merr guxim që t'i gjykojë me përjashtim shumicën absolute të myslimanëve nga grupi i 'ehlus-sunnetit vel xhemaatit', përkatësisht duke i përjashtuar mu themeluesit e "ehlus-sunnetit vel xhemaati", disi bie në përngjasim me qëndrimin kryeneç të krishterëve që e mbajnë ndaj myslimanëve. Myslimanët e pranojnë pejgamberin e Isait a.s., ndërsa ata nuk e pranojnë pejgamberin e Muhamedit a.s. E njëjta gjë po ndodh këtu. Hanefinjtë-maturidinjtë i pranojnë në gjirin e 'ehlus-suneti vel xhemaatit', të ashtuquajturit "selefizmin" pakicë, ndërsa ata nuk e pranojnë maturidijen dhe esh'arijen shumicë në 'ehlus-suneti vel xhemaati'. Absurd.

a) Mbi grupin e parë

Ky grup, zakonisht janë ata që konkluzionet e tyre studimore dhe të besimit i mbështesin vetëm në tri burimet e lartcekura, duke mos i dhënë aspak pjesëmarrje arsyes dhe burimeve tjera të njohjes. Zakonisht ky grup, përgjatë gjithë historisë është shquar dhe dalluar me konservatizëm të tepruar dhe nuk ka mundur që t'u rezistojë mendimeve që për bagazh i kanë pasur dituritë e tjera sekulare. Vazhdimisht kanë pësuar disfatë në diskutime me fetë tjera dhe intelektualët tjerë të profileve filozofike, sepse të tillët dijen e tyre e argumentojnë vetëm me këto burime, ndërsa është fare e qartë se këto burime janë të respektuara vetëm për myslimanët e jo edhe për jobesimtarët të cilët as nuk i pranojnë dhe as nuk i llogarisin për argumente. Dijetarët e këtij grupi, në kohën bashkëkohore, kanë mbetur vetëm intelektualë të 'oborrit të xhamisë', pra për shtresat e thjeshta të myslimanëve dhe asgjë nuk kanë të bëjnë me pjesëmarrje në trendet botërore dhe me kërcënimin që po vjen nga rrymat bashkëkohore të natyrës së ekzistencializmit, modernizmit, ateizmit, sekularizmit etj. Këto rryma, këta dijetarë i sulmojnë vetëm nga distanca dhe me hamendje dhe nuk kanë përgatitje intelektuale për t'u ballafaquar për diskualifikimin e

²⁰ Muhamed bin Salih El Uthejmin, "Mexhmuu fetava-fetavel akideti", xhemun ve tertibun Fehd bin Nasir bin Ibrahim Es-Sulejman, boton 'Daruth-thurija lin-neshri', botimi i dytë 1414/1994, vëllimi tetë, f. 685-686.

tyre, sepse ajo që do të mund t'i ndihmonte për këtë është shkencë e **ilmu'l kelamit** (apologjia islame), ndërsa këta, këtë shkencë nuk e preferojnë për ta lexuar, madje e konsiderojnë të ndaluar. Prandaj, dhe për këtë shkak, këta dijetarë, përballë arritjeve të mahnitshme të shkencës, mbeten vazhdimisht të prapambetur dhe të padenjë për ta mbrojtur me anë të argumenteve, sovranitetin e besimit të pastër islam. Për ta mbrojtur këtë besim duhet pa tjetër që të përdoret krahas argumenteve tradicionale edhe argumenti i mendjes dhe krahasimeve logjike.

Të tillët po ashtu besimin e konsiderojnë si dhuratë që dhurohet e jo si diç që duhet angazhuar për ta arritur apo vërtetuar atë. Pikërisht dhe për këtë, për shumë çështje të besimit, që megjithatë janë provuar nga rrymat e ndryshme joislame, kanë mbetur të bllokuara dhe nuk kanë mundur ta arsyetojnë atë besim. Tani në kohën kur të arriturat shkencore kanë përparuar mjaft shumë, të mendosh se metoda e krahut 'selefije', vetëm përmes '**nassit**' (argumenteve tradicionale), mund të kontribuojë në ruajtjen e integritetit të pastër të akides së Selefi Salihit, është më tepër se aventurë emocionale dhe zhgënjim.

b) Mbi grupin e dytë

Ky grup, krahas mbështetjes në argumentet tradicionale, u jep sovranitetin e duhur edhe mendjes dhe krahasimeve logjike. Është tepër primitivizëm të mendohet se ky grup nuk bazohet në argumentet tradicionale. Këta pos që në dijen e tyre i kanë argumentet tradicionale, i kanë po ashtu edhe argumentet racionale, me se dhe bëhen të pampostur në konkluzionet e besimit.

Për shembull, derisa krahu konservator mendon se cilësitë e Allahut nuk mund të vërtetohen me anë të arsyes²¹, porse vetëm me anë të argumenteve tradicionale, gjoja se arsyeja nuk ka mundësi që të arrijë njohjen e tyre, dijetarët e grupit të dytë pohojnë të kundërtën se, përpos vërtetimit të Kur'anit dhe hadithit ndaj emrave dhe cilësive, edhe mendja ka mundësi që t'i vërtetojë ato.

²¹ Shih: El-Uthejmin, "Mexhmuu fetava ...", po aty, f. 8/62.

Lidhur me këtë, kryesuesi i ‘ehlus-sunneti vel xhemaati’, imam Ebu Mensur El-Maturidiju thotë:

“Edhe mendja i vërteton ato, sepse kur vërtetohet se Allahu xh.sh. ka krijuar gjëra (sende) që përbëhen prej substancave dhe aksidencave të veçuara me veçori dhe specifika të ndara, atëherë kjo argumenton se veprimet e Tij nuk janë veprime të natyrës, por janë veprime me anë të zgjedhjes (el-ihitjar)”.²²

Gjithashtu harmonizimi i veprimeve suksesive (të mbarëvajtshme) të shfaqura pa kurrfarë çrregullimi dhe as thyerje të rregullit të caktuar, vërteton ekzistimin e të vepruarës nga vepruesi me anë të preferencës-zgjedhjes, dhe vërtetohet se krijimi është me veprimin e Tij të vërtetë (të planifikuar)... Ndërsa kur vërtetohet (ekzistimi) i preferencës-zgjedhjes, vërtetohet pjesëmarrja e “**fuqisë**” (el kudretu) dhe e “**vullnetit**” (el iradetu) në krijim, në mënyrë që krijimi të jetë sipas asaj që Ai dëshiron të jetë.²³ Ndërsa, ‘**fuqia**’ dhe ‘**vullneti**’ janë prej cilësive të Allahut xh.sh. Kështu sipas këtij elaborimi, pra edhe me anë të mendjes vërtetohen cilësitë e Allahut, me karakter absolut përkatës, për veprime të caktuar, si p.sh. kënaqësia e Allahut është kur njeriu ndjek rrugën e tij, e jo e kundërta.

Ja ky është një shembull konkret. Në këtë mënyrë ky grup janë të vetmit që mund ta ruajnë besimin e pastër islam dhe t’u rezistojnë tendencave të armiqve që synojnë ta rrënojnë këtë besim. Duke e përdorur argumentin logjik dhe pa e kundërshtuar fare Kur’anin dhe Sunnetin, mund të vihet te një përfundim i drejtë edhe për myslimanët edhe për armiqët, të cilët nuk e konsiderojnë Kur’anin e as Sunnetin e as ixhmain për argument, por që e konsiderojnë logjikën dhe bazat e saj.

Në këtë formë, imam Maturidiju, mbi bazën e direktivave të shpalljes (Kur’anit dhe Synnetit) mbështetet në mendje, duke e konsideruar atë dhe përdorimin e saj në të kuptuarit e konkluzioneve të besimit,

²² Ebi Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud, El Maturidijj Es-Semerkandij “*Kitabut-tevhid*”, tahkik dhe ta’lik prof.dr. Bekir Topalloglu dhe dr. Muhamed Aruçi, boton ISAM-i (Turkiye Diyanet Vakfi) me nr.318, botimi i parë, 1423/2003, Ankara, f. 70.

²³ El Maturidijj Es-Semerkandij “*Kitabut-Tevhid*”, po aty, f. 70-71.

si obligim të pashmangshëm, sikurse thotë imam Ebu Zehre: Maturidiju është ai i cili e obligon shikimin me anë të mendjes duke i kundërshtuar me këtë fukahenjtë dhe muhad-dithinët, të cilët obligojnë mbështetjen vetëm sipas transmetimit, dhe se të vërtetën duhet kërkuar prej transmetimit e jo në ndonjë gjë tjetër pas kësaj, në shenjë frike se mendja mund të bjerë në lajthitje e të humbet. Ai (Maturidiju), duke e refuzuar këtë rezonim, në librin e tij “**Kitabu’t-tevhid**” thotë:

“Me të vërtetë, kjo është prej intrigave të shejtanit dhe prej vesveseve të tij, sepse ai që mohon rolin e meditimit, nuk mund të ketë argument tjetër përpos vetë meditimit (ليس لمنكري النظر دليل إلا النظر). Nga këtu, kjo ua obligon atyre thënien për nevojën e domosdoshme të meditimit (en-nadhru). Si mund që ata ta mohojnë meditimin ndërkohë që Allahu i madhëruar u ka bërë thirrje robërve të Tij për meditim dhe i ka urdhëruar me të menduar dhe persiatje (و أمرهم بالتفكر والتدبر) dhe i ka obliguar me të mësuar (menduar) dhe me shqyrtime (بالإعتاب والإعتبار)? Kjo është argument se meditimi dhe të menduarit janë një burim prej burimeve të dijës.”²⁴

Kjo ka bërë që esh’arinjtë dhe maturidinjtë, veçanërisht këta të fundit të shquhen, me përkrahjen e masës së gjerë të myslimanëve.

Islami e ka fytyrën e vërtetë të tij vetëm atëherë kur është në gjendje që t’u rezistojë të gjithëve. Madje jo vetëm t’iu rezistojë, por edhe t’i turpërojë në esencë. Nuk mund të bëhet fjalë për një islam burimor e që ai të mos jetë në gjendje t’i arsyetojë bazat doktrinare të tij sikurse që në këtë aspekt kanë pësuar debakël në kohën e hershme, muhadithinët dhe një pjesë e fukahenjve.

Të mendosh se Maturidije dhe Esh’arije nuk kanë pasur nevojë që t’ia japin sovranitetin e duhur mendjes, këtë sovranitet që Allahu i madhëruar ia ka dhënë, jo vetëm se është thyerje e urdhrave të Kur’anit dhe Sunnetit, kjo nuk diskutohet, porse është edhe kundërshtim i qartë që i bëhet urdhrave të Allahut. Të mendosh se sot në kohën tonë mund t’i luftosh rrymat moderne, sikurse janë ‘ekzistencializmi’, ‘se-

²⁴ Muhammed Ebu Zehre, “*Tarihu’l medhahibi’l islamijeti – fis-sijaseti ve’l-akaidi*”, pjesa e parë boton ‘Daru’l fikri’l arebijj, pa vend dhe vit botimi 1/177.

kularizmi' dhe të tjera me gjithë hovin e madh të tyre, vetëm me anë të 'nassit' (argumenteve tradicionale), kjo do të thotë brohoritje për dështimin e metodave të Fesë Islame, dhe kjo është më tepër se anormali.

Metoda që e kishte përdorur Maturidiju, përmes shkencës së 'ke-lamit', (apolegjetikës), jo vetëm se ishte e nevojshme në atë kohë të retorikës dhe kur muhadithinët dhe fukahenjtë kishin dështuar në përpjekjet e tyre për ta ruajtur sovranitetin e besimit islam, por ishte e domosdoshme sikurse që është po ashtu e domosdoshme edhe sot e gjithnjë.

Imam Maturidiu, luftoi që akideja islame të ketë unitetin e saj dhe ai ishte protagonist kryesor që krahas sfidave të kohës, kishte arritur që akiden islame të unifikojë në një tërësi të vetme sa që është e pamundur që në të të gjesh kontradiktë.

Ja edhe një shembull:

Pjesëtarët e grupit konservativ, thonë se tekstet e Kur'anit duhet interpretuar ashtu sikurse janë, pa marrë parasysh se aspekti i jashtëm i tyre, përmban elemente të antropomorfizmit. Ndërsa, dijetarët e "eh-lus-sunnetit vel xhemaatit" pohojnë se pa iu larguar tekstit, pra pa e mohuar dukjen tekstuale të tyre, ata duhet të komentohen në dritën e ajeteve të qarta, në të kundërtën vjen deri te kundërshtimi i Kur'anit me Kur'an, apo te kundërshtimi i pikëpamjeve të besimit, ndërsa një gjë e tillë është absurde që të ndodhë.

Njëri prej shembujve nga Kur'ani është ky:

Allahu xh.sh. thotë:

نَسُوا اللَّهَ فَنَسِيَهُمْ إِنَّ الْمُنَافِقِينَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

"...*Harruan Allahun* (nuk iu binden), *prandaj Ai i harroi* (nga mëshira)... " (Kur'ani, Et-Tevbeh: 67); dhe thënia e Tij:

فَالْيَوْمَ نَسَاهُمْ كَمَا نَسُوا لِقَاءَ يَوْمِهِمْ هَذَا

Po ashtu Allahu i madhëruar thotë:

"*Sot, pra ne i harrojmë ata sikurse e patën harruar takimin e kësaj dite të tyre...*" (Kur'ani, El A'raf: 51)

Në këto ajete potencohet se Allahu 'harron'.

Si mund të lejohet që harresa (en-nisjan) t'i atribuohet Allahut të madhëruar, kur dihet se ajo është prej llojit të gafletit (pakujdesisë), me se dhe Allahu është i pastër nga kjo, ku Ai vetë Thotë:

وَمَا كَانَ رَبُّكَ نَسِيًّا

"...*E Zoti yt nuk është që harron*" (Kur'ani, Merjem: 64).

Sipas kuptimit të dy ajeteve të para, shihet se Allahu 'harron', ndërsa sipas ajetit të fundit, shihet se Allahu nuk harron. Faktikisht, pamja e jashtme e ajeteve është kundërthënëse, ndërkohë që dihet se ata nuk mund të jenë të këtillë, sepse këtë e ka dëshmuar vetë Allahu: "*Atij* (Kur'anit) *nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të urtit, të Lavdishmit*" (Kur'ani, Fussilet:42), pastaj citati: "...*Sikur ai* (Kur'ani) *të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie*" (Kur'ani, En-Nisa:82).

Tani lind nevoja se si mund që këto ajete t'i harmonizojmë në kuptimin e vërtetë të tyre, pasi është vërtetuar se ato në pamje të tyre sipërfaqësore janë tërësisht kundërthënëse. Këtë nuk do të mund ta bëjmë derisa nuk e pranojmë të vërtetën se fjala 'nisjan' në këto ajete është me kuptim alegorik, dhe se patjetër duhet që ajo të interpretohet nën dritën e ajeteve të qarta. Fundja ky është obligim.

Pra, nuk lejohet për asnjë çast të thuhet "*Ai (Allahu) është që harron*", sepse harresa e Tij nuk është sikurse të harruarit tonë, apo mos ndoshta është harresë që lidhet vetëm me Allahun?²⁵. Jo, kjo është metaforë e qartë dhe duhet të komentohet kontekstualisht, sikurse thotë Ibni Atijeh:

²⁵ Abdul Kerim Tetan, Muhamed Edib El Kilanijj, "Avnul muridi lish-sherhi xhevheret 'it-tevhidi'" fi akideti Ehli-Sunneti vel Xhemaati, boton Darul Beshair, botimi i dytë, 1999/1419, pa vend botimi 1/456.

Thënia e Allahut të madhëruar: ”نَسَاهُمْ... *ne i harrojmë ata...*”²⁶, është prej lajmërimeve të Tij të madhëruar, se çfarë do të veprojë me ta, dhe se “*nisjan – harresa*” këtu është në kuptim të lënies – braktisjes (et-terku) (dhe jo se kjo ka të bëjë me harresë). Do të thotë: **i lëmë në dënim ashtu sikurse ata e kanë injoruar takimin e kësaj dite.**²⁷

Në këtë kontinuitet, prof.dr. Muhamed Seid Ramadan El-Buti, thotë: ”Pas gjithë kësaj që u tha, dije se metoda e selefëve në kohën e tyre ka qenë më e vlefshme, më e sigurt dhe më e përshtatshme, me besimin e natyrshëm të mbështetur në logjikë dhe në zemër. Kurse edhe metoda e halefëve në kohën e tyre është bërë fakt përfundimtar, prej të cilit nuk mund të largohet. E gjithë kjo për shkak të formimit të shumë shkollave dhe zhvillimit të debateve shkencore dhe për shkak të paraqitjes së retorikës, e cila mbështet në norma të termave apo shprehjeve figurative, për shkak të alegorisë dhe metaforës.”²⁸

Duhet ditur se koha e sahabëve është krejt tjetër për akiden sesa koha e pas shekullit II është krejt tjetër, sikurse koha jonë që është po ashtu krejt tjetër.

Qasja për ta argumentuar besimin duhet t’i përgjigjet kohës, e jo për shkak të metodave të bëhemi viktimë e saj.

c) Mbi grupin e tretë

Kurse sa i përket grupit të tretë, ai është një kombinim që ashtu sikurse u theksua bën gërshetimin edhe të argumenteve të grupit të parë edhe të grupit të dytë, prej fazës në fazë. Ky grup ndihmon në zhvillimin e psikologjisë islame.

Orhan Bislimaj

AHLUS SUNNAH WAL JAMAA’H (The adherents to the Sunnah and the community)

(Summary)

The phrase Ahlus Sunnah wal-Jamaa'h means "the adherents to the Sunnah and the community". It is comprised of two parts:

The first one is “As-Sunnah”, whereas the second “wal-Jamaa’h”. In order to define this phrase we must define its parts.

Lexically the word “Sunnah” means “road” (as does the word “tariqat”). In this phrase it denotes: “the acceptance of what has been established by the Prophet”.

أورحان بسلامی

أهل السنة و الجماعة

(خلاصة البحث)

يتكون لقب أهل السنة و الجماعة من المفردتين الاثنتين. المفردة الاولى هي السنة و الثانية هي الجماعة و لكي نفهم محتواها علينا أن نتعرف على كل مفردة وحدها. و السنة لغة معناها الطريقة و معناها العام هو الاخذ بما ثبت عنه صلى الله عليه و سلم ظاهرا و باطنا في القول و العمل و الاعتقاد.

²⁶ Kur’ani, El A’raf:51.

²⁷ Tetan & El-Kilani, “Avnul muridi ...” po aty, f. 1/457.

²⁸ Prof. Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti “Të vërteta e patundshme të besimit islami” (detyrimet e njeriut ndaj Krijuesit), boton ASR, Tetovë, 2004/1425, f. 128.

STUDIME

Osman Mehmeti

VËSHTRIM KUTUBHANEVE DHE ZHVILLIMIT TË TYRE NË KOSOVË* (Zanafilla, rrita dhe historiku)

﴿فيها كتب قيمة﴾

“Në të cilat ka vetëm dispozita të drejta e të qëndrueshme”

(Kaptina “El-Bejjine”, 3)

“Një vend pa libra... është si qyteti pa pasuri, kështjella pa ushtarë, kuzhina pa enë, salla e bukës pa ushqime, kopshti pa barë, livadhi pa lule, druri pa gjethe.”

(Umberto Eco, “Emri i trëndafilin”))

HYRJJE

Kurani është libër fetar që urdhëron qysh në ajetin e parë të tij leximin. Edhe Pejgamberi a.s., të cilit iu shpall ky libër, e urdhëronte ymmetin e tij në këtë rrugë. Edhe ashabët e respektuar dhe dijetarët e

tjerë të mëdhenj islamë, ashtu siç qenë bërë shembull i qartë, për sjelljet e bukura dhe zemërgjerësinë e tyre, po ashtu ata nuk qëndruan anash as në shërbimet për dituri, njohuri dhe qytetërim, dhe as në dëshirën e themelimit të qytetërimit.¹

Kështu, duke pasur parasysh urdhëresat e Kur'anit dhe Synetit të Pejgamberit a. s. dhe porosinë e dijetarëve islamë lidhur me leximin, mësimin e kërkimin e ditorisë, myslimanët qysh në vitet e parë të Islamit u angazhuan me të gjitha mundësitë e tyre për të mësuar e përfutur diturinë. Fillimisht ky angazhim u përqendrua më tepër në fushën fetare, sepse një pjesë e konsiderueshme e njohurive lidhej me detyrimet fetare (ibadetet) ditore, javore e vjetore. Ato detyrime nuk mund të kryheshin pa përfitim të njohurive fetare. Një mysliman që duhej të agjëronte ose të falej i duhej të ngrinte kokën e të hulumtonte qiellin. Në këtë mënyrë ai ishte i detyruar të njihnte qoftë edhe përciptas astronominë. Një tjetër që donte ta kryente haxhin duhej të kishte njohuri të thjeshta në gjeografi, një tjetër që do të ndjente detyrimin e dhënies së zekatit duhej të njihnte qoftë edhe në një shkallë të ulët matematikën.²

Me vendosjen e sundimit osman në trojet shqiptare e rrjedhimisht edhe në Kosovë (shek. XIV- XV), dhe sidomos me përhapjen e Islamit, i cili pati ndikim të ndjeshëm edhe në mënyrën e jetesës, por edhe në kulturën materiale e shpirtërore, nisi kontakti i shqiptarëve me kulturën orientale-islame, edhe pse shqiptarët historikisht kanë pasur lidhje kulturore si me Perëndimin ashtu edhe me Lindjen.³ Mirëpo, me përqafimin e Islamit nga ana e tyre, lidhjet me Lindjen u zgjeruan, u shtrinë në disa fusha dhe u bënë më të drejtpërdrejta për një shtresë më të madhe të popullsisë.

Përhapja e Islamit në trojet shqiptare, s'ka dyshim se ka luajtur një rol të dorës së parë në këtë drejtim, por jo edhe përcaktues. Themi jo përcaktues sepse kanë qenë, në radhë të parë, vlerat e larta të qytetë-

¹ Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Shkup, 2002, f. 35.

² Prof. dr. Ziya Kazici, *Historia e arsimit islam*, Tiranë, 2001, f. 3.

³ Dr. Shefik Osmani, *Klasikët e Lindjes në gjuhën shqipe*, "Univers", nr. 1, Tiranë, 2001, f. 45.

* Pjesë nga punimi i diplomës me titull “Kutubhanet dhe roli i tyre në zhvillimin e kulturës islame në Kosovë”, mbrojtur më 30 shtator 2005 në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

rimit islam dhe të kulturës islame-orientale ato që kanë hapur rrugën vetes për të gjetur admirues në mesin e shumë popujve të tjerë, pra edhe te shqiptarët. Ndërsa përhapja e xhamive, mektebeve, medreseve, teqeve dhe kutubhaneve⁴ kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në zgjerimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjella kulturore shqiptaro-orientale. Këto institucione të shumta, e institucionalizuan depërtimin kulturor të osmanëve në vendin tonë. Porse këto institucione nuk shërbyen vetëm si mjete të përvetësimit ideologjik në duart e qeveritarëve osmanë, siç është bërë zakon të thuhet. Ato u shndërruan në qendra të popullarizimit të arritjeve të shkëlqyera të qytetërimit islam, sidomos në fushën e letërsisë, në radhë të parë të poezisë, dhe të filozofisë. Dhe jo vetëm kaq. Por ato u shndërruan edhe në qendra të studimit të kësaj trashëgimie, në qendra të lëvrimin e të vjershërimit në gjuhën arabe, turke dhe perse⁵.

Xhamitë, medresetë, teqetë, kutubhanet, etj., kanë ndikuar pa dyshim në vetë popullatën, në kulturën e saj, në zhvillimin moral, në zakonin, në arsimin fetar e artistik dhe në aspekte të tjera.

Historia e edukimit dhe e arsimit islam në Kosovë ka një lidhje të ngushtë me kutubhanet – bibliotekat islame, sepse midis shkollave islame (mektebeve, medreseve etj.) dhe kutubhaneve ka ekzistuar një marrëdhënie e ngushtë dhe e veçantë. Shkollat islame edhe në Kosovë, sipas rregullit, ishin të pajisura me biblioteka të pasura. Kutubhanet si institucione, kanë ndikuar shumë në zhvillimin kulturor dhe në ngritjen arsimore të popullatës myslimane të këtyre anëve. Në përgji-

⁴ Fjala *kutubhane* rrjedh nga fjala arabe “*kutub*” – libra dhe nga fjala perse “*hane*” – shtëpi, ndërtesë, d.m.th. bibliotekë. Ne gjatë shtjellimit të punimit tonë, të shumtën, kemi parapëlqyer që fjalën bibliotekë ta përdorim në origjinal: d.m.th. kutubhane, megjithëse, edhe emërtimi bibliotekë islame, sipas mendimit tonë, do të ishte i pranueshëm. Kurse, nuk pajtohem në asnjë mënyrë me qëndrimin e disave, siç kemi parë kohëve të fundit, që në vend të fjalës kutubhane ose bibliotekë islame të përdorin fjalën kuranotekë (madje: Kuranotekë), sepse, një gjë e tillë, për mendimin tonë, është tepër naive, e paqëndrueshme shkencërisht dhe e dëmshme. Sepse po t’i thuash bibliotekës islame kuranotekë, d.m.th. të ngushtosh veprimtarinë e bibliotekës islame në një vend vetëm për ruajtjen e Kuranave, sa kohë që, dihet fakti, që ka vetëm një Kuran të shtypur në shumë kopje.

⁵ Gazmend Shpuza, *Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*, "Perla", 1-4, Tiranë, 2001, f. 5.

thësi në Botën Islame, krahas medreseve, edhe kutubhaneve u jepej një rëndësi e veçantë. Edhe pranë një xhamie pothuaj gjithnjë gjendej një bibliotekë, madje çdo xhami kishte bibliotekën e vet, në mos më shumë, gjithsesi me disa libra e dorëshkrime më të domosdoshme për nëpunësit e xhamisë, dhe sidomos "Mus'hafe" që shërbenin për lexim nga xhematlinjtë. Kutubhane me dorëshkrime e libra të çmuar kishin edhe njerëzit e pasur dhe të arsimuar, kurse numri i bibliotekave private në Kosovë, sikurse është dëshmuar, ka qenë shumë i madh, por fatkeqësisht nga stuhitë e kohës e sistemet e ndryshme, ato janë shkatërruar.⁶

Ndër bibliotekat islame - kutubhanet më të vjetra në Kosovë është ajo që e themeloi më 1513 poeti dhe alimi prizrenas, Suziu, pastaj ajo e "Mehmed Pashës" në Prizren, themeluar në vitin 1573, e cila ekziston edhe sot dhe ruan afro 200 dorëshkrime islame - orientale. Edhe në qytetet e tjera u themeluan biblioteka, si biblioteka e "Atik Medresesë" në Pejë, e cila ka pasur një koleksion të çmueshëm të librave dhe të dorëshkrimeve orientale, pastaj në Gjakovë më 1733 u hap biblioteka e "Medresesë së Madhe"⁷ dhe biblioteka të tjera që dihen e që nuk dihen.

Për institucionin e kutubhaneve në Kosovë kanë shkruar studiuesit e njohur Dr. H. Kaleshi⁸, Dr. M. Mujezinović⁹, Dr. J. Rexhepagiç¹⁰, M.

⁶ Sadik Mehmeti, “*Biblioteka Qendrore e Vakëfit*” në Prishtinë 1951-1961, “Dituria Islame”, nr. 1960-1961, Prishtinë, 2003, f. 39.

⁷ Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture*, “Antikitete të Kosovës”, nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 81-96.

⁸ Hasan Kaleshi, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, “Albanoloshka istraživanja”, 1, Prishtinë, 1962, fq. 91-117. Hasan Kaleši, *Spomenici islamske arhitekture i orijentalni rukopisi*, Kosova nekad i danas, Beograd, 1973, 478. Dr. Hasan Kaleshi, *Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi*, “Edukata Islame”, nr. 70, Prishtinë, 2003, f. 58-72.

⁹ Mehmed Mujezinović, *Kolekcija Orientalnih rukopisa biblioteke Mehmed-Pašine džamije u Prizrenu*, “Starine Kosova”, br. II-III, Priština, 1963, f. 198-205.

¹⁰ Dr. Jašar Redžepagiç, *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine*, Priština, 1968; Po ai: Faltore, *Institucione dhe qendrat islame në Kosovë (Xhami, teqe, Kutubhane, vakëfe)*, “Edukata Islame”, nr. 65, Prishtinë, 2003, f. 47-55.

Beqirbegović¹¹, M. Shukriu¹², R. Virmiça¹³, R. Rexhepi¹⁴, S. Mehmeti¹⁵ e ndonjë tjetër që mund të ketë botuar ndonjë shkrim a të dhënë, megjithëse roli dhe kontributi i institucionit të kutubhaneve në Kosovë, po edhe më gjerë, me sa dimë, ende nuk është studiuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk është arritur të bëhet një studim tërësor i përmbytjes dhe i veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Fillet dhe zhvillimi i kutubhaneve në Botën Islame, në Perandorinë Osmane dhe te ne

Të shtyrë nga aspekti shpirtëror dhe nga nevoja praktike, në Botën Islame shumë herët ka filluar mbledhja, ruajtja dhe shumimi i fjalës së shkruar¹⁶. Vende koncentrimi të fjalës së shkruar kanë qenë, sikurse u tha, xhamia, mektebet, medresetë, kutubhanet, teqetë, spitalet dhe shtëpitë private.

Dihet mirëfilli se ndikimin kryesor për zhvillimin e shkrim-leximit dhe për përhapjen e librave, e ka pasur burimi i parë i mësimave të Islamit - Kurani Fisnik, i cili, para së gjithash, i nxit dhe i porosit njerëzit që ta shfrytëzojnë fjalën e shkruar dhe leximin e saj (kira'a) dhe ai i përmend: suhufet - fletushkat¹⁷, Kurani/kitabën - libër i cili lexohet¹⁸, sixhil-lin - letër e shkruar¹⁹, kalemin - midadin - penën dhe ngjyrën²⁰ etj.

¹¹ Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture*, "Antikitete të Kosovës", nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 81-96.

¹² Muhamet Shukriu, *Prizreni i lashtë, morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale*, Prizren, 2001.

¹³ Raif Virmiça, *Kosova da osmanli mimari eserleri*, Ankara, 1999.

¹⁴ Resul Rexhepi, *Vakëfi institucion shumë i rëndësishëm islam*, "Edukata islame", nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 45-59.

¹⁵ Sadik Mehmeti, *"Biblioteka Qendrore e Vakëfit" në Prishtinë 1951-1961*, "Dituria Islame", nr. 1960-61, Prishtinë, 2003, f. 40.

¹⁶ Shih Kasim Dobraća, *Uticaj Kurana na širenje pismenosti, kaligrafije i ornamentike među islamskim narodima*, Glasnik, VIS, Sarajevë, nr. 4-6, Sarajevë, 1962, 120-123.

¹⁷ Kaptina "El-A'la", 18-19.

¹⁸ Kaptina "El-Bekare", 1.

¹⁹ Kaptina "El-Enbija", 104.

²⁰ Kaptina "El-Kalem", 1; Kaptina "el-KehP", 109.

Pastaj Kurani i porosit njerëzit në kërkimin e diturisë, që nënkupton edhe fjalën e shkruar²¹. Ai kërkon shkrimin e porosive dhe vasijeteve²² Pastaj, në Kuran tregohet se shfrytëzimi i Librit - el-kitab, i cili i është "shpallë botës mbarë", është e drejtë e të gjithë njerëzve dhe jo privilegj e vetëm disave²³ etj.

Po ashtu, është i njohur fakti se i dërguari i Allahut, Muhammedi a.s., ka porositur që në të gjallë të tij shkrimin e shpalljes së Kuranit (i shpallur midis viteve 611 - 632). Fjalët, mësimet, këshillat e porositë e tij, sikurse edhe të disa ashabëve, kanë qenë lëndë shkrimi dhe të ruajtjes.

Nga ana tjetër, njohja e të rinjve me Islamin, sikurse edhe pranimit i Islamit nga njerëz të rinj, në një sipërfaqe të gjerë gjeografike, që nga Kina deri në Atlantik, ka shtruar nevojën për shkrimin e ilmihalëve, doracakëve të ndryshëm dhe të literaturës jo vetëm nga fusha të dijes e të shkencës islame, po edhe të tjerë.

Kurse hyrja nën flamurin e në kufijtë e shtetit dhe të shoqërisë islame e shumë popujve me mësimet religjioze, filozofike dhe etike të ndryshme, ka kërkuar nga ulemaja islamë që të ruhen nga këto mjedis dhe nga këto ide, e shpeshherë edhe të zhvillohen dialogë dhe biseda me ta, me qëllim që t'i përvetësojnë ata dhe t'i largojnë nga idetë dhe mësimet e tyre, ose të paktën, t'i mbrojnë mësimet islame nga sulmet dhe kritikën e tyre.

Jetesa e myslimanëve në një mes etnik dhe fetar heterogjen, ka bërë që myslimanët të përballëshin nga ndikimet e ndryshme filozofike-etike. Kjo ka shtyrë që ata të ruajnë mësimet islame nga këto ndikime, që ka rezultuar me shkrimin dhe ruajtjen e librave të shumtë.

Lufta për pushtet dhe rivalitetet reciproke të disa popujve myslimanë (arabëve, persianëve, berberëve, turqve e shumë të tjerëve) gjithashtu ka ndikuar në studimin e prejardhjes së familjeve, fiseve dhe

²¹ Kaptina "El-Alak", 1; Kaptina "Ta Ha", 114.

²² Kaptina "En-Nisa", 12.

²³ Kaptina "El-Kalem", 52.

popujve, historisë së tyre, së bashku me përshkrimin e vendeve, mundësive fetare kulturore dhe ekonomike, si dhe të tipareve psike-fizike të tyre. Duke pasur parasysh se për këto studime duhej të ofroheshin disa argumente fetare, kjo shkaktoi sfidën për provokimin e hulumtuesve të drejtësisë (fikut), apologjistikës, etikës, filozofisë, linguistikës, letërsisë dhe disiplinave të tjera shkencore, që aktivisht të merrnin pjesë në zgjidhjen e shumë problemeve të paraqitura në rrethin në të cilin ata jetonin²⁴.

Ringjallja e qendrave të lashta kulturore (Damaskut, Aleksandrisë, Semarkandit, Isfahanit) dhe ndërtimi i qendrave të reja (Medinës, Kufës, Basrës, Bagdadit, Kajros, Fesit), në të cilat po përqendrohej kapitali, ka bërë të arrihej deri te një gjendje e mirë materiale, andaj u mundësoi banorëve të atyre qendrave dhe rajoneve të merreshin me letërsi, filozofi, art dhe me shumë zeje, për të cilat po ashtu flitej e shkruhej.

Pikërisht një pjesë e këtyre punimeve, shqyrtimeve dhe shprehjeve arabe, turke e perse do të shtrihet edhe në viset e tona, të cilat do të përshkruhen dhe do të lexohen e studiohen në medresetë dhe do të shqyrtohen dhe arsyetohen nëpër xhami, teqe, shtëpi e kutubhane²⁵.

Kështu, bibliotekat më të njohura në Botën Islame kanë qenë: në Bagdad (“Bejtu-l-Hikme” themeluar më 830 dhe “El-Mustensirijje”, themeluar më 1234), në Kajro (“Daru-l-Hikme-l-ilmijje”, themeluar më 1005 dhe “Al-Azhar” themeluar më 975); në Kordovë (biblioteka e Hakemit II (961 – 976), etj., të cilat kanë qenë biblioteka publike.

Biblioteka (gjysmëpublike) kanë pasur pallatet e dinastive të ndryshme, p.sh., Emevinjtë, (në Damask dhe në Kordovë), Abasidet (në Bagdad), Samanidët (në Samerkand dhe Buhara), Gaznevinjtë (në

Gazna), Fatiminjtë (në Kajro), Ejubinjtë (në Damask), Idrisinjtë (në Fes), Osmanlinjtë (në Stamboll) etj²⁶.

Biblioteka (private) kanë pasur disa vezirë të këtyre dinastive si dhe dijetarët dhe ulematë e njohur islamë, juristët, poetët, por edhe tregtarët, esnafët - zanatlinjtë etj.²⁷

Edhe në shoqërinë osmane kutubhanet kanë pasur vlerë të madhe. “Osmanlinjtë, shkruan historiani i mirënjohur i Perandorisë Osmane Halil Inalxhik, kutubhanet i kanë themeluar nëpër xhami, nëpër spitale dhe nëpër teqe, por kanë themeluar edhe kutubhane private nëpër shtëpitë e tyre. Shumë përmbledhje librash private kanë arritur nëpër kutubhanet e vakëfeve, sepse është konsideruar gjë shumë e çmueshme që librat të dhuroheshin për ndonjë hajrat. Biblioteka ka përfaqësuar njësinë e veçantë në përbërje të vakëfit; zakonisht ka qenë e vendosur në ndonjë lokal prej guri ose në ndonjë godinë të ndarë. Me vakëfname është përcaktuar se si duhet të ruhen dhe të shfrytëzohen librat. Po ashtu është emëruar bibliotekari, i cili ka marrë rrogë nga fondet e vakëfit. Në këto biblioteka sot e kësaj dite ruhen mbi dyqind mijë dorëshkrime të epokave të ndryshme nga të gjitha vendet e Botës Islame që përbëjnë burimin më të pasur të konstruksionit historik dhe kulturor të islamit”²⁸.

Nga koha kur trevat tona drejtpërdrejt janë njohur me fjalën e shkruar orientale – islame, shek. XIV e deri më sot, ajo ka pasur një përvojë, traditë dhe përmbajtje shumë të pasur. Kësisoj, edhe te ne

²⁶ Epërsinë e bibliotekave të myslimanëve karshi atyre të botës së krishterë, në mënyrë shumë objektive e përshkruan në romanin e tij “*Emri i Trëndafllit*”, Prishtinë, 2005, f. 43, shkrimtari i njohur Umberto Eco, ku thotë: “...Di se abacia juaj është e vetmja dritë që krishterimi mund t’u kundërvihet atyre *tridhjetë e tri bibliotekave të Bagdadit, dhjetë mijë kodikëve të vezirit Ibn el-Ahkami*, se numri i biblave tuaja është baras me *dy mijë e katërqind Kuranët* (në dorëshkrim – O.M.) që ka Kajroja dhe se përmbajtja e rafteve tuaja është një pamje e shkëlqyer kundër legendës krenare të të pabesëve (lexo: myslimanëve – O. M.) që vite më parë e paraqitnin bibliotekën e Tripolit si të pajisur me *gjashtë milionë vëllime dhe të banuar nga tetë mijë komentues e dyqind shkruar...*”

²⁷ Filip Hiti, *Istorija Arapa*, Sarajevë, 1967, f. 374-377, 480, 560; Ahmed Shelebi, *Tarih et-Terbijeh el-islamijeh*, Kajro, 1966, fq. 180-205, Cituar sipas, Mr. Nijaz Sukrić, *Gazi Husrev-Begova biblioteka - doprinos uvakufljene knjige obrazovanom procesu kod nas*, “ANALI”, Gazi Husrev-begove biblioteke, knjiga, IX-X, Sarajevë, 1983, f. 294.

²⁸ Halil Inalxhik, *Perandoria Osmane (periudha klasike 1300-1600)*, Shkup, 1995, f. 252

²⁴ Mr. Nijaz Sukrić, *Gazi Husrev-Begova biblioteka - doprinos uvakufljene knjige obrazovanom procesu kod nas*, “ANALI”, Gazi Husrev-begove biblioteke, knjiga, IX-X, Sarajevë, 1983, f. 294.

²⁵ Mr. Nijaz Sukrić, *Gazi Husrev-Begova biblioteka - doprinos uvakufljene knjige obrazovanom procesu kod nas*, “ANALI”, Gazi Husrev-begove biblioteke, knjiga, IX-X, Sarajevë, 1983, f. 293.

janë themeluar kutubhanet e para, si në Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë etj., të cilat, sipas studiuesve, u kanë takuar disa llojeve të kutubhaneve.

Gjatë shekujve të kaluar, kutubhanet kryesisht kanë qenë pranë xhamive dhe medreseve, qoftë në brendi të tyre, qoftë në anekset e tyre. Edhe dijetarët – ulemaja natyrisht që kanë pasur kutubhanet e tyre, të cilat u kanë takuar kutubhaneve private-personale. Këto të fundit, kryesisht kanë qenë shumë të pasura me libra dhe dorëshkrime nga gjuha arabe, osmane dhe perse, qoftë vepra të autorëve tanë, qoftë të autorëve të huaj.

NDARJA E KUTUBHANEVE

Për sa i takon ndarjes së kutubhaneve, ç'është e drejta, në literaturën që disponohet, kemi hasur disa mendime. Kështu, p. sh., studiuesi boshnjak mr. Nijaz Šukrić²⁹, mendon se kutubhanet në Botën Islame, e rrjedhimisht edhe në Perandorinë Osmane, e përmes saj edhe te ne, janë ndarë në:

1. Biblioteka publike (bibliotekat e vakëfeve)
2. Biblioteka gjysmëpublike (pranë pallateve) dhe
3. Biblioteka private³⁰.

Ky studiues, madje konstaton se te ne, (Kosovë, Bosnjë, Maqedoni), në përgjithësi, janë njohur vetëm këto dy të parat, d.t.th., bibliotekat publike (të pavarura ose pranë ndonjë institucioni) dhe bibliotekat private. Bibliotekat gjysmëpublike, të shumtën, shkruan ky autor, kanë qenë nëpër metropole, pranë pallatit të ndonjë kalifi, sulltani ose pranë pallatit të ndonjë veziri. Edhe këto biblioteka kanë qenë në shfrytëzim, por vetëm me leje të veçantë.³¹

Nga ana tjetër, studiuesi dr. Hasan Kaleshi³², mendon se kutubhanet, sidomos ato të periudhës së hershme të qeverisjes osmane në viset tona, mund të ndahen në tri lloje:

1. Bibliotekat private (personale)
2. Bibliotekat e xhamive, mesxhideve dhe teqeve
3. Bibliotekat e medreseve, që sipas tij, ky ishte lloji më i rëndësishëm i bibliotekave, sepse në një farë mënyre ato ishin biblioteka publike, se qytetarët kishin mundësi t'i huazonin librat, t'i lexonin apo t'i përshkruanin ato.

Një ndarje të ngjashme të kutubhaneve si të dr. H. Kaleshit, me pak ndryshime, e gjejmë edhe te studimi i prof. Resul Rexhepit³³. Të njëjtin mendim kemi parapëlqyer edhe ne, sepse, kujtojmë se është më i detajuar dhe përkon me zhvillimin, rritën dhe historikun e kutubhaneve te ne.

Sido që të jetë, është më se e njohur se kutubhanet private i kanë themeluar disa dijetarë, personalitete të rëndësishme si dhe dashamirët e librit, të cilët kishin bërë punë të ndryshme gjithandej intelektuale e profesionale dhe të cilët kishin mundësi për blerjen e librave. Është e njohur po ashtu se librat ishin shumë të shtrenjtë, sepse ata shkruheshin me dorë dhe ilustrheshin me ilustrime të ndryshme. Të shumtën e rasteve këta libra liheshin vakëf para vdekjes së pronarëve të tyre, apo ndodhte që ata t'i lënin vakëf trashëgimtarët e tyre pas vdekjes, për disa shkolla (medrese), bibliotekat e të cilave ishin rritur në këtë mënyrë dhe ishte rritur numri i librave në to.

Bibliotekat e xhamive ruanin kryesisht dorëshkrime të “mus-hafeve” dhe “xhuze” të veçantë të tij, si dhe libra fetarë të përgjithshëm. Këta libra u jepeshin në dispozicion njerëzve për lexim apo për përshkrimin e tyre. Teqetë, po ashtu kanë pasur bibliotekat e tyre, të cilat

²⁹ Mr. Nijaz Šukrić, op. cit. f. 291-304.

³⁰ Mr. Nijaz Šukrić, op. cit. f. 294.

³¹ Kështu, p.sh. Ibn Sinait i është lënë në shfrytëzim biblioteka shumë e pasur e udhëheqësit Samanid, Nuhut II (976-997) në Buhara.

³² Dr. Hasan Kaleshi, *Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi*, “Edukata Islame”, nr. 70, Prishtinë, 2003, f. 60.

³³ Resul Rexhepi, *Vakëfi institucion shumë i rëndësishëm islam*, “Edukata islame”, nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 45-59.

të shumtën e rasteve në fondin e tyre kishin përfshirë kryesisht vepra të karakterit mistik³⁴.

Dokumentet e ndryshme flasin për disa personalitete të rëndësishme, që kanë lënë vakëf dhe i kanë dedikuar për këto biblioteka kopjet më të bukura të Kuranit si dhe një numër të madh të librave të tjerë.

Siç përmendëm më sipër, bibliotekat më të rëndësishme dhe më interesante, si për nga funksioni i tyre, ashtu edhe për sa i takon përbërjes së fondeve, kanë qenë ato kutubhane që gjendeshin pranë komplekseve shkollore (medreseve, mektebeve etj.), sepse ato ishin më të pajisura, kishin një numër të madh të librave dhe ishin më të dobishme në aspektin përmbajtësor. Dhe se secila bibliotekë ishte e pajisur me veprat me të njohura në lëmin e shkencave natyrore dhe fetare, të cilat mësoheshin në atë kohë. Si bibliotekat po ashtu dhe medresetë, në atë kohë ishin të themeluara vetëm sipas sistemit të vakëfit.

Meqenëse vakëfi ishte institucion i bamirësisë dhe librat ishin prej gjërave që mund të lireshin vakëf, shumë biblioteka, të cilat në kohën e themelimit të tyre ishin shumë modeste, me kalimin e kohës u pajisën me një numër të konsideruar të librave. Kështu ne nuk i shohim vetëm personalitetet e njohura dhe të pasurit, që lënë libra vakëf, por këtë e bënin edhe njerëzit, që kishin një pasuri modeste, madje edhe zanatçinjtë e ushtarët (gazitë), të cilët jo vetëm që kanë lënë vakëf libra, po ata i hasim të kenë qenë edhe përshkrues e kopjues të tyre³⁵.

Prej dokumenteve të vakëfeve të ndryshme, shohim se mësuesit ishin ata që kujdeseshin për këta libra, atëherë kur bibliotekat ishin të vogla, ndërsa sekretari i bibliotekës, apo siç quhej ruajtësi i librave (hafiz-i kutub)³⁶, atëherë kur bibliotekat ishin të mëdha.

Dëshirën që libri të jetë sa më mirë dhe sa më shumë i shfrytëzueshëm e gjejmë të përmendur në çdo vakëfname ku përmenden librat e vakëfuar. Njëjtë është edhe me shënimet për vakëfnimin e vetë librave.

³⁴ Dr. Hasan Kaleshi, *Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi*, op.cit. f. 63.

³⁵ Zagorka Janc, *Islamska minijatura*, Zagreb, 1985, f. 26.

³⁶ Me institucionin e *hafiz-i kutubit* (sekretarit të kutubhaneve) në Kosovë, deri më sot, në mënyrë të veçantë nuk kam takuar që të jetë marrë ndonjë studiu.

ave. Nëse vakëflënësi ka lënë edhe ndonjë shënim a porosi të veçantë, si p.sh., që akëcili libër të mos shitet, të mos dhurohet, të mos lihet peng, të mos nxirret jashtë vendit ku është vakëfuar, atëherë ky libër ka qenë në shërbim të gjerë. Përveç blerjes së dorëshkrimeve nga qendrat e vjetra islame (Mekë, Medinë, Damask, Jerusalem, Bagdad, Kajro, Brus, Stamboll etj.), kopjimi i librave ka qenë burim shumë domethënës. Në Kosovë kjo veprimtari ka qenë mjaft e zhvilluar (sidomos nëpër medrese)³⁷. Madje edhe pas osmanlinjve dhe përhapjes së librit të botuar, kjo traditë, kujtoj, nuk është ndërprerë³⁸.

Prandaj, na thotë mendja, do të ishte me interes shkencor për kulturën dhe të kaluarën tonë islame dhe kombëtare sikur të studioheshin dhe të njiheshin në mënyrë meritore institucioni i kaligrafistëve (hattat), miniaturistëve (res-sam) dhe të libërlidhësve (muxhel-lid), të cilët sigurisht se nuk kanë qenë në numër të paktë.

Kutubhanet më të njohura në Kosovë

Ashtu sikundër dihet, Kosova dikur ka zotëruar një numër të madh të kutubhaneve nga periudha e pranisë mbi 500-vjeçare të Perandorisë Osmane, shumë të ndryshme për nga lloji, përmbajtja dhe vlera shkencore artistike. Mirëpo, në shekujt e kaluar, në rrethanat që kaloi populli ynë, dhe për shkak të neglizhencës dhe pakujdesjes sonë, këto kutubhane të çmueshme u dogjën, u zhdukën apo humbën gjurmët dhe së bashku me to u zhduk, për të mos u kthyer kurrë më edhe një pjesë e çmueshme e trashëgimisë sonë kulturore e fetare, të cilën me shumë mund e sakrificë e themeluan dhe e hartuan të parët tanë.

Themi kështu, sepse kemi parasysh faktin se ato kutubhane janë themeluar nga njerëz tanë, dhe sepse në raftet e tyre ato kanë ruajtur një numër të madh të veprave (shumica në dorëshkrim) të shkruara

³⁷ Dr. Hasan Kaleshi, *Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi*, "Edukata Islame", nr. 70, Prishtinë, 2003, f. 67.

³⁸ P.sh. Myftiu i Prizrenit, H. Rrustem ef. Shporta, në vitin 1921, kishte shkruar dy vepra origjinale në gjuhën arabe, pastaj Mulla Mehmed ef. Salihu nga Bresana e Opojës, ka shkruar disa vepra më 1951, Abdullah Telaku nga Prizreni ka kopjuar në vitet e njëzeta të shek. të kaluar shumë vepra nga gjuha turke dhe arabe etj.

nga autorë tanë dhe një numër të madh të dokumenteve të hartuara gjithandej në vendet tona, pa përmendur këtu veprat, qoftë të botuara, qoftë në dorëshkrim të autorëve të ndryshëm nga Bota Islame.

Për më tepër, kutubhanet, përveç se janë mbushur me libra nga njerëz tanë, ato edhe janë shfrytëzuar dhe janë përdorur nga studentët, talebët, myderrizët, ulematë dhe të interesuar të tjerë që ishin nga viset tona. Prandaj, ato me plot kuptimin e fjalës kanë qenë kutubhanet tona dhe vetëm si të tilla duhet t'i konsiderojmë.

Përmes njohjes së kutubhaneve mund të dihet se ç'kulturë dhe ngritje intelektuale kanë zotëruar paraardhësit tanë. Sikundër që mosnjohja e kutubhaneve që tregon se ç'vlera të mëdha janë humbur dhe çfarë boshllëku i madh është krijuar.

Sido që të jetë, deri në ditët tona kanë ardhur, qoftë të ruajtura përmes dokumenteve e shkrimeve, qoftë përmes ruajtjes deri në njëfarë mase të tyre, këto kutubhane publike dhe private:

A. KUTUBHANET PUBLIKE

1. Kutubhaneja e Suziut

Për këtë kutubhane dihet se është më e vjetra në Kosovë³⁹. E themeloi në Prizren poeti, alimi dhe prizrenasi i njohur Suzi Çelebiu (vdiq më 1524/5 në Prizren), i cili në vakëfnamenë e tij të legalizuar më 1513, përveç shumë objekteve të tjera të themeluara nga ky vakëflënës i madh (si xhami, shkollë në të cilën edhe vetë ishte mësimdhë-

³⁹ Prof. dr. Skender Rizaj mendon se kjo bibliotekë duhet llogaritur jo vetëm një nga bibliotekat më të vjetra në Kosovë, por edhe në gjithë kontinentin e Evropës, duke pasur parasysh faktin se në këtë kohë në shtetet evropiane, përveç disa bibliotekave shumë të varfra mbretërore nuk kishte biblioteka të qyteteve". (Skënder Rizaj, *Prizreni deri te Tanzimati 1839*), Gjurmime Albanologjike, SSHH, XIII, Prishtinë, 1984, f. 62). Megjithatë, ky konstatim i prof. Rizajt nuk qëndron, sepse duke u mbështetur në dokumentet e gjetura deri më tash, dëshmohej se biblioteka më e vjetër në tokat shqiptare dhe më gjerë, është biblioteka e Manastirit e themeluar më 1430, pra, gati një shekull para asaj të Suziut të famshëm, pastaj ajo e Isa beu në kuadër të Medresesë së Shkupit etj.

nës), shënoi edhe kutubhanen, e cila, sigurisht, shënon bibliotekën më të vjetër në Kosovë.

Në bazë të titujve të librave të shënuar në vakëfnamenë e sipërpërmendur, shihet se në këtë kutubhane janë ruajtur veprat e disa dijetarëve të njohur arabë dhe persianë, që tregon jo vetëm shijen e Suziut, por edhe argumenton se në Prizren në atë kohë ka pasur njerëz që kanë ditur të lexojnë dhe të shërbehen në këto gjuhë. Përveç librave nga fusha e traditës dhe të drejtës së Sheriatit, këtu janë ruajtur edhe disa vepra të njohura të mistikëve, si të Attarit dhe Xhelaludin Rumiut, sikurse edhe të filozofit të madh arab Gazaliut.⁴⁰

Tregohet se Suzi kishte një kusht shumë të mirë të vakëfnimit rreth përdorimit të librave të tij, e ai është:

"Derisa ai të jetë gjallë, ai do të jetë pronar i tyre, ndërsa pas vdekjes së tij për to do të kujdeset imani i xhamisë time. Le t'ua japë ato në huazim dijetarëve dhe atyre që janë në gjendje të kenë dobi prej tyre, të cilët do të lexojnë salavate për shpirtin e tij"⁴¹.

Kutubhaneja e Suziut gjendej në verilindje të xhamisë me po të njëjtin emër (xhamia e Suziut) dhe, në godinë të njëjtë, Suzi Prizrenasi kishte vendosur edhe shkrimoren dhe mejtepin e tij⁴². Objekti i kutubhanes ishte në kat. Në përdhese gjendeshin tri kroje, që buronin nga pllaka të mëdha gurësh kristali, ku kishte vend edhe për pushimin e besimtarëve para dhe pas abdesit.

⁴⁰ Hasan Kaleši, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, "Albanološka istraživanja", 1, Priština, 1962, f. 92.

⁴¹ Dr. Hasan Kaleshi, *Dorëshkrimet orientale në Jugosllavi*, op.cit. f. 67.

⁴² Esat Haskuka, *Historijsko-geografska analiza urbanih funkcija Prizrena*, Vise Pedagogoska skola "Bajram, Curri", Džakovica, 1985, f.161.




Fig. 1. Rikonstruimi i kutubhanes, shkrimores dhe mektebit të Suzi Prizrenasit (M. Shukriu)

Kati ishte i vendosur në transversale druri, që mbështetej në nën-trarëza dhe shtylla, po ashtu prej druri. Pullazi përmbi strehë ishte i mbuluar me rrasa guri, ndërsa më lart, me qeramidhe turke. Në këtë mënyrë mbuloheshin edhe pullazet e shtëpive në Prizren, ndërsa më parë mbulesa ishte vetëm prej rrasash guri. Një pjesë e godinës është rrënuar nga pakujdesia, kurse pjesa e ngelur është shndërruar në bane-së. Në bibliotekën e Suziut supozohet të janë ruajtur edhe veprat e vetë Suziut dhe të vëllait të tij Nehariut.⁴³

⁴³ Muhamet Shukriu, op.cit., f., 339-340.

2. Kutubhaneja e Mehmed Pashës

Një kutubhane tjetër në qytetin e Prizrenit, është ajo të cilën e themeloi Mehmed Pasha (1573). Kjo kutubhane i ka sfiduar rrebesheve të kohës dhe gjendet edhe sot e kësaj dite.

Në këtë kutubhane janë ruajtur një numër ri madh i dorëshkrimeve arabe, turke dhe persiane, po edhe në gjuhën shqipe të shkruar me grafi arabe. Prej këtyre dorëshkrimeve po përmendim: "Tefsiru el-Kashifi" në gjuhën persiane. Ky është një dorëshkrim shumë i bukur i stolisur me ar, i përkthyer në vitin 984, "El-Xhami Es-sahih" i Buhariut, "Fetfat e Kadi Hanit" i përkthyer në vitin 966, "Sherhu Mexhmeu-l-Bahrejn" i përkthyer në vitin 863 H. Pastaj "Fjalori i Fejruz Abadit", i përkthyer në vitin 968, si dhe "Sihahu-l-Xhevheri" etj. Aty janë ruajtur disa dorëshkrime, të cilat i ka lënë vakëf shqiptari Sinan Pasha, i cili e çliroi Jemenin, ishte vali në Kajro dhe kryeministër i Perandorisë Osmane.

Në këtë bibliotekë ruhen një numër i madh i librave nga fusha të ndryshme të fesë, shkencës dhe të disiplinave filozofike të cilat janë mësuar dhe kanë qenë aktuale në atë kohë. Në disa margjina të atyre librave shihet se ato i kanë shfrytëzuar dhe kanë qenë pronë e disa njerëzve të njohur të Prizrenit dhe të Kosovës. Më interesanti është komentimi i një Kurani në gjuhën perse, i kopjuar shumë herët (948/1541), me miniaturë në fillim e në fund, shumë i bukur që pranë tekstit arab është dhënë edhe komentimi në gjuhën perse, fjalë për fjalë, ajet për ajet e të cilin e kishte lënë vakëf Koxha Sinan Pasha nga fshati Topojan i Lumës, veziri i sulltan Muratit, në shërbim të bibliotekës së Mehmed Pashës⁴⁴.

Më 1952 kjo kutubhane ka qenë e vendosur në një ndërtesë të veçantë pranë xhamisë, kurse sot është e vendosur në turbën e Mehmed Pashës, e cila gjendet në oborr të xhamisë e në të cilën nuk është varrosur kurrë.

⁴⁴ Hasan Kalesi, *Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda*, "Albanoloshka istraživanja", 1, Prishtinë, 1962, f. 91-117.

Në të ruhen libra nga shkencat e medicinës, aritmetika dhe shkencat e tjera. Në këtë bibliotekë ekzistojnë vepra tejet të vlefshme në dorëshkrim. Veprat janë evidencuar nga orientalisti Mehmed Mujezinoviç dhe, më vonë, janë rishqyrtuar nga prof. dr. Hasan Kaleshi.

Pesëdhjetë vepra nga fusha të ndryshme kësaj biblioteke ia ka falur imami i njohur nga Prizreni, hafiz Abdullah ef. Hëzëri-Telaku⁴⁵.

Kutubhaneja e Mehmed Pashës për shkak të vlerave të larta, është shpallur përmendore kulturore nën mbrojtjen e shtetit me aktvendimin nr. 02/382/61 të Entit Krahinor për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës në Prishtinë⁴⁶.



Fig. 2. Kutubhaneja e Mehmed Pashës në Prizren

Nuk na është e njohur gjendja e dorëshkrimeve sot, sepse nëpër këtë kutubhane kanë defiluar njerëz me qëllime jo të mira dhe jo dashamirë të dorëshkrimeve e librave islamë.

Deri vonë objekti i kësaj nuk ka qenë i siguruar, dhe librat i janë nënshtruar shkatërrimit gradual për shkak të dëmtimeve të letres nga lagështia e nga myku si dhe ekziston rreziku i vjedhjeve të tyre.

⁴⁵ Muhamet Shukriu, op. cit. 47.

⁴⁶ Po aty.

Të theksojmë edhe se kohët e fundit ka një interesim nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës që dorëshkrimet që ruan kjo kutubhane të bartën në një vend më të sigurt - në kutubhanen e medresesë “Alauddin” në Prishtinë.

3. Kutubhaneja e Gjakovës

Kutubhaneja e Hadim Xhamisë ka qenë e vendosur në një ndërtesë të veçantë me dy kate. Ka qenë e mbuluar me një kupolë karakteristike, të ndryshme nga biblioteka e “Mehmed Pashës” në Prizren dhe nga ajo “Atik” në Pejë, dhe për këtë arsye mund të thuhet se ajo ka paraqitur një nga monumentet kryesore të arkitekturës islame në Kosovë dhe më gjerë.




Fig. 3. Kutubhaneja e Xhamisë së Hadimit në Gjakovë

Kjo kutubhane ka qenë e ndërtuar nga gurët dhe ka pasur një numër të madh të dorëshkrimeve dhe të librave orientale. Biblioteka

është ndërtuar në vitin 111-1733 dhe ishte e vetmja ndërtesë e bibliotekës me kupolë në Kosovë⁴⁷.

Është djegur së bashku me Xhaminë e Hadim Agës nga forcat serbe në luftën e fundit në Kosovë më 1999.

4. Kutubhaneja e Kuklibeut

Këtë kutubhane e ka themeluar njëri ndër vakëflënësit më të mëdhenj, Mehmed Hajrudini, i mbiquajtur Kuklibeg, që ishte nga fshati Kuk i Opojës (jetoj në shek. XV-XVI). Ky ka lënë një numër të madh të vakëfeve gjithandej në tokat shqiptare dhe më gjerë.

Kutubhaneja e tij përmendet në vakëfnamën e tij që është legalizuar në vitin 1538⁴⁸.

Nuk dihet se kur është themeluar me saktësi kjo kutubhane dhe se ç'fond të librave ka poseduar, por dihet se ajo ka qenë në shërbim të mektebit të Kuklibeut që gjendej pranë kutubhanes dhe xhamisë me të njëjtin emër⁴⁹.

Në literaturën e shfrytëzuar, nuk kemi gjetur të dhëna të cilat do të na njihnin sadopak me formën e kësaj kutubhane.

5. Kutubhaneja e Pejës

Ka qenë e ndërtuar e vendosur në juglindje të ndërtesës së medresesë me të njëjtin emër. Ajo ka pasur një kujdes të madh. Ka pasur një numër të madh të dorëshkrimeve orientale por që deri më sot fatkeqësisht nuk janë ruajtur⁵⁰. Nuk dimë se kur është themeluar.

⁴⁷ Madžida Bećirbegović, po aty, fq. 88.

⁴⁸ Hasan Kalešić i Ismail Redžep, *Kuklibeg i njegova zadužbina, Prilozi za orientalni filologiju*, Sarajevë, 1963, f. 147.

⁴⁹ Hasan Kalešić, Ismail Redžep, *Prizrenac Kuklibeg i njehove zadužbine*, POF, VII-IX, Sarajevë, 1960, str. 147; Nehat Krasniqi, *Mehmed Kuk-libegu- legatori më meritore për zhvillimin ekonomik dhe kulturo-arsimor të Opojës në shek. XVI*, "Dituria Islame", nr. 97, Prishtinë, 1998, f. 47.

⁵⁰ Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture*, "Antikitete të Kosovës", nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 81-96.

Me gjithë hulumtimet e bëra, në literaturë nuk kam gjetur në ndonjë të dhënë se kur është themeluar kjo kutubhane.

6. Kutubhaneja Qendrore e Vakëfit të Prishtinës

Njëra nga kutubhanet më të reja në Kosovë, është "Biblioteka Qendrore e Vakëfit" në Prishtinë. Kjo bibliotekë u themelua më 24 shtator 1951, në mbledhjen e Kuvendit të Vakëfit të Bashkësisë së Fe-së Islame (asokohe) të Republikës Popullore të Serbisë në Prishtinë. Njihej edhe me emërtime jozyrtarë: "Kutubhaneja e Vakëfit" ose shkurt "Biblioteka e Vakëfit"⁵¹.

Themelimi i kësaj kutubhane nga udhëheqësit e atëhershëm të BFI-së të Kosovës me vizionarin hfz. Bajram ef. Agani në krye, që konsideruar si një çështje imediate, nevojë dhe domosdoshmëri e kohës, të cilës i duhej kushtuar kujdes i jashtëzakonshëm, jo vetëm për themelimin e saj, po edhe për pasurimin dhe mbushjen me libra e dorëshkrime orientale, sepse, "biblioteka është një nga segmentet më të rëndësishme të kulturës, kurse ruajtja, blerja dhe mbledhja e "qitapeve" paraqet vlera të veçanta, prandaj dhe duhet t'u kushtojmë kujdes të veçantë ... dhe ky kujdes shfaqet në ruajtjen e kësaj pasurie të madhe shpirtërore", konstatohet asokohe, për të vazhduar: "Biblioteka..., përveç se do të shërbejë për ruajtjen e këtyre vlerave, ajo do të jetë e hapur për të gjithë të interesuarit, e sidomos për njerëzit tanë të arsimuar, të cilët do të mund të shfrytëzojnë këtë pasuri, sidomos kur është i njohur fakti se njerëzit tanë kanë shkuar në Stamboll, po edhe në Dubrovnik e në vende të tjera me qëllim të marrjes dhe hulumtimit të dokumenteve të nevojshme historiografike..."⁵²

Nisur nga ky fakt, më 1951, Drejtorja e Vakëfeve, me një qarkore u qe drejtuar të gjithë këshillave të vet që edhe ata të kujdeseshin për mbledhjen e "qitapeve". Mirëpo, disa nga ata këshilla kishin pranuar që librat dhe dorëshkrimet që posedonin, t'ia dorëzonin Bibliotekës...

⁵¹ Sadik Mehmeti, "Biblioteka Qendrore e Vakëfit" në Prishtinë 1951-1961, "Dituria Islame", nr. 1960-61, Prishtinë, 2003, f. 40.

⁵² Po aty.

të porsathemeluar, por kishte nga ata që s'kishin denjuar ta bënin një gjë të tillë, si këshilli i vakëfit të Prizrenit, Gjakovës etj..

Drejtorja e Vakëfit kishte ngritur enkas një komision, i cili të kujdesej për mbledhjen, blerjen, ruajtjen dhe vlerësimin e librave e dorëshkrimeve orientale. Ai përbëhej nga hfz. Bajram ef. Agani, kryetar, Hajrullah ef. Zaimi, Ali ef. Raçi, Shemsi Salihu dhe Faik Begolli, anëtarë.

Dy muaj pas themelimit të bibliotekës, më 14 nëntor 1951, si bibliotekist me honorar që emëruar Faik Hamdibegu (Begolli) nga Prishtina, i cili njihje katër gjuhë - shqip, serbisht, arabisht dhe turqisht; merrte vesh nga librat dhe dorëshkrimet orientale, dhe, përveç të tjerash, bibliotekës ia kishte dhuruar 80 "qitape" (libra-dorëshkrime).

Ndër detyrat kryesore të kësaj kutubhane ishte dalja në terren për të mbledhur dhe për të blerë (aty ku paraqitej nevoja) libra, dorëshkrime dhe dokumente të tjera në gjuhën arabe, turke e persiane; pastaj vendosja në raftet e bibliotekës; bërja e inventarizimit të tyre etj.⁵³

Në vitin 1951 "Biblioteka Qendrore e Vakëfit" pati njohur një hov të madh zhvillimi, sa asnjëherë më vonë, sepse kishte arritur të mbli-dhte dhe të pasuronte fondet e saj me një numër të madh librash e dorëshkrimesh orientale. Përveç disa librave-dorëshkrimeve orientale që kishte vetë Vakëfi, vakëf kishin lënë edhe shumë bamirës të tjerë, jo vetëm nga Kosova, po edhe nga Shkupi, kurse disa qindra të tjerë ishin blerë nga pronarë të ndryshëm.

Sipas disa regjistrave që ruhen edhe sot e kësaj dite, bërë nga bibliotekisti i "Bibliotekës Qendrore të Vakëfit", mësojmë se ajo bibliotekë në vitin 1951-1952 kishte afro 300 njësi bibliografike, prej tyre afro 30 dorëshkrime. Në regjistrat e sipërpërmendur ishte shkruar emri i librit, i botuar a dorëshkrim; emri i autorit; emri i vakëflënësit, si dhe çmimi i blerjes në dinarë (nëse ishte blerë). Shumica e titujve ishin lënë vakëf. Faik Hamdibegolli kishte lënë vakëf, sikurse u tha, 80 njësi bibliografike; 16 i kishte lënë vakëf ish-imami i Prishtinës, Jusuf ef. Bushra; ish-imami tjetër i Prishtinës, Davud ef. Saidi, kishte lënë

⁵³ Po aty, f. 41.

vakëf 23 libra-dorëshkrime; vakëf kishin lënë edhe Abdush Mustafa, Ali ef. Raçi (Rashidi) etj., kurse disa libra të tjerë ishin marrë nga vakëfi i Xhamisë së Madhe të Prishtinës. Familja e të ndjerit Said Idrizi, ish-deputet i popullit nga Shkupi, kishte lënë vakëf 31 njësi bibliografike. Ndërkaq, më 27 dhjetor 1951, 69 njësi bibliografike (67 libra dhe 2 dorëshkrime), në vlerë prej 3. 685 dinarësh, ishin blerë nga znj. Adile, e veja e Jahja ef. Ademit, ish-imam nga Prishtina⁵⁴.

Numrin më të madh të këtyre librave-dorëshkrimeve që posedonte "Biblioteka Qendrore e Vakëfit" në Prishtinë, sipas regjistrave të sipërpërmendur, e përbënin veprat në fushën e gjuhësisë, etikës dhe jurisprudencës islame, që zinin vend kryesor, çka është e kuptueshme, siç janë veprat mbi namazin, rregullat e obligimeve të tjera fetare etj., por kishte edhe nga fusha e tefsirit, hadithit, logjikës etj.

Shumica e atyre titujve mësoheshin si libra didaktikë nëpër medresetë tona të kohës, kurse autorë të këtyre librave dhe dorëshkrimeve ishin ulematë më eminentë të Botës Islame, si Bejdaviu, Mulla Husrevi, Ibrahim Halebiu, Taftazani, Kuduriu, El-Fenari, Suhraverdi, Xhurxhaniu, Xhevdet Pasha etj.

Nga dorëshkrimet ruheshin "Lugati bahr-ul-garaib-i Halimi", "Teddhkiretu el-Kurtubi", "S'adi 'ale-Kadi", "Bahrul-mesail", "Sherh-i 'avarif el-me'arif", "Misbah", "Sherh Shi'atul-islam", "Sherh-i Nihaje li ibni Maxhe", "Tekmile li ibni Humam", "Divan-i Misri", "Lugat Xhevheru-sihha", "Ahtari Kebir", "Fetava-i Uskubi", "Eshbahun-Nedhair", "Fetava-i Ankaravi", "Fetavai 'Ali efendi", "Multeka el-Ebhur", "Ahsenul-mesail ve ekmelul-hitab" etj., nga autorë të ndryshëm që dihen e nuk dihen, ndonjë edhe nga alimët tanë, kurse kopjuesit e këtyre dorëshkrimeve, me siguri shumica kanë qenë nga paraardhësit tanë.

Në fund të vitit 1952 mbledhja e librave-dorëshkrimeve orientale për shkak të mungesës së mjeteve materiale, kishte ngecur shumë, parvësisht nga kërkesat e njëpasnjëshme që Drejtoria e Vakëfit të Prishtinës u kishte bërë institucioneve më të larta shtetërore dhe fetare të

⁵⁴ Po aty.

asaj kohe në ish-RFPJ-dhe në Kosovë, nga të cilat nuk kishte marrë asnjë përgjigje⁵⁵.

Më 1959, sipas një raporti të Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës, "Biblioteka Qendrore e Vakëfit" kishte 2.092 njësi bibliografike - "qitape" në gjuhët arabe, turke dhe persiane, 147 prej të cilave ishin dorëshkrime të vjetra dhe u takonin 46 fushave të ndryshme shkencore⁵⁶.

Më 1961 "Biblioteka Qendrore e Vakëfit", me vendimin e Entit Krahinor të Kosovës, nr. 383/1961 kaloi nën mbrojtjen e monumenteve të kulturës⁵⁷.

Pjesa dërrmuese e "Bibliotekës Qendrore të Vakëfit" është bartur në bibliotekën e medresesë "Alauddin" të Prishtinës, ku ruhen rreth 400 dorëshkrime⁵⁸.

Objekti ku dikur gjendej "Biblioteka Qendrore e Vakëfit", së bashku me ndërtesën e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, më 1999 u dogj nga forcat paramilitare serbe.

B. KUTUBHANET PRIVATE

Në Kosovë, sikurse u tha, ka ekzistuar edhe një numër i madh i kutubhaneve private-personale, të cilat kanë qenë pronë e personaliteteve të njohura të fushave të ndryshme të dijes e të kulturës, udhëheqësve të huaj e vendorë, zanatlinjve, njerëzve të pasur dhe dashamirëve të librit.

Shumicës së këtyre kutubhaneve u kanë humbur gjurmët, përveç një pjese të vogël të tyre që, në mënyrë të coptuar e të sakatuar, ruhen ndër trashëgimtarët e këtyre personaliteteve dhe për disa të tjera që dihet nga vulat e firmat që këto personalitete kanë vënë në libra të ndryshëm.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Izveštaj o radu Saborskog Odbora IVZ za NRS 1958-1959, "Glasnik", br. 1-3, Sarajevë, 1960, s. 82.

⁵⁷ Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë 1945-1980*, Prishtinë, 1988, f. 170.

⁵⁸ Dr. Feti Mehdiu, *Islam kod Albanaca u svjetlu rukopisnik djela*, Zbornik Radova VII Medžunarodnog Islamskog Simpozija, Zagreb, 1997, f. 78.

Deri më sot nuk është bërë ndonjë përpjekje serioze për evidencimin ose për blerjen dhe tubimin e këtyre kutubhaneve, në mënyrë që të shpëtohet ajo që ka mbetur për t'u shpëtuar.

Si do që të jetë, dihet se në qytetin e Prishtinës kutubhane të tyre shumë të pasura kanë pasur pinjollët dhe dinjitarët e familjes së mirënjohur shqiptare Xhinolli⁵⁹: Maliq Pasha, Jashar Pasha, Bahtijar Pasha, pastaj biblioteka e myftiut të Prishtinës, Hysejn efendi haxhi Sadikut që ka pasur një kutubhane të çmuar, kutubhaneja e familjes së hoxhallarëve Atallah e Jahja ef. Junusi, po nga Prishtina. Këto dy kutubhane, me fondin e tyre jashtëzakonisht të vlefshëm, kanë qenë krenaria e Prishtinës në atë kohë.⁶⁰

Ndërkaq, në Prizren janë evidencuar edhe disa kutubhane private të personaliteteve të ndryshme islame të kohës që ruhen nga pasardhësit e tyre. Madje vepra origjinale në dorëshkrim, me vlerë për shkencën islame dhe shqiptare, si në kutubhanen e trashëguar nga Xhemal Heremi, pastaj në kutubhanen familjare të të përsekutuarit nga forcat unitariste, Xhemil Fluku, si dhe në kutubhanen personale të Qamil Hoxhës, të cilën e trashëgoi i biri Mehmedaliu⁶¹.

Në shtëpinë e Berzat Shportës, pasardhësit të prijësit fetar e kombetar haxhi Rrustem Shporta, ruhen 18 dorëshkrime e vepra me rëndësi nga fushat islame⁶².

Përfundimi

Mbi bazën e asaj që u tha, mund të përfundojmë se falë mësimëve kuranore, haditheve të Pejgamberit a.s., kontributit të ulemave dhe angazhimit të dashamirëve të fesë islame dhe të dijes, në Kosovë kutubhanet kanë njohur një përhapje dhe një zhvillim të hovshëm dhe se ato kanë një histori dhe traditë mjaftë të bujshme.

⁵⁹ Të dhëna për familjen Xhinolli dhe pinjollët e saj - Maliq pashën dhe Jashar pashën, gjejmë në: Hasan Kaleshi - Ismail Eren, *Prizrenac Mahmud pasha Rrotul, njegove zadužbine i vakufnama*, Starine Kosova, VI-VII, Prishtina, 1972-1973, f. 25-30, si dhe; Kadri Halimi, *Trajtime dhe studime etnologjike*, Prishtinë, 2000, f. 304-306.

⁶⁰ Libra nga këto kutubhane ruhen në Arkivin e Kosovës në Prishtinë.

⁶¹ Muhamet Shukriu, op.cit. f. 51.

⁶² Po aty, 413.

Kutubhanet kanë ndikuar shumë në zhvillimin kulturor dhe në ngritjen arsimore të popullatës myslimane në viset tona. Nuk ka pasur shtëpi të myslimanëve që nuk ka pasur në mos asgjë tjetër, të paktën një “mus’haf”, sikundër që çdo medrese, mekteb, xhami e teqe ka pasur kutubhanen e vet, që kanë qenë në shërbim të popullatës së interresuar.

Megjithëkëtë, po thuaj të gjitha kutubhanet në Kosovë kanë pasur fund tragjik, duke filluar që nga gjysma e dytë e shek. XVI gjatë luftërave austro-turke, dhe sidomos në shekullin e fundit, ku shumica e tyre janë djegur, janë shkatërruar dhe u kanë humbur gjurmët. Dy nga këto kutubhane (ajo e Gjakovës dhe ajo e Vakëfit të Prishtinës) janë djegur në luftën e fundit në Kosovë më 1999 nga forcat paramilitare serbe.

Prandaj, mendoj dhe propozoj që:

- Është me interes që të bëhen përpjekje nga njerëz kompetentë, dhe sidomos nga ulematë (përfshirë këtu hoxhallarët, studentët, medresantët etj.) që të përdorin autoritetin e tyre që të shpëtohet ajo pak pasuri që ka ngelur nga këto kutubhane.

- Është me interes fetar e kombëtar që të themelohet një kutubhane qendrore, d.t.th., të bëhet centralizimi i të gjitha kutubhaneve që gjenden në Kosovë. Me një fjalë, librat dhe dorëshkrimet që do të mbli-dheshin gjithandej në Kosovë, të vendosen në një vend të sigurt, siç është për shembull kutubhaneja e medresesë “Alauddin” në Prishtinë, në mënyrë që të jenë më të sigurta, më të mbrojtura dhe më lehtë të shfrytëzueshme nga të interesuarit, si dhe të bëhet regjistrimi, evidenci, katalogimi dhe botimi i tyre eventual, në mënyrë që vlerat e tyre të vihen në pah.

- Është e udhës që në Kosovë, meqë ka një traditë mbi 500-vjeçare të kutubhaneve, të kremtohet kontributi i kutubhaneve në shoqërinë tonë, d.t.th., të ketë një datë në të cilën në mënyrë tradicionale do të shënohej dita e kutubhaneve, me ç’rast do të mbaheshin tryeza, sesi-one e konferenca shkencore të ndryshme.

- Është mirë dhe e do puna që të organizohet një konferencë shkencore a një simpozium me temë bosht kutubhanet.

Osman Mehmeti

A VIEW ON THE KUTUBHANE AND THEIR DEVELOPMENT IN KOSOVA (Origins, development, history)

(Summary)

The Qur’an is a religious book, which calls upon people to read. The prophet, to whom it was revealed, ordered his ummah to do the same. The Ashab and other Islamic scholars, who served as an example due to their good behavior and generosity, also contributed to the efforts to spread knowledge and civilization.

عثمان مُحمّدي

دراسة عن شبكة المكتبات و تطورها في كوسوفا

(نشأتها و تطورها و تاريخها)

(خلاصة البحث)

مدخل:

القرآن الكريم هو كتابنا الذي أمر المسلمين بالقراءة منذ نزول الآية الأولى. و نبينا محمد صلى الله عليه و سلم الذي أنزل إليه هذا الكتاب أمرنا أن نتبع نفس الطريق. و لقد اتبع المسلمون الاوائل نفس هذا الاسلوب حتى استفادوا من العلوم و افادوا بها الاخرين.

DOKUMENTE

Mr. Aliriza Selmani

**NJË DOKUMENT ME RËNDËSI
 MBI PRONAT E PATUNDSHME VAKËFNORE
 TË RRETHIT TË GJILANIT NË PRAG
 TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE¹**

Që nga fillet e shtrirjes së islamit ndër vende e popuj, vjen deri te themelimi i institucionit të vakëfit, i cili gjatë gjithë kohës ka pasur rol të jashtëzakonshëm në jetën e gjithmbarshme të shoqërisë dhe shtetit islam. Për rolin e vakëfit në shtetin islam vlen të përkujtojmë orientalistin tonë të ndjerë dr. Hasan Kaleshin i cili thotë: "Në asnjë shoqëri apo religjion tjetër nuk ka ekzistuar një institucion që të ketë pasur rol aq të rëndësishëm si institucioni bamirës i vakëfit në shoqëri dhe shtetin islam. Nuk ka ekzistuar pothuaj asnjë aspekt i jetës-fetare, morale, ekonomike, politike, sociale etj., ku institucioni i vakëfit të mos ketë pasur ndikim të madh".² Vakëfi i parë i shënuar në historinë e islamit, sipas Haditheve rrjedh nga koha e Muhamedit a.s. kur Omeri r.a. sipas këshillës së Pejgamberit a.s. la në emër të Allahut, kopshtin e tij të

dashur në trashëgimi si Vakëf, të ardhurat e të cilit do të shërbejnë në të mirë të njerëzisë.³ Kjo pastaj është shndërruar në traditë të përherëshme në institucionet fetare islame duke u bazuar edhe në librin e sheh-njtë Kur'an, i cili udhëzon në bamirësi të përherëshme. "**Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim (as kënaqësinë e lumtur në xhenet) derisa të mos e jepni më të dhembshmen e pasurisë. Çfarëdo që të jepni (për Zotin), Allahu atë e di**".⁴

Me përhapjen e islamit në viset e Ballkanit, pra edhe në ato shqiptare u vunë themelet e vakëfit, si institucione bamirëse, që kishte në trashëgimi sasi të caktuar pronësore private, të tundshme e të patundshme, të dhuruar që prej kohësh nga ana e bamirësve të shtresave dhe kategorive të ndryshme shoqërore, duke filluar që nga sulltani e administratorë të tjerë deri te shtresat më të ulëta të shoqërisë, me përfitimet e së cilës plotësoheshin nevojat e ndryshme të bashkësive islame, të administratës, medreseve, xhamive, tekeve etj., por edhe zgjidheshin problemet e ndryshme sociale të një bashkësie të ngushtë apo të gjerë shoqërore. Çdo bamirës me rastin e vakëfimit të pronës, me anën e vakëfnames (tapi e vakëfit) përcaktonte qëllimin e vakëfimit të pronës së tij dhe çdo vakëfname në fund kishte të shkruar; "**I mallkuar qoftë ai i cili në çfarëdo mënyre e përdhos veprën time të bamirësisë**"⁵

Me okupimin e Kosovës dhe të trojeve tjera etnike shqiptare e myslimane në Ballkan, nga ana e okupatorit sllavo-ortodoks, krahas shtypjes me qëllim të shkombëtarizimit të këtyre trojeve, pos masave të tjera, me ligjin për reformën agrare dhe kolonizimin, janë prekur edhe pronat vakëfnore si bazë kryesore e ekzistencës së bashkësive islame në këto vise.

Pas formimit të Mbretërisë SKS, Rrethi i Gjilanit hynte në kuadër të administratës së Banovinës së Vardarit dhe ishte rrethi më i madh në Kosovë, me 18 komuna, i cili përfshinte pjesën juglindore të Koso-

¹ Arkivi i Bashkësisë Islame Gjilan, Spisak nepokretnog imanja Sreskog Mearifskog Poverenstva Gnjilane.

² Dr. Hasan Kaleshi, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Prishtinë, 1972, fq.13.

³ Të dhëna nga interneti, www.Islambosna.ba, Myderriz Nazim Haliloviq, nga fjala në Hydbe, Sarajevë, 3 dhjetor 2004, fq.1.

⁴ Kur'ani, Sura Ali Imran, Ajeti 92, përkthimi sipas Sherif Ahmetit.

⁵ Po aty.

vës së tanishme. Ky rreth në aspektin fetar-administrativ ishte nënmyfytni dhe hynte në kuadër të Myftinisë së Prishtinës, me 23 Këshilla të Xhematit.

Përkundër shpronësimit të vazhdueshëm të pronave të vakëfit, pas okupimit serbo-sllav të këtyre trojeve, të dhënat dokumentare të kohës na bëjnë me dije se Nënmyftinia e Gjilanit respektivisht Vakëfi Mearife i këtij rrethi, i cili ishte në mbikëqyrje të Drejtoratit të Vakëfeve Mearife në Shkup, para Luftës së Dytë Botërore, kishte në posedim një numër relativisht të madh pronash të patundshme, të trashëguara që prej kohësh, të dhuruar nga bamirësit e ndryshëm të kësaj treve, por edhe të tjerë. Këto prona ishin të llojit dhe kategorive të ndryshme si objekte fetare xhami, mejtepe, shtëpi banimi, teqe, prona tokësore të punëshme, varreza, livadhe, dyqane etj., të cilat shtriheshin në tërë sipërfaqen e rrethit dhe sillnin përfitime në interes të funksionimit të institucioneve fetare islame të rrethit, si dhe për interesa të tjera të bamirëse. Mirëpo, me riokupimin sllavo-komunist të këtyre trojeve dhe sidomos gjatë viteve 1945-1959, të sistemit komunist, me riaktivizimin e reformës agrare dhe kolonizimit, u bë konfiskimi, nacionalizimi, eksproprijimi etj., i pronave, në kuadër të cilave hyjnë edhe pronat e vakëfit, të cilat janë zhdukur pothuaj në tërësi. Mirëpo nuk duhet anashkaluar edhe uzurpatorët e ndryshëm privat të këtyre pronave, të cilët që me kohë i kanë ndihmuar shpronësimit të pronave vakëfnore.

Bazuar në dokumentin autentik me titull: “Regjistër i pasurisë së patundshme të Komisionit të Vakëfit Mearife të Rrethit të Gjilanit”, të punuar me pedanteri, jepen të dhëna me vlerë, për pronat e vakëfit të para Luftës së Dytë Botërore, të sistemuara sipas këshillave të xhematit (23 këshilla) të këtij rrethi, i cili sipas të dhënave të Ylema Mexhlisit të Shkupit për vitin 1938/39, kishte 8.378 shtëpi me 63.783 banorë myslimanë⁶. Regjistri në fjalë i përpiluar në këtë kohë, cili mund të ketë edhe mangësi, mban në vete të dhëna të hollësishme, lidhur me

⁶ Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), fon. Komuniteti Mysliman, nr. 882, v.1944, d.80, fq. 16, 24-25. Raport statistikor i Inspektorisë dërguar Kryesisë së Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 27.06.1944. Të dhënat e nxjerra nga raporti i Ylema Mexhlisit të Shkupit për vitin 1938/39.

pronat e patundshme të Vakëfit Mearife të Rrethit të Gjilanit, e sidomos për shtrirjen dhe përkufizimin e tyre, gjë që mundëson qasje më të lehtë në identifikimin e këtyre pronave. Pronat janë të trashëguara që prej kohësh, por për një numër të tyre dihet edhe koha dhe emri i bamirësit. Në vijim sjellim të dhëna nga ky regjistër, lidhur me pronat e patundshme, sipas xhemateve të rrethit, nën përkujdesjen e të cilëve ishin edhe këto prona, të plotësuara me disa të dhëna dokumentare të kohës.

Xhematet e qytetit të Gjilanit

Në kuadër të qytetit të Gjilanit, ishin: **Xhemati i Çarshi Xhamisë** (Xhamisë së Madhe); **Xhemati i “Atik” Xhamisë** dhe **Xhemati i Xhamisë-Deremëhallë** (Xhamia e Vogël). Pronat e tyre të vakëfit në këtë regjistër janë të shënuara me aktin nr. 113/38.

Xhemati i Çarshi Xhamisë, në kuadër të tij kishte 270 shtëpi myslimane⁷, kurse si imam në këtë xhami atëbotë shërbente Ismajl Ramushi, i emëruar me dekret (vendim) nr.3099/35, nga Ylema Mexhlisi i Shkupit më 27.11. 1933.⁸ Pos xhamisë që përfshinte një sipërfaqe prej 375 m², në qendër të qytetit ky xhemat kishte në pronësi edhe 4 dyqane brenda një kompleksi që kapte vlerën në shumë prej 80.000 din. të kohës. Mirëpo këto katër dyqane gjatë Luftës së Dytë Botërore sipas planit urbanistik ishin ekspropriuar me kompensim nga Bashkia e Gjilanit, dhe me ato të holla Zyra e Vakëfit në Gjilan kishte blerë një truall në qendër të qytetit për ndërtim të dyqaneve⁹. Pos këtyre ky xhemat kishte edhe dy dyqane të tjera veç e veç, po ashtu në qendër të qytetit, të cilët kishin vlerën e përbashkët prej 28.000 din. të kohës.

Xhemati i “Atik” Xhamisë apo xhamisë së vjetër në Gjilan, përfshinte 329 shtëpi myslimane.¹⁰ Si imam dhe njëherësh edhe kryeim-

⁷ Po aty, fq. 24.

⁸ Po aty, fon. nr.882, v.1943, d.14, fq.72, 73. Lista e xhematëve që paguhen nga Komuniteti Mysliman. Raport i Zyrës së Vakëfit në Gjilan, dërguar Kryesisë së Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 21.05.1943.

⁹ AQSH. F.482, v. 1943, d.52, fq.4 dhe 5, më 25.09.1943

¹⁰ Po aty, fon. 882, d.80, v.1944. fq.24.

am (imam ofiçar), nga data 17.10.1938, shërbente Sylejmon Jakupi, më parë i emëruar në Xhematin e Smirës, me dekretin e Ylema Mexhlisit të Shkupit nr.3303/35, të datës 14.12.1935¹¹. Në pronësi të këtij xhemati ishte kompleksi i xhamisë me oborr, objekti i medresesë dhe një shtëpi banimi me gjithsej sip. 2025 m².¹² Një gjysmë shtëpie në të cilën banonte Nënmyftiu Shaip Rexhepi, si dhe teqeja me shtëpi dhe kopsht.

Xhemati i Xhamisë-Deremëhallë-Lagjeja Vis?, kishte gjithsej 364 shtëpi myslimane.¹³ Si imam i xhamisë së kësaj lagje shërbente Ymer Bajrami, i emëruar me dekretin nr. 3102/33, të datës 3.11.1933, nga Yl. Mexh. i Shkupit.¹⁴ Në kuadër të këtij xhemati atëbotë ishin edhe fshatrat Livoç i Ulët dhe Livoç i Epërm, andaj ky xhemat pos në qytet prona vakëfnore kishte edhe në këto fshatra.

Pronat e vakëfit të këtij xhemati në qytet ishin: Xhamia me oborr në lagjen “Deremëhallë” me sip. 546 m², në vlerë prej 40.000din. të kohës; një oborr i quajtur “Oborr Vakëfnor”, me sip. 269m², i lënë kësaj xhamie nga Suhbibeg Xhinolli, më 1910; një livadh në Kufcën e Poshtme, me sipërf. 1900 m², i dhuruar nga Haxhi Sadik Arifi nga Gjilani dhe Mezxhidi i “Hysen Pashës” (Xhamia e Balcit) me sip. 324 m².

Në **Livoçin e Epërm**, mektebi me sip. 357 m². i ngritur gjatë vitit 1933/34, me punë vullnetare të xhematit; varrezat e fshatit, me sip. 3200 m² dhe varrezat e “Jabuqëve”, me sip. 13400 m².

Në **Livoçin e Ulët**, ishin varrezat e fshatit më sip. 6550 m² dhe “Varrezat e Muhaxherëve”, me sip. 15050 m².

Sipas këtij regjistri, pronat e patundshme të vakëfit të xhematëve të qytetit të Gjilanit kishin një sipërfaqe prej 28946m² me vlerë prej 151600 din. të kohës.

¹¹ Po aty, v.1943, d.14. fq.73.

¹² Rreth gjysma e kësaj prone aty kah fundi i shek.XX, është uzurpuar nga mësuesi gjilanas Gani Gashi.

¹³ Po aty, d.80, v.1944, fq.24.

¹⁴ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

Vlen për t’u theksuar se në këtë regjistër nuk bëhet fjalë për varrezat myslimane të qytetit të Gjilanit, të cilat ndodheshin bri qendrës së tanishme të qytetit dhe shtriheshin skaj rrugës kryesore, prej hotelit “Kristal” dhe deri afër stacionit të autobusëve. Mirëpo rreth viteve 20-ta të shekullit të kaluar me intervenimin e serbëve të Gjilanit, ndalohej varrimi i mëtejme në këtë vend, për të vazhduar në lokacionin e ngushtë mes dy rrugëve, ngjitur me oborrin e shkollës së tanishme fillore “Abaz Ajeti” në Gjilan, mu në vendin ku vitin e kaluar (2005) është rregulluar mini-parku i ri, kurse më pas varrezat janë bartur në vendin ku gjenden tani.

Xhemati i Bresalcit, (Komuna e Bresalcit), sipas të dhënave të Ylema Mexhlisit të Shkupit më 1938/39, ky xhemat kishte gjithsej 348 shtëpi myslimane.¹⁵ Pronat e patundshme të vakëfit me aktin nr.1664, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Bresalc** në pesë vende kishte prona të vakëfit dhe ato ishin: Xhamia e fshatit me sip. 1000 m² dhe vlerë 18.000din. të kohës, ku si imam shërbente Abdullah Neziri, i emëruar nga Ylema Mexh. i Shkupit më 1940,¹⁶ pas të cilit për një kohë shërbeu Rashit Y. Bajrami, kurse nga 7.04.1943, Adem Shaban Selmani i emëruar me vendim nga Kësh. i Yl. të Kom. Mysliman në Tiranë.¹⁷ Mungojnë të dhënat për llojin e pronave të tjera vakëfnore të këtij fshati, e që mund të jetë fjala për varrezat e fshatit të shpërndara në disa vende sipas lagjeve. Dihet sipërfaqet e këtyre pronave. Kështu prona e dytë kishte sip. 945m²; prona e tretë sip. 5600m²; prona e katërt me sip. 14200m², e cila ishte e dhuruar si vakëf nga Musa Hajrullahu para 100 vitesh dhe prona e pest me sip. 4400m².

Në fshatin **Ponesh** (Komuna e Parallovës), pronë të vakëfit ishin varrezat e fshatit që shtriheshin në dy vende, varrezat në sipërfaqe prej 9200m² dhe varrezat me sip. 3000m².

Në fshatin **Zhegoc**, ishin varrezat e fshatit, në sipërfaqe prej 5000m².

¹⁵ Po aty, v.1944, d.80. f.24.

¹⁶ Po aty, fq.74. Nga lista e xhematëve private që paguhen nga populli.

¹⁷ Po aty, fon. 882, v.1943, d.14, fq.73 dhe fq. 117.

Në fshatin **Vërbicë e Zhegocit**, Varrezat e fshatit shtriheshin në tri vende, varrezat e quajtura “Varrezat e fshatit”, me sip. 250m.², “Varrezat e Vjetra”, me sip. 4000m.² dhe varrezat me sip. 3000m.²

Prona e patundshme të këtij xhemati, sipas regjistrit në fjalë ishte 50595m², kurse vlera 43100 din. të kohës.

Xhemati i Llashticës, (Komuna e Pasjanit), atëbotë kishte gjithsej 344 shtëpi myslimane.¹⁸ Pronat të vakëfit të shënuara me aktin nr. 106/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Llashticë**, në një vend ishin xhamia me mekteb dhe oborr, me sip. 356m.², vlera e të cilëve llogaritej në 12.000 din. të kohës dhe një livadh me sip. 15950m.² Në kuadër të fshatit Budrikë e Poshtme, të “Zallina”-Morava, një arë me sipërf. prej 4200m.², e dhuruar nga fshatarët e fshatit Llashticë para 12 vjetësh.

Në fshatin **Zhegër** (Komuna e Shurdhanit), ishte xhamia e fshatit me oborr dhe sib. mektebi, të “Lumi”, me sip. 2455m.², vlera e saj llogaritej në 12.000 din.; një arë “Nën Breg”, me sip. 1000m.² dhe ara tjetër në “Toplak”, me sip. 650m.², e dhuruar nga fshatarët e lagjes “Demaj”, para 15 vjetësh.

Në fshatin **Lladovë**, ishte sibijan mektebi në “Oborrishtë”, me sip. 208m.², për të cilën thuhet se është e dhuruar nga Mehmet Mahmuti nga Lladova para tre vjetësh.

Në fshatin **Muçibabë**, ishte xhamia me oborr dhe sibijan mektebin, “Te Bregu”, të cilat i kishte dhuruar Ymer Saçipi nga Myqybaba para 5 vjetësh.

Sipërfaqe e patundshme të këtij xhemati ishte 24819m². dhe vlera 44750din.

Xhemati i Desivojcës (Komuna e Hogoshtit), kishte gjithsej 333 shtëpi myslimane.¹⁹ Pronat me aktin nr.296/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Desivojcë**, ishte Xhamia e fshatit me oborr, sip. 570m.², ndërtuar nga banorët e fshatit në truallin e lënë vakëf nga

Abdullah Islam Ademi, me vlerë 40.000 din. të kohës. Si imam i xhamisë nga data 13.01.1938, shërbente Tefik Jakupi, ky më parë ishte i emëruar në Xhematin e Krilevës, me dekretin e Yl. Mexh. të Shkupit nr.4083/34, të datës 6.01.1934.²⁰ Prona tjera të vakëfit ishin, sib. mektebi me oborr, në Desivojcë, me sip. 1721m.², dhuruar nga Mehmed Halid Ahmedi nga Desivojca; një shtëpi me oborr dhe dy stalla të ndërtuara nga banorët e fshatit, në tokën e dhuruar prej Abdullah Islam Ademit, vlera e së cilës ishte 30.000 din. të kohës. Në këtë shtëpi atëbotë banonin xhandarët; varrezat e Desivojcës në dy vende, varrezat me sip. 550m.², toka e dhuruar nga Demir Hajdin Islami dhe varrezat në sip. 250m.² në tokën e dhuruar nga Halim Zejnel Halimi; një livadh, të cilit i mungon sipërfaqja, i dhuruar nga Nezir Kurtesh Mehmeti.

Në fshatin **Laçiç**, ishte Sibijan mektebi me oborr, me sip. 550m.², dhuruar nga Hysein S. Ramadani; varrezat e fshatit në dy vende, varrezat në sip. 2750m.², në tokën e dhuruar nga Hajdin Zymberi dhe Kadri Asllani dhe varrezat me sip. 1750m.², në tokën e dhuruar nga Nezir Aliu.

Në fshatin **Vriçec**, ishte xhamia me sip. 628m.², e ndërtuar në truallin e dhuruar nga Zahir Miftari, në të cilën atëbotë i shërbente Ajet Selimi.

Në fshatin **Velegllavë**, ishte Sibijan mektebi i ndërtuar në truallin e dhuruar nga fshatarët.

Prona të patundshme të këtij xhemati sipas regjistrit në fjalë kishte mbi 8769m.². vlera e të cilëve ishte mbi 82.800 din. të kohës.

Xhemati i Dobërçanit, (Komuna e Ropotovës), në këtë kohë kishte 329 shtëpi myslimane.²¹ Pronat e vakëfit të regjistruara me aktin nr. 448/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Përlepnicë**, pos xhamisë së fshatit me sibijan mektebin, vlera e së cilës llogaritej në 80.000 din. të kohës, ishin edhe këto prona: varrezat e fshatit në dy vende, në një vend me sip. 10250m.²

¹⁸ Po aty, v.1944, fq.24.

¹⁹ Po aty, fq.25.

²⁰ Po aty, v.1943, fq.72.

²¹ Po aty, v.1944, fq.25.

dhe varrezat me sip. 5250m.²; një arë te “Varrezat “, me sip. 3950m.² dhe një shtëpi banimi me oborr me sip. 446m.², dhuruar nga Ali Mehmeti nga Përlepnica.

Në fshatin **Kmetoc**, ishin varrezat me sip. 1800m.².

Në fshatin **Dobërçan** (Komuna e Ranillukit), si prona të vakëfit ishin: Xhamia nr.1 me oborr, apo “Xhamia e Vjetër “, me sip. 296m.², dhuruar nga Ramadani dhe Xhymshiti nga Dobërçani. Imam në këtë xhami shërbente Emin Shaqiri nga Përlepnica, i emëruar me dekretin nr.3090/33, të Yl. Mexh. të Shkupit, më 3.11.1933²². Xhamia nr.2, apo “Xhedid Xhamia” (Xhamia e Re), me sip. 542m.² Si imam shërbente Hafëz Vehbiu i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit me 1940²³; sib. mektebi me oborr dhe shtëpi me sip. 2032m.²; arë në Tomancë, me sip. prej 4850m.²; varrezat e fshatit në dy vende, varrezat me sip. 3450m.² dhe varrezat mbi rrugë, me sip. 4750m.².

Në fshatin **Topanicë**, Xhamia e fshatit me sip. 250m.², në të cilën shërbente Rexhep Ademi i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940²⁴; sibijan mektebi me sip. 108m.². Në pronësi të vakëfit të këtij fshati figurojnë në nëntë vende ara, si arë te “Fusha I”, me sip. 3360m.², arë tjetër te “Fusha II”, me sip. 2250m.²; arë “Nën Lum” me sip. 4850m.²; arë “Nën Rrugë” me sip. 2500m.²; arë “Përskej Lumit”, me sip. 900m.²; arë te “Qairllëku”, me sip. 3100m.²; arë te “Teranja”, me sip. 3050m.²; arë te ”Svoxha”? me sip. 2450m.² dhe arë e quajtur “Zagrizina” me sip. 3404m.²

Pronat e tërësishme të patundshme të këtij xhemati ishin, rreth 63838m.², e trashëguar kryesisht që prej kohësh me vlerë 121200din. të kohës.

Xhemati i Zarbicës (Komuna e Rogoçicës), atëbotë kishte 305 shtëpi myslimane.²⁵ Pronat e vakëfit të këtij xhemati me aktin nr. 1908/38, shtriheshin në këto vende:

²² po aty, v.1943, d.14, fq.73.

²³ Po aty, fq.74.

²⁴ Po aty, fq.74.

²⁵ Po aty, v.1944, fq.25.

Në fshatin **Zarbicë**, pos xhamisë së fshatit e cila ishte te “Lumi”, me sip. 369m.² edhe sib. mektebi po ashtu te “Lumi”, me sip. 239m.² Që të dyja të dhuruara nga Bilall Luma nga Zarbica.

Në fshatin **Karaçevë e Epërme**, Xhamia ndodhej te “Kroi”, me sip. 285m.² dhe sib. Mektebi po ashtu te “Kroi”, me sip. 44m.², të ndërtuara në tokën e dhuruar nga banorët e fshatit. Imam në xhaminë e fshatit shërbente Shuajib Aliu, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 1940²⁶. Prona të tjera të vakëfit ishin: varrezat po ashtu “Te lumi”, me sip. 20700m.², në tokën e dhuruar nga banorët e këtij fshati; arë te “Varrezat e Vogla”, me sip. 11650m.² Nga kjo e dhënë shihet se në këtë fshat varrezat shtriheshin në dy vende.

Në fshatin **Karaçevë e Ulët**, ishte Xhamia me sib. mektebin te “Lumi”, me sip. 660m.², dhuruar nga Baftijar Selmani nga fshati Karaçevë e Epërme, Si imam i xhamisë së fshatit atëbotë shërbente Destan Salih, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 1940²⁷. Varrezat e fshatit, “Përskej Lumit”, me sip. 7500m.², në tokën e dhuruar nga fshatarët e Karaçevës së Ulët.

Pronat e patundshme të këtij xhemati sipas këtij regjistri ishin rreth 41447m.² me vlerë prej 22400 din. të kohës.

Xhemati i Krilevës, (Komuna e Vaganeshit) kishte gjithsej 347 shtëpi myslimane²⁸. Pronat e vakëfit të këtij xhemati me aktin nr. 150/39, shtriheshin vetëm në këtë fshat dhe ato ishin: Xhamia e fshatit me oborr te “Uji i Mirë “, me sip. 142m.² dhe sib. mektebi me oborr, në sip. 750m.² Imam në xhaminë e fshatit që nga 3.01.1938, shërbente Ismajl H. Jakupi i cili më parë kishte qenë i emëruar në Xhematin e Desivojcës me dekretin e Yl. Mexh. të Shkupit nr.4083/34, të datës 14.12.1935.²⁹ Prona vakëfnore të këtij xhemati ishin ara në tri vende dhe ato: arë e quajtur “Ara e Xhamisë”, me sip. 3400m.²; arë te vendi i quajtur “Uji i mirë”, me sip. 3700m.² dhe arë te “Melishta”, me sip. 1600m.².

²⁶ Po aty, v.1943, d.14, fq.74.

²⁷ Po aty, fq.74.

²⁸ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

²⁹ Po aty, v.1943, d.14. fq.72

Pronat e patundshme të këtij xhemati sipas regjistrimit ishin rreth 9592m.² me vlerë prej 13500 din. të kohës.

Xhemati i Koretinit (Komuna e Kamenicës), kishte 286 shtëpi myslimane³⁰. Pronat e vakëfit me aktin nr. 1558/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Koretin**, Xhamia të “Lama e Sylejman Spahiut”, për të cilën thuhet se është e ndërtuar në vakëfin e lënë nga Sylejmon Spahiu qysh para 500 vjetësh, me sip. 600m.² Si imam i xhamisë shërbente Muharrem Hasani i emëruar me dekretin nr. 3317/35, të Yl. Mexh. të Shkupit, më 14.12.1935³¹. Prona të tjera vakëfnore në këtë fshat ishin edhe varrezat që shtriheshin në pesë vende dhe ato: varrezat të “Prr-oi”, me sip. 9650m.²; varrezat “Kovan”, në sipër. 4350m.²; varrezat “E Mëdha”, në sip. 5300m.²; “Varrezat e Ulta”, me sip. 4600m.²; varrezat “Përskej Lumit”, me sip. 300m.² dhe varrezat “Skaj Fshatit”, me sip. 24500m.².

Në fshatin **Busavatë**, ishte xhamia e fshatit me mekteb dhe shtëpi banimi, vlera 15.000 din. Imam-hatib (predikues) në këtë xhami shërbente Nevzad Hoxha, i emëruar nga Këshilli i Ylemave të Komunitetit Musliman në Tiranë, më 23.01.1943³². Varreza e këtij fshati të shpërndara në nëntë vende dhe ato: varrezat “Te Quka”, në sip. 9900m.²; varrezat të “Lumi”, me sip. 11200m.²; varrezat e “Jabukovikëve” të Busavatës, me sip. 1900m.²; varrezat të “Prrroi”, me sip. 5600m.²; varrezat të “Lagjeja e Epërme”, me sip. 2300m.²; varrezat të “Shpati”, me sip. 66m.²; varrezat të “Lugi i Thanave”, me sip. 550m.²; varrezat të “Rruga e Gjilanit”, me sip. 8400m.² dhe “Varrezat e Romëve”, me sip. 1500m.² Një arë të “Lubota”, me sip. 3100m.².

Në fshatin **Birivojcë**, pronat me aktin nr. 150/39, ishte Xhamia e fshatit me sip. 4869m.² e ndërtuar nga banorët e fshatit, me vlerë 10.000 din. Varrezat e këtij fshati shtriheshin në dy vende, varrezat “Mes dy Prrojve”, në sip. 4550m.² dhe varrezat “Përskej Fshatit”, në sip. 1450m.²

³⁰ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

³¹ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

³² Po aty, fq.74.

Në fshatin **Boscë**, e vakëfit ishin, varrezat në “Utrina” me sip. prej 2200m.²

Në fshatin **Shipashnicë e Epërme**, ishte xhamia me mekteb, me sip. 2117m.², vlera 15.000 din. Si imam xhamie shërbente Ramadan Sallahi, i emëruar nga Këshilli i Ylemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 23.01.1943³³. Varrezat “Përskej Fshatit”, me sip. 24500m.²

Pronat e patundshme të këtij xhemati sipas regjistrimit ishin rreth 133502m.², me vlerë prej 71900 din. të kohës.

Xhemati i Kremenatës, (Komuna e Ajnovcit) atëbotë kishte 360 shtëpi myslimane.³⁴ Pronat e patundshme të vakëfit me nr. të aktit 1490/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Kremenatë**, flitet vetëm për varrezat e fshatit në dy vende, varrezat me sip. 650m.² dhe varrezat në sip. 1200m.²

Në fshatin **Tygjec** ishte xhamia fshatit me sip. 324m.² dhe sib. mektebi me sip. 86m.². Si imam shërbente Ramadan Azemi, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940³⁵. Sib.mektebi me sip. 86m.² Varrezat e këtij fshati shtriheshin në nëntë vende dhe ato: varrezat me sip. 900m.²; varrezat me sip. 1000m.²; varrezat me sip. 3400m.²; varrezat me sip. 900m.²; varrezat me sip. 200m.²; varrezat me sip. 100m.²; varrezat me sip. 200m.²; varrezat me sip. 200m.² dhe varrezat me sip. 300m.²

Në fshatin **Meshinë**, Xhamia e fshatit me vlerë 8.000 din., ku si imam xhamie shërbente Fetah Rexhepi nga data 30.05.1940, ky më parë ka shërbyer në Xhematin e Pidiqit, i emëruar me dekret nga Ylema Mexhlisi i Shkupit³⁶. Sib. mektebi me sip. 180m.² Në katër vende varrezat e fshatit dhe ato: varrezat me sip. 6100m.²; varrezat me sip. 3100m.²; varrezat me sip. 850m.² dhe varrezat me sip. 250m.²

Në fshatin **Feriçej** varrezat në dy vende, varrezat në sip. 1000m.² dhe varrezat me sip. 200m.²

³³ Po aty, fq.74.

³⁴ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

³⁵ Po aty, v. 1943, d.14, fq.74.

³⁶ Po aty, fq.72.

Në fshatin **Ajnoc** në tri vende varrezat dhe ato: varrezat në sip. 140m.²; varrezat në sip. 80m.² dhe varrezat në sip. 450m.²

Në fshatin **Bushinc**, varrezat në tri vende, varrezat në sip. 950m.²; varrezat në sip. 30m.² dhe varrezat në sip. 296m.²

Në fshatin **Kostadincë** në dy vende varrezat, varrezat në sip. 440m.² dhe varrezat me sip. 60m.²

Në fshatin **Bratillocë**, në dy vende varrezat, varrezat në sip. 60m.² dhe varrezat me sip. 40m.²

Në fshatin **Tirincë**, në dy vende varrezat, varrezat në sip. 270m.² dhe varrezat me sip. 100m.²

Në fshatin **Kopërnice** (Komuna e Hogoshtit), xhamia e fshatit me sip. 400m² dhe vlerë 15.000 din. Si imam i xhamisë shërbente Ali Idrizi, i emëruar nga Ylema Mexhlisi i Shkupit, më1940³⁷. Sib. mektebi me sip. 20m.² Në tri vende varrezat e fshatit dhe ato: varrezat në sip. 5300m.²; varrezat me sip. 200m.² dhe varrezat me sip. 300m.²

Në fshatin **Ruboc** (Komuna e Kamenicës) në dy vende varrezat e fshatit, varrezat në sip. 540m.² dhe varrezat me sip. 540m.²

Në xhematin e **Kremenatës** prona të patundshme sipas regjistrimit në fjalë ishin rreth 31372m.², me vlerë prej 67550din. të kohës.

Xhemati i Lubishtës (Komuna e Vërbovcit), kishte 381 shtëpi myslimane³⁸. Pronat e vakëfit me aktin nr. 1687/38. shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Lubishtë**, pos xhamisë me sib. mektebin të “Kodra”, të cilat kishin sip. 6720m.², me vlerë 30.000 din., ishin edhe varrezat e fshatit me sip. 13200m.²

Në fshatin **Beguncë** ishte xhamia e fshatit me sip. 14510m.², e ndërtuar nga fshatarët në vitin 1936, vlera 20.000 din. dhe varrezat e fshatit me sip. 14696m.²

Në fshatin **Kabash**, xhamia e fshatit me sip. 30861m.², vlerë 20.000 din. dhe varrezat e fshatit, me sip. 20197m.²

Për fshatin **Xhylekar** në këtë regjistër bëhet fjalë për një sipërfaqe mjaft e madhe e tokës si pronë e vakëfit, me nr. të aktit 423/39. Kështu vetëm për rreth Xhamisë së fshatit ishte një sipërfaqe prej 118832m.² pastaj sib. mektebi me sip. 120m.², i ndërtuar nga fshatarët më 1938. Në këtë fshat kishte ara të vakëfit që shtriheshin në njëmbëdhjetë vende dhe ato: arë me sip. 2185m.²; ara në sip. 2478m.²; arë në sip. 2500m.² arë në sip. 2660m.²; arë me sip. 2310m.²; arë me sip. 1472m.²; ara me sip. 1617m.²; dy ara të quajtura të “Kthesa”, njëra me sip.2420m.² dhe tjetra me sip. 2975m.²; ara me sip. 5876m.² dhe ara në sip. 2600m.² Varrezat “E Poshtme”, me sip. 22447m.² Mulliri i lënë nga Gjinollët, në sip. 450m.²

Në fshatin **Podgorc** varrezat me emrin e pronës të “Lubishtës”, me sip. 34225m.²

Prona të patundshme sipas regjistrimit kishte 205351m. me vlerë prej 162850 din. të kohës

Lidhur me **Xhematin e Hogoshtit** (Komuna e Hogoshtit) i cili atëbotë kishte gjithsej 296 shtëpi myslimane.³⁹ Sipas regjistrimit pronat e vakëfit të xhematit shtriheshin vetëm në fshatin **Hogosht**, me aktin nr. 1551/35, por me të dhëna jo të plota. Në dy rubrika janë të shënuara xhami, por është fjala për një xhami dhe sib. mektebin. Si imam në xhaminë e fshatit, nga data 21.09.1937, shërbente Faik Behluli, i cili më parë kishte qenë i emëruar në Xhematin e Svircës me dekretin e Yl. Mexh. të Shkupit nr. 6201/37, të datës 10.03.1937.⁴⁰ Varrezat e fshatit sipas këtyre të dhënave ndodheshin në 4 vende, por pa të dhëna të nevojshme. Ndërkaq, ara të vakëfit kishte në pesë vende, prej të cilave në katër vende të quajtura “Gollubac”, (afër Mullirit të Mujës), njëra me sip. 693m.² e dyta me sip. 3639m.² e treta me sip. 8600m.² dhe e katërta me sip. 3639m.² dhe arë të “Ykdyli”, me sip. 2467m.²

Prona të patundshme sipas këtij regjistri kishte gjithsej rreth 18999m.²

³⁷ Po aty, fq.74.

³⁸ Po aty, v.1944, d. 80, fq.24.

³⁹ Po aty, fq.25.

⁴⁰ Po aty, v.1943, d.14. fq.72.

Xhemati i Pogragjës (Komuna e Ranillikut), kishte gjithsej 315 shtëpi myslimane.⁴¹ Pronat e vakëfit me aktin nr. 1669/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Pogragjë**, pos xhamisë me truall, me sip. 8955m.² me vlerë 30.000 din., ishin edhe varrezat e fshatit të “Zallina”, me sip. 23616m.²

Në fshatin **Sllubicë**, ishte xhamia e fshatit me sib.mektebin, me sip. 10000m.², vlera 20.000 din. dhe varrezat e fshatit me sip. 1500m.²

Në fshatin **Konçul**, ishte xhamia me sip. 360m.², me vlerë 20.000 din.; sib.mektebin të “Rruga”, me sip. 225m.² dhe varrezat me sip. 3840m.²

Në fshatin **Stublin**, ishin vetëm varrezat e fshatit me sip. 27950m.²

Në fshatin **Bilincë**, ishin varrezat e fshatit, në sip. 3200m.²

Në fshatin **Inatoc** (Komuna e Shurdhanit), varrezat e fshatit me sip. 5000m.²

Sipërfaqja e tërësishme e pronës së patundshme sipas regjistrit në fjalë ishte 84646m.² vlera 83700 din. të kohës

Xhemati i Pozharanit (Komuna e Pozharanit), kishte gjithsej 327 shtëpi myslimane⁴². Në regjistër mungon nr. i aktit të pronave. Pronat e vakëfit të këtij xhemati sipas regjistrit në fjalë shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Pozhoran**, në një truall ndodheshin së bashku Xhamia, mektebi dhe varrezat të “Xhamia”, për sipërfaqen e së cilës nuk jepen të dhëna të nevojshme, por sipas të dhënave memoriale duhet të ketë pasur më tepër se 15000m², kurse vlera e tyre llogaritej në 100.000 din. të kohës. Si imam xhamie atëbotë shërbente Shyqeri Sylejmani, i emëruar nga Yl.Mexh. i Shkupit me dekretin nr.3296/35, të datës 14.12.1935⁴³. Një livadh të “Billata”, me sip. 32175m.²; një truall me sip. 1872m.²; varrezat e quajtura “Varrezat e Vjetra”, me sip. 9480m.²

⁴¹ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

⁴² Po aty, fq.24.

⁴³ Po aty, v.1943, d. 14, fq.73.

Në fshatin **Ramjan**, ishte mektebi me truall, me sip. 196m.² dhe varrezat e quajtura “Varrezat e Vjetra”, me sip. 858m.²; ”Varrezat e Reja”, në sip. 5000m.² dhe “Varrezat e Muhaxherëve”, në sip. 3750m.²

Në fshatin **Çifllak**, ishin varrezat të “Varri i Hoxhës”, në sip. 21920m.²

Në fshatin **Tërpez**, ishin së bashku Xhamia me mekteb e truall dhe varreza, me sip. 6125m.² Si imam xhamie shërbente Ramadan Avdiu, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 1940.⁴⁴Varrezat e quajtura “Varrezat e Vjetra” në sip. 7000m.² dhe “Varrezat e Reja”, me sip. 1600m.²

Në fshatin **Meresalë**, për xhaminë e fshatit nuk flitet në regjistër, por vetëm për truall me sib. mektebi, me sip. 200m.² Nga të dhënat dokumentare të kohës shihet se imam i xhamisë së këtij fshatit ishte Habib Tahir Hyseini, me shpërblim nga populli, i riemëruar me vendim nga Kësh. i Yl. të Kom. Mysliman në Tiranë, më 7.08.1943⁴⁵. Varrezat shtriheshin në dy vende, me emrin “Varrezat e Vjetra”, me sip. 875m.² dhe “Varrezat e Reja”, me sip. 14500m.²

Prona e patundshme tokësore të vakëfit, sipas regjistrit në fjalë ishte 105551m.², vlera e tyre llogaritej në 145000din. të kohës.

Xhemati i Pidiqit (Komuna e Shurdhanit) kishte gjithsej 332 shtëpi myslimane⁴⁶. Pronat e vakëfit me nr. aktit 1559/38, shtriheshin në këto fshatra:

Për fshatin **Pidiç**, në regjistër flitet për xhami me sip. 1200m.², vlera 10.000 din.; xhami me sib. mekteb me sip. 2800m.², vlera 50.000 din. si dhe në një vend sib. mekteb të “Ledina”, me sip. 400m.² Imam në Xheminë e Pidiqit shërbente Fetah Rexhepi, i emëruar nga Yl Mexh. i Shkupit me dekret të datës 14.12.1935, ky më

⁴⁴ Po aty, fq.74.

⁴⁵ Po aty, v.1943, d.14. fq.256. Vendim nr.440, i Këshillit të Ylemave të Komunitetit Musliman shqiptar i datës 7.08.1943, mbi riemrimin e Habib Tahir Hyseinit për imam në fshatin Meresal.

⁴⁶ Po aty, v.1944, d.80, fq.24.

pas, më 1940, ishte transferuar në Xhematin e Meshinës.⁴⁷ Varrezat e fshatit shtriheshin në dy vende, varrezat me sip. 6160m.² dhe varrezat tjera me sip. 6160m.². Një arë e quajtur “Vakëf”, me sip. 975m.²

Në fshatin **Stubëll e Ulët**, flitet vetëm për varrezat e fshatit me sip. 9300m.²

Në fshatin **Shurdhan**, po ashtu varrezat e fshatit, me sip. 4875m.² dhe në fshatin **Çelik, ishin** varrezat e fshatit, me sip. 6000m.²

Në fshatin **Dunav**, Xhamia dhe mektebi me truall, me sip. 5200m.², me vlerë 7.000 din. Varrezat me sip. 6000m.² Arë te “Lumi i Zi”, me sip. 1372m.², e dhuruar nga banorët e fshatit në vitin 1937

Në fshatin **Stançiq**, ishin varrezat me sip. 40000m.²

Prona e patundshme e vakëfit të këtij xhemati sipas regjistrit ishte rreth 90442m.² me vlerë prej 95600din. të kohës.

Xhemati i Rogoçicës (Komuna e Rogoçicës), kishte gjithsej 408 shtëpi myslimane.⁴⁸ Pronat e vakëfit me aktin nr. 241/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Rogoçicë**, ishte, Xhamia e fshatit me oborr me sip. 1000m², e ndërtuar në truallin e lënë nga banorët e fshatit Rogoçicë, vlera e së cilës llogaritej në 10.000 din. të kohës. Si imam i fshatit atëbotë shërbente Shefki Kallaba, i emëruar nga Yl.Mexh. i Shkupit, me nr. të dekretit..3097/33, të datës 3.11. 1933⁴⁹. Varrezat e fshatit shtriheshin në dy vende, varrezat te “Zallina”, me sip. 3357m.² dhe varrezat te “Tekja”, me sip. 11220m.² Arat ishin në dy vende arë te “Rrjedha”, me sip. 5950m.², e dhuruar nga Sylejmani dhe arë te “Lumi”, me sip. 1210m.², e dhuruar nga vëllezërit Ajvazi.

Në fshatin **Hodonoc**, ishte Xhamia e fshatit me truall, me sip. 600m.², vlera 10.000 din. të kohës. Imam në xhami të fshatit shërbente Shefki Rexhepi i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 1940⁵⁰. Varrezat e fshatit të shpërndara në tri vende dhe ato: varrezat te “Smonicat”, në sip. 700mn.²; dhe varrezat te “Guri i Fortë” në dy vende, në

⁴⁷ Po aty, v.1943, d.14, fq.72.

⁴⁸ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

⁴⁹ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

⁵⁰ Po aty, fq.74.

njërin vend me sip. 3472m.² dhe në vendin tjetër me sip. 1872m.² Arat të vakëfit kishte në katër vend edhe ato: dy ara njëra afër tjetrës te vendi “Svogja”, njëra me sip. 3160m.² dhe tjetra me sip. 3669m.²; arë e quajtur “Vakëf ara”, me sip. 3547m.² dhe ara te “Varret”, me sip. 7248m.²

Në fshatin **Kranidell**, xhamia me oborr te vendi i quajtur “Qehajka”, me sip. 400m.², dhuruar nga Ajvaz Islami në vitin 1937.

Në kuadër të xhematit të Rogoçicës duhet të ishte edhe xhemati i fshatit **Dajkoc**, për të cilin nuk flitet në regjistër. Në xhaminë e këtij fshati imam atëbotë ishte Kamber Muslija, i emëruar nga Ylema Mexhli i Shkupit, më 1940⁵¹.

Prona të patundshme sipas regjistrit ky xhemat kishte gjithsej rreth 47405m.² me vlerë prej 35150 din. të kohës.

Xhemati i Sllatinës (Komuna e Sllatinës), gjithsej kishte 399 shtëpi myslimane⁵². Pronat vakëfnore kishin aktin nr. 1789/38, dhe shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Sllatinë**, ishte Xhamia me oborr në Sllatinë të Epërme te vendi i quajtur “Varreza”, me sip. 6080m², në pronën vakëfnore të lënë nga Haxhi Mustaf Emini para 60 vitesh. Si imam atëbotë shërbente Ukshin Hajrullahu i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit me vendimin nr.1558/35, të datës 22.07 1935⁵³, ky pastaj edhe nga ana e Kësh. të Yl. të Kom. Mysliman në Tiranë, më 15.05.1944, do të caktohet për imam ofiqar dhe mësues besimi, me pagesë nga populli⁵⁴. Pronë e vakëfit ishte edhe livadhi te “Jezeret”, me sip. 7848m.²

Në fshatin **Gërmovë**, në regjistër nuk bëhet fjalë për xhaminë e fshatit e cila gjithsesi ka ekzistuar, flitet për ara të vakëfit në dy vende, arë e quajtur në “Terballc” dhe arë te “Qeremidëhana”, me sip. 3108m.² Varrezat te vendi i quajtur “Te Rrugë”, me sip. 1484m.² dhe

⁵¹ Po aty, fq.74.

⁵² Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

⁵³ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

⁵⁴ Vendimi nr.170, më1.05.194, d.7, fq.99; Në fshatin Sllatinë, për mësues besimi ishte caktuar edhe Ibrahim Lutfiu me shpërblim nga populli, më 4.03.1944. f.882, v.1944, d.7, fq.49.

varrezat “Te fshati”, me sip. 3770m.² Livadhe në dy vende, njëri i quajtur “Zllatarja”, me sip. 14668m.², dhe tjetri, me sip. 2421m.²

Në fshatin **Komogllavë**, po ashtu nuk bëhet fjalë për xhaminë e fshatit, por nga të dhënat dokumentare të kohës mësojmë se si imam në xhaminë e fshatit shërbente Asllan Sherifi, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940⁵⁵. Arat e vakëfit të këtij fshati shtriheshin në nëndë vend dhe ato: arë e quajtur “Livadhia”, me sip. 3852m.²; arë e quajtur “Dovidub”?, me sip. 3990m.²; arë te vendi “Qeranka”, me sip. 1849m.²; arë te “Davidub”, me sip. 2541m.²; arë te “Xhamia”, me sip. 3750m.²; ara tjetër te “Xhamia”, me sip. 3674m.²; arë te “Qeranka”, me sip. 2015m.²; arë vendi te “Uka”, me sip. 1849m.². dhe arë te “Pre-kaqa” (Mulliri), me sip. 2184m.²

Edhe në fshatin **Tërstenik**, nuk bëhet fjalë për xhaminë e fshatit, por nga të dhënat dokumentare shihet se si imam në xhaminë e fshatit shërbente Riza Lutfiu, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, me 1940 dhe prapë i riemëruar nga Kësh. i Yl. të Kom. Mysliman në Tiranë më 7.08.1943⁵⁶. Pronat e vakëfit të këtij fshati shtriheshin në tre vende dhe ato: një livadh me sip. 375m.²; një arë me sip. 6242m.² dhe varrezat, te “Xhamia”, me sip. 6815m.²

Në fshatin **Sadovin e Çerkezëve**, po ashtu nuk flitet për xhaminë e fshatit, në të cilën si imam shërbente Arif Sherifi, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940. Pronë vakefnore ishin varrezat e fshatit “Te Xhamia”, me sip. 3298m.².

Sipërfaqe e tërësishme e Xhematit të Sllatinës ishte reth 84157m.², i mungon vlera.

Xhemati i Smirës (Komuna e Vitisë), gjithsej kishte 312 shtëpi muslimane⁵⁷. Pronat e vakëfit me nr. e aktit 1484/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Smirë**, për xhaminë e fshatit nuk flitet në këtë regjistër, për vetëm për truall xhamie, me sib. mektebin të dhuruar nga Vesel

⁵⁵ Po aty, fq.74.

⁵⁶ Po aty, fq.230. Vendim i Këshillit të Ylemave të Komunitetit Musliman në Tiranë mbi riemërimin e Riza Lutfiut për imam në fshatin Tërstenik, më10.08.1943.

⁵⁷ Po aty, 1944, d.80, fq.24.

Kadriu para 60 vitesh me sip. 260m.² vlera 30.000 din. Nga të dhënat dokumentare të kohës shihet se si imam i xhamisë së fshatit ishte emëruar Sylejman Jakupi, me dekretin e Yl. Mexh. të Shkupit, nr. 3303/35, të datës 14.12.1935, por i njejtë më 1938 ishte transferuar në Xhaminë “Atik”, në Gjilan⁵⁸. Varrezat e këtij fshati shtriheshin në shtatë vende dhe ato: varrezat te pronat e quajtura te “Azizovit, I”, me sip. 7139m.² dhe te “Azizovit, II”, me sip. 2536m.²; varrezat e quajtura “Beshkovit I”, me sip. 10800m.² dhe “Beshkovit II”, me sip. 5081m.², këto të fundit ndodheshin në tokën e dhuruara nga Miftar Ramadani më 1919; varrezat te “Deltovit”, me sip. 9600m.²; varrezat te “Hazirovit” me sip. 220m.² dhe varrezat te “Bibrak Mahalla”, me sip. 196m.²

Në fshatin **Mjak**, varrezat shtriheshin në tri vende dhe ato: varreza te “Baftiovit”, me sip. 1550m.²; varrezat e quajtura “Varrezat e luftëtarëve”, me sip. 532m.² dhe varreza te “Kroi i Gurit”, me sip. 6319m.²

Në fshatin **Drenogllav**, në tri parë varrezat e fshatit, te vendi i quajtur “Bob Mahalla”, dhe ato: varrezat me sip. 2736m.²; varreza me sip. 2010m.² dhe varreza me sip. 3195m.²

Në fshatin **Vërban**, bëhet fjalë për truall të Xhamisë me sip. 1664m.², vlera 10.000 din. dhe varrezat e fshatit në dy vende, varrezat “E vjetra”, me sip. 2754m.² dhe varrezat “E reja”, me sip. 11407m.²

Në fshatin **Gushicë**, varrezat shtriheshin në pesë vende dhe ato: varrezat e “Vjetra”, me sip. 3847m.²; varreza te prona e quajtur “Muslimi Abdylit”, me sip. 4414m.²; varreza në “Zabelishte”, me sip. 2061m.²; varreza e “Vjetra”, me sip. 2667m.², dhe varrezat te “Molla e bardhë”, me sip. 494m.²

Në fshatin **Binç**, ishin varrezat te prona e quajtur “Shushkovo”, me sip. 1203m.²

Në fshatin **Drobesh**, një arë te “Qeremidëhanja” e dhuruar nga Ilijaz Pajaziti me sip. 2242m.²; varrezat me emrin “Varrezat e Vjetra”, te Lagjja e Epërme, me sip. 350m.² dhe “Varrezat e Reja”, me sip. 2885m.² në tokën e dhuruar nga Sefedin Jashari më 1920.

⁵⁸ Po aty, v.1943, d.14. fq.72 dhë 73.

Në fshatin **Korbliç**, një truall i quajtur trualli i xhematit, me sip. 258m.², i dhuruar nga Asim Mehmeti më 1934, vlera 10.000 din. Varrezat e shpërndara në gjashtë vende dhe ato: varrezat e quajtura “Dinarike”, me sip. 1215m.²; varrezat në “Dardhishte”, me sip. 3465m.²; varrezat te “Lejthiat”, me sip. 2835m.²; varrezat te “Lumi”, me sip. 4500m.²; dhe varrezat në dy vende të Xhematit Bllacë te “Lumi”, me sip. 6723m.² dhe te vendi “Leskovic”, (te Lejthia) me sip. 7600m.²

Prona të patundshme të xhematit të Smirës sipas regjistrimit në fjalë ishin rreth 107761m.² me vlerë prej 72900din. të kohës.

Xhemati i Svirçës (Komuna e Ajnovcit), kishte gjithsej 341 shtëpi myslimane⁵⁹. Pronat me akti nr. 66/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Zhujë** ishte xhamia e fshatit me sip. 80m.², dhe sib. Mektebi, me sip. 60m.². Imam në xhaminë e fshatit shërbente Islam Hyseini, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940⁶⁰. Varrezat e fshatit të shpërndara në katër vende dhe ato: varrezat e quajtura “Lisocka”?, me sip. 782m.²; varrezat me sip. 2050m.²; varrezat me sip. 2350m.², dhe varrezat te vendi “Gjyrisheci”, me sip. 4125m.² Ndërkaq livadhet shtriheshin në pesë vende dhe ato: livadhe në tre vende te prona e quajtur “Livadhi”, njëri me sip. 1150m.², i dyti me sip. 520m.² dhe i treti me sip. 1247m.²; livadh te “Prroi i Xhematit”, me sip. 3660m.², dhe livadh me sip. 13000m.².

Në fshatin **Svirçë**, Xhamia e fshatit me sip. 96m.², sib. mektebi, me sip. 45m.². Imam i këti fshati gjatë Luftës së Dytë Botërore ka shërbyer Hamza Jakupi, i emëruar nga Kësh. i Ylem. të Kom. Mysl. në Tiranë⁶¹. Varrezat e fshatit shtriheshin në katër vende dhe ato: varrezat te “Glina” në dy vende, në njërin vend me sip. 2035m.² dhe në tjetrin me sip. 1554m.²; varrezat te “Dedovit” me sip. 1554m.² dhe varrezat te “Qelovit”, me sip. 1764m.².

Në fshatin **Gmicë**, ishte vetëm sib.mektebi me sip. 54m.²

Në fshatin **Zajçec** ishte xhamia e fshatit me sip. 80m.² ku si Imam shërbente Ethem Hoxha, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më

⁵⁹ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

⁶⁰ Po aty, v.1943, d.14, fq.74.

⁶¹ Po aty, fq.73.

1940⁶². Varrezat e fshatit në dy vende, varrezat te “Latifovit” me sip. 1800m.² dhe varrezat te “Spahiovit” me sip. 3240m.²

Sipas regjistrimit prona e tërësishme e patundshme ishte rreth 41246m.² vlera i mungon.

Xhemati i Sllakocit (Komuna e Pozharanit), shtëpi myslimane ishin gjithsej 283⁶³. Pronat me nr. të aktit 1611/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në **Sllakoci** i **Epërm**, ishte xhamia me sip. 346m.² me vlerë 5.000 din. Si imam në këtë xhami gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte emëruar Rizah Isufi, nga ana e Kësh. të Ylem. të Kom. Mysliman në Tiranë⁶⁴. Livadhe si pronë vakëfi në dy vende, livadh me sib. mektebin te “Bregu” dhe livadh me sip. 2772m.². Varrezat në tre vende dhe ato: varrezat mbi “Fshat”, me sip. 1248m.²; varreza te “Bregu”, me sip. 3403m.² dhe varrezat te “Lashi”, me sip. 5000m.²

Në fshatin **Sllakoc i Poshtëm**, bëhet fjalë vetëm për varrezat e fshatit te “Fusha” me sip. 2500m.²

Në fshatin **Kishnapol**, ishte sib. mektebi te “Uura e Sllakocit”, me sip. 168m.², dhuruar nga Musli Ajeti, banor i këtij fshati. Varrezat e fshatit në dy vende, varrezat “Nën Fshat” me sip. 1404m.² dhe varrezat te “Prroi” me sip. 69000m.²

Në fshatin **Zllatar**, ishte sib.mektebi te “Cernica”, me sip. 645m.², dhuruar nga fshatarët e Zllatarit më 1937 dhe varrezat te “Bregu” me sip. 1938m.²

Në fshatin **Gadish**, ishin varrezat te “Podina”, sip. 3216m.²

Në fshatin **Ballanc**, ishin varrezat e fshatit në dy vende, varrezat te “Lisat e but” me sip. 4495m.² dhe varrezat “Nën fshat” me sip. 1332m.²

Në fshatin **Radivojc**, flitet vetëm për varrezat te “Visoqa”, me sip. 980m.²

Sipas regjistrimit në fjalë prona të patundshme gjithsej ishin rreth 98447m.² me vlerë prej 12050 din. të kohës.

⁶² Po aty, fq.74.

⁶³ Po aty, v.1944, d.80, fq.24.

⁶⁴ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

Xhemati i Marecit (Komuna e Bostonit), shtëpi myslimane ishin gjithsej 408⁶⁵. Pronat me nr. të aktit 1903/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Marec**, ishte, xhamia me oborr te “Lumi”, me sip. 186m.², e dhuruar nga Kamber Hasani para 50 vjetësh. Imam në xhaminë e fshatit shërbente Sejfedin Ademi, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit me nr. të dekretit 3099/33, të datës 3.11.1933⁶⁶. Arë te”Proji i Malit”, me sip. 6m.², dhuruar po ashtu nga Kamber Hasani më 1900. Livadh te “Dhelpra e butë”, me sip. 56m.², dhuruar nga Sali Latifi më 1900.

Në **Marecin e Ulët**, ishte xhamia me mekteb “Te Hyskovit”, me sip. 25m.², në vlerë 5.000 din.

Në fshatin **Novo Bërd**, xhamia me oborr te “Kërshevina”, me sip. 27m.², me vlerë 2.500 din. Si imam në këtë xhami shërbente Idriz Ademi, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit më 1940⁶⁷. Varrezat e “Varoshit”, me sip. 28m.²

Në fshatin **Jasenovik**, ishte vetëm një livadh te ”Lumi”, me sip. 10000m.²

Edhe në fshatin **Prijakoc**, ishte një livadh te “Lumi”, me sip. 2964m.²

Sipërfaqe e tërësishme pronësore të patundshme sipas regjistrit ishin 13292m², me vlerë prej 17050 din. të kohës.

Xhemati i Malishevës (Komuna e Pasjanit), shtëpi myslimane kishte gjithsej 278 shtëpi⁶⁸. Pronat vakëfnore me nr. të aktit 520/39, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Malishevë**, në një sipërfaqe ishte xhamia me oborr, varrezat dhe sib. mektebi, me sip. 7890m.², lënë vakëf nga fshatarët e Malishevës, vlera 70.000 din. Imam në xhaminë e fshatit shërbente Mehmed Behluli i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, me dekretin nr.

⁶⁵ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

⁶⁶ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

⁶⁷ Po aty, fq.74.

⁶⁸ Po aty, v.1944, d.80, fq.25.

3138/33, të datës 27.11.1933⁶⁹. Varrezat te ”Lagjja Epërme”, me sip. 9540m.²

Në fshatin **Bukovikë**, xhamia me mekteb dhe truall, me sip. 196m.², lënë nga fshatarët e Bukovik në vitin 1934, vlera 30.000 din. Si imam i xhamisë shërbente Ramadan Ejupi i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 1940⁷⁰. Varreza në dy vende, varrezat e fshatit, me sip. 3960m.² dhe varrezat e “Muhaxhirëve”, me sip. 1600m²

Në fshatin **Velekincë**, nuk bëhet fjalë për xhaminë e fshatit, ku për imam, me dekretin të Kësh. të Ylem. në Tiranë, të datës 23.01.1943, ishte emëruar Ilias Salihu (Selmani) nga Gjilani.⁷¹ Vakëf i fshatit ishte sib. mektebi me oborr me sip. 109m.², i lënë vakëf nga fshatarët e fshatit më 1938 dhe varrezat te ”Kodra” në sip. 4620m.²

Në fshatin **Uglarë**, ishte xhamia e fshatit me sib. mektebin me sip. 104m.², e lënë nga fshatarët e fshatit më 1928, vlera 40.000 din. Si imam xhamie shërbente Kurtesh Zejnullahu i emëruar nga Yl. Mexh. I Shkupit, me dekretin nr.8399, të datës 10.01.1940.⁷² Varreza e fshatit në dy vende, varrezat te “Lugu i Varreve”, me sip. 4396m.² dhe varrezat e “Muhaxherëve”, sip. 814m.² Një pronë vakëfnore me sipërfaqe të madhe e quajtur “Mbi Varreza”, me sip. 3.276.40.

Në fshatin **Capar** (Komuna e Ranillukit), nuk flitet për xhaminë e fshatit, por vetëm për sib. mektebin me truall, në sip. 170m.², dhuruar nga fshatarët e Caparit në vitin 1930. Si imam i xhamisë ishte Bejtullah Sylejmani, i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit, më 10.01.1940⁷³. Një pronë vakëf te “Zabeli i Varreve” në sip. 8262m.², vlera 20.000 din. Varrezat me sip. 8556m.²

Sipërfaqja e tërësishme e pronës së patundshme ishte 83171m.², me vlerë prej 211000din. të kohës.

⁶⁹ Po aty, v.1943, d.14, fq.73.

⁷⁰ Po aty, fq.74.

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty.

⁷³ Po aty.

Xhemati i Caravajkës, (Komuna e Shurdhanit), shtëpi myslimane kishte gjithsej 399 shtëpi.⁷⁴ Pronat e vakëfit me aktin nr. 1665/38, shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin **Caravajkë**, ishte xhamia me oborr me sip. 4999m.² dhe sib. mektebi me oborr, me sip. 1959m.² Varrezat e fshatit në dy vende, varrezat te “Bregu, me sip. 3375m.² dhe varrezat po ashtu te “Bregu”, me sip. 765m.².

Në fshatin **Llocë**, xhamia te “Kroi”, vlera e së cilës llogaritej në 1.000 din. dhe varrezat me sip. 1900m.²

Në fshatin **Burincë**, varrezat e fshatit me sip. 3150m.²

Në fshatin **Lipovicë**, varrezat e fshatit në dy vende, varrezat me sip. 3360m.² dhe varrezat me sip. 2250m.²

Në fshatin **Depcë**, varrezat shtriheshin në katër vende dhe ato: varreza te “Lagjja Rexhmen”, sip. 900m.²; varreza te Lagjja e “Xhinajve”, me sip. 3160m.²; varreza te Lagjja e “Zekbashve”, me sip. 680m.² dhe varrezat te Lagjja “Ukmehmet”, me sip. 540m.²

Në fshatin **Sefer**, varrezat në tri vende dhe ato: varreza në Lagjen “Zekloj”, sip. 5800m.²; varreza te “Osmon Mahalla”, me sip. 1408m.² dhe varrezat në “Shyt Mëhallë”, me sip. 1600m.²

Në fshatin **Stanec**, varrezat të shpërndara në katër vende dhe ato: varreza te Lagjja e “Gruhalive”, me sip. 2160m.²; varreza te Lagjja e “Kurbalive”, me sip. 1800m.²; varreza në “Tahir Brah.”, sip. 4389m.² dhe varreza në Lagjen “Lelbali”, me sip. 4125m.²

Në fshatin **Buhiq**, varrezat e fshatit, me sip. 4000m.²

Në fshatin **Maxherë**, varrezat e “Epra”, me sip. 2250m.²

Në fshatin **Ranatoc**, varrezat e fshatit në dy vende, varreza me sip. 6300m.² dhe varreza me sip. 3900m.²

Sipërfaqe e tërësishme e pronës së patundshme sipas këtij regjistri ishte rreth 76871m.² vlera e tyre e pjesshme ishte 5220 din. të kohës.

Xhemati i Cernicës (Komuna e Parteshit), shtëpi myslimane kishte gjithsej 334⁷⁵. Mungon nr. i aktit të pronave. Pronat e vakëfit shtriheshin në këto fshatra:

Në fshatin Cernicë, ishte xhamia me sib. mektebin, me sip. 1335m.², vlera 20.000din., kurse si imam shërbente Vehbi Iliasi i emëruar nga Yl. Mexh. i Shkupit me dekretin nr.3091/33, të datës 3.11.1933⁷⁶. Varrezat e fshatit në dy vende, "Varrezat e Epërme" në sip. 8190m.² dhe "Varrezat e Poshtme", me sip. 4190m.²

Në fshatin **Remnik**, ishte xhamia me sip. 38m.², vlera 10.000 din. dhe varrezat në dy vende, varrezat me sip. 13090m.², dhe varrezat me sip. 1430m.²

Në fshatin **Budrikë e Epërme**, sib. mektebi me sip. 24m.², vlera 4.000 din.; varreza në tre vende dhe ato: varrezat e “Epra”, me sip. 3990m.²; varrezat tjera të “Epra”, me sip. 4235m.² dhe varrezat te “Visoqa e Madhe”, me sip. 2430m.² Arat e vakëfit shtriheshin në gjashtë vende dhe ato: arë te vendi i quajtur “Razor”, me sip. 13689m.², e lënë për vakëf nga Jakup Sejda nga Budrika para 55 vjetësh; arë e quajtur “Ara e Madhe”, me sip. 7254m.²; arë te vendi “Razor”, me sip. 3848m.²; arë në “Billata”, me sip. 8325m.²; ara e quajtur “Ara e Madhe”, me sip. 1575m.²; si dhe ara tjetër po ashtu me emrin “Ara e Madhe”, e dhuruar nga Tahir Sadiku, me sip. 14000m.²

Në fshatin **Radivojc**, mejtepi i ngritur nga xhemati i Radivojcit më 1942.

Në fshatin **Gumnishtë**, Varrezat e fshatit, me sip. 3915m.²

Në fshatin **Kravaricë**, varrezat e fshatit, me sip. 6164m.²

Në fshatin **Devajë**, varrezat e fshatit, me sip. 1674m.²

Në fshatin **Zhiti** (Kom. Pozhoranit), sib. mektebi i ndërtuar në pronën e lënë nga fshatarët më 1937, me sip. 3540m.² dhe varrezat e fshatit, me sip. 3540m.²

Në fshatin **Vrapçiq**, varrezat e fshatit me sip. 9646m.²

Në fshatin **Mogillë** (Kom.e Vërbovcit), varrezat e fshatit, me sip. 6468m.² Sipërfaqe e tërësishme e pronave së patundshme tokësore e këtij xhemati sipas regjistrit në fjalë ishte rreth 122590m.² me vlerë prej 92350 din. të kohës.

⁷⁴ Po aty, v.1944, d.80, fq.24.

⁷⁵ Po aty, fq.24.

⁷⁶ Po aty, v. 1943, d.14, fq.73.

Siç u tha edhe më parë përkundër të dhënave jo të plota të këtij regjistri, shihet se Vakëfi Mearife i Rrethit të Gjilanit, në prag të Luftës së Dytë Botërore, sipas një llogarie jo edhe të saktë, kishte në pronësi rreth 1575699m.² të sipërfaqes së tokës, me vlerë mbi 1.546370 din. të kohës, (mungojnë çmimet për një numër të pronave) të cilat figuronin zyrtarisht si prona të vakëfit dhe shtriheshin në tërë rrethin, ato ishin, lokal dhe oborre të xhamive, varreza, tokë buke, livadhe, shtëpi banimi, dyqane etj., pjesa dërrmuese e tyre të trashëguara që prej kohësh.

Pos disa të dhënave të tjera, në këtë regjistër, mungojnë të dhëna edhe për numrin e të gjitha xhamive dhe teqeve të rrethit, jepen shënime për 54 xhami, por nga të dhënat tjera dokumentare të kohës, të dala nga Ylema Mexhlisi i Shkupit, për vitin 1938/39, shihet se Rrethi i Gjilanit kishte gjithsej 64 xhami dhe 7 teqe. Pas Rrethit të Prizrenit ky rreth kishte numrin më të madh të xhamive në Kosovë. Xhamitë ishin të ndërtuara në kohë të ndryshme, dhe ato deri më 1912 ishin ndërtuara 45 xhami, nga viti 1912-1930, ishin ndërtuar 7 xhami dhe prej vitit 1930-1940 12 xhami, nga të cilat 54 xhami ishin në gjendje të mirë dhe të ndërtuara prej materialit të fortë, 28 xhami ishin pa minare etj. Ndërkaq, sa u përket teqeve 6 ishin të ndërtuara para vitit 1912 dhe një pas këtij viti, të cilat i përkisnin tarikateve: sadi 3 teqe; bektashi 2; kaderi 1 dhe rufai 1⁷⁷.

⁷⁷ AQSH, f.882, v.1944, d.80, fq. 16,18 dhe18/1.Raport statistikor i inspektorisë dërguar Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, më 27.06.1944, bazuar në të dhënat e raportit të Ylema Mexhlisit të Shkupit, për vitin 1938/39.

Aliriza Selmani

AN IMPORTANT DOCUMENT ON THE WAQF PROPERTY IN THE GJILANI REGION ON THE VERGE OF WORLD WAR II

(Summary)

The very beginnings of the spread of Islam were followed with the establishment of the institution of waqf, which had an extraordinary role in Islamic countries and societies. In order to explain the role of the waqf in Islamic countries we are going to quote our late Orientalist, Hasan Kaleshi, who stated: "in no other society or religion existed an institution which had such an important role as the role of the charitable institution of waqf in Islamic countries. There were almost no aspects of religious, moral, economic, political, social life, etc., in which the institution of waqf did not have a great influence.

على رضا سلمان

وثيقة مهمة عن وقف اسلامي ببلدية جيلان

قبل الحرب العالمية الثانية

(خلاصة البحث)

مع بداية انتشار الاسلام بين الشعوب و الاماكن المختلفة تم تأسيس أوقاف كمؤسسة مستقلة لعبت دورا مهما في الحياة العامة للشعوب الاسلامية وكذلك في نهضة الدولة الاسلامية و من الجدير بالذكر هنا أن نذكر مستشرقنا الراحل د. حسن كاليشى و الذي يقول: "لا يمكن ان نجد مجتمعا أو دينا كان له وجود مؤسسة لعبت دورا اجتماعيا مثل وجود مؤسسة الوقف في الدولة الاسلامية اذ لا يمكن تصور وجود اي نشاط ديني أو اجتماعي و اقتصادي أو اخلاقي أو سياسي لم يكن للوقف الاسلامي تأثير فيه".

KUMTESË

Nehat Krasniqi

ROLI I FISNIKËRISË SHQIPTARE NË ZHVILLIMIN E KULTURËS DHE CIVILIZIMIT ISLAM NË TROJET SHQIPTARE GJATË PERIUDHËS OSMANE*

Tri arsye themelore më kanë motivuar që të merrem me këtë temë: E para është se fisnikëria shqiptare ka luajtur rol parësor dhe të pazëvendësueshëm në zhvillimet kulturore islame në trojet shqiptare, pothuaj gjatë tërë periudhës osmane, më saktë deri në fund të dekadës së tretë të shek. XIX, por rolit të saj nuk i është dhënë vendi i merituar në shkencë. Arsyeja e dytë është qëndrimi shpërfillës dhe marginalizues i institucioneve shkencore shqiptare, që ende po vazhdon të mbahet ndaj trashëgimisë kulturore shqiptare me frymë islame, përgjithësisht. Qëndrim ky i cili i ka kontribuar më së shumti varfërimit të asaj pjese të trashëgimisë kulturore, që është me rëndësi të veçantë për komponentë më të madhe të kombit shqiptar. Lënia e kulturës shqiptare me frymë islame, në margjina, madje dhe jashtë interesimeve shkencore sistematike, trashëgimtarët e kësaj kulture i ka privuar nga e drejta e tyre e ligjshme për ta njohur atë, për ta përjetuar dhe për

t'u mburrë me të. Njëherësh e ka dëmtuar edhe vetë kulturën kombëtare shqiptare, sepse pa njohjen e pjesëve të saj, nuk mund të njihet tërësia dhe anasjelltas. Arsyeja e tretë është se në qarqe shkencore jashtëshqiptare vazhdojnë të shprehen tendenca që trashëgiminë kulturore shqiptare me frymë orientale islame ta trajtojnë si trashëgimi kulturore turke-osmane. Këto tendenca madje sikur po dalin përtej qarqeve të caktuara shkencore ballkanase, tradicionalisht të dëshmuara për prirje mohuese dhe shtrembëruese ndaj trashëgimisë kulturore shqiptare dhe po orvaten që për këtë synim të gjejnë mbështetje edhe nga mendimi shkencor ndërkombëtar. Ç'është e vërteta ka edhe ndonjë autor shqiptar që me dashje ose pa dashje i ka shërbyer kësaj teze të gabuar. Në themel të të tri këtyre arsyeve dhe fakteve që u thanë më lart, qëndron mosnjohja, respektivisht njohja e pamjaftueshme shkencore e zhvillimeve kulturore shqiptare me frymë orientale islame gjatë periudhës osmane.

Rezultatet e studimeve të deritashme albanologjike dhe të orientalistikës shqiptare, si krahu i saj, nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme për t'u thelluar sa duhet në një temë si kjo. Rrethanë vështirësuese paraqet fakti se është ruajtur vetëm një pjesë e vogël nga burimet relevante, në të cilat doemos të mbështeteshin kërkimet për këtë temë dhe për tema të kësaj natyre, siç janë vakufnamet, ixhazetnamet, hilafetnamet dhe sixhilatet e gjykatave të sheriatit dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre janë publikuar. Në anën tjetër, vështrimin panoramik të kësaj teme, ashtu siç është menduar, në një rrafsh kohor afro pesëshekullor dhe në rrafshin gjeografik gjithëshqiptar, e vështirëson fakti se burimet e këtyra të botuara, nuk mbulojnë njësoj tërësinë gjeo-etnike shqiptare.

Edhe pse roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimet kulturore të vendit, nuk është trajtuar më parë si temë e veçantë, megjithatë janë publikuar punime të cilat sjellin informacione deri diku të mjaftueshme për këtë temë. Do të veçonim këtu kontributet shkencore të studiue-

* Kumtesë e lexuar në Simpoziumin e Dytë Ndërkombëtar: "Islamic Civilisation in the Balkans", Tiranë, 4-7 dhjetor 2003.

sve: H. Kaleshi¹, E. Vlora², K. Frashëri³, S. Rizaj⁴, V. Buharaja⁵, J. Rexhepagiq⁶, F. Duka⁷, H. Bushati⁸, N. Krasniqi⁹, M. Asimov¹⁰, R. Vërmica¹¹, M. Kiel¹² etj. Nga literatura e zgjedhur turke që kemi përdorur për këtë punim, po veçojmë enciklopeditë si: Kamus-ul’ a’ lam e Samiut, Sicill-i osmani e Mehmed Süreyyas, Islam ansiklopedisi, Türk ansiklopedisi; biografitë dhe biobibliografitë e poetëve (tezkiretu’ş-şuara) të autorëve Sehi, Latifi, Salim, Riza, Bejani, Kënali-zade Hasan Çelebi, Mehmed Tahir Bursallë, Ali Emiri e të tjerë, Seyahatnamen e Evliya Çelebisë, veprën e E. H. Ayverdit: “Vepra të arkitekturës osm-

¹ Hasan Kaleši: Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku = Dokumentat më të vjetra të vakufëve në Jugosllavi në gjuhën arabe, Prishtinë 1972; Hasan Kaleši, Ismail Eren: Prizrenac Mahmud-Paša Rotul, njegove zadužbine i vakufnama: Antikitete të Kosovës VI-VII, Prishtinë 1973; Kemal Ozergin, Hasan Kaleshi, Ismail Eren: Prizren Kitabeleri. Në: Vakıflar Dergisi VII, Ankara 1968. (Hasan Kaleshi): Përmendoret e arkitekturës islame dhe dorëshkrimet orientale. Në: Kosova dikur e sot, Beograd 1973, f.467-478.

² Eqrem bej Vlora: Kujtime, Tiranë:Shtëpia e librit dhe e komunikimit, 2001; Ekrem Vlora: Kalaja e Kaninës: [separat i revistës Shejzat], Romë,1961.

³ Kristo frashëri: Historia e Tiranës, Vëll.I, Tiranë: Toena 2004.

⁴ Skender Rizaj: Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Prishtinë:Rilindja 1982.

⁵ Vexhi Buharaja: Mbishkrime turko-arabe në Shqipëri (Dorëshkrim, ruhet në Arkivin e Institutit të Historisë) Tiranë, 1980.

⁶ Jashar Rexhepagiq: Školstvo i prosveta na Kosovu: Od kraja XVIII stoleca do 1918. godine. Prishtina, 1974; Jashar Rexhepagiq: Dervishët dhe teqetë. Bot. i dytë, Pejë: Duka-gjini, 2003.

⁷ Ferit Duka: Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII). Tiranë 2001.

⁸ Hamdi Bushati: Shkodra dhe motet. Vëllmi I Shkodër 1998; Vëllmi II Shkodër 1999; Hamdi Bushati: Bushatllinjët. / Pajisur me shënime dhe një Supplement nga Nexhmi Bushati. Shkodër 2003

⁹ Nehat Krasniqi: Dy dokumente gjenealogjike të rendësishme. Në: Dituria Islame, nr. 59, Prishtinë 1994; Nehat Krasniqi: Kronika (Menakib) e Tahir efendiut, burim i rendësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane. Në: Edukata Islame, nr.57, Prishtinë 1995; Nehat Krasniqi:Mehmet Kuklibegu – legatori më meritë për zhvillimin ekonomik dhe kulturo-arsimor të Opojës gjatë shek XVI. Në: Penda, nr.1. Prizren 1995; Nehat Krasniqi: Kontributi i Pashallarëve Bushatllinj të Shkodrës në fushën e kulturës. Në: Seminar i katërt ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Vëllmi I. Shkodër 2002.

¹⁰ Muxhait Asimov: Osmanska epigrafika na Kosovu i Metohiji. (Disertacion i doktoratës në dorëshkrim). Prishtinë 1995.

¹¹ Raif Vërmica: Kosova’da osmanli mimari eserleri. Ankara 1999.

¹² Machiel Kiel: Ottoman architecture in Albania 1385-1912. Istanbul 1990.

ane në Evropë”, si dhe sallnamet e katër vilajeteve shqiptare, të cilat ofrojnë informacione me vlerë. Burime informacionesh të rëndësishme për këtë temë, kemi pasur edhe Koleksionin e dorëshkrimeve orientale të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si dhe koleksionet e dorëshkrimeve orientale të bibliotekave speciale dhe familjare në Kosovë dhe jashtë saj.

* * *

Depërtimi osman në tokat shqiptare që filloi nga dekada e tetë e shekullit të XIV dhe instalimi i pushtetit osman në këto toka gjatë dekadave të mëpastajme, krijuan premisa për një varg procesesh, që lidhen ngushtë me zhvillimin etnik dhe historik të shqiptarëve. Konfirmimi i raportit të vazalitetit të një vargu fisnikësh shqiptarë ndaj sulltanëve osmanë dhe fillimi i pranimit të fesë Islame prej tyre dhe prej vartësve të tyre, iu hapi atyre rrugën e integritit shumë të shpejtë në jetën shoqërore të Perandorisë Osmane. Sistemi i ashtuquajtur “gulam-i mir” u mundësonte djemve të fisnikërisë shqiptare, të veçuar si shtresë shoqërore dhe të formuar qysh në periudhën paraosmane, që të edukoheshin në institucionin më prestigjioz edukativ arsimor osman, në “Enderun-i Humajun”, ku përgatiteshin kuadro për funksionet më të larta administrative shtetërore. Një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kanë mbaruar shkollimin në Enderun-i humajun, apo nëpër institucione tjera arsimore osmane dhe kanë arritur pozita të ndryshme ushtarake e administrative, përfshirë këtu edhe pozitën e sadr-i a’zamt, respektivisht pozitën e kryeministrit të shtetit osman. Ata dhe sidomos pasardhësit e tyre, pastaj, u bënë shtresa drejtuese e vendit dhe bartësit e shartuesit kryesorë të kulturës islame në trojet shqiptare. Sipas të dhënave që kemi në dispozicion deri sot, nga gjiri i popullit shqiptar kanë dalë 39 kryeministra, 14 admiralë, 9 ministra të financave, 3 sheyh’ul-islamë, shumë vezirë, Pashallarë, bejlerë, sanxhakbejlerë, valinj, myteselimë, mir-i miranë, si dhe rreth 400 poetë e shkrimtarë, shumë myderrizë, myftilerë, kadilerë, naibë e të tjerë.

Disa dyer të mëdha shqiptare si Skurajt, Mahmutbegollët, Vlorajt, Asllan-Pashalinjtë, Sinan-pashët, Bushatlinjtë, Kurt-pashët, Bargjinollët, Hoxhollët, Rrotllat, Rexhep-pashët, Gjinollët, Toptanët, Biçaqçinjët, Tepelenasit etj., fituan të drejtën e trashëgimit familjar të posteve, ofiqeve dhe gradave të larta shtetërore, duke ushtruar pushtet, pothuaj, autonom në njësi të ndryshme administrative brenda hapësirës etnike shqiptare. Këto dyer të mëdha kanë pasur të gjitha tiparet dhe rolin e një fisnikërie të mirëfilltë shqiptare. Pikërisht në këto dyer janë përpunuar idetë jetike për fatin historik të popullit shqiptar.

Roli dhe kontributi i fisnikërisë shqiptare, në drejtim të zhvillimit të kulturës dhe të civilizimit islam ndër shqiptarët, ka qenë i gjithanshëm, i shumëllojshëm dhe vendimtar për këto zhvillime. Ai është shfaqur kryesisht në këto pika:

Kanë themeluar një varg kasabash të reja, me ç'rast kanë futur në vend frymën e urbanizmit oriental islam.

Kanë themeluar dhe kanë vakufuar një varg institucionesh fetare, kulturore e arsimore, të cilat ishin vatra ku njihej, përpunohej, krijohej dhe kultivohej kultura islame, apo më drejtë, kultura shqiptare me frymë islame dhe prej nga distribuohet ajo.

Kanë qenë aktivë në jetën kulturore duke u marrë me krijimtari letrare, shkencore e fetare.

Kanë përkrahur dhe kanë inkurajuar dijetarët, letrarët dhe artistët.

Ndër kasabatë më të rëndësishme shqiptare që ka themeluar fisnikëria vendëse janë: Korça, Zinova, Kavaja, Gjakova, Kaçaniku, Tirana, Peqini etj.

Korça statusin e kasabasë e ka fituar pas ndërtimeve dhe vakufimit të objekteve prej Iljaz Bej Mirahorit në vitin 1495. Iljaz beu i njohur edhe si Koxha Mirahor, është lindur në Panarit¹³. Si fëmijë i krishterë me emrin Ilo, u mor devshirme, kur Sulltan Murati II hyri në Shqipëri më 1410. U shkollua dhe u aftësua në Enderun-i Humajun në Edrene që ishte kryeqendër e Perandorisë Osmane. Pas shkollimit ai pati një karrierë të bujshme. Një kohë ka shërbyer si oficer i trupës së

¹³ N. D. N.: Korça dhe kadundet e qarkut. Korçë 1923, f. 35.

jeniçerëve. Fitoi famë si luftëtar trim dhe i zhdërvjelltë, sidomos në luftën për marrjen e Konstantinopolit nga ana e Sulltan Mehmetit II, më 1453. Për aftësitë që tregoi Iljazi, Sulltani e gradoi bej. Iljaz beu ka qenë vali në disa vilajete osmane. Në vitet 1460-65 ai ka qenë vali i Janinës¹⁴. Në kohën e Sulltan Mehmet Fatihut arriti postin e Mirahorit. Vitet e pleqërisë Koxha Mirahori i ka kaluar në Korçë, ku dhe ka vdekur në vitin 1500-501. Është varrosur në tyrben pranë xhamisë që vetë e ka ndërtuar. Iljaz bej Mirahori në Korçë përveç xhamisë ka ndërtuar edhe një medrese, një imaret (kuzhinë ku ushqeheshin të varfrit falas)¹⁵, një teqe të tarikatit halveti, disa dyqane që përbënin pazarin, i cili ishte nga më të bukurit në Shqipëri. Ai është ndërtuar me gurë të gdhendur e me qepena të hekurta, në dy anët e lumit Mora-va, të cilat i bashkonte ura e gurit, përsipër të cilës ka pasur dyqane.¹⁶ Iljaz beu në Korçë ka ndërtuar edhe një hamam. Zbukurimet e xhamisë së Iljaz beut dhe mbulesa e plumbtë është bërë nga pasardhësi i tij Mehmet beu në vitin 1572.

Zinova statusin e kasabasë e ka fituar falë ndërtimeve dhe vakufimeve të Mehmet Kukli-begut. Kukli-begu ka qenë njëri nga legatorët më të rëndësishëm shqiptar. Me objektet që ka ngritur e ka ndihmuar shumë zhvillimin e kulturës islame ndër shqiptarët e sanxhakut të Prizrenit dhe më gjerë. Nga vakufnameja e tij e legalizuar në vitin 1538, në Prizren, shohim se ai ka vakufuar këto objekte: 2 xhami, 1 mesxhid, 1 teqe, 3 hamame, 14 karavansaraje, 167 dyqane, 1 urë, 2 puse, 16 gurë mulliri, 50.000 akçe argjendi, shumë parcela tokash, si: vresh-ta, bahçe, livadhe, male etj. Prej këtyre në kasabanë Zinovë të Opojës, ka vakëfuar: 1 shkollë, 1 xhami, 1 mesxhid, 1 karavansaraj, 1 hamam dhe 1 krua¹⁷.

Kavaja ka arritur të promovohet kasaba në vitin 1561 pas ngritjes së Xhamisë së Vjetër dhe objekteve tjera nga Ali Hajdar beu. Xhami-

¹⁴ Poaty f. 60.

¹⁵ Mehmed Süreyya: Sicill-i Osmanî 3, Istanbul 1996, f. 796.

¹⁶ N.D.N.: Korça dhe katundet e qarkut, f. 36; 43.

¹⁷ Nehat Krasniqi: Mehmet Kuklibegu – legatori më meritor për zhvillimin ekonomik dhe kulturo-arsimor të Opojës gjatë shek XVI. Në: Penda, nr.1. Prizren 1995

në Kubelije të Kavajës e ka ndërtuar pasardhësi i Ali Hajdar beut, Kapllan Pasha, në vitin 1735¹⁸. Nga dera fisnike e Kavajës ka pasur edhe poetë të shquar, njëri prej tyre ka qenë “Tevfik” Kavaja. “Tevfik” Kavaja ka qenë kushëri i Ibrahim beg Kavajës, myteselim i Mustafa Pashë Shkodrës në Kavajë dhe vakufues i sahat-kullës (kullës së orës) shumë të bukur të Kavajës, ndërtuar në vitin 1817.¹⁹ Mësimet i ka vijuar në Shkodër e Tiranë, ku përveç tjerash ka zotëruar shumë mirë poetikën dhe stilistikën. Vdiq në vitin 1260 h. / 1844, duke lënë një përmbledhje poezish, ndër të cilat dallohen gazelat. Ka njohur mirë krijimtarinë poetike të poetëve shqiptarë nga qytetet fqinje me Kavajën, gjë që e dëshmojnë poezitë nazire (imituese). Një poezi imituese e ka shkruar në shenjë respekti ndaj poetit Fehmi bej Peqini në garë me të.

Gjakova ka fituar statusin e kasabasë me objektet që ka ndërtuar dhe ka vakufuar Sylejman Hadim-aga, nga fshati Guskë i rrethit të Gjakovës. Ai në vitin 1003 h. / 1594 ka vakufuar një xhami, që njihet me emrin Xhamia e Hadumit, një mekteb (shkollë), një bibliotekë, një muvakit-hane (objekt për matjen e kohës dhe për caktimin e kalendarit), një han dhe një hamam. Për mirëmbajtjen e këtyre objekteve, ai pastaj ka kërkuar nga Sulltani që një varg tokash nga haset sulltanore t'i bashkëngjiteshin vakufit të tij dhe të ardhurat e tyre të përdoren për mirëmbajtjen e objekteve dhe pagimin e personelit të angazhuar me punë në objektet e vakufuara nga ai. Zhvillimi i arsimit dhe kulturës në Gjakovë gjatë periudhës osmane, nuk mund të merret me mend pa kontributin e familjes Kurtpasha. Pinjollët e kësaj familje kanë ndërtuar pothuaj të gjitha objektet e kultit dhe të kulturës islame në Gjakovë. I pari pashë i kësaj dera fisnike ka qenë Kurt Pasha, muhafiz i Ujvarit në vitin 1663. I biri i tij Hasan Pasha, ka qenë pjesëmarrës aktiv në luftërat austro-turke. Në vitin 1694 Hasan Pasha ka qenë my-

tesarrif i Shkodrës. Mbi njëzet pasardhës të Kurt Pashës, kanë arritur gradën Pasha. Disa prej tyre u dalluan si mbështetës të zhvillimeve kulturore e arsimore në Gjakovë. Mahmud Pasha i biri i Hasan Pashës, ka ndërtuar xhaminë dhe mektebin në qendër të Gjakovës që mban emrin e tij. Murat Pasha i biri i Adem Pashës, (vd. rreth vitit 1748), ka ndërtuar dhe ka vakufuar Medresenë e Madhe dhe Teqenë e Madhe të saadinjve në Gjakovë²⁰. Këto dy objekte kanë qenë institucionet më të rëndësishme kulturore edukative të Gjakovës gjatë periudhës osmane. Myderriz i parë në Medresenë e Madhe të Murad Pashës në Gjakovë, ka qenë Yveys efendi nga Shkodra. Ndërsa shehi i parë i Teqesë së Madhe, ka qenë Sylejman Axxhiza Baba, po nga Shkodra²¹. Në kohën kur këta dy doajenë të jetës fetare arsimore e kulturore, kanë filluar të veprojnë në Gjakovë, dera e Kurdpashëve ishte ndër dyert që prinin në aktivitetet politike e shoqërore të vendit. I ati i Murad Pashës, Adem Pasha, në ato vite, ka qenë mytesarrif në disa sanxhaqe shqiptare. Në vitin 1694 ka qenë mytesarrif i Ohrit, në vitin 1696 mytesarrif i Elbasanit, në vitin 1697 përsëri mytesarrif i Ohrit, ndërsa në vitin 1699, kur Axxhiza Baba vjen në Gjakovë, Adem Pasha ishte mytesarrif i Shkodrës²². Shejh Sylejman Axxhiza Baba në Gjakovë ka ardhur në vitin 1699 dhe ka filluar aktivitetin për ngritjen shpirtërore të masave dhe për përhapjen e tarikatit Saadi, tarikat ky, deri atëherë i papranishëm në trojet shqiptare. Në Gjakovë ai do të gëzojë përkrahje morale dhe materiale të pakursyer, nga familja autoritare e Kurtpashëve, në veçanti gëzoi përkrahjen e Murat begut (më vonë fitoi gradën Pasha) i biri i Adem Pashës. Murat Pasha ishte donatori më i rëndësishëm dhe personi më meritor për zhvillimin e jetës kulturore, arsimore dhe fetare në Gjakovë në fillim të shek. 18-të. Objektet që ai ndërtoi kanë rendësi të veçantë kulturo arsimore dhe fetare. Teqenë e Madhe Murat Pasha e ka ndërtuar në vitin 1714, siç konfirmon Axxhiza Baba me një

¹⁸ Machiel Kiel: Ottoman architecture in Albania 1385-1912. Istanbul 1990, f. 158. Sipas Mehmed Syrejasë, Kapllan Pasha me gradën mirimiran ishte muhafiz i Vlorës. (Sixhill-i Osmani 3, f.867).

¹⁹ Ali Emiri, Po aty; Machiel Kiel, Ottoman Architecture in Albania 1385-1912, Istanbul: Research Centre for Islamic History, Art and Culture, 1990, f. 155.

²⁰ Nehat Krasniqi, Dy dokumente gjenealogjike të rëndësishme, Në: Dituria Islame, nr. 59, Prishtinë 1994, f. 14.

²¹ Është e pambshtetetur hipoteza se Axxhiza Baba rrjedh nga familja e Bushatllinjëve.

²² Mehmet Süreyya: Sicill-i Osmanî 1, Istanbul 1996, f. 141.

tarih (kronogram) në Divanin e tij²³. Ndërsa vakufimi i saj dhe i objekteve tjera që ka ndërtua Murat Pasha është bërë në vitin 1732. Axhiza Baba në Divanin e tij, ia ka kushtuar një poezi lavdëruese Mehmet Pashës së Gjakovës, nga e cila kuptojmë se ai në vitin 1717 përkrah Mehmet Pashë Gjakovës ka marrë pjesë në luftën kundër venedikasve që është zhvilluar në Ulqin²⁴. Axhiza Baba, ka vdekur në Prizren në vitin 1747-48 dhe është varrosur në tyrben pranë teqesë së tij të dytë të ndërtuar në Marash.

Murat Pasha ka qenë mecen i vërtetë i dijetarëve dhe intelektualëve të kohës. Ai edhe vetë ka qenë njeri i ditur dhe i penës, gjë që vërtetojnë dorëshkrime të cilat ruhen nëpër disa koleksione në Prishtinë, Gjakovë dhe Sarajevë. Nga dera fisnike e Kurtpashëve dolën dijetarë dhe poetë si Sejfedin Pasha, i biri i Ali Pashë Gegës (vd. 1790), Ahmed Kurt Pasha (vd. 1827) dhe Mustafa Pasha, i biri i Sejfedin Pashës. Sejfedin Pasha i parë, ka ndërtuar një xhami, e cila quhet Xhamia e Sefës. Edhe zonjat Sofa dhe Hanka të cilat kanë qenë nga kjo derë fisnike, kanë ndërtuar nga një xhami në Gjakovë.

Kaçaniku ka marrë statusin e Kasabasë në vitin 1003 H. / 1594 kur Koxha Sinan Pasha, i biri Ali begut, i lindur në Topojan të Lumës, ndërtoi aty xhaminë, një hamam, një shkollë, një imaret dhe dy hane. Sinan Pasha gjatë periudhës 1580-1596 ka zënë postin e vezir-i azamit pesë herë. Ai ka ndërtuar dhe ka vakufuar një varg objektesh në trojet shqiptare dhe gjetiu në Perandorinë Osmane. Gati nuk ka qytet shqiptar të asaj kohe nga veriu në jug, ku nuk ka lënë ndonjë objekt ky vakif i madh. Për mirëmbajtjen e objekteve që ka ngritur në Kaçanik, si dhe për pagat e personelit të punësuar në ato objekte, Sinan Pasha vakufoi një varg objektesh fitimprurëse: 12 dyqane në Shkup, një hamam në Prishtinë, si dhe pasuri tjera të paluajtshme në disa fshatra të

²³ Në kopjen e Divanit të Axhiza Babës që ruhet në Teqen e Sheh Banit në Gjakovë, f.118-119, është poezia epigrafike të cilën autori ia ka kushtuar ndërtuesit të Teqes së Madhe, Murat Pashës. Data e ndërtimit të saj del nga kronogrami: “Allah gani” i cili sipas llogaritjes ebxhedike jep vitin 1126 H. që është ekuivalent me vitin 1714 sipas erës sonë.

²⁴ Divani i Axhiza Babës, që ruhet në Koleksionin e Dorëshkrimeve të Bibliotekës Komëtare dhe universitare të Kosovës, f 43-44.

Shkupit, në disa fshatra të Kosovës, në Lumë, në Shqipërinë Jugore, në Ulqin e gjetiu²⁵. Edhe djali i Sinan Pashës së përmendur, Mehmed Pashë Kaçaniku (vd. 1605) themeloi një varg vakufesh. Në vitin 1601 ai vakufoi një xhami në Shkup dhe vaizit (predikuesit) të saj i caktoi pagën ditore prej tri akçesh. Po në Shkup ai ndërtoi një shkollë dhe mësimdhënësit i caktoi pagën ditore prej gjashtë akçesh. Mehmed Pashë Kaçaniku ka vakufuar edhe një bibliotekë dhe një teqe në Shkup²⁶. Titujt e librave të bibliotekës së vakufuar, i ka shënuar në vakufname. Po ky vakif ka ndërtuar edhe një xhami dhe një shkollë në Gostivar, kurse për mirëmbajtjen e tyre ka vakufuar një karavansaraj dhe një hamam në Gostivar. I biri i tij Mustafa Pashë Kaçaniku, në vitin 1644 ka ndërtuar një xhami në Gostivar. I biri i Mustafa Pashës, Ebubekir Pasha, po në Gostivar ka ndërtuar Xhaminë e Saatit dhe medresenë pranë sajë. Djali i vëllait të madh i Koxha Sinan Pashës, Mustafa Pasha, i biri Ajas Pashës së ekzekutuar nga Sulltani në vitin 1562, ka ndërtuar një xhami në Prizren.

Tirana e ka fituar statusin e kasabasë falë objekteve që i ka ndërtuar dhe i ka vakufuar Sylejman Pashë Bargjini, nga fshati Mullet²⁷. Ai, para se të vritej në luftë në vitin 1024 H. /1614, ka ndërtuar xhaminë, e cila njihej me emrin Xhamia e Vjetër, një hamam, një imaret, një furrë dhe sarajin e tij. Sylejman Pashë Bargjini ka qenë i zoti i penës dhe i shpatës. Ka shkruar poezi në të tri gjuhët e orientit islam, në arabisht, në persisht dhe në osmanisht. Në poezitë e tija Sylejman Pasha ka përdorur mahllasin (pseudonimin poetik) “Halimi” që ka domethënieën i buti; i mëshirshmi²⁸. Poezitë e “Halimi” tiranasit reflektojnë shpirtmadhësi, butësi dhe shije artistike të hollë. Ndërsa me xhaminë e tij, ndërtimin e së cilës vetë e ka projektuar dhe e ka mbi-

²⁵ Hasan Kaleši: Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku = Dokumentat më të vjetra të vakufëve në Jugosllavi në gjuhën arabe, Prishtinë 1972, f. 274; 328.

²⁶ Hasan Kaleši, Mehmed Mehmedovski: Tri vakufnami na Kaçanik Mehmed Paša. Skopje 1955, f. 15; 33.

²⁷ Ali Emiri: Işkodara Vilayeti Osmanlı Şairleri. Në: Istanbul, Mil-let Kütüphanesi, Trh. 1190, f. 20.

²⁸ Ali Emiri. Po aty.

këqyrur, ka nisur një stil të ri arkitektonik të xhamisë në Shqipëri²⁹, respektivisht ka promovuar një stil autentik të xhamisë shqiptare. I biri Sylejman “Halimi” Pashë Bargjinit, Ahmet Pasha, në vitin 1633 i ndërtoi minaren xhamisë dhe një krua pranë saj³⁰.

Për pasardhësit tjerë të Sylejman “Halimi” Pashë Bargjinit, nga vija mashkullore, nuk kemi hasur të dhëna nëse ndonjëri prej tyre ka kontribuar me ndonjë vepër konkrete në zhvillimin e kulturës në Tiranë. Ndërkaq, dihet se ata kanë qenë aktivë në jetën politike e shoqërore të vendlindjes dhe më gjerë. Djali i Ahmet Pashës, Ibrahim Pashë Bargjini dhe i biri Kahraman Beu, që prej kohësh ishin angazhuar në lëvizjet kryengritëse të Bushatlinjve, si përkrahës por edhe si miq familjarë të tyre. (Zonja e Mahmud Pashë Bushatit ishte goca e Ibrahim Pashë Bargjinit, më vonë edhe goca e Ibrahim Pashë Bushatit u martua me Ahmet Pashë Bargjinin II). Ibrahim Pashë Bargjini u burgos dhe më vonë u ekzekutua në burgun e Jedi-kules, në vitin 1788, me pretekst se nga burgu ka komunikuar fshehtas me dhëndrin e vet Kara Mahmud Pashën, të shpallur fermanli nga Sulltani dhe të rrethuar në Kalanë e Shkodrës³¹. Po atë vit, më 13 gusht, u vra tradhtisht nga Mustafa Pashë Toptani edhe Kahraman Beu³².

Rol të veçantë në zhvillimet kulturore në Tiranë dhe më gjerë, kanë lozur pasardhës të themeluesit të këtij qyteti nga vija femërore, duke filluar nga Mehmet Molla beu (vd. 1808) i biri i Ed’hem Beut (vd. 1768) dhe nipi i Shaban Beut³³ nga Petrela. Mehmet Molla Beu ishte nip i Bargjinollëve. Nëna e tij ishte bija e Ahmet Pashë Bargjinollit³⁴. Mehmet Molla Beu në vitin 1208 h./ 1793 hodhi themelet e xhamisë më të bukur të Tiranës, e cila sot njihet me emrin Xhamia e Haxhi Ed’hem Beut. Kështu e mori emrin sepse Mehmet Molla Beu

²⁹ Ali Emiri. Po aty.

³⁰ O. Myderizi: Qyteti i Tiranës. /ribotim/ Tiranë 1998, f. 43.

³¹ Mehmed Süreyya: Sicill-i Osmanî 3, Istanbul 1996, f. 772; Ahmed Cevdet Paşa: Tarih-i Cevdet, cild 4, Istanbul 1973, f. 138-139.

³² Stavri N. Naçi: Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllive në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII (1757-1796). Tiranë 1964, f. 212.

³³ Ali Emiri. Po aty, f. 33.

³⁴ Machiel Kiel. Po aty f. 265, shënimi 25.

nuk arriti ta përfundojë ndërtimin e saj derisa që gjallë dhe pas vdekjes së tij në vitin 1223 h./ 1808 i biri Haxhi Ed’hem Beu përfundoi ndërtimin e saj në vitin 1236 h./1820. Këto të dhëna me vitet e hedhjes së themeleve, të vdekjes së Molla Beut dhe të përfundimit të ndërtimit të xhamisë, i përmban mbishkrimi i vendosur mbi portalin e jashtëm të saj.

Autor i këtij mbishkrimi është Haxhi Ymer Mustafa Kashari, i cili në krijimtarinë e vet poetike përdorte pseudonimin “Suzi”, e jo poeti turk Ahmed “Suzi” nga Sivasi, siç supozon M. Kiel³⁵. Një mbishkrim tjetër është skalitur mbi portalin e brendshëm të xhamisë. Autor i këtij mbishkrimi është poeti, dijetari dhe arsimtari tiranas Ibrahim Alltiparmak efendiu, i cili në krijimtarinë e vet poetike përdorte pseudonimin “Muznib”, e jo “një farë Zija”, siç mendon Kr. Frashëri³⁶. Ibrahim “Muznib” Alltiparmak efendiu ka qenë mësues i djalit të Haxhi Edhem Beut, Ali Riza Beu, i lindur në vitin 1832³⁷. Pas ndërtimit të minares së xhamisë, të sofasë dhe pas zburimit të interierit dhe eksterierit të saj, Haxhi Ed’hem Begu ndërtoi kullën e sahatit dhe medresenë. Vitin e përfundimit të ndërtimit të kullës së sahatit 1238 h./1822, e ka shënuar poeti krutan Shaban “Hulusi” Bej Toptani (vd. 1833) në një poezi përuruese me kronogram, të cilën ia ka kushtuar Haxhi Ed’hem Beut³⁸. Nuk kemi gjetur askund vitin e ndërtimit të medresesë së Haxhi Ed’hem Beut, por mund të supozojmë se ndërtimi i saj nuk do të ketë shkuar më vonë se viti 1825. Haxhi Ed’hem Beu (1783-1848) ka qenë poet mjaft i frytshëm. Ka përdorur dy pseudonime poetike “Shehidi” dhe “Vefaji”. I takonte tarikatit bektashi, e jo atij kaderi, si thotë Kr. Frashëri³⁹. Ai madje pas largimit nga Tirana, afër dhjetë vjet (1808-1818) ka qëndruar në Karaağaç në dergjahun

³⁵ Machiel Kiel. Po aty f. 257.

³⁶ Kristo Frashëri. Po aty f. 187.

³⁷ Ali Emiri. Po aty, f. 33. Kur biobibliografi dhe bibliofili turk Ali Emiri e viztoi Vilajetin e Shkodrës në cilësinë e inspektorit financiar në vitin 1896, Ali Riza Beu i kishte dhënë atij të dhëna biografike për 12 poetë tiranas dhe krutanë. Ali Riza Beu aso kohe ishte pensionuar duke qenë Kajmekam i Kazasë së Kavajës.

³⁸ Ali Emiri. Po aty, f. 28.

³⁹ Kristo Frashëri. Po aty f. 243.

bektashi të Mustafa Fatih Babës, ku ka shërbyer si postneshin (Baba) i këtij dergjahu⁴⁰. Një Divan i Haxhi Ed'hem Beut gjendet në Bibliotekën Universitare të Stambollit, me numrin e signaturës Ty 1017. Haxhi Ed'hem beu ka mbajtur raporte të shkëlqyera me dijetarët dhe poetët bashkëvendës, si me Haxhi Ymer "Suzi" Kasharin, me djalin e Haxhi Ymerit Saidin, i cili po ashtu ka qenë poet, me Sheh Selim "Halimi" efendiun, me babën e Sheh Selimit, Sheh Jonuz efendiun etj. Mund të themi se Haxhi Ed'hem Beu ka qenë një intelektual i lartë, një veprimtar i ndërgjegjshëm politik, një poet i shkëlqyer, me një fjalë një fisnik i mirëfilltë shqiptar.

Në Tiranë kanë jetuar dhe vepruar edhe tre poetë dhe shehlerë kaderi, të cilët kanë bërë pjesë në elitën kulturore të Tiranës aso kohe. Ata janë Sheh Rexhep "Lisani", Sheh Selim "Halimi" dhe Hasan "Hadim" Tirana, për të cilët po japim në vazhdim ca të dhëna të reja jetëshkrimore

Sheh Rexhep "Lisani" Tirana (1670-1789), ka qenë sheh dhe poet i dalluar tiranas. I ati quhej Dervish Kubati, që nga mbiemri kuptohet se ka qenë me prejardhje nga fshati Kubat. Ka jetuar e vepruar në Tiranë, ku plot shtatëdhjetë vjet qëndroi në postin e shehut të tarikatis kaderi. Vdiq në Tiranë në moshën 119-vjeçare, më 1789.⁴¹ Në krijimtarinë e tij letrare Sheh Rexhepi nënshkruhej me emrin poetik "Lisani".⁴² Ai ka qenë një sheh shumë i ditur dhe i ngritur. Në teqenë e tij frekuentonin tiranas të arsimuar të asaj kohe. Si njohës i thellë i tesavufit (misticizmit islam) dhe i islamologjisë përgjithësisht, që ishte, gëzonte epitetin "kutb", me të cilin epitet, zakonisht, mbiemroheshin dijetarët dhe gnostikët më të mëdhenj. Sheh Rexhep "Lisani" ka lënë trashëgimtarë të arsimuar. Djali i tij ishte Sheh Junus Efendi. Me rastin e vdekjes së tij më 1831, poetët e njohur tiranas Haxhi Ymer

⁴⁰ Baba Rexhepi: *Misticizma Islame dhe Bektashizma*. New York 1970, f. 343-345; Ali Emiri. Po aty f.28.

⁴¹ Ali Emiri, *Iskodra ... Vep. e cit. fl. 21.*

⁴² Dhimitër S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Prishtinë: Rilindja, 1978, f. 115.

"Suzi" Kashari dhe Haxhi Ed'hem "Shehidi" Tirana, ia kushtuan nga një elegji.⁴³

Sheh Selim "Halimi" Tirana (1793-1853) u lind në Tiranë. Është djali i Sheh Junus Efendiut dhe nipi i Sheh Rexhep "Lisani" Efendiut, jetëshkrimin e të cilit e shënuam më lart. Mësimet fillestare i mori në vendlindje, pastaj mësoi edhe nga i ati. Ndërsa, mësimet e larta dhe ato speciale nga fusha e tesavufit, i vazhdoi në Dibër, te dijetari dhe shehu i njohur kaderi, Sheh Osman Efendi Dibra. Pasi mori nga ai hilafetnamen (diplomën për sheh) dhe veshi hërkën (rrobën e shehut), u kthye në Tiranë. Pas vdekjes së të et, në vitin 1831, Sheh Selim "Halimi" zuri postin e tij. Këtë post ai e ka mbajtur 23 vjet rresht, deri kur vdiq në vitin 1853. Është varrosur në tyrben pranë teqesë së kaderive në Tiranë. Sheh Selim "Halimi" Tirana kishte njohuri solide nga fusha e fikhut (e drejta e shariatit). I zotëronte të tri gjuhët orientale, gjuhën arabe, gjuhën perse dhe gjuhën osmane. Ka shkruar poezi në këto tri gjuhë, por tarihi (poezia jetëshkrimore) në gjuhën perse, të cilin ia kushtoi gjyshit të tij, Sheh Rexhep "Lisani" Efendiut, është një dëshmi e qartë se në çfarë shkalle të lartë zotëronte këtë gjuhë dhe letërsinë e poetikën orientale përgjithësisht. Përveç poezive të shumta që ka lënë në gjuhët orientale, Sheh Selim "Halimi" ka bërë edhe komentimin e disa veprave të njohura mistike-filozofike, siç është vepra e Abdyl-Kadër Gjejlaniut "Tuhfetu'l-gajb". Komentimin e kësaj vepre e ka përfunduar në vitin 1242 H./1826.⁴⁴ Të dhëna jetëshkrimore me interes, për këtë dijetar e poet, sjell poeti tiranas Said Efendi, i biri i Haxhi Ymer "Suzi" Kasharit, me mersijen (elegjinë) kushtuar Sheh Selimit me rastin e vdekjes.⁴⁵

Hasan "Hadim" Tirana (vd. 1805) ka qenë sheh i kaderive dhe poet i letërsisë se teqeve. U lind në Tiranë ku edhe vijoi shkollimin. Mësimet speciale nga fusha e tesavufit dhe e ngritjes shpirtërore, i mori nga dijetari dhe gnostiku më i madh tiranas i asaj kohe, Sheh Abduselam Tirana (vd. në vitin 1776), i njohur me atributin e lartë "Shejhu'l-

⁴³ Ali Emiri, *Vep. e cit. fl. 22.*

⁴⁴ Ali Emiri, *Iskodra vilayeti ... Vep. e cit. fl. 23.*

⁴⁵ Po aty, fl. 22.

islam”.⁴⁶ Hasan “Hadim” Tirana nga ky dijetar i famshëm mori po ashtu hilafetnamen për sheh kaderi.

Ai kishte themeluar një hanikah (teqe) në Tiranë, ku mblidheshin ithtarët e rendit kaderi, të cilët i mësonte dhe edukonte në frymën e këtij rendi. Pas një veprimtarie mbi dyzet vjeçare, ka vdekur në Tiranë në vitin 1805 dhe është varrosur në tyrben pranë hanikahit të tij⁴⁷.

Ka shkruar shumë poezi të karakterit mistiko- filozofik në të tri gjuhët orientale.

Peqini ka arritur të promovohet kasaba falë objekteve që ka ndërtuar dhe vakufuar Abdurrahman Pashë Peqini, nga fshati Çicul (Vd. 1687). Abdurrahman Pasha në vitin 1666 ka ndërtuar një xhami, një hamam, shtatë kroje, hane dyqane ura etj. Abdurrahman Pasha ka qenë i afërm i Hoxha –zade Hasan Pashës. Në vitin 1669 u bë aga i jeniçerëve. Në vitin 1674 fitoi gradën e vezirllëkut dhe postin e valiut të Bagdadit. Prej atje më 1679 shkoi në Egjipt, kurse në vitin 1681 u emërua vali i Bosnjës. Në vitin 1682 ishte muhafiz (komandant) i kalasë së Kamenicës, kurse në vitin 1684 u bë vali i Budimit. Në vitin 1685 qe komandant i ushtrisë osmane në Hungari dhe po atë vit shkoi vali në Halep. Në vitin 1686 shkoi vali në Budim, për herë të dytë dhe atje më 26 gusht 1687 është vrarë në luftë, në moshën 80-vjeçare. Ai përveç vakufeve që ka lënë në Peqin, ka rinovuar edhe tyrben e Ma’ruf-i Kerhit në Bagdad⁴⁸.

Nga kjo derë kanë dalë veprimtarë të shquar shoqërorë dhe kulturorë si Xhafer “Sadik” Pashë Peqini (vd. 1834). Xhafer Pasha u lind në Peqin, qytezë kjo e cila atëherë binte nën juridiksionin e Vilajetit të Shkodrës. Ai rrjedh nga një familje fisnike peqinase, e cila luajti rol parësor në themelimin dhe zhvillimin e kësaj qyteze. I ati i Xhaferit, Sylejman Pashë Peqini (vd.1820) ishte njëri nga autoritetet e vendit.

⁴⁶ Për pozitën dhe rolin e shejhu’l-islamit në komunitetin mysliman në përgjithësi dhe në Perandorinë Osmane në veçanti, shih punimin: Institucioni i shejhu’l-islamit te osmanli- njtë dhe shejhu’l-islamët shqiptarë, në: “Dituria Islame” nr. 50, Prishtinë, 1993, f. 24-26.

⁴⁷ Ali Emiri, Iskodra vilajeti ... Vep. e cit. fl. 25.

⁴⁸ Mehmed Süreyya: Sicill-i Osmanî 1, Istanbul 1996, f. 95.

Stërgjyshi i Xhaferit, Abdurrahman Pashë Peqini (vd.1687), ndërtoi dhe vakufoi një varg objekteve të rëndësishme, të cilat Peqinit i dhanë tiparet dhe statusin e një qyteze. Mësimet e para, Xhaferi i mori në vendlindje, ndërsa studimet i ka vijuar në Shkodër. Në Shkodër mori mësim nga myderisi shkodran me famë, Myrteza “Safi” Efendiu, si dhe nga dijetarë të tjerë shkodranë⁴⁹. Pas vdekjes së të et, Xhaferi kthehet në Peqin, ku, më 1821, u emërua mydyr (prefekt) i kësaj qyteze. Për aftësitë administrative, por edhe ushtarake që tregoi Xhaferi, pas një viti, fitoi gradën vezir. Në vitin 1827, Xhafer Pasha u emërua mytesarrif i Maçinit (tani Dobrugja në Rumani), në vitin 1829 u emërua guvernator i Inebahtit (Lepanto) dhe po atë vit u emërua vali i Karlli-ilit. Në luftërat që ndodhën atëherë në vilajetin e Karlli-ilit, Xhafer Pasha mori pjesë dhe tregoi aftësi të rralla ushtarake⁵⁰. Në vitin 1833 ai shkoi në Stamboll ku u prit në audiencë te Sulltan Mahmudi II⁵¹. Një vit më pas (1834), Xhafer Pasha vdiq dhe u varros pranë xhamisë që e ka ndërtuar stërgjyshi i tij Abdurrahman Pasha. Me rastin e vdekjes, vëllai i tij Fehim Efendi Peqini, ia kushtoi një elegji të cilën e botoi Ali Emiri⁵². Duke imituar (nazire), këtë poezi, poeti bashkëkohës nga Kavaja, Tevfiku, i kushtoi po ashtu një elegji Xhafer Pashës.⁵³ Xhafer Pasha në shkrimet e tij ka përdorur pseudonimin poetik “Sadik”. Një gazel i Sadikut është botuar nga biografi i parë i tij, Ali Emiri. Përndryshe, vepra e tij letrare ka mbetur në dorëshkrim dhe ruhet në Bibliotekën Popullore (Millet Kütüphanesi) në Stamboll. Ajo është e përmbledhur në një divan në të cilin gjejmë poezi të Xhafer “Sadik” Pashës të shkruara gjatë kohës së sundimit të tre sulltanëve osmanë, të Selimit III, (1789-1807), të Mustafës IV, (1807-1808), dhe të Mahmudit II, (1808- 1839).⁵⁴ Xhafer Pasha ishte poet por edhe stilist i dalluar, ishte njeri i vendosur, i edukuar dhe fisnik.

⁴⁹ Ibnülemin Mahmud Kemal Inal, Son asër tyrk shairleri, cüz 9, Istanbul: Maarif matbaasë, 1940, f. 1559.

⁵⁰ Mehmed Süreyya, Sicilli Osmanî, cilt 2, Istanbul, 1996, f.383.

⁵¹ Istanbul Kütüphaneleri türkçe yazma divanlar katalogu, IV cilt, fasikul I,II, f.129.

⁵² Ali Emiri, Iskodra Vilajeti Osmanli Sairleri, Millet Kütüphanesi, Trh 1190, fl.14.

⁵³ Ali Emiri, vep. Cit. fl. 9-10.

⁵⁴ Istanbul Kütüphaneleri türkçe yazma ... vep. Cit. f. 130.

Në të pikasin atributet më të mira njerëzore. Poet i njohur peqinas ka qenë edhe vëllai i Xhafer “Sadik” Pashës, Ibrahim “Fehmi” bej Peqini (vd.1853). Biobibliografët dhe autorët e antologjive të ndryshme të letrarëve osmanë, ofrojnë pak të dhëna për këtë poet, madje, e ngatërrojnë me ndonjë person tjetër. Njëri prej tyre Ibnulemin Mahmud Kemal Inali duke bërë fjalë për jetëshkrimin e Xhafer “Sadik” Pashës, prezanton elegjinë që ia kushtoi i vëllai Fehmiu dhe me një shënim na orienton në f. 381, ku jepen të dhëna jetëshkrimore për një Fehim tjetër të cilin e trajton si vëlla të Xhafer “Sadik” Pashës.⁵⁵ Këtë ngatërrim e zgjidhi biobibliografi Mehmed Tahir Bursaliu, i cili ofron pak të dhëna për këtë poet, por ato i merr nga Divani i Ibrahim “Fehmi” Beut, të botuar nga nipi i tij Salim beu në vitin 1870. Sipas Bursaliut, Fehmiu ishte një poet i shkallës së mesme. Ai i takonte tarikatis Mevlevi dhe shquhej për etikën e tij të lartë.⁵⁶

Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimet kulturore të vendit ka qenë i rëndësishëm së veçantë po ashtu edhe në qytetet e mëdha e të vjetër ku etnia shqiptare ka qenë shumicë, duke ndërtuar dhe vakufuar objekte të ndryshme të kultit dhe të kulturës islame. Kontribut tejet të rëndësishëm zhvillimeve kulturore i ka dhënë dera fisnike e Bushatlinjve të Shkodrës, sidomos duke filluar nga Mehmet Pashë Plaku e këndej, qoftë duke themeluar institucione të arsimit e të kulturës, apo qoftë duke u marrë edhe vetë me krijimtari letrare⁵⁷. Medreseja e Qafës e ndërtuar nga Mehmet Pashë Plaku, ka qenë institucion me rëndësi të veçantë për zhvillimin e arsimor dhe kulturor të Sanxhakut të Shkodrës dhe më gjerë. Myderrizi i parë që ka dhënë mësim në këtë medrese është Murteza “Safi” Shkodra (vd. pas vitit 1775) i biri i Murteza “Raxhi” Shkodrës. Nga tradita njihet si Myrteza efendi Shoshi⁵⁸. Ka qenë myderrizi kryesor, poeti e mjeshtri i poetëve dhe myftiu i Pasha-

⁵⁵ Ibnulemin Mahmud Kemal Inal, Son asër türk sairleri, cuz II, f.1559, shënimi 1.

⁵⁶ Bursali Mehmed Tahir Efendi, Osmanli Müellifleri(1299-1915), cilt II, Istanbul: Meral Yayınevi, 1972, f. 120.

⁵⁷ Më gjërësisht lidhur më këtë shih: Nehat Krasniqi, Kontributi i Pashallarëve bushatlinjë të Shkodrës në fushën e kulturës. Në: Seminari i Katërt Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj” 20-22 nëntor 2000, Vëllimi i parë, Shkodër 2002.

⁵⁸ Hamdi Bushati, Shkodra Dhe Motet, Vëllimi I, Shkodër, 1998, f. 596- 597.

llëkut të Shkodrës. Si dijetari më i dalluar shkodran që ishte, Mehmed Pashë Plaku ia besoi arsimimin dhe edukimin e fëmijëve të vet. Kështu që, mësuesi dhe edukatori kryesor i Ibrahim “Halili” Pashës, qe Murteza “Safi” Shkodra. Ibrahim Pasha edhe artin e letërsisë dhe poetikën i mësoi nga ky poet i dalluar i kohës së tij.⁵⁹ Ky dijetar i shkëlqyer dhe poet elokuent, me rastin e vdekjes së Mehmed Pashë Plakut, ia kushtoi një tariah (poezi jetëshkrimore), nga kronovargu i së cilës del viti 1189 H/ 1775, që tregon vitin e vdekjes së tij⁶⁰.

Përpos disa poezive të Murteza “Safi” efendiut që janë ruajtur deri tani, sipas një informacioni që ka sjellë Hamdi Bushati, nga ai është ruajtur edhe një vepër nga fusha e jurisprudencës islame, e shkruar në gjuhën arabe⁶¹. Murteza “Safi” Shkodra, nxori një plejadë shkollarësh e poetësh, të cilët pastaj i dhanë shtytje e ndihmesë të rëndësishme zhvillimit kulturor, arsimor e shoqëror të vendit, në veçanti Pashallëkut të Shkodrës. Kontribut i veçantë i tij është nxitja e dashurisë për artin e letërsisë të studentët e tij. Po veçojmë këtu Ibrahim “Halili” Pashë Shkodrën dhe Xhafer “Sadik Pashë Peqinin. Personalitetin e Murteza efendiut e stolisnin virtytet më të larta që mund të kishte një intelektual i lartë i kohës së tij. Jehona e famës së tij kishte arritur deri në Oborrin sulltanor. Prandaj, ai ka qenë ftuar nga Shejhu’l-islami i Perandorisë Osmane për vizitë pune dhe në atë rast është pritur edhe në audiencë të Sulltani.⁶²

Mehmed Pashë Plaku ka ndërtuar edhe objekte tjera. Nga ato po përmendim Xhaminë e Plumbit, e ndërtuar në vitin 1773 dhe bibliotekën e parë publike e cila njihej si Biblioteka e Vakëfit. Objekte të rëndësishme kulturore ka ndërtuar edhe Kara –Mahmud Pasha. Medreseja e Pazarit me Bibliotekën dhe Xhaminë e Madhe janë ndërtesa të tij.

⁵⁹ Ali Emiri, Işkodra Vilayeti... Vep. e cit. fl. 3.

⁶⁰ Po aty, fl. 2. Një kopje e kësaj poezie ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë.

⁶¹ Hamdi Bushati, Shkodra Dhe Motet, Vëllimi I, Shkodër, 1998, f. 596.

⁶² Më gjërësisht për këtë vizitë të tij në Stamboll, shih: Hamdi Bushati, Shkodra ... Vep e cit , Vëllimi II, f. 90-91.

Me krijimtari letrare nga kjo derë fisnike janë marrë: Ibrahim Pasha me emrin letrar “Halili” (vd. 1809), Mehmed Pasha me emrin letrar “Asaf” (1768-1802) dhe Mustafa Pasha me emrin letrar “Sherifi” (1797-1860). Bijtë e Mustafa Pashës, Mahmud “Hamdi” Pasha, i lindur në Shkodër, më 1824 dhe Hasan “Haki” Pasha, i lindur në Shkodër më 1826. Këta janë dëshmuar poetë të talentuar dhe të thellë. Nga këta do veçonim Mehmed “Asaf” Pashë Shkodrën (1768-1802). Në shkrimet e tij, Mehmed Pasha është nënshkruar me emrin poetik “Asaf”. Mehmed “Asaf” Pasha ka qenë dijetar i ngritur, shkrimtar letrar i formuar dhe poet me talent dhe shije të kohës artistike. Ai ishte njohës shumë i mirë i letërsisë orientale, përgjithësisht. Veçanërisht e njëjtte letërsinë klasike persiane, nga e cila edhe ishte ndikuar. Poezitë e tij më të forta janë në persishte, ndërsa të tjerat janë në gjuhën osmane. Në to spikat talenti i tij për poezi, njohja e shkëlqyeshme e poetikës orientale dhe aftësitë e stërholluara shprehëse. Në zyrën e Mehmed “Asaf” Pashës, gjithmonë kanë qenë të mirëseardhur dijetarët dhe poetët. Ai ka qenë një lloj redaktori i poezive që krijonin poetët e kohës dhe vendit të tij dh njëherësh nxitës dhe përkrahës i tyre. Kështu, Mehmed “Asaf” Pasha ka qenë shëmbëlltyrë e poetit, intelektualit dhe e pushtetarit të kohës⁶³. Poetët bashkëvendës të Mehmed “Asaf” Pashës, shkonin në zyrën e tij dhe lexonin poezitë e tyre. Ai i shpërblente të gjithë poetët, madje edhe ata të rretheve tjera që nuk kishin fatin të prezantonin te ai. Me dijetarët dhe sidomos, me letrarët që shkruanin në persishte, Mehmed “Asaf” Pasha shkëmbente letra me anekdota në vargje. Njëri nga ata ishte dijetari e poeti Mesud “Kamber” Demiri nga Shkodra, i cili, sipas Ali Emirit, ishte poet i rangut të Saibit⁶⁴ dhe Nabiut⁶⁵. Mesud “Kanberi” i kishte dërguar Mehmed “Asaf” Pashës një poezi të shkurtër në gjuhën perse, me të cilën kërkonte nga ai për-

⁶³ Sadettin Nuz’het Ergun, Turk Sairleri, Istanbul, /s.a./ f. 97.

⁶⁴ Saib (vd. 1676). Poet i njohur persian nga Tebrizi. Është dalluar me gazelet dhe kasidet e tij të bukura. (Më gjërësisht: Ibrahim Alaettin, Meshur adamlar, cild IV, Istanbul, 1933-36, f.1402.)

⁶⁵ Nabi (vd. 1712). Poet i njohur turk, i cili u dallua me poezitë e tija filozofike.

mbledhjen e fetfave të Ali Efendiut.⁶⁶ Zyra e Mehmed “Asaf” Pashës ishte një lloj biblioteke. Aty ai kishte veprat e poetëve më të shquar persianë dhe jopersianë që kanë krijuar në persishte si: Urriu, Sadiu, Hafizi, Selmani, Hasani, Enveri, Talibi, Fejziu, Saibi, Shefketi, Xhamiu, Zahiri, Hakaniu si dhe divane në osmanishte, të poetëve: Baki, Nef’i, Jahja, Fehim, Sabri, Vexhdi, Naili, Mezaki, Shehri, Xhevri, Nabi, Nedim, Nahifi, Ragib Pasha e të tjerë⁶⁷. Mehmed “Asaf” Pasha ishte mecen i poetëve dhe i dijetarëve, por edhe qeveritar i drejtë dhe i matur. Ai vdiq në moshën më të mirë, pa i mbushur të dyzetat. Me vdekjen e tij, poetët dhe dijetarët bashkëvendës e bashkëkombës, humbën përkrahësin më të madh të tyre, ndërsa populli humbi një qeveritar të drejtë.

Një derë fisnikësh që u dallua në Prizren për kontributin që i dha përparimit të jetës kulturore, duke themeluar e vakufuar institucione të ndryshme, ishte familja e famshme Rrotlla, me prejardhje nga fshati Nangë i Lumës, e cila në Prizren kishte sunduar mbi një shekull nga fillimi i shekullit 18-të deri në fund dekadës së katërt të shekullit 19-të. Gjatë kësaj periudhe pjesëtarë të familjes Rrotlla kanë themeluar dhe kanë vakufuar një varg institucionesh në Prizren dhe rrethinë.

I pari i kësaj familjeje ishte Salih Zajmi, i cili pas aftësive që kishte treguar në luftën e Kretës, në vitin 1667, sadriazami Fadil-Ahmet pashë Qypërliun i kishte dhuruar një zeamet. Salih Zaimi la dy djem: Mahmudin dhe Mehmedin, për të cilët nuk kemi informacione nëse kanë pasur farë pozite ose jo. Por nipi i tij, Salih Pasha, i biri i Mahmudit, në vitin 1747 fitoi gradën Pashë dhe u emërua sanxhakbe i Prizrenit. Këtë pozitë e mbajti deri në vitin 1749/50. Pas tij sanxhekbej të Prizrenit patën ardhur të bijtë e tij, Emrullah Pasha (qe vrrarë nga Pashai i Shko-

⁶⁶ Zenbil-li Ali Efendi, respektivisht Ali Efendi Shporta, ka qenë njëri ndër shejhulislamët më të shquar të Perandorisë Osmane. Ka mendime se ka pasur prejardhje shqiptare. (Shih: Kultura Islame, Tiranë 1942 viti II, nr. 16, f. 90). Pozitën e shejhulislamit e ka mbajtur prej vitit 1503 e deri në vdekje më 1526. Gëzonte epitetin e njeriut të drejtë e të guximshëm, sa dhe u bë simbol i drejtësisë. Vepra e tij “Fetavi” konsiderohet nga më të arrirat në fushën e jurisprudencës islame. (Shih: Ismail Hami Danishmend, Izahli Osmanli Tarihi Kronolojisi: Osmanli Devlet Erkani, Istanbul: Turkiye yayinevi, 1971, f.111).

⁶⁷ Ali Emiri, Vep. e cit. f. 8; Sadettin Nüz’het Ergun, Vep. e cit. f. 97.

drës më 1774) dhe Ismail Pasha (sanxhakbeg i Prizrenit në vitet 1785/86). Këtë pozitë më pastaj e patën marrë të bijtë e Emrullah Pashës, Tahir Pasha (1794/95) dhe Rrustem Pasha (1800). Më vonë këtë pozitë e kishin arritur bijtë e Tahir Pashës, Said Pasha (1805-1815), Mahmud Pasha (1819-1836) dhe Emin Pasha, i cili qe emëruar për të dytën herë sanxhakbe i Prizrenit në vitin 1842 (vdiq më 1843)⁶⁸. Nga ndërtimet që kanë bërë ata, po veçojmë: Mahmud Pashë Rrotlla ka ndërtuar tri xhami në Prizren, njërën në Kala në vitin 1828, tjetrën në Bylbyl-dere dhe të tretën në Mahallën e Hoçës në vitin 1833. Mahmud Pasha ka ndërtuar po ashtu një medrese në vitin 1831, Kullën e sahatit në vitin 1816. Nga një kullë sahati ka ndërtuar në Rahovec (1791) dhe në Mamushë (1815).

Dera fisnike e Mahmut-begollëve të Pejës, po ashtu e ka ndihmuar zhvillimin kulturor të Pejës dhe të sanxhakut të Dukagjinit. Shumica dërrmuese e objekteve fetare dhe kulturore-arsimore në Pejë, janë ndërtuar dhe janë vakufuar prej tyre. Kjo derë ka dhënë mbi 20 Pashallarë, ndër ta edhe kryeministrin Merre Hysjn Pasha, i cili në pozitën e kryeministrit të Perandorisë Osmane ka ardhur dy herë gjatë viteve 1622-1623. Merre Hysejn Pasha në Pejë ka ndërtuar Xhaminë e Plumbit, një hamam dhe një han. Medreseja e Vjetër dhe Biblioteka e Vjetër janë ndërtuar nga pjesëtarë të kësaj familjeje fisnike. Kara Hysejn Pasha, i biri Mahmud Pashës, ka ndërtuar një xhami në Pejë. Ahraman Pasha ka ndërtuar një shkollë (mejtep). Edhe bijtë e Numan Pashës (vd. 1813), Abdurezak Pasha dhe Asllan Pasha kanë ndërtuar nga një xhami në Pejë. Abdurezak Pasha ka ndërtuar Xhaminë e Puhovcit, kurse Asllan Pasha xhaminë në Pehlivan Mejdan (Fusha e Pehlivanëve). Ndër xhamitë më të vjetra në Pejë është Xhamia e Defterdarit e ndërtuar nga Defterdar haxhi Mehmet Efendiu, i biri i Musa Beut, i vdekur në vitin 1624 dhe i varrosur në një tyrbe të veçantë pranë kësaj xhamie pranë zonjës së tij Fatime, e bija e Daut Begut (vd. 1625). Mbishkrimet mbivarrorë të tyre janë ruajtur.

⁶⁸ Nehat Krasniqi: Kronika (Menakib) e Tahir efendiut, burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane. Në: Edukata Islame, nr.57, Prishtinë 1995.

Familja fisnike Gjinolli ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kulturës në Prishtinë. Jashar Pashë Gjinolli (vd. 1840), në vitin 1834 ka ndërtuar xhaminë ndër më të bukurat në Kosovë nga aspekti i dekorimeve. Dekori artistik i kësaj xhamie është i ngjashëm me atë të Haxhi Ed'hem Beut në Tiranë dhe të Xhamisë së Larme në Tetovë. Abdurrahman Pasha, i biri i Jashar Pashës, në vitin 1869 ka ndërtuar Ruzhdijen (gjimnazin e ulët). Pas djegies në vitin 1881 atë e kanë rindërtuar bijtë e Abdurrahman Pashës: Zija Bej Prishtina, Ali Danish Beu dhe Fuad Pasha. Kjo familje ka hapur një muze familjar, të cilin e drejtonte Fuad Pasha. Një medrese ka punuar në Prishtinë qysh nga koha e Sulltan Ahmedit III. Atë e ka ndërtuar Besharet Beu.

Një derë fisnike shqiptare që ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e kulturës shqiptare me frymë islame është ajo e Rexhep Pashë Tetovës. Ka qenë djali i një Dervish Shalës. Kjo familje fisnike, që nga fillimi i shek. 18-të ka ndihmuar kulturën dhe arsimin. Teqeja bektashiane e Harabati Babës në Tetovë është rindërtuar nga Koxha Rexhep Pasha në vitin 1780 kur edhe u gradua Pashë. Në këtë vit ai ka vendosur mbishkrimin mbivarror të Harabati Babës, kurse në vitin 1790 ka ndërtuar aty një krua. Abdurrahman Pasha i Rexhep Pashës ka bërë ndërtime e renovime të ndryshme në Tetovë. Ai ka financuar dekorimin artistik të Xhamisë së Larme, të ndërtuar nga Hysnije Hanëmi, e bija e një Pashai tetovar, mbase nga paraardhësit e Abdurrahman Pashës. Po ashtu ai ka rinovuar hamamin e ndërtuar nga Mensure Hanëmi. Kryevepër e Abdurrahman Pashës është Kalaja e Tetovës. Nga kjo derë fisnike kanë dalë shumë Pashallarë, por edhe poetë të njohur. Mehmet Akif Pasha (1822-1893), pastaj i biri tij, Salih Rashit Pasha (1846-1920), kanë lënë një krijimtari të begatë poetike. Abdurrahman Pashë Tetova së bashku me vëllezërit e vet mbante nën pushtetin e tij krahinën nga Prizreni deri në Shtip. Mori pjesë në Lëvizjen Kryengritëse të Pashallarëve Shqiptarë kundër pushtetit qendror Osman të viteve '30 të shek. 19-të. Në fillim të vitit 1834 Abdurrahman Pashë Tetova u thirr në Stamboll prej nga nuk u kthye më.

Sadriazami (kryeministri) i Perandorisë Osmane Jemishçi Hasan Pasha, i cili në këtë pozitë ka qëndruar gjatë viteve 1601-1603, në fsh-

atin Rogovë, ku u lind, ka ndërtuar një xhami dhe objekte tjera në vitin 1580. Hasan Pasha ka lënë vakufe edhe në Prizren dhe në Gjakovë.

Dera fisnike Skura e Beratit ka dhënë kontribut të çmuar në zhvillimet e kulturës në këtë qytet dhe më gjerë. Ahmed Bej Skura (Zgura) ka ndërtuar Xhaminë e Plumbit në vitin 1553 pranë sajë medresenë. Gazi Murad Pasha ka ndërtuar një xhami. Po ashtu edhe Hysen Pasha, nipi i Kara Murad Pashës në vitin 1670 ka ndërtuar një xhami në Berat⁶⁹. Medresenë më të madhe në Berat e kanë ndërtuar bashkëshortët Ajshe Kadën dhe Sali Beu në dekadat e fundit të shek.17-të.⁷⁰

Pashallarët e Beratit, veçanërisht Ismail Pashë Velabishti dhe Ahmed Kurd Pasha, e kanë ndihmuar jetën kulturore. Për të parin dihet se ka shkruar edhe poezi shqipe dhe se ka qenë mecen i Nezim Betatit, përfaqësuesi më të rëndësishëm të letërsisë shqipe alhamiado.

Dera fisnike Libohova, e njohur si Familja e Asllan Pashallinjve të Janinës, i ka kontribuar zhvillimit kulturor të vendit. Zylfikar Aga është ndërtuesi dhe vakufuesi i Bajrakli Xhamisë në mes të Pazarit të Janinës, para vitit 1583⁷¹. Asllan Pasha, sanxhakbe i Janinës, në vitin 1615 ndërtoi në Kalanë e Janinës xhaminë e tij madhështore⁷² Asllan Pasha II-të, i biri Mustafa Pashës dhe dhëndri i Mahmut Pashë Begollit të Pejës, ka ndërtuar pazarin e Janinës. Ai ka qeverisur në Janinë nga viti 1702 deri më 1740⁷³. Libohova nga fundi i shek. XVII mori tiparet e një qyteti.

Memi Pasha ka ndërtuar objekte të ndryshme dhe i ka vakufuar ato, në Delvinë, Kardhiq, Gjirokastër e gjetiu. Ai në Gjirokastër përveç xhamisë ka ndërtuar edhe medresenë e tij dhe një han. Ai po ashtu ka themeluar vakufe edhe në Peshkopi.

Është shumë me rëndësi të theksohet se edhe femrat shqiptare të dyerve fisnike kanë dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e kulturës gjatë periudhës osmane. Dervish Hatixhja nga Tirana ka një

⁶⁹ Ferid Duka: Berati në Kohën Osmane, Tiranë 2001, f. 182-184.

⁷⁰ Po aty, f. 192.

⁷¹ Ajet Libohova: Brezë e Libohovës në shekuj, Tiranë, 2003, f. 9.

⁷² Po aty, f. 12.

⁷³ Po aty, f. 29.

vend të veçantë në këtë drejtim. Ajo është gruaja e parë që krijoi poezi shqipe alhamiado⁷⁴. Po ashtu ajo ka ndërtuar një teqe ku më vonë u bë sheh i kësaj teqeje të tarikatit Kaderi. Zejnep Hanmi në Tiranë ka ndërtuar një xhami. Fatma Hanmi ka ndërtuar një faltore në një fshat të Beratit. Koxha Hanmi ka ndërtuar një xhami në Durrës. Ajshe Hatuna ka ndërtuar një mesxhid në Elbasan. Rabie Hatuna, e bija e Mustafa Efendiut ka ndërtuar një xhami dhe një zaviye në Elbasan. Po në Elbasan është e njohur Xhamia e Nazireshës. Hatixhe Hatuna ka ndërtuar një xhami në një lagje të Shkodrës, Hanife Hatuna po ashtu ka ndërtuar një mesxhid në Shkodër, Fatime Sherife Hanmi ka ndërtuar xhaminë e Qafës në Shkodër, të cilën pastaj dhëndri i saj, Mustafa Pashë Shkodra e ka meremetuar. Gylfem Hatuna ka ndërtuar një xhami në Pejë. Motrat Sofa dhe Hanka kanë ndërtuar nga një xhami në Gjakovë. Në Prishtinë, po ashtu, dy zonja kanë ndërtuar nga një xhami që njihen me emrat Xhamija Hatunije dhe Xhamija Kadrije. Shehzade Hanmi, e bija e Mehmet Tahir Pashë Rrotllës nga Prizreni, ka ndërtuar një xhami në Gjiilan në vitin 1835. Ajshe Kadën me bashkëshortin kanë ndërtuar Medresenë më të madhe të Beratit. Hysnije Hanmi ka ndërtuar xhaminë më të bukur në Tetovë. Ajshe Hatuna në vitin 1596 ka ndërtuar një Xhami në Tetovë. Po në Tetovë Mensure Hanmi ka ndërtuar një hamam.

⁷⁴ Një poezi të sajë e ka botuar për her të parë Kristo Frashëri në librin Historia e Tiranës, Vëll. I, Tiranë 2004.

Përfundim

Gjatë periudhës osmane në Shqipëri, fisnikëria shqiptare ka qenë shtysë e zhvillimeve kulturore. Ajo ka ndërtuar dhe ka vakufuar një varg medresesh, bibliotekash, xhamish e teqesh, si dhe një varg objektsh ekonomike tregtare e utilitare. Me të ardhurat që realizonin objektet ekonomike tregtare, mirëmbaheshin institucionet kulturore, arsimore e fetare dhe paguhej personeli që punonte në këto institucione. Të gjitha këto institucione e objekte të ndryshme, në këtë periudhë janë ngritur, fund e krye sipas sistemit të vakufit.

Si rrjedhojë e islamizimit më masiv të shqiptarëve në shek. 18-të kemi një zhvillim më intensiv të jetës kulturore në vend. Këtë e ka shoqëruar edhe përdorimi më dendur i gjuhës shqipe në jetën letrare e fetare, gjë që i ka dhënë një kualitet të ri jetës kulturore shqiptare. Roli i fisnikërisë shqiptare në këtë kohë merr peshë më të madhe dhe përmasa më të gjëra.

Rrjeti relativisht i gjerë i mektebeve që janë hapur madje edhe nëpër viset rurale me popullsi shqiptare myslimane, si dhe hapja e medreseve nëpër të gjitha qytetet dhe kasabatë e vendit, na çon te përfundimi se, arsimi dhe edukimi i komunitetit shqiptar të besimit islam, në këtë periudhë ka njohur një masivizim të lakmueshëm për rrethanat e atëhershme. Ky masivizim ka shkallëzuar sidomos në shekullin 18-të, në radhë të parë falë kontributit të fisnikërisë shqiptare në ndërtimin e institucioneve edukative e kulturore. Po ashtu, mbështetur në plan-programet mësimore të medreseve vendore, në këtë periudhë si dhe në nivelin mjaft të lartë profesional dhe intelektual të arsimtarëve (myderrizëve) që jepnin mësim në to, gjë që pasqyrohet në veprat e tyre të mbetura në dorëshkrime, vijmë te përfundimi se këto medrese kanë qenë fidanishte të inteligjencies fetare e akademike të kohës. Në këto medrese janë kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, fushash dhe disiplinash të ndryshme shkencore, letrare e fetare, të cilat presin të studiohen nga historianët, historianët e kulturës, linguistët, teologët dhe sidomos nga orientalistët. Nga koleksionet e ruajtura të

dorëshkrimeve, del se një pjesë e konsiderueshme e tyre është rezultat i punës intelektuale të fisnikërisë shqiptare, kurse një pjesë tjetër e rëndësishme e këtyre dorëshkrimeve kanë qenë pronë e kësaj fisnikërie.

Fisnikëria shqiptare, krahas pjesëmarrjes aktive në jetën politike dhe qeverisëse të vendit, në ç'drejtim gjithmonë ka pasur rol të veçantë që t'i sigurojë vendit rregullin, paqen, sigurinë dhe kështu të mbajë të zgjuar në popull ndjenjën për vetadministrim dhe besimin në forcat e veta, ajo po ashtu ka luajtur rolin kryesor në zhvillimin kulturor të vendit.

Gjatë tërë periudhës së sundimit osman, fisnikëria shqiptare, ka përkrahur bujarisht dijen dhe artin dhe ka kultivuar shijen e hollë për të bukurën dhe të madhërishten.

Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimet kulturore në vend gjatë periudhës osmane, do të duket më qartë pasi që të studiohet me kujdes trashëgimia dorëshkrimore në gjuhët orientale e krijuar nga shqiptarët, apo në trojet shqiptare, gjatë periudhës osmane dhe pasi që të studiohen dhe të publikohen vakufnamet si dokumentet më relevante për historinë e institucioneve kulturore, arsimore fetare e të tjera, gjatë kësaj periudhe. Fatkeqësisht, për realizimin e këtyre objektivave, institucionet tona edukative arsimore dhe shkencore janë shumë prapa si në krijimin e kuadrit aq të nevojshëm në fushën e filologjisë orientale, po ashtu edhe në hulumtimin, mbledhjen dhe ruajtjen e dokumenteve, respektivisht trashëgimisë dorëshkrimore në gjuhët orientale.

Nehat Krasniqi

**THE ROLE OF THE UPPER CLASSES IN THE
DEVELOPMENT OF ISLAMIC CULTURE AND
CIVILIZATION IN THE TERRITORIES INHABITED
BY ALBANIANS DURING THE OTTOMAN RULE**

(Summary)

The main reasons, which motivated me to deal with this topic, are as follows:

First: The upper classes played a very important role in the development of Islamic culture in the territories inhabited by Albanians during the Ottoman rule, that is until the end of the third decade of the XIX century (despite this, its importance has not been recognized).

Second: The lack of attention by scientific institutions towards the Albanian cultural heritage of an oriental spirit. Such an attitude has contributed to the impoverishment of part of our cultural heritage, which is of a special importance to a very large section of the Albanian nation. The marginalization of Albanian culture of an Islamic spirit has deprived a large number of people from their legal right to get to know it. At the very same time, it has damaged our national culture. This is due to the fact that without the acknowledgment of all its parts, the entirety cannot be acknowledged and vice-versa.

The third reason is that certain scientific circles continue to treat the Albanian cultural heritage (with an Islamic – oriental spirit) as Ottoman heritage.

نحات كراسنيشي

**دور العائلات الالبانية في تطوير الثقافة و الحضارة الاسلامية
بالاراضي الالبانية خلال حكم الدولة العثمانية
(خلاصة البحث)**

هناك اسباب ثلاثة جعلتني أتناول هذا الموضوع:

أولاً: ليس هناك أدنى شك بان العائلات الكبيرة الالبانية لعبت دورا مهما جدا في تنمية و تطوير الثقافة الالبانية بالاراضي الالبانية خلال كل حكم الدولة العثمانية أو بالاحص حتى نهاية العقد الثالث للقرن التاسع عشر، و لكن مع الاسف الشديد فإن هذا الدور لم يوضح بصورة جيدة في التاريخ.

ثانياً: موقف الامبلاة للمؤسسات العلمية الالبانية تجاه المؤسسات الاسلامية.

ثالثاً: هناك محاولات لدى بعض الجماعات العلمية الاجنبية للانتساب كل شئ يتعلق بالثقافة الاسلامية إلى عناصر تركية و عثمانية.

KUMTESË

Nexhat Ibrahim

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË FILOZOFIKE ISLAME NË MESJETË* (Burimet, prejardhja, karakteristikat dhe prapavija historike e zhvillimit të terminologjisë filozofike islame në Mesjetë)

“Evropianët, duke pasur mendime të prapambetura e të errëta për Kur’anin e Madhërisëm për një kohë të gjatë nuk e pranuan filozofinë islame, por kur i shfletuan veprat filozofike të myslimanëve dhe kur panë aty përparimet e mëdha të tyre në këtë fushë të dijes; kur panë se Kur’ani Kerim, që është një filozofi më vete, nuk e ndalon filozofinë, por përkundrazi, e urdhëron dhe e këshillon atë në çdo faqe të tij, e kuptuan dhe më në fund e pranuan të vërtetën.” Sami Frashëri.¹

I. Shqyrtime hyrëse

1. Trajtimi i lëndës me titullin e lartpërmendur është punë sa interesante dhe kureshtare, aq edhe e vështirë, delikate dhe komplekse. Kureshtja e temës konsiston në faktin se tema të hedhë nga bregu në

* Kumtesë e paraqitur në Tryezën Shkencore me titull “Terminologjia islame” të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë më 10 nëntor 2005.

¹ Sami Frashëri, Qytetërimi islam, vepra 13, Shkup, 2004, fq. 88.

breg, nga kultura në kulturë, të hedhë në horizonte të pakufishme të feve, kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme. Po ashtu, kureshtja dhe rëndësia e temës konsiston edhe në çështjen se terminologjia numërohet ndër elementet që lënë vragë më të thella në kulturat e popujve, sepse nëpërmjet saj përcaktohet edhe konceptimi edhe mënyra e të menduarit.²

Kurse vështirësia e temës konsiston në mosekzistimin e një pune paraprake në nënqiellin tonë, por as në botën myslimane. Vështirësi tjetër është joharmonizimi i terminologjisë filozofike islame të ne. Dallimet janë rezultat i ndikimit të traditave të ndryshme dhe i pikëpamjeve dhe prirjeve individuale, por edhe i mosnjohjes së problematikës, e jo rezultat i një pune të gjatë dhe sistematike hulumtuese-shkencore.

Për një punë të mirëfilltë shkencore-hulumtuese nevojiten shumë punë parapërgatitore, siç janë edhe këta punime dhe ky tubim dhe punë interdisiplinare të shumë studiuesve të kualifikuar.

2. Lënda e këtij punimi është **terminologjia mesjetare filozofike islame** dhe ka për qëllim hulumtimin e prejardhjes së terminologjisë filozofike dhe karakteristikat themelore në pika të përgjithshme, kryesisht nga pikëpamja e historisë së filozofisë mesjetare.³

Periodha në të cilën sajohet dhe formësohet terminologjia mesjetare filozofike islame, në shekullin IX dhe X, është arenë e fërkimeve dhe kontakteve dinamike e intensive e të dy kulturave dhe qytetërimeve, greko-bizantine dhe islame, por edhe e këmbimit dhe e përvetë-

² Muhammed Umhazun, Koncept izucavanja islamske historije, Sarajevë, 2000, fq. 77-80.

³ Një pjesë e traditës myslimane e ka refuzuar filozofinë si të huaj, joislame dhe madje antikur’anore dhe antisunnitike. Mendojmë se refuzimi i tillë nuk ka qenë i bazuar në frymën e mirëfilltë islame, por në momentet konkrete, të motivuara politikisht apo nga interesat e ngushta subjektive. Mendojmë se në këtë rast sinkretizmi është karakteristikë e islamit shpirtëror kundrejt traditave paraprake dhe paralele shpirtërore. Islami asnjë nga ato tradita nuk e ka refuzuar tërësisht, por as pranuar tërësisht. Prej tyre ka marrë vetëm atë që i ka shërbyer për ngritjen e identitetit vetjak, autonom dhe specifik. Filozofia nuk mund të vendoset mbi Shpalljen, as t’ia nënshtrojë Shpalljen kritereve specifike filozofike. Shih: Muhamed Mrahorovic, Filozofijska razmedja islamske duhovnosti, Sarajevë, 2001, fq. 222-223.

simit të trashëgimisë së tjetrit, jo vetëm filozofike, por edhe të tjera.⁴ Disa autorë pohojnë se kjo kohë karakterizohet me këmbim intensiv të ideve ndërmjet dijetarëve nga një anë dhe këmbimit e përshkrimit të librave ndërmjet bibliotekave dhe i përkthimit të tyre në gjuhë të ndryshme: induse, persiane, greke, latine, arameite, hebraike e të tjera në gjuhën arabe.⁵ Pa dyshim, periudha kohore dhe hapësira gjeografike e hulumtuar ofron material të pasur dhe të llojlojshëm kulturologjik, sociologjik, letrar-historik dhe psikologjik për hulumtim, por këtë radhë, për shkak të synimit të kufizuar të punimit, aspektet tjera do të mbesin jashtë shqyrtimeve tona.⁶

Duhet pranuar se, dekadave të fundit, në të gjitha gjuhët e rëndësishme evropiane janë bërë përpjekje dhe janë shkruar studime lidhur me emërtimet, terminologjinë filozofike islame.⁷ Në këtë rrafsh është punuar diç edhe në gjuhët më afër nesh, boshnjake-kroate-serbe, kurse emrat e Daniel Buçanit, Tarik Haveriqit, Enes Kariqit, Reshid Hafizovićit janë vetëm disa nga ata që kontribuuan në hyrje të shkencës së historisë së filozofisë islame dhe të terminologjisë së saj. Në gjuhën shqipe kjo punë pritet të bëhet. Puna e Sami Frashërit dhe të tjerëve më herët ende është e pastudiuar dhe nuk mund të flasim për një të kaluar në këtë pikëpamje.⁸

Gjatë studimit të kësaj teme duhet pasur parasysh se filozofia mesjetare ka pasur pozitë nënshtruese kundrejt teologjisë, andaj edhe shumë shprehje dhe koncepte filozofike duhet kuptuar në këtë frymë. Kjo gjendje ka qenë e shtrirë në Perëndim, por në masë të caktuar edhe në Lindjen islame. Shih: Salih H. Alic, *Arapsko-islamska filozofija*, definicija i znacaj u istoriji, në: *Prilozi za Orijentalnu Filologiju*, XXIV/1974, Sarajevë, 1976, fq. 109-111.

⁵ Ajatollah Misbah Yazdi, *Islamska filozofija*, 1, Sarajevë, 2004, fq. 17.

⁶ Një kontribut fillestar dhe konstruktiv në këtë pikëpamje e ka dhënë: Tarik Haveric, *Srednjovjekovno filozofijsko nazivlje u arapskom jeziku*, Sarajevë, 1990, fq. 7 e tutje.

⁷ Louis Massignon, Amelie-Marie Goichon, Ibrahim Madkur, Abdurrahman Badawi etj. kanë bërë një punë të madhe, natyrisht më tepër në relacionin latinisht - arabisht. Sipas: Tarik Haveric, op. cit., fq. 10.

⁸) Kontributi i akad. Ekrem Murtezait në aspektin e terminologjisë fetare dhe filozofike dhe të personaliteteve myslimane në kuadër të **Fjalorit filozofik** dhe **Fjalorit të feve**, ndonëse i përgjithësuar, meriton vëmendje shkencore. Shih: Ekrem Murtezai, *Fjalor i filozofisë*, Prishtinë, 1995 dhe *Fjalor i feve*, Prishtinë, 2000.

II. Burimet për hulumtimin e terminologjisë filozofike islame

Burimet më të rëndësishme për hulumtimin dhe studimin e terminologjisë mesjetare islame janë burimet islame: Kur'ani dhe Sunneti dhe burimet dytësore islame.⁹ Të ndikuar nga Kur'ani, arti dhe letërsia është pasuruar në masë të jashtëzakonshme.¹⁰ Përkthimi i veprave filozofike greke në gjuhën arabe¹¹ në rend të parë dhe i veprave burimore të filozofëve islamë dhe të fjalorëve mesjetarë arabë të terminologjisë profesionale në rend të dytë.¹²

1. Burimet islame

Burimet islame për hulumtimin e terminologjisë filozofike islame janë brenda Kur'anit dhe Hadithit dhe natyrës së tyre të hapur dhe konstruktive kundrejt vlerave njerëzore. Burim është edhe gjuha arabe e bazuar në Kur'an, e cila me kalimin e kohës mundësoi zhvillimin e shprehjeve shumë të pasura.¹³ Mirëpo, menjëherë pas vdekjes së

⁹) Është për keqardhje që filozofi boshnjak, T. Haveriq, (për shkak të bindjeve ateiste) në veprën e tij mjaft analitike, që në punimin tonë i referohemi më së tepërmi në shumë aspekte, injoron burimet islame (Kur'anin, Hadithin etj.) si burim të hulumtimeve të terminologjisë islame. Por, Salih H. Alic, filozof tjetër, pohon se “filozofia në islam ka pasur dy burime, nga të cilat më vonë ka zhvilluar dy drejtime shprehimisht tjetërfare të filozofimit” e ata janë: i pari “brenda vetë traditës islame fetare” dhe i dyti “trashëgimia filozofike greke.” Salih H. Alic, op. cit., fq. 112-114 dhe 115 e tutje.

Për burimet e medimit filozofik në islam lexo: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, *History of Islamic Philosophy*, part I, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 27-39. M. M. Sharif, *Historija Islamske Filozofije*, I, Zagreb, 1988, fq. 159 e tutje. Po ashtu: Henry Corbin, *Historia e filozofisë islame*, I-II, Shkup, 1997, fq. 13-32.

¹⁰ Shih gjerësisht: Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, *The Cultural Atlas of Islam*, New York & London, (1986 ?), fq. 342-353.

¹¹ Umer Ferruh thekson se përkthimet e para greke në gjuhën arabe i kemi shumë herët, madje qysh në kohën e Muaviut dhe Jezidit. Umer Ferruh, *Tarih'ul-fikri'il-arabijji ila ejjami Ibn Haldun*, botimi IV, Bejrut, 1983, fq. 271. Shih edhe faqet: 271-286.

¹² Si burime ndërmjetëse mes veprave burimore islame dhe të fjalorëve profesionalë arabë janë edhe veprat e tipit *Kitab'ul-hudud*. Sipas: Tarik Haveric, op. cit., fq. 13.

¹³ Seyyed Hossein Nasr, *The Qur'an and hadith as source and inspiration of Islamic philosophy* në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, *History of Islamic Philosophy*, part I, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 27e tutje. Krhs.: Teufik Muftic, *Gramatika arapskoga jezika*, Sarajevë, 1998, fq. 19 e tutje. Teufik Muftic, *Klasicna arapska stilistika*, Sarajevë, 1995, fq. 11.

Muhammedit a. s. filluan të formohen shkollat, drejtimet, sektet e shumta teologjike, juridike dhe më vonë edhe filozofike. Synimi dhe dëshira që secila në mënyrën e vet të përpiqet t'i arsyetojë pikëpamjet dhe shikimet mbi rregullimin e raporteve të njeriut me Krijuesin, vetveten dhe rrethin ku jeton, ndikoi të krijohen pikëpamje dhe teori të ndryshme, e krahas kësaj edhe terminologji të shumtë, të pasur dhe interesante për historinë e leksikografisë, të teologjisë dhe të jurisprudencës¹⁴, që do të ekzistojë deri në ditët e sotme.

2. Përkthimet e veprave filozofike greke në gjuhën arabe

Interesimi më sistematik dhe më shkencor për filozofinë islame nga perëndimorët u paraqit pas shekullit XVIII.¹⁵ Filloi interesimi për përkthimet arabe e jo për përkthimet latine të përkthimeve arabe. Por vetëm pas Luftës së Dytë Botërore filloi studimi dhe botimi sistematik dhe metodik i përkthimeve arabe të veprave të filozofëve grekë. Sigurisht se merita kryesore i takon egjiptianit Abdurrahman Bedeviut, i cili botoi edhe tekstet e Platinit dhe të neoplatonistëve.¹⁶

Rëndësia e këtyre burimeve është e padiskutueshme, sepse drejtpërdrejt njoftohemi me mënyrën e përkthimit të teksteve dhe të terminologjisë filozofike dhe të tjera.¹⁷

¹⁴ Një pasqyrë të shkëlqyeshme të periudhës së hershme të shkollave dhe sekteve mund ta gjejmë te: El-Imam Ebi'l-Hasan Alij ibn Ismail El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin ve ihtilaf'il-musal-lin, botimi III, Wiesbaden, 1980. Në gjuhët evropiane lexo: Henri Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989. Për ndikimin reciprok të akaidit dhe gjuhës shih: Teufik Muftic, Klasicna arapska stilistika, op. cit., fq. 13.

¹⁵ Orientalisti serb Rade Bozhoviq mendon se interesimi për gjuhën arabe në Evropë është paraqitur "qysh në mesjetën e hershme, por arabistika, si disiplinë shkencore në kuadër të orientalistikës, themelohet nëpërmjet shkollës holandeze të semiologëve në shek. XVII dhe XVIII." Sipas: Rade Bozovic, Udzbenik arapskog jezika sa vjezbankom i rjecnikom, Botimi I, Sarajevë, 1984, fq. 9.

¹⁶ Për këtë problematikë lexo: Tarik Haveric, op. cit., fq. 14. Ibrahim Madkur, Fi'l-fel-sefet'il-islamijeh, II, pa vit dhe vend botimi, fq. 164 e tutje.

¹⁷ Motivi i dijetarëve myslimanë të përkthejnë filozofinë greke ishte i qartë. Fjalët e El-Kindiut njoftojnë qartë: "Në citate të plota të tubohet çdo gjë që të lashtit (dmth. grekët) kanë thenë për sendin (objektin) dhe të plotësohet ajo që të lashtit nuk e kanë shprehur mjaft, dhe këtë me mjetet e gjuhës sonë arabe dhe sipas traditave të kohës sonë dhe sipas aftësisë sonë vetjake." Walzer, Greek into Arabic, fq. 13, në: Salih H. Alic, op. cit., fq. 115.

3. Veprat burimore të filozofëve islamë

Nëse ndjekim rrjedhën kronologjike, **veprat burimore të filozofëve islamikë** janë të rendit të dytë. Numri i përkthyesve në fund të shekullit VIII filloi të rritej, për të gjetur kurorë me El-Kindiun (801-865), pastaj me El-Farabiun (870-950), Ibn Sinain 950-1036), Ibn Baxhën (?-1138), Ibn Tufejljin (?-1185), Ibn Rushdin (1126-1198) etj. Mirëpo, burimet arabe nga përkthimet greke janë bërë të njohura shumë vonë; kanë filluar në shekullin XIX kurse shumica janë bërë në shekullin XX, me përjashtime të vogla. Meritën kryesore e kanë F. Dieterici (vd. 1903), M. Bouyges (vd. 1945), por edhe L. Gauthier, P. Kraus etj.¹⁸

Këta filozofë që lindën dhe u rritën në korrelacion me filozofinë greke quhen filozofë të frymëzuar helenistë. Kështu i ka quajtur edhe H. Corbin.¹⁹

Kemi edhe një grup tjetër të filozofëve të cilët kanë hartuar vepra të llojit të leksikonëve, Kitab'ul-hudud, me të cilët janë përpjekur t'i përcaktojnë kuptimet e shprehjeve të caktuara. Edhe këtu El-Kindiu dhe Ibn Sinai janë të shkëlqyeshëm.²⁰ Njëherësh këto vepra janë hyrje në veprat e specializuara, në fjalorët e mirëfilltë të filozofisë dhe diturive të tjera.

4. Fjalorët mesjetarë arabë të terminologjisë profesionale

Fjalorin e parë sistematik mbi terminologjinë profesionale arabe e kemi nga Ebu Abdullah Muhammed El-Hawarizmi (nga shekulli X). Vepra e tij Mefatih'ul-ulum. Ky fjalor përfshin fjalët nga të gjitha dituritë e asaj kohe dhe ka shërbyer deri në shekullin XIX.

Fjalori vijues me rëndësi është ai i Mir Sejjid Sherif Xhurxhanit (1339-1413), me emrin Kitab'ut-ta'rifat (Libri i njësive), i cili "është

¹⁸ Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002, fq. 38-58. Tarik Haveric, op. cit., fq. 14-15 dhe fusnotat: 9, 10, 11, 12.

¹⁹ Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, I-II, Shkup, 1997, fq. 167 e tutje. Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987, fq. 120-130.

²⁰ Tarik Haveric, op. cit., fq. 15.

fillesë e fjalorit të ardhshëm të madh të emërtimeve teknike të filozofëve të shprehjes gjuhësore arabe.”²¹ Për shumë kohë ky fjalor do të shërbejë si strumbullar.

Mirëpo, fjalori që do të jetë kurorë e fjalorëve është ai i Alij ibn Alij Et-Tahaneviut (vd. 1745), nga India, Keshshaf istilahat ‘ul-ulum we’l-funun, i cili ndonëse me kohë është i Kohës së re (në Kalkutë, më 1861), me frymë është mesjetar dhe sigurisht njëri prej fjalorëve më gjithëpërfshirës me shprehje teknike.²²

Ndër fjalorët filozofikë modernë të koncipuar është ai i Xhemil Salibas, me titull El-Mu’xhem’ul-felsefij, i cili ka mangësitë dhe përparësitë: mangësitë konsistojnë sepse ky fjalor është më i varfër sa i përket terminologjisë së vjetër dhe nuk përmban shpjegime të hollësishme, kurse përparësitë konsistojnë në faktin se shpjegimet e terminologjisë filozofike të kohës së re janë të plota dhe të hollësishme.²³

Si burime parësore për studimin dhe hulumtimin e prapavijës historike të krijimit të terminologjisë filozofike islame, të kontakteve të para të qytetërimit islam dhe bizantin, të njohjes së historikut të lëvizjeve të përkthyesve, analet e jetës dhe veprës së përkthyesve, janë të pakalueshëm edhe fjalorët biografikë dhe bibliografikë dhe shënimet e tyre të pasura.

Ndër fjalorët e këtyllë në vend të parë duhet theksuar veprën **El-Fihrist** të Ibn Is’hak En-Nedimit (shek. X) nga Bagdadi²⁴, veprën **Ujun’ul-enba’i fi tabekat’il-etibba`** të mjekut Ebu’l-Abbas Ahmed Ibn Ebi Usajbia (shek. XIII), **Tarih’ul-hukama** e Zavzaniut etj.²⁵ Por, vepra më vëllimore është **Keshf’udh-dhunun** të poligrafit-poli-historit turk Haxhi Halife me nofkën Katib Çelebiu (1609-1657).²⁶

²¹ Henry Corbin, Historia, op. cit., fq. 303. Shih: Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?), fq. 239.

²² Ibid, op. cit., fq. 284. Shih: I.R. al-Faruqi and L.L. al-Faruqi, The Cultural, op. cit. fq. 239.

²³ Xhemil Saliba, El-Mu’xhem’ul-felsefijji bi’l-elfadh’il-arabijjeti we’l-frensijjeti we’l-inklizijjeti we’l-latinijeh, I-II, Bejrut, 11414 h./1994, fq. 17.

²⁴ F. E. Peters, The Greek and Syriac background, në: S. H. Nasr – O. Leaman, op. cit., pp. 41-43.

²⁵ Shih: Tarik Haverić, op. cit., fq. 18.

²⁶ Shih: Tarik Haverić, op. cit., fq. 18. Nerkez Smailagic, Leksikon, op. cit., fq. 227-228.

Burimet dytësore për studimin dhe hulumtimin e prapavijës historike të krijimit të terminologjisë filozofike islame janë përkthimet më të hershme të veprave filozofike islame në gjuhën latine dhe të tjera, të cilat ndonjëherë janë përcjellë me fjalorë profesionalë dy-tre gjuhësorë dhe studimet e specializuara të filozofëve, orientalistëve dhe historianëve të filozofisë islame.

Në pamundësi që ta ndjekim historinë e përkthimit të veprave filozofike islame, sepse kjo detyrë do t’i kapërcente mundësitë tona intelektuale por edhe materiale, kohore dhe hapësinore, do të theksojmë se **Miguel Asin Palasiosi**, pastaj **Enciklopedia islame** nga evropianët (sidomos botimi II), **Amelie-Marie Goichon** etj., kanë dhënë kontribut të madh. Por, punën më gjithëpërfshirëse e ka bërë **Suheil M. Afnan**, në veprën tashmë shumë herë të përmendur “Philosophical lexicon in Persian and Arabic”, “Philosophical terminology in arabic and persian” etj..²⁷ Me rëndësi është edhe puna e **Abdurrahman Bedeviut**²⁸ dhe e **Ahmed Eminiut**²⁹

III. Prejardhja e terminologjisë filozofike islame

Letërsia e vjetër dhe shkrime të caktuara të asaj kohe i kanë ndihmuar përkthyesve dhe filozofëve si model në punën e tyre të përkthimit dhe shkrimit. Mirëpo, llojllojshmëria e ndikimeve letrare-historike qartë tregon se nuk mund të flitet për një ndikim, respektivisht për një prejardhje unike³⁰, por për një vistër prejardhjesh. Ndërkaq, Suheil M. Afnan, terminologjinë filozofike islame e lidh me zhvillimin e prozës paraislamike arabe, e cila sot thuajse nuk ekziston dhe në pjesë të

²⁷ Shih: Tarik Haverić, op. cit., fq. 21-22.

²⁸ Abdurrahman Bedevi, La transmission de la philosophie greeque au monde arabe, Paris, 1968, dhe Abdurrahman Bedevi, Eflatun fi’l-islam, bot. III, Bejrut, 1402 h./1982 etj. Shih edhe: Tarik Haverić, op. cit., fq. 24.

²⁹ Ahmed Emin, Duh’al-islam, I, botimi X, Kairo, 1984, fq. 253-288.

Për lexuesin shqiptar kanë rëndësi edhe veprat: Ahmed Fuad El-Ehwani, Filzofia islame, Prizren, 2002 dhe Henry Corbin, Historia e filozofise islame, I-II, Shkup, 1997, të cilat sjellin të dhëna të shumta për historinë e përkthimeve dhe informacione të tjera.

³⁰ Sipas: Tarik Haverić, op. cit., fq. 25.

caktuara të Kur'anit, aty ku është i theksuar sexh'i, apo proza e rimuar.³¹

Shuheil M. Afnan dhe shkencëtarë të tjerë, dallojnë tri lloj veprash prozaike që u krijuan në dekadat e para të islamit, dhe të cilat më tepër do t'u shërbejnë përkthyesve të veprave greke si model në aspekt të stilit sesa të terminologjisë³²:

Proza religjioze

Prozë religjioze quhet çdo formë letrare e lidhur me jetën religjioze, në rend të parë shkrimet mistike, por edhe fjalimet e liderëve të parë myslimanë, të cilët kryesisht janë të lidhur ngushtë me pejgamberinë islame.³³

Letërsia mu'tezilite

Letërsia mu'tezilite qëndron ndërmjet prozës religjioze dhe asaj profane. Zhvillohet në fillim të shekullit VIII. Mu'tezilitët kishin zhvilluar gjuhë profesionale të teologjisë, por kanë përdorur edhe disa shprehje filozofike. Herë-herë është vështirë të dallohet a është shprehja e caktuar nga mu'tezilitët apo edhe ata e kanë përvetësuar nga të tjerët.³⁴

³¹ Studiuesit e semantikës së Kur'anit e të tefsirit, nuk janë unanimë rreth çështjes se a ekziston sexh'i – proza e rimuar në Kur'an. Gjerësisht: Dzermaludin Latic, Stil kur'anskog izraza, Sarajevë, 2001, fq. 118 e tutje.

³² Soheil M. Afnan, Philosophical Terminology in Arabic and Persian. Leiden: E. J. Brill, 1964, pp. 13, sipas: Tarik Haverić, op. cit., fq. 25.

³³ Shembull të tillë kemi **Nehxh'ul-belagah** të Aliut r. a. etj.

³⁴ Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, op. cit., fq. 107-142. Krhs.: Muhammed Iqbal, Razvoj metafizike u persiji: Prilog historiji muslimanske filozofije, Sarajevë, 2005, fq. 43 e tutje, ose: Muhammad Iqbal, The Development of Metaphysics in Persia – A Contribution of Muslim Philosophy, Sarajevë, 2005, pp. 43.

Letërsia profane

Mendohet se kjo letërsi është krijuar për herë të parë në periudhën e vonshme emevite.³⁵ Në këtë trajtë numërohet letërsia epistolare, ajo e oborrit mbretëror dhe letërsia artistike.

a.) Letërsia epistolare

Letërsia epistolare, kitaba, u sajua në zyrat e pallatit, kurse është motivuar me nevojën befaz të rritur që në territoret e reja të qeveriset administrativisht.³⁶ Në zyra janë të njohura me emrin persik divan.³⁷ Kjo shtresë, shpesh me prejardhje joarabe, i udhëhiqnin punët sipas shembullit të zyrës sasanidase. Themelues i këtij zhanri mendohet të jetë Abdulhamidi, sekretar i halifit të fundit emevit, Mervanit II. Fjalori i letërsisë arabe epistolare të periudhës së vonshme emevite ka përfshirë edhe shumë shprehje të cilat më vonë do të gjejnë vend në prozës filozofike.³⁸

b.) Letërsia e pallatit mbretëror

Në këtë prozë bëjnë pjesë trajtesat mbi detyrimet e sunduesve, këshillat për sundim të mirë dhe veprat e udhëpërshkruesve iranianë për ngadhënjimet e sunduesve të tyre. Ky lloj krijimi megjithatë shkëput lodhjet me kasiden arabe dhe zhvillon traditën e vet, me stil më të rrjedhshëm e më subtil, dhe me karakter didaktik dhe ceremonial.³⁹ Këto vepra i siguronin, i përkthenin nga pahlevishtja, i kompilonin dhe i përshtatnin autorët-shkruesit e caktuar. Ndër më të njohurit në këtë aspekt kemi Ibn Mukaffen (720-756).⁴⁰

³⁵ Për këtë periudhë shih: Vojislav Simic, Arapska knjizevnost umejadskog perioda, në: Mogucnost – knjizevnost, umjetnost, kulturni problemi, nr. 8-9/1979, Split, fq. 891-925.

³⁶ Edhe pse shprehja **kitab** shpesh lajmërohet në Kur'an në kuptime të ndryshme, kuptimi parësor është për Librin e shenjtë, Kur'anin. Por, shprehja **kitab** ka edhe kuptimin e letërsisë së rëndomtë, ose të lajmërimit, kumtesës, që i dërgohet një personi që gjendet larg. Shih: Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarajevë, 1990, fq. 330.

³⁷ Për kuptimet e shumta të shprehjes **divan** në rrafshin teorik dhe praktik, historik lexo: Nerkez Smailagic, Leksikon islama, op. cit., fq. 126-132.

³⁸ Shih gjerësisht: Tarik Haverić, op. cit., fq. 47-49.

³⁹ Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, II, Zagreb, 1976, fq. 101-102.

⁴⁰ Persian, ndër krijuesit e parë të prozës artistike arabe, dhe njëri ndër përkthyesit e parë nga indishtja dhe persishtja në arabishte. Sipas: Mogucnost op. cit., fq. 1124. Krhs.: Tarik Haverić, op. cit., fq. 26.

c.) Letërsia artistike apo letërsia e bukur

Letërsia artistike apo letërsia e bukur është ajo letërsi me vlera të pastra letrare, synimi i së cilës është më tepër të argëtojë se sa të këshillojë, mësojë. Edhe në këtë zhanër kryesor është emri i Ibn Mukaffes.⁴¹

Përkundër vërejtjeve rreth ndarjes së saktë të zhanreve në aspektin letrar, këto gjini letrare kanë rëndësi parësore në aspekt zhvillimit të leksikut përgjithësisht dhe terminologjisë filozofike islame në veçanti.⁴²

IV. Karakteristikat e terminologjisë filozofike islame

Në pikëpamje të zanafillës, sajimit, lindjes së terminologjisë, kemi disa grupime kryesore shprehjesh:

1. Fjalët greke janë përkthyer në gjuhën siriane-arabe me sukses relativ. Por, kur nuk mund të gjendej shprehje përkatëse, transliterohej fjala greke, duke e ruajtur shqiptimin e fjalës greke aq sa është e mundur. Ndonjë shprehje greke është transliteruar nga sirianishtja dhe shpesh nuk mund të identifikohet se është me prejardhje greke, sepse së pari sirianët e pastaj edhe arabët e kanë përshtatur për nevojat e fonetikës së tyre. Transliterimi ka vazhduar edhe atëherë kur sirianishtja nuk shërbente si gjuhë ndërmjetëse, por e drejtpërdrejtë për përkthime, në fillim të shekullit IX.⁴³ Edhe Ç. Veljaçiq mendon se sirianishtja ka qenë gjuhë shtyllë ndërmjet gjuhës greke dhe arabe.⁴⁴ Do të cekim disa shembuj:

Fjala greke

stoicheion ka dhënë fjalën arabisht **ustuqus > element;**

aithér > atir;

philosophia > filozofi; philosophos > feylesuf > filozof;

⁴¹ Sipas: Mogucnost, op. cit., fq. 1124. Krhs.: Tarik Haverić, op. cit., fq. 26-27.

⁴² Shih për periudhën abasite: Aisa Djulizarevic-Simic, Arapska knjizevnost abasidskog perioda, në: Mogucnost, op. cit., fq. 926-1013.

⁴³ F. E. Peters mendon se greqishtja dhe sirianishtja kanë qenë ndërmjetëse të filozofisë islame në Mesjetë, pra edhe të terminologjisë. Shih: F. E. Peters, The Greek and Siriac background, në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, History of Islamic Philosophy, part I-II, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 40-51.

⁴⁴ Cedomil Veljačić, Razmedja azijskih filozofija, II, Zagreb, 1978, fq. 317 e tutje.

hylé > hayula > send, gjë;

nómos > namus.

Disa fjalë si **arimetika** (aritmatiqi) dhe **gjeometria** (xhumatriya) fillimisht janë përdorur në origjinal e më vonë këto shprehje janë zëvendësuar me shprehje nga gjuha arabe, si **hisab** dhe **ilm'ul-hende-se**.⁴⁵

Pasi që përkthimet e para në gjuhën arabe janë bërë nga sirianishtja dhe greqishtja pa ndërmjetësimin e gjuhës latine, fjalët me prejardhje latine, nuk kanë vend në literaturën e asaj kohe.⁴⁶ Hana Fahuri dhe Halil Xherr shtrojnë dhe provojnë gjerësisht se sirianishtja ishte gjuha nga e cila fillimisht përkthehej trashëgimia greke. Nerkez Smailagiq pohon se rol të veçantë në transmetimin dhe absorbimin e trashëgimisë greke të myslimanët kanë zonat lindore (Mezopotamia, Siria, Persia) dhe sidomos sektet kristiane siriano-persiane e nestorianëve dhe monofizitëve.⁴⁷ Vetëm pastaj filluan përkthimet e drejtpërdrejta nga gjuha greke në gjuhën arabe.⁴⁸ Përkthyesit bashkëkohorë medemos duhet ta kenë parasysh këtë fakt në përkthimet kritike të veprave burimore islame.

2. Vetëm disa fjalë janë huazuar nga gjuhët tjera dhe janë arabizuar (nga aspekti i fonetikës), e ndonjëherë këto fjalë janë lënë në trajtën origjinale. Fjala siriane **mîmar** (predikim, homili, shqyrtim, trajtim), në fillim ishte ruajtur sipas origjinalit, por më vonë ka marrë trajtën **maymar**.

⁴⁵ Tarik Haverić, op. cit., fq. 29 dhe 59-105.

⁴⁶ Daniel Bucan, në: Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, 1988, fq. LX.

⁴⁷ Këto sekte pas ikjeve nga Greqia dhe vendet përreth u vendosen në këto zona dhe vazhduan ta kultivojnë filozofinë greke. Shih: Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, I, Zagreb, 1973, fq. 83-84.

Syed Nomanul Haq mendon se edhe hindishtja dhe persishtja, nëpërmjet sirianishtes, kanë rol të konsiderueshëm në sajimin e terminologjisë filozofike islame. Gjerësisht: Syed N. Haq, The Indian and Persian background, në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, op. cit., fq. 52-68.

⁴⁸ Hana El-Fahuri – Halil El-Xherr, Tarih'ul-felsefet'il-arabijeh, II, botimi II, Bejrut, 1993, fq. 19 e tutje.

Për ndikimin e filozofisë greke në botën islame shih gjerësisht: Yegane Shayegan, The transmission of Greek philosophy to the Islamic world, në: S. H. Nasr – O. Leaman, op. cit., fq. 89-104.

Fjala iraniane **göwhar** në arabishte është bërë **xhawhar** (qenësi, rrojtje, substancë, esencë, thelb). Me këtë shprehje është përkthyer fjala greke **usía**.⁴⁹

3. Shumë fjalë nga gjuha klasike arabe, qoftë në poezinë parakur'anore, qoftë nga Kur'ani, marrin kuptime të reja dhe në këtë mënyrë bëjnë jetë të dyfishtë: ruajnë kuptimet e deriatëhershme, por edhe paraqiten në tekste jofilozofike. P. sh.

- Fjala **idafetu** (shtojcë, aneks) do ta përkthejë fjalën e Aristotelit **prós ti**, dhe do të ketë kuptimin: raport, marrëdhënie, relacion, sikurse edhe në gramatikë që ka kuptimin e lidhjes gjenitive.

- Fjala **tabkit**: qortim, vërejtje, sharje, ka përkthyer fjalën greke **élgchos**, dhe nga atëherë si shprehje profesionale ka kuptimin edhe përgënjeshtër, refuzim.

- Fjala **nefs** e arabishtes është përkthyer me fjalën greke **psyche**, kurse fjala **ruh** me fjalën **pneûma**, pa ndryshuar kuptimin.⁵⁰

4. Ky grup është më i vëllimshmi dhe përbëhet nga neologjizmat, togfjalëshat të "farkuar nga rrënjët burimore të gjuhëve në pajtim me rregullat e morfologjisë gramatikore"⁵¹ Këto togfjalësha i kanë sajuar përkthyesit dhe vetë filozofët deri në ditët tona. Mendohet se kësaj i ka ndihmuar edhe dominimi i shkollës nga Basra, e cila me metodat e saj preskriptive (mundi shkollën deskriptive të Kufes) ishte e gatshme të absorbojë nocione të reja.⁵²

Autorët theksojnë se gjuha arabe është mjaft e pasur me shprehje për **konkretin**, por jo aq edhe për **abstrakten**, por nga aspekti morfologjik, ky problem është kapërcyer duke shtuar prapashtesën **-ijje** - : p.sh.: **insan** (njeriu) > **insanijeh** (njerëzorja, humanitas) etj.⁵³ Dijetarët mendojnë se gjuha arabe me dy poet e saj, të kultivuara në mode-

⁴⁹ Tarik Haverić, op. cit., fq. 29.

⁵⁰ Tarik Haverić, op. cit., fq. 30.

⁵¹ Soheil M. Afnan, op. cit., fq. 27.

⁵² Për ekspertët rekomandojmë leximin: A. M. Goichon, La philosophie d'Avicenne, Paris, 1979, fq. 59, sipas: Tarik Haverić, op. cit., fq. 30-31 dhe: Louis Massignon, Reflexion sur la structure primitive de l'analyse grammaticale en arabe, Arabica, 1954, fq. 3, sipas: Tarik Haverić, op. cit., fq. 32.

⁵³ Sipas: Tarik Haverić, op. cit., fq. 33-34.

lin e Shpalljes, me shkollën e saj për konkretin në Kufe, duke poseduar në këtë mënyrë karakterin figurativ dhe empirik, dhe me shkollën e saj për abstrakten në Basra, e frymëzuar me konceptimin parimor dhe teorik, me prirje kah teologjika, shkencorja dhe filozofikja, është e denjë për realizime të pashembullta.⁵⁴

Mund të konstatohet se fjalët e huaja të futura në përdorim në gjuhën arabe ndahen në dy grupe:

1) Fjalët e arabizuara (mu'arrab), ku bëjnë pjesë fjalët e transliteruara greke ose nga gjuhët tjera, në trajtën e tyre burimore ose të përshtatura⁵⁵ dhe

2) Fjalët e porsasajuara (muwal-lad), ku bëjnë pjesë "shprehjet të cilat i kanë përdorur sajuesit e fjalëve (al-muwal-lidun) dhe atë tjetërfare, sesa që i kanë përdorur arabët. Brenda këtij grupi kemi edhe dy nëngrupe:

- a) Fjalët që i janë përshtatur rregullave të gjuhës arabe dhe
- b) Ato që nuk i janë përshtatur rregullave të gjuhës arabe.⁵⁶

V. Prapavija historike e sajimit të terminologjisë filozofike islame

Një shekull pas vdekjes së Muhamedit a.s., më 632 e.r., shteti islam shtrihej në hapësirat, në të cilat në të kaluarën janë krijuar, janë zhvilluar dhe janë shkatërruar gati të gjitha kulturat dhe qytetërimet e Kohës së vjetër. Në horizontet e kësaj hapësire gjeografike kemi edhe dy religjione të mëdha monoteiste, judaizmin dhe krishterimin.⁵⁷

⁵⁴ Sipas: Frithjof Schuon, Dimenzije islame, Sarajevë, 1996, fq. 28. Shih edhe fq. 28-45.

⁵⁵ Shaikh Husain Wali, Comptes Rendus de l'Acad. Royale de la Langue Arabe, vol. 1-2.1934-1935, fq. 348, sipas: S. M. Afnan, op. cit., fq. 28.

⁵⁶ Shaikh Husain Wali, Comptes Rendus de l'Acad. Royale de la Langue Arabe, vol. 1-2.1934-1935, fq. 348, sipas: S. M. Afnan, op. cit., fq. 28. Krhs.: Teufik Muftic, Gramatika arapskoga jezika, Sarajevë, 1998, fq. 12-13.

Është e nevojshme të lexohet parathënia e Xhemil Salibes rreth formimit dhe sistemit të terminologjisë në fjalorin e tij: Xhemil Saliba, El-Mu'xhem'ul-felsefijj, I, Bejrut, 1414 h./1994, fq. 7-21.

⁵⁷ Për prapavinë historike të zhvillimit të marrëdhënieve islame dhe të tjerët, rekomandojmë leximin e: Hisam Dzait, Evropa i islam, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989.

Pushtimi ushtarak tërheq me vete, rëndom, përpjekjen që të konstituohet edhe dominimi ideologjik dhe kulturor. Kjo edhe u arrit, Islamin e pranuan edhe hebraikët dhe të krishterët, edhe persianët edhe hindusët, edhe sirianët edhe egjiptianët ... Por, ata që dëshiruan të mbesin në besimin e vjetër, këtë mund ta bënin, duke iu falënderuar tolerancës dhe maturisë islame.⁵⁸ Këtë proces F. Hiti e përshkruan: “Posa persianët, sirianët, kobtët, berberët dhe të tjerët në grupe e përqafonin islamin dhe filluan me arabët të lidhin martesë, u rrënuan muri i lartë fillestar i cili më herët i ka ndarë arabët nga popujt tjerë joarabë. ...Prej tash arab quhej çdonjëri që predikonte islamin dhe kush fliste dhe shkruante arabishten, pa marrë parasysh prejardhjen e tij racore.” “Prandaj, kur flasim për medicinën ose për filozofinë arabe ose për matematikën arabe, nuk mendojmë me këtë se shkencat medicinale, filozofia dhe matematika domosdo janë prodhime të frymës arabe ose këto janë prodhime që i ka zhvilluar populli që jeton në siudhësën arabe, porse ky është thesar të cilin në tërësi e kanë depozituar në libra në gjuhën arabe njerëzit të cilët kryesisht kanë jetuar në periudhën e halifatit dhe vetë ishin persianë, sirianë, egjiptianë apo arabë, të krishterë judaistë dhe myslimanë, dhe të cilët lëndën për librat e tyre kanë mundur ta marrin nga burimet greke, arameite, indo-persiane dhe të tjera.”⁵⁹

Mungesa e një gjuhe unike dhe mungesa e terminologjisë profesionale në mesin e përkthyesve dhe ndarjet në aspekt të parimeve filozofike lindore dhe perëndimore filozofinë, por edhe shkencat tjera, i bërën të vështira për t’u studiuar dhe kuptuar, por ardhja e gjenive sikurse El-Kindiut, Farabiut, Ibn Sinait, Ibn Rushdit dhe të tjerëve, bëri që e kaluara të kuptohet, të zhvillohet, të krijohet filozofi e re dhe të transmetohet më tej.⁶⁰ Punës së këtyre gjenive iu ka ndihmuar edhe

⁵⁸ T. Haveriq kritikon bindjen se muslimanët kanë qenë absolutisht tolerantë. Ai mendon se kjo bindje është shprehur në mënyrë jokritike. Mirëpo, T. Haveriq mendon se dekadat e para të shtetit islam janë të pashembullta në histori. Në: Tarik Haverić, op. cit., fq. 37.

⁵⁹ Filip Hiti, Istorija arapa od najstarijih vremena do danas, Sarajevë, botimi II fototip, 1988, fq. 228.

⁶⁰ Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002, fq. 38-58; Ajatollah Misbah Yazdi, Islamska filozofija, 1, Sarajevë, 2004, fq. 17.

natyra e gjuhës arabe, e cila si gjuhë konsonantesh dhe foljore, është mjaft e përshtatshme t’i shprehë “gjendjet shpirtërore” dinamike, në lëvizje.⁶¹

Kjo në pika të shkurtra do të ishte gjendja shpirtërore e hapësirave dhe kohëve të trajtuara me këtë rast, që drejtpërdrejt ka ndikuar në zhvillimin fetar, kulturor dhe qytetëruar të Mesjetës dhe kohës që vinte.

VI. Në vend të përfundimit & përmbylljes

Pse në vend të përmbylljes? Sepse as për shkaqe formale as joformale ky punim i filluar nuk mund të mbyllet. Pavarësisht nga vullneti i autorit, puna e këtillë është e gjykuar të plotësohet, të ndryshohet, të përmirësohet në vazhdimësi. Besojmë se koha që vjen do ta verifikojë dhe provojë këtë të shkruarën dhe do të ofrojë zgjidhje të reja, sigurisht më fatlume. Punimi ynë këtyre punimeve të ardhshme do t’u ndihmojë pak, kurse punimet e ardhshme, me kontributin e vet, mund të ofrojnë më shumë për këtë punim. Por, edhe atëherë do të shtrohet pyetja e përfundimit dhe përmbylljes. Pra, puna e këtillë nuk mund të përfundojë as përmbyllet.

Përmbledhje

Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë

Në punimin tim temë bosht është **Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë**, respektivisht **burimet, prejardhja, karakteristikat dhe prapavija historike e zhvillimit të terminologjisë filozofike islame në Mesjetë**. Duke e marrë parasysh se filozofia në mesjetë ka mbuluar një fushë të gjerë të diturive dhe shkencave, mendoj se shqyrtimi i terminologjisë filozofike islame, kryesisht me prejardhje arabe, iraniane dhe turke, dhe asaj greke, latine por edhe shqipe, do të ofrojë ndihmesë në zhvillimet e mëtejme të drejta dhe origjinale shkencore ndër shqiptarët. Është mendimi im se gjuha shqi-

⁶¹ Sipas: Louis Gardet, Mistika, Zagreb, 1983, fq. 136.

pe ka potencial cilësor dhe sasior ta bartë barrën që i takon në familjen e gjuhëve botërore.

Në fund kemi ofruar edhe një fjalor filozofik pesëgjuhësor, me 143 shprehje, me shpresë se do të ndihmojë në zhvillimin e gjithmbarshëm.

Literatura:

I. Në gjuhën arabe

1. Ahmed Emin, Duha'l-islam, I, botimi X, Kairo, 1984.
2. El-Imam Ebi'l-Hasan Alij ibn Ismail El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijin ve ihtilaf'il-musal-lin, botimi III, Wiesbaden, 1980.
3. Hana El-Fahuri – Halil El-Xherr, Tarih'ul-felsefet'il-arabijeh, pjesa II, botimi II, Bejrut, 1993.
4. Ibrahim Madkur, Fi'l-felsefet'il-islamijeh, I-II, pa vend dhe vit botimi.
5. Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?).
6. Xhemil Saliba, El-Mu'xhem'ul-felsefijji bi'l-elfadh'il-arabijjeti we'l-frensijjeti we'l-inklizijjeti we'l-latinijeh, I-II, Bejrut, 11414 h./1994.
7. Umer Ferruh, Tarih'ul-fikri'il-arabijji ila ejjami Ibn Haldun, botimi IV, Bejrut, 1983.
8. Abdurrahman Bedevij, Eflatun fi'l-islam, bot. III, Bejrut, 1402 h./1982.

II. Në gjuhët boshnjake-kroate-serbe

1. Ajatollah Misbah Yazdi, Islamska filozofija, I, Sarajevë, 2004.
2. Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987.
3. Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, 1988.
4. Čedomil Veljačić, Razmedja azijskih filozofija, II, Zagreb, 1978.

5. Filip Hiti, Istorija arapa od najstarijih vremena do danas, botimi II fototip, Sarajevë, 1988.
6. Frithjof Schuon, Dimenzije islama, Sarajevë, 1996.
7. Henri Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989.
8. Hisam Dzait, Evropa i islam, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989.
9. Louis Gardet, Mistika, Zagreb, 1983.
10. M. M. Sharif, Historija Islamske Filozofije, I, Zagreb, 1988.
11. Muhammed Iqbal, Razvoj metafizike u Persiji – Prilog historiji muslimanske filozofije, Sarajevë, 2005.
12. Muhamed Mrahorovic, Filozofijska razmedja islamske duhovnosti, Sarajevë, 2001.
13. Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarajevë, 1990.
14. Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, I, Zagreb, 1973.
15. Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, II, Zagreb, 1976.
16. Rade Bozovic, Udzbenik arapskog jezika sa vjezbankom i rjecnikom, Botimi I, Sarajevë, 1984.
17. Dzermaludin Latic, Stil kur'anskog izraza, Sarajevë, 2001.
18. Tarik Haveric, Srednjovjekovno filozofijsko nazivlje u arapskom jeziku, Sarajevë, 1990.
19. Teufik Muftic, Gramatika arapskoga jezika, Sarajevë, 1998.
20. Teufik Muftic, Klasicna arapska stilistika, Sarajevë, 1995.
21. Umhazun, Muhammed, Koncept izucavanja islamske historije, sarajevë, 2000.

III. Në gjuhën shqipe

1. Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002.
2. Ekrem Murtezai, Fjalor i feve, Prishtinë, 2000.
3. Ekrem Murtezai, Fjalor i filozofisë, Prishtinë, 1995.
4. Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, I-II, Shkup, 1997.
5. Sami Frashëri, Qytetëprimi islam, vepra 13, Shkup, 2004.

IV. Në gjuhën angleze:

1. Ismail Raji al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?).
2. Muhammad Iqbal, The Development of Metaphysics in Persia – A Contribution of Muslim Philosophy, Sarajevë, 2005.
3. Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, History of Islamic Philosophy, part I-II, Teheran, Iran, pa vit botimi.

V. Periodiku

1. Glasnik – Casopis Rijaseta IZ BH, Sarajevë, 11-12/1997.
2. Glasnik – Casopis Rijaseta IZ BH, Sarajevë, 1-2/1998.
3. Prolozi za Orijentalnu Filologiju, XXIV 1974/ Sarajevë, 1976.
4. Mogucnost – Casopis za knjizevnost, umjetnost, kulturni problemi, nr. 8-9/1979, Split.

Nexhat Ibrahim**THE DEVELOPMENT OF ISLAMIC PHILOSOPHIC TERMINOLOGY IN THE MIDDLE AGES****(Summary)**

(Sources, origin, characteristics and historical background of the development of Islamic philosophic terminology in the middle ages)

The Europeans due to their narrow-minded views about the Noble Qur'an did not accept Islamic philosophy for a considerable period of time. But later on, upon reading philosophical books written by Moslems, upon seeing their great achievements in this field of knowledge, upon seeing that the Qur'an, which is a philosophy in itself, does not ban philosophy, but on the contrary, promotes its development, understood it and finally accepted the truth – Sami Frashëri.

نجد إبراهيم

تطوير مصطلحات الفلسفة الاسلامية في القرون الوسطى**(خلاصة البحث)**

(المصادر و الحذور و الخصائص التاريخية لتطوير المصطلحات الفلسفية الاسلامية

في العصور الوسطى)

بما أن الاوربيين كان لديهم أفكار خاطئة عن القرآن الكريم لهذا السبب هم لم يقبلوا الفلسفة الاسلامية. الا انهم بعدما تعرفوا عليها و عرفوها حق المعرفة و تعرفوا على الانجازات الكبيرة التي حققها المسلمون في مجال الفلسفة و عندما عرفوا بان القرآن الكريم هو قمة الفلسفة و الذي لا يحرم الفلسفة بل على العكس يحث على تعلمها و نشرها فقد بعدها فهموا الاسلام و اعترفوا بحقيقته"

سامي فراشيري

KUMTESË

Akad. Jashar Rexhepagiq

TERMINOLOGJIA ISLAME NË NJË NGA VEPRAT MË TË REJA NË GJUHËN KROATE*

Në vitet e fundit dhe në një varg vendesh ballkanike është gjithnjë më i madh interesimi për emërtime, nocione dhe përcaktime të tjera nga fusha e filozofisë, e shkencës, e kulturës, e arsimit dhe e fesë islame. Fjala është për emërtimet dhe përmbajtjen e terminologjisë islame, që është me rëndësi edhe për përdorimin e tyre në gjuhën dhe në literaturën shqipe, në komunikim të përditshëm dhe në fusha të ndryshme të jetës e të punës. Në të vërtetë, përcaktimet e përmendura janë në funksion të terminologjisë islame shqipe. Prandaj, në radhë të parë meritojnë shqyrtim të gjithanshëm.

Ndër veprat e këtij lloji veçohet “Fjalori i madh i gjuhës kroate” (“*Veliki rječnik hrvatskoga jezika*”) i autorit Vladimir Aniq. Fjalori në 1881 faqe është botuar në Zagreb në vitin 2003. Krahas këtij “Fjalori”, si burim kryesor, do të konsultohen edhe punime të tjera në gjuhët kroate, boshnjake, shqipe dhe serbe, veçmas fjalori i “Nocioneve të Islamit” (“*Pojmovnik islama*”) nga Rade Bozhoviq dhe Vojislav

Simiq, vepër kjo e botuar në Beograd në vitin 2003 në gjuhën serbo-kroate.

Vladimir Aniq është gjuhëtar kroat dhe leksikograf i njohur, i cili, sa ishte gjallë, me dekada është marrë me shqyrtimin dhe interpretimin e jo më pak se 70.000 zërave. Më konkretisht, ky fjalor më i madh bashkëkohor i gjuhës kroate, botimi i tij i katërt më i vëllimshëm përmban 70.576 fjalë themelore dhe 125.000 derivate. Fjalori” i Aniqit është vepër kapitale e botuar nga Enti Leksikografik i Zagrebit. Gjatë vitit të kaluar dhe në këtë vit ka hyrë në radhën e librave më të lexuar në Kroaci. Kjo është vepër jetësore e autorit dhe sintezë e punës së tij të tërësishme leksikografike. Autori është marrë me kujdes e dijeni me tërësinë e emërtimeve, fjalëve dhe shprehjeve, me krijimin e nocioneve dhe domethëniet e relacionet e tyre.

Aniq, nga domeni i shkencës islame, ka zgjedhur dhe ka shpjeguar shkurtimisht këto terma:

1. **abdest (abdes, avdes)**, pers., larje rituale sipas dispozitave të Islamit para faljes, me larjen e fytyrës, duarve deri në bërryla dhe këmbëve deri te nyjat, shpëlarjen e gojës e të hundës, prekjen me dorë të lagur të qafës, të veshëve dhe të tepes së kokës.¹

Fjala vjen nga persishtja: abdest (ab=ujë, dest=dorë). Në literaturën shqipe është në përdorim nocioni **avdes**. Për shembull: **Merrnin avdes**.

2. **adet**, arabisht, zakon nga jeta popullore; shprehi, doke, zakon, e drejta zakonore.²

Mungon vetëm se adet njëkohësisht do të thotë traditë dhe se fjala ka ardhur te ne nga turqishtja. Në gjuhën dhe në literaturën shqipe fjala adet zakonisht interpretohet me fjalët: **zakon, doke, ves**. Për shembull: **Sipas adetit**.

3. **aga** (turq.), pronar i tokës së punueshme në Perandorinë Osmane, emërtim i oficerit në ushtrinë e rregullt osmane, bujar i rangut më të ulët, feudal.³

* Kjo kumtesë është lexuar në tryezën shkencore me titull “terminologjia Islame” të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë më 10 nëntor 2005.

¹ V. Aniq, **Veliki rječnik hrvatskoga jezika**, Zagreb, 2003, 1

² Po aty, 3.

³ Po aty, 5.

Është i domosdoshëm plotësimi se ky është pronar i madh, feudal, i parë në fshat e qytet⁴. Në shqip “aga” është “pronar tokash më i vogël se beu”⁵

4. **ahiret** (arabisht), bota tjetër, ajo botë. Ndahet në xehnet dhe xehenem.

Në të vërtetë, kjo është jeta pas vdekjes. Në literaturën shqipe dhe fetare ahireti interpretohet si **botë tjetër pas vdekjes**.⁶

5. **Allah** (arabisht), tek Aniq: i vetmi perëndi, krijuesi i botës, i amshueshëm, i padukshëm, i gjithëpranishëm, i gjithëfuqishëm dhe i gjithëdijshëm. Këtu ka munguar etimologjia e fjalës arabe “Allah” që do të thotë “zot, perëndi”, megjithëse një, i vetmi” është epiteti më i rëndësishëm. Ka munguar edhe sqarimi, sipas shpalljes kur’anore (shiko suren *Ikra*) se “Allahu është ai që njeriut ia mëson atë që nuk e di”. Nuk është shënuar as e dhëna e rëndësishme se Allahu ka qenë hyjni edhe në periudhën paraislamike dhe se në traditën fetare popullore janë ndërtuar 99 epitete të emrit të Allahut, që përmenden në Kur’an. Për më shumë të dhëna për zotin shiko fq. 96-97. Është posaçërisht me rëndësi që autori thekson se Zoti është “krijues i botës së gjithmbarshme materiale e shpirtërore dhe zot i natyrës”.⁷ Në gjuhën shqipe dhe në besimin e myslimanëve Allahu është **Zoti**, përkatësisht **emri i Zotit** në arabisht.

Në “Fjalorin” e Aniqit janë shpjeguar edhe shumë terma albanologjike, si **Albanac-anka, Albanija, albanizacija, albanizirati, albanolog, albanologija, albanologijski. albanoloshki, albanski, Arbanas, Arbanka, Arbanasi, arbanaski, arbanashki, Arbanija, Arnaut –tkninja, Shiptar (Shqiptar)** e të tjerë, çka gjithashtu tregon rëndësinë e shumanshme të kësaj vepre. Ky “Fjalor” mund të shërbejë edhe si shembull joekskluziviteti. Këtë do ta dëshmojmë qoftë edhe vetëm me një shembull. Kështu, për shembull, fjala **ballist** (në fq. 54) është shpjeguar me këto fjalë: “1. pjesëtar i aradheve paraushtarake të

⁴ shiko: A. Shkaliq, **Turcizmi u sprskohrvatskom jeziku**, Sarajevë, 1985, fq. 72.

⁵ **Fjalor i shqipes së sotme**, Tiranë, 1984, 6.

⁶ *Fjalor serbokroatisht-shqip*, Prishtinë, 1974, 969,

⁷ Po aty, 96.

nacionalistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipëri në Luftën e Dytë Botërore; 2, aderues i lëvizjes Balli Kombëtar (që përfaqësonte idenë e shkëputjes së Kosovës dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë)”.

6. **Beg** (turqisht), titull bujari në Perandorinë Osmane; zyrtar i lartë ushtarak ose civil; zotëri, sundimtar, njeri prestigjioz. Shtohet pas emrit personal, për shembull, Mustaj-beg.⁸

Duhet theksuar posaçërisht se ky titull nuk është përdorur vetëm në periudhën e Perandorisë Osmane, por edhe më vonë (p.sh. në Bosnjë: Safvet-beg; në Kosovë: Nexhib-bej; në Plavë: Shaban-beg etj.).

Edhe një plotësim i zërit “beg” do të ishte: “bujar”, që e plotëson shpjegimin e termit. Në gjuhën shqipe titulli “beg” përdoret më tepër si **bej, bejlerë** dhe ka të njëjtin kuptim.

7. **Bajram** (turqisht), ditë e madhe islame, festë fetare myslimane. Autori dallon Kurban Bajramin ose Bajramin e Haxhit, i cili fillon 70 ditë pas Bajramit të Ramazanit dhe zgjat katër ditë, nga Bajrami i Ramazanit, i cili fillon ditën e parë pas agjërimit të Ramazanit dhe zgjat tri ditë.⁹ Kurban-Bajrami quhet kështu për arsye se për këtë bajram (festë) theren kurbanet (gjedhe ose dele), e quhet edhe i Haxhit për arsye se gjatë atyre ditëve bëhet pelegrinazhi vjetor kryesor i haxhilerëve rreth Qabes në Mekë.

Duhet theksuar se ky është emërtim me prejardhje turke dhe do të thotë “festë fetare, festë në përgjithësi, kremtim, gëzim”. Në gjuhën shqipe të dyja këto festa të bajramit quhen edhe: **Bajrami i Madh** dhe **Bajrami i Vogël**.¹⁰

8. **Berat** (arabisht), dekret i sulltanit, me të cilin ndahen titujt, dekoratat, privilegjet; dekret, kartë, leje.¹¹

Nuk duhet harruar se dekretet e veçanta të sulltanit – **fermanët** rregullonin çështje të rëndësishme në Perandorinë Osmane. Këtë urdhëresë perandorake duhej ta respektonte secili. Prej andej ka dalë në

⁸ Po aty, 66.

⁹ Po aty, 51.

¹⁰ Sipas Pasho Baku: **Fjalor enciklopedik**, Tiranë, 2002. 64.

¹¹ Po aty, 68.

boshnjakishte folja “fermati” – respektoj, nderoj. Vetë fjala “ferman:” është me prejardhje orientale (persiane).¹²

Në gjuhën dhe në literaturën shqipe janë në përdorim fjalë: **berat**, **dekret diplomë (turke)**.

9. **Qaba** (arabisht), pelegrinazh ose shenjtërore në përgjithësi; vend i shenjtë në Mekë ku shkohet në haxhillëk.¹³

Është dashur të shtohet se Qaba është godinë e shenjtë islame, tempull në qytetin e Mekës në Arabi. Për çdo vit, myslimanët nga të gjitha viset e botës, për Bajram të Haxhit (Bajram të Vogël) vijnë në Mekë dhe e vizitojnë Qaben. Gjithashtu nuk mund të mos përfillet e dhëna se është detyrë fetare që secili mysliman, një herë në jetë, ta vizitojë këtë tempull¹⁴, natyrisht nëse gjendja ekonomike ia lejon këtë. Do ta shtonim edhe faktin se në shenjtëroren e sotme islame, gurin e zi të quajtur Qabe në Mekë, edhe në kohën paraislamike janë mblendhur arabët paganë¹⁵.

Në literaturën shqipe gjejmë emërtimet: Qabe (Kaaba).

10. **Qitab (kitab)**, arabisht, libër në përgjithësi, libër që përmban mësim dhe rregulla fetare. Në rastet më të shpeshta është edhe sinonim për Kur’anin.¹⁶

Ky libër në gjuhën shqipe quhet **qitap**. Fatkeqësisht nuk është sqaruar gati në asnjë fjalor leksikologjik shqip.

11. **Dervish** (persisht), klerik lypës, pjesëtar i rendit fetar mysliman (që nga shek. 11/12). Punon me besimtarët në rituale të veçanta (vallëzim, misticizëm).¹⁷

Sqarimi nuk është i plotë. Do të ishte më e drejtë të thuhet se dervishi është pjesëtar i rendit të caktuar të dervishëve ose tarikatit. Ky term do të thotë gjithashtu: njeri modest, i tërhequr dhe i devotshëm.

Duhet të përmendte së paku disa rende të dervishëve: halveti, sadi, bektashi, rufai, melami etj.

Do të shtonim edhe faktin se në disa vende dervishët arsimohen në institucione të veçanta, të quajtura hanikase. Në veprat në gjuhën shqipe, ka raste kur fjala “dervish” interpretohet shumë ngushtë, si “murg i sektit bektashian”.¹⁸

12. **Divan** (arabisht dhe persisht), këshill, kuvend, pleqësi; këshill perandorak (mbretëror) ose i vezirëve (i ministrave); pleqësia shtetërore; oborri perandorak (mbretëror), ose oborri, shtëpia e ndonjë veziri, pashai; kuvendimi, biseda; lloji i sofës: kolltuku, seqia (sexhadja); përmbledhja ose tufa e këngëve orientale.¹⁹

Zëri është trajtuar përpikërisht edhe sipas modelit të “Turqizma-ve” të A. Shkaliqit. Edhe te ne në Kosovë shumë autorë kanë shkruar divane. Më të njohura janë divanet e Sheh Malës, nga Rahoveci. Në literaturën shqipe termi shpjegohet edhe si **këshilli i sulltanit** edhe si **përmbledhjet lirike të një poeti**.²⁰

13. **Xhamia** (arabisht) është faltore myslimane me minare.²¹

Është i saktë zëri i xhamisë, sepse faltorja pa minare është mesxhid, do të thotë vend për falje (lutje). Xhamia rrjedh nga fjala arabe “gāmi” që do të thotë “faltore”, më saktë: tempull islamik. Pranë xhamive ndërtohen edhe kuzhinat për të varfër, udhëtarë e kalimtarë (**imaretët**). Xhamitë më të mëdha kanë edhe lokalet për nxënës të teologjisë dhe për organizimin e mësim-fesë. Sipas traditës, xhaminë e parë e ka themeluar vetë Muhamedi te Medina në vitin 622. Rrjeti i xhamive është shumë më i zgjeruar në Ballkan, ndërsa në rajonin arab ka mbizotëruar emërtimi i zakonshëm mesxhid. Literatura në gjuhën shqipe ka mjaft lëndë e njoftime mbi faltoren myslimane – xhaminë.

¹² Sipas librit: **Da li znate? -/A e dini?/,** Beograd, 2004, fq. 50.

¹³ Po aty, 179.

¹⁴ Për këtë më shumë shiko: A. Shkaliq, **Turcizmi...**, në fq. 182.

¹⁵ Sipas: Rade Bozhoviq – Vojislav Simiq: **Pojmovnik islama,** Beograd, 2003, fq. 121

¹⁶ Po aty, 181.

¹⁷ Po aty, 205.

¹⁸ Shiko: **Fjalor i shqipes së sotme,** Tiranë, 1984, në fq. 192.

¹⁹ Po aty, 224.

²⁰ **Fjalor enciklopedik,** Tiranë, 2002, 160.

²¹ Po aty, 273.

14. **Xhehenem** (hebraisht), ferr në doktrinën islame.²²

Termi është shpjeguar shkurtimisht. Ka qenë e domosdoshme që të theksohet se kjo fjalë në Kur'an është sinonim i fjalës “nar” (zjarr, flak), por e ka edhe domethënien “ferr”. Ekzistojnë kategori të ndryshme mëkatarësh dhe ata, duke hyrë nëpër dyer të ndryshme, vendosen në anë të ndryshme.²³

Fjala xhehenem në shqip identifikohet me fjalën **ferr** ose **skëterrrë**.

15. **Xhemat** (arabisht), tubim, shoqëri, bashkësi; komunitet fetar, njësi themelore e bashkësisë fetare islame; tubim i njerëzve që falen bashkërisht.²⁴

Duhet të theksohet se xhemat quhet edhe xhama'a. Ky, pra, është tubim, tubim i besimtarëve. Këtë domethënie e ka termi xhemat në gjuhën fetare të Islamit.

16. **Xhenet** (arabisht xhehenet), kulminacioni i mirëqenies në Islam; parajsja, qielli.²⁵

Në arabisht xhenet quhet ġānnā, do të thotë “parajsja”, kurse domethënie thelbore e ka fjalën “bahçe”. Gjithashtu, do ta theksonim se ky emërtim është në përdorim në traditën dhe në literaturën myslimane në Kur'an.

Në gjuhën shqipe janë në përdorim fjalët: **xhenet** dhe **parajsë**. Figurativisht ky është “vend i bukur dhe i begatë”.²⁶

17. **Haxh** (arabisht), pelegrinazh në Mekë, e bën besimtari personalisht ose me anë të zëvendësit (bedelit). (Po aty 392).

Haxhi ose haxhillëku është obligim i rregullt vjetor i myslimanëve. Për shkaqe të arsyeshme (lufta, epidemitë e mëdha) haxhillëku mund të mos bëhet. Përndryshe, secili besimtar e ka për detyrë që një

herë gjatë jetës të shkojë në haxhillëk.²⁷ Besimtari mysliman që shkon (ose ka qenë) për t'u falur në Mekë në gjuhën shqipe quhet **haxhi**.

18. **Ibadet** (arabisht), gjendje e përkusimit të besimtarit në frymën e Allahut gjatë lutjes; lutje. falje; mësim i besimit, i ritualit dhe i jetës shoqërore.²⁸

Na duket më i plotë dhe më i kuptueshëm është interpretimi i A. Shkaliqit në fjalorin e tij **Turcizmi u srpskohvartkom jeziku** (Turqizmat në gjuhën serbokroate, Sarejevë, 1985), i cili, për fjalën “ibadet” në fq. 338 thotë kështu: 1. lutje Zotit, falje dhe mësim, 2. “të bësh ibadet”, t'i lutesh Zotit, të falesh e të mësosh.

19. **Islam** (arabisht), religjion monoteist i bazuar në besimin në Allahun sipas mësimit të profetit të tij Muhamedit (shek. 7), mbështetet në Kur'anin. Termi ka edhe domethënie tjetër - kjo është bota islame, tërësia e qytetërimeve dhe e popujve islamikë.²⁹

Po theksoj se fjala islam tekstualisht do të thotë nënshtrim vullnetit të Zotit. Këtu zëri islam është interpretuar shumë më mirë sesa në “Turqizmat” e Shkaliqit, ku është reduktuar në “emrin e fesë myslimane”,³⁰ që është interpretim shumë i ngushtë.

Ndërkaq, zëri (determinimi) më i plotë i islamit është dhënë në “Pojmovnik islama” (në fq. 62-65) ku, përveç të tjerash, është thënë se religjioni praktik (dini) përbehet prej katër, përkatësisht pesë detyrave themelore, kryesore, e këto janë: 1. që myslimani i devotshëm të bëjë pesë falje (lutje) në ditë; 2. agjërimi i obligueshëm i ramazanit; 3. dhënia e zeqatit (mëshirës fetare); 4) haxhillëku i obligueshëm në Mekë (haxhi) dhe 5. obligimi – predikimi se zoti është një. Doktrinën islame shqiptarët e quajnë më shkurt islam. Së këndejmi edhe termat: **islamik, islamizim, islamizoj** e të tjera. Me anë të islamit është bërë

²² Po aty, 273.

²³ Për këtë shiko në **Pojmovnik islama**, Beograd 2003, fq. 148.

²⁴ V. Aniq, **Veliki rječnik**, Zagreb, 2003, 273.

²⁵ Po aty, 274.

²⁶ **Fjalor i shqipes së sotme**, fq. 854.

²⁷ Më hollësisht për haxhin shiko në **Pojmovnik islama**, fq. 138-139.

²⁸ Po aty, 423.

²⁹ Po aty, 463.

³⁰ Shiko te Shkaliqi në fq. 350.

edhe përhapja e kulturës orientale dhe e institucioneve arsimore te popujt e ndryshëm, veçmas te shqiptarët.³¹

20. **Kur'an,-i** (arabisht), libër i shenjtë i Islamit; fjalët e Zotit të dërguara Muhamedit, të pranuar si bazë e së drejtës, e kulturës, e politikës dhe e letërsisë islame. Përmban 114 sure (kapituj) me gjithsej 6220 ajete (fjali), përkatësisht 77934 fjalë.³²

Në “Fjalori madh” të Aniqit mungon domethënia themelore e Kur’anit se ai është “recitim, mësim, ai që duhet lexuar”, faktikisht libër leximi. Derisa norma më e vjetër e këtij libri të shenjtë rrjedh nga viti 776, në shekullin IX janë përcaktuar edhe mënyra të ndryshme të leximit të Kur’anit në disa qendra, p.sh. në Medine, Mekë, Damask, Kufë e të tjera. Dhe kështu në lidhje me Kur’anin me kohë janë zhvilluar interpretime të ndryshme të këtij libri të shenjtë të myslimanëve, prej të cilave janë krijuar shumë sekte e parti. Njëkohësisht s’ka dyshim se Kur’ani “ka qenë dhe ka mbetur shembull i rrëfimit arab në prozë” dhe njëkohësisht “bazë e jetës së gjithmbarshme shpirtërore e materiale”³³

Ky libër i shenjtë edhe në gjuhën shqipe është i njohur me emrin **Kuran,-i**.

21. **Medresa** (arabisht), shkollë fetare islame në rangun e shkollës së mesme e të lartë.³⁴

Në mënyrë të ngjashme është thënë për medresenë edhe te Shkalliq, i cili jep këtë shpjegim: “shkollë fetare myslimane, në të cilën hyhet pas mbarimit të mejtepit ose ruzhdijes”.³⁵

Në “Pojmovnik islama” (fq. 87) për medresenë thuhet se dikur ka qenë “shkollë fetare myslimane”, ndërsa sot kjo është “në rangun e shkollës sonë të mesme, në të cilën mësohen lëndë të ndryshme fetare”.

³¹ Më shumë për këtë shiko në librin tonë: **Zhvillimi i arsimit dhe i shkollave të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918**, Prishtinë, 1968, fq. 35-36

³² Po aty, 657.

³³ Sipas: **Pojmovnik islama**, fq. 77-78.

³⁴ Po aty, 738.

³⁵ A. Shkalliq, **Turcizmi...**, 451.

Shkurt, të gjithë autorët e përmendur medresenë e trajtojnë si shkollë fetare islame ose myslimane, duke harruar se aty, varësisht nga rangu, mësoheshin edhe shkencat të ndryshme natyrore dhe ndonjë lëndë tjetër laike: p.sh., nga rendi i shkencave shoqërore. Edhe te ne ka pasur medrese për arsim fetar e laik, e të tilla kanë qenë Medreseja e Is-hak-Beut në Shkup, Medreseja e Gazi-Husrev-Beut në Sarajevë, Medreseja e Mehmed-Pashës në Prizren e shumë të tjera. Në Prishtinë punon Medreseja Alaudin.

22. **Mekteb (mejtep)**, arabisht, shkollë fillore fetare.³⁶ Në mënyrë të ngjashme është shpjeguar me nga një fjalë në “Turcizmi” dhe “Pojmovnik islama”.

Në **Enciklopedia Pedagogjike 2** (v. 1989), në faqen 25, zërin “mejtep” ne e kemi sqaruar kështu: “Mejtep, arabisht maktab, vend ku shkruhet – shkollë, në rastet më të shpeshta shkollë fillore myslimane ose tipi më i ulët i shkollës fillore islame. Mejtepet hapeshin në qytete e fshatra, vendoseshin në xhami ose afër tyre. Nxënësit mësonin aty lexim, shkrim (i shkronjave arabe), Kur’an, aty-këtu edhe libra të tjerë... Mësimi ishte i përshkuar me religjiozitet e dogmatizëm. Mësohej pa e kuptuar lëndën, përmendsh dhe me dënime të rrepta fizike. Mësues ishin hoxhallarët, ndërsa në mejtepet moderne – **ibtidaitë**, mësuesit me kualifikime të domosdoshme. Mejtepet janë hapur që në shekullin VII – VIII. Te ne ka pasur më shumë deri në vitin 1912, me ndërprerje deri në vitin 1918 dhe në kohën midis dy luftërave. Ekzistojnë mejtepet për djem, për vajza dhe të përziera. Në literaturë takohen edhe emërtimet: mejtef, mejtep dhe mektep.”

Në gjuhën shqipe përdoret gati ekskluzivisht emërtimi **mejtep**.

23. **Merhamet** (arabisht), emërtim i organizatës bamirëse islame. Merhamet do të thotë: mëshirë islame, përdëllim.³⁷

Në mënyrë të ngjashme është shpjeguar termi edhe në “Turcizmi”, në fq. 460, por edhe në literaturën shqipe gjuhësore etj.

³⁶ Po aty, 742

³⁷ Po aty, 745

24. **Muhamed** (arabisht), i dërguari i Zotit, profet, themelues i Islamit; mësimi i tij është shkruar në Kur'an.³⁸

Në emërtimin arabisht: "Muhämmäd" do të thotë "i lavdëruar, i madhëruar". Më hollësisht për Muhamedin, i cili si i dërguar i Zotit e ka shpallur besimin e ri monoteist – Islamit, shiko në "Pojmovnik islama" në fq. 94-96.

Është i lindur rreth vitit 570 në qytetin Mekë. Në fëmijëri të hershme ka mbetur pa të dy prindërit dhe për të është kujdesur xhaxhai i tij Abu Talibi. Si i ri ka marrë pjesë në aktivitete fetare në Mekë. Rreth vitit 610 ka përjetuar përvoja religjioze në formë vizionesh e zërash. Gradualisht ka filluar ta pranojë rolin e vet të dërguarit të Perëndisë. Shpalljet që ka pranuar Muhamedi, më vonë janë mbledhur në librin e shenjtë – Kur'an.³⁹

25. **Musliman(ka)**, (arabisht-persisht), ai që është i besimit mysliman, ithtar i Islamit. Është në përdorim edhe emërtimi i vjetër: muhamedan. Musliman është edhe emërtim për pjesëtarin e nacionalitetit mysliman në BeH, ndërsa tash për këtë përdoret emërtim boshnjak.⁴⁰ Në të njëjtën faqe, termi **muslimanstvo** (muslimanizëm) do të thotë "ndjenja e përkatësisë myslimanëve". Është më e drejtë dhe më precize që termi të shpjegohet me fjalët: pjesëtar i fesë islame. Mungojnë karakteristikat e tjera të zërit "mysliman", si dhe faktet konkrete – se në botë janë diçka më shumë se një miliard njerëz, se te ne Islami është përhapur pas ardhjes së turqve në Ballkan, se myslimanët te ne kanë organizatën e vet fetare (Bashkësinë Fetare Islame) dhe të dhënat e tjera konkrete, p.sh., ku ka më shumë myslimanë, në cilat vende janë me numër më të madh e të tjera. Pjesëtar i fesë myslimane në gjuhën shqipe emërtohet **mysliman**, dhe feja e tij është: **feja myslimane**.

26. **Namaz** (persisht), sipas Aniqit, namazi është falje - lutje myslimane që bëhet pesë herë në ditë në kohë të caktuar me falje e shqiptim të fjalive nga Kur'ani dhe lutje në gjuhën arabe.⁴¹

³⁸ Po aty, 786.

³⁹ Më shumë për këtë: Milan Vukomanović, **Religjia**, Beograd, 2004, 29.

⁴⁰ Po aty, 789.

⁴¹ Po aty, 814.

Interpretimi është i saktë dhe krejtësisht sipas shembullit në "Turqizmat" e Shkaliqit në fq. 486. Në të dy burimet është dashur të shtohet se myslimanët për çdo ditë bëjnë pesë lutje: në mëngjes (sabah ose sabah namaz), në drekë, midis mesditës dhe perëndimit të diellit në gjysmën e dytë të ditës (iqindia), në perëndim të diellit (akshami) dhe në mbrëmje (rreth dy orë pas muzgut të parë – jacia). Namazi është njëra nga shtyllat më të rëndësishme të Islamit, e të njëjtin kuptim e ka edhe fjala arabe **salat**.

Faljen e obligueshme myslimane (**namaz-in**) e gjejmë edhe në literaturë (fetare e tjetër) në gjuhën shqipe.

27. **Oriental** (lat. orientalis), që ka të bëjë me lindjen, lindor; që ka të bëjë me Orientin, përkatësisht me Lindjen e Afërme, të Mesme dhe të Largët. I përmend shembujt e **kishave orientale**, në të vërtetë kishave të botës ortodokse, të **gjuhëve orientale** (për gjuhët e Lindjes së Afërme e të Mesme dhe gjuhët e tjera orientale) dhe **sagun orient**.

Lidhur me këtë term e ka shpjeguar edhe domethënien e **orientalistikës** si studim shkencor i kulturës shpirtërore e materiale të Orientit.⁴²

Theksojmë se zërat oriental, orientalistika nuk janë trajtuar në fjalorët e Shkaliqit e të Bozhoviqit bashkë me Simiqin.

Në gjuhën shqipe gjejmë disa terma: **oriental, orient, orientalist, orientalistikë, orientalizëm** e të tjera.

28. **Pasha** (turqisht), titull i eprorëve të lartë ushtarakë e civilë në Perandorinë Osmane dhe në disa shtete të tjera; guvernator i krahinës.⁴³

Shpjegimi i këtij titulli është sipas shembullit të "Turqizmave" të Shkaliqit.⁴⁴ Duhet theksuar se pashai ishte edhe këshilltar shtetëror, komandant autoritativ, kurse në kuptimin figurativ sundimtar arbitrar.

⁴² Po aty, 955.

⁴³ Po aty, 1005

⁴⁴ Shiko në fq. 511.

Termi është me prejardhje turke, me formën e parë: “basha”. Emërtimi gati gjithnjë vihet pas emrit (p.sh. Mustafa-pasha, Ali pashë Tepelena, Ali pashë Gucia etj.).

Në shqip: **pasha, pashallarë** dhe figurativisht: **jetoj si pasha**.

29. **Pashallëk** (turqisht), njësi më e madhe administrativo-territoriale në Perandorinë Osmane, krahina në krye të të cilës ishte pashai.⁴⁵ Autori përmend shembujt e Pashallëkut të Bosnjës e të Pashallëkut të Beogradit. Do të shtonim se Bosnja është bërë pashallëk në vitin 1583, kurse selia e Pashallëkut të Beogradit ka qenë në Beograd prej vitit 1521. Në shekullin XVIII atë e drejtonte mëkëmbësi me emërtimin e pashait. Ekzistonin edhe pashallëqet e Jeni Pazarit, Leskovcit, Nishit, Vidinit (në Bullgari) e të tjerët.⁴⁶ Sa për shembull po përmend një njësi të tillë administrativo-territoriale: **Pashallëkun e Shkodrës**.

30. **Rumelia** (latinisht-turqisht), pjesa më e madhe e territoreve evropiane nën pushtetin osman (fundit i shekullit XIV dhe fillimi i shekullit XV) e organizuar si ejalet: më vonë ngushtohet në rajonin e Bullgarisë së sotme, pjesët e Serbisë, të Maqedonisë e të Greqisë. Domethënie tjetër ka Rumelia Lindore, përkatësisht pjesa e Bullgarisë, e cila, pas vitit 1878, ka mbetur në përbërje të Perandorisë Osmane, kurse në vitin 1885 është bashkuar me Bullgarinë.⁴⁷

Përcaktim më preciz i Rumelisë është Turqia evropiane, përkatësisht emërtimi për pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Deri në vitin 1541, të gjitha vendet ballkanike hynin në përbërje të Bejlerbejllëkut (pashallëkut) të Rumelisë. Termi rrjedh nga fjala turke “Rum” (grek) dhe latine “Roma”.

31. **Sabah** (arabisht), agim, mëngjesi i hershëm, Falja e parë islame e mëngjesit.⁴⁸ Është dhënë edhe domethënia tjetër: Sabah – shtet autonom në ishullin Borneo. Sabah do të thotë gjithashtu mëngjes, agim. Po themi edhe një domethënie të fjalës sabah. Ky është leksioni i

dhënë në mejtep ose medrese.⁴⁹ Mbase, kjo rrjedh nga fjala turke “sabah” (leksion).

Në gjuhën shqipe më shumë përdoret fjala **mëngjes**. Thuhet p. sh. **U ngrit që me sabah**.

32. **Sabur** (arabisht), durueshmëri, aftësi e zotërimit të vetvetes. Lidhur me këtë është edhe fjala **saburim** – sundim i vetvetes, durim i vështirësive të jetës.⁵⁰

Në gjuhën shqipe shumë të afërta janë fjalët: **sabër** dhe **durim**. P.sh. **Punoj me durim**. Është e njohur edhe fjala e urtë popullore: “sabri – selamet” (durimi – shpëtim).

33. **Sheriati** (arabisht), ligj themelor fetar i myslimanëve, dispozita islamike të themeluara në shekullin VIII – IX. Thuhet edhe **e drejta sherie** si sistem i së drejtës myslimane e dalë nga Kur’ani, p. sh., e drejta e pronës, e drejta familjare, e drejta trashëgimore, e drejta ndëshkimore e të tjera.⁵¹

Emërtimi shariat rrjedh nga fjala arabe: sharia, domethënia themelore e të cilës është: “rruga e drejtë”. Edhe në gjuhën shqipe është në përdorim emërtimi **shariat-i**, ndërsa në periudha të caktuara historike edhe e drejta e shariatit ka ushtruar ndikim të padyshimtë. (Shqip: **E drejta e shariatit**).

34. **Teqe** (arabisht), faltore, në të cilën banojnë dervishët dhe kryejnë ritualet fetare - kuvend i dervishëve.⁵² Por, ky do të ishte përkufizim tepër i ngushtë nëse do të thuhej se tekia - teqeja shërben vetëm për rite fetare, sepse aty bëhen edhe biseda, aty-këtu shkruhen ose analizohen libra, artikuj dhe kryhen obligime të tjera. Është dashur të thuhet edhe se eprori i teqesë është shehu dhe se këso faltroresh edhe tani ka shumë, sidomos në Kosovë, Bosnjë, Maqedoni dhe Shqipëri. Në Kosovë dhe në Shqipëri teqe ka në Prizren, Gjakovë, Rahovec, Pejë, Mitrovicë, Berat, Elbasan, Tiranë, Krujë, Shkodër e të tjera.

Në gjuhën shqipe tekia quhet **teqe, teqeja**.

⁴⁵ Po aty, 1006.

⁴⁶ Sipas librit: **Da li znate?**, Beograd, 2004, 263.

⁴⁷ Po aty, 1355.

⁴⁸ Po aty, 1360.

⁴⁹ Shiko: **Turcizmi...**, fq. 538

⁵⁰ Po aty, 1361.

⁵¹ Po aty, 1530.

⁵² Po aty, 1577.

Turcizëm, njësi e marrë nga osmanishtja (p.sh. “bakar”, “çarapa”, “sheqer” etj.). Domethënia e dytë e turqizmit është se njësia nga arabishtja, persishtja ose ndonjë gjuhë tjetër është marrë me ndërmjetësimin e osmanishtes në kohën e rishtresimit të kulturës turke, sllave, shqiptare e të kulturave dhe të qytetërimeve të tjera.⁵³

Është e drejtë që ky term si dhe domethënia e tij kanë hyrë në këtë Fjalor.

Është e nevojshme të thuhet edhe se në gjuhën shqipe, boshnjakisht e gjuhë të tjera fqinje, në radhë të parë në të folurin popullor, janë me mijëra fjalë që rrjedhin më së shumti nga arabishtja, mandej nga persishtja dhe turqishtja. Këto emërtime orientale janë të njohura si “turqizma”. Ky term (turqizëm) ka zënë vend te ne me ndërmjetësimin e turqve dhe kjo është arsyeja themelore që edhe sot e kësaj dite është mjaft i pranishëm edhe në literaturë (p.sh. titulli i fjalorit të A. Shkaliqit: **Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku**).

Kur është fjala për përdorimin praktik të termave-nocioneve orientale te ne, sot, është qëndrim shkencor adekuat se disa fjalë kanë “depërtuar thellë” në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera të këtushme, disa janë në zhdukje e sipër, ndërsa disa janë zhdukur fare.⁵⁴

36. **Vilajet** (arabisht), njësia më e madhe administrative në Perandorinë Osmane, krahinë, qark; në kuptimin pezhorativ: mjedis i prapambetur, p.sh. “tamni vilajet” (botë e errësirës dhe e territ shekullor).⁵⁵

Këtu janë të domosdoshme plotësime të caktuara: së pari se ky është territor i një valiu, së dyti se vilajet do të thotë atdhe, vendlindje. (A. Shkaliq, Turcizmi..., 641) dhe së treti, se kjo ndarje e madhe administrativo-territoriale në vilajete faktikisht është në fuqi edhe sot në Turqi.⁵⁶

⁵³ Po aty, 1636.

⁵⁴ Për më shumë te: Mehmet Bećović, **O nekim orijentalnim nazivima u Novom Pazaru**, Novopazarški zbornik, 13/1989, 203-210).

⁵⁵ Po aty, 1733.

⁵⁶ Sipas Pasho Baku: **Fjalor enciklopedik**, Tiranë, 2002. 733

Në hapësirat e Turqisë evropiane janë të njohura vilajetet e Edrenesë, Selanikut, Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës. Në Turqi vilajetet ekzistojnë prej vitit 1866.

37. **Zahir** (arabisht), ithtar i shkollës islame (shekulli IX deri XIV) e cila kërkonte interpretim tekstual të Kur’anit dhe të Hadisit si burime të vetme të mësimin islam⁵⁷.

Termi i cituar islamik është shënuar dhe sqaruar shkurtimisht vetëm në këtë Fjalor. Fjala “zahir” në arabishte do të thotë “i qartë”, “i dukshëm”.

38. **Zeman** (arabisht), epokë, kohë në relacion të gjatë, vakt, stinë.⁵⁸

Fjala “zeman” shpeshherë shpjegohet me fjalën – kohë, -a. Përjashtimisht, te Vujaklia⁵⁹ në faqen 323 termi është shpjeguar si kohë, shekull, qindvjetësh, madje edhe vdekje, shuarje e jetës.

Edhe në literaturën shqiptare fjala “zeman” interpretohet si kohë, periudhë, epokë, e diku do të thotë edhe shekull.

Pas këtyre zërave më të rëndësishme për terminologjinë e përgjithshme dhe islamike, në Fjalorin e Aniqit gjejmë edhe terma të cilat i trajton gjithashtu nga pikëpamja e shkencave orientaliste dhe islamiste. Kështu p.sh., lidhur me termin **objava** (në fq. 896) autori thekson se ky është “njoftim publik për diçka, shpallje e drejtuar opinionit” e njëkohësisht “akt i besimit në shumë religjione”. Si shembull e merr besimin islam në Kur’an.

Më faqen 902, lidhur me zërin **obred**, jep shembujt e riteve romokatolike, grekokatolike, ortodokse, adventiste dhe të riteve të tjera, e gjithashtu edhe të riteve islame.

Në faqen 1792, lidhur me fjalën **vera**, tregon institucionet e jetës fetare në formë të organizuar, si fenë katolike, ortodokse, myslimane e të tjera.

⁵⁷ Po aty, 1783.

⁵⁸ Po aty, 1832.

⁵⁹ **Leksikon stranih reči i izraza**, Beograd 1954.

Është e mundur që në Fjalor të gjendet edhe ndonjë e dhënë, që tregon me çfarë serioziteti dhe gjithanshmërie autori i ka studiuar zërrat e shumtë.

Në veprën e tij gjejmë dhe shumë nocione, terma e zëra, p.sh., nga jeta e mjedisëve të tjera dhe të popujve të tjerë. Kështu ai, në fq. 1461, përpos fjalëve **Srbija, Srbin**, shpjegon shkurtimisht termat: **Srbadija** (të gjithë serbët, serbizmi), **srbenda** (ai që në serbizmin e vet është agresiv), **Srbijanac** (serb nga Serbia), **srbijanski** (që ka të bëjë me Serbinë dhe serbët), **srbizacija** (akt i serbizimit, serbizimi, serbizimi i pjesëtarëve të popujve të tjerë), **srbizam** (element i njohshëm i gjuhës serbe i marrë në ndonjë gjuhë tjetër), **srbizirati** (zbatimi i serbizimit, të bërit që diçka të jetë serbe, që të marrë karakteristikën e serbizimit etj.), **srbovati** (shprehje imponuese e ndjenjave nacionale serbe). Analiza të ngjashme ka dhënë edhe për vende e kombe të tjera, p.sh., për kroatët, si janë: **hrvaština, Hrvatina, hrvatovati, hrvatskije, hrvats-tvo** etj. (Shiko faqen 418).

Academician Jashar Rexhepagiq

ISLAMIC TERMINOLOGY IN THE CONCISE DICTIONARY OF THE CROAT LANGUAGE

(Summary)

Among the main characteristics of the Concise Dictionary of the Croat Language is the fact that a large number of terms and notions related to Islamic doctrine and terminology have been included in it.

These terms have been presented properly.

Most of these terms originate from the Arab language. We have come in contact with these terms via the Turkish language and literature in this language.

ياشار رجبأغيش

المصطلحات الاسلامية في أحدث كتاب باللغة الكرواتية

(خلاصة البحث)

لقد تم معالجة عدد من المفردات و التسميات و المصطلحات التي لها علاقة بمجال الفكر الاسلامي و ذلك في "المعجم الكبير للغة الكرواتية" الذي صدر حديثا بمدينة زغرب.

لقد تم طرح المادة و معالجتها معالجة علمية بحتة و بموضوعية تامة. ان غالبية المفردات التي تم التطرق اليها و دراستها هي كلمات تمتد إلى جذور عربية. تلك المفردات جاءت إلينا عن طريق الادب الذي تداول الائمة و شيوخ الطرق الصوفية و في الغالب وصلت إلينا بواسطة اللغة التركية و الادب التركي.

KUMTESË

Dr. Pajazit Nushi

TERMI “SHPIRT” DHE DERIVATET KONCEPTUALE E GJUHËSORE TË TIJ NË PSIKOLOGJINË E FESË ISLAME*

Hyrje

Psikologjia përgjithësisht, sidomos psikologjia e religjionit, veçanërisht psikologjia e fesë islame ka filluar të zhvillohet vonë, madje shumë më vonë sesa janë zhvilluar fetë monoteiste dhe teologjia e judaizmit, e krishterimit dhe e islamizmit. Në të vërtetë, teologjia e secilës nga fetë e përmendura ka nocione dhe terma të psikologjisë. Ndër konceptet dhe termat e këtilla shpirti dhe dukuritë shpirtërore janë ndër më të vjetrat.

Psikologjia e religjionit, duke përfshirë edhe psikologjinë e fesë islame në shqipe, duke kërkuar dhe ndërtuar sistem koherent konceptesh e termash dhe lidhje logjike ndërmjet tyre, ballafaqohet me domosdonë e njohjes, të përcaktimit të përmbajtjes dhe të emërimit të shpirtit, të proceseve shpirtërore, të funksionit dhe të manifestimit të

tyre në jetën e gjithmbarshme të njeriut. Konsideroj se pa përcaktim të këtyre konceptit dhe të termit shpirt dhe të sistemit të zbatimit të tij në të folur, sidomos në të shkruar, vështirë se mund të përshkruhet dhe të shpjegohet esenca, zanafilla, funksioni, vlera dhe zhvillimi i fesë dhe i sjelljeve fetare të njeriut. Po ashtu, pa saktësim të këtyre termave edhe më vështirë mund të përshkruhet dhe të shpjegohet zhvillimi i mendimit për fenë, ku koncepti dhe termi shpirt është ndër nocionet më të rëndësishme, përkatësisht termat qendrore.

Termi shpirt është ndër termat e lashtë; ky term ka përdorim relativisht të dendur në shprehjet e mendimeve, të ndjenjave dhe të llojeve të ndryshme të aktiviteteve të njeriut. Në përdorim të deritashëm të termit shpirt dhe të termave që kanë për bazë të formimit të tyre termin shpirt (shpirtlig, shpirtëzim, shpirtëror etj.) janë shfaqur lajthitje. Në këto lajthitje termi shpirt dhe termat e proceseve shpirtërore dhe domethënia e tyre shpesh janë trajtuar terma me domethënie të barasvlershme me termat frymë, vetëdije, ndjenjë, frymëzim, madje edhe me termin temperament¹.

Psikologjia e fesë islame ka për detyrë të japë përgjigje në tri pyetjet kryesore: 1. çfarë është shpirti? 2. përse është i këtyre? si është zhvilluar mendimi për të dhe si janë zhvilluar sjelljet fetare të islamikut?. Pa përgjigje në këto pyetje, që përcaktojnë statusin shkencor të secilës disiplinë dhe të terminologjisë së saj, psikologjia e fesë islame vështirë mund të bashkërenditet ndër disiplinat e tjera të psikologjisë. Megjithatë përgjigja në disa nga pyetjet e shtruar i tejkalon caqet e shqyrtimit të shprehjeve profesionale, teknike e gjuhësore të psikologjisë së fesë islame, konsideroj se vlen të merremi edhe me njërin ndër çështjet më të rëndësishme të mendimit filozofik e psikologjik dhe të terminologjisë islame, sikurse është shpirti, sidomos marrëdhënia e tij me trupin.

* Kjo kumtesë është lexuar në tryezën shkencore me titull “terminologjia Islame” të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë më 10 nëntor 2005.

¹ Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, Botimet Tona, Tiranë 2002, fq. 1 281.

Psikologjia – shkenca mbi shpirtin

Sikurse është e njohur, psikologjia qysh nga ditët e para të zhvillimit të saj është përcaktuar si shkencë që studion shpirtin. Njohja e të vërtetës ose e të vërtetave për shpirtin, për proceset shpirtërore dhe për sjelljet shpirtërore të njeriut të fesë islame do duhej të jetë lëndë e psikologjisë së fesë islame. Mirëpo, që në fillim të përcaktimit të objektit të studimit të psikologjisë së fesë islame hasim në vështirësi dhe në pengesa metodologjike gati të pakapërcyeshme. Mendimi i vërtetë për shpirtin do të thotë përputhje e tij dhe bindje e njeriut për qenien e shpirtit. Ndërkaq, qenia e shpirtit dhe e mendimit të njeriut për ekzistencën, fillin e zhvillimit, mënyrën e funksionimit të tij etj., nuk ka mundësi të provohet dhe në mbështetje të rezultateve të të provuarit të tij të pohohet ose të mohohet ekzistenca, zhvillimi dhe funksionimi i shpirtit. Spiritizmi në përgjithësi dhe teologjia islame, sikurse edhe psikologjia e fesë islame nuk kanë arritur të provojnë ekzistencën substanciale, shfaqjen dhe funksionimin e drejtpërdrejtë të shpirtit. Madje, në Kur'an është shkruar: “Të pyesin Ty për shpirtin (i drejtohet All-llahu Muhamedit a.s., thuaj: “Shpirti është krijuar me urdhrin e Zotit tim, e juve ju është dhënë vetëm pak dijeni (se dijenia e plotë është vetëm e Perëndisë)”². Po ashtu, në këtë përkthim të Kur'anit thuhet: “Pastaj e ka krijuar atë (njeriun) dhe i ka dhënë gjallëri, me frymëzim të Tij. Ai iu ka dhënë të dëgjuarit, të parit dhe të menduarit, - e sa pak prej jush jeni mirënjohës”³. Këto thënie të Kur'anit kanë shkaktuar te disa studiues besimtarë heqje dorë nga gjurmimi themeltar i shpirtit dhe i dukurive shpirtërore. Ndërkaq, nga ana e disa studiuesve të tjerë të psikologjisë, pamundësia metodologjike e të provuarit të substancës së shpirtit dhe të funksioneve të tij ka kërkuar angazhim serioz në zbulimin dhe në njohjen e atyre proceseve psikike të vetëdijshme të njeriut, tërësia e të cilave emërtohet me termin shpi-

² Prof. Hasan I. Nahi: “Kur’ani i Madhëruar”, El Israë, 85, Prishtinë, 1988, fq. 291.

³ Po aty, Es Sexhde, 9, fq. 416.

rt. Në këtë rrafsh dallohen studiuesit e psikologjisë së fesë islame të Egjiptit.

Megjithëkëtë, të arriturat në këtë pikëpamje janë të kufizuara. Ndërkaq, termi shpirt ka përdorim të zakonshëm, sidomos në komunikimin kolokvial jo vetëm në gjuhën shqipe. Në teologji, sikurse edhe në disiplinat e studimeve islame, si janë “Tasavuf” (misticizëm), “Fikh” (e drejta islame), Sheriat (ligji i All-Llahut), etj. termi “shpirt” ka status të qëndrueshëm. Në disiplinat e psikologjisë bashkëkohore përdoret gjithnjë e më rrallë meqë sot psikologjia, në kuptimin e gjerë të saj, përkufizohet shkencë mbi sjelljet. Përrjashtim nga këto disiplina të psikologjisë së sotme bëjnë psikologjia e moralit, psikologjia e fesë, nga të cilat ndahet metapsikologjia. Meqë është nocion dhe term themelor edhe i psikologjisë islame, term prodhues në gjuhësi me modalitete fjalëformuese të ndryshme, term me shkallë relativisht të lartë të qëndrueshmërisë dhe të përdorimit të tij etj., kurse domethënia e tij është e problematizuar, përdorimi i tij, pa marrë parasysh kontekstin e zhvillimit të mendimit, paraqet një çështje të rëndësishme për psikologjinë e fesë islame dhe për terminologjinë e saj.

Statusi leksikografik dhe semantik i termit “shpirt” në psikologji dhe në psikologjinë e fesë islame

Në gjurmimin e burimit të nocionit dhe të termit “shpirt” konstatohet se në mendimin filozofik që nga koha e lashtë “shpirti” ka qenë ndër nocionet qendrore. Mjafton të përmendim pikëpamjen e mendimtarëve të vjetër grekë prej Alkemonit, Demokritit dhe Epikurit e deri tek Aristoteli dhe vepra e tij “Për shpirtin” për të dalluar orvatjet e panumërta që nga mendimet e para për njeriun dhe për shpirtin e tij për të përcaktuar kuptimin e termit shpirt, funksionin e shpirtit, raportin shpirt-trup etj.

Nga filozofia nocioni dhe termi shpirt është bartur në psikologji duke mos ndryshuar jo vetëm pozicionin e nocionit dhe të termit qendror edhe në këtë disiplinë, por duke u bërë emërtues i gjithë asaj që

studion psikologjia. Pozicionin e këtyllë e dallojmë edhe në leksikon e psikologjisë, sepse fjala ballore e greqishtes së vjetër “Psikologji”, kur zberthehet në domethënien e fjalës Psyche = shpirt dhe logos shkencë = shkenca për shpirtin e argumenton pozicionin e nocionit dhe të termit qendror të psikologjisë. Nocioni dhe termi psikologjik e ka ruajtur pozicionin dhe statusin leksikografik edhe sot. Termi shpirt, psikë, psikikë, psikologji etj., ka ngelur i pandryshuar në strukturën dhe në morfologjinë leksikore të shqipes edhe sot.

Psikologjia e dikurshme, që është përcaktuar sipas sqarimit leksikografik të termit psikologji - shkenca për shpirtin, sot përkufizohet shkencë për sjelljen. Kjo ikje e psikologjisë në përdorim të termit shpirt më tepër mund të shpjegohet nga pamundësia e të provuarit eksperimental të ekzistencës së shpirtit, të formave të shfaqjes, të matjes dhe të vlerësimit kualitativ të proceseve, të gjendjeve dhe të tipareve karakteristike të dukurive shpirtërore. Mbisundimi i metodave objektive të studimit, të argumentimit të qenies së shpirtit, të funksionimit, të formave të shfaqjes dhe të vlerësimit kuantitativ dhe kualitativ të dukurive shpirtërore ose psikike dhe zhvillimi i degëve të psikologjisë aplikative në edukatë, në shëndetësi, në industri etj., kanë shkaktuar përdorimin gjithnjë e më të paktë të termit shpirt duke e lënë përdorimin e këtij termi më tepër në komunikim të përditshëm se në terminologji të psikologjisë. Megjithatë, në historinë klasike të psikologjisë, në antropologji, në etnologji, në etikë etj., termi shpirt ka përdorim të zakonshëm, por me domethënie të ndryshme, ku domethënia e tij mund të nxirret më lehtë nga konteksti i rrjedhës së mendimit.

Në psikologjinë e fesë islame termi “shpirt” dhe domethënia e tij ka ngelur të thuash i pandryshueshëm, kurse dijenia për të është e paktë dhe e pamjaftueshme për të ngritur psikologjinë e fesë islame si në pikëpamje substanciale ashtu edhe në pikëpamje funksionale në nivel të një disipline me nocione dhe me terma, me rregullsi dhe me ligjësi të mendimit koherent për shpirtin. Për shkaqet e përmendura, psiko-

gjia e fesë islame sot ka arritur më tepër të krijojë një sistem koherent të mendimit dhe të terminologjisë së nocioneve të saj në fushën funksionale e shumë më pak në fushën substanciale të shpirtit dhe të dukurive shpirtërore. Pikërisht falë të arriturave në njohjen e sjelljeve fetare të njeriut, e jo në fushën e njohjes së substancës e të qenies së shpirtit, psikologjia e fesë islame ka arritur të formohet fushë e psikologjisë me terminologji në zhvillim të sistemit të nocioneve të saj.

Qasja studimore e nocionit dhe e termit shpirt

Në psikologjinë e feve përgjithësisht kërkimi i burimit të nocionit dhe i termit “shpirt” shpie në teologjinë e fesë së caktuar, përkatësisht në shkencën për “Zotin”, ku nuk polemizohet për qenien e tij, por ai dhe shpirti i njeriut i ardhur nga Zoti mund të njihet vetëm me njohjen e besimit të njeriut në Zotin e tij. Meqë secila nga fetë monoteiste e ka zotin e vet (Judaizmi-Juden, Krishterimi-Jezusin, Islamizmi-All-Llahun) Zoti i secilës prej këtyre feve është burim i shpirtit të njeriut; rrjedhimisht All-Allahu për myslimanin është Ai, që, sikurse thuhet në Kur’an: “Dhe kur Unë ta plotësoj atë dhe t’i jap frymë prej shpirtit tim (kur t’i jap jetë), bëni sexhde atij”⁴. Sipas këtij pohimi këto dy nocione janë jashtë kategorive objektive dhe të pamundshme të njihen me anë të njohjes shqisore dhe racionale të njeriut. Për këtë shkak, për termin shpirt dhe për domethënien e tij, mund të flitet nga këndvështrimi metapsikologjik dhe psikologjik.

Psikologjia e religjionit i qaset studimit të shpirtit dhe fenomeneve shpirtërore duke u mbështetur në metoda objektive dhe duke u nisur nga baza konceptuale, që është raporti shpirt-organizëm. Në kuadër të kësaj baze konceptuale dhe duke u mbështetur në metoda e procedura objektive shpirti u studiua në tri aspekte të funksionit të tij: *1. nga aspekti i raportit të dinamikës mentale, ku çështje kryesore është raporti shkak-rrjedhim, përkatësisht shpirt – sjellje e njeriut, 2. nga aspekti i*

⁴ Po aty, kapitulli a surja “Sad”, verseti 29, fq. 458.

topografisë mentale, ku çështja u shtrua drejt njohjes së pozicionit të shpirtit në strukturën mentale e trurorë dhe 3. nga aspekti i funksioneve mentale, me të cilin rast çështje e diskutueshme është çfarë funksionesh mentale kryen shpirti dhe si i kryen këto funksione?

Në kuadrin e studimit të këtyre aspekteve të fesë islame psikologjia ka arritur të njohë sjelljet e besimtarit islam, zhvillimin, motivet dhe modifikimet e sjelljeve të islamikut, sikurse edhe integrimet e këtyre sjelljeve në tipare karakteristike të personalitetit dhe të karakterit të tij. Gjatë njohjes së tyre psikologjia e fesë islame edhe në shqipe ka arritur të formojë një grup të veçantë termash dhe të orvatet të krijojë një sistem pak a shumë të qëndrueshëm të termave të kësaj fushe të psikologjisë. Në këtë kuadër psikologjia e fesë islame në shqipe bën fjalë për tiparet e personalitetit të islamikut, për karakterin e islamikut, qëndrimet e islamikut ndaj Zotit, ndjenjat fetare e morale të tij, për pikëpamjen e tij për gjithësinë dhe fenomenet e ndryshme fizike, biologjike, sociale e psikologjike të njeriut etj. Këto dhe shumë terma të nocioneve gjegjëse të tyre kanë arritur të stabilizohen në terminologjinë shqipe të psikologjisë së fesë islame. Ndërkaq, termi “shpirt” ka ngelur term me domethënie të pakapshme në kuadrin e tri aspekteve të përmendura. Për këtë arsye dallojmë qasjen metapsikologjike dhe qasjen psikologjike të studimit të shpirtit dhe të proceseve shpirtërore, sikurse edhe të emërtimit të tyre.

Pozicioni dhe domethënia metapsikologjike e termit “shpirt”

Nga teologjia islame mësojmë se fjala arabe *ruuh*, herë-herë edhe fjala *nefs*, në gjuhën shqipe janë përkthyer me fjalën *shpirt*. Mendimtarët islamikë të lashtë, me gjithë kufizimet kur’anore për shqyrtim dhe njohje të shpirtit, sepse “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit...” janë marrë me studimin e shpirtit. Ndër mendimtarët e vjetër të fesë islame, që u dalluan me pikëpamjet e tyre për shpirtin, janë: Gazali, Avicena, Rumi etj.

Ebu Hamid El-Gazal (1058-1085) për shpirtin ka thënë: “Shpirti në vete përmban gjallëri, jetë, freski e kënaqësi, e gjallëron trupin, e kontrollon, e rregullon dhe e dirigjon atë. Trupi është instrument dhe bartës i shpirtit...”⁵.

Mendimtari i njohur islam Abu-Ali Ibn Sena, përkatësisht Avicena, natyralist dhe mjek arab (980-1037) ka pohuar ekzistencën e pesë llojeve të shpirtit: 1. Shpirti i gjërave të ngurta, që te njerëzit e përfaqësojnë eshtrat, 2. Shpirti i bimëve, te njerëzit përfaqësohet me mëlçinë e zezë, 3. Shpirti i kafshëve, të cilin te njeriu e përfaqëson zemra, 4. Shpirti njerëzor, që përfaqësohet me intelektin dhe me ndërgjegjen e njeriut dhe 5. Shpirti i bekuar, që është dhuratë e All-Llahut për besimtarët islamë të sinqertë⁶.

Enciklopedisti i urtësisë së jetës shpirtërore Xhelaluddin Rumi (1207-1273) ka folur për lidhjen e njeriut me format dhe me funksionet e shpirtit. Sipas tij, shpirti i njeriut paraqet konstitucionin dhe tipin, pesë shqisat e jashtme dhe të brendshme të lidhura me qendrat e tyre në sistemin nervor qendror, kuptimin e lidhur me intuitë dhe me aftësi të njeriut, gjendjen e ndryshuar të aktivitetit të njeriut (njeriu në gjumë dhe jashtë tij), gjendjen e frymëzuar të njeriut dhe në fund gje-

⁵ Prim. dr. med. sci. Ali F. Iljazi, Kur’ani dhe shkenca bashkëkohore, Gjakovë, 2000, fq.466.

⁶ Po aty, fq. 468.

ndjen e të vërtetave, që njeriu nuk mund t'i njohë, sepse ato i takojnë fuqiplotit⁷.

Nga këto pohime të mendimtarëve të lashtë islamikë shohim se teologët islamikë janë marrë me studimin e shpirtit dhe kanë sajuar nocione dhe terma të gjuhëve orientale. Disa nga nocionet dhe termat e tyre janë bërë pjesë e terminologjisë shqipe të psikologjisë klasike të mbarimit të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe të fillimit të shekullit njëzet, kurse sot kanë ngelur kryesisht pjesë e leksikut të psikologjisë popullore të islamit.

Një numër fjalësh dhe termash të këtilla të kësaj psikologjie kanë depërtuar edhe në gjuhën shqipe. Të këtilla janë fjalët: abdest, ah, ahenng, alamet, Allah, amanet, amin, amshim, arnaut, ashik, averoizëm, avicenizëm, baba, bajraktar, bektashizëm, bela, beqar, bezdisje, bilm-ez, bismil-lah, budalla, deli, dembel, dert, derman, dervishizëm, devshirme, ejvalla, enkas, fakir, efendi, fetfa, fidai, fikhi, fiqir a fiqer, fukara, gazep, gajret, gjoks, gjynah, hadith (hadis), hall, hasmëri, hashura ose ashura, hatër, hiç, iman, inat, jetim, insan, islamizëm, kësm-et (kismet), kodosh, lazëm, lezet, majmun, llafazan, marak a merak, maraz, marifet (zotësi), matuf, medet, meleq (engëll), meskin, muhamedan, muhaxhir, mysafir, mysliman, nazeli, nef(p)si, qejf, rehati, sebeb, sefa, selam, selam alejkum, sevda, sifet (virtyt, sjellje, ves), siklet, shaka, vesvese, ters, tefsir, ujdj, uzdaj, vardisje, xhelat, xhind, zahmet, zanat, zapt, zët, zor, Zot, zullum etj. Ndër këto fjalë të lidhura me domethënien e shpirtit disa kanë marrë statusin e termit të psikologjisë së fesë islame. Këto janë: Allah, amshim, averoizëm, avicenizëm, bektashizëm, bezdisje, dembeli-a, dervishizëm, devshirme, fukara, hadithet, hasmëri, inat, jetim, islamizëm, majmun, llafazan, merak, matuf, siklet, shaka, vardisje, xhelat, Zot etj.

Disa nga nocionet dhe termat e përmendura kanë karakter nocionesh abstrakte. Ndër nocionet e këtilla është edhe nocioni shpirt. Domethënia e këtij termi është reflektuar edhe në nocionet konkrete, që

janë emërtuar me terma islame dhe janë mbartur në gjuhën shqipe. Reflektim të këtillë hasim sidomos në antroponimi të shqiptarëve.

Shpirti dhe antroponimia islame e mbartur në gjuhën shqipe

Domethënia metapsikologjike e fjalës shpirt, përkatësisht e termit “shpirt” të turqishtes a të arabishtes ka pasur ndikim të fuqishëm në antroponiminë e shqipes. Shumë emra dhe mbiemra në shqipe kanë ardhur nga arabishtja dhe turqishtja me domethënien bazë të termit të shpirtit ose të ndonjë funksioni të tij. Meqë antroponimet e shqipes, të ardhura nga arabishtja e turqishtja, i kalojnë caqet e temës sonë, më poshtë do të vë në dukje vetëm disa nga antroponimet më të stërpikura dhe të lagura me domethënie të shpirtit ose të funksioneve të tij dhe që kanë përdorim të shpeshtë në shqipe.

Antroponime të këtilla janë: Abdullah - me shpirt të shërbyesit të Zotit, Adem - njeri, Behxhet - freski e bukurisë, Bejaze - e bardha, më shpesh me shpirt të bardhë, Dervish - i tërhequr në varfëri dhe në përvuajtëri, Dilaver - trim, Emin - i besueshëm, Eshref - fisnik, Fadil - i vlefshmi, Faik - i zgjedhuri, Hamdi - i falënderuari, Hasan - bukursh, Ibadete - të mësuarit për Zotin dhe falja ndaj Zotit, Ismet - i mbrojturi, Islam - i dhënë pas Zotit, Kadri - i fatit, Kasem - ndarës, Kahreman - kreshnik, trim, Latif - i butë, i pashëm, Lutfi - mirëbërësi, Mahmut - i falënderuari, Mazllum - modest, Mehdi - i rrugës së mbarë, Myrvet (njerëzi, bujari), mysliman, Naile - fituese, Naim - i butë, Nuredin - besimi i ndritshëm islam, Pejgamer, Qamil (i pjekur, i provuar), Qemal - pjekuri, përsosmëri, Ramiz - i shkathët në të folur, Rashid - i dhënë pas Zotit, Ragib - ai që mban shpresë, Sadik - i saktë, Salih - shpirtmirë, Serbeze - e lirë, e pafrikueshme, ballëhapët, Shaqir - falënderues, Shefki - me pasion të flaktë, Tahir - i pastër, Teufik - përkrahës i Zotit, Vehbi - i prirë nga Zoti, Vehab - rob i Zotit, Zeqir - ai që ka kujtesë të fortë, Zeki - mendjemprehtë, Zihniye - e talentuara etj.

⁷ Po aty, fq. 472.

Termi “shpirt” dhe domethënia e tij në terminologjinë e psikologjisë bashkëkohore të religjionit

Në psikologji termi “shpirt” emërton tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme të njeriut, kurse sintagma “shpirti fetar”, sidomos termi “vetëdija fetare”, ka domethënie të tërësisë së ndërlikuar të përjetimeve fetare të individit, ku hyjnë bindjet, ndjenjat, paragjykimet, pasionet, pikëpamjet, qëndrimet dhe sentimentet fetare, sikurse edhe tiparet e personalitetit dhe të karakterit të qytetarit fetar duke përfshirë edhe qytetarët e fesë islame. Këto janë terma të psikologjisë funksionaliste dhe, si të këtilla, kanë status të qëndrueshëm edhe në psikologjinë e fesë islame. Sintagmat e tipit “shpirt fetar”, “vetëdije fetare”, “bindje islame” etj., mund të jenë ndër më të ndryshmet, si, bie fjala, interesim religjioz, pikëpamje fetare, qëndrim islamik, paragjykimet fetare, karakter fetar, sinqeriteti i denjë religjioz, vetëpërbajtje islame, zemërgjerësi muhamedane, islamizmi i hershëm etj. Kërkesat e zhvillimit dhe të formimit të tipareve të besimtarit islam mund të shprehen me terma të tipit sintagmë në mënyrë më të saktë. Kështu, mund të cilësohet vetia e karakterit të besimtarit islam me termat: dashuria ndaj së vërtetës, toleranca fetare, çiltëria islame, sinqeriteti i besimtarit islam, guximi islamik, skofia islame etj. Termat sintagma kanë stabilitet më të fortë në terminologjinë e psikologjisë islame se termi shpirt.

Në psikologjinë bashkëkohore termi shpirt po zëvendësohet shkallë-shkallë me termin psikë. Termi psikë në psikologjinë bashkëkohore është zhveshur nga domethënia metapsikologjike, sepse psikologjia ka marrë drejtim të zhvillimit objektiv. Ky drejtim zhvillimor dallohet edhe me përkufizimin e objektit të psikologjisë, dhe sot, sikurse përmendëm, *objekti i studimit të saj janë sjelljet e individit, që kanë karakter perceptues, që kontrollohen, maten, vlerësohen, verifikohen, shpjegohen dhe formësohen gjuhësisht në mënyrë të kuptueshme*. Pa përmbushje të këtyre kriterëve psikologjia, sikurse edhe disiplinat e tjera shkencore, nuk do të mund të ekzistonte si disiplinë e pavarur e shkencës. Zhvillimi i saj sot mbështetet në të dhëna e fakte të qenësi-

shme dhe empirike, që u nënshtrohen provave të organizuara në mbështetje të zbatimit të metodave hulumtuese. Këto të dhëna e fakte kanë të bëjnë, në rend të parë, me reagime dhe me sjellje konkrete të individit në kushte dhe në situata të caktuara fizike, organike, sociale, fetare e psikike dhe me raporte të posaçme të këtyre kushteve e situatave.

Në mjedisin e kulturave të niveleve të ndryshme ekziston pikëpamja se shpirti ekziston në brendinë e trupit të gjallë. Një pikëpamje e këtillë ka të bëjë edhe me aktualizimin e paralelizmit psikofizik, që rrjedh që nga dualizmi i Dekartit, sipas të cilit, shpirti është substancë që mendon, për ndryshim nga substanca që ka kuptim më të gjerë - nga trupi. Më këtë pikëpamje u aktualizua dhe më tepër një çështje serioze në filozofi dhe në psikologji: çështja e raportit shpirt-trup, që është ndër çështjet dominuese të mendimit njerëzor edhe sot. Vilhelm Vunt (1832-1920) – themelues i psikologjisë empirike - ka pohuar se “nuk ekziston substanca shpirtërore, jomateriale, e përhershme dhe e mëvetësishme”. Të këtij mendimi kanë qenë edhe disa mendimtarë të tjerë nga psikologjia, ndër të cilët edhe Teodor Fehner (18081-1887). Në psikologjinë bashkëkohore substanca e shpirtit gjen mbështetje në funksionimin e sistemit nervor qendror dhe ndikimin e mjedisit social në zhvillimin e tij dhe të sjelljeve të individit. Në këtë shpjegim është ndier ndikimi i madh i rrymës së reflektologjisë së Vladimir Behterievit, I. Pavlovit dhe, sidomos ndikimi i madh i rrymës biheviariste dhe neobiheviariste.

Biheviarizmi, sidomos neobiheviarizmi, i referohet domosdosë së studimit të fakteve psikike të kapshme me shqisat dhe me arsyen e të tjerëve dhe të kontrolluara nga të tjerët duke përfshirë më vonë edhe zhvillimin e kibernetikës dhe të informatikës, ku përpunimi i informacioneve dhe vënia në lëvizje e vetvetes, sikurse edhe kontrollimi i lëvizjeve mbështetet në një sistem fizik të provuar dhe të argumentuar. Nga mendimi i tyre sot në anglishte përdoret termi “mind” në domethënien e mendjes dhe të sjelljeve të lidhura me mendjen, që dallohet nga termi “soul” a shpirt. Nuk ndodh kështu në disa gjuhë të tjera, bie fjala, në gjermanishte (“die Seele”), në frëngjishte (“ame”) dhe në shqipe, ku termi shpirt përdoret në literaturën e psikologjisë bashkë-

kohore. Mirëpo, përdorimi i tij është i nivelit dukshëm më të ulët se në tekstet e psikologjisë së fillimit të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të.

Pas rezultateve të psikanalizës së Zigmund Frojdit nga dekada e parë e qindvjetëshit njëzet, sidomos të asaj të Karl G. Jungut, terminologjia e psikologjisë ka pësuar ndryshime dhe plotësime të mëdha. Z. Frojdi ka nxitur zhvillimin e psikologjisë me konceptin dhe me termin kapital të “pavetëdijes” dhe të *dinamikës së pavetëdijes*, kurse K.G. Jung ka shtrirë konceptin e pavetëdijes edhe në *sferën e pavetëdijes kolektive*. Duke u mbështetur në këto zbulime të rëndësishme edhe psikologjia e ka shtrirë lëndën e studimit të saj jo vetëm në tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme, kur dominonin nocionet dhe termat e lidhura me termin bazë “shpirt” dhe së bashku me të edhe nocioni e termi “besim fetar”, por edhe në atë të pavetëdijshme dhe në dinamikën e pavetëdijes. Këta dy mendimtarë kanë nxitur më tepër zhvillimin e metodave gjurmuese të përmbajtjes së pavetëdijes e të dinamikës së saj, sepse, për disa forma të shfaqjes së pavetëdijes, sikurse janë: gjumi, ëndrrat, paravdekja e njeriut e të tjera – në fenë islame kanë qenë të njohura që nga koha e profetit Muhamed.⁸ Më këtë zgjerim termi “shpirt” i psikologjisë intraspeksioniste dhe strukturaliste u bë i pamjaftueshëm për të shprehur tërësinë e psikës dhe të formave të shumëllojshme të dinamikës së saj. Nga ana tjetër, përhapja e bihevizimit në psikologji ka shkaktuar nxjerrjen jashtë përdorimit të termave shpirtërore dhe mentale, sikurse edhe rezultatet e gjurmimeve introspektive të shpirtit.

Meqë në psikologji, sikurse edhe në disiplinat e tjera të shkencës, nuk mund të ketë të vërteta të pandryshueshme dhe përfundimtare, kjo ka korrigjuar e plotësuar sistemin konceptual të saj duke përsosur njëkohësisht sistemin e shprehjes gjuhësore të këtij sistemi. Pasojë e një zhvillimi të këtillë janë ndryshimet e mëdha në terminologji të psikologjisë, ku termi shpirt gjithnjë e më shumë po ngel në grupin e termave të psikologjisë introspektive dhe të historisë së zhvillimit të saj deri

⁸ Prof. Hasan I. Nahi, vep. e cituar, verseti Ez-Zumer, 42, fq. 464.

kah mbarimi i gjysmës së parë të shekullit njëzet, por term i lëkundshëm pas mbarimit të gjysmës së parë të këtij shekulli. Në këtë fazë të zhvillimit të psikologjisë termi “shpirt” ka emërtuar tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme të njeriut dhe në këtë kuadër edhe strukturën e besimit fetar të njeriut.

Në veprat e terminologjisë më të re të psikologjisë në anglishte, sikurse kemi përmendur, termi shpirt “soul” nuk është shtjelluar⁹, por në vend të tij është vënë termi “mind”, përkatësisht “mendje”, kur shpjegohet problemi “mind-trup”, që ka zënë vend shtjellues të posaçëm¹⁰. Por, edhe në veprat e psikologjisë bashkëkohore në anglishte termi “soul” përmendet rrallë¹¹.

⁹ Oxford Dictionary of Psychology, Andrew M. Colman, Oxford University Press, 2005.

¹⁰ Po aty, fq. 450

¹¹ Carole Wade-Carol Tavis, Psychology, Seventh Edition, Pearson Education LTD., London, 2005.

Pajazit Nushi

THE TERM "SPIRIT" AND ITS CONCEPTUAL AND LINGUISTIC DERIVATES IN THE PSYCHOLOGY OF ISLAM

(Summary)

The results of research activities on human behavior have created the need for further neurophysiologic and neuropsychological studies. According to Rene Descartes, the brain is the principal seat of the soul. Nowadays, the latter is not disputed at all. The front lobe of the brain and the thalamus were considered the principal seats of the soul, which regulate human behavior.

بايازيت نوشى

مصطلح "النفس" و مشتقاته اللغوية في علم النفس الاسلامى

(خلاصة البحث)

إن نتائج دراسة سلوك و تفكير الانسان تؤدي حتما إلى دراسة نفسيه الانسان اذ كما هو معروف منذ عند ديكارب فان العقل هو الذي يقوم بالرعاية الكاملة للحياة النفسية. و ليس هناك أي شئ في هذا الامر، و في نفس الوقت يقوم الجزء الامامى للعقل بالمحافظة على تحمل التوازن لسلوك الانسان. و فيما يتعلق بكيفية عمل الاجزاء المختلفة للعقل فانه من المستبعد القول بان مركز النفس موجود في وسط العقل البشرى من حيث يتم تنظيم الحياة النفسية للانسان و تصرفاته و فقا للمعايير الذنبية.

HISTORIOGRAFI

Fitim Flugaj

MEHMET ALI PASHA, PERSONALITET SHUMËDIMENSIONAL

(Qasje në tekstet shkollore të lëndës së historisë në shkollat
e Egjiptit¹ dhe në librin Muhamed Ali Pashai të autorit libanez
Xhorxh Zidani², për ndriçimin e personalitetit
të Mehmet Ali Pashait shqiptar)

Është fare e zakonshme që kur një personalitet studiohet nga shumë studiues, të na paraqitet edhe shumëdimensional, por shtrohet pyetja se a ishte vërtet ashtu Mehmet Aliu?

Përgjigjja ime do të ishte se po. Kur lexojmë tekstet shkollore të Egjiptit, hasim vetëm te një burrshtetas të fuqishëm, i cili arriti të vendosë themelet e një shteti modern, në një vend që na paraqitet si shtet me institucione shtetërore, qysh para shtatë mijë vjetëve. Por, ky modernitet bazohet kryesisht në reformat e bëra nga Mehmet Ali Pashai,

¹ Historia e klasës V, VII dhe e mesme II dhe IV.

² Xhorxh Zidani është nga historianët dhe shkrimtarët ma të njohur arab që e ka studiuar dhe ka shkruar për Mehmet Ali Pashain, sidomos ka shfletuar arkivat dhe ka gjetur mjaft shumë nga dokumentet që kanë të bëjnë me mardhëniet ne mes Mehmet Ali Pashait dhe popullit libanez. Është autor i romanit historik për Muhamed Ali Pashain dhe i punimeve shkencore historike për Muhamed Aliun. Të cilat vepra i kamë studiuar.

në arsim, bujqësi, ushtri e të tjera, gjë që vërtet të bën që ta admirosh këtë strateg të madh. E sidomos kur i viziton muzetë egjiptiane, si atë ushtarak në kështjellën e Salahudinit ku prore qëndron edhe xhamia e këtij burrshtetasi të madh, e brenda saj në një qoshe të kësaj xhamie të punuar me kujdes dhe të veshur me alabastrin e që mbanë emrin “mesxhid Muhamed Ali basha el kebiir”³ pushon trupi i kësaj figure shumë të përfolur në mbarë botën, por shumë pak te ne, që jemi gjaku i tij. Mbi të gjitha, kudo që hyn nëpër muzetë egjiptiane do ta hasësh portretin madhështor të këtij strategu, të vendosur prore në krye të të gjitha figurave kombëtare egjiptiane. Ashtu do ta hasësh edhe nëpër biblioteka e universitete, në libra e tekste shkollore, nëpër kalendarë e kudo tjetër. Të gjithë e quajnë Muhamed Ali basha el kebiir⁴. Mirëpo, nuk mbetet kështu edhe nëpër librat tjerë historikë.

Fëmijëria e Mehmet Aliut

Kur i kthehemi fëmijërisë së tij, gjë që këtu unë do të bazohesha edhe në historianin, studiuesin dhe shkrimtarin e madh libanez, Xhorxh Zidani, i cili me një mjeshtri të rrallë na paraqet Mehmet Aliun si një fëmijë të llastuar dhe mjaft kryeneç, djali i vetëm i cili gëzonte privilegje të shumta brenda familjes së gjerë, e cila e kultivonte duhanin dhe ishte bërë mjaft e pasur nga kultivimi dhe tregtimi i tij. Kjo familje sipas të gjitha gjasave ishte shpërngulur nga fshati Zemlak⁵ i Korçës në Kavallë të Greqisë. Mirëpo, Mehmeti ishte këmbëngulës në realizimin e dëshirave të tij, qoftë edhe nëse rrezikonte jetën e vet. Ai na paraqet një djalosh temperament, i zgjuar, por gjithnjë kryeneç sa

³ Xhamia e Mehmet Ali Pashait

⁴ I gjithë populli egjiptian edhe më gjerë e njohin si Muhamed Ali pashai i madh ose madhështor, sepse la shumë vepra madhështore për Egjiptin. Është edhe varianti tjetër që thotë se shkaku i stërnipit të tij Princit Muhamed Ali Pasha, i pari quhet El-Kebiir “i madh” për dallim nga i dyti.

⁵ Për nder të vendlindjes dhe për ta përkujtuar i dha këtë emër ishullit ma të bukur që gjendet në mes të lumit Nil dhe që sot është lagja e aristokratëve egjiptian dhe e ambasadave të botës, kuptohet me deformime në theksim dhe quhet Zemalek.

që kundërshton të vazhdojë mejtepin apo shkollën e asaj kohe, kështu që ngel autodidakt në njohjen e shkrim-leximit por jo edhe në njohjen e jetës dhe sfidat e saj, derisa arrin të bëhet komandant i forcave osmane të përbëra nga ushtarët arnautë siç ishin të njohur shqiptarët në kohën e osmanlinjve, dhe që më vonë caktohet që të shkojë në Egjipt (Misirin e njohur te ne shqiptarët nëpërmjet shkrimeve të rilindësve tanë) të cilët kishin fatin që të jetojnë në Egjipt, si njerëz të një origjine me dinastinë mbretërore të këtij vendi, e që gëzuan mjaft privilegj, duke gëzuar një liri të gjerë veprimi.

Mehmeti i vogël që nga fëmijëria e hershme ishte nën kujdesin e gjithë fisit, babai i tij Ibrahim Aga e kishte të vetmin djalë, secili nga xhaxhallarët dhe të tjerët e llastonin Mehmetin dhe nuk i prishnin qejfin aspak. Si duket kjo edhe ndikoi që ai të ketë një ego të lartë dhe aspirata shumë të mëdha, të cilat me siguri e bënë një lider dhe strateg gjenial.

Mehmeti, si një djalosh mjaft i llastuar, kalon një rini përplot aventura e kthesa, këto aventura do të marrin fund dhe Mehmeti do të bëjë kthesë në jetën e tij atëherë kur vendosi që të shkojë në shërbimin ushtarak në ushtrinë osmane, edhe pse familja e tij e kundërshtoi një gjë të tillë dhe dëshironte që ta paguajë një person për të shërbyer në emër të Mehmetit, ai nuk pranoi dhe filloi shërbimin si një ushtar i thjeshtë, derisa për një kohë jo të gjatë u dallua nga kolegët e tij dhe filloi të ngjitet shkallëve të karrierës dhe famës. Ushtria osmane ishte e ndarë sipas gjuhës që fletej nga ushtarët e saj, sepse çështja nacionale ende ishte e panjohur në botë⁶.

Shqiptarët, sikur se edhe turqit, çerkezët, llazët, arabët e të tjerët ishin të ndarë në reparte sipas gjuhës që flitnin ashtu që komandimi i

⁶ Çështja nacionale bëhet e njohur me revolucionin borgjez francez. Perandoria Osmane ishte e ngritur mbi bazat e shariatit islam, e feja islame për ta ruajtur sa më mirë kompaktesinë e ithtarëve të saj shkon nga ajo që fisin ose kombin të mos e trajtojnë njerëzit si diçka të shenjët për të kaluar në ekstrem dhe për ta adhuruar atë, por vetëm si mjetë njohje dhe bashkëpunimi në mes njerëzve, dhe kurrsesi si nënçmim dhe urrejtje e mburrave. Prandaj edhe gjejmë personalitete të larta osmane me origjinë shqiptare.

tyre të bëhet më lehtë dhe që gjatë betejave të përdoren gjuhët e tyre, ashtu që të mos kuptojnë armiqtë për rrjedhën e luftës, kur dihet se armiqtë e Perandorisë Osmane e mësonin vetëm gjuhën turke për të spiunuar dhe kuptuar strategjinë osmane. Mehmeti i kishte kuptuar të gjitha, prandaj ishte shumë i zgjuar për t'i shfrytëzuar këto favore. Ai fitoi një besim të thellë dhe me talentin e tij të një strategu edhe ushtarak edhe politikë arriti që t'i përfitojë zemrat e komandantëve të tij qysh herët, ashtu që i shkoi nami deri te Sulltani. Si zakonisht Porta e Lartë, kur kishte ofensiva të rëndësishme caktonte që atje të shkojnë forcat e përbëra nga arnautët siç i quanin ata shqiptarët. Kështu ndodhi edhe në malet e Jemenit, dhe në malet e Libanit e shumëkund gjetiu, aty ku ishte vështirë aty ishin shqiptarët. Kur Turqia e kishte humbur vendin më të begatshëm në rruzullin tokësor, Egjiptin, valiu i saj kishte kaluar dhe ishte shndërruar në një servil francez.

Napoleon Bonaparta e kishte pushtuar Egjiptin me një ekspeditë të plotë ushtarake e shkencore. Ai me vete kishte marrë edhe njerëz të shkencës, shumica e të cilëve nuk u kthyen më në Francë por u ndalën në Egjipt, gjë që më vonë do t'i gjejmë nga ata që kontribuuan dhe i ndihmuan sundimtarit të ardhshëm të Egjiptit (Mehmet Ali Pashait) në zhvillimin e vendit. Sulltanit i duhej që patjetër atje të dërgojë nga trimat e shqiponjave për ta shpëtuar këtë pjesë kaq vitale të perandorisë, në krye të këtyre forcave ishte komandanti i spikatur Mehmet Aliu, i cili pasi e fitoi betejën kundër francezëve merr titullin pasha. Për të marrë postin e valiut të Sulltanit në Egjipt ishte thuhetse e pamundur, e sidomos kur merrej parasysh konkurrenca që ekzistonte mes pashallarëve për të marrë postin e valiut të një vendi përplot begati. Mirëpo, kur ekziston ambicia për një gjë të tillë edhe nuk do të jetë e vështirë që të arrihet ajo. Sulltani vendosi një vali nga mesi i memalikëve që kishin mbetur në Egjipt, ishte ky Murrshid Pasha, i cili në vend që të bëjë reforma të mençura për zhvillimin e vendit, ai bëri reforma negative për t'i hapur rrugë korrupsionit institucional. Ai vendosi taksa të dyfishta, ashtu që pjesën e parë t'ia dërgojë qendrës

(Portës së Lartë) dhe pjesën e dytë që ta mbajë për vete dhe bashkëpunëtorët e tij. Kjo gjë e dëmtoi dhe e lodhi jashtëzakonisht shumë popullin egjiptian. Indinjata e madhe rezultoi me kryengritje popullore. Kryengritjen e organizoi heroi i popullit egjiptian, Omer Mekrem, i përkrahur dhe i ndihmuar nga dijetarët e Al-Azharit⁷. Për shuarjen e kësaj kryengritjeje nuk pranoi të marrë pjesë Mehmet Ali Pasha, shqiptar. Ai i urdhëroi forcat e tij të përbëra nga shumica shqiptarë që të qëndrojnë larg kryengritjes dhe të mos implikohen në rrjedhat e saj, as pro e as kontra. Vetë ai hyri në bisedime të fshehta me Omer Mekrem dhe dijetarët e Al-Az'harit. Gjatë këtyre bisedimeve Mehmet Aliu, duke e ditur rëndësinë që ka Egjipti për Perandorinë Osmane, i bindi udhëheqjen egjiptiane që të kërkojnë nga Porta e Lartë zgjedhje të lira, sepse Sulltani nuk ka llogari ta nxjerrë nga dora Egjiptin dhe me siguri do të pranojë, gjë që kjo edhe ndodhi. Mehmet Aliu i kishte premtuar që do t'i japë fund korrupsionit dhe problemeve me shumë princa memalikë, të cilët ishin shtuar si kërpudha dhe kishin krijuar rrjetin e tyre të rrezikshëm. Në vitin 1802, në Egjipt u organizuan zgjedhjet e lira, populli ia dha votat Mehmet Ali Pashës, megjithatë Porta e Lartë nuk donte t'ia lëshojë fermanin⁸. Kjo gjendje zgjati deri në vitin 1805, plot tre vjet Porta e mbajti zvarrë dekretimin e Mehmet Ali Pashait për vali të Egjiptit. Pas këmbënguljeve që treguan paria egjiptiane, Porta e Lartë u detyrua që t'ia lëshojë dekretin Mehmet

⁷ Al-Az'har është universiteti ma i lashtë në botë që punon sistematikisht qe plotë 1030 vjet. Posedon të gjitha nivelet e arsimit, që nga parashkollorja e deri në docent doktor shkencash, si nga drejtimitet fetare gjithashtu edhe drejtimitet e përgjithshme shkencore. Deri në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar ka qenë shtet brenda shtetit. Posedon pasuri të mëdha, një pjesë ia ka uzurpuar shteti. Kryeplaku ose kryerektori që është institucioni më i lartë dhe lëshon direktiva për rektorin dhe dekanët e drejtorët e shkollave të shtrira në mbarë territorin e Egjiptit, konsiderohet si udhëheqësi shpirtëror i botës islame. Ekziston Ministri e veçantë për çështjet e Al-Az'harit. Përgjatë gjithë shekujve, Al-Az'har ka ndikuar direkt në ndryshimet qeverisëse të Egjiptit dhe më gjerë. Është iniciator në hapjen e shkollave fetare dhe moderne në mbarë botën arabe dhe islame.

⁸ Dekretin.

Aliut. Kjo ndodhi në vitin 1805, nga ky vit dinastia shqiptare në Egjipt lëshon rrënjët zyrtarisht në sundimin e këtij vendi.

Mehmet Ali Pasha, me ta marrë timonin e shtetit menjëherë filloi me reforma, ai u përqendrua në reformimin e arsimit, bujqësisë dhe ushtrisë, e sidomos flotës ushtarake.

Këto gjëra e bënë edhe më të fortë, populli filloi të jetojë mirë dhe krijuan besim të fortë në të. Në Egjipt filloi një lulëzim i vërtetë. Sipas historianëve egjiptianë të kohës bashkëkohore, lulëzimin dhe standartin e lartë jetësor që e arriti populli egjiptian në kohën e sundimit të Mehmet Ali Pashait nuk e ka arritur më në ndonjë kohë tjetër pas tij.

Mehmet Ali Pasha, kur i bëri njëmbëdhjetë vjet në qeverisjen e Misirit, pasi kishte krijuar përshtypje se e ka harruar çështjen e princave të korrumpuar metalikë, organizoi një mbrëmje ceremoniale kinse për kthimin e djalit të tij Tosun Pashait, triumfues nga Sudani, që e vërteta ishte ndryshe. Kishte vendosur që atë natë t'i pushkatojë të gjithë princat memalikë. Dhe ashtu bëri, të gjithë memalikët u vranë përveç njëfarë Rustem Agait, i cili ishte vonuar në ceremoni dhe pasi kishte hyrë brenda kalasë dhe ishte afruar te pallati, i dëgjoji të shtënat dhe ia ndërroi drejtimin kalit të tij, nga një lartësi dhjetëra metra kërcëu nga muri i lartë i kalasë. Kali i tij ngordhi, ai shpëtoi dhe duke u strehuar te miqtë e tij arriti deri në jug të Egjiptit, aty qëndroi mjaft gjatë derisa u zbulua në kohën sundimit të Ibrahim Pashait. Me zbulimin e tij, ai duhej të marrë ndëshkimin me vdekje që kishte nxjerrë babai i Ibrahim Pashait, Mehmet Pashai, mirëpo në këtë rast ndërhyu sundimtari i Malit të Libanit, i cili ishte mik i dinastisë shqiptare dhe vali i Ibrahim Pashait në Malin e Libanit. Ibrahim Pashai e faloi me kusht që ai të jetojë sa më larg Egjiptit. Rustem Agai pranoi dhe jetoi në qetësi e pa frikë derisa vdiq nga vdekja e natyrshme, i strehuar në një fshat libanez.

Me pushkatimin e princërve metalikë, Mehmet Pasha i jep fund çdo tentimi që mund ta kërcënonte pushtetin e tij. Mirëpo, sipas kronistëve të kohës së Mehmet Ali Pashait, tregohet se sa herë që ndiente

rrezik nga ndonjë person i afërm i tij ose nga ndonjë person autoritar që gëzonte autoritet në popull ose në ushtri, i jepte tokë në jugë të Egjiptit ose në Sudan dhe ia caktonte të jetojë atje, sa më larg qendrës dhe sa më larg mundësive për të organizuar eventualisht ndonjë kryengritje ose grusht-shtet. Sot gjejmë në Sudan dhe jug të Egjiptit njerëz që kanë tipare të racës evropiane dhe janë mjaft të bardhë në mesin e popullatës zeshkane.

Me rëndësi ishte, që Mehmet Aliu ta forcojë shtetin e tij, gjë që këtë e bëri. Me të forcuar shtetin ai filloi që t'ia kthejë shpinën Portës së Lartë, jo vetëm kaq, ai filloi edhe ta kërcënojë. Kjo vërehet qartë kur e nisi birin e tij Ibrahim Pashain që t'i zgjerojë kufijtë kah territori i Shamit dhe Hixhazit⁹. Gjenialiteti i tij i vërtet shihet kur ai arriti ta shfrytëzojë rivalitetin dhe dëshirën e perandorive evropiane dhe asaj ruse për dobësimin e Perandorisë Osmane, që ata t'ia njohin të drejtën e trashëgimisë mbretërore familjes së Mehmet Aliut, kështu do të mbetët e vetmja familje shqiptare në historinë bashkëkohore, e cila do të respektohet si familje mbretërore¹⁰.

Te Mehmet Ali Pashai hasim në kthesa të mëdha, ai pasi arriti që të ishte nga ata që i dëbuan francezët nga Egjipti, pasi merr udhëheqjen e vendit në duart e tij fillon të bashkëpunojë me francezët, të cilët vite më parë kishin qenë armiq të tij. Shumë shkencëtarë francezë, si niveli i Shampolejonit¹¹, i ishin bashkangjitur ekspeditës ushtarake të Napoleon Bonapartës. Kur u larguan forcat franceze nga territori i Egjiptit, shumica e atyre shkencëtarëve nuk u larguan dhe kërkuan strehim në Egjipt. Mehmet Ali Pashai pasi u vendos përfundimisht si

vali, i ftoi ata dhe i shfrytëzoi në realizimin e reformave të shumta që i bëri në shtet. Pikërisht ishin këta francezë të cilët e nxitën bashkëpunimin e Mehmet Aliut me Francën, dhe jo siç mendohet se konsulli francez, i cili ishte bërë më vonë këshilltar i Mehmet Aliut kishte ndikuar në këtë drejtim, sepse marrëdhëniet e tij me Francën fillojnë shumë më herët se ta fillojë misionin diplomatik konsulli francez, i cili edhe e shtyri Mehmet Ali Pashain që në pleqëri t'ia fillojë mësimin të gjuhës frënge dhe të lidhin miqësi të ngushtë. Në të vërtetë Mehmet Aliu edhe pse paraqitet kontravers, e sidomos në marrëdhëniet e tij me francezët dhe grekët, ai në fakt është një strateg i spikatur dhe di t'ia luajë mirë figurat diplomatike. Porse është shumëdimensional, është mase e vërtetë. Ai përderisa na paraqitet strateg shumë i aftë politik, në të njëjtën kohë, na paraqitet edhe si strateg i spikatur ushtarak, ndryshe mund të themi se ishte një universitet i përsosur, përplot me përvojë. Për ta argumentuar se sa gjenial ishte ky njeri, zbulimet e fundit tregojnë se zotëria e tij kishte hartuar një plan për ta zëvendësuar Perandorinë Osmane dhe për ta krijuar një perandori më të madhe se të Xhingis Kanit e të Lekës së Madh. Si duket ky plan ishte zbuluar nga perandoritë e asaj kohe, prandaj edhe u futën në koalicion të fshehtë Franca, Britania dhe Porta e Lartë për t'ia shkatërruar flotën e tij të fuqishme, e cila kishte shkuar deri në Meksikë, për t'ia ndihmuar mbretit të Meksikës për ta ndalë kryengritjen atje dhe ishte shndërruar nga flotat që dominonte në Mesdhe.

⁹ Shami përfshinë Sirinë, Palestinën, Jordaninë dhe Libanin, ndërsa Hixhazi sot njihet me emrin Arabia Saudite dhe disa principata e shtete të vogla.

¹⁰ Është e njohur se në pallatet mbretërore të monarkive ma të mëdha botërore nuk u pranua Mbreti Zog si monarku legjitim i Shqipërisë dhe shqiptarëve edhe përkundër insistimit të tij dhe shqiptarëve.

¹¹ Shampolejoni është arkeologu i njohur francezë, falë të cilit sot lexohet përsëri alfabeti hereoglifik i Egjiptit. Në qytetin verior të Egjiptit, në Rrashid, ai zbuloi një pllakë me një mbishkrim të shënuar në tri alfabetë në bazë të cilit i zbërtheu hereoglifet.

Mehmet Ali Pashai dhe shqiptarët

Mehmet Aliu shqiptar, për Shqipërinë dhe shqiptarët kishte të njëjtin interesim sikur të gjithë pashallarët tjerë shqiptarë, ndoshta pak më shumë. Në radhë të parë kishte tërhequr gjithë faqefisin e tij nga Shqipëria dhe Greqia dhe i kishte pasuruar në Egjipt, por edhe shqiptarëve që emigronin atje u ofronte shumë privilegje. Si ai gjithashtu edhe pasardhësit e tij, u kishin ofruar ndihmë shqiptarëve që u ngritën nga Misiri dhe shkuan për t'i mbrojtur tokat shqiptare. Shqiptarët e fundit që kishin mbetur në Egjipt tregojnë se baballarët e tyre ishin organizuar dhe kishin shkuar nga Egjipti për ta mbrojtur Shkodrën e Korçën. Sikur që tregojnë se shqiptarët në Egjipt ishin shtresa e aristokracisë dhe ishin pronarët e gjithë çifligjeve. Rilindësit shqiptarë aty gëzonin lirinë e plotë të veprimit, pa marrë parasysh besimin e tyre, shqiptarët në Egjipt kishin klubet e tyre, gazetat e tyre, aktivitetet e tyre kulturore, që nuk i gëzonin askund tjetër. Mbi të gjitha, ai mbetet shpëtimtar dhe themelues i shtetit modern egjiptian, prandaj njëri nga rilindësit tonë shkruan posaçërisht për Mehmet Ali Pashain kur thotë: “ *O mor shqiptarë të mjerë , shpëtuat vende të tjerë...*” Në këtë varg bëhet fjalë për luftën që bëri Mehmet Aliu për Egjiptin kundër francezëve dhe kundër metalikëve, duke e shpëtuar dhe duke e bërë shtet modern dhe të fuqishëm e të pavarur, e konsiderohet si i mjerë pasi nuk arriti ta bëjë për Shqipërinë atë që e bëri për Egjiptin.

Por, fundja ishte po dinastia e Mehmet Ali Pashait që iu ofroi strehim shqiptarëve sa herë që kishin nevojë, këtu do të përmendja strehimin e Mbretit Zog dhe familjen e tij bashkë me të gjithë bashkëpunëtorët e tij.

Falë këtij burrështetasi të madh, sot ne shqiptarët kur shkelim tokën e Egjiptit respektohem me respektin që nuk e gjejmë diku tjetër në botë.

Fitim Flugaj

MOHAMMED ALI PASHA – A MULTI-DIMENSIONAL PERSONALITY

A view on the history books, which are used in Egypt, as well as the book titled Mohammed Ali Pasha, written by Geroge Zidani, a Lebanese author, to shed light on the personality of Mohammed Ali Pasha

It is more than obvious that if a certain person is analyzed by more than one scholar he will appear to us as a person with a multi-dimensional personality. The question arises: Was Mohammed Ali Pasha such a person?

My answer to this question would be yes. If we read the school books, which are used in Egypt we see a powerful statesman, who managed to set the foundations of a modern state in a place which claims to have had state institutions more than 7000 years ago.

فيتيم فلوغاي

مُحَمَّدُ عَلِيٌّ باشا شخصية متعددة الاطراف

(خلاصة البحث)

(دراسة وفقا للكتب المدرسية المقررة في مادة التاريخ في جمهورية مصر و كذلك حسب كتاب مُحَمَّدُ عَلِيٌّ باشا للمؤرخ اللبناني جرجي زيدان لكي نلقى بعض الضوء على شخصية مُحَمَّدُ عَلِيٌّ)

ليس هناك أدنى شك بأنه اذا ما تم دراسة شخصية من قبل عدد كبير من المؤرخين سوف يقدم إلينا شخصية متعدد الجوانب و هذا الأمر ينطبق تماما على شخصية مُحَمَّدُ عَلِيٌّ.

و هذا الأمر يبدو اوضحا اذا ما درسنا شخصية مُحَمَّدُ عَلِيٌّ باشا بالكتب المدرسية و بصفة خاصة في الكتب الخاصة بمادة التاريخ.

HISTORIOGRAFI

ISLAMI NË ANDALUZI

S'ka dyshim që përvoja e hidhur e myslimanëve në Andaluzinë e djeshme, Spanjën e sotme, është njëra prej fatkeqësive më të dhimbshme e më ndikuese në historinë e njerëzimit, derisa janë përballur me persekutim, djegie, shkatërrim, plaçkitje dhe torturë, që vazhdoi për 120 vjet. Dhe zgjidhja ishte pranimi i krishterimit apo therja, sa që në fund të vitit 1610 në Andaluzi mbeti vetëm një numër i vogël që arrinte në 30 milionë. Dhe kjo është në kundërshtim të plotë me tolerancën dhe tretmanin e mirë që kishin spanjollët gjatë lulëzimit të civilizimit islam, që nuk ishte vetëm me ta, por ishte zakoni i Islamit me ehli dhime në të gjitha kombet që dëshironin të jetonin në paqe.

Myslimanët vazhduan jetën në Spanjë për tetë shekuj. Gjatë kohës së tyre lulëzoi civilizimi islam, fama e tij arriti horizontin dhe myslimanët ndërjuan xhamitë, qytetet, pallatet, kalatë e fortesat më të bukura. Në jugun e saj shkëlqyen dituritë e ndryshme, artet dhe civilizimi.

Kur Ebu Abdullah Sagir, mbreti i fundit i Andaluzisë dorëzoi çelësat e Hamrasë dhe lëshoi qytetin për të mos u kthyer më, hyri në të Ferdinandi e Izabela në një ditë të ftohtë pikëlluese të muajit janar në vitin 1492. Kështu qyteti i patrembur i Granadës ra në duart e spanjollëve. Dhe në atë natë përfundoi së ekzistuari njëri prej shteteve më të fuqishme në atë kohë, pas vuajtjes që pati në vitet e saj të fundit nga

dobësia e përçarja. Humbi njëri prej civilizimeve më të ndritshme njerëzore që mbushte dëgjimin e shikimin, të cilën e ngritën myslimanët me gjakun e tyre që e ujiti këtë tokë dhe me shpirtrat e tyre të mbushura me besim të dhëna për ngritjen e shtetit islam.

Ra Granada dhe dolën myslimanët, por Islami nuk doli. Mbetën gjurmët e tij deri në ditët e sotme, pavarësisht urrejtjes së thellë që kishin ndaj tij. Mbeti dëshmitar i madhështisë që lanë myslimanët, edhe ende mbetet njëri prej vendeve më atraktive turistike për Spanjën.

Andaluzia në të kaluarën dhe në të tashmen

Sot, Andaluzi quhet pjesa jugore e Spanjës, dhe shtrihet në jug të lumit Lujina e Madhe. Përfshin shtatë qytete: Kortobën, Seviljen, Kadishin, Xhejanin, Granadën, Malakën dhe Velben.

Këto shtatë qytete sot quhen "Andaluthija" dhe kur thuhet për dikë që është andaluzian, qëllimi është të njëri prej këtyre qyteteve.

Dhe nëse thuhet se kjo pjesë muzikore është andaluziane, qëllimi është që është nga jugu dhe bart shpirtin e karakteristikën e saj në melodi e ekzekutim.

Ndërsa arabët me termin Andaluzi quanin tërë pjesën e Gadishullit të Ibrisë që ishte nën sundimin e tyre.

Në dokumentin e Çlirimit të Parë të vitit 710-715, termi Andaluzi përfshinte tërë Gadishullin nga Ngushtica e Gjibraltarit në jug e deri në malin Albert që ndan Francën e Spanjën, që sot njihet me emrin Albrans e deri në bregdetin verior të Gjirit të Baskës, që njihet si Bregdeti Kunterbrije.

Andaluzia nuk përfshin vetëm këta kufij gjeografikë, apo gjire apo bregdete, por ajo është një civilizim madhështor e i plotë.

Dr. Husejn Muenis, një historian i njohur, në librin e tij "Udhëtimi në Andaluzi, firdevsin e premtuar", e përshkruan me këto fjalë: "Andaluzia nuk është gjurmë e së kaluarës. Nuk është as xhami e Kortobës, e as pallat i Seviljes a Hamraja e Granadës. Por, ajo është një qenie që

ende jeton, që ende merr frymë. Ajo është toka e Andaluzisë, me pemët, malet e shkëmbinjtë e saj. Ajo është një qenie e gjallë e plotë, që gjithsesi duhet ta shohësh të plotë që të kuptosh se kush është. Dhe këto gjurmë të mbetura janë pjesë e stolisë me të cilën është dalluar, apo disa rroba të cilat i ka bartur. Stolia dhe rrobat tregojnë një pjesë të burrit, por ai nuk është burrë".

Spanja dhe çlirimi islam

Myslimanët vazhduan me çlirimet e tyre që u shtrinë në lindje deri në Indi dhe në vendet pas lumit. Vazhduan marshimin e tyre drejt Perëndimit, derisa pushtuan tërë Afrikën Veriore e arritën në Marokun e largët. Nëse flasim për ekspeditat ushtarake të cilat ndodhën në fushëbetë në Lindje dhe Perëndim, do të marrë shumë kohë, por do të ndalemi te ndodhitë më të rëndësishme të cilat ndryshuan rrjedhën e tërë historisë njerëzore.

Çlirimet islame pasuan njëra pas tjetrës, që nga mësymja e parë islame, që kur ushtritë myslimane u nisën nga Egjipti në kohën e emevijve për përhapjen e dritës islame nga Deti Mesdhe e shtetet që kishin dalje në të e deri në Marok. Pati batica e zbatica, humbje e fitore, që përfundojnë me arritjen e Ukbetu ibn Nafi'ë në Oqeanin Indian, ku themelon qytetin e Kajrevanit që të jetë pikëmbështetje e çlirimeve tjera islame. Dhe kur arrin në Oqeanin Indian, kthehet nga deti dhe ngrit duart nga qielli duke i rrjedhur lotët e me zemër të frikësuar lut Zotin e tij: "Unë nuk kam dalë si mosmirënjohës e as i gëzuar. Dhe Ti e di se unë e kërkoj shkakun, të cilin e kërkoj robi yt Dhulkarnejni, që të adhurohesh e të mos të bëhet shok Ty. O Zot, po ta dija se pas këtij deti gjendet toka do ta kisha nxitur që të jetë në rrugën Tënde".

Këto çlirime arritën një intensitet më të madh kur udhëheqjen e ushtrive islame e mori Musa ibn Nesir, i cili arriti ta bindë halifen në Damask për çlirimin e Spanjës. Musa ibn Nesiri ishte njeri ambicioz, trim, i matur. Mendonte gjatë për çdo çështje para se ta ndërmerre

dhe e shqyrtonte nga të gjitha anët. Vendosi (dhe sytë i kishte nga Evropa përmes Spanjës) që të formonte një flotë detare për të zotëruar Afrikën Veriore nga deti e toka. Dhe me të vërtetë arriti që ishujt Mijurit, Menurita dhe Beljar t'i vërë nën zotërimin islam. Në të njëjtën kohë arriti të qetësonte rebelimet në Marok. Marshoi me ushtrinë e tij deri në qytetin Tanxha, të cilën e pushtoi dhe emëroi udhëheqës të saj, komandantin e njohur Tarik ibn Zijadin.

Përcillte konfliktet për pushtet, të cilat ndodhnin të tokën spanjolle dhe ishte i njoftuar për padrejtësinë, persekutimin e taksat e larta që vuanin populli. Gjithashtu e dinte rëndësinë e Spanjës, që përmes saj të përhapej Islami në Evropë. Prandaj, e priste rastin dhe e studionte gjendjen. Dhe më në fund erdhi momenti i shumëpritur. Si zakonisht nuk ngutej, por dëshironte ta njihte më mirë armikun. Prandaj, urdhëroi njërin prej komandantëve të tij berberë të quajtur Tarif ibn Malik, që me 400 ushtarë e 100 kalorës të kalonte në tokën spanjolle për të vëzhguar gjendjen. Tarifi arriti të realizojë fitoren e parë islame në Spanjë, që e shtyri Musa ibn Nesirin të urdhërojë komandantin e tij Tarik Ibn Zijadin të përgatitet për kalimin e Ngushticës së Gjibraltarit, që më vonë u quajt sipas emrit të këtij trimi të madh. Dhe ai nisete me emrin e Zotit që të çlirojë tokat spanjolle.

Myslimanët ende e kujtojnë dhe do ta kujtojnë me nder e respekt komandantin e tyre Tarik ibn Zijadin, i cili derisa ishte i ulur në kalë shikonte fytyrat e ushtarëve të tij duke vërejtur frikën në sytë e tyre, pasi panë madhësinë e ushtrisë armike. Pasi pa këtë, ngriti zërin si bubullimë duke frikësuar shpirtrat, qetësoi lëvizjen e kuajve dhe zgjati qafat e ushtarëve që t'u mos u kalojë asnjë fjalë nga fjalë e komandantit, i cili dogji anijet pasi që arriti në bregdetin e fundit dhe zbriti ushtarët e tij duke u thënë:

"O njerëz! Ju në këtë ishull jeni më të humbur se bonjakët në gostinë e keqe, dhe nuk ka shpëtim për ju. Deti është prapa jush e armiku para jush. Forcat e përforcimet e tij janë të shumta, kurse ju nuk keni rrugëdalje tjetër përveç shpatave tuaja, e as ushqim përveç asaj

që do ta merrni nga armiku juaj me këto shpata. Duhet ta dini që fitorja ndaj kësaj ushtrie të madhe është e mundshme, nëse i lejoni vetes të vdisni. E unë nuk kërkoj nga ju asgjë prej të cilës vetë do të lirohemi, e as nuk do t'ju ngarkoj me asnjë plan, e të mos fillojë vetë i pari. Pasi të takohemi me armiqtë do të ndeshem me sunduesin e tyre dhe do ta vras, nëse dëshiron All-llahu. Të përballemi me ta së bashku. E nëse vdes para se të arrij te ai, betohuni me vendosmëri se ata do të zhgënjehen pas vdekjes sime”.

Fjalë të sinqerta e të vendosura, që nuk mund të humbë ai që i bart. Pasi që Tariku përfundoi fjalimin, vdekja ishte më e dashur për ushtarët e tij se jeta. Ata ishin të dërguarit e Islamit në Evropën e padrejtë, duke luftuar me moton "Fitore apo rënie shehid". Nuk kaloi shumë kohë derisa grupe të spanjollëve filluan të iknin të frikësuar e të humbur. Filluan të iknin duke mos iu kushtuar vëmendje asgjëje, por duke kërkuar shpëtim nga vdekja e papritur. Ndërkaq, fitorja gëzoi të gjithë në Afrikën Veriore e botën islame.

U grumbulluan njerëzit për të kaluar detin në drejtim të tokave të reja të prirë nga komandanti i shquar, Musa ibn Nesir, ushtria e të cilit u bashkua me ushtrinë e Tarikut. Pas kësaj, qytetet spanjolle e portugeze binin njëra pas tjetrës. Ibn Nesiri i bëri sexhde All-llahut si shenjë falënderimi, derisa mendonte për një plan gjigant. Pse të mos vazhdojë marshimin e tij deri në Francën Jugore? Pastaj të pushtojë tërë Evropën, duke ia bashkuar shtetit islam të pafund Francën, Italinë, Gjermaninë dhe Ballkanin. Të pushtojë edhe vetë Konstadinopojën, kryeqytetin e Perandorisë bizantine, e me ushtrinë e tij të kalojë Azinë e Vogël dhe kështu përmes Evropës të arrijë në Damask, kryeqytetin e shtetit emevij.

Po të arrihej kjo ëndërr, do të ndryshonte plotësisht harta e botës dhe e tërë Evropa do të bëhej pjesë e botës islame. Por, halifeja emevij refuzoi propozimin e Musa ibn Nesirit dhe i kërkoi që të forcojë Islamit në tokat e çliruara. Dhe më vonë e thirri edhe Tarik ibn Ziyadin që të kthehej në Damask.

Dhe kështu, Spanja (Andaluzia) u bë pjesë e botës islame. Kjo ndodhi në të njëjtën kohë kur ushtritë islame arritën në nënkontinentin indian.

Kryqtarët përjetojnë humbje

Pas kësaj, pasuan humbjet e kryqtarëve në betejën e Zelakës me Jusuf ibn Tashefinin, në të cilën vrau mbretin e Kasteljes, Alfonsin VI. Kjo ndodhi në vitin 1086. Pastaj fitorja e Mensurit në betejën e Erkut, ku u vranë prej armiqtë më shumë se 100 mijë, ndërsa u zunë robër me dhjetëra mijë. Spanjollët nuk mund të pajtoheshin me këto humbje të dhimbshme, por dëshironin të hakmerreshin. Por, Mensuri iu shkaktoi humbje të madhe, dhe ua rriti plagën e hapur, duke bërë që të përgatiten për hakmarrje në kohën e duhur.

Halifeja el-Mensur bilah Jakub ibn Jusuf siç cekëm më lart, arriti fitore të madhe kundër spanjollëve në betejën e Erkës, që nuk është më e vogël se ajo e arritur në Zelaka. Kështu, arritën që të rregullojnë problemet e Andaluzisë për një kohë të shkurtër. Por, barra e shtetit të tyre, i cili përfshiu Marokun arab u rëndua. Nuk shkoi shumë kohë kur u mundën në betejën e quajtur Altel, të cilën transmetimet spanjolle e quajnë Las Nafas Di Tuluz. Për këtë betejë, spanjollët kërkuan ndihmë nga vëllezërit e tyre të krishterë në Evropë, thirrje të cilës iu përgjigj një numër i madh i vullnetarëve gjermanë, britanikë e francezë. Kjo betejë konsiderohet si përfundim i sundimit faktik të myslimanëve në Andaluzi dhe shenjë e rënies së kufijve të shtetit islam atje. Si rezultat i përçarjeve të hidhura mes myslimanëve, qytetet më të mëdha islame ranë në duart e mbretërve të krishterë.

Por, si u arrit kjo dhe cilat ishin shkaqet? Spanjollët e kuptuan që mënyra më e mirë për fitimin e luftës ishte sulmi gradual ndaj tokave islame dhe brejtja e tyre pjesë-pjesë, si dhe konfliktet mes mbretërve të Andaluzisë. Ky plan pati sukses të madh në shkatërrimin e shtetit islam në atë pjesë të largët të botës.

Granada guximtare u rezistoi katër mbretërve spanjollë

Dhe, pas gjithë këtyre përmytjeve shkatërrimtare, u përpoqën shumë të parandalojnë rrezikun nga armiku, por pa sukses. Disa prej tyre shpejtuan në vende të fortifikuara dhe u strehuan aty. Një prej tyre ishte Muhamed ibn Ahmeri, i cili ishte një kalorës trim dhe largpamës. Ky me ushtarët e tij me shpejtësi pushtoi Kalanë e vjetër të Granadës, që quhej Hamraja e vjetër. Formoi një principatë arabe islame dhe e fortifikoi mirë.

Ky njeri me shkathtësitë e tij arriti të formojë një mbretëri, që përfshiu gjithë pjesën jugore të siujdhesës të lumit Vadi i Madh. Në këtë mbretëri erdhën me mijëra myslimanë prej vendeve të cilat i pushtuan spanjollët, duke bartur me vete esencën e civilizimit andaluzian.

Në këtë pjesë të vogël jugore jetoi mbretëria islame e Granadës, e cila vazhdoi t'u rezistojë e vetme katër mbretërve spanjollë deri në vitin 1492.

Shkaqet e shkatërrimit të shtetit

Drita islame vazhdoi të ndriçojë në rrafshinat e Andaluzisë për të të shekuj me radhë. Në pjesën e parë të saj ishte shumë e përhapur dhe e shkëlqyer, ngase buronte nga një burim i përbashkët dhe shkëlqente me një vigjilencë të plotë. Por, në pjesën e dytë u përhap përçarja. Shteti u nda në shtete të vogla, ku sunduesit e tyre luftonin për pushtet, u dobësuan shpejt dhe bashkëpunonin me armikun. Ndërkohë, Spanja evropiane afrohej, derisa pesë mbretëritë e saj u bashkuan në Mbretërinë e Kasteljes. Ndërsa Spanja islame ndryshoi në saje të përvetësimit të asaj që quhej "Kolona e pestë e arabëve dhe berberëve" derisa nuk mbeti në duart e myslimanëve vetëm Granada.

Pushteti në këtë qytet të mbetur mbeti te familja Benu Ahmer dhe përfundoi me të fundin e tyre, Ebu Abdullahun e vogël, i cili komplotoi kundër babait të tij.

Sulltani Ebu Hasani ishte në kulmin e konfliktit me spanjollët, të cilët e sulmuan nga çdo anë. Nuk pushonte nga një luftë derisa hynte në luftën tjetër dhe as të kthehej prej një çlirimi derisa të përgatitej për çlirim tjetër. Dhe derisa kthehej nga një prej fitoreve të tij ku ishte plagosur, djali i tij Ebu Abdullahu i vogël ia mbylli portat e Granadës, duke mos e lejuar të hyjë në kryeqytetin, shtëpinë dhe te familja e tij. E tillë ishte gjendja në këtë kohë!

Qytetet e mëdha, për të cilat u shkruan vëllime të shumta në historinë e civilizimit arabo-islam, mbetën jashtë nga luftërat kryqtare, të cilat u ndërmoren nga mbretër, prapa të cilëve ishin me mijëra kalorës të veshur me parzmorë. Prapa malit Albert me mijëra luftëtarë të tjerë kryqtarë pranuan thirrjen e Papës. Dhe prapa detit, flotat e shteteve italiane të Gjenovës, Bizës dhe Emalkës u ngarkuan me njerëz të etur që të mos u ikë plaçka e luftës. Të gjithë këta së bashku me luftëtarë nga Franca, Britania dhe Gjermania u bashkuan që të përkrahin Ferdinandin me ushtri që arritën horizontin, për të asgjësuar çdo arab e mysliman që gjendej në atë tokë.

Megjithëkëtë, populli i Andaluzisë u mbrojt dhe tregoi heroizëm të paparë. Banorët e Kortobës, Xhejanit, Seviljes, Belnisit dhe Beljarit u mbrojtën dhe nuk u dorëzuan, vetëm pasi që humbën shpresën e fundit për rezistencë.

Ebu Abdullahu i vogël, mbreti i fundit i Granadës nuk e dinte që Ferdinandi V, mbreti i Kasteljes i kishte drejtuar sytë nga Granada, nusja e Andaluzisë dhe vendi i Hamrasë dhe ajo që mbeti nga firdevsi i humbur. Ai u frikësua për veten e pushtetin e tij. Prandaj, e dërgoi te armiku një përfaqësues të tij, që t'ia ndante një pjesë të tokës që do ta sundonte nën emrin dhe nën flamurin e tij. U arrit marrëveshja e padrejtë dhe erdhi momenti i dorëzimit. Por, një grup i kalorësve të Granadës që ishin më të mirët, kanë ruajtur faqe të historisë me emrat e

tyre. Në krye të tyre ishin Musa ibn Ebi Gasani, Neim ibn Ridvani, Muhamed ibn Zaidi dhe me mijëra ushtarë tjerë të panjohur që e kundërshtuan dorëzimin, qëndruan, u mbrojtën dhe vdiqën si trima të vërtetë.

Gasani - kalorësi i kalorësve

Musa ibn Ebi Gasani ishte shembull i kalorësisë arabe, e cila mbushi faqe të ndritshme në historinë islame. Ishte i pakrahasueshëm në etikën e shpatës dhe gjuhës dhe trimëritë e tij ishin bisedë e tubimeve në Spanjën islame e të krishterë.

Ibn Ebi Gasani i mllëfosur i tha mbretit:

"O mbreti i myslimanëve! Thuaj mbretit të krishterëve se myslimani nuk e pranon padrejtësinë, derisa është duke e bartur shpatën. Dhe më shumë preferon të ketë varrin në rrënojat e Granadës sesa të ketë pallat në kopshtet andaluziane".

Ebu Abdullahut të vogël, nuk i mbeti tjetër vetëm që të largojë të gjithë zotërinjtë e udhëheqësit dhe të prishë marrëveshjen e të bëjë përgatitjet për mbrojtje. Dhe një ditë, njerëzit panë 80 mijë ushtarë të Kasteljes që u ishin drejtuar Kalasë së Granadës për ta rrethuar. Musau ndau mbrojtjen e qytetit komandantëve tjerë, ndërsa vetë mori udhëheqjen e kalorësisë, të cilin e ndihmonin edhe Muhamed ibn Ebi Zaidi dhe Neim ibn Ridvan. U ndez flaka e luftës. Kalorësia e Gasanit ndërmori sulme të njëpasnjëshme, por më vonë kasteljanët konsoliduan rrethimin e Granadës, shkatërruan gjithë të mbjellat dhe i shtuan përforcimet nga toka e deti. Kur durimi po përfundonte, udhëheqësi i qytetit pa që uria pa dyshim po vinte dhe mbrojtja ishte një ngarkesë, prej të cilës nuk kishte dobi.

Por, Musa Gasani i nxiti me fjalët e tij: "Zemrat duruese të mu-xhahidëve (luftëtarëve) nuk dinë për pikëllim".

Pastaj urdhëroi që të hapen portat dhe me batalionin e tij doli që të ndeshje me armikun ballë për ballë. Kalorësve të tij u tha:

"Nga Andaluzia nuk ka mbetur asgjë përveç tokës mbi të cilën qëndrojmë. E nëse e humbim, do ta humbim atdheun dhe lirinë". Pastaj me një sulm të suksesshëm i nxori armiqtë nga qyteti, por ata u kthyen dhe e rrethuan përsëri.

Beteja vazhdoi për ditë të tëra me baticat e zbaticat e saj, derisa ushtarët u lodhën dhe i preku pikëllimi. U rikthyen në qytet sa që nuk mbeti në fushëbetejë askush!

Në mbrëmje, mbreti mblodhi dijetarët, udhëheqësit e komandantët, të cilët e shqyrtuan këtë çështje nga të gjitha aspektet dhe u pajtuan që të dorëzohen.

Aty u ngrit vetëm Musa Gasani, i cili kundërshtoi këtë mendim, nuk u pajtua me dorëzimin si dhe u përpoq që në zemrat e dëshpëruara të ngjallë shpresën. Prandaj tha:

"O popull! Mundësitë tona mbrojtëse nuk janë harxhuar akoma. Ende zotërojmë mjete, të cilat e bëjnë të pamundshmen dhe arrijnë mrekulli. Prandaj, të ngjallim te populli shpirtin e sakrificës, t'u japim armë dhe të luftojmë me ata deri që të shkatërrohem të gjithë. E nëse çdo njëri prej jush nuk e gjen varrin që e fsheh, ai nuk do të humbë nga qielli që e mbulon. Dhe më mirë për ne është të numërojmë ata që kanë luftuar e vdekur, sesa të numërojmë ata që janë dorëzuar!"

Por, oratoria dhe fjalët shpresëdhënëse të Gasanit nuk patën efekt këtë radhë. Të gjithë preferonin dorëzimin.

Kur pa disa komandantë duke dalë për të biseduar me armikun për zbatimin e marrëveshjes, i vloi gjaku dhe tha:

"O popull! Mos e mashtroni veten dhe mos mendoni se spanjollët do t'i përmbahen marrëveshjes. Vdekja është ajo që i frikësoheni, por nëse dorëzoheni do ta shihni që qyteti ynë do të shkatërrohet, pasuria jonë do të plaçkitet, gratë tona do të përdhunohen, xhamitë tona do të njolloshen, balli do të na përdhoset, trupat tanë do të goditen, gjaku ynë do të rrjedhë, dhe kujtimet tona do të shkatërrohen. Do të shihni tërë këtë, por edhe më tmerrshëm, o ju të cilët e keni mëri vdekjen fisnike, ndërsa unë pasha All-llahun nuk do ta shoh!"

Pastaj me shpejtësi doli nga "Salla e Zezë" e pallatit Hamra dhe duke mos çarë kokën për askënd shkoi në shtëpinë e tij. Veshi rrobat, veshi parzmoren, mori armët, hipi në kalë dhe doli nga një prej portave të Granadës, duke depërtuar në ushtrinë armike. Luftoi me ta derisa iu thye shpata në dorë, dhe pastaj ra pa vetëdije, pasi që kishte vrarë një numër të madh të kalorësve spanjollë.

Granada u mbrojt para rënies së saj me një heroizëm të rrallë dhe toka e saj u ujit me gjakun e luftëtarëve trima. Në fushëbetejën e ndërrit ranë shumë prej kalorësve e banorëve të saj, ndërsa Gasani me shokët e tij shënoi faqe të rralla në histori.

Dhe në një ditë të ftohtë e të mërzitshme të muajit janar të vitit 1492, Ebu Abdullahu i vogël ia dorëzoi çelësat e Hamrasë e kësh-tjellave tjera mbretit Ferdinand, që të hynë kryqtarët në Granadë nga të gjitha portat.

Ebu Abdullahu i vogël u ndal te mali Rejhan që t'ia hedhë shikimin e fundit Granadës, ndërsa spanjollët këtë vend e quajtën "Pshërëtimi e fundit arabe". Transmetimet na kujtojnë që nëna e tij Ajsheja pyeti për të. Iu tha që ai po qan. Prandaj tha:

"Qaj si grua mbretërinë e humbur,

pasi që nuk e ruajtë si burrë".

Pas dorëzimit gjithmonë pason nënshkrimi i marrëveshjes.

Ne, nuk e tregojmë këtë përveç që të marrim mësim dhe si paralajmërim.

Në marrëveshje shkruante që myslimanët gëzonin të drejtën e adhurimit e banimit dhe se gëzonin liri të plotë në shtëpitë e tyre. Asnjë spanjoll nuk kishte të drejtë të hynte në këto shtëpi, si dhe në Granadë duhej të ktheheshin të gjithë robërit myslimanë nga e gjithë Spanja. Mbreti, mbretëresha dhe ndihmësit e tyre u pajtuan për respektimin e kësaj marrëveshjeje dhe zbatimin e saj.

Por, asgjë nga kjo nuk ndodhi! U realizua ajo që tha kalorësi i kalorësve Musa ibn Ebi Gasani kur refuzoi dorëzimin.

Nuk kaloi kohë e gjatë, kur mbretëresha Izabela nxori një urdhër të neveritshëm drejtuar gjithë myslimanëve në gjithë Andaluzinë, ku ua paraqiste një prej dy zgjidhjeve, ose vdekjen ose pranimin e krishterimit. Që të dyja të hidhura.

Njerëzit, në çdo vend u ngritën kundër këtij vendimi të neveritshëm, ndërsa spanjollët i shkatërruan e i dogjën shtëpitë e xhamitë dhe i detyruan të bëhen të krishterë përmes detyrimit e forcës. Shumë e injoruan këtë, por Kisha nuk i la me kaq. I detyroi të hanë mishin e derrit, të pinë alkoolin, të mblidhen për meshë në kisha, mosbërjen synet e më vonë i vuri para asaj që u quajtën "Gjyqet e Inkuzicionit". Dhe kjo ishte njëra prej metodave më të tmerrshme për dënim në historinë njerëzore.

Si rezultat i këtyre urdhrave të padrejta u bënë kryengritje të shumta në çdo vend kundër kësaj poshtërsie, por shumë shpejt u shuan me egërsi. E tillë ishte kryengritja e quajtur Xhebal Beshurat, e cila vazhdoi për dy vjet të plota deri që u shtyp me një tmerr të paparë nën sloganin "Jo robëri, por vrasje pa butësi". U vranë pleqtë, gratë e fëmijët, u dogjën kalorësit në zjarr, dhe iu zu fryma me tym sa që mendoan se kishin shtypur çdo zë.

Por të gjitha këto metoda të padrejta nuk i detyruan myslimanët e Andaluzisë të braktisin fenë, gjuhën, kombësinë dhe zakonet e tyre. Ushtruan fshehtëzi fenë e tyre dhe ndërtoan xhami të vogla të fshehta brenda shtëpive të tyre, ku mblidheshin dhe falnin namazet. Të rinjve ua mësuuan fenë e gjuhën e tyre dhe i edukuan sipas zakoneve fisnike arabe e moralit të lartë islam. Me aq sa kishin mundësi, largoheshin nga ajo që i detyronte Kisha. Priftërinjtë nuk i thërrisnin në shtëpitë e të sëmurëve të tyre, vetëm pasi që vdisnin apo nuk mund të flisnin, që të mos i jepnin mundësi priftit t'u mësonte ndonjë gjë para vdekjes që binte ndesh me parimet islame.

Kur detyroheshin të martoheshin në kishë, ktheheshin në shtëpi dhe martoheshin sipas ligjeve islame.

Mbretërit dhe njerëzit e fesë mendonin se do të asgjësonin çdo gjurmë islame e arabe në Gadishullin e Iberisë pas një gjenerate apo dy. Nëse pagëzimi nuk i bëri të krishterë baballarët, fëmijët do të jenë të tillë. Por, pas kalimit të 100-vjetëve panë që myslimanët ende ishin pasardhës së myslimanëve, siç ishin më parë baballarët dhe gjyshërit e tyre. Prandaj, pranuan dështimin e tyre në asgjësimin e vitalitetit të këtij populli dhe pranuan që nuk arritën asnjë sukses në krishterimin e tyre.

Për këtë, në vitin 1609 vendosën largimin e gjithë atyre që kishin mbetur në Spanjë me prejardhje myslimane pa përjashtim. Këtë e ushtruan me forcë e urrejtje të madhe sa që pretenduan në vitin 1610 se nuk ka mbetur asnjë mysliman në Gadishullin e Iberisë.

Por e vërteta siç e përforcojnë shumë të tjerë ishte që ky fanatizëm spanjoll nuk arriti të nxjerrë nga Andaluzia bazën e shkëlqyer të civilizimit të ndritur islam, të cilin e themeluan dhe e trashëguan atje. Ky civilizim është rezultat i një pune të zellshme e të vazhdueshme që zgjati për tetë shekuj.

Turistë të shumtë, nga vende të ndryshme të botës udhëtojnë sot në Spanjë, ngase dëshirojnë të shohin trashëgiminë e lënë nga myslimanët, e cila ende ekziston duke luftuar zakonet e kohës.

Dhe ajo që është më tragjike e më e dhimbshme për myslimanët është që spanjollët të cilët i persekutuan, e tepruan në mundimin dhe fyerjen e tyre, shumica prej tyre ishin pasardhës të atyre që jetuan me myslimanët. Këta jetuan në shtetin islam të lirë e të nderuar, nga myslimanët patën sjelljen më të mirë e më të drejtë dhe u zhvilluan duke ushtruar të drejtat e tyre në atë mënyrë që nuk u njoh nga asnjë shtet që sundoi në Spanjë para hyrjes së Islamit në Gadishullin e Iberisë, sikurse nuk e njohu as Evropa në atë kohë.

Civilizimi islam në Andaluzi

Çlirimi i Spanjës nga myslimanët ishte fillimi i zhvillimit të civilizimit islam dhe rritja e tij në Evropë. Ky civilizim lulëzoi shumë në aspektin shkencor e letrar si dhe shkencave kur'anore. Evropa arriti një shkallë civilizimi që nuk kishte njohur deri atëherë.

Pas çlirimit, myslimanët treguan një tolerancë fetare e shoqërore me të gjitha grupet që kishin lidhje, sa që njerëzit nga të gjitha vendet arritën në këtë pjesë të shkëlqyer të Evropës për të mësuar për etikën e shkencat e ndryshme.

Antikiteti arabo-islame

Dr. Husejn Muenis në librin e tij "Udhëtimi në Andaluzi" thotë:

"Prej veriut të Gadishullit e deri te malet Albert të njohur si Brans shtrihej Andaluzia. Qytetet e këndshme të cilat i shohim atje, ne jemi të zotët e tyre ndërsa baballarët tanë ndërtesat e tyre. Larida, Veshkah, Tutileja, Benbeluna e shumë të tjera, të gjitha ishin qytete arabe dhe ende deri në ditët e sotme e ruajnë shpirtin e tyre arab. Gjërat antike që kanë mbetur në të duken si gërmadha që lundrojnë mbi ujë nga një anije gjigante që e lëkundin valët. Megjithëkëtë, ky vend i largët i dashur është afër teje. Jeton me ty dhe në ty.

Dhe vazhdon: T'i lëmë gjërat antike në mendime e dituri. Ky është libër i njohur. Ne kemi shumë dëshmitarë që dëshmojnë këtë duke na ndihmuar të hulumtojmë koleksionet letrare dhe arkivat e shkencës e dritës. Civilizimi andaluzian nuk kufizohet vetëm në kufijtë e Gadishullit të Iberisë, por u shtri edhe më shumë sa që ka përfshirë Marokun arab deri në kufi me Tunisin. Shumë prej porteve marokiene janë të ndërtuara nga andaluzianët si Tatvani, Telmesani, Vehrani, Tunisi dhe Xhezair bin Mezgana, që sot njihet me emrin Xhezair e shumë të tjera. Brenda Marokut, qyteti i Fasit të tregon për kontributin e andaluzianëve në ndërtimin e saj. Meknasi të tregon për rolin arkitektonik

andaluzian. Ndërsa në Shavun e deri në Tatvan gjejmë qytete me formë e shpirt andaluzian, sikur të jenë të gjallë nga të gjallët e Granadës.

Nga ky gadishull, ky civilizim kaloi në gjithë Detin Mesdhe. Këtu, në vendet tona Andaluzia jeton në ndërjegjen tonë, duke rrahur me gjallëri sikur të ishte vend bashkëkohor arab. Deklaron me fjalë: Vërtet, Andaluzia është anëtar në Ligën e madhe Arabe, anëtar me zë të fuqishëm që kalon shekujt.

Këtij zëri të fuqishëm i takon meritë e madhe në vendin e lartë që ka zënë civilizimi arab në mesin e civilizimeve botërore.

Evropa e cila krenohet para nesh me atë që na ka mësuar në kohën e re, e ul zërin kur kujton që mësuesit tanë andaluzianë i kanë mësuar gjyshërit e tyre në të gjitha universitetet evropiane. Edhe vetë Vatikanin nuk harron që një prej papëve ishin nxënës i Kortobës dhe mësuesve të saj.

Nëse letrarët më të njohur evropianë janë katër: Dante, Servantesi, Shekspiri dhe Gëte, dy prej tyre janë nxënës të Andaluzisë arabe. I pari mori nga origjina e komedisë hyjnore, ndërsa i dyti transmetoi kapituj nga Hamid ibn Nehilij. Dhe i katërti Gëte nga ana tjetër është nxënës ynë dhe përmbledhja e poezive të tij lindore është dëshmitar i qartë për inspirimin e tij nga poezitë tona lindore.

Kjo Andaluzi e pavdekshme nuk jeton vetëm në zemrat e dijetarëve, por gjithashtu në zemrat e gjithë njerëzve. Shpikjet si Biblioteka e Andaluzisë dhe Kafaja e Andaluzisë janë të zakonshme e familjare në çdo vend arab.

Dr. Muenesi e vërteton që vendi i vetëm në botë ku u bashkuan Lindja e Perëndimi me një bashkim të vërtetë ishte Andaluzia.

Aty u rritën pemë arabe që rrënjët i kishin në tokën evropiane, e të cilat nxorën fryte me ngjyrë perëndimore e shije lindore.

Atje të gjithë njerëzit që nga halifeja, ministri, gjykatësi e deri te shitësi e këngëtari flisnin në shtëpi e rrugë gjuhë evropiane, ndërsa lexonin ose shkruanin në gjuhën arabe.

Atje ibn Ruzhdi u mor me shpjegimin e mësimëve të Aristotelit. Pastaj njerëzit i përkthyen shpjegimet e tij në gjuhën latine dhe i lexuan në këtë gjuhë më shumë se sa që i kemi lexuar në gjuhën arabe.

Atje nuk mjaftoi vetëm që Lindja e Perëndimi të bashkohen, por u bënë gjë e vetme unike në kapitullin e tyre në histori. Dhe kjo gjë unike në kapitullin e tyre të historisë ende qëndron deri në ditët e sotme. Fytyrat e njerëzve të cilat i takojmë atje nuk janë tjetër veç figura që i sheh rreth teje në vendin tënd arab”.

Autori i librit “Kortoba në historinë islame” shkon më tepër se kjo kur thotë:

“Çlirimi islam i Gadishullit të Iberisë nuk ishte ndodhi prej ndodhive politike apo luftarake, të cilat gjithnjë paraqiteshin vetëm në skenën e jetës, por ky çlirim kristalizoi një ndodhi kulturore të mrekullueshme që i përgatiti njerëzit për zbulimin e shumë të panjohurave, të cilat nuk i njihje mendja më parë. Pastaj e motivoi këtë mendje për hulumtim dhe shpikje, dhe i hapi rrugën që të ecë me planet, hulumtimet e shpikjet e tij që kurrë nuk i ishte mundësuar njeriut një gjë e tillë.

Këtë e dëshmon atë që ka bërë gjenialiteti njerëzor në Spanjën Islame nën patronazhin e halifëve apo sunduesve të shtetit gjatë viteve të pakta kur krahasohet me jetën e gjatë të historisë.

Dhe kështu çlirimet islame përhapën dritën e besimit islam në çdo vend. Shkëlqimi islam u shtri në shkallën më të madhe që mund ta imagjinojë mendja. Pyesim: Pse të mos e kthejmë lavdinë e stërgjyshërve tanë? Me punë e sakrificë, si dhe marrja e shkaqeve të përparimit shkencor e civilizues në mënyrë që të mos bëhemi umet që ka histori, por që nuk ka të tashme.

Dëshmitarët e madhësisë së civilizimit islam

Dhe pas kalimit të atyre viteve të gjata pas rënies së Granadës, gati se nuk gjejmë sot diçka që na zbulon të kaluarën, përveç Kalasë së Hamrasë, e cila i kaloi tërë ato kohëra sikur të jeton në buzë të historisë, duke mos ndikuar në të ndodhitë e as të veprojë koha. E kush nga ne nuk ka dëgjuar për kalatë e Hamrasë?

Ndërsa sot, në qytetin e Granadës depërtojnë në të rrugët e gjëra dhe ngrihen në të minaret e larta.

Dhe ajo që e tërheq vëmendjen e një turisti arab janë sloganet në mure që shprehin solidaritetin e banorëve të qytetit dhe popullit spanjoll në përgjithësi me çështjen kryesore arabe, çështjen palestineze. Në mure të ndryshme janë shkruar sloganet si “Solidarizohemi me popullin palestinez dhe rroftë lufta e popullit palestinez”. Gjithashtu gjenden edhe slogane tjera për solidarizimin me Nikaraguan, Kilin, si dhe slogane të shumta kundër pranisë së bazave amerikane në Spanjë. Afër këtyre sloganeve, në afërsi të kështjellës së Hamrasë gjenden fjalët e një lypësi të verbër: “Beso, se nuk ka gjë më irrituese në jetë sesa të jesh i verbër në Granadë”.

Por, kur na bie ndërmend e kaluara e largët dhe civilizimi islam, që kanë provuar t’i fshehin përmes deformimeve, atëherë gjithsesi duhet të largohemi nga qendra e qytetit modern të ngjeshur dhe të shkojmë te kopshtet e saj në pjesën veriore që njihet me emrin “Pushimi i Bajazinit”, i cili i ka ruajtur shtëpitë e tij të vogla me mure të trasha dhe rrugica të ngushta e të pastra. Të gjitha shtëpitë atje janë të ndërtruara sipas stilit arab. Shoqëria ende është “andaluziane”. Nuk ka dallim mes të pasurit dhe fqinjit të tij të varfër, që të gjithë janë vëllezër të barabartë siç ishin në kohën e arabëve. Me një fjalë lagjja e quajtur "Bajazin" ende është arabe. Në atë lagje të vjetër mund të ndalemi te e kaluara me të gjitha kujtimet e vjetra islame të dashura për vete dhe të cilat kanë mbetur gjatë kohës dëshmitar i madhësisë së civilizimit

islam. Atëherë, na prek zilia e pendimi për neglizhencën tonë ndaj kësaj pasurie historike të çmueshme që na doli nga duart.

Në mes të xhamisë së Kortobës ndërtuan kishë dhe emrin e saj e ndërruan në katedrale

Kur flasim për antikitetin kulturor islam në Gadishullin e Iberisë, xhamia e Kortobës na bie së pari ndërmend. Padyshim se kjo xhami është puna më e madhe arkitektonike që e kanë bërë myslimanët si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Mbuloja e xhamisë është 4868 m², ndërsa sipërfaqja e xhamisë është 12189 m². Kjo xhami është e mbuluar me një mori shtyllash që kanë mbetur edhe sot dhe numri i tyre kalon 1200. Ajo është mrekullia e artit islam në Andaluzi.

Gjenialiteti arkitektonik qartësohet nëse shikojmë me kujdes se si arkitekti e ka bartur mbulojën, lartësia e të cilit arrin deri në 9 metra mbi një shtyllë të gjatë, largësia e njërës prej tyre nuk shkon më shumë se 25 centimetra.

Arkitektit të njohur Nortedramit i është nevojitur një shtyllë guri në hapësirë për çdo njëren prej tyre deri në katër metra, që të ndërton një kulm të ngjashëm.

Por, këtë pasuri të vjetër islame e kemi neglizhuar. Të tjerët kanë bërë atë që kanë bërë. Në mes të saj kanë ndërtuar kishë, minaret e saj i kanë shndërruar në kulla për zile, ndërsa emrin e saj prej xhamisë e ndryshuan në katedrale.

U zemëruam e bërtitëm duke e ditur se ne jemi përgjegjës për atë që na gjeti.

Përmirësimi i figurës së Islamit brenda Spanjës

Myslimanët, sot në Spanjë jetojnë në qytetet e mëdha si në Granadë, Sevilje, Malakë dhe Kortobë. Me gjithë numrin e vogël të tyre (afër 200 mijë) në krahasim me numrin e popullsisë spanjolle afërisht 40-milionëshe, myslimanët po përpiqen të përmirësojnë figurën e Islamit në sytë e popullsisë vendase, pasi që u prish kjo figurë te shumica e popullsisë. Kjo ndodhi veçanërisht pasi që spanjollët dëbuan nipërit e myslimanëve vendas të Andaluzisë nga vendi, siç përmendëm më lart.

Myslimanët me një durim të madh përpiqen të zgjojnë interesimin e spanjollëve për fenë islame, sepse kushtet e Islamit në Spanjë dallojnë më shumë nga çdo vend tjetër evropian. Myslimanët në çdo shtet evropian mund ta paraqesin fenë islame, njoftimin me të dhe thirrjen për të duke e konsideruar si fe të re për popullsinë vendase, ndërsa në Spanjë gjendja ndryshon plotësisht. Me gjithë ndjeshmërinë e madhe kundër Islamit (kjo për shkak të sundimit të Andaluzisë dhe historisë së tyre plot me çlirime islame e humbjeve të vazhdueshme që ua shkaktoan spanjollëve, si dhe rolit të rrezikshëm të cilin e luajtën misionarët në prishjen e figurës së Islamit te popullsia vendase), ndryshimi i disa mendjeve fanatike kundër Islamit është bërë çështje e vështirë që i lufton myslimanët. Por, me durim e tolerancë përmes argumentimit, këshillës së mirë dhe sjelljes shembullore, do të ngjallet përsëri Islami në zemrat e spanjollëve.

E vërteta është që fanatizmi i spanjollëve katolikë në të kaluarën kundër feve ka përfshirë shumicën e feve që janë paraqitur në tokën spanjolle. Por, kjo mostolerancë fetare nuk i ka penguar që të vlerësojnë disa shpikje në mendim, dituri dhe artin arabo-islam, siç u ka mundësuar shoqërimi i gjatë me shtetin islam, njohja e antikitetit islam dhe përfitimi prej tij në të gjitha fushat e jetës së tyre shkencore, mendore dhe arkitektonike.

Sevilja, nusja e Andaluzisë

Nëse kthehemi te Sevilja, nusja e Andaluzisë (siç e pëlqejnë ta quajnë disa) sikur e ndjejmë se si ka qenë në kohën e arabëve, në kohën kur ka qenë qytet i artit, bukurisë e muzikës, vendtakim i poetëve, këngëtarëve e artistëve. Për të Benu Ubadi shkroi poezinë më të mirë e më të ëmbël. Netët e tyre të gjata i kalonin në vende poetike, ndërsa vdekja iu shfaqej në mëngjes e mbrëmje duke i zënë njerëzit e tyre. Megjithëkëtë, gjenin kohë për të rregulluar poezinë. Dëshmi më e mirë për këtë është adresimi ndaj njëri-tjetrit. Sa që edhe letrat e tyre drejtuar armiqve ishin poezi!

Në sheshin e fitores "Triumfo" e rreth tij bashkohen Kalaja e Seviljes, minarja Hajralda, arkiva perëndimore e Hindit, afër saj Kalaja e Platos, kisha Salvador, kulla e arit, lagjja "Santa Krut", Kisha Katedrale.

Madhësia e kësaj kishe nuk mund të paramendohet. Ajo është një pjesë e gjerë prej guri që përfaqëson zemrën e gjithë qytetit. Ngado që kthehesh e ke përpara dhe çdo gjë brenda saj është e zbukuruar me art të vërtetë.

Shtrohet pyetja: Pse e kanë ndërtuar këtë ndërtesë gjigante?

Shkaku: Me këtë kanë dashur fshehjen e çdo gjurme të xhamisë së Seviljes, motër e xhamisë madhështore të Kortobës.

Po të dëshiroja do të thosha: Kjo kishë gjigante rëndon mbi rrënojat e një xhamie madhështore, bukuria e madhështia e së cilës nuk është më e paktë se e xhamisë së Kortobës. Po të mbetej do të ishte veçori e arkitekturës në gjithë historinë e saj.

Por, nga xhamia nuk ka mbetur asgjë përveç bukurisë së minares, e cila sot është kullë e kishës!

Ndërsa Seviljen sot, e gjejmë të mbushur me banorë, zakonet e të cilëve u ngjajnë atyre arabe. Myslimanët e Seviljes dallohen, ngase ushtrojnë jetë dhe punë islame më shumë. Qendrat islame në përgjith-

ësi luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e myslimanëve, ku marrin mësim nga feja e shkencat kur'anore, si dhe aty gjenden anekse të veçanta për myslimanët e rastit apo për ata të cilët dëshirojnë të qëndrojnë për një kohë të shkurtër në Spanjë. Këto qendra kujdesen për nxënësit myslimanë, të cilët mësojnë në universitete, institute apo për specializime të ndryshme. Myslimanët përpiqen të përfitojnë nga këta nxënës, duke u miqësuar me ta që të njohin më shumë Islamin, veçanërisht prej atyre që janë të ditur në fe. Prej tyre kanë zgjedhur imam të xhamive dhe mësues për mësim fetare e të gjuhës arabe. Vërtet, ata kanë nevojë të madhe për thirrës e dijetarë, që të mësojnë prej tyre Islamin e vërtetë, pa deformime e shtrembërime.

Islami si fe, nuk mësohet në shkollat spanjolle, por mësohet historia islame në Spanjë, e atë në mospajtim të plotë me të vërtetat historike. Prandaj, është domosdoshmëri për myslimanët të kërkojnë burime tjera më të përpikta e më të vërteta për ta njohur të vërtetën e historisë islame, drejtësinë e tolerancën e tij dhe origjinalitetin e vlerave të tij njerëzore.

Për shkak të këtyre burimeve të pakta në gjuhën spanjolle, nuk kanë zgjidhje tjetër përveç që t'i lexojnë në gjuhën franceze e angleze dhe të kthehen te burimet që janë shkruar në këto dy gjuhë. Kjo është çështje shumë brengosëse, ngase shumica e myslimanëve nuk i njohin mirë këto dy gjuhë. Prandaj, kanë filluar t'i rregullojnë mësimet e gjuhës arabe e ato fetare për fëmijët e tyre që të mos kenë të njëjtin problem kur të rriten. Gjithashtu, përpiqen të importojnë librat islame përmes qendrave islame.

Problem tjetër është mungesa e librave që flasin për parimet islame dhe mësimin e fillestarëve. Në përgjithësi, gjenden libra që u drejtohen myslimanëve, të cilët kanë lindur e janë rritur në Islam.

E tërë kjo po ndodh në vendet ku Islami një ditë prej ditëve ishte fe zyrtare. Kjo po ndodh në qytetin si Granada, në të cilin janë lindur dijetarët më të njohur myslimanë si: Ebi Mervan ibn Zehr, dijetari i njohur i fundit i mjekësisë pas Razit dhe ibn Sinas, i cili në kohën e tij

arriti një përparim të madh në shkencat mjekësore. Myslimanët i përfeksionuan operacionet e rrezikshme, si operacioni i syrit me gjilpërë precize. Ky përparim shkencor erdhi si rezultat i mbështetjes së tyre në eksperiment e mendje për shpjegimin e sëmundjeve dhe zbulimin e ilaçeve. Ndërsa, evropianët vazhduan të shpjegojnë epideminë për një kohë të gjatë me analiza të brishta e me mitet e magjisë, derisa librat arabe filluan të depërtojnë te ta në shekullin XI përmes përkthimeve. Kështu, Evropa mori nga myslimanët shkencat mendore e humane. U përkthyen librat e Razit e ibn Sinas në gjuhën latine, të cilat u bënë librat e burimet më të rëndësishme në universitetet evropiane.

Kortoba, në përgjithësi luajti një rol të rëndësishëm në këtë fushë si qendër e rrezatimit për çdo lloj diturie dhe civilizimi islam, që u bart pastaj te qytetet e fshatrat tjera spanjolle.

Ende para nesh qëndrojnë Madridi, Malaka, Toledo e qytete tjera. Biseda zgjat dhe për të do të duhen faqe të shumta, por mjafton thënia: Gjurmët e Islamit e myslimanëve në të, që të gjitha tregojnë për të kaluarën e ndritshme të Islamit. Por, këto gjurmë konsiderohen prej elementeve më të rëndësishme për joshjen turistike, ku Spanjën për një vit e vizitojnë 54 milionë turistë, që është më shumë se numri i popullsisë që arrin deri në 40 milionë banorë. Të ardhurat e vitit të kaluar nga turizmi që arritën në 16.7 miliardë dollarë arritën të mbulojnë deficitin tregtar, i cili arriti në 15.9 miliardë dollarë.

Islami ende jeton në Spanjë

Armiqtë e civilizimit islam bënë atë që bënë. Myslimanët dolën nga Andaluzia para pesë shekujve, por atje mbeti Islami. Nuk arritën të nxirrin nga Andaluzia bazën e civilizimit islam e artet e tij, por mbetën të gjalla e të qëndrueshme në atë tokë, në kujtimet arabe e në imagjinatën e gjithë njerëzimit. Dëshmitarë që myslimanët ishin ndër-tues të një civilizimi të madh, që historia nuk njohu të tillë.

Andaluzia nuk mund të humbet, nëse e kujtojmë mësimin, përfitojmë nga përvoja dhe mësojmë se si u shpërbë. Nëse e kuptojmë këtë, mund të kthejmë shpirtin e Islamit e tolerancën e tij në atë vend.

ISLAM IN ANDALUSIA

(Summary)

There is no doubt that the bitter experience of Muslims in Andalusia (present day Spain) is one of the biggest tragedies in the history of mankind. Muslims were faced with persecution, which lasted for more than 1 century. They were given the choice to convert to Christianity or to be slaughtered. Consequently, by the end of 1610, only a small number of Muslims were left in Andalusia. This is something completely different to the good treatment the Spaniards enjoyed during the golden age of Islamic civilization. Such a treatment was not confined only to the Spaniards, as it is a custom of Islam to coexist with all those who want to live in peace.

Muslims lived in Spain for more than 8 centuries. During this period, Islamic civilization thrived. Its fame reached the highest horizons. Muslims built beautiful mosques, towns, palaces, fortresses, etc. In the south of Spain science, art and civilization thrived.

الاسلام في الاندلس

(خلاصة البحث)

لا شك ان محنة المسلمين في أندلس الامس، أسبانيا اليوم من أكثر المنى في تاريخ الانسانية ايلاما و تأثيرا في النفوس، لما لا قوه من اضطهار و حرق و دمار و نهب و تنكيل استمر مدة مائة عام و عشرين عاما، و كان الخيار (التنصير أو الذبح) حتى انه لم يبق في اواخر علم ١٦١٠ الا القليل من عددهم البالغ ثلاثين مليوناً. و ذلك على التقيض تماما لما عرفه الاسبان في ظل ازدهار الحضارة الاسلامية من التسامح و حسن المعاملة، ليس معهم فحسب بل كان ذلك موقف الاسلام مع أهل الذمة في كل الامم الراغبة في العيش بسلام.

MYSLIMANËT NË BOTË

ISLAMI NË SHBA

POPULLATA MYSLIMANE - Harta Demografike

Nëse merret parasysh Kushtetuta amerikane në të cilën nuk lejohet që cilado qoftë kombësi të bëjë hulumtimin dhe regjistrimin e karakteristikave shtetërore amerikane dhe fetare, atëherë pamundësohet që saktësisht dhe në mënyrë precize të verifikohet numri si dhe madhësia e grupeve fetare, duke i llogaritur këtu edhe myslimanët në SHBA. Burimet e të dhënave të kësaj natyre janë nga hulumtimet individuale, si dhe hulumtimet e bëra nga ana e disa individëve të bashkësive fetare apo të institucioneve relevante shkencore.

Numri dhe shtimi i popullatës myslimane

Nga hulumtimet e ndryshme vlerësimi i numrit të myslimanëve në SHBA, sillet prej tre deri në nëntë milionë, kurse nga vlerësimet e lira arrin deri në dhjetë milionë. Ndërsa një numër i madh i hulumtimeve tregon se në SHBA jetojnë më së paku shtatë milionë myslimanë, apo 2,5% nga popullata e përgjithshme. Ajo popullatë është më e madhe nga disa prej shteteve ballkanike, si dhe nga Norvegjia, Finlanda, Danimarka, Zvicra dhe Suedia.

Islami është njëra nga religjionet e cila më së shpejti zhvillohet, kurse popullata myslimane është ajo e cila më së shpejti rritet. Në tri dekadat e fundit numri i myslimanëve dukshëm është rritur, prej

500.000, sa ishin në vitin 1970, arritën që në vitin 2002, të jenë rreth shtatë milionë. Shkalla e rritjes vjetore e popullatës myslimane në SHBA është 6%, në krahasim me shkallën e rritjes të popullatës së përgjithshme në SHBA e cila përbën 0,9%. Faktori më i rëndësishëm për shtimin e popullatës myslimane në SHBA, vazhdon të jetë emigrimi dhe shtimi natyror i saj. Këtë të dytën e vërteton fakti se mesatarja e numrit të anëtarëve në familjen myslimane në SHBA është 4,9 veta. Megjithatë, një faktor shumë me rëndësi për rritjen e numrit të myslimanëve në Amerikë është pranimi i fesë islame, posaçërisht në mesin e popullit afro-amerikan. Vlerësohet se gati një e treta e popullatës myslimane në Amerikë është e kësaj natyre. Brenda një viti rreth 20.000 amerikanë kalojnë në islam. Nga ky numër 63% janë afro-amerikan, 27% të bardhë, 6% latino-amerikan dhe 3% të tjerë. Paraqitjet e vitit 2000 tregojnë se 67% e të konvertuarit janë meshkuj, kurse 32% janë femra.

Përhapja gjeografike

Shumica e myslimanëve amerikanë jetojnë në vende kozmopolite të rëndësishme amerikane. Rreth 20% e të gjithë myslimanëve amerikanë jetojnë në Kaliforni (që përbënë 3,4 % të popullatës së përgjithshme të këtij vendi) ku, në mënyrë konsekuente, ekziston një numër i madh i xhamive dhe qendrave islame që numërohen në disa qindra. Gjashtëmbëdhjetë për qind e popullatës myslimane jetojnë në shtetin e Nju-Jorkut (që përbën 4,7% të popullatës së përgjithshme të këtij vendi), në Ilinois 8% (me 3,6 % të popullatës së përgjithshme në këtë vend), nga 4% ka në Nju Xhersi (me 2,4 % të popullatës së përgjithshme të vendit), dhe Indianë (me 3,2 % të popullatës së përgjithshme në vend), dhe përafërsisht nga 3% jetojnë në Virgjini me 2,4 % të popullatës së përgjithshme të vendit, Teksas me 0,7 % nga popullata e tërësishme e vendit, Ohio me 1,2% nga popullata e përgjithshme e vendit, dhe në fund Meriland me 1,4% nga popullata e përgjithshme e vendit. Këto janë dhjetë shtete me numër më të madh të popullatës

muslimane, ndërsa të tjerët me përqindje më të vogël jetojnë në vende tjera të SHBA-së.

Prejardhja dhe gjuha

Bashkësinë myslimane në Amerikë e përbëjnë njerëz me një spektër të gjerë të rrënjëve dhe prejardhjes etnike dhe nacionale. Dy të tretat e myslimanëve në SHBA janë me prejardhje emigrante, qofshin ata të ardhur apo pasardhës të tyre. Numri më i madh i ardhacakëve myslimanë në Amerikë janë nga vendet e Azisë Jugore dhe Juglindore, siç janë: India, Bangladeshi, Pakistani dhe Afganistani, të cilët përbëjnë 35% të popullatës së tërësishme myslimane në SHBA. Grupi i dytë etnik sipas madhësisë janë arabët me 25%, pastaj afrikanët nga vendet e ndërsahasë afrikane me 3.4%, mandej vijjnë evropianët me 2.1% që përbëhen nga boshnjakë, tatarë dhe shqiptarë të Kosovës. Grupeve tjera etnike u takojnë: turqit, iranezët, ardhacakët nga Karai-bet, latino-amerikanët, afro-amerikanët, amerikanët e bardhë dhe të tjerë.

Përafërsisht një e treta e myslimanëve në Amerikë përbëhet nga të konvertuarit, që më së shumti janë nga bashkësia afro-amerikane të cilët përbëjnë rreth 30% të popullatës së përgjithshme myslimane, pastaj amerikanët e bardhë, latino-amerikanët dhe të tjerë. Nëpër familjet e myslimanëve amerikane të cilët janë me prejardhje joamerikane, si dhe në xhamia dhe shkolla private fetare dhe etnike ende praktikohet dhe mësohet gjuha amtare apo gjuha e vendit nga janë.

Arsimimi dhe struktura ekonomike-sociale

Muslimanët e Amerikës përbëjnë grupin fetar shumë të arsimuar. Rreth 70% të tyre e kanë të kryer fakultetin apo ndonjë shkallë të lartë të arsimit, ndërsa në të njëjtin kohë, vetëm 44% e popullatës së përgjithshme amerikane e ka këtë nivel të arsimimit. Çdo e dhjeta familje myslimane e qet nga një mjek apo doktor të mjekësisë. Ndërsa, vetëm 3.5% të myslimanëve të Amerikës nuk kanë të kryer shkollën e me-

sme, derisa në të njëjtin kohë 4.7% e popullatës së tërësishme amerikane janë pa shkolla të mesme.

Punësimi dhe profesioni

Sa u përket profesioneve me të cilat merren myslimanët në Amerikë, mund të thuhet se janë të grupit të shumanshëm. Megjithatë, inxhinieria dhe programimi janë dega më e zgjedhur e më tepër se 19% të myslimanëve amerikanë. Në fusha të lidhura me mjekësi janë të punësuar më tepër se 10%, ndërsa, 4% gjenden në punët që kanë të bëjnë me financa. Një numër i dukshëm i myslimanëve amerikanë merren me ndërtimtari, ata përbëjnë rreth 10%. Profesionet tjera, me numër të caktuar, me të cilat merren myslimanët e Amerikës janë: menaxhimi nëpër firma të ndryshme, puna e mësuesit, qarkullime të voga private, punët hulumtuese, angazhimet administrative dhe të tjera. Në përbërjen e profesionit të forcave të armatës amerikane janë diç më tepër se 1%. Kurse më tepër se 20% të myslimanëve amerikanë janë studentë.

Ndërkaq, myslimanët e Amerikës nuk janë mjaft të pranishëm në punët të cilat e hartojnë politikën e përgjithshme apo ndikojnë në formimin e masës publike, siç janë mediumet, gjykata, avokatura, pastaj industria e filmit (drejtor, producent, artist) e të tjerë.

Të ardhurat

Mund të thuhet se myslimanët e Amerikës mesatarisht janë popullatë imune. Derisa të ardhurat mesatare të një familje në SHBA janë më pak se 40.000 dollarë, kurse 66% të shtëpive myslimane në Amerikë brenda viti fiton më tepër se 50.000 dollar, 26% janë me më tepër se 100.000 dollarë, ndërsa 5% e kalojnë shifrën prej 250.000 dollarëve.

Kontaktet e para të myslimanëve me Amerikën

Edhe pse mendimi më i përhapur për myslimanët e parë që kanë shkelur në Amerikë bazohet në zezakët e robëruar që vinin nga popujt afrikanë të cilët me dhunë ishin sjellë atje përgjatë shekujve 18-të dhe 19-të, ekzistojnë dokumente historike që na informojnë, se myslimanët e parë të cilët shkelën në tokën amerikane ishin njerëz të lirë, dhe të punësuar nëpër qeveritë spanjolle dhe portugeze, të cilët gjatë shekujve 15-të dhe 16-të bashkë me konkvistadorë kishin marshuar në Amerikë. Një numër i dukshëm i morisëve (myslimanë spanjollë, të cilët pas vitit 1492 mbanin fenë në fshehtësi) gjatë shek. 16-të emigruan në Amerikën spanjolle dhe portugeze, por sundimtarët e krishterë, duke u frikësuar nga numri i tyre, i ndoqën me inkuizicion. Gjithashtu besohet se në anijet Nina dhe Pinta të ekspeditës së parë të Kristofor Kolombos që u zbarkuan në kontinentin amerikan në vitin 1492 kapitenët e anijeve ishin myslimanë. Sipas një dokumenti kinez i njohur si dokumenti Sung, marinarët myslimanë u zbarkuan në tokën e njohur si Mu-Llan-Pi (Amerikë), qysh herët në vitin 1178, pra 300 vjet para “zbulimit” të Botës së re të Kolombos. Vlerësohet se 35-45% të afrikanëve të cilët gjatë periudhës së mesit të shek. 16-të dhe i mesit të shek. 19-të me dhunë e lëshuan Afrikën (Senegali, Gambia, Sahara Jugore, Nigeria, dhe vende tjera) ishin të fesë islame, kurse më së paku një e pesta e atyre të cilët konsideroheshin si robër zezakë dhe të cilët përfunduan në Amerikë ishin myslimanë.

Shumica dërrmuese e këtyre myslimanëve gjatë kalimit të kohës e humbën identitetin e vet islam apo u detyruan me dhunë të konverteshin në krishterim. Nga gjurmët që janë ruajtur e të cilat na informojnë për ekzistimin e tyre janë disa gojëdhëna si dhe ekzemplari i Kur'anit i asaj kohe për të cilën besohet se është i shkruar nga hafëz Ajb ibn Sylejman Ibrahim Diallo (i njohur si Jab ibn Soliman), mysliman nga Senegali, i cili në vitin 1730 në Amerikë u soll si rob. Ekziston gojëdhëna për disa kryengritje myslimane, si ajo e Haitit e vitit 1758.

Vendosja e përhershme e myslimanëve në kontinentin amerikan

Migrimet e para të rëndësishme të myslimanëve në Amerikë kanë ndodhur në intervalin kohor prej vitit 1875 e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore. Kjo valë e emigrantëve myslimanë në Amerikë kryesisht ishte nga Lindja e Afërt, nga Siria e sotme, Libani, Jordania dhe Palestina. Pikërisht këta ishin një fuqi punëtore e pakualifikuar dhe e paarsimuar, struktura e të cilëve ishte në shumicë të rinj dhe meshkuj të pamartuar. Motivi i ardhjes së tyre në Amerikë ishte ekskluzivisht përmirësimi i gjendjes ekonomike. Të bindur në tregimet për “Botën e re” se atje shumë lehtë dhe shpejt njeriu pasurohet ata nuk menduan që të vendosen në Amerikë përgjithmonë, por të fitojnë para të mjaftueshme dhe të kthehen prapë nëpër vendlindjet dhe familjet e veta. Meqenëse nuk e njihnin gjuhën angleze, shumë nga ata punuan si shitës të gazetave (nëpër rrugë) apo edhe si tregtarë të vegjël, duke shkuar “derë më derë”.

Të tjerët gjetën punë nëpër fabrika të ndryshme dhe miniera, apo u bënë pemëshitës dhe dyqanxhinj. Gjatë kalimit të kohës ata kuptuan se gjasat për t'u kthyer në vendlindje janë të humbura, atëherë filluan që t'i adaptohen shoqërisë amerikane dhe jo rrallë herë u martuan me femra amerikane dhe në vazhdimësi, duke u vendosur me shumicë në lindje të SHBA-së, në perëndimin e mesëm, dhe përgjatë bregdetit të Pacifikut, ata rrezikuan identitetin e tyre islam. Përkundër vështirësive të shumta këta myslimanë i vunë themelet e bashkësive islame dhe xhamive, të cilët sot janë shumë aktivë në vendet si: Cedar Rapids, Iowa, dhe Edmonton, Alberta.

Lufta e Parë Botërore ndërpreu përkohësisht migrimin e myslimanëve në kontinentin amerikan. Pas përfundimit të luftës, që ishte një ko incidencë me shkatërrimin e Perandorisë Osmane, dhe të kolonizimit perëndimor të vendeve të Lindjes së Afërme, shkuarja e myslimanëve në Amerikë vazhdoi. Vendi i veçantë nga i cili në këtë valë të dytë më së shumti emigruan, ishte Libani, i cili gjatë luftës kishte

pësuar shkatërrime. Një numër i rëndësishëm i myslimanëve të kësaj ane vendos të emigrojnë në Perëndim, por këtë herë, përveç shkaqeve ekonomike ishin edhe ato të natyrës politike. Dominonte edhe dëshira që t'u bashkëngjiten të afërmeve të cilët kishin emigruar më herët dhe që ishin vendosur tashmë në Amerikë. Në vitin 1924, SHBA miratuan një ligj të ri për imigracion, me këtë rast valës së dytë të imigrantëve myslimanë në Amerikë në masë të madhe iu çrregullua situata. Ky ligj futi “sistemin nacional të kuotave” apo përkufizoi hyrjen në SHBA në baza të prejardhjes nacionale, e cila më së shumti vinte në shprehje për arabët. Gjatë viteve tridhjetë të shek. XX, nën ndikimin e këtij ligji, ardhja e myslimanëve në Amerikë dukshëm është zvogëluar, kjo vlente kryesisht për ata myslimanë, familjet dhe farefisi i të cilëve gjendeshin në Amerikë. Në masë të madhe të kësaj periudhe, ligjet për imigracion ishin dukshëm diskriminuese. Shumica e myslimanëve të Lindjes së Mesme me vështirësi e merrnin nënshtetësinë. Me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, ky migrim përsëri për një kohë u ndërpre. Perioda tjetër e cila mund të identifikohet si vala e tretë e migrimit mysliman në Amerikë, është periudhë drejtpërsëdrejti e pas Luftës Dytë Botërore, prej vitit 1947, deri në mesin e viteve gjashtëdhjetë. Në këtë valë të emigrimit përveç myslimanëve nga Lindja e Afërt ishin të kyçur edhe ata të Azisë Jugore, Evropës dhe Bashkimit Sovjetik. Ligji i SHBA-së i vitit 1953, për emigrim dhe shtetësi (*The US Immigration and Nationality Act*) ndryshoi formulën për kuota, e cila ishte normuar për çdo vend me prejardhje të popullatës së migruar. Si rezultat i kësaj, filluan migrimet e myslimanëve nga vendet e tjera të botës, si nga Evropa Lindore (para së gjithash nga Jugosllavia e atëhershme dhe Shqipëria) dhe Bashkimi Sovjetik. Një numër i vogël migruan edhe nga India dhe Pakistani, por pas ndarjes nga India në vitin 1947. Në formimin e kësaj popullate të emigruar reflektoi situatë e rikrijuar nëpër vendet myslimane. Shumica e tyre migruan në Amerikë duke ikur nga persekutimet politike. Numrin më të madh e përbënin palestinezët, të cilët i kishte ndjekur Izraeli nga vatrata e tyre, pastaj egjiptianët pronën e të cilëve e kishte nacionalizuar Gamal Abdall Naseri, Iranian, Sirian, por edhe myslimanë të tjerë dhe nga pjesët e tjera

të botës, sikur ata të Evropës Lindore dhe BS, të cilët ikën nga pasojat e Luftës Dytë Botërore apo nga torturat e regjimit komunist. Për dallim nga emigrantët e mëhershëm, këta ishin kryesisht më të arsimuar, dhe një numër dukshëm i tyre vinte nga familjet elite të Lindjes së Afërt dhe Azisë Jugore. Qëllimi i tyre kryesor ishte që të arrijnë shkallë të lartë në arsim dhe përgatitje profesionale. Edhe pse shumë prej tyre janë kthyer, një numër i madh mbeti me qëllim që duke e mbajtur identitetin islam, të integrohen në shoqërinë e Amerikës Veriore.

Myslimanët me prejardhje ortodokse këta myslimanë nganjëherë i quanin “myslimanë të Bajramit” sepse në xhami vinin, prej Bajrami në Bajram. Megjithatë, këta myslimanë kontribuuan shumë në rivendosjen e një numri të madh të xhamive dhe qendrave islame, si dhe bashkësive më të mëdha myslimane, sikurse janë Federata e asocialcioneve islame, Këshilli i Xhamive i SHB, Asociacioni i studentëve myslimanë të SHBA dhe Kanadasë, por edhe emigrantët e tjerë myslimanë të kësaj periode ishin kryesisht nga vendet urbane, dhe në shumicën e rasteve ata vendoseshin nëpër qytete të mëdha sikurse janë: Nju- Jorku dhe Çikago.

Vala katërt e emigrantëve myslimanë në Amerikën Veriore filloi kah mesi i viteve të gjashtëdhjeta dhe vazhdon akoma. Ndryshimet të cilat ndodhën në legjislacionin e SHBA-së për imigracion gjatë kohës së administratës të kryetarit Lëndon Xhonson, e mundësuan këtë valë të emigrimit. U anulua “sistemi i kuotave nacionale”. Sipas sistemit të ri, e cila ishte në harmoni me nevojat e ekonomisë punëtore të SHBA, përparësi u jepej përveç farefisnisë të shtetasve amerikanë edhe atyre, profesionet e të cilëve ishte deficitare në SHBA. Ligji i ri për herë të parë pas viteve të para të shek. XX, bëri të mundshme që dikush të emigrojë në Amerikë duke mos marrë parasysh prejardhjen nacionale. Në këtë mënyrë emigracionin mysliman të kësaj periode e përbënin kryesisht myslimanë të arsimuar, të cilët e flisnin gjuhën angleze. Këta emigrantë të cilët përveç që vinin nga Lindja e Afërt, ishin edhe nga Turqia, Irani, Afganistani, Pakistani, India, Bangladeshi, kohëve të fundit edhe nga Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova, nuk vinin në Amerikë sa për të fituar para, e pastaj të kthehen në atdheun e tyre,

por, që të nguliten dhe të natyralizohen, dhe të përparojnë në formimin dhe aftësitë e tyre profesionale, me qëllim që të arrihen, mundësitë e punësimit. Gjithashtu, shumë prej tyre që kërkonin strehim vinin nga vendet që ishin me regjime të ashpra. Natyrisht, se ekzistojnë edhe disa përjashtime nga profili i thënë më parë për emigrimin e kësaj popullate, sikurse që është një numër i caktuar i shi-ive të Libanit dhe palestinezët e ndjekur gjatë konfliktit në Liban, të cilët kryesisht janë të paarsimuar dhe të pa kualifikuar. Kjo valë e fundit e emigrantëve deri më tani është më e motivuara që ta mbajë dhe ta ruajë identitetin islam, si dhe të vendosë institucione me një bashkësi dhe strukturë të përgjegjshme dhe permanente. Këtë qëllim mundohen ta arrijnë nëpërmes misionit (*da'wah*), shkollave islame, publikimeve, ndërtimit të xhamive dhe qendrave islame, duke u kyçur në politikë, në marrëdhënie publike, por edhe nëpërmes zhvillimit të institucioneve financiare islame, siç është p.sh., sistemi bankar pa kamata.

Islami në Bashkësinë afrikano-amerikane

Grupin e dytë për nga madhësia të myslimanëve etnikë, dhe përfshihet një të tretën e popullatës myslimane në Amerikë e përbëjnë amerikanët me prejardhje afrikane, të parët e të cilëve me gjenerata kishin jetuar në Amerikë, por të cilët islamin e pranuan tek në shek. e kaluar. Ndonëse një numër i konsiderueshëm, më tepër se 20%, të të parëve të afrikano-amerikanëve të sotshëm kur me dhunë i kishin sjellë në Amerikë ata kishin qenë myslimanë, por identiteti i tyre islam humbi gjatë diskriminimit dhe të drejtave tjera fetare, si, p.sh., krishterimi i dhunshëm.

Tre janë faktorët kryesorë që ndikuan në kalimin e afrikano-amerikanëve në islam: shumica e tyre ishin të vetëdijshëm për prejardhjen e tyre të hershme myslimane dhe që kishin humbur identitetin islam; lajmërimi i lëvizjeve të reja kuazi-myslimane në mesin e afrikano-amerikanëve, të cilat lindën nga dëshira për rimëkëmbjen e identitetit të humbur; si dhe trendi i dëshirës në mesin e afrikano-amerikanëve të

cilët gjendeshin nëpër burgje dhe qendra të ndryshme të shtëpive ndëshkuese.

I pari i cili filloi të propagandojë principet islame si mjet për bashkimin e amerikanëve me prejardhje afrikane, në fillim të shek. të kaluar ishte zezaku i varfër nga Karolina Veriore me emrin Timothy Drew (1886-1929). Ai duke ndërruar emrin në Noble Drew Ali, në vitin 1913 themeloi lëvizjen pro-islame *Morish-Amerikan Science Temple* në Newark, dhe Nju Xhersi. Noble Drew Ali, Amerikanët e zi i konsideronte si “Aziatik” dhe “Maur” e jo si zezak. Islami shikohej si një religjion i aziatikëve, ndërsa krishterimi si religjion i të bardhëve. Lëvizja Maure-amerikane i huazoi disa aspekte të islamit, por e trasonte kursin e vet. Në vitin 1913 u zgjerua në disa qytete më të mëdha të veriut, duke përfshirë Filadelfinë dhe Detroitin, si dhe disa në jug. Pas vdekjes së Drew Aliut njëfarë Wallac Fard Muhammad, i panjohur por besohej se ishte me prejardhje turko-iraniane, i cili pohonte se ka lindur në Meke nga babai arab dhe nëna evropiane, në vitin 1930 në Detroit themeloi lëvizjen e re me emër *The Lost-Found Nation of Islam in the Wilderness of North Amerika* (Populli islam i humbur dhe i gjetur në shkretëtirat e Amerikës Veriore), më vonë vetëm *Nation of Islam*. Fardi thërriste për shkollim, për rituale të përbashkëta, dhe për lidhje të forta në bashkësi, dhe të gjitha këto me një rigorozitet që ishin në pajtim me normat e etikës. Pas zhdukjes misterioze të Fardit në vitin 1934 rolin udhëheqës në lëvizje e merr zezaku amerikan Elijah Muhamed (1897-1975) i lindur në Gjeorgji me emrin Elijah Pole, i cili ishte luftëtar konsekuent i mësimeve të Fardit. Me përjashtim të emrave, lëvizja në vete kishte shumë pak nga islami. Sa për ilustrim, sipas predikimeve të tyre W. F. Muhamedi ishte trupëzim i zotit, kurse Elijah Muhamedi i dërguar i tij. Të bardhët i shikonin si demon të cilët ua kishin grabitur zezakëve pozicionet e paracaktuara në vendin e nderit në rregullimin e punëve. Shumë nga ish-anëtarët e Noble Drew Aliut, si njëfarë Marcusa Garveja iu bashkuan popullit islam për të kërkuar identitetin e humbur islam. Megjithatë, *populli islam* ndërtoi një numër të madh të tempujve dhe xhamive në vendet urbane anembanë Shteteve të Bashkuara. Disa nga ato përfshihen nëpër zona më

depressive amerikane. Meqenëse lëvizja zgjerohej, në të pranoheshin profesionistë të dalluar dhe amerikanë me prejardhje afrikane të shkolluar, të inspiruar për misionin e saj në punët e mundimshme, në mohimin e vlerave të forta familjare dhe morale, dhe të përcaktimit të qëndrueshëm në lëvizjet për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të popullatës zezake. Lëvizja themeloi edhe disa sektorë në Kanada dhe Karaibe.

Njëri ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohej lëvizja ishte se shumica e amerikanëve refuzonin pranimin legal të organizatës. Liderë të tjerë afrikano-amerikanë, të krishterët e bardhë dhe emigrantët myslimanë, secili në mënyrën e vet, lëvizjen e përjetonin si një atak në interesat personale. Problemi tjetër brenda lëvizjes ishte Malkolm X (1925-1965), nxënësi më i zellshëm i Elijah Muhamedit dhe njeri nga udhëheqësit më të shquar të *popullit islam*, i cili për pak sa e përçau lëvizjen. Edhe pse ishte njëri prej bashkëpunëtorëve më elokuent dhe më besnik i Eljadit, ai në vitin 1963 për shkak të disa deklaratave publike të tij u përjashtua nga lëvizja. Pas pak kohe Malkolm X shkon në haxhillëk, në Meke, aty njoftohet me porosinë universale, mbi nacionale dhe anti-diskriminuese të islamit, ashtu që bëri korrigjimin e disa qëndrimeve të veta të mëhershme, sikurse që ishte ajo për “frytin e keq të racës së bardhë”. Duke u zhgënjyer në Elijah Muhamedin, ai i shkëputi të gjitha lidhjet me *popullin islam*.

Gjatë një fjalimi të mbajtur në një tubim fetar në vitin 1965 ndaj tij u bë atentat, dhe për këtë u fajësuan dhe u gjykuan dy anëtarë të *popullit islam*. Shumë shpejt pas vrasjes së tij, Malkolmit iu rrit fama si njerit ndër amerikanët më me ndikim për vizionin e ngritjes dhe forcimit të popullit zezak. Faktori kryesor çdoherë e më i madh i identifikimit të myslimanëve afrikano-amerikanë me bashkësinë e botës myslimane ishte të pranuarit e islamit tradicional suni. Zyrtarisht ky proces filloi në vitin 1976, kur pas vdekjes së Elijah Muhamedit, i biri i tij Wallace Deen Muhamed, i cili e trashëgoi kryesin e lëvizjes, paralajmëroi se *populli islam* braktis shumicën e predikimeve të atit të tij dhe filluan të ecin rrugës së islamit normativ. Ishte kjo dhe fillimi i procesit për pranimin e *popullit islam* si pjesë legjitime e bashkësisë

myslimane të botës, në vend të një lëvizjeje të ngushtë nacionale zezake, sikur që ishte më parë.

Duke arritur një arsim klasik islam, W. D. Muhamedi merr titullin muxhedid (ri-mëkëmbës i fesë) dhe nisat kah procesi i transformimit, e cila shumë shpesh përfshinte nderimin e emrit të lëvizjes. Lëvizja nën emrin *The Amerikan Muslim Mission* në vitin 1985, edhe zyrtarisht integrohet në bashkësinë e përgjithshme myslimane të SHBA, derisa anëtarët e saj tashti thjesht identifikohen si myslimanë. Gjithashtu u bënë ndryshime edhe në infrastrukturën e lëvizjes. Tempujt u kthyen në mesxhid dhe xhamia, priftëria në imamë, ndërsa gazeta zyrtare *Muhammad Speaks* u bë *Muslim Journal*. Në vitin 1985 imam W.D.Muhammadi befas e braktisi pozicionin udhëheqës në *Amerikan Muslim Mission*, dhe nga selia e saj në Çikago u shpërngul në Kaliforni. Të gjithë pjesëtarët e lëvizjes Eljad Muhamedit nuk ishin të pajtimit me ndryshimet e bëra nga i biri i tij. Një pjesë e konsiderueshme e lëvizjes, nën udhëheqjen e klerikut Louis Farakhan ish Louis X vazhduan rrugën e predikimeve të Eljadit dhe mbajtën emrin e popullit islam, si dhe bazën e strukturës organizative të saj. Lëvizja i mbajti disa aspekte të islamit, por myslimanët tradicionalë amerikanë refuzuan ta pranajnë si një lëvizje autentike islame.

Në një pamflet shënohet “faranizmi”, si religjion i posaçëm, i mbrojtur me Amendamentin e parë, por që nuk është islame. Selia e lëvizjes së Farakanit është në Çikago, por ekzistojnë edhe tri grupe, në Baltimor, Detroit, dhe Atlant, të cilët nën udhëheqje të ndryshme pohojnë se janë popull autentik islam.

Dhe, krahas të gjitha hapave të bëra në drejtim të bashkimit të popullatës zezake myslimane në zgjerimin e bashkësisë myslimane amerikane, ekziston një digë e rëndësishme kulturore, profesionale, arsimore dhe ekonomike mes emigrantëve myslimanë dhe shumicës së myslimanëve afrikano-amerikanë.

Krahas misionit mysliman amerikan, ekzistonin edhe grupe tjera myslimane, të cilat u ofronin afrikano-amerikanëve islamit sunit. Një grup i tillë i cili viteve gjashtëdhjeta me të madhe tërhiqte vëmendjen quhej *Darull-islam*. Ndonëse e formuar kah fundi i viteve të dyzeta

dhe fillimi i të pesëdhjetave, *Darull-islam* xhamin e parë e ndërtoi tek në vitin 1962, në Brokrin. Lëvizja mjaft shpejt u zgjerua, e pastaj për shkak të disa mosmarrëveshjeve të brendshme u shua, dhe më në fund në fillim të shtatëdhjetave e reformoi Imam Jahjaja. Deri në mesin e viteve shtatëdhjetë lëvizjes iu bashkëngjitën 31 bashkësi sunite afrikanë-amerikane sidomos nga qytetet e mëdha të bregdetit lindor dhe disa nga Karaibet. Në vitin 1980. Imam Jahjaja u tërhoq nga pozita udhëheqëse e lëvizjes.

Të bardhët e konvertuar në islam

Islamin nuk e përqafojnë vetëm qytetarët amerikanë me prejardhje afrikanë-amerikane, por atë e bëjnë edhe popullsia e bardhë e SHBA-së. Vlerësohej se islamin në Amerikë e përqafoan rreth 100.0000 të bardhë amerikanë. Ndër të parët prej të bardhëve që përqafoi islamin ishte Aleksandër Rasel Ueb (1846-1916), i cili kah fundi i shek. XIX ishte konsull i SHBA-së në Filipine. Me të konvertuar në islam ai u bë një mbrojtës dhe propagandues shumë i zellshëm i saj në Amerikë. Botonte revistën "*The Moslem Word*", dhe publikoi disa punime islame.

Shumica e të konvertuarve nga të bardhët janë femra. Disa nga ato e përqafoan islamin pasi që u martuan me myslimanë, derisa të tjerat këtë e bënin për shkak bindjes së tyre se femrat më shumë nderohen në islam sesa në shoqërinë e përgjithshme amerikane. Shumica e amerikanëve, të cilët nuk janë të kënaqur me atë çka u ofron tradita fetare e tyre apo normat mbizotëruese të kulturës amerikane, alternativën e shohin në islam. Shumica prej tyre iu bashkëngjiten shkollave të mendimit sufi, të cilat veprojnë në Amerikë.

Ngjarjet me rëndësi në historinë e myslimanëve të Amerikës

1178. Dokumenti kinez Sung shënon pranimin e lundërtarëve myslimanë në tokën e njohur si Mu-Lan-Pi (Amerikë).
1312. Myslimanët e Afrikës duke shfrytëzuar lumin Misisipi si rrugë hyrëse arritën në gjirin Meksikan për hulumtime në brendësi të Amerikës.
1530. Në Amerikë filloi ardhja e robërve afrikanë, një e treta e të cilëve ishin myslimanë. Këta robër u dërguan në Meksikë, Kubë dhe në Amerikën Jugore.
1539. Për nevojat e guvernatorit të Spanjës së Re u bënë hulumtime në Arizonë dhe Meksikën e Re, pjesëmarrës i këtyre hulumtimeve ishte edhe Marokeni Estephan.
1717. Në Amerikën Veriore arritën robër nga vendet ku flitej gjuha arabe, të cilët nuk e hanin mishin e derrit, dhe të cilët i besonin Zotit dhe Muhamedit.
1732. Themeluesi i Georgis, James Oglethorpi, në Maryland e liroi robin Ajub ibn Sulejman Janan.
1790. Është regjistruar ekzistimi i Maurëve të Spanjës në Karolinën Jugore dhe në Floridë.
1807. Kongresi i SHBA-së ndaloi hyrjen e robërve në Amerikë. Edhe për kundër ndalimit, robëria në Amerikë në gjashtëdhjetë vjetët vijues arriti në një shkallë të lartë.
1856. Haxhi Alia paguhet me qira nga ana e kalorësve të SHBA-së, për të provuar devetë në vrapim në Arizonë.
1869. Pas hapjes kanalit të Suezit, në Amerikë vjen një numër i caktuar i jemenasve.
1870. Misionari metodist i nderuari Norman përqafoi islamin.
1893. Muhamed Aleksandër Rasel Ueb formoi lëvizjen amerikane-islame për propagandë.
1900. Në Rosi, North Dakot u regjistrua grupi më i parë mysliman, i cili organizoi falje në bashkësi.

1908. Në Amerikën Veriore erdhën emigrantë myslimanë nga provinca arabe të Perandorisë Osmane (kryesisht turq, kurdë, shqiptarë dhe arabë.
1913. Në Newark të Nju Jerseit, themelohet *Moorish-American Science Temple*.
1915. Shqiptarët myslimanë në Mayne ndërtuan një mesxhidë dhe formuan *Islamik Association*.
1919. Në Parkun Highland në Miçigan formohet *Islamik Association*
1920. Në Detroit themelohet gjysmëhëna e kuqe organizatë humanitare myslimane.
1922. Në Detroit, Miçigan formohet *Islamik Association*
1926. Tatarët me të folme të krahinës oolake ndërtuan xhami në Brokrin të Nju-Jorkut, e cila është ende në shërbim.
Formohet *Arab-American Banner Society* në Quincy, Massachusetts.
1930. Themelohet *Lost-Found Nation of Amerika* (myslimanët e zi).
1930. Myslimanët afrikano-amerikanë në Pittsburg, të Pensilvanisë themelojnë xhaminë e parë.
Themelohet populli islam (*Nation of islam*).
1934. Në Ceder Rapid, te Iowa ndërtohet xhamia e parë.
1952. Pas ankesës së myslimanëve në forcat ushtarake, Pushteti Federal lejoi që ushtarët myslimanë në aspektin fetar të deklarohen si myslimanë.
1954. IMS ndërroi emrin në *Federation of Islamic Associations* (FIA).
1957. Hapet Islamik Center of Washington, D.C.
1962. Me hapjen e xhamisë në Broklyn bëhet lindja formale e lëvizjes sunite *Darul- Islam*.
- Nxirret gazeta Muhamed Speaks.
Themelohet Myslim Student's Association (MSA).
1965. Në Nju-Jork vritet Al-Hajj Malik al SHhabazz (Malkolm X).
1971. Themelohet asociacioni i shkencëtarëve dhe inxhinierëve myslimanë.
1972. Themelohet asociacioni i shkencëtarëve myslimanë në shkencat shoqërore.

1974. Lidhjes Myslimane të botës në Kombet e Bashkuara i jepet statusi i Organizatës Joqeveritare.
1975. Vdes Elijah Muhamed, udhëheqësi i popullit islam, ndërsa e zëvendëson i biri i tij Warith Deen Muhamed, i cili në të njëjtin vit heq dorë nga predikimet e babait të vet, dhe popullin islam e shpie rrugës së reformave fetare në pajtim me traditën islame.
1977. Në Newark themelohet dhe për herë të parë takohet *Islamik Conference of North Amerika* (ICNA).
1981. Themelohet Instituti ndërkombëtar për mendimin islam.
1981. Në Plainfield në Indian themelohet biblioteka e parë islame e Amerikës.
1982. Formohet Bashkësia Islame e Amerikës Verore.
1983. Në Çikago themelohet *Islamik College*.
1985. W. D. Muhamed decentralizon *Amerikan Muslim Mission*.
1986. Në Philadelfi, në banesën e vet, bashkë me bashkëshorten vritet dr. Ismail el Faruku.
1990. Myslimanët organizojnë konferencë të parë të solidaritetit nën emrin - Myslimanët kundër aparteidit.
1991. Imam Siraj Wahaj këndoi lutje në Dhomën e përfaqësuesve të Kongresit Amerikan. Ai ishte myslimani i parë që bëri këtë.
1991. Organizata *The Myslim Members in the Military* (MMM) e mbajti konferencën e parë nën emrin *Unity in Uniform*.
1991. Charls Biladh, Kountze, në Teksas, bëhet i pari major mysliman në një qytet amerikan.
1992. Imam W. D. Muhamed këndoi lutje në Senat.

Organizimi fetar

Në Amerikë nuk ekziston një strukturë organizative unike e bashkësisë islame. Myslimanët në Amerikë kryesisht janë të organizuar në nivele lokale, edhe pse ekzistojnë disa të ashtuquajtura organizata të pullazit apo kulmore. Xhemati, si organizatë lokale islame, dhe xhamia, si qendër e veprimtarisë organizative e saj, janë bosht i fesë, por edhe e formave tjera organizative të myslimanëve amerikanë. Krahas organizimeve fetare, myslimanët e Amerikës kishin edhe organizime të motivit kulturor, politik, shkencor, profesional, social etj.

ORGANIZATAT LOKALE ISLAME

Gati në të gjitha hulumtimet e vepruara në mesin e myslimanëve amerikanë termi xhami shfrytëzohet për të treguar një organizatë lokale islame, qendrën islame, xhematin apo xhaminë si institucion. Në bazë të hulumtimeve nën emrin Studime për xhamia 2000 (The Mosque Study Project 2000), e udhëhequr nga Këshilli për marrëdhënie amerikano-islame, vlerësohet se në SHBA ekzistojnë më tepër se 3000 institucione islame, nga të cilat më së paku 1209 janë organizata islame, gjegjësisht xhamia dhe qendra islame. Në këtë numër llogariten vetëm ato organizata islame të cilat disponojnë me hapësirat e xhamive dhe të cilat përveç aktiviteteve tjera organizojnë edhe faljen e namazit të xhumasë. Grupet të cilat faljen e namazit të xhumasë e organizojnë nëpër spitale, ndërmarrje dhe nëpër burgje nuk hyjnë në këtë kategori. Edhe pse emigrantët e parë myslimanë qysh në shek. XIX për shkaqe fetare dhe nevoja tjera filluan të organizohen, ata ishin që hapën rrugë dhe vunë themelet e xhamive dhe bashkësive myslimane të sotëm, mirëpo konsiderohet se organizimet dhe xhamitë e parë si institucione u formuan tek në deceniet e parë të shek. XX. Afërsisht, çdo e teta organizatë islame (13%), në SHBA që sot ekzistojnë, janë vendosur deri në vitin 1970. Gjatë viteve shtatëdhjetë tendenca për themelimin e organizatave islame dhe ndërtimin e xhamive dukshëm rritet, ashtu që në këtë periudhë ndërtohen një e katërta e

xhamive të cilat ekzistojnë sot në SHBA. Megjithatë, sot në SHBA shumica e xhamive dhe të organizatave islame që përbëjnë rreth 62% apo më tepër se tri të pestat e tyre kanë zënë fill që nga viti 1980 e këndej. Vetëm gjatë periudhës së vitit 1994 e deri në vitin 2000 numri i xhamive dhe organizatave islame është rritë për 25%. Organizatat islame në SHBA, për dallim nga organizatat tjera fetare kryesisht janë të përbërjes shumetnike, që përbëjnë afër 90%. Vetëm 7 % e organizatave islame janë që tubojnë një grup etnik. Sot, vlerësohet se rreth dy milionë myslimanë janë drejtpërsëdrejti të përfshirë në anëtarësimin e ndonjë xhamie apo organizate islame në Amerikë.

Krahas imamit apo prijësit, shumica e organizatave lokale islame që përbëjnë 94%, kanë këshillin drejtues dhe ekzekutiv, në shumicën e rasteve të quajtur Mexhli esh-Shura. Në tri të pestat e rasteve (59%), ky trup në emër të organizatës e gëzon autorizimin për miratimin e vendimeve. Në shumicën e rasteve ku Mexhli esh-Shura nuk e ka këtë autorizim, vendimin për vendosje në 28% të rasteve e bien imami, dhe në 11% të rastit vendimet i lejojnë udhëheqës të tjerë. 55% të organizatave lokale islame që janë në shumicë, nuk e bëjnë punësimin e përhershëm të personave, derisa 10% e bëjnë punësimin e përhershëm e më tepër se dy nëpunësve. Në 69% të organizatave lokale islame u lejohet femrave që të zgjidhen në këshillat drejtues dhe ekzekutiv. Bashkësitë lokale islame në Amerikë financohen nga të ardhurat e veta personale (kryesisht nga anëtarësimi dhe ndihmat vullnetare) ato sillen rreth 10.000 dhe 100.000 e më tepër dollar në vit. Vetëm diçka më tepër se gjysma (55%) e organizatave lokale islame në Amerikë janë të lidhur me ndonjë organizatë më të madhe nacionale apo ndërkombëtare islame, derisa gati gjysma (45%) e tyre vepron në mënyrë të pavarur dhe nuk janë anëtare të asnjërës prej atyre organizatave apo asociacioneve.

Xhamitë: Në 43 % të rasteve xhamitë janë të ndërtuar në zonat periferike të qyteteve të mëdha, 16% janë nëpër para lagje, në zonat qendrore të qyteteve janë 21% derisa 31% e xhamive janë të stacionuar në vende më të vogla apo rurale. Meqenëse shumica e xhamive në fillim nuk ishin ndërtuar për këto qëllime, atëherë shumë shpesh

nderohej lokacioni i tyre dhe kështu bëhej edhe ndërrimi i adresave në disa organizata islame. Vetëm 40% e xhamive dhe organizatave islame ende gjenden nëpër ato vende ku kanë qenë që nga fillimi i vendosjes dhe ndërtimit të tyre. Shumica e hapësirave në të cilat janë ndërtuar xhamitë, të cilat përbëjnë 55%, janë të blera dhe të adoptuara për nevojat e organizatave islame, derisa përafërsisht një të katërtën apo 26% të xhamive, muslimanët vetë i kanë ndërtuar. Përafërsisht vetëm një e pesta e xhamive nuk është pronë e tërësishme e muslimanëve por, ose janë prona të huazuara në 15% të rasteve ose, atyre u është ndarë nga ana e ndonjë universiteti apo ndonjë ndërmarrje në 4% të rastit. Krahas kryerjeve të përbashkëta të lutjeve ditore dhe xhumave, qendrat islame dhe xhamitë ofrojnë edhe shërbime tjera siç janë: orë të mësimave fetare (duke mos u ndërlidhur me shkollat e vikendit), ligjëratat e rregullta, kurset në gjuhën arabe, programi për femra, orët në kiraet dhe texhvidi, aktivitete dhe sporte të ndryshme për të rinj, këshilla për muslimanët e rinj, për prindër dhe bashkëshortët etj.

Imamët dhe udhëheqësit

Në krye të çdo organizate lokale islame gjendet imami apo dikush tjetër, të cilët zgjidhen sipas procedurës, ky person prej organizatës në organizatë personifikohet si kryetar, emir, përfaqësues, apo drejtor. Ku është numri i vogël i xhematit përdoren edhe tituj tjerë si p.sh., sekretar gjeneral, koordinator gjeneral, administrator, drejtor ekzekutiv dhe këshilltar. Të gjitha organizatat islame nuk kanë imam klasik. Atje ku kanë, e që përbëjnë 81%, imami është autoritet fetar, i cili i udhëheq namazet në xhami dhe mëson për islam, megjithëse nuk është çdoherë në krye të organizatës. Në 41% të rasteve imami përveç se është prijës fetar, ai njëkohësisht është edhe udhëheqës i organizatës.

Në 40% të rasteve imami është vetëm autoritet fetar, ndërsa organizatën e udhëheq personi civil. Në 19% të organizatave lokale islame, të cilët në përgjithësi nuk kanë imam zyrtar, udhëheqës janë gjithashtu

laikët. Në situata të cilat imamët janë prijës fetarë dhe njëkohësisht udhëheqës të organizatës, kjo posaçërisht bie në shprehje në mesin e muslimanëve afrikano-amerikanë, ku në 89% të rasteve imami gjendet edhe në rolin e prijësit fetar edhe në udhëheqjen e organizatës, derisa p.sh., në organizatat dominuese arabe islame, imamin e gjejmë në 21% të rasteve në të dy rolet. Në 97% të rasteve gati se të gjithë udhëheqësit, të cilët nuk janë imamë vullnetarisht e kryejnë këtë detyrë, derisa më tepër se 60% e imamëve, të cilët nuk janë edhe udhëheqës të organizatës, por janë në marrëdhënie të përhershme të punës për të cilën punë edhe paguhen. Ata imamë të cilët nuk janë në marrëdhënie të përhershme pune në organizatën islame, si dhe udhëheqësit të cilët nuk janë imamë, kryesisht punojnë ndokund jashtë organizatës islame. Shumica e imamëve dhe udhëheqësve të organizatave islame të paktën kanë diploma të kolegjit. Sa i përket arsimit në përgjithësi, më të shkolluarit në mesin e tyre janë udhëheqësit të cilët nuk janë imamë, prej të cilëve gati dy e treta kanë të kryer fakultetin. Kurse sa i përket shkollimit islam, 71% e imamëve të cilët nuk janë udhëheqës të organizatës kanë një lloj formale të shkollimit islam, më së shpeshti me fakultet të kryer jashtë Amerikës, derisa vetëm 10% e udhëheqësve të cilët nuk janë imamë kanë çfarëdo lloji formal të shkollimit islam. Imamët dhe udhëheqësit e organizatave lokale islame kryesisht janë nga ato grupe etnike të cilat dominojnë në organizatë. Meqenëse shumica e xhematit e dëshirojnë imamin, i cili e flet arabishten dhe është profesionist në shkencat klasike islame, atëherë imamët shumë shpesh i sjellin nga vendet islame të lindjes së mesme dhe të Azisë Jugore. Imamët që vijnë nga vendet e Evropës (p.sh. nga Bosnjë e Hercegovina) shkollimin e tyre formal islam e kanë të kryer në ndonjë vendet islame të lindjes.

Organizatrat profesionale kulmore dhe asociacionet: Me qëllim të një prezantimi sa më të mirë dhe më efikas të interesave të gjëra të bashkësive muslimane brenda shoqërisë amerikane, muslimanët e Amerikës themeluan disa të ashtuquajtura organizata kulmore nacionale- rajonale dhe asociacione.

Asociacioni i studentëve myslimanë i SHBA-së dhe të Kanadasë (*The Muslim Student Association of U.S.A and Canada*) është themeluar në vitin 1963. Kjo organizatë u themelua nga një grup studentësh me qëllim të sigurimit të shoqatave islame, si dhe për t'iu përgjigjur nevojave të qindra mija studentëve të huaj myslimanë, të cilët janë të regjistruar nëpër universitete amerikane. MSA bën organizimin e xhumasë dhe të namazeve tjera në fakultet, hap biblioteka islame, dhe studentëve u ofron shërbime tjera të nevojshme. Organizata është e karakterit ndërkombëtar dhe përpiket për tejkalimin e dallimeve etnike, gjuhësore dhe racore. Deri në themelimin e ISNA-s, MSA ishte organizatë islame më e madhja dhe më aktivja në SHBA.

Këshilli i myslimanëve amerikanë (*American Muslim Council-AMC*) themelohet në vitin 1990 që sidoqoftë në mënyrë sa më efektive të rrisë anëtarësimin e myslimanëve amerikanë në politikën dhe skenën publike amerikane. Qëllimi i AMC është promovimi i vlerave etike, e cila përmirëson kualitetin e jetës të të gjithë amerikanëve si dhe myslimanëve të Amerikës t'u mundësojë pjesëmarrje më të madhe në jetën publike të shoqërisë amerikane.

Bashkësia islame e Amerikës Veriore (*The Islamic Society of North America-ISNA*), u themelua në vitin 1982, është organizatë kulmore me disa grupe profesionale islame të dalë nga asociacioni i studentëve myslimanë, duke i kyçur shkencëtarët myslimanë të shkencave shoqërore, asociacionin e shkencëtarëve dhe inxhinierëve myslimanë, asociacioni i mjekësisë islame, si dhe më tepër se 350 organizata lokale islame, xhamia dhe qendra të ndryshme. Në përpjekje për t'iu përgjigjur nevojave të popullatës myslimane, ISNA organizon konvencione vjetore, pastaj konferenca dhe seminare të specializuara, duke u fokusuar në aspekte të ndryshme të jetës myslimane në Amerikën Veriore. Në dialogët ndërfaqësorë është gjyqtar aktiv. ISNA boton revistën "The Islamic Horizons", e cila ka më tepër se 50.000 lexues.

Bashkësia Myslimane e Amerikës (*The Muslim American Society-MAS*) është një organizatë humanitare, fetare, sociale, kulturore, arsimore dhe jofitimprurëse, e cila u themelua në vitin 1992, qëllimi i së cilës është të vazhdojë punën e organizatave ekzistuese islame dhe të

trasonjë rrugën e veprimtarisë islame të nevojshme për t'iu përgjigjur provokimeve të shek. XXI. MAS-i përpiket për rimëkëmbjen, reformimin dhe ngritjen e individit, familjes dhe shoqërisë në baza të principeve dhe vlerave islame.

Rrethi Islam i Amerikës Veriore (*The Islamic Circle of North America-ICNA*) u themelua në vitin 1971, është organizatë jonacionale, josektare, e pavarur dhe e hapur për të gjitha organizatat lokale anembanë Amerikës Veriore. Qëllimi i ICNA-s është vendosja dhe promovimi i vlerave të sistemit dhe mënyrës së jetesës islame.

Asociacioni i Mjekësisë Islame (*The Islamic Medical Association-IMA*) u themelua në vitin 1967, qëllimi i tyre është që në bashkësitë e veta ta sigurojnë forumin e ekspertëve myslimanë në fushën e mjekësisë, që të takohen dhe ndërrojnë informata dhe shërbime me të tjerët që kishin me qenë në dobi të bashkësisë myslimane. IMA boton revistën dymujore "*The Journal of the Islamic Medical Association*" dhe mban konventa vjetore.

Aktiviteti i tyre përfshin edhe gjetjen e bursave, dhe ofrimin e shërbimeve për ata të cilët kanë pengesa.

Asociacioni i shkencëtarëve dhe inxhinierëve myslimanë (*The Association of Muslim Scientist and Engineers-AMSE*) u themelua në vitin 1969 me qëllim që të bëjë promovimin e hulumtimeve shkencore dhe përshtatjen e shkencës në themelet e principeve islame. AMSE boton buletin dhe një revistë shkencore, si dhe organizon konferenca vjetore. Asociacioni Shkencëtarëve Myslimanë i Shkencave shoqëror (*The Association of Muslim Social Scientists-AMSS*) themelohet në vitin 1972, si një trup profesional, akademik, arsimor dhe kulturor i vendosur për inicimin, revitalizimin dhe promovimin e mendimit islam. AMSS-ja bën organizimin e konferencave dhe brenda vitit mban seminare në disa disiplina. Në bashkëpunim me Institutin ndërkombëtar për mendimin islam boton "*American Journal of Islamic Social Sciences dhe Newsletter*".

Instituti Ndërkombëtar për Mendimin Islam (*The International Institute of Islamic Thought-IIIT*) u themelua në vitin 1981 në Herndon, Virginia. IIIT-ja është donatore kryesore në punët hulumtuese, në

sigurimin e bursave, për organizimin e seminareve dhe të konferencave, si dhe në botimin e veprave klasike dhe bashkëkohore duke përfshirë edhe *American Journal of Islamic Social Sciences*.

Përkatësitë e shkollave juridike fetare Shumica dërrmuese e myslimanëve suni në Amerikë, qofshin ata emigrantë apo autoktonë u takojnë shkollave të ndryshme juridike fetare. Mozaikun shumë të pasur të myslimanëve amerikanë e plotësojnë edhe disa grupe të ndryshme shiite. Rol të rëndësishëm në jetën fetare të myslimanëve të Amerikës e kanë edhe sufijt.

Arsimi Fetar

Jo më tepër se tre për qind të fëmijëve myslimanë në Amerikë arsimin formal fetar e arrijnë jashtë shtëpive, që në krahasim, p.sh., me fëmijët e hebrenjve të Amerikës, të cilët përafërsisht në 80% të rasteve i vijnë shkollat fetare javore, apo në forma tjera të programeve arsimuese hebraike, kjo përqindje e fëmijëve myslimanë është e vogël.

Shkollat islame

Sipas informatave të vitit 2001, në Amerikë ekzistojnë rreth 200 shkolla fillore, të mesme dhe të kombinuara islame, dhe gjashtë shkolla për arritjen e shkallës më të lartë në arsimin islam. Përafërsisht 21% e organizatave lokale islame drejtojnë shkollat e rregullta islame. *Populli islam* ende, gjatë kohës së Elija Muhamedit, për myslimanët autoktonë në Amerikë kishte vënë një sistem të rëndësishëm të arsimit i njohur me emrin Universiteti Islam (*University of Islam*). Pas reformave të zbatuara në *popullin islam* nga W.D.Muhammadi kjo hallkë e shkollave mbijetoi por me emër të ri *Clara Muhammad Schools*. Vlerësohet se pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë për qind të shkollave të tilla të pranuar anëmbanë Amerikës, veprojnë të pavarur nga çfarëdo qendre administrative, dhe bëjnë sigurimin e arsimit fillor dhe të mesëm sipas plan-programeve dhe mësimëve islame.

Shkolla të vikendit

Shtatëdhjetë e një për qind të xhamive, në kuadër të aktiviteteve të veta, organizojnë shkolla të ashtuquajtura fundjavore apo vikend-shkolla, të cilat rregullisht mbahen gjatë ditëve të vikendit. Përafërsisht 49% të këtyre shkollave organizohen vetëm për fëmijë, rreth 5% vetëm për të rritur, kurse 46% organizohen edhe për të vegjlit edhe për të rriturit. Numri mesatar i vijuesve në shkollat e vikendit është: një shkollë me 35 të rritur, dhe me 93 që janë të moshave të ndryshme. Kjo tregon se 29.500 të rritur dhe 79.600 fëmijë të të gjitha moshave i vijnë mësimet në vikend-shkolla islame.

PERSONALITETE TË SHQUARA

Muhamed Aleksandër Rasel Webb, i lindur më 9 nëntor 1846 në Hudson, Nju-Jork në një familje presbiteriane. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Glendaleu, Masaçusets, ndërsa të lartën në kolegjin Claverak, afër Hudsonit. Pas kryerjes së shkollimit, dhe si duket nën ndikimin e babait, i cili ishte njëri ndër gazetarët më të njohur të asaj kohe, Webi e bleu për javoren në Junionvil, Misuri, dhe u bë botues i saj. Më vonë Misuri bëhet botues edhe në disa gazeta tjera ditore.

Në vitin 1887, në Filipine emërohet konsull amerikan me seli në Manile. Së paku pesëmbëdhjetë vjet para përfundimit të islamit ai nuk e praktikonte asnjë religjion. Duke lexuar literaturë ai, në vitin 1881 fillon të gjurmtojë besimin e vetë personal. E hulumtonte budizmin e më pas edhe islamin. Në vitin 1888, edhe formalisht bëhet mysliman. Në vitin 1892, ai e lëshon pozitën e konsullit dhe e fillon një turne nëpër Indi. Pas kthimit nga India e themeloi shtëpinë botuese *Oriental Publishing Company*, në të cilën publikonte punimet e veta, ndër të cilat edhe vepra e tij më e rëndësishme: "Islami në Amerikë". Krahas kësaj ndërmarrjeje ai në vitin 1893, e nxjerr edhe të përkohshmen "Lëvizja myslimane amerikane për propagandë" (*American Muslim Propagation Movement*) nën emrin *Moslem World*, e cila doli shtatë muaj.

Webbi ishte përfaqësues kryesor për islam në Parlamentin botëror të Religjioneve të mbajtur në Çikago në vitin 1893. Deri në fund të jetës ishte zëdhënës i islamit në Amerikë. Ai kishte themeluar dhe një mesxhit në Manhatan, por për shkaqe të mungesës së mjeteve ajo shpejt u shua. Webbi është i njohur edhe për librin që bën fjalë për luftërat jermenoturke nga perspektiva myslimane (*The Armenian Troubles and Where the Responsibility Lies*), si dhe për atë, që Sulltan Abdyl Hamidi dytë e emëroi konsull nderi të Turqisë në Nju-Jork.

Muhamed Aleksandër Rasel Webb vdiq më 1916 në Rutherford, Nju Xhersei ku edhe sot i gjendet varri.

Malkolm X, i lindur në vitin 1925, në Omahi, Nebraskë, në një familje të varfër zezake të krishterë si Malkolm Little. Ishte i njohur edhe si El-Hajj Malik el-Shabaz. Malkolm X ishte lider i myslimanëve afrikano-amerikanë, luftëtar për të drejtat qytetare dhe njerëzore, pan-afrikan dhe pan-islamist. Jeta e myslimanit amerikan të viteve të gjashtëdhjeta, ishte shënuar me zemërimin e tij ndaj racizmit të të bardhëve (amerikanët evropianë), dhe vendos për përparimin e kushteve në jetën e afrikano-amerikane. Babanë ia vrasin, kurse nënën padrejtësisht e dërgojnë në çmenduri. Rritet në jetimore. Në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare ai e kishte kryer shkollën fillore, por Malkolmi kuptoi se nuk kishte prirje për shkollë dhe organizime fetare. Ai jetën e zgjodhi në mëkate dhe kriminalitete, çka në fund e solli edhe në burg. Qëndrimi në burg (1946-1952) shënon fillimin e transformimit të tij intelektual dhe shoqëror. Burgu për të ishte një “akademi”, aty Malkolmi lexoi filozofinë dhe letërsinë e Lindjes dhe të Perëndimit, shkrime për krishterimin, gjenetikë dhe për robërinë amerikane, dhe aty ai përsosi aftësi oratorike. Me studime joformale ra në kontakt me islamit dhe me historinë e heroizmit mysliman. Islamit apo saktësisht të thuhet mësimet e Elijah Muhamedit liderit të atëhershëm të *popullit islam* e pranoi në vitin 1948. Përvoja shoqërore, zhvillimi intelektual dhe besnikëria e tij ndaj liderit të vet ia mundësuan që të ketë pozitë mjaft me ndikim të *popullit islam*.

Prej vitit 1959 e këndej Malkolmi i lejoi vetes që të bëjë modifikimin e disa qëndrimeve në mësimet e Elijah Muhamedit, me ç’rast

erdhi në shprehje lojaliteti i tij. Vizitat e shkurtra të tij në Arabinë Saudite dhe në vendet afrikane i hapën paksa dyert e islamit suni, dhe trimëroi miratimin e ndërrimeve të cilat bënë jehonë në Xhaminë numër shtatë të Eljadit. Pas dhënies së disa komentimeve, me rastin e vrasjes së Gjon F. Kenedit, në vitin 1963, Malkolmi u suspendua nga pozita e liderit të *popullit islam*, ndërsa në vitin tjetër ai tërësisht u largua nga *populli islam*, dhe vazhdoi veprimtarinë e tij si i pavarur. Ai e pranoi islamit suni normative dhe shkoi në Meke për të kryer obligimin e haxhillëkut. Nga atje ai kthehet me ide të reja, por edhe me emër të ri: El-Hajj Malik el-Shabazz. Me rastin e një fjalimi të mbajtur në një tubim fetar në ditën e lindjes së tij më 21 shkurt 1965, atë e vrasin pjesëtarët e *Popullit islam*, sipas pohimeve të disa historikanëve “haptazi në bashkëpunim me Qeverinë amerikane”.

Jeta e Malkolm X me vetë biografinë e tij u bë e pavdekshme, e cila më vonë edhe është ekranizuar. Sot disa rrugë dhe shkolla, por, edhe një xhami me numër shtatë e mbajnë emrin e tij.

Muhamed Ali, kampion i trefishtë botëror dhe boksier më i çuditshëm i të gjitha kohërave, Muhamed Ali (më herët i njohur si Cassius Marcellus Clay) i lindur më 12 janar 1942 në Lousivile, Kentaki. Kur i kishte 22 vjet e përqafoi islamit kur ishte në majë të popullaritetit në boks. Si dymbëdhjetëvjeçar filloi të merret me boks, kurse në Olimpiadën e vitit 1960 të mbajtur në Romë fitoi medaljen e artë olimpikë kur i kishte tetëmbëdhjetë vjet. Tri herë ishte kampion botëror në kategorinë e rëndë. Në vitin 1967, refuzon të shkojë në luftën e Vietnamit, ku për këtë shkak dënohet me pesë vjet burgim, i anulohet leja e boksit dhe pa kontestim i merret titulli i kampionit botëror. Në vitin 1971, ankesën e Muhamed Aliut në gjykatë pozitivisht e zgjedh Gjykata Supreme e SHBA-së. Për shkaqe shëndetësore në vitin 1981 ndërpret aktivitetin në boks. Sot, Muhamed Aliu është një njeri shumë religjioz, dhe kudo që paraqitet është i mirëpritur dhe i dashur. Pas braktisjes së boksit u sëmurë nga sëmundja e Parkinsonit, por kjo nuk e ndali që në vitin 1996 ta ndezë flakën e olimpiadës. Në vitin 1990 hyri në Aulën e boksierëve të famshëm (*Boxing Hall of Fame*). Kontributi i Aliut në histori është i madh. Përmes boksit kontribuoi në

atletikë, me përfaqimin e islamit i dha kontribut religjionit dhe të drejtave të njeriut. Duke refuzuar të luftojë në Vietnam ai i dha kontribut paqes. Me ngritjen e vetëdijes për sëmundjen e Parkinsonit dhe sjelljen e mjeteve për zbulimin e ilaçit për të, ai kontribuoi në luftë kundër kësaj sëmundje çoroditëse.

Muhamed Ali me familjen e vet sot jeton në Berin Springs, Miçigan. Është martuar katër herë dhe është baba i nëntë fëmijëve.

Sejjid Husein Nasi, filozof iranian, filozof i diturisë, teolog dhe tradicionalist, Nasi është njëri ndër dijetarët më të rëndësishëm dhe më produktiv të islamit tradicional, si dhe të studimeve krahasuese islame. U lind, më 7 prill 1933, në Teheran të Iranit. Të atin e kishte mjek dhe edukator. Pas kryerjes së arsimit të mesëm në Iran, studimet i vazhdoi në SHBA. Në vitin 1954, diplomoi në Institutin e teknologjisë në Masaçuest (*Massachusetts Institute of Technology*), kurse në vitin 1958 në Harvard doktoroi në fushën e filozofisë dhe diturisë historike. Arsimimi klasik i Nasit përfshin historinë e Lindjes dhe të Perëndimit, filozofinë dhe shkencat shoqërore, lëndën bashkëkohore teologjike të historisë myslimane dhe krishterë, si dhe zhvillimin mistik, shpirtëror, artistik dhe kulturor të islamit.

Pasi doktoroi, Nasi kthehet në Iran për të ligjruar në Universitetin e Teheranit, por edhe për të vazhduar në përfitimin e diturisë personale te autoritetet më të mëdha fetar të Iranit. Revolucioni i vitit 1979 në Iran, Nasin e gjeti në vendin e drejtorit të Akademisë Mbretërore të Filozofisë Iraniane (*Imperial Iranian Academy of Philosophy*). Pas rënies së Shahut, ai vazhdon të përfaqësojë islamit safevide, duke prezantuar thelbin e vërtetë të mendimit islam, posaçërisht të asaj Shiite. Si profesor universiteti, ai prej vitit 1979 deri në vitin 1984, në *Temple university* të Filadelfies ligjëroi Studimet islame, dhe prej vitit 1984 e deri më sot ligjëron në Universitetin "*Gorge Uashington*" në Uashington, D. C. I interesuar për integrimin e shkencës, filozofisë dhe të artit, Nasi përkushtohet për shpjegimin e thelbit të njësisë së të gjitha çështjeve si refleksion i njësisë së zotit. Sekularizimin e shkencave natyrore dhe prishjen e baraspeshës në tokë, e cila sot shihet

nga krizat ekologjike, i sheh si ilustrim i çrregullimeve të brendshëm në relacionin ndërmjet njerëzores dhe hyjnore.

Nasi mundohet të tregojë se disa myslimanë rrejshëm prezantohen si tradicionalistë, duke sugjeruar se ata në të vërtetë, vetëm i përsërisin disa gabime të Perëndimit modern, në vend se të mësojnë nga ata. Individualitetin e Perëndimit Nasi e sheh si diçka të kundërt me lirinë e vërtetë, të cilën e definojnë filozofia islame dhe sofizmi, lirinë e cila nuk përbëhet nga aksioni, por nga kuptimi i lidhjes së brendshme të njeriut ndaj Zotit. Nasi i kundërshton ideologjitë bashkëkohore sikurse që janë modernizmi, racionalizmi, sekularizimi dhe materializmi, dhe në vend tyre, ai rekomandon në principet e pandryshueshme, të cilat më së miri janë të ilustruara në islamit tradicional. Veprat dhe punimet e tija qartë na tregojnë në dy qëllime të tij të lidhura mes vete, e para; që njeriut skeptik të Perëndimit t'i shpjegohet civilizimi islam, dhe e dyta; të sulmohen forcat e sekularizimit të cilat perëndimorët i kanë larguar nga fetë e tyre, dhe kërcënohen që edhe myslimanëve t'i ndodhë e njëjta gjë. Profesor Nasi me më tepër se pesëdhjetë libra dhe pesëqind punime e artikuj që janë të përkthyer në disa gjuhë më të njohur në botën myslimane, evropiane, dhe aziatike është një personalitet dhe intelektual shumë i njohur si në Perëndim ashtu edhe në botën islame.

Qamil Avdiq, shkencëtar, vizionar dhe udhëheqës, u lind më 10 korrik 1914, në Pllana të Bilegia (Bosnjë e Hercegovinë). Në Sarajevë kreu medresenë e Gazi Hursev-begut dhe diplomoi në Az-har të Egjiptit. Në vitin 1954, shkoi në Amerikë për të kryer detyrën e imamit në një bashkësi të vogël boshnjake të Çikagos. Para magistraturës në informimin bibliotekar ai ishte punësuar te *John Crearer Library* në Çikago. Avdiçi në Tolledo punoi si imam, përkthyes dhe mësues.

Ishte anëtar i këtyre asociacioneve akademike: Asociacionit Amerikan të profesorëve universitarë; Asociacionit të studimeve për lindjen e afërm; Qendrës kulturore amerikano-boshnjake; Këshillit të Imamëve dhe të Shoqërisë orientale amerikane. Në mesin e shumë librave të botuar ishte libri shkollor në gjuhën angleze "Bazat e Islamit" dedikuar fëmijëve myslimanë të Amerikës, si dhe versioni i veprës

së njëjtë por i rishikuar, plotësuar dhe i zgjeruar, me titull, “ Pasqyrimi i Doktrinave Islame”. Themeloi dhe redaktoi Buletinin e Qendrës Kulturore Islame, gjithashtu Avdiçi ishte themelues, redaktor dhe botues i "*Rrugës së drejtë*" që ishte organ zyrtar i Këshillit të imamëve të Amerikës Veriore. Ka qenë kryetar i parë i Asociacionit kulturor boshnjako-amerikane në Ilionisë, nga e cila më vonë doli Qendra kulturore islame *Northbrook*, e cila ishte një organizatë multinacionale dhe multikulturore myslimane. Avdiçi ëndërronte për një bashkësi në të cilën myslimanët amerikanë, turqit, boshnjakët, arabët, indo-pakistanezët dhe të tjerët së bashku do të punonin, do të falen dhe kështu do t'ia kthejnë borxhin Allahut dhe bashkësisë myslimane si një tërësi. Deri në momentet e fundit punoi për realizimin e ëndrrës së vet, për vendosjen e dialogut shumëtnik mysliman dhe të dialogut me religjione tjera. Vdiq në Çikago, më 2 dhjetor 1979.

RETHANAT SHOQËRORE-POLITIKE

Bashkësitë islame në Amerikë e pranojnë dhe e çmojnë lart mesazhin se Amerika është një shtet sekular dhe pluralist, i cili toleron të gjitha religjionet dhe ideologjitë, por njëkohësisht edhe frikësohet nga paragjykimet amerikane për fetë e tyre që çdoherë e më shumë rriten dhe zgjerohen. Brengosen për deklarata dhe shkrime të pandjeshme dhe raciste të kumtuara në televizion, radio dhe gazeta. Përcjellja e luftës në medime të popujve të ndryshëm myslimanë për të drejtat dhe liritë e veta, të cilët më së shpeshti i karakterizojnë si “fundamentalizëm të myslimanëve fanatikë”, si dhe raportimet për aktet terroriste, të cilat i kryejnë pjesëtarët e fesë myslimane, i shohin si jo të balancuara dhe të ngarkuara me paragjykime, e që kjo i shtyn amerikanët tjerë që islamit ta identifikojnë me terrorizëm. Dukshëm rritet paragjykimi ndaj islamit, myslimanëve dhe arabëve, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë shtohet rrezikimi i të drejtave lirive, jetës dhe pronës së myslimanëve në kohën e konflikteve në botën myslimane, në të cilat është e ndërlydhur Amerika direkt apo indirekt. Të tilla ishin lufta e gjirit, lufta në Afganistan, dhe përsëri lufta në Irak. Sulmet terroriste të vitit 2001, në Nju-Jork dhe Uashington, pozitën e myslimanëve

edhe më tepër e vështirësuan në Amerikë. Me përjashtim të përkrahjes lokale, e cila bashkësisë myslimane u ofrohet nga disa qytetarë, myslimanët nuk shohin përkrahje të niveleve tjera, të cilat do të ballafaqoheshin me këtë problem. Nuk është formuar ndonjë komision, i cili haptazi amerikanëve u kishte demonstruar për padrejtësitë diskriminuese që u bëhen bashkëqytetarëve të tyre myslimanë në baza të religjionit, dhe as që është ekzekutuar apo shqyrtuar ndonjë hetim parlamentar lidhur me këtë temë. Përkundrazi, zyrtarët qeveritarë vazhdojnë të flasin për Amerikën si “komb hebre-krishterë” ashtu duke përjashtuar myslimanët dhe grupet tjera fetare nga loja e shoqërisë, e cila kishte me qenë sekulare dhe pluraliste. Myslimanët dëshirojnë që të jenë të pranuar si anëtarë të plotë të shoqërisë amerikane, qofshin ata si përfaqësues të grupeve të tyre nacionale, apo si ithtarë të islamit, apo thjesht, si qytetarë të Amerikës. Edhe pse myslimanët në përgjithësi, ende e gëzojnë të drejtën për integrim dhe lirinë e të folurit, ata akoma brengosen për diskriminimin i cili, megjithatë, ekziston, gjë që tregon fakti se ata shumë shpesh kanë probleme për punësim, dhe në disa aspekte të politikës së jashtme amerikane në Lindjen e Afërm.

Rreth 90% të liderëve të organizatave myslimane në Amerikë janë të mendimit se myslimanët duhet të jenë më aktivë me pjesëmarrjen e tyre në proceset politike të shoqërisë amerikane.

Marrë nga “Atlas Islamskog Svijeta” - Sarajevë 2004
Përgatiti: Shevki Sh. Voca

ISLAM IN THE USA
Moslems in the Usa – demographic map
(Summary)

It is impossible to verify the size of different religious groups in the USA (including the size of the Moslem population). Most of the sources of information (of such a nature) derive from research activities conducted by individuals, individuals belonging to different religious groups or relevant scientific institutions.

الاسلام في الولايات المتحدة الامريكية
المسلمون-الخريطة الديموغرافية
(خلاصة البحث)

بما أن الدستور الامريكي لا يسمح بادراج اسم الدين في أى قائمة خاصة بالمواطنين الامريكان، بناء عليه ليس من السهل معرفة العدد الكامل للامريكان الذين ينتمون إلى ديانات مختلفة بما في ذلك المسلمون الذين يعيشون بالولايات المتحدة الامريكية عليه فان جميع الاحصائيات من هذا النوع هي تعتبر احصائيات خاصة للافراد أو للجماعات الدينية و ليست لها صفة رسمية أو علمية.

(Ekstrakt nga Propozimi Preliminar për Konservimin dhe Restaurimin e Sipërfaqeve të Pikturuara nga Tody Cezar dhe Xhavit Lokaj, 2001 dhe nga Hulumtimi i Trashëgimisë Kulturore <http://users.tyenet.com/koslich>)

TRASHËGIMI

RESTAURIMI I XHAMISË SË HADUMIT NË GJAKOVË

Historiku

E ndërtuar në vitin 1595, Xhamia e Hadumit është xhamia më e vjetër në Gjakovë dhe e vetmja e cila nuk ka pësuar asnjë rikonstruim ireversibil apo ndonjë intervenim të madh, dhe si e tillë është njëri ndër shembujt më unik dhe më të rëndësishëm të mjeshtrit ballkanas.

Objekti, dikur pjesë e një kompleksi më të madh, është strukturë e thjeshtë katrore me kupolë qendrore dhe portik hyrës të mbuluar me disa kupola më të vogla. Një restaurim i përmasave më të mëdha u ndërmor në vitin 1841. Sipër derës kryesore, në arabishte është e shkruar se ngjyrosja dhe pikturat janë kryer nga shurdhmemeci Sylejman në vitin 1260 (kalendari islamik).

Hajati i drurit që rrethon portikun me siguri është shtuar në kohën e restaurimit të vitin 1842, kurse sipërfaqet që më parë ishin në eksterier ishin rivendosur dhe ngjyrosur.

Në pranverë të vitit 1999, xhamisë iu vu zjarri nga forcat serbe, me ç'rast u humb Hajati, ndërsa maja e minares ishte goditur me pre-dha dhe si pasojë, pjesa e sipërme kishte rënë mbi bibliotekën, e cila gjendej afër xhamisë, duke shkaktuar dëme të mëdha në së paku gjysmën e ndërtesës.

Prapavija e projektit

Ky projekt filloi në vitin 2001 kur Andras Riedlmayer dhe Andrew Herscher nga Projekti i Trashëgimisë Kulturore për Kosovën (Kosovo Cultural Heritage Project - KCHP) nga Shtetet e Bashkuara u interesuan për restaurimin e Xhamisë së Hadumit dhe ia dolën të marrin donacione nga Fondacioni Packard.

Në bashkëpunim me Bashkësinë Islame, Ministrinë e Kulturës dhe IMM-në në Gjakovë, ata u pajtuan rreth projektit dhe porositen matjet dhe planet nga ekspertët turq.

Vështirësitë në gjetjen e mjeshtërive me përvojë dhe materialit të mirë gjatë viteve të pasluftës e stopuan restaurimin në vitin 2002, mu në kohën kur portiku ishte mbuluar me plumb të ri dhe kupola ishte riparuar me urgjencë për ta mbrojtur objektin nga shiu.

Në vitin 2003, KCHP kishte kërkuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) që të marrë përsipër menaxhimin e projektit. Ne e pranuan këtë përgjegjësi dhe restaurimi rifilloi, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga Turqia, profesor Zeynep Ahunbay, Stamboll, përgjegjëse për dizajnin e përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e Trashëgimisë, dhe Mustafa Pehlivanoglu, arkitekt, përgjegjës për vizatimet e planeve.

Qëllimet e restaurimit

Ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë, autoritetet për trashëgimi dhe CHwB-ja janë pajtuar që:

- të rikonstruohet minarja;
- të sigurohet objekti për pesëdhjetë vjetët e ardhshme me ndërrimin e mbulesës së plumbit të kupolës dhe me forcimin e shtyllave të portikut;

- të zvogëlohet lagështia në muret e sallës së Lutjeve, duke e ulur nivelin e tokës në nivelin origjinal dhe me kryerjen e izolimit të themeleve nga ujërat nëntokësore;
- të restaurojë hyrjen në xhami, duke përfshirë edhe rikonstruimin e dyshemesë së portikut dhe restaurimin e kujdesshëm të derës hyrëse dhe të shtojë një perde të hyrjes(?);
- të ruajë fasadën dhe gurët e minares me mënjanimin e tërë cementit që ka eroduar mjaft shumë gurin origjinal gjatë tridhjetë vjetëve të kaluara;
- të konsolidojë gurët e dritareve dhe dyerve të cilat ishin eroduar shumë;
- të pastrojë oborrin.

Pasi që ekspertët dhe mjeshtrit kosovarë i kanë kryer punët në terren, kjo ka rezultuar me profesionistë vendorë të cilët janë të aftë në kryerjen e punëve konservuese dhe restauruese në nivel të mirë ndërkombëtar për punët e gurit dhe plumbit, dhe po ashtu me rritjen e dijës sonë se ku mund të gjendet materiali i duhur.

Xhamia e restauruar

Kjo pjesë e restaurimit ka përfunduar. Pasi që xhamia është një “monument i gjallë”, Bashkësia Islame mban përgjegjësinë e rëndësishme që të përkujdeset për këtë objekt jashtëzakonisht të vlefshëm për gjeneratat e ardhshme të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Evropës.

Hapi i ardhshëm do të jetë konservimi i pikturave, njëkohësisht jemi mirënjohës për premtimin nga Turqia për financimin e këtyre punëve. Qëllimi ynë është që të vazhdojmë me rritjen e aftësive në fushën e konservimit të pikturave, duke përfshirë konservues vendorë, që do të udhëhiqen nga ekspertë ndërkombëtarë e vendorë.

Dick Sandberg, koordinatori ndërkombëtar i projekteve të CHwB-së në Kosovë.

Konservuesit, mjeshtrit dhe menaxhimi i projektit:

Eksperti i konservimit Tody Cezar nga SHBA-të restauroi derën hyrëse.

Konservimi i gurit në terren është kryer nga konservues vendorë, të udhëhequr nga arkitektja kosovare, Lindita Cervadiku, nën mbikëqyrjen e ekspertit në konservimin e gurit, Simon Warrack nga Italia.

Ajaz Mujovi, mjeshtrë nga Prizreni, ka kryer punët e gurit, drurit dhe plumbit. Për punët e plumbit në kupolë ai është trajnuar nga kryemjeshtri Ahmet Semih Ucar nga Turqia.

Kryemjeshtri i gurit, Shaban Zeneli nga Peja, ka bërë dekorimin e gurit në parmakun balustradin) e minares.

Përgjegjësia e përgjithshme për implementimin e projektit ishte mbi krahët e ndërtimitarit Sezair Gafurri, menaxher i projektit në CHwB në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Kreun e Divizionit për Trashëgimi në Ministrinë e Kulturës, Gjejlane Hoxha, dhe drejtorin e IMM-së së Gjakovës, Osman Gojani.

Donatorët

Fondacioni Packard, SHBA, ka kontribuar me 200.000 dollarë amerikanë përmes KCHP-së, për shumicën e punëve restauruese të kryera.

Qeveria suedeze përmes Sida-s, ka kontribuar me rreth 60.000 euro për rritjen e aftësive në konservimin e gurit, për kursin e programit të mirëmbajtjes, për programin e mirëmbajtjes për xhaminë dhe për një pjesë të menaxhimit të projektit dhe shpenzimet administrative.

Punëtorja e titulluar “Konservimi i integruar” është mbajtur në Prishtinë dhe në Prizren, prej 20 shtatorit deri më 30 nëntor 2002, duke përfshirë një javë të punës në terren, të zhvilluar në Prizren. Qëllimi kryesor ishte ndërtimi i kapaciteteve institucionale në përputhshmëri me politikën e konservimit të trashëgimisë kombëtare të aprovuar nga Drejtorati i Kulturës, në korrik 2002. Punëtorja u zhvillua nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezi-

dente (MKRSIJ), përkatësisht Drejtoratit të Kulturës (DiK), ishte e përkrahur nga Ministria për Mbrojtjen e Ambientit dhe Planifikim Hapësinor dhe UN HABITAT-i, ndërsa partner implementues ishte OJQ Cultural Heritage without Borders (CHwB) – Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Grupi udhëheqës përbëhej nga znj. Gjejlane Hoxha dhe z. Gerard Links (DiK), kurse z-sha Vjollca Aliu kishte rolin e koordinatores gjatë tërë kohës së zhvillimit të projektit. Mjetet financiare ishin të siguruara nga Drejtorati i Kulturës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

Pjesëmarrës ishin stafet nga Institutet për Mbrojtjen e Monumenteve të nivelit kombëtar dhe rajonal, disa urbaniste individuale dhe studente të arkitekturës.

Qyteti i vjetër i Prizrenit është zgjedhur si cak për zhvillimin e punës në terren, duke u bazuar në faktin se është qyteti me strukturën më të mirë urbane para-industriale në Kosovë, ende koherente. Kjo trashëgimi unike dhe delikate është e kërcënuar nga neglizhenca dhe mungesa e përkrahjes administrative dhe financiare. Z. Shend Kabashi, urbanist nga Universiteti Teknik i Stambollit ishte përgjegjës për planifikimin dhe udhëheqjen e punëve në terren.

Detyra e përpilimit të raportit për rezultatet e punës i është besuar z. Enes Toska, student në Fakultetin e Arkitekturës dhe njëkohësisht pjesëmarrës në punëtori.

Kersti Berggren & Maria Hakanson (studente praktikante nga Suedia).

Studentët pjesëmarrës nga Fakulteti i Arkitekturës ishin: Agon Basha, Arion Xhemaj, Arta Basha, Enes Toska, Kreshnik Ferizi, Labint Boçolli, Lindita Hasani, Muhamet Uka, Valdet Gashi dhe Valdete Paçolli.

Shpresoj se raporti “Konservimi i Integruar” do të japë një pasqyrë të qartë me një interes të madh rreth temave dhe vendeve të shtjelluara gjatë kësaj kohe. Në arritjen e rezultatit përfundimtar të kësaj punëtorie kanë kontribuar shumë njerëz. Dëshiroj ta shpreh respektin dhe mirënjohjen për të gjithë ligjëruesit, organizatorët dhe pjesëmarrësit, të cilët së bashku bënë të mundur realizimin e këtij projekti.

Kushtet e vështira fizike të cilat mbretërojnë në Kosovë kërkojnë një angazhim të posaçëm, në mënyrë që të arrihet një funksionim sa më efektiv në këto rrethana. Një falënderim të veçantë për z. Abib Ademi dhe stafin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren për përkrahjen e tyre të sinqertë dhe shfrytëzimin e ndërtesës së tyre gjatë punës praktike në terren.

Stokholm – Prishtinë, korrik 2004.

Znj. Kersti Berggren, arkitekte dhe udhëheqëse e projektit CHwB (Trashëgimia Kulturore pa Kufij)

Aktivitetet e OJQ “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” CHwB viteve të fundit janë rritur në mënyrë rapide. Duke iu falënderuar mbështetjes nga SIDA (Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim), u bë e mundur të vazhdojmë dhe t’i rrisim përpjekjet tona në Kosovë.

Gjatë vitit 2003 kemi parë se për arritjet nga restaurimi i 5 kullave, (mbështetur nga AER dhe Sida) është përkujdesur në disa mënyra. Kështu seminare dhe fushatat informative janë realizuar për ta paraqitur restaurimin në një perspektivë më të gjerë.

Asnjëherë nuk mjafton vetëm restaurimi i monumentit.

Por, duhet të bëhet edhe përkujdesja e tij nga një organ vendor apo kombëtar, ndërsa njëkohësisht restaurimi duhet përdorur për arritjen edhe të qëllimeve tjera.

Pyetjet me esenciale për aktivitetet tona janë: Çka jemi duke restauruar dhe pse? Kush do të përfitojë nga kjo? Dhe në çfarë mënyre? Cila është lidhja mes restaurimit dhe zhvillimit të një fshati, qyteti a vendi?

Restaurimi mund të jetë edhe një përparësi tjetër për mbrojtje më të mirë të mjedisit. Mund të shfrytëzohet edhe për zhvillimin ekonomik, nëse në këtë mënyrë do të tërhiqte turistë apo ofronte hapësirë për ndërmarrësit vendorë. Mund të zhvillojë demokracinë dhe duhet të pasqyrojë pjesët e ndryshme të shoqërisë. Dhe po ashtu duhet të jetë e dobishme për klimën kulturore, sepse ashtu jep pasqyrën historike.

Se çfarë mund të arrihet nga restaurimi varet vetëm nga kujdes-tarët, të cilët janë drejtpërdrejtë të kyçur. Këtë e shohim në Isniq dhe

në Deçan. Një nga përshtypjet e mia personale gjatë këtij viti ishte kur pashë popullin e Isniqit duke vendosur me krenari shenjat rrugore që tregonin se si mund të arrihej te fshati i tyre i bukur dhe të shihet se çka ata do të mund të ofronin gjatë Ditëve të Trashëgimisë (në tetor 2003). Kjo tregon perspektivë të ndritur për punën tonë në të ardhmen.

Nëse nuk do të kemi partnerë të përkushtuar që do të kujdeseshin për shfrytëzimin efikas dhe mbrojtjen afatgjatë të ndihmës sonë atëherë ne nuk do të mund të punonim. Prandaj, Vitin e Ri e mirëpresim me një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe më të ngushtë me partnerët tanë në Kosovë - për të mirën e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të rajonit.

THE RESTORATION OF THE HADUMI MOSQUE IN GJAKOVA

(Summary)

Its history

The Hadumi Mosque was built in 1595. It is the oldest mosque in Gjakova. It is the only mosque which has not been subjected to large scale interventions (and has not suffered irreversible change), and as such it is one of the most important examples of craftsmanship in the Balkans.

The mosque, which once was part of a larger complex, has a square structure, with a central dome and a portico with smaller domes over it.

The mosque was restored to a considerable extent in 1841. Over the main entrance, there is an inscription in Arabic, which reads that the interior of the mosque was painted by a person who was deaf and dumb and whose name was Sulejman. The latter took place in 1260 according to the Islamic calendar.

اعادة تعمير جامع خادم آغا في جاكوفا

(خلاصة البحث)

التاريخ:

لقد تم بناء جامع خادم آغا سنة ١٥٩٥ و يعتبر اقدم جامع بمدينة جاكوفا و الذي لم يتم اعادة تعميره و يعتبر من المباني النارة في شبه جزيرة البلقان. و كان الجامع في السابق جزءا من عمارة متكاملة الجوانب تتكون من قبة كبيرة و عدد من قبب صغيرة بالمدخل. و قد تم اعادة تعميره لأول مرة سنة ١٨٤١. و توجد على الباب المدخل الرئيسي باللغة العربية تاريخ بناء المسجد و كذلك تاريخ الرسوم التي تم رسمها سنة ١٢٦٠ هـ (١٨٨٢) من قبل الرسام المعروف باسم سليمان.

Avni Aliu

MËSOHU TË JETOSH ME BESIM NË ALLAHUN (*Letër Mikut*)

“Unë besoj, por s’jam i lumtur - ku është faji”? Kështu më tha miku im një ditë, derisa po udhëtonim me makinë për në P., dhe vazhdoi: -“ ju hoxhollarët, kur flisni, gjithmonë e keni në gojë besimin, nevojën e besimit, besimi...besimi...!” “Se besimi ju sjell lumturinë, ju bën të lumtur, jua mbush zemrat e zbrazura” etj. “Por ja, që unë besoj, të paktën, ti e di, e megjithatë, i zbrazët në zemër dhe i palumtur në jetë...!” -“Ku është faji”? Dhe kështu vazhdoi të fliste miku im një kohë, duke më treguar pakënaqësinë e tij me jetën, siç e quante ai jetë boshe, ndërsa unë e dëgjoja me vëmendje, pa i ndërhyrë në fjalë. Thënë të drejtën, një grimë më gëzoi pyetja e tij kur tha: “Ku qëndron faji?”, por e mbulovala disi, pa më hetuar. Dhe nëse më pyetni se pse u gëzova, ju them sinqerisht: jo për hallet e tij, jo se ai vuante, sepse vuajtja e tij njëherësh ishte edhe vuajtja ime, po se më hapi rrugën për të dhënë opinionin tim lidhur me pyetjen e tij, për aq sa e lejon ajo dija ime e vogël dhe e pakët në trurin tim, me lutje drejtuar Zotit e me shpresë mbase do t’i hynte në punë. Mirëpo, megjithatë, përkundër qëllimit tim të mirë, atë ditë, pra ditën kur udhëtuam së bashku, unë nuk munda të kënaq mikun tim me fjalët e mia, se edhe koha që e

shkurtër, por edhe miku im ama, pas çdo fjale që unë e thosha, gjuante gurin tjetër. Dhe kur pashë se, më në fund, nuk isha i përgatitur t’ia dal me të, e përfundova duke e përdorur atë thënien e urtë që populli ynë shpesh e thotë: “faji është jetim”, me mendimin se një ditë do t’i shkruaj radhazi një nga një për pyetjet që m’i bëri. Prandaj, kjo është arsyeja që më shtyri të shkruaj.

Besoj, s’jam i lumtur-ku është faji?

Për mendimin tim kjo pyetje sa është serioze aq është e rëndësishme: “Besoj, s’jam i lumtur-ku është faji?”. Është një pyetje e qartë si drita e diellit, apo jo? Por edhe e rëndësishme për përgjigje dhe sqarim. Prandaj, shkrimin tim lidhur me këtë pyetje e titullova “Mësohu të jetosh me besim në Allahun”. Po kjo s’do të thotë se nuk mund të titullohet edhe ndryshe.

Së pari duhet të dimë: Besimi është diçka që ka rëndësi. Dhe të kesh respekt për simbolet e shenjta është e rëndësishme. Por athua çdo besim, pa marrë parasysh në çka e cilës fe i përket, të sjellë lumturinë!

Unë besoj se vetëm një besim është i drejtë. Vetëm një fe është dhe vetëm një Zot është. Nëse një Zoti të vërtetë dimë t’ia shfaqim besimin, dimë të marrim qëndrim të drejtë ndaj Tij, mendoj se edhe lumturia do të ishte e pashmangshme.

Tani mund të shtrohet pyetja tjetër.

Përse kërkohet besimi vetëm në një Zot të vetëm e të pashoq? Njeriu mund të besoj në çdo gjë dhe si të dojë? E ky është një gabim shumë serioz. Ja se pse: Një ditë derisa po shkonim për vizitë te një shok, polici i trafikut ndaloi makinën tonë dhe, pasi përshëndeti, ia kërkoi dokumentet shoferit që e ngiste veturën. Shoferi ia vuri përpara lirshëm dokumentet e tij policit të trafikut. “Ju lutem”, - tha polici, - “Patentës sate i ka skaduar afati”! “Iiha, ku e gjete edhe ti tash”, - ia ktheu shoferi, - “kryesorja është të kesh patentë shoferi”. “Këtu qëndron gabimi yt”!.- u shpreh polici, -“kryesorja është të kesh një patentë që është e vlefshme”.

E njëjta gjë është me besimin. Fakti i besimit, i besimit në çdo gjë, dhe siç do, nuk është ajo që ka rëndësi në fund. Sepse çdo njeri sipas mënyrës së tij beson në diçka. Edhe ai që thotë besoj në ujin, beson;

edhe ai që thotë besoj në gurin apo drurin, ka një farë besimi; besim është edhe i atij që thotë besoj në zjarrin apo diellin, në lopën apo idhullin; edhe ai që thotë se mund të ha një tepsi me lakror fill vetëm, beson. Edhe këta kanë një farë besimi! Ajo që ka rëndësi nuk është vetëm të kesh një farë besimi, por të kesh besimin e vërtetë, një besim që të aftëson të jetosh kur çdo gjë përreth bëhet e errët, sterrë e zezë, që të mbështet kur rrezikon të biesh në tundim; një besim i plotë, i pastër, burimor, pa kurrfarë shtesash, origjinal, me nocione të definuara, me mësim të baraspeshuara, universal, i pa damkosur, i tërësishtëm, i pandarë; një besim i baraspeshuar, harmonik, që të ndihmon të përballosh jetën dhe vdekjen. Vdekja dhe jeta janë provë e mirë dhe e rëndësishme e vërtetësisë së besimit tënd. A do t'i qëndrojnë besimi yt provës? *“(Allahu) është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë...”* (Kur’ani, sura *El-Mulk*, ajeti 2.)

Tani, ka vetëm një besim të vërtetë. Një të vetëm, i cili na aftëson të jetojmë dhe të vdesim denjësisht. Është besimi në Allahun Mëshirëplotë që e shpalli Islami me anë të Kur’anit dhe e bëri të qartë e për të zbatuar në jetën praktike i zgjedhuri i Tij i fundit, Muhammedi a.s., me anë të Sunnetit. Besimi në Allahun xh.sh. vlerësohet nga gjendja e zemrës kur i afrohet Zotit. Çfarë është zemra jote kur thuash: “Unë besoj Allahun?” Si e ndien ajo këtë? Si e përjeton ajo këtë që deklarativisht e shpreh me gjuhë?

Po pse vetëm Islami të merret në konsideratë? Pse është besimi sipas Islamit i vetmi besim i vërtetë?

Duhet ditur një gjë: Feja Islame është Shpallje e Allahut, Mëshirëplotit dhe Krijuesit të Gjithësisë, dhe është shpallje për të gjithë njerëzit, pas shpalljeve të vazhdueshme që i janë bërë njerëzimit, është përmblylje e një procesi të mesazhit Hyjnor, dhe shërben si mësim për mbarë njerëzimin dhe për të gjitha kohët, si finalizim i mëshirës së Krijuesit ndaj njeriut. Allahu e shënoi me vulën e përhershme Islamin për të gjitha krijesat, udhëzim të përhershëm për të gjitha racat, mëshirë i të Madhit Zot për të gjithë botët, e vërtetë “që s’i vjen gënjeshtër nga asnjë anë”, fe, mësimet e së cilës njeriut i dalin në ndihmë

gjatë gjithë historisë së zhvillimit të tij në të gjitha vendet e rruzullit tokësor, në të gjitha mjediset dhe në të gjitha kohërat. Allahu xh. sh. thotë: *“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë time, zgjedha për ju Islamin fe”* (Sura *el-Maide*, ajeti 3). Nga kjo del e qartë se Islami është sistem Hyjnor i plotësuar që Zoti ua adresoi të zgjedhurve nga krijesat e Tij në këtë tokë dhe e pëlqeu rrugë-metodë shembullore në sjelljet njerëzore me jetën dhe universin.¹

Vlen të përmendim se fjala “Islam” nuk është titull apo emër i veçantë me atë që është dërguar Muhammedi a.s., sikurse mund të mendojnë disa, por me fjalën “Islam” nënkuptojmë paqen, nënshtrimin dhe dorëzimin e njeriut në përgjithësi ndaj inspirimeve të Allahut që u janë zbuluar të dërguarve në çfarëdo kohe dhe vendi që janë gjetur. Ndërsa ata që iu kanë nënshtruar të vërtetës me të cilën ka ardhur Ibrahim a.s. janë quajtur myslimanë; ata që iu kanë nënshtruar asaj që i është dërguar pejgamberit pas tij, sikur është Musa a.s., Isa a.s., janë myslimanë. E ata që iu kanë nënshtruar asaj që i është shpallur Muhammedit a.s. me anë të Shpalljes (Vahj), janë gjithashtu myslimanë. Kjo bazuar në domethënien e ajetit të Kur’anit: *“...Ai edhe më parë, edhe ky (Kur’an) ju quajti myslimanë...”* (Kur’ani, sura *el-Haxh*, ajeti 78).² Ç’harmonie e mrekullueshme ekziston në qiell, në tokë, në krejt gjithësinë, në ndryshimet dhe pandryshimet, ç’lidhje harmonie, lidhje e nyje e fortë paqeje e mbajtur nga një ligj i përkryer në qiell e në tokë. Deshi Allahu xh. sh. që të ruhet paqja në këtë gjithësi, të ruhet kjo harmonie e mrekullueshme e tij, prandaj njerëzimit ia shpalli Islamin si një sistem hyjnor me një besim real të plotësuar nga Zoti që ofron besim të vërtetë, paqe me veten dhe paqe me të tjerët, dhe paqe me gjithësinë; që niset nga të vërtetat ekzistenciale dhe bart te njerëzit një ligj të suksesshëm dhe të drejtë ekonomik; ofron rrugën më me vlerë edukuese për përkujdesjen e familjes dhe ruajtjen e saj nga shpërbërja dhe zhdukja. Gjithashtu ka për obligim ruajtjen e shëndetit të njeriut nga një numër i madh lëngatash të parashikuara. Zgjon ndje-

¹ Dr. Muhamed S.R. el Buti, Hyrje në të kuptuarit e esencës, f.71.

² Dr. Muhamed S.R. el Buti, Hyrje në të kuptuarit e esencës, f.51.

njën e përgjegjësishë të njeriut, duke i thënë se je përgjegjës para Zotit, para natyrës, para njerëzimit, para vetvetes, para familjes dhe para çdo krijese.

Ndërkaq, unë e di se sikur miku im, ka edhe të tjerë që mendojnë se duhet të jetë disi ndryshe, më saktë t'iu ishte ndryshe. Ata janë të gatshëm të diskutojnë për Zotin për orë të tëra, për të shkëmbyer ide të mençura se si mund të jetë Ai. Por Zoti nuk mund të jetë një temë për diskutim. E përsëris: është vetëm një besim i drejtë. Besimi në Allahun, i cili, kur rivendos ekzistencën e vet në substancën e njeriut mbi bazat të forta që përfshijnë njohuri rreth Hyjnisë së Allahut e Njëshmërisë së Tij, pastaj, harmonizohet në vepra të mira dhe pasqyrohet në sjelljet e zakonshme njerëzore, pra, një besim i tillë me bindje të plotë mendore e shpirtërore dhe në lidhshmëri me punën e mirë mund të na bëhet garanci e lumturisë si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin shoqëror.

Nëse pyetni se cila është mënyra për ta bërë njeriun të lumtur në jetën e këtushme dhe në jetën e ardhshme? Përgjigjja është kjo: rruga e vetme është t'i përmbahesh Kur'anit me fjalë dhe me vepër, dhe të pasosh gjurmët e njeriut të Kur'anit, gjegjësisht, të Muhammedit a.s., Sunnetit të tij. E nëse pyetni se cilat janë mjetet që i ndërmori Kur'ani për ta bërë njeriun të lumtur në këtë dhe jetën tjetër? Prapë përgjigjja do të ishte: E para, njeriun e mësoi me atë që nuk e dinte, dhe e dyta, e urdhëroi që ta punojë atë që ia mësoi. Kur'ani shprehet kështu: **“Lexo! Se Zoti yt është më bujari. Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”**. (Sura el-Alak, ajeti 3-5). Sa i përket punës dhe veprimit Kur'ani thotë kështu: **“...Veproni, Allahu do t'i shohë veprat tuaja, edhe i dërguari i Tij, edhe besimtarët. Më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, dhe Ai do t'ju njoftojë për atë që vepruat”**. (Sura et-Tevbe, ajeti 105)³ Pra, në këto ajete të mësipërme është treguar themeli i formimit të njeriut dhe ky formim arrihet kështu: Të dish dhe të zbatosh themelet e besimit dhe të veprimit. Për të theksuar se dituria dhe besimi

janë punët më të virtytshme, si kurdoherë në Kur'an, ashtu edhe në këto ajete, janë theksuar në radhë të parë besimi dhe dija, pastaj është sjellë shprehja që tregon veprat dhe veprimet. Kjo është rruga dhe metoda që kërkon Kur'ani të ndiqet prej nesh. Mëso, zbat, kumto, bëhu i devotshëm, pamja le të përputhet me përmbajtjen, fjalët me punën. Rruga e suksesit në jetë dhe e ndikimit të tjerët është përputhja e teorisë me praktikën. Këtu qëndron e fshehta themelore e suksesit dhe e lumturisë në këtë jetë kalimtare dhe në jetën e amshuar që është premtuar pas vdekjes, duke dëgjuar zërin e engjëllit kur thotë: **“... të mos frikësoheni dhe të mos pikëlloheni, keni myzhde xhennetin që u është premtuar”**. **“Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, ku do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkonti”**. (Kur'ani, sura Fussilet, ajeti 30-31).

Si mund të dimë se një vepër është e mirë apo e keqe?

Se është vepra e mirë apo e keqe mund ta dimë me anë të dispozitave islame. Në qoftë se mendja jonë bie në kundërshtim me dispozitat islame, do t'i japim përparësi dispozitës islame dhe do të veprojmë në pajtim më të. Nëse mendja jonë nuk është gjithnjë e aftë të kuptojë dobinë dhe qëllimin e një norme islame, megjithatë, ne do t'i përmbahemi asaj, sepse më vonë do të mësojmë mbi urtësinë e saj dobiprurëse për njeriun.

Marrim një shembull:

Themi se në dhomë ku ndodhemi nuk ka pluhur. Le të hyjë drita e diellit në dhomë, do të vërejmë nën rrezet e tij mijëra grimca pluhuri. Kur i pamë këto grimca pluhuri, atëherë kur rrezja e diellit depërtoi në dhomën tonë. Ajo është më e fortë se drita e syrit tonë, prandaj na i qiti në pah.

Themi se jemi të drejtë, dimë ç'bëjmë. Prit pak. Le të hyjë drita islame në zemrën dhe mendjen tënde. Çka tani? Do të shohësh gabimimëkatën, ndonëse mendja ka mundur të thoshte se kjo punë është e mirë. Ja përse jemi të detyruar t'i përmbahemi dispozitës islame, që do të thotë, mësimi të Allahut, sepse Ai di më mirë për ne se ne që dimë për vete. Kur'ani shprehet kështu: **“...Thuaj: Vetëm Allahu udhëzon në të vërtetën...”** (Sura Junus, ajeti 35) **“Ne nuk të shpallëm ty**

³ Shih Hasen Doh, Rruga e Kur'anit, f. 19, Prishtinë, 1996.

për tjetër Kur'anin, vetëm që t'ua bësh të qartë atyre atë për çka u përçanë, që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë". (Sura En-Nahl, ajeti 64) "...Ai di më mirë për ju edhe para se t'ju krijojë..." (Sura En-Nexhm, ajeti 32)

Ndërkaq, a kanë të drejtë njerëzit të mos pajtohen rreth mënyrës më të mirë me të cilën duhet të punojë një makinë, nëse zbuluesi i makinës e ka dërguar udhëzimin me sqarime të plota, lidhur me funksionimin e saj. Nëse udhëzuesi na thotë se "kjo makinë është ndërtuar për të funksionuar në rrugë, a kemi të drejtë që makinën ta përdorim të funksionojë fushave, shpateve, kodrave. Në qoftë se zbuluesi ose udhëzuesi thotë se kjo makinë mund të funksionojë me benzinë, a kemi të drejtë që në vend të benzinës t'i qesim ujë. Çdo të bëhet më të nëse veprojmë të kundërtën e asaj që udhëzuesi na thotë. Përgjigja është e qartë dhe e shkurtër: prishet makina.

Kështu, pra, meqë Krijuesi i të gjitha krijesave ua ka bërë të qartë njerëzve mënyrën e jetesës nëpërmjet të dërguarve të sinqertë, nuk duhet lejuar që njerëzit të ndahen rreth gjërave, të cilat Allahu i Gjithëdijshëm i ka sqaruar. Prandaj e mira e njeriut është që të vërë jetën e vet në shërbim të Zotit, të jetojë në pajtim me kërkesat e Tij. Ky është sukcesi. Sepse pa të jeta mund të bëhet vërtet e mjerueshme dhe fati i tij do t'i ngjante fatit të makinës. Allahu zh. sh. me gjuhën kur'anore shprehet kështu: **"Jo, për Zotin tënd, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty (o Muhammed) për të gjykuar ndërmjet tyre në konflikt, e pastaj të mos ndjejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht."** (Sura En-Nisa, ajeti 65) Ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë: "Askush nga ju nuk do të besojë gjithnjë derisa synimi i tij nuk përputhet me atë me çka kam ardhur".

Si qëndron me shpalljet e mëhershme dhe me "Fetë qiellore"?

Paraqitja e shpalljes është një e vërtetë e vetme dhe me një kuptim të vetëm gjatë gjithë historisë së ekzistimit të njeriut, pa marrë parasysh numrin e të dërguarve të cilët kanë qenë të njohur dhe të ngarkuar më të. Shpallja, revelata apo zbulesa, nuk është diç tjetër pos një metodë e caktuar e ligjërimit të Allahut ndaj të sinqertëve e të zgjedhurve nga krijesat e Tij. Periudha e shpalljes përfundon me

Kur'anin, i cili paraqet shpalljen e fundit. Andaj edhe Muhammedi a.s., është Pejgamberi i fundit-vula e pejgamberëve. Shpallja në themel është unitare. Ajo u shpall disa herë gjatë historisë. Secila shpallje që ka ardhur më vonë, ka qenë më e kompletuar se e para, por në themel e njëjtë. Por informacionet e shpalljeve Hyjnore të cilat i kanë bartur gjeneratat bartin edhe të meta, në to janë bërë ndryshime, janë futur shumë modifikime nëpër periudha të ndryshme gjatë historisë së të dërguarve dhe profetëve. Të dërguarit që pranuan njohuritë e tyre nga engjëlli, Xhibril, i cili është fisniku i Allahut në qiellin e Tij, domosdo që të dërguarit të jenë fisnikët e Tij në tokë- që me këtë, lajmet e tyre të jenë të njësuar, të njëjta dhe nuk logjikohet ndërmjet tyre të gjendet ndonjë kontrast. Në qoftë se supozohet kjo, në këtë rast a mund të jetë e pranueshme për mendjen që, pasi besoi në Allahun xh. sh., në urtësinë e Tij, në cilësitë e Tij të qarta, që të jenë lajmëruar të gjitha palët nga adhuruesit e Tij në kundërshtim me atë që u lajmërua pala tjetër; për shembull, disa të jenë lajmëruar se Allahu është Një i Pashoq, e të tjerët në kundërshtim me këtë, apo disave t'u vërtetohet se Ai nuk lind, as është i lindur, e disave t'u vërtetohet se Ai kishte një fëmijë, dhe se ai është Isa ose Uzejri? Vërtet kjo pyetje u detyrohet të gjithë atyre të cilët arritën këtë vendim. Nëse ishin të drejtë të dërguarit në atë që u kumtuuan popujve të tyre nga këto lajme kontraktore, gënjeshtre pra është e fshehur në burimin e lajmit, e Ai është Allahu i Madhërishtëm!! Ndaj, nuk ka dyshim se kulminacioni i këtij vendimi është ateizmi...Mirëpo, sikur mendja refuzon këtë mendim në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë, ai gjithandej refuzon mendimin e gënjeshtres së të dërguarve. Pra, kontrastet dhe kontradiktat paskan ardhur nga ky lloj mendimi, përzierja rrjedh nga njerëzit në emër të të dërguarve, e jo nga vetë ata. Gjithashtu fshihet një gabim serioz dhe i rrezikshëm në shprehjen "Fetë qiellore", sepse me këtë shprehje mund të nënkuptohet se Allahu çdo grupi të robërve të Tij i kumtoi njohuri mbi veten e Tij dhe universin, në kontrast me ato që i kumtoi grupit tjetër të mëhershëm, gjë që nuk mund të komentohet ndryshe pos me kotësi ose gënjeshtër...Prandaj, feja e vërtetë të cilën ua shpalli Allahu xh.sh. robërve të Tij, përbën bazën nga një sërë parashiki-

mesh e lajmesh nga Allahu xh.sh. mbi universin, njeriun dhe atë që e pret atë. Kjo fe e vërtetë është një e nuk ka tjetër, nuk ka të dytë që nga fillimi i krijimit të njerëzimit e deri më sot. Andaj, domosdo duhet të përmirësohet ajo shprehje e gabueshme dhe e gabimit. Se e vërteta është: Një Fe e vetme qiellore, e jo shumë kontradiktore. Feja qiellore e vërtetë është ndryshe nga fetë që njerëzit ia shpikën vetes në të kaluarën e lashtë dhe ato nuk janë pos një korrje e imagjinatës, koncepteve dhe efekteve shoqërore dhe ideologjike të prapambetura të cilat morën justifikimin psikologjik nga realiteti i instinktit të thellë e të fshehur të besimit të çdo njeri, me ndjenja dhe të menduar të pastër.- siç konstaton Buti.⁴ Duhet ditur se ekzistimi i këtij modifikimi, në këtë kohë nuk paraqet ndonjë problem para atij hulumtuesi që dëshiron të ketë pasqyrë të qartë ndaj njohurive të Allahut dhe të kuptojë rrugën e Tij. Sepse, tashmë është bërë e qartë se feja për të cilën ka obliguar Allahu robërit e Tij është Një, që do të thotë se informacionet e inspimit Hyjnor për tregimet e këtij universi, udhëtimit të njeriut dhe ringjallja e tij pas vdekjes si edhe lidhshmëria e tij me Allahun, janë në pajtim me periudhën e të gjithë të dërguarve dhe profetëve dhe në mesin e tyre nuk gjenden kontradikta dhe modifikime. Sipas Gazaliut, parimet kryesore të Islamit janë: 1) monoteizmi (besimi në Një Zot të Vetëm e të Pashoq), 2) pejgamberia Hyjnore dhe 3) ringjallja pas vdekjes ose Dita e Gjykimit. Këto baza themelore i kanë përfshirë edhe Tevrati (Dhiata e Vjetër) edhe Inxhili (Dhiata e Re).⁵ Megjithatë, "fetë qiellore" si judaizmi dhe krishterimi të kufizuara në kohë e hapësirë, të cilat nuk paraqesin mision të përgjithshëm dhe të përhershëm për të gjithë njerëzimin, dhe për të gjitha lëmenjtë jetësorë, librat e të cilave nuk janë kursyer nga dora dhe gjuha e degradimit leksikor, që nënkupton fshirjen e disa fjalëve hyjnore dhe zëvendësimin me fjalë njerëzore, dhe shtrembërimin kuptimor, që nënkupton interpretimin e fjalëve të Allahut ndryshe prej asaj që ka synuar i Lartmadhërishti, edhe përkundër pretendimit të tyre në rrënjët burimore religjioze, ko-

⁴ Hyrje në të kuptuarit e esencës, f.36

⁵ shih: Izbor Hutbi i vazova, f.31

nsiderohen forma religjioze të moduluara që dallojnë në natyrë dhe në përmbajtje. Kur'ani si mesazh i fundit që Allahu ia zbriti Muhammedit a.s. është kultivues dhe burimet e vjetra i vërteton, i ruan dhe i mbron prej çfarëdo shtrembërimi, dhe u tërheq vërejtjen të gjithë atyre kundërshtarëve që kundërshtojnë argumentet e Allahut pa dallim se a janë ata kundërshtarë të Tevratit, Inxhilit, apo të Kur'anit. Nga këtu besimi i drejtë në Kur'an është besim në të gjithë të dërguarit dhe librat e zbritura më herët. Një është Zoti, burim i çdo gjëje; një është ligji që e sundon botën; një është njeriu pa marrë parasysh ngjyrën, gjuhën, racën. Besimi në Kur'an të detyron të besosh në pejgamberinë e Musait a.s. Isait a.s. e në të gjithë pejgamberët, të cilët ishin para tyre, që i ka shpjeguar e veçuar Kur'ani, por nuk pajton me devijimet dhe modifikimet që u janë bërë shpalljeve të mëhershme nga mendjet njerëzore, dhe ky është një fakt i pamohueshëm që tregon qartazi se pse është dashur t'i zbrësë Kur'ani pejgamberit të fundit Muhammedit a.s., për ta rikthyer e për ta nxjerrë në pah bazën e saktë e të vërtetë të besimit, mënyrën e veprimit me atë besim dhe për t'i pastruar shpalljet e mëhershme nga devijimet dhe modifikimet që u janë mveshur. Çështja më e ndjeshme për të cilën Kur'ani kritikon krishterimin është insequenca në monoteizëm. Për të krishterët Isai a.s. nuk është vetëm pejgamber i Allahut xh.sh., por edhe Zoti vetë!. Në të vërtetë, zoti i të krishterëve u inkarnua, paraqitet në treshin (ati, biri dhe shpirti). Kur'ani, përkatësisht Islami hedh poshtë idenë e inkarnimit të Zotit dhe trinitetin.⁶ Cila logjikë e shëndoshë sot në botë do të pajtohet me pohimin se: "Jezusi është Zot!!!". "Në personin e Jezu Krishtit, Perëndia erdhi!!?" "Perëndia u fut në Jezusin në fushat e Bethlehemit!!?" etj.

Ç'është e drejta me këto gjëra ne fyejmë Allahun xh.sh. dhe personalitetin e Isait (Jezusit) si njeri dhe si pejgamber i Allahut xh.sh. Jezusi, i cili ka ngrënë, ka pirë, ka nxjerrë nga trupi mbetjet e metabolizmit për një çast bëhet Zot, duke ia mohuar atij cilësitë njerëzore dhe duke ia mveshur esencën e Hyjnisë! Jezusi këtë s'do ta dëshironte

⁶ Husein Gjozo, Islami në kohë

dhe me gjuhën e Kur'anit ai shprehet kështu: “**Kur Allahu tha: O Isa, i biri i Merjemes, a ti u ke thënë njerëzve-merreni nënën time dhe mua si dy zotër, përveç Allahut? Qofsh lartësuar o Zot, (tha Isa), mua s'më ka mbetur të them atë çka s'është e vërtetë...**” “**Unë s'u kam thënë asgjë tjetër pos asaj që Ti më ke urdhëruar. Adhuronit Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!**” (Sura el-Maide, ajeti 116-117). Gjë e tmerrshme për njeriun që vetëm të mendojë kështu e lëre më edhe të besojë. Si mund të personifikohet Perëndia me Jezusin!!? Allahu, të Cilit nuk i mungon asgjë e nuk ka asnjë të metë, disa nga krijesat e veta i ka bërë tokë e disa qiell, disa i ka bërë baltë e disa flori, disa bimë e disa kafshë, disa i ka bërë njerëz e disa xhindë. Lartësia që u jep Ai disa krijesave të veta, është vetëm nga mirësia e Tij. Gjithashtu edhe pozicioni e gjendja që Ai u ka dhënë krijesave, është nga urtësia e Tij. Çfarë lloj mendjeje është ajo që disa krijesa ia bën ortak Allahut në adhurim. Qysh mund të përfytyrohet që Shpikësi i Madh i qiejve dhe i tokës të jetë baba për këta trupa, të cilët Ai vetë i ka krijuar në gjithësi? Dhe ç'është Isai kundrejt madhësisë së trupave qiellorë?,- shtron pyetjen Gazaliu.⁷ Mendoj se tashmë është e qartë se pse besim i vërtetë është besimi që e koncepton Kur'anin. Dhe ta adhurosh e ta falënderosh Atë si e kërkon Kur'anin. Megjithatë, njeriu ka lirinë e plotë të zgjedhjes sipas shprehjes kur'anore: “**Kush të dojë, le të besojë; kush të dojë, le të mohojë**”. (Fe men shae fel-ju'min ve men shae fel-jekfur).

Po mirë, ç'nevojë ka Allahu për adhurimin tonë?

Jo. Ai nuk ka nevojë fare. Ne kemi nevojë për Të. Një poet që i kishte hedhur sytë e ballit botës së këtushme dhe sytë e zemrës botës së ardhshme kishte shkruar këto vargje:

Ekziston një shkëlqim

tjetër i Diellit

tjetër i Hënës

tjetër i yjeve

⁷ Besimi i myslimanit, f.66

Kështu ringjallen njerëzit

Ditën e Gjykimit

Të varrosur me trup

Të ngritur në famë

Të varrosur fizikisht

Të ngritur shpirtërisht.

Të qeshurën e ka vetëm njeriu dhe vetëm njeriu shquhet me të qeshur. Gjithësia është e mbushur me të mira të panumërta. Por vetëm njeriu është ai që me këngë shpreh ndarjen. Dhe për këtë qanë vetëm njeriu, sepse ndjenjat, gëzimet, dhembjet vetëm njeriut i janë dhënë. Ndaj, ai shquhet me të qeshur dhe me të qarë “**Ve ennehu huve ed'hake ve ebka**”. (Sura en-Nexhm, ajeti 43) Edhe mendja për të kujtuar të kaluarën dhe për të ardhmen i është dhënë vetëm njeriut. Këngën e ndarjes shtazët nuk e këndojnë, sepse nuk kanë ndjenja. Vetëm njeriut i është dhënë ndjenja mbi sëmundjen, vdekjen, pleqërinë, jo edhe shtazëve. Po mos të ishte njeriu krijesë për xhennet dhe për jetë të amshuar në botën e ardhshme, mund të ishte një shtazë e thjeshtë. Sepse, shtaza duke mos pasur mend, atë nuk e mendojnë ngjarjet e së kaluarës, por as sëmundjet dhe nuk ka frikë nga vdekja. Dhe ato mbështeten në instinktin e tyre. Dhe ato, gjithashtu, nuk kanë mundime për veshmbathje, as brenga rreth fëmijëve. Më shkurt, ato duke mos pasur mend, nuk mbesin prapa dëshirave të tyre.⁸ Të ndalemi një çikëz dhe të mendojmë... Ende pa ardhur në sipërfaqen e tokës po të na kishin pyetur: - “Shikoni shtazën, mend nuk ka, por as frikë. Por, për shkak të mungesës së mendjes, edhe adhurimin nuk e ka obligim. Kështu si është, nuk ka as xhennet për të. A doni të jeni të këtillë? Ose: shiko një njeri, mend ka, të kaluarën dhe të ardhmen e ka. Dhe për këtë, detyrë të parë e ka adhurimin. Kurse dhuratë për këtë do të jetë xhenneti i amshuar. A kishit kërkuar të jeni të këtillë? Më shkurt, athua si njeri i mençur doni të adhuronit Zotin dhe hyni në xhennet,

⁸ Vehbi Karakash, Niçin Namaz, f.7.

apo pa adhurim do të jetoni sikur deveja. Çfarë do të kishim për të thënë? Sigurisht përgjigjja jonë do të ishte: O Zot! Vetëm na krijo si njerëz, se jo vetëm do të adhurojmë e do t'i falim pesë kohët e namazit, por edhe shumë më shumë do të bëjmë për Ty dhe vetëm për Ty. A s'është kështu? Ç'mendoni?

Allahu na ka krijuar njerëz, miku im i nderuar. Allahu, e askush tjetër përveç Tij nuk ka krijuar ndonjë send. Prandaj, çdo adhurim dhe falënderim përveç Tij është i gabuar dhe me pasoja të rënda. Ai është dhurues i jetës së çdo gjallesë, siguries i kushteve për jetë si nga toka ashtu edhe nga qielli. Profeti Davud a.s. kishte pyetur: "A thua cila është më e pakta e bekimit Tënd, o Zot?" Dhe Zot i shpalli: "O Davud, merr frymë dhe Davudi mori frymë". Atëherë Zot i tha: "Ja, kjo është më e pakta e bekimit Tim mbi ty". Merreni me mend, frymëmarrja-më e pakta e bekimit të Zotit ndaj nesh, po kjo është e tërë jeta, apo jo?! Kjo është dhurata e Allahut. Prandaj, pos Tij nuk meriton kush tjetër të adhurohet. Njeriu, me mend në kokë, si mund të marrë nëpër këmbë mirësitë e Zotit? Po ka një epsh që joshet me gënjeshtër, hipokrizi e dhunë!. Kur flet epshi i hapen dyert djallit për të vepruar dhe për të manipuluar me vullnetin e njeriut. E dihet se ndërmjet dashurisë për të mirën dhe dashurisë për të ligën ka vetëm një hap të vogël, sepse është puna gjithnjë për të drejtuar të njëjtin vullnet. "Por ndryshimi është tek objekti, dhe objekti njihet që atje tej". Në njërën anë ke Zotin dhe në anën tjetër ke djallin. Djalli është kokëfortë, ndjek një ritëm në djallëzitë dhe joshjet e tij, i përsërit dredhitë dhe mjeshtëritë e veta gjithnjë, gjithmonë prej se është mallkuar nga Zot për kokëfortësinë e tij, dhe është gjithnjë po ai, prandaj njihet nga të gjithë me emrin e armikut, sepse Allahu e ka quajtur "*aduvvun mubin*". Ne s'duhet ta pasojmë atë. Qoftë lavdëruar Krijuesi që i ka caktuar të gjitha gjërat në numër, peshë e masë. Ai ka mund të na bëj dru, po nuk na bëri, ka mundur të na bëj gjarpër që zvarritet për tokë, po s'na bëri, as krijesa që jetojnë nëpër mbeturina s'na ka bërë. Na ka krijuar me fizionominë më të bukur, na ka pajisë ne me të gjitha gjërat, tërësisht, pa asnjë mungesë dhe për ne i ka krijuar gjërat më të bukura. Në suren Et-Tinë, ajeti 4. kjo e vërtetë është shprehur kështu: "**Pa dyshim, Ne e**

krijam njeriun në formën më të përsosur". A nuk duhet t'i falënderohemi Atij? Mendja është një begati tjetër e Zotit. Prandaj kërkohet adhurimi: "**Unë i krijova xhinët dhe njerëzit vetëm për të më adhuroar Mua!**". (sura Edh-Dharijat, ajeti 56). Përse prej devesë nuk kërkohet namazi? Sepse devetë nuk kanë mend". Kush ka mend ai duhet të adhurojë Zotin, të falë namazin, të lexojë Kur'anin. Leximi i Kur'anit dhe falja e namazit janë veprime që kërkojnë logjikë. Kjo a mund të pritët prej devesë? Njeriut i ka hije adhurimi, namazi, veprimi i mirë etj., dhe për këtë është krijuar, thotë Vehbi Karakashi.⁹

Adhurimi për të larë borxhin ndaj Zotit, apo jo?

Borxhin!? Si mund t'ia lashë borxhin Zotit? Me se mund t'i shpaguhesh Atij? Një adhurues kishte adhuroar Zotin për 50 vjet rresht. Allahu i tha atij se e kishte falur. Njeriu, në saje të adhurimit që kishte bërë 50 vjet, mori guxim dhe tha: "O Zot, ç'ka këtu për të falur, kur unë s'kam bërë asnjë gjynah?" Allahu, qoftë lavdëruar, bëri që një nerv në qafë t'i jepte dhembje dhe ai s'mundi të bëjë një sy gjumë gjatë tërë natës, as të falej. Kur dhembja iu lehtësua dhe mundi të flinte, i erdhi një engjëll të cilit iu ankua për dhembjet që kishte vuajtur. Engjëlli i tha: "Zoti yt të thotë se adhurimi yt 50-vjeçar është për të paguar qetësimin e dhembjes tënde".¹⁰ Merret vesh se njeriu nuk mund të paguajë madje edhe për një nga bekimet e panumërta të Allahut, sepse edhe më i vogli favor dhe bekim nga thesari i mirësive të Zotit peshon shumë më tepër se veprat e njeriut.

Ç'është ajo që mund t'i dhurosh Zotit, kur ai të thërret: "**O njerëz, ju jeni të varfër tek Allahu, kurse Allahu është i pasur dhe i denjë për lëvdatë**". (Sura el-Fatir, ajeti 15) Allahu i fton të varfrit në tryezën e vet. Në gjithësi çdo gjë duket sikur është përgatitur diku tjetër dhe, pastaj, i është ofruar përfitimit të njeriut. Faqja e tokës, me të gjitha të mirat të dhuruara asaj të shtrohet përpara si një sofër. Dhe kur njeriu zgjat dorën te këto të mira të panumërta të saj, i bëhet sikur ndien praninë e Zotit të vërtetë të atyre të mirave. Dhe atëherë e gjen

⁹ Niçin Namaz, f.7

¹⁰ Ibn Kajjim el-Xhevzi, durimi dhe mirënjohja, f.117.

veten në një dimension tjetër kënaqësie, ngazëllimi, habi e mahnitjeje. Po, çdo e mirë e çdo dhuratë bujare, nga njëra anë shërben si argument i ekzistencës së Zotit të tyre, kurse nga ana tjetër, na shtyn ne të tregojmë respekt ndaj Tij. Me fjalë të tjera, sapo që Zoti t'ia bëjë të njohur njeriut veten, i duhet përgjigjur menjëherë me adhurim.¹¹ Ja edhe një shembull: “Fryti i drunjve është i qartë, fryti i lopës, dhisë, deles është qumështi, fryti bletës është mjalti, fryti i diellit është drita dhe nxehtësia, fryti i detit është peshku, fryti i pulës është veja...Këto krijesa të gjitha frytet e veta i japin njeriut, e nuk i hanë vetë. Mirëpo, ç’është fryti i njeriut dhe për kënd duhet bërë atë? Përgjigjja: Të gjitha krijesat i kanë detyrat veta, kurse njeriu nuk mund të jetë pa obligime. Edhe prej tij pritet një fryt: A thua ç’është ai fryt? Ibadeti (adhurimi). Për kënd duhet bërë? Për Allahun. Dhe atë fryt vetëm Allahu e blen. Vlerën e atij fryti vetëm Allahu e jep. Ç’është vlera e atij fryti? Xhenneti... Po të mos ishte adhurimi, namazi etj., çfarë do të kishte qenë njeriu? Do të kishte ngrënë pemët më të bukura, ku do t’i kishte hedhur mbeturinat...? Pra do të ishte bërë një makinë që punon midis kuzhinës dhe plehërimit. A thua detyra jonë është vetëm plehërimi... a thua është kjo e logjikshme? Pa iman, pa adhurim, pa namaz, pa Islam do t’i ngjanim atij që thamë më sipër”.¹² S’ka dashur Allahu të na lërë në këtë pozitë, na nderoi me frytin më të çmuar - e bëri obligim që ta njohin robërit e Tij, andaj ka kërkuar t’i bëjnë ibadet. Kur’ani i fton njerëzit: “**Ja ejuhen-nasu’budu rebbekumul-ludhi halek- km...**” “**O njerëz! Adhurone Zotin tuaj, Krijuesin tuaj...**” (Sura *El-Bekare*, ajeti 21). Allahu me madhërinë e vet i fton njerëzit drejtpërdrejt në adhurim për tri arsye: a) për të gëzuar dëgjuesit besimtarë; b) për t’i rritur rëndësinë adhurimit; c) për të mbyllur vendin mundimit që shkakton adhurimi me shijimin e adresimit të drejtpërdrejtë. Ky urdhër i Allahut u jepet si atyre që kishin besuar me qëllim që të vazhdonin të besonin e të shtonin adhurimin, ashtu edhe atyre që ende nuk kishin besuar, me qëllim që të pranonin besimit dhe të fillonin

¹¹ M. Fethullah Gylen, *Lëkundjet që solli shekulli 2*, f.45.

¹² Vehbi Karakash, *Niçin Namaz*, f. 7.

adhurimin.¹³ Sikur të mos kishte qenë mëshira e Tij ndaj njerëzve, nuk do t’u takonte “nderi ibadetit” (adhurimit) për Të, sepse nderin e ibadetit e arrijnë vetëm ata që meritojnë shpërblime të mëdha: “**Nëse ju falënderoni Unë do t’u jap akoma më shumë...**” (Sura *Ibrahim*, ajeti 7). “**Dhe Ne do t’i shpërblejmë falënderuesit**” (Sura *Ali Imran*, ajeti 145) Dhe, mirësitë e Zotit ekzistojnë qysh para se ta ketë krijuar njeriun, nuk i ndërpritën gjatë tërë jetës, do t’i vazhdojnë edhe pas vdekjes. Mirësitë e Tij do të jenë sërish pas ringjalljes, sepse vijnë nga më Fisniku, qoftë lavdëruar vetëm Ai.¹⁴

Po të mos ishte adhurimi, njeriu ç’mund t’i dhurojë Allahut? Kurr-gjë, ama bash kurr-gjë! “Sikur tërë pasurinë e vet ta harxhonte në rrugën e Allahut, prapë s’do t’i jepte gjë Allahut, sepse, në të vërtetë, pasuria e njeriut është pasuri e Allahut. Dhe sikur njeriu ta copëtonte tërë trupin e vet në rrugën e Allahut, as me të, s’do t’i dhuronte gjë, sepse edhe trupi i tij është pasuri e Allahut. Edhe sikur shpirti yt të qajë e të rënkonte ditë e natë nën peshën e vuajtjeve e dënimeve më të rënda në rrugën e Allahut, as atëherë s’do t’i dhurosh gjë Allahut, sepse ti me gjithçka që ke në vete, je në posedim të Allahut. Ai që poseduesit të vet ia kthen atë që Ai i ka dhënë në ruajtje, nuk thuhet jep dhuratë”.

Përkundër kësaj vërejmë se më Fisniku dhe më i Lartësuar, pranon falënderimin dhe adhurimin e njerëzve si zëvendësim për dhuratë. Këtë falënderim dhe këtë adhurim Ai e ka bërë nga mëshira e vet, që të shtohet dhurata e Tij: “**Dhe kur Zoti i juaj kumtoi: “Nëse ju falënderoni, Unë do t’u jap akoma më shumë...**” (Sura *Ibrahim*, ajeti 7).

Ja, pra, ç’mund t’i japim ne Zotit, vetëm adhurimin, asgjë tjetër. “Adhurim, është falënderimi i Zotit për të mirat e panumërta që u ka dhënë njerëzve. Dhe, pa dyshim mirësia më e madhe e Zotit është se Ai na ka krijuar e na ka nxjerrë në dritë pa ekzistuar ndonjëherë. E nga ana tjetër, gjërat që duhet bërë, duhet të bëhen me përkushtim dhe dashuri vetëm për Allahun, duhet të kanalizohen e të trajtësohen ve-

¹³ Ibrahim Dalliu, *Ajka e kuptimeve të Kur’ani Kerimit*, f. 54)

¹⁴ Ahmed Behxhet, *Allahu*, f.10

tëm sipas urdhrave të Tij, në bazë të orientimeve të Tij. Do të thotë, për të mos bërë veprime të hutuara e të parregullta para Zotit pasi ta kemi njohur Atë, kryejmë adhurime nën udhëzimin e Fjalës së Tij, nën dritën e lëshuar nga Pejgamberi ynë dhe në përputhje me kërkesat si dhe kërkojmë të dimë kur mbetet i kënaqur Krijuesi”. Kjo, do të thotë, të vendosësh kontakt me Krijuesin tënd përmes adhurimit (ibadetit-namazit etj.), duke qenë i vetëdijshëm se je pronë e Tij, e Krijuesit tënd, dhe se vetëm Zoti është Ai që meriton të adhurohet, t’i bëhet ibadet, t’i nënshtrohesh dhe t’i dorëzohesh. Por ka edhe një mënyrë tjetër adhurimi: Të mësosh të fshehtat e natyrës, të përdorësh dijen për të përmirësuar gjininë njerëzore dhe feja, të cilën Allahu ta dërgoi të jetë pjesë e pandashme e vetëdijes tënde, e zemrës, syrit, veshit, dorës, këmbës, trupit, barkut, lapsit, gjuhës; të bëhet pjesë e pandashme e ditëve dhe e netëve tua, e tërë jetës tënde, e mundit dhe e veprave tua. Të qëndrosh në çdo gjë i drejtë, i vërtetë, i paanshëm, i zgjuar, i përuhur, modest dhe i denjë, mirëbërës dhe dashamirës, e të mos shtiresh në dëm të identitetit tënd fetar dhe kombëtar, qoftë edhe me një përtypje në gojë të zbrazur, duke qenë i vetëdijshëm se orë e çast je i soditur nga Soditësi, Krijuesi yt. Prandaj Zoti di edhe të ndëshkojë.

Si, një përtypje...- nuk e kuptoj?!

Kujtesa e bashkësisë së mëhershme myslimane mban plagosjet dhe humbjet e anëtarëve të saj, dhe, që ta kuptosh, nga biografia e tyre na takon të përmendim ndonjë nga përjetimet dhe vdekjen e adhuresve më të flaktë të Zotit, të atyre që pranuan të vërtetën e mesazhit hyjnor, dhe vdiqën duke besuar në Allahun dhe me nder për Ligjet e Tij. Mësimet islame sjellin shembuj të besimtarëve të mirëfilltë që s’kanë mundur t’i pengojnë hija dhe balta e kësaj toke për të parë dritën e Zotit, dhe drita e Zotit kishte hyrë thellë në zemrat e tyre, të ndriste aq shkëlqyeshëm e të ndriçonte punën e tyre, dhe me punën e tyre, përkundër persekutimeve e torturave që të copëtonin zemrën, arritën dy qëllime të mrekullueshme: “dinjitetin e njeriut besimtar dhe shembullin e spikatur për ata që duan ta ruajnë identitetin e vet, sidomos të rinjve”.

Shëmbëlltyra e sakrificës

Ja një shembull:

Njëri nga beni israilët, Tevrat (Bibla) e quan me emrin Eleazari, që nga fëmijëria adhuroes i flakët i Zotit, ”njëri ndër më të përmendurit ndër mësues të Ligjit, burrë i shtyrë në moshë të thellë e i hijshëm për nga pamja, e shtrëngonin të hajë mish derri, duke ia hapur gojën me dhunë. Por, ai, duke parapëlqyer më parë vdekjen me nder se jetën me turp, u drejtua vetë vullnetarisht në vendin e mundimeve, pasi pështyu kafshatën siç duhet të bëjnë ata që kanë guximin të flakin çka s’është e lejueshme të shijojnë as për dashuri të jetës. Madje, ata që ishin në krye të përgatitjes së gostisë flijuese të palejueshme, për arsye të miqësisë së kahershme me të, e qitën në një anë vetëm e iu lutnin, të merrte mishra që ishin të lejueshme të hahen, të cilat ai vetë t’i përgatiste e vetëm të bënte kinse po hante prej asi mishi të flisë që kishte urdhëruar mbreti, që kështu të shpëtonte nga vdekja e ta shfrytëzonte dashamirësinë për shkak të miqësisë së vjetër me ta. Por, ai. Duke marrë një qëndrim bujar, të denjë për moshën e vet e me rëndësi për pleqërinë që ia stolisnin thinjat dhe sjellja e mirë që nga fëmijëria dhe, i denjë sidomos për ligjet e shenjta të caktuara nga Zoti, u përgjigj menjëherë: Le ta çojnë pa vonesë në Nëntokë (në dhe). “Moshës sonë, shtoi Eleazari, s’i ka hije të shtihet, kështu që shumë të rinj të mendojnë se Eleazari nëntëdhjetë vjeç ka përqaftuar doket e të huajve. E, ata, për shkak të shtirjes sime, për të fituar pak ditë të shkurtra të jetës sime, të bjerrin për shkakun tim, e unë kështu tash pleqërisë sime t’ia shtoj dangën e çnderimit. Sepse, edhe në qoftë se tash për tash shpëtoj nga dënimi që vjen prej njerëzve, dorës së Gjithëpushtetshmit s’do t’i shpëtoja as i gjallë as i vdekur. E tash, nëse i bie burrërisht pendimit, do të dëftohem se jam i denjë për pleqëri, e të rinjve do t’u lë shembull të fortë se si duhet të kenë gatishmëri e burrëri për ta përballuar me guxim vdekjen me nder për Ligjet e shenjta”.

Pas këtyre fjalëve, iu afrua vendit të mundimeve. Ata që e kishin në dorë e shndërruan mirësjelljen në urrejtje, duke i çmuar, sipas me-

ndimit të tyre, se fjalët që i tha, ishin marrëzi. Ndërsa ishte duke vdekur nën peshën e mundimeve, tha duke gjëmuar: *“Për Zotin që e ka dijen e shenjtë, e ka krejtësisht të qartë se, megjithëse pata mundësinë të shpëtoj nga vdekja, po i duroj në trup dhimbjet e tmerrshme të frushkullimit, ndërsa në shpirt i duroj me ëndje ngase kam nderim për Të.”*

Në këtë mënyrë ai e dha jetën e vet duke u lënë vdekjen e vet she-mbull burrërie dhe kujtim virytesth jo vetëm të rinjve, por dhe shumicës së madhe të kombit. (Derri është kafshë e papastër për hebraikun. Ai s’pranoi as të simulojë: kinse po ha mish derri, se do të ishte skandal për të rinj që do të kujtonin se hëngri, megjithëse ai nuk kishte ngrënë në të vërtetë).¹⁵ (Po ka edhe shembuj të tjerë të bijve dhe të bijave të Islamit, të cilët i kishin rënë në gjunjë të vërtetës dhe më kurrrë s’kishin pranuar të përulen para faraonëve dhe zotërve të rrejshëm si: Bilali, Hubejb ibn Adijj, Ebu Fakih, Hababi, Ammari, i ati i tij, Jasiri dhe e ëma Sumeja. Kjo grua vdiq duke e pasur nderin të bëhej dëshmorë i parë i Islamit, kur Ebu Xhehli i afronte idhullin të puthte, kurse kjo nënë e fortë në besim me një guxim të papërshkrueshëm e kundërshtoi duke e pështyrë idhullin dhe atë në fytyrë. Atëherë Ebu Xhehli i egërsuar si bishë, e goditi me heshtë.

Do të thotë, pati edhe nga femrat që ruajtën besimin edhe me jetë?

Po. Bile, e mrekuallueshme dhe e denjë për kujtim bujar qe nëna, e cila, duke parë se si në një ditë i vdiqën shtatë djemtë, të cilët nuk pranuan të hanë mishin e derrit të ndaluar, qëndronte plot guxim në fuqi të shpresës që e kishte në Zotin. Ajo e fortë në ndjenja bujare, duke përforcuar butësinë femërore me guximin burrëror, u jepte zemër bijve e u thoshte: “Nuk di se si u krijuat në kraharorin tim, sepse unë nuk ua dhashë shpirtin as jetën, as nuk ua dhashë trajtën e gjymtyrëve cilitdo prej jush. Por, e di se Krijuesi i botës, që e ka trajtuar gjininë njerëzore, i cili ua dha të gjithëve prejardhjen, do t’jua kthejë, në mëshirën e vet, e shpirtin e jetën, sikurse që ju tash po e përbuzni vetveten për dashurinë e ligjeve të tij”. (...) Ndërsa, kur ia morën edhe

¹⁵ Nga Libri i dytë i Makabejve, f. 1358-1359

djalin e vogël, nëna iu ofrua dhe duke e tallur tiranin e pashpirt i foli djalit: “Biri im, ki dhimbje për mua që të barta për nëntë muaj në kraharor, të dhashë të pish për tre vjet gji, të ushqeva e të rrita e të edukova deri në këtë moshë. Po të përbejoj, biro, shikoj qiellin e tokën e gjithçka është në ta e dije se Hyji i ka krijuar nga asgjëja dhe se po në këtë mënyrë ka qenë krijuar edhe gjinia njerëzore. Mos e druaj këtë “kasap”, por je i denjë për vëllezërit e tu e pranoje vdekjen, që të të gjej bashkë me ta ditën e mëshirës!”

Ende pa i kryer ajo fjalët, foli djaloshti: “Çka prisni? Nuk e dëgjoj urdhrin e mbretit, por i bindem urdhrin të Ligjit, që u qe dhënë etërve tanë me anë të Moisiut (Musaut a.s.)” (...) Ky djalosh, pra, vdiq pa u përlyer e me një besim të patundur në Zotin. E pas fëmijëve, dha jetën edhe nëna”.¹⁶

Kërkohet kjo gjithëherë?

Jo, gjithëherë. Vetëm atëherë kur faraonët, nemrudët, mbretërit, tiranët, kasapët kërkojnë të të shkulin besimin e vërtetë nga zemra dhe të të shtrëngojnë të shkelësh ligjet e Zotit. Presioni mund të jetë shumë mënyrash. Ka që bëhet me “marifet”, e me prapavijë të rrezikshme. Këtu njeriu mund të lajthitë shumë lehtë...?! Por, ne sot po pësojmë nga vetvetja, për shkak të mëkateve tona. Shpirti është i qetë vetëm kur mban të vërtetën dhe kur gëzohet me të mirën që ka bërë, dhe me të vërtetën dhe të mirën nuk mund të jesh i dëshpëruar dhe i pakënaqur. Prandaj s’më befason fakti kur thuash: “Besoj, s’jam i lumturku është faji?” Në mos e paça thënë, po e them: në botë ka diçka që gjithmonë synon rrënimin e njeriut, ka diçka që synon të krijojë mjerrimin, e kjo diçka mund të jetë në vetë njeriun, në ne. Duhet të kuptojmë një gjë: e mira dhe e keqja janë krijime të Zotit, s’ka dyshim, por njeriu është përgjegjës për aktet e veta. Pa më thuaj a s’kemi gabuar ndonjëherë, s’kemi shkelur Ligjin e Zotit, s’kemi keqpërdorur vendimet dhe parimet e tij, s’jemi shmangur nga rruga e drejtë. Të gjitha problemet ia nënshtrojmë një vlerësimi të ftohtë e të pajetë, një arsye të pandriçuar nga Ligji Hyjnor, duke mbajtur gjithnjë qëndrimin:

¹⁶ Bibla, nga Libri i dytë i Makabejve, f. 1359-1361

“Bën kështu e nuk bën kështu”...”është kështu e nuk është kështu...”

E dihet ai që pranon këtë lojë tejet të rrezikshme mund të çmojë edhe lojën e mendjetrashit të qeshë me atë për të cilën dihet se është e vëmënjë e vërtetë që është thënë tashmë një herë e përgjithmonë në Ezel: “*Kalu bela*”. Vetëm njerëzit me besim mburravec në arsyen e tyre, gjejnë kohë e i bëjnë punët që të tallen me besimin e drejtë, tallen me misteret e Zotit, tallen me simbolet e fesë e çdo ditë shqiptojnë shprehje blasfemie, ushqehen me to, mbushin barkun e kokën e tyre dhe përpiqen që ato t’ua imponojnë edhe të tjerëve. Synojmë hënën e tokën e kemi mbjellë me farën e varfërisë. Varfëri në xhep, varfëri në tru. Skamnorë, endacakë, bredhacakë, endës, makiatxhinj, ekspresxhinj, kumarxhinj, hilexhinj, marifetxhinj, reklamxhinj të trupit e të turpit, lustraxhinj, hajmalixhinj, frymaxhinj, cullakxhinj, dredhaxhinj, trafikxhinj, kriminelxhinj, shitësgjinj, prostitutxhinj, munafikxhinj, servilixhinj, keqbërësxhinj, veshëprerëxhinj, hajdutëxhinj, besëprerëxhinj, njerëz të krisur e të çmendur, si edhe gjithfarë batakçinjsh, demagogë e kopukë e shoqëri bandash bredharake, të cilët sillen rrotull udhëve të botës. Ndërsa ne jemi qenie të brishta, që, me gjuhën kur’anore thuhet “*hulikal insanu daifa*” (Sura En-Nisa, ajeti28) “*Ve kanel insanu axhula*” (Isra,11) “*Innel insane hulika helua.*” (sura, Mearixh, ajeti 19) Po s’që i kujdesshëm, mbarove! Djalli, duke i treguar të stolisura disa të këqija, mund t’i mashtrojë edhe njerëzit që s’besohet se mund të mashtrohen. Mes njerëzve të bërë vegla të djallit, disa herë mund të gjendet edhe njerëz të nivelit shumë të lartë për sa i përket strukturës së tyre moralo-shpirtërore. Janë shumë gjëra të fituara, të thjeshta por rrënuese, si paraqitja e të mirave si të pakëndshme e josimpatike, kurse i të këqijave si simpatike e të këndshme që i dedikohen shejtanit, djallit. Për këtë arsye Allahu i thotë “muzejen”, stolisjes i të këqijave për t’i treguar të bukura. Veçanërisht, ndjenjën e konkurrencës e nxisin edhe kur i flet epshi, djajt e shpirtit dhe egoizmi, dhe ne provohe mi me këtë. Në fillim e bën një mëkat të vogël dhe s’e vret mendjen se ç’ke bërë. Me kalimin e kohës ai gabim i vogël të rëndon, gjithnjë të vjen duke të rënduar e peshuar si t’i mbash gurët e malit mbi supë e s’mundesh kurrë t’i flakësh. Dhe për këtë ia lë fajin Zotit, drejtësisë së

Tij, në vend se ta fajësosh vetveten, se ke dashur të gabosh, ke dashur lavdinë e kotë, ose e ke kujtuar trupin tënd vend për qejfi, e ke mohuar shpirtin apo ke pëlqyer gjëra të përbindshme në shpirtin tënd- e tani duhet të rrosh bashkë me fajin, i kërrusur me fajin tënd, i kërrusur para të tjerëve në botën e këtushme. Po në botën tjetër?!. Tash të djeg mëkati, trupi flakë të shkon, flaka e zjarri të përzhit trupin, e ky mundim të është dhënë për mëkatin që ke bërë, ke dëgjuar epshin, epshin e mishit, epshi t’u është bërë zot e ti i je bërë rob, e ky zjarr që s’shuhet tani gjithnjë gllabëron e përvëlon. Po të vazhdosh së mëkatuari do të miqësohesh më të, do të mishërohesh me epshin tënd, dhe s’do jesh në gjendje të ndjesh erën e qelbur të mëkateve tua aq sa a do jesh në gjendje të ndjesh erën e keqe të gojës me të cilën gënjen. Ky tip njeriu shikohet çdo ditë në pasqyrë dhe prapë s’e njeh vetveten.

Ku është zgjidhja?

Të parët thoshin kështu: “Lartësimi bëhet detyrimisht në raport me mundimin dhe vuajtjen!” Ne mund të themi kështu duke e zgjeruar këtë ide: Çdo lloj sukcesi material e moralo-shpirtëror dhe përparimi hap pas hapi është në përpjestim të drejtë me çdo lloj privimi dhe shqetësimi. Po, kushedi ç’heq fara derisa ta nxjerrë kryet mbi tokë. Ç’forcë i duhet për të mbledhur asaj derisa një ditë të çanë koren e tokës, e të thotë: “ja ku jam”. Bimë është ajo, rrënjët i ka në tokë ushqehet nga balta e, megjithatë, fytyrën e kthen kah dielli. Kjo është shumë e rëndësishme për të kuptuar përpjekjet dhe luftën për lindje, rilindje, ngritje dhe ekzistencë. Kur’ani tërheq vëmendjen mbi zotat e ndryshëm ose forcat sunduese që nxirren në plan të parë në jetën e njeriut si forcë eprore, dhe parashikon për njerëzit vetëm një forcë eprore dhe kërkon që jeta të ngrihet sipas saj. Kjo forcë eprore e propozuar nga Kur’ani është Allahu, krijuesi dhe zotëruesi i çdo gjëje. Me këtë Kur’ani thekson se fusha e lirisë së njeriut që është krijuar si kalif, është e përkufizuar vetëm nga Allahu, ndërsa nga ana tjetër, njeriun e liron dhe e shpëton nga përcaktueshmëria e mjedisit shoqëror, politik e kulturor që e rrethon, mbi mendimet, qëndrimet dhe sjelljet e tij. Sepse edhe mbreti edhe robi bashkohen në një pikë: njerëz janë. Kështu, Kur’ani nënvizon barazinë e të gjithë njerëzve (madje të një

profeti me një njeri të thjeshtë) nën autoritetin e Allahut dhe pohon se në gjërat e përcaktuara nga Allahu as edhe një profet nuk ka të drejtë kundërshtimi. Në këtë kuadër, Kur'ani i bën thirrje njeriut që të njeh vetëm fuqinë e Zotit. Gjithashtu, Kur'ani thotë se aktet e njeriut si dhe e keqja ose dhuna varësisht nga priret ai, janë rezultat i vullnetit të lirë të tij, prandaj e bën njeriun përgjegjës për aktet e realizuara prej tij jashtë botëkuptimit të parashikuara nga feja për të.¹⁷ Ndërkaq, Islami e koncepton njeriun, si “kalif”, - “...*Inni xhailun fil-erdi halife...*”, (Sura *el-Bekare*, ajeti, 30) si qenie që mundet të përdor lirinë e mendimit, shprehjes, qëndrimit, sjelljes vetjake, ndryshe nga perceptimi i krishterimit se njeriu është “qenia që qysh nga lindje është rob mbi mëkatin kryesor dhe i vdekjes”. Mirëpo, qëllimi i ardhjes së njeriut në tokë dhe i përcaktuar si kalif, ka një provë. Zoti kështu thotë: “*Ne i provuam një pjesë të tyre me pjesën tjetër!*” (Sura *En'am*, ajeti 53). Kjo do të thotë se njerëzit provohen edhe me njëri-tjetrin. Ai do të shohitet shpesh, do të kalohet nëpër sitë dhe shpirtrat e pastër dhe të imtë do të veçohen nga shpirtrat e papastër e të trashë, margaritari do të veçohet nga qymyri, do të dalin në dukje njerëzit me përbërje djallëzore dhe me përbërje engjëjlore dhe, kështu do të vërtetohet qëllimi i themelimit të kësaj bote. Po të mos kishte një provë të tillë, njerëzit me shpirt margaritar nuk do të dalloheshin e veçoheshin nga njerëzit me shpirt të qymyrtë dhe që të gjithë do të mbeteshin në të njëjtin nivel. Sigurisht, po të mos ishte një provë e tillë, e vërteta e umetit në përbërje kurrë nuk do të shkëlqente.¹⁸ Duke e trajtuar qëndrimin e njerëzve ndaj së vërtetës e ndaj së gabuarës, në Suren *Er-R'ad*, ajeti 17, Kur'ani e sjell shembullin kështu: “Mirësitë e Allahut i shikoni me sytë tuaj, ndërsa idhujt nuk kanë asnjë influencë në këto mirësi. Allahu e lëshon shiun prej reve për të mirën tuaj dhe me ujët e shiut mbushen lumenjtë, luginat, me atë sasi uji, sa e ka caktuar Allahu i lartë dhe aq sa duhet të mbijnë bimësia e të japin fruta pemët. Lumenjtë, gjatë rrjedhës së tyre, bartin sende të padobishme, të cilat dalin mbi sipërfaqe

të ujit, por lumenjtë mbajnë edhe materiale të dobishme. Materialet e dobishme qëndrojnë në ujë, ndërsa sendet e padobishme largohen. Si ky shembull është edhe qëndrimi ndaj së vërtetës e ndaj së gabuarës. E vërteta qëndron, ndërsa e gabuara humbet. Këtë shembull e shikoni edhe te mineralet, kur i shkrini në zjarr dhe nga të cilët prodhoni sende zbukurimi, ari e argjendi, ose edhe minerale të tjera prej të cilave keni shumë dobi, siç janë hekuri e bakri. Në këto minerale ka edhe gjëra të pavlefshme, të cilat, gjatë shkrirjes, dalin mbi sipërfaqe dhe ju i hiqni e i flakni, ndërsa materiali i vlefshëm mbetet”.

Në këtë ajet Allahu na e bën të qartë ngjashmërinë e dy gjërave të ndryshme, të ujit të pastër e të mineralit të pastër, nga të cilat përfitohen gjëra të mira dhe në të njëjtën kohë po nga këto dy gjëra na jep edhe ngjashmërinë për dy gjëra jo të mira, jep shembullin e shkumës së ujit dhe të skories së mineralit të shkrirë, jep shembullin për dy gjëra të padobishme dhe thotë: Nga retë zbres shiun, ujërat rrjedhin nëpër luginat me pakicë e me shumicë, por ujët që ecën nxjerr në sipërfaqe të tij shkumën që quhet mbuloja e ujit. E njëjta gjë ndodh edhe me mineralet, kur njerëzit i shkrijnë në zjarr, si arin, argjendin, bakrin etj., me të cilët bëjnë sende zbukurimi, enë e të tjera gjëra të nevojshme. Edhe shkuma e mineralit qëndron lart mbi mineralin e shkrirë, njëlloj si ajo e ujit. Nëpërmjet shkumës së ujit e skorjeve të mineraleve Allahu i lartësuar ua bën të qartë njerëzve të vërtetën e të gabuarën. E vërteta është si uji i kulluar, si metali i pastër, ndërsa e gabuara është si shkuma e ujit e si skorja e mineralit, nga të cilat nuk ka asnjë dobi. Shkuma e ujit dhe skorjet e mineraleve largohen e hidhen dhe nga ajo që mbetet prej ujit e minerali përfitohen gjëra me vlerë. Me këto dy shembuj shumë të qartë, Allahu i lartë i bën njerëzit të dallojnë të mirën nga e keqja. Allahu që e shpjegoi të vërtetën e të gabuarën, caktoi edhe ligje për pasuesit e së vërtetës e për ata të së gabuarës. Ata që i janë përgjigjur Zotit të tyre dhe i janë bindur Atij, në botën e ardhshme do të shpërblehen me xhennet e me mirësitë e tij; ndërsa ata që nuk i janë përgjigjur rrugës së Allahut edhe po të kenë pasuritë e gjithë botës, madje sikur të kenë edhe njëherë më shumë dhe këto pasuri

¹⁷ Shinasi Gyndyz, Dhuna fetare, f. 15, 74-75

¹⁸ M. Fethullah Gylen, Lëkundjet që solli shekulli 4, f.129

t'i jepnin për të sprapsur ndëshkimin e Allahut prej vetes nuk do ta bënin dot, sepse Allahu i lartë nuk pranon asgjë prej tyre.

Kështu qëndron edhe puna e besimit: ajo që është e gabuar-shkon dhe mbetet vetëm ajo që është e drejtë dhe e vërtetë. Kështu, pra, i shpjegon Allahu i lartë të vërtetat. Ai sjell shembuj të ngjashëm për sende të ndryshme, derisa ato të bëhen të qarta e të kuptueshme.¹⁹ Ç'është e drejta, Islami synon të krijojë një shoqëri të shëndosh, monolite dhe për krijimin e një shoqërie të shëndoshë e vetmja rrugë është mbështetja mbi individë të shëndoshë, të ngrihet një shoqëri e shëndoshë, të cilën Zoti do ta ruajë dhe mbrojë, do ta marrë nën mbrojtjen e Tij të posaçme, do ta grumbullojë nën kubën e bujarisë së Tij dhe kështu, individët, duke shpëtuar prej një mundimi të tillë si përpjekja për t'u mbrojtur individualisht, do të sigurojnë lumturinë, mbrojtjen dhe sigurinë hyjnore. Po qe se shoqëria është e shëndoshë dhe marrëdhëniet me Zotin i ka të fuqishme, atëherë, siç i pati thënë Muhammedi a.s., Ebu Bekrit në shpellën "Thevr", "po qemë dy Allahu është i treti me ne, po qemë tre, Allahu është i katërti, po qemë katër, Allahu është i pesti etj.", Allahu do të jetë me ne dhe Ai ka garantuar se do t'i ruajë e do t'i mbrojë miqtë! Kur'ani, këshillimi i të cilit është më i arsyeshëm se çdo këshillim tjetër, na thotë: Po qe se individi shkëputet nga kjo shoqëri dhe unitet dhe tenton të bëjë një strehim dhe mbrojtje më vete, çadra hyjnore e gjerë sa një kube i merret nga dora, duke e lënë vetëm me freskoren që ka në dorë. Pastaj shfaqet e vërteta "si të jeni, ashtu do të qeveriseni" dhe i gjithë populli apo kombi ha shpullën e kësaj të vërtete dhe tronditet.²⁰ ***"Dhe respektojeni Allahun e të nderuarin e Tij, dhe mos u përçani mes vete e të dobësoheni, të humbni fuqinë..."*** (Sura Enfal, ajeti 46)

Miku im, mësohu të jetosh me të vërtetën. S'ka dyshim. Zoti na ka krijuar, në fillim, si qenie e dobët, e papërmendur (Sura 76:1), pastaj e ngritur në qenie afirmative, përmbajtësore, progresiste, mençurake, qenie e motivit, inspiruese, intelektuale, qenie e kulturës, qenie histo-

rike që ka marrë mbi vete përgjegjësinë, detyrat dhe obligimet të cilat refuzuan t'i pranojnë qiejt e toka. S'do të ishte kjo njësoj si në shoqërinë hedoniste, ku qëllimi kryesor i jetës së njeriut është kënaqja e qejfeve, epsheve dhe dëshirave?! Mësohu të jetosh me të vërtetën se e vërteta është ëmbëlsia shpirtërore ndaj Krijuesit e rregullit të kësaj bote që ka vendosur dhe me nderim e gëzim adhuro Allahun. Dhe sa më shumë që ta adhurosh, aq më mirë del në dritë fuqia krijuese e Tij, aq më shumë të zbulohen mirësitë e Zotit dhe shtigjet e lumturisë. Jeta është përplot batica dhe zbatica, ngritje dhe rënie dhe njeriu përballet me këto gjendje e me këtë ligj të jetës. E domosdoshme është për njeriun ta ruajë nivelin njerëzor dhe t'i përmbahet arsyes dhe udhëzimeve të Zotit, ndërsa udhëzimet e Zotit nuk janë gjë tjetër vetëm se ndihmë për ta vënë mendjen në rrugën e saj të sigurt. Kjo është rruga që shkon drejt bashkimit, unitetit dhe lumturisë dhe që kalon përmes këtij mendimi...!

(Marrë nga libri në dorëshkrim, "Njeriu i ri")

¹⁹ Përzgjedhje në komentimin e Kur'ani Kerimit, nga Haxhi Selim Stafa, Tiranë, 1418/1997, f.15-16.

²⁰ M. Fethullah Gylen, Lëkundjet që solli shekulli 4, f.132.

Avni Aliu

LEARN TO LIVE WITH FAITH IN ALLAH (A letter to a friend)

(Summary)

"I believe, but I am not happy, why is it so"? This is what I was told by a friend of mine while traveling to P. He added: "you the hodjas, whenever you speak, you always talk about faith, the need to believe, faith... faith...!" "Because faith will bring you happiness, it will fill your empty hearts", etc. "I believe and you know that, yet, my heart is empty and I am not happy with life...!" – "Why is it so"? My friend continued to talk for a while, telling me of his disappointment with life, which he called an empty life, while I continued to listen to him with attention, not interrupting his words.

عوني على

تعلم أن تعيش مع إيمان بالله سبحانه و تعالى

(رسالة إلى صديق لي)

(خلاصة البحث)

أنا أؤمن و لكنى لست سعيدا – أين الخطأ؟ هكذا قال لي صديقي يوما ما و نحن نسافر معه بالسيارة إلى ب و استمر قائلا: "أنتم الشيوخ لما تتكلمون باستمرار تتحدثون عن الايمان و الحاجة إلى الايمان الخ" و تقولون باستمرار: "بان الاسلام يجلب لكم السعادة و يملأ قلوبكم الفارغة بالايمان" الخ. و لكن و كما ترى فاني أؤمن و لكن مع ذلك أنا لست سعيدا". "أين الخطأ؟" و هكذا استمر صديقي يتحدث مبينا لي عدم ارتياحه بالحياة الفارغة كما كان يسميه و أنا كنت استمع إليه بدون أن أتدخل فيما كان يقول.

ESE

Hans Kristian Anderson - (Danimarkë)

NJË TREGIM DANEZ PËR DITËLINDJEN E PROFETIT MUHAMED

Ky është një tregim i bukur për profetin e Islamit. Autor i këtij tregimi është Hans Kristian Anderson, njëri nga shkrimtarët më të famshëm që njohu ndonjëherë Danimarka. Me këtë tregim ai dëshmon se i respekton ithtarët e feve tjera. Edhe pse është i krishterë, aq më tepër se edhe vetë emri i tij dëshmon për këtë. Ai pohon se të gjitha fetë monotheiste thërrasin ithtarët e tyre të mos jenë shpirtngushtë, të mos e urrejnë njëri-tjetrin, vetëm pse ata besojnë ndryshe.

Islami në mënyrë shumë të qartë e manifeston këtë: “Nuk ka detyrim në fe”. “Ju keni fenë tuaj e unë kam fenë time!”

Kështu lypset të jetë toleranca dhe shpirtgjerësia për ata që e adhurojnë Zotin. Secili në mënyrën e vet. Në xhami, kishë apo sinagogë.

Anderson kishte dëshirë të madhe të udhëtonte jashtë vendit të tij, Danimarkës. Sepse gjatë udhëtimeve, ai njihej me popuj dhe kultura të ndryshme. Prej këtyre udhëtimeve, ai tubonte material për të shkruar me respekt dhe dashuri për historinë, traditën dhe besimet e popujve tjerë që ndryshonin nga populli i tij.

Ndodhi që Anderson ta vizitojë edhe Stambollin, kryeqendrën e Perandorisë Osmane, në kohën kur po festohej ditëlindja e Muhame-

di, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të. Shkrimtari nga Danimarka ishte mahnitur me atë që kishte parë. Ai personalisht kishte marrë pjesë në këtë manifestim të madh. Në duar kishte bartur një kandil, ashtu siç kërkonin zakonet e vendit. Por, ai nuk mjaftohet vetëm me këtë. Anderson e merr pendën e tij të mprehtë për të na përshkruar me fjalë ato pamje magjepse, të cilat na bëjnë, që edhe ne t'i përjetojmë ato sikur të ishim prezent, t'i përcillnim aty nga afër me një dashuri dhe respekt.

Ky tregim i shkrimtarit nga Danimarka u botua në dyjavoren e Kajros, “Oktober”, nr. 1528, të datës 9 shkurt 2006, në kohën kur protestat rreth karikaturave ofenduese ndaj profetit të islamit kishin arritur kulmin e tyre në të gjitha anët e botës. Nga këto trazira nuk kishte shpëtuar as Egjipti. Me këtë dëshirohet të tregohet se gjërat nuk duhet përgjithësuar, as në të kaluarën e as sot.

Le të jetë ky një kontribut sado i vogël për uljen e tensioneve, ftohjen e gjakrave dhe mirëkuptimit midis popujve të besimeve dhe kulturave të ndryshme.

- 1 -

Më 4 prill të atij viti ishte ditëlindja e profetit të Islamit. Në mbrëmje të asaj dite filloi manifestimi, e them me sinqeritet të plotë, se ishte një manifestim i mrekullueshëm. Nata ishte me hënë. Policia osmane kishte dhënë urdhrin se çdokush që do të dalë nga shtëpia e tij pas rënies së territ duhet të bartë me vete një kandil. Natyrisht se kjo vlente edhe për mua. Nuk ishte e mundur t'u kundërvihesha këtyre urdhrave. Këtë nuk mund ta bënte as hëna.

Unë dhe një i ri rus që quhej Idirhas u nisëm së bashku. Me vete morëm një kandil të madh në shenjë manifestimi. Shkuam një rrugice të ngushtë në Pira. Para nesh ishte një pamje e mrekullueshme, të cilën ne banorët e Veriut mund ta shohim vetëm në ëndërr. U ndalëm në afërsi të një rendi shtëpish, në drejtim të gjirit, para oborrit të kishës “Bostan Rum”, para së cilës ngriheshin një numër i pishave të mbulura me errësirë. Në maje të maleve të thepisura ishte një rrugë me shu-

më kthesa. Aty vëreheshin gjurmët e këmbësorëve dhe patkonjtë e kuajve. Rrugica kthehej në të djathtë, duke kaluar nëpër varreza. Atykëtu vërehej ndonjë gur mbivarrezor, i lënë në mëshirën e kohës.

Shihnim drita të kaltërta, të cilat lëviznin këtu e atje. Ato zhdukeshin shumë shpejt për t'u paraqitur përsëri prapa këtyre pamjeve. Në hapësirën ku gjendej kisha, shiheshin disa shtëpi të shkapërderdhura. Drita ndriçonte nga katet e sipërme të tyre. Kohë pas kohe ajo vinte dhe shkonte si vetëtima nga ballkonet e atyre shtëpive.

Pas kopshteve të drunjve të lartë vezullonte uji i gjirit me anijet e tij, sikur ato të ishin margaritarë, dy prej të cilave ishin të zbukuruara me llamba ngjyrash të ndryshme përreth limanit.

Në atë pjesë të qytetit para nesh ngrihej një numër i pakufizuar i minareve. Ato dukeshin sikur ishin të renduara me llamba ndriçuese. Qielli sikur kishte marrë ngjyrë të kuqe për shkak të errësirës dhe diellit që ishte në perëndim e sipër. Qielli ishte i kthjellët dhe i pastër. Derisa ne mund t'i shihnim malet e Azisë dhe Alpet, majat e të cilave janë të mbuluara me borë në mënyrë të vazhdueshme. Nga largësia shihnim vijat e tyre të thyera, sikur ato të ishin re të bardha pas qytetit të bukur. Drita e hënës nuk e kishte prishur dritën e mrekullueshme të llambave. Ato dukeshin sikur të ishin lule prej zjarri. Minarja e vogël ishte zbukuruar me një rend yjesh ngjyrash të ndryshme. Minaret e mesme ishin të stolisura me nga dy rende, kurse ato më të larta me nga tre rende yjesh.

- 2 -

Afër nesh nuk kishte njerëz. Ishim vetëm. Shëtisnim në mesin e pishave. Aty në afërsi u paraqit zëri i një bilbili, i cili lëshonte zërin sikur të ishte flaut. Gugurima e pëllumbit shpërthente errësirën e drunjve. U nisëm në drejtim të një shtëpize të rojës me ngjyrë të kuqe, para së cilës ishte ndezur një zjarr i vogël. Ushtarët ishin mbështetur në mesin e gurëve mbivarrezorë. Ishin të veshur me uniforma evropiane. Edhe pse pamjet e tyre të jashtme të jepnin të kuptosh se ata ishin beduinë. Në gojën e secilit prej tyre kishin nga një fyell të gjatë. Ata

vëzhgonin dhe dëgjonin tregimet për të cilat kinin të bënin me ditëlindjen dhe biografinë e profetit Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të. Këtë na e përcolli shoqëruesi ynë. Këtë assesi nuk do ta kuptonim pa ndihmën e tij. Ja pra ky është tregimi:

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Do të thotë se nuk ka zot përveç Allahut, i lartësuar qoftë Ai. Shoqëruesi ynë pastaj vazhdon e thotë: "Në Meke, në kohën e haxhit edhe para se të dërgohej Muhamedi a.s. tuboheshin tregtarë nga Egjipti, Persia, India, Siria . Secili prej tyre kishte putin e vet të veçantë në Qabe. Njëri nga nipërit e zotërisë tonë Ismailit i shërbente haxhilerët me bukë dhe ujë që ata ta shuanin urinë dhe etjen e tyre. Secili prej tyre me devotshmërinë e tyre dëshironin sikur të sakrifikonin bijtë e tyre, ashtu siç kishte vepruar zotëriu ynë Ibrahim. Mirëpo, profetësia paralajmëroi se Abdullahu i bukur do të mbijetojë, dhe se jeta e tij do të shpaguhet me njëqind deve. Abdullahu u rrit dhe u bë burrë i pashëm. Me qindra vajza të Mekes lakmonin të martoheshin me të. Në këtë familje brez pas brezi trashëgohej drita pa e parë askush. Kjo vazhdoi derisa u lind Muhamedi. Këtë dritë e kishte parë Fatimja. Për hir të saj ajo kishte vendosur t'i therte njëqind deve, nëse Abdullahu do të martohej me të. Por, fati deshi që ai të martohej me Eminen. Kështu që drita u zhduk nga balli i tij dhe ndriçoi në zemrën e Emines.

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Erdhi viti tjetër. Më parë, lulet asnjë herë në këtë kohë nuk kishin çelur në këtë mënyrë. Pemët në degë, asnjëherë nuk kishin rritur frytet e tyre në këtë kohë. U dridhën gurët. Liqeni Seva u fundos në tokë dhe u zhduk. U rrëzuan putat në Qabe. Djajtë, binin si vetëtima nga qielli. Ata u treteshin si meteorë që bijën në tokë me miliona. Atë natë lindi profeti Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të.

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Ky ishte tregimi, të cilin na përktheu shoqëruesi ynë. Ai e dinte gjuhën turke ashtu siç e dinte gjuhën tonë.

- 3 -

Vazhduam së ecuri deri nën pìrgun e Pirës, duke kaluar hapësirën e dervishëve, të cilët kishin organizuar një hallkë të ziqrit. Ne ishim para një panorame shumë të bukur. Deti Marmara shtrihej para nesh. Ai shndriste nën dritën e hënës. Në gjysmën e largësisë qëndron një xhami me minaret e saj të larta. Mbi të gjenden shumë llamba të ndezura. Ato rrezatojnë me dritën e tyre atë pjesë të Stambollit, ku gjendet xhamia e Aja Sofisë me katër minaret e saj. Xhamia e sulltan Ahmedit me gjashtë minare. Ato qëndrojnë lart me madhështi dhe krenari. Janë të stolisura me yje që shndrisin me dy apo tri rende dritash. Ishin të rrethuara me kopshte të bukura, të cilat shtrihen në drejtim të Bosforit. Ai duket i errësuar sikur nata pa yje. Nga pallati i sulltanit nuk shihej asnjë dritë në afërsi të bregdetit. Por, aty gjendej një shpatë prej zjarri, e cila lëshonte rrezet e saj mbi sipërfaqen e ujit që datonte nga fundi i shekullit të art të Perandorisë. Mbi sipërfaqen e detit qëndronin barka të bukura të vogla të panumërta. Ishin të zbukuruara me llamba ngjyrash të ndryshme: të kuqe, të gjelbërta, të kaltra. Dukeshin sikur të ishin flutura që ndriçonin në mes dy kontinenteve.

Të gjitha anijet e mëdha të flotës ishin radhitur në një radhë. Mbi të cilat ndriçonin llamba të mëdha. Çdo anie, çdo lundër, por çdo barkë dhe çdo litar mund të shiheshin në mënyrë të qartë. Stambolli dhe Yskydari dukeshin sikur të ishin kapur njëri me tjetrin me rreze drite, që buronin nga sipërfaqja e ujit. Qyteti dukej mitik, si kur të ishte i magjepsur. Ishin dy vende, të cilat i kishte mbuluar errësira enigmatike: Në Azi një vend pas Yskydarit. Në Evropë parku i Sarajeve. Ato i kishin rënduar nata dhe ëndrrat. Shehidët trima ëndërronin për hyritë e xhenetit. Parku ëndërronte për bukuroshet e tokës që janë të ngjashme me hyritë.

Rrugët ishin përplot me grekë, çifutë e evropianë. Secili prej tyre mbante në dorë kandilin e tij. Ishte një karvan oriental i bukur dhe i mrekullueshëm. Rrobat ishin të bukura, elegante, ngjyrash të ndryshme. Shumë më të bukura se rrobat që vishen në natën e fundit të festi-

valit të Romës në Itali. Portat e ambasadave ishin me drita të ndezura në formë të piramidave të Xhizes, apo në formë të shkronjës M, shkronjës së parë të emrit MUHAMED, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të.

Në ora nëntë fiks u hodhën gjylet e topave nga të gjitha anijet. Sikur ato të ishin murmurima. Nga ushtrimi e tyre u trandën të gjitha dritaret. Ky ishte shenjë i lajmërimit të lindjes së profetit Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të.

- 4 -

Gjatë murmurimës së topave m'u duk sikur unë u zgjova shumë herët nga kjo zhurmë. Muzika, sapo kishte filluar të dëgjohet nëpër rrugë. Njerëzit sapo kishin filluar të ecnin mes xhamisë së Sulltan Ahmedit dhe Sarajeve, duke pyetur se a do të jetë sulltani në krye të karvanit.

Konsulli i Danimarkës, Rumanisë dhe i Italisë erdhën të më kërkonin. Para nesh kaloi një turk që në duar mbante një kuti cigaresh. Pastaj erdhi një ermen me një palltë të kaltër të mbyllët, në kokën e tij mbante një kapuç. Vazhduam ecjen tanë në rrugën kryesore, në drejtim të Gallatës. Shërbëtorët hipën në një barkë. Ne zbritëm në një barkë tjetër. Filluam të lundrojmë në gjiri në mesin e mijëra barkave. Udhëtarët bërtitnin para atyre që ishin në barka tjera. Këta po ashtu bërtitnin nga frika se mund të ndeshen anijet. Në lima të Konstantinopolit duhej të kërcenim të zbritnim në bregdet. Aty ishte një numër shumë madh njerëzish. Nuk kishte vend të mjaftueshëm për të gjithë. Me ne erdhi një karvan i madh i grave të mbuluara derisa arritëm te muret e Sarajeve të larta. Ato dukeshin sikur të ishin mure të larta të një kështjelle të vjetër. Aty- këtu gjendej ndonjë pìrg i lartë me ndonjë derë të vogël, e cila nuk është hapur që një kohë të gjatë. Barërishta të gjata ishin varur rreth tyre. Drunjtë e vjetër ishin radhitur njëri pas tjetrit, kurse degët e tyre ishin shtrirë mbi mure. Njeriu mendon sikur është në mes të një mali.

Zgjedhëm një vend mu përballë xhamisë së Aja Sofisë, e cila me kupolat dhe minaret e saj dukej sikur të ishte një lule e madhe. Korridoret ishin mbushur plot me gra turke. Shamitë e bardha shndrisnin në fytyrat e tyre, duke ua shtuar bukurinë. Panorama më e bukur qëndronte në fontanën e madhe që ishte prapa nesh. Fontana sipas asaj që ne e parafytyrojmë është nga një qeshmë e lartë, nga e cila rrjedh uji. Fontana turke dallon nga kjo. Mund ta parafytyrosh një shtëpi katërkëndëshe. Muret e së cilës rrezatojnë ngjyra të ndryshme. Pas tyre një hapësirë e bardhë ku janë të shkruar disa ajete të Kur'anit me shkronja të bukura me ngjyrë të kuqe dhe të kaltër.

- 5 -

Aty janë disa qeshmë të cilat myslimanët i përdorin për të marrë abdes para se të falen në kohë të caktuara gjatë ditës dhe natës. Plafoni është i ngjyrosur me ngjyra të ndryshme

Pëllumbi, i cili kishte strofullin e tij aty fluturonte pa ndalur mbi kokat tona, duke shkuar mes fontanës dhe Aja Sofisë.

Përreth nesh kishte një numër të madh të kafeve turke. Të gjitha ishin të ndërtuara prej drurit. Ballkonet e të cilave u përngjanin shumë kapsollave zvicerane. Para tyre ishin të mbjella disa pemë. Përngjanin në kopshte, ku uleshin turqit për të pirë kafe dhe duhan. Kafet ishin të ndriçuara me fenerë. Njerëzit që qëndronin aty disa mbanin në kokë shall e disa fesa. Në hapësirën midis fontanes dhe portës së lartë e cila çonte për në hyrje të Sarajeve ishin dy bina. Ato ishin të vendosura mbi karrige. Njëra prej tyre ishte më e lartë. Aty ulej një grua turke me një pamje të thjeshtë prej klasës së ulët lexonte disa ajete të Kur'anit. Aty kishte turq, persianë, kurse evropianët ishin më pak. Në binën e poshtme kishte gra që nuk i kishin fytyrat të mbuluara.

Në ato momente u paraqitën disa ushtarë turq me uniforma evropiane. Kishin veshur pantallona të ngushta dhe setra të ngjitura për trupin. Në kraharor bartnin rripa të bardhë dhe të gjerë, ndërsa në kokat e tyre kishin fesa. Këta si duket ishin garda mbretërore. Disa ushtarë ishin esmera. Rrobat e tyre zyrtare ishin të bardha. Ata i shoqëronin

ushtarë të zinj si thëngjilli. Të gjithë ishin së bashku. Disa prej tyre çalonin. Dikush më tha se ata i kishin shqyer pantallonat e tyre te gju-njët që të mund të lëviznin lirshëm. Vazhduan në një rresht të gjatë. Ishte për t'u habitur se në mesin e tyre kishte edhe të atillë që ishin zbathur. Disa kishin mbathur vetëm një këpucë. Kishte dhe të atillë që kishin mbathur sandale me ngjyra të ndryshme. Në përcjellje të muzikës ushtarake, me hapa që shkonin paralel me tingujt e muzikës ushtarake shkuan në drejtim të sheshit. Kur arritën para sulltanit u ndanë në dy tabore. Secili prej tyre shkoi në drejtimin e vet. Etiopianët dhe bullgarët qëndruan njëri pranë tjetrit. Aty pranë tyre ishin disa barinj që kishin ardhur nga vendet e Ballkanit. Në momentin kur ora ra njëmbëdhjetë të rëna filloi përcjellja. Kur akrepat e orës iu afruan dymbëdhjetës, sulltani vërejti si ishte koha për të shkuar. Dielli po rrezonte me rrezet e tij të nxehta. Bina në të cilën ishin vendosur gratë turke nga pesha e rëndë ra poshtë, duke krijuar rrëmujë. Për pak kohë mbretëroi një lloj heshtjeje dhe qetësie. Disa të rinj që dinin pak fjalë të gjuhës frënge dhe italiane zgjuan interesimin tonë, duke na shpjeguar disa gjëra që neve na interesonin. Aty nën ne po flinte në qetësi deti Marmara. Atë e kishin mbuluar barkat dhe anijet e shumta, të cilat shndrisnin nën rrezet e diellit. Pas tyre qëndronin malet e Azisë, majet e larta të të cilave i mbulonte bora. Pas tyre dukej qielli i kaltër dhe i gjelbër. Nuk më kishte ndodhur asnjëherë në jetën time që të shoh ndonjë pamje më magjepsë se kjo. Ngjyrat e tij ishin përzier. Një i ri turk, që kishte lindur në brigjet e Eufratit, në Irak, m'u afrua e më tha: "Nga një herë qielli anon kah ngjyra e gjelbër".

Rastësisht u dëgjuan të shtëna topi:

-6-

Kjo të jepte të kuptosh se përcjellja kishte filluar. Në krye ishte trupa muzikore ushtarake e kalorësisë. Tupaxhinjtë dhe muzikantët ishin hipur në kuaj. Kalorësi i fundit kishte lëshuar frerët para duarve dhe po kërcente në qafën e kalit. Ai i mëshonte zengjine njërenë me tjetrën. Ato shndrisnin në dritën e diellit. Pastaj u paraqit garda e sulltanit. Ishin ngjitur njëri për tjetrin sikur të ishin një trup i vetëm. Pas tyre erdhi një grup kuajsh të stolitur me xhevahire. Këta kuaj filluan të vallëzonin me këmbët e tyre të para të bukura, duke lëvizur kokën bashkë me jelët. Hundët e tyre dridheshin sikur të ishin gjethe të pemëve. Sytë e tyre shndrisnin sikur xixëllonjat.

Pastaj erdhën oficerët të rinj me rroba evropiane. Ata ishin hipur në kuaj. Në kokë mbanin fesa. Ata i përcillnin nëpunës civilë dhe ushtarakë. Pastaj u paraqit një njeri i shtyrë në moshë, me një mjekër të gjatë e të thinjur. Në vende të ndryshme ishin vendosur trupa muzikore. Njëra prej tyre vallëzonte muzikën Vileim Tel e kompozuar nga Rusto. Papritmas muzika u ndërpre dhe filloi himni, të cilin e preferon sulltani i ri mbi çdo gjë tjetër. Ky himn ishte përpiluar nga vëllai i tij Venozin, i cili ishte zgjedhur komandant e trupës muzikore ushtarake.

Më në fund erdhi sulltani, të cilit i parapriu një grup kuajsh autoktonë arabë. U duk sulltan Abdulmexhidi. Ishte në moshën 19-vjeçare. I dobët, me fytyrë të zbehtë. Kishte veshur një palltë me ngjyrë të gjelbër me pulla në kraharor. Veshët e kalit të tij ishin stolitur me margaritarë. Mbi shpinën e tij kishte një shalë nga Maroku, e stolitur me gurë të çmueshëm. Ashtu ishte edhe freri. Më dukej sikur në të ishim para një llambe, të cilën e kishte punuar Alaeddin. Ishim të rrethuar nga të rinjtë, të cilët na kishin mahnitur me bukurinë e tyre të rrallë. Në veçanti disa gra turke me shamitë e tyre që kishin hipur në kuajt arabë autoktonë.

- 7 -

Sulltani nuk ishte stolitur me margaritarë. Ai kishte vetëm një diamant të madh, rreth të cilit përhapeshin pendlat e shpendit të xhenetit, të vendosura mbi fesin e tij. Shikimin e kishte përqendruar në popull. Në veçanti në drejtim të evropianëve. Ne i ngritëm kapelat tona, duke i përlulur kokat në shenjë respekti dhe nderimi. Ushtarët bërtitën:

Rroftë perandori!

Por, ai si duket nuk tregoi interesim për përshëndetjen tonë.

Pyeta një djalosh turk që ishte pranë meje:

Përse nuk na ktheu përshëndetjen tonë? Me siguri ai na ka parë duke ia hequr kapelat tona?

Djaloshi u përgjigj: Të shikoi ty. Shikimin e përqendroi te ti. Ne duhej t'i bindemi kësaj. Nuk lakmonim diçka më shumë. I thash turkut.

Të gjithë princat evropianë kur ne ua heqim kapelën, ata na përshëndesin. Si duket turku e kuptoi.

Pastaj e arritën disa pashallarë si dhe disa nëpunës evropianë që punonin tek ata.

Pas tyre erdhën shërbëtorët: burra e gra në fund të karvanit. Shtyheshin sa mundeshin dhe ata ishin gjysmëlakuriqë. Në koka kishin shall me ngjyra si dhe lypsa plaka me shami të shqyera. Ishin të veshura me dimi me ngjyra. Ato shkaktuan një zhurmë të madhe. Kur policia u përpoq t'i largojë nisën të bërtasin.

Allahu është më i madhi. Lavdi i qoftë Zotit të madhërisëm.

Rruga dukej si të ishte një lumë me ngjyra të ndryshme, nga shallat, fesat si dhe mbulesat e kokave shumëngjyrëshe. Kurdo që evropianët donin ta kalonin këtë tollovi, policët nxitonin t'u ndihmonin për hapjen e rrugës para tyre me kujdes, duke i shtyrë bashkëqytetarët e tyre, të cilët dëshironin t'i hidhnin një shikim këtyre të huajve. Ata bërtitnin me zë të lartë:

Allahu është më i madhi!

*Përshtati dhe përktheu:
Qemajl Morina*

Hans Christian Anderson - (Denmark)

A DANISH STORY ON THE BIRTHDAY OF PROPHET MOHAMMED

This is a beautiful story about the prophet of Islam. Hans Christian Andersen, one of the most distinguished Danish writers, is its author. Through this story the writer proves that he respects the followers of other religions despite the fact that he himself is a Christian. He claims that all the monotheistic religions call upon their followers not to be narrow-hearted and not to hate each other just because their faiths are different.

In Islam, the above-mentioned is manifested in a very clear manner: "There can be no coercion in religion". "You have your religion and I have mine".

This is the tolerance, which should be shown by those who believe in God. Each one should pray to his/her God in his/her own way (in a mosque, church or synagogue).

هانس كريستيان أندرسون

قصة دانماركية عن مولد النبي (صلعم)

(خلاصة البحث)

هذه قصة جميلة عن نبي الاسلام و مولفها هانس كريستيان أندرسون أحد أشهر كتاب دانمارك. و بهذه القصة الجميلة هو يريد أن يقول بأنه يحترم اصحاب الديانات الاخرى، و مع أنه مسيحي و أحسن دليل على ذلك هو اسمه. هو يقول بان جميع الديانات السماوية تدعو اصحابها لكي لا يكونوا ضيقوا الصدر و ان لا يكرهوا بعضهم بعضا فقط لأنهم يؤمنون بالله بطريقة مختلفة. و السلام يدعو إلى ذلك بمنتهى الصراحة عندما يقول: "لا أكره في الدين" و لكم دينكم و لي دين".

و هكذا يجب أن يكون التسامح لكل هؤلاء الذين يعبدون الله حق عبادة، الكل بطريقته، في الجامع و في الكنيسة و في الكنيس.

QASJE

Muhamed Esad

A ËSHTË RELIGJIONI ÇËSHTJE E SË KALUARËS?

Gjatë mijëra vjetëve, nga fillet e turbullta më të hershme të vetëdijes njerëzore – religjioni ka qenë forcë e fuqishme, e cila i ka tërhequr njerëzimin përpara kah ndonjë qëllim i panjohur.

Ai nuk ka qenë forcë e vetme lëvizëse. Uria ka qenë e dyta, kurse ambiciet njerëzore e treta. Por, gjatë historisë religjioni gjithmonë ka qenë në krye, në të mirën ose në të keqen. Në emër të tij janë krijuar mbretëri dhe kanë lindur kombe edhe mbretëritë janë shkatërruar dhe kombet janë tretur. Fjala e tij magjike i ka ngritur njerëzit në lartësitë më madhështore të dashurisë dhe vetëflijimit – kurse të tjerët për shkak të tij kanë bërë vepra më të urryera tiranike. Ai (religjioni) i ka dhënë gëzim jetësor shumkujt, - kurse të tjerët i ka shtyrë ta urrejnë jetën si mashtrim të kotë. Disa i ka mbushur me zjarrin krijues dhe u ka dhënë forcë për të realizuar vepra të paharrueshme kulturore- kurse disa tjerë i ka shpënë në bestytëni, errësirë dhe në marrëzi. Por, të gjithëve të cilët e kanë ndjekur sinqerisht në format e këtilla apo të atilla të tij, religjioni në një mënyrë iu ka dhënë lumturi. Prandaj, përkundër dallimeve të mëdha evidente dhe të vështira në bindjet dhe pikëpamjet e ndryshme religjioze, diçka duhet të ketë qenë, ose duhet të

jetë, e përbashkët për të gjitha ato. Ajo “diçka” duhet të jetë shumë e rëndësishme: ngase ka dhënë dhe jep lumturi.

Është e qartë se ajo “diçka” është bindja religjioze e njeriut që është në përputhshmëri me atë që e përshkruan metafizika si realitet të skajshëm ose absolut. Çfarëdo qofshin qëndrimet themelore të ndonjë religjioni – sado që të jetë mësimi i tij i lartë ose primitiv – qoftë ai monoteist, politeist apo panteist – thelbi më sekret i çdo përjetimi religjioz, së pari është bindja se çdo gjë që ekziston, e ndodh në këtë botë e ka pikënisjen e saj në Fuqinë e vetëdijshme, krijuese, gjithëpërfshirëse – ose ta shprehim më thjesht: në vullnetin e Zotit, dhe e dyta ndjenja që jemi ose që dëshirojmë të jemi në përputhjen shpirtërore me kërkesat e atij Vullneti. Vetëm me këtë bindje, ndjenjë dhe dëshirë ka qenë edhe e bazuar aftësia njerëzore për të vendosur ndërmjet të mirës dhe të keqes. Sepse, nëse nuk supozojmë se në rrënjë të krijimit të gjithmbarshëm ekziston Vullneti i menduar absolut, nuk ka kurrfarë kuptimi të supozohet që ndonjë nga qëllimet dhe veprat tona të mund të jetë në esencë e drejtë ose e gabuar, e moralshme ose e amoralshme, me fjalë tjera nëse nuk besojmë se ekziston një vullnet i menduar i tillë, ne nuk kemi standarde me të cilët do t’i vlerësonim qëllimet dhe veprat tona. Në mungesë të besimit, kuptimi i morales e humb precizitetin e vet dhe shkrihet së pari në një varg konceptesh të mjegullta – të cilat prapë do t’i nënshtrohen gjithnjë e më shumë pyetjeve se a është ndonjë qëllim ose vepër e dobishme për personin e caktuar (ose shoqërinë së cilës i takon personi) apo jo. Sipas kësaj, drejt ose gabim bëhen plotësisht shprehje relative, të cilat duhet çfarëdo qofshin të shpjegohen në përputhje me nevojat personale (ose shoqërore) të dikujt dhe në përputhje me kërkesat e ndryshuara të kohës dhe të vendit. Këto mendime mbi rolin e kuptimit religjioz në fushën e moralit e fitojnë rëndësinë më të lartë, nëse vëmë re se rrjedhat e kohës sonë janë qartë në kundërshtim me mendimin religjioz.

Disa intelektualë tani na paraqiten me tezat e tyre se religjioni është vetëm mbetje e së kaluarës së njeriut, i cili duhet të zëvendësohet me “shekullin e shkencës”. Ata thonë shkenca po e merr vendin e sistemit të tejkaluar të religjionit, shkenca e cila po përparon në më-

nyrë kaq madhështore e të pakundërshtueshme do ta mësojë njeriun të jetojë në përputhje me mendjen e pastër dhe përfundimisht do t'i ndihmojë për të zhvilluar standardet e reja të moralit pa kurrfarë paragjykimi metafizik.

Ky optimizëm naiv në lidhje me shkencën, në realitet nuk është krejtësisht “modern” ai është shumë modë e vjetër – me fjalë tjera kopje jokritike e optimizmit naiv perëndimor të shekullit 18-të dhe 19-të. Në atë kohë (e posaçërisht në pjesën e dytë të shekullit 19-të) shumë shkencëtarë të Perëndimit besonin se vërtet zgjidhja e fshehtësive të gjithësisë është si “përtej qoshes” dhe se në ardhmëri asgjë nuk do ta ndalë njeriun për ta rregulluar jetën e tij në mënyrë të pavarur e të arsyeshme ngjashëm me Zotin. Ndërkaq, shkencëtarët e shekullit 20-të janë shumë më tepër të rezervuar, për të mos thënë skeptikë në këtë çështje. Ata kanë konstatuar se shkenca deterministe nuk është në gjendje t'i plotësojë shpresat shpirtërore lidhur me të, sepse fshehtësitë e gjithësisë, sa më tepër që përparojmë në hulumtimet tona, ato gjithnjë bëhen më të fshehta dhe më të komplikuar. Për çdo ditë është duke u bërë gjithnjë më e qartë se kurrë nuk do të jetë e mundshme për t'u përgjigjur, me mjete të pastra shkencore në pyetjen: Si është krijuar gjithësia dhe si ka filluar jeta në të? Mandej as në pyetjen për natyrën e vërtetë dhe qëllimin e ekzistencës njerëzore. Andaj, derisa të mos jemi në gjendje të përgjigjemi në pyetjen e fundit, nuk mund të provojmë as për ta definuar “të mirën” e “të keqen”, thjesht për shkak se këto shprehje nuk kanë fare kuptim, nëse nuk janë të lidhura për njohjen (e vërtetë ose të imagjinuar) të natyrës dhe qëllimit të ekzistencës njerëzore. E derisa nuk jemi në gjendje ta definojmë “të mirën” e “të keqen” s'ka kuptim të flitet për standardet e moralit.

Kjo pikërisht është ajo që në realitet shkencëtarët përparimtarë kanë filluar ta kuptojnë. Duke u ballafaquar me pamundësinë e zgjidhjes së çështjeve metafizike me anë të hulumtimeve fizike ata kanë hedhur poshtë shprehinë fëmijërore të dy shekujve të kaluar që shkenca ndonjëherë mund të ofrojë ndonjë direktivë në fushën e etikës. Jo që ata e kanë humbur besimin në shkencë si të tillë, përkundrazi ata besojnë fort se ajo do t'i prijë njerëzimit në çudirat gjithnjë më të mëdha të di-

turisë dhe realizimeve, por në të njëjtën kohë ata kuptojnë se shkenca nuk ka lidhje direkt me jetën morale njerëzore. Shkenca mund dhe vërtet na shpie në të kuptuarit më mirë të botës rreth nesh dhe në ne, por pasi që merret vetëm me vështrimin e fakteve të natyrës dhe me analizën e ligjeve, të cilat duken se qëndrojnë në marrëdhënie reciproke të fakteve të tilla, shkenca nuk mund të jetë e thirrur që të marrë vendim për qëllimin, nëse ekziston, të jetës njerëzore dhe kështu të krijojë ndjenjën morale te ne. Kurrfarë entuziazmi për mendimin shkencor nuk mund ta fshehtë faktorin se problemi i moralit nuk është në fushëveprimin e shkencës. Nga ana tjetër, ai është në fushën e religjionit.

Vetëm me përvojën religjioze mund të vijmë – drejt ose gabimisht – deri te shëmbëlltyrat e moralit dhe te vlerat e etikës, pavarësisht nga ndryshimet kalimtare në rrethinën tonë dhe deri te pranimi i të mirës morale të vlefshme që për të të luftohet dhe të keqes morale të cilës duhet shmangur. Kam thënë “drejt ose gabueshëm” ngase sipas të gjitha ligjeve objektive ekziston gjithmonë mundësia që religjioni të gabojë në pikëpamjet e tij metafizike, prandaj pranimi ose refuzimi ynë (pikëpamjeve) të cilitdo religjion, në instancën e fundit, duhet të udhëhiqet nga përvoja dhe mendja, të cilat na tregojnë deri ku një religjion përputhet me nevojat themelore fizike dhe shpirtërore të njeriut. Por, kjo nevojë e shfaqjes së aftësive tona kritike në raport me religjionin, nuk zbret asgjë nga qëndrimi themelor se vetëm religjioni mund t'i japë kuptim jetës sonë dhe për këtë të lëviz tek ne dëshirën që t'i përputhim sjelljet tona me shembujt e vlerave morale, plotësisht të pavarura nga ndikimet e rrethit të ekzistencës sonë. Për ta shprehur këtë më ndryshe: Religjioni është i vetmi i cili mund t'i ofrojë platformë të gjerë grupeve të mëdha të njerëzve për të rënë në ujdi se çka është mirë (e dëshirueshme) dhe çka është keq (e urryer). E a mund të ketë çfarëdo dyshimi që një ujdë i tillë është kërkesë absolute, e domosdoshme për çfarëdo lloj rendi, në marrëdhëniet njerëzore. Shikuar nga kjo pikëpamje, dëshira religjioze (në kuptimin më të gjerë) nuk është vetëm fazë kalimtare në historinë e zhvillimit njerëzor, por burim themelor i etikës dhe moralit. Jo pasojë e besimit të lehtë, i cili mund të “rrjedhë” në cilëndo kohë – por e vetmja përgjigje në nevojën e vër-

tetë themelore të njeriut në të gjitha kohët edhe në të gjitha rrethanat. Me fjalë të tjera, ajo është një dëshirë origjinale.

Religjioni sot

Krahas tërë kësaj, nuk mund t'i iket faktit se bindja religjioze në kohën tonë është në rënie të theksuar, jo pse është “prishur” natyra e njeriut, se ajo në esencë është e njëjtë, e mirë ose e keqe, siç ka qenë gjithmonë – e përshtatshme për t'u ngritur deri në lartësitë më të mëdha të altruizmit dhe idealizmit ose për të zbritur në humnerat më të thella të mizorisë dhe lakmisë. As që ka ndonjë shenjë që njeriu e ka humbur dëshirën e tij instiktive për ta përputhur jetën e tij individuale me interesat e gjerë shpirtërore, të cilat i tejkalojnë interesat materiale të ekzistencës së tij personale, përndryshe çfarë shpjegimi tjetër do të kishte për zjarrin e gjysmëreligjiozes në të cilin prehen lëvizjet e ndryshme moderne sociale dhe nacionale? Atëherë pasi që këto lëvizje janë me mangësi të zëvendësimit nga religjioni në kuptimin e tyre të vërtetë aspak nuk e demanton vërtetimin tonë se njeriu modern ndien nevojë për religjion ashtu siç kanë ndier mijëra gjenerata para tij. Por ai zgjerohet për zëvendësim pasi që gjëja kryesore i është shkurtuar. Për këtë shkak “njeriu” zyrtar i religjionit – mjerueshëm ka dështuar në detyrën e tij themelore për t'i treguar njeriut se si ta rregullojë anën praktike të jetës së vet në përputhje me thirrjen e moralit religjioz dhe për këtë shkak shumë besimeve religjioze konvencionale problemet dhe mjerimet e jetës së sotshme janë bërë të huaja. E pasi që nga pikëpamja shoqërore dhe ekonomike, koha e jonë është në esencë kohë e hutisë, dështimi i udhëheqësve religjiozë për të na udhëhequr në çështjet e jetës tonë është i përcjellë me pasoja të vërteta katastrofale.

Falë zhvillimit të shpejtë shkencor dhe zbatimit praktik të tij në industri, komunikacion, luftë, në kushtet e punës etj., sistemi konvencional i bashkëpunimit shoqëror është rregulluar gjithkund në botë.

Problemet më themelore të jetës: ushqimi dhe veshmbathja, varfëria e siguria, puna dhe edukimi, janë bërë ashtu të komplikuar sa që sot paraqesin probleme të ngatërruara reale në kuptimin e plo-

të të fjalës. Jo pse dikur ka qenë periudha kur këto gjëra kanë qenë më pak të rëndësishme sesa që janë sot. Njerëzit gjithmonë kanë pasur nevojë për ushqim dhe veshmbathje, varfëria gjithmonë ka qenë e hidhur dhe brengë, kurse siguria gjithmonë ka qenë synim, por në periudhat e mëhershme kur shoqëria ende nuk e ka pasur kompleksitetin e sotëm, të gjitha problemet e tilla, relativisht kanë pasur zgjidhje të lehtë dhe për këtë nuk e kanë preokupuar mendjen njerëzore dëshpërueshëm si sot. Shkenca me përparimin e saj të hatashëm në periudhën e re, plotësisht i ka ndryshuar kushtet e ekzistencës sonë. Ajo ka hapur horizonte të reja – me të gjitha komplikimet përcjellëse – gati në të gjitha degët e aktivitetit njerëzor. Ajo ka mundësuar shumë gjëra (disa prej tyre krijuese dhe plot premtime për ardhmëri e disa prej tyre shkatërruese e tmerruese) për të cilat gjeneratat e mëhershme nuk kanë mundur as të ëndërrojnë, pikërisht për shkak se për këto gjëra as që është ëndërruar, shumica e njerëzve nuk kanë qenë të përgatitur në mënyrë adekuate, as në pikëpamje morale as intelektuale, për të – kështu që tani nuk kemi as teknikën e nevojshme ekonomike as pjekurinë etike, e cila do të mund të përballet në mënyrë adekuate me situatën e re. Intensiteti i hulumtimeve njerëzore i rrugëve të reja dhe i mjeteve që të zgjidhet ky çrregullim, manifestohet në pasqyrimin e shtimit të ideologjive sociale, të cilat sot luftojnë për mbisundim, kërkesat e tyre thellësisht kundërthënëse na shpien në atë që vetë themeli i mendimit tonë konvencional – besimi në stabilitetin e formave tona shoqërore dhe raportet e njeriut ndaj njeriut – plotësisht është thyer.

Kjo rrëmujë e pikëpamjeve ekonomiko-shoqërore, nuk ka mbetur – as që ka mundur të jetë – e kufizuar në anën e pastër materiale të punëve tona. Natyrisht rrëmuja e politikës dhe ekonomisë në botën bashkëkohore i ka dhënë shkas kritikizmit të gjerë të bindjeve etike dhe religjioze, në të cilin janë prekur politika dhe ekonomia e deritashme, sikurse udhëheqësit religjiozë që kanë qenë të mësuar që çdo koment ta konsiderojnë si të sigurt, kështu që pak kanë kontribuar në zgjidhjen e hutisë, me të cilën është sulmuar jeta moderne. Në këtë mënyrë, shqetësimi politik dhe socio-ekonomik i ditëve tona e ka

shkakun e tij dhe është i përcjellë me shqetësimin e thellë në planin etik.

Nuk është vështirë të shihet se çka është mirë ose keq në kuptimin relativ socio-ekonomik, por kjo është e lidhur ngushtë me çështjen se çka është mirë ose keq në kuptimin absolut shpirtëror. Pikërisht për këtë shkak shumëkush si në Lindje ashtu edhe në Perëndim ka filluar të ndjejë shqetësime, të cilat mund të jenë plotësisht të ngjashme me rrëmujën ekonomike dhe politike të ditëve tona. Janë shfaqur dyshime të thella në këtë se a mund të jenë të mjaftueshme vetëm rregullimi i sistemit ekonomik apo vetëm fitorja e kësaj ose asaj ideologjie politike, për ta zgjidhur kaosin politik të rendit. Ngadalë, po mbretëron mendimi dhe bindja se diçka larg më thellë sesa pikëpamjet politike dhe ekonomike përfundimisht është përgjegjës për shqetësimet e botës së sotme. Ajo “larg më thellë” është e qartë rrënimi i të gjitha standardeve të vlerave morale. Tani e kuptojmë se kriza e kohës sonë është krizë e ideve morale dhe etike.

Shumica e kuptimeve etike të cilat deri tani kanë qenë aktive në ndërtimin e raporteve njerëzore dhe ideja për të “mirën e përgjithshme” tani po kalojnë në provim të rëndë dhe për shumë nga ato është vërtetuar se nuk janë adekuat kërkesave të jetës bashkëkohore. Pasi që shumica e udhëheqësve fetarë në mbarë botën kanë qenë mësuar ta identifikojnë shoqërinë sunduese me vetë religjionin (dhe për këtë janë treguar plotësisht të pafuqishëm) në përpjekje reale për të udhëhequr me punët praktike të njerëzve me shekuj bindjet e vjetra religjioze janë lëkundur dhe sot gjithkund ato janë të pranishme. Shumë konventa shoqërore të cilat kanë qenë thjesht të lidhura me bindjet e tilla (prandaj janë konsideruar se janë ndërtuar në themele të përhershme) sot dukshëm thyhen, jo vetëm në këtë apo atë bashkësi por në të gjitha bashkësitë dhe në të gjitha pjesët e globit. Marrë në përgjithësi religjioni gjithkund është në tërheqje e zëvendësohet (në të shumtën në mënyrë joadekuate) me disa emocione dhe bindje të pavend – si ai entuziazmi fëmijëror për ardhjen e “shekullit të shkencës” – ose (më i rrezikshëm) me adhurimin pasionues të zotave të nacionalizmit. Siç është tashmë përmendur kulti i nacionalizmit – ashtu karakteristik për

kohën tonë – ka ton gati mistik, i cili me përngjashmërinë sipërfaqësore atë ia ofron religjionit, por në kundërshtim me religjionin, i cili fillon dhe përfundon me të kuptuarit e të mirës dhe të keqes absolute (qysh do që të mund të jetë i ndryshëm ky kuptim në secilin religjion) nacionalizmi mohon në esencën më të thellë të tij, ekzistimin e së mirës dhe të keqes absolute. Ai i pranon këto ide vetëm në kuptimin relativ, do të thotë në relacion me atë çka është ose duket se është, mirë ose keq për zhvillimin e ndonjë kombi, andaj ai rrënon vetë themelet e etikës dhe moralit.

Nga çfarëdo këndi që e vështrojmë këtë problem, nuk duhet të harrojmë se gjatë historisë njerëzore etika është nxjerrë drejtpërsëdrejti ose indirekt nga mendimi religjioz. Gjithnjë derisa nuk është zbuluar burimi alternativ i etikës, nuk ekziston as paralajmërimi më i afërt që etika joreligjioze fare të jetë e mundshme (sepse çfarëdo që sot të kalojë nën këtë emër, në realitet ajo është trashëgimi e nënvetëdijës së mendimit të kaluar religjioz). Por, pasi që nuk ka paralajmërim të tillë në intervalin kohor të jetës njerëzore, që dikur ka qenë i mbushur (dhe atë në mënyrë të kënaqshme) me bindjet dhe shpresat religjioze, tani po shndërrohet në zbrazëti, në të cilën mund të rritet vetëm mjerimi, mjerimi i patregueshëm për ardhmërinë e njeriut, për qëllimin dhe arsyetimin e jetës së tij, për atë se ekzistojnë vlera të tilla siç janë e mira dhe e keqja.

Religjioni në Perëndim

Hidhërimi i luftës, mizoria e pashpresë fizike e morale, e cila sot po e trondit njerëzimin – e diktuar kryesisht me frikë – me të cilën kombet ose grupet brenda kombeve luftojnë për pushtet, shkujdesja universale për të drejtat dhe drejtësinë, eksploatimi i pamëshirshëm i të dobëtëve nga ana e të fortëve dhe mosbesimi i të gjithëve ndaj të gjithëve, të gjitha këto janë vetëm simptome të çrregullimit etik, nga të cilat vuajnë shumica e njerëzimit modern – çrregullimi i cili në instancë të fundit është përgjegjës për të gjitha luftërat e konfliktet qytetare të kohës sonë dhe i cili shkakton mjerimin e patregueshëm të trupit

dhe të shpirtit te njerëzit e panumërt. Ndjenja e pasigurisë, jo vetëm sociale por edhe morale, ndjenja se ndodhitë tona lëvizin larg, si lumi i cili i ka përshkuar brigjet e tij në drejtimet e panjohura dhe të papapara, vazhdimisht është në rritje te njerëzit e vetëdijshëm në gjeneratën bashkëkohore.

Kjo vlen gjithashtu edhe për botën Islame. Ajo si të tjerët jeton midis vorbullës së përroit. Për të, si për të gjithë të tjerët, ka ardhur koha e trazimeve morale. Shoqëria e saj është në fermentim. Shumë nga bindjet e saj të çmueshme – disa prej tyre irelevante për jetën Islame por shumë të domosdoshme për të – tani tretën nën presionin e ndikimit kulturor të Perëndimit dhe nevojave ekonomike, të cilat rrjedhin nga nënshtrimi ndaj ndikimeve të tilla. Përkundër të gjitha parullave të hedhura në emër të Islamit në kohën tonë, përkundër entuziazmit të vet (i cili mbretëron sidomos në siudheshën pakistano-hinduse) për riorientimin e mendimit politik mysliman, në drejtimin islam: Përkundër tërë kësaj, mbetet fakti se te shumica e myslimanëve të sotëm, thirrja e religjionit gjithnjë më tepër po bëhet teorike dhe gjithnjë pak e më pak ka persona të gatshëm për t'i zbatuar parimet e Islamit në sjelljet e tyre personale dhe në angazhimet e tyre shoqërore. Pra, perëndimorët tanë “progresistë” madje nuk mundohen as ta mohojnë këtë. Shumë prej tyre me fytyrë të qeshur nga vetëkënaqësia, pranojnë se “fryma e kohës është kundër mendimit religjioz”. Kjo tani është plotësisht e vërtetë. Fryma e kohës është kundër mendimit religjioz – por kjo frymë ka lindur dhe është kultivuar në Perëndim dhe plotësisht pa lidhje me problemet Islame. Mbase nëse mendimtarët perëndimorë drejtohen kundër religjionit, mund t'i kuptojmë dhe t'i arsyetojnë në bazë të përvojave të tyre me botëkuptimet e tyre personale. Të kuptuarit islam të religjionit dhe përvojat myslimane me të janë të natyrës tjetër fare. Aq tjetër fare sa që vetëm shkurtpamësia e skajshme mund ta pengojë dikë për ta kuptuar se religjioni nuk është i diskredituar në vete, por vetëm forma e veçantë të cilën ai e ka marrë në Perëndim.

Çka është me Islamin?

Mirëpo siç thash, nëse mendimtarët perëndimorë kanë shumë arsye për të qenë të dëshpëruar me religjionin dhe të dyshimtë ndaj tij, mendimtarët myslimanë nuk kanë shkak të vlefshëm të tillë:

Së pari, Islami nuk njih kurrfarë ndarje të jetës njerëzore në pjesën “fizike” dhe “spirituale” dhe nuk e ka kufizuar kur religjionin në vetëm kultin spiritual. Sistemi të cilin Pejgamberi e shpalli në 23 vjet të peygamberisë së tij, ka të bëjë jo vetëm me çështjet spirituale dhe është orientuar jo vetëm në pastërtinë individuale, por gjithashtu ofron bazat për të gjitha aktivitetet tona individuale dhe shoqërore. Ai e përfshin jetën me të gjitha aspektet e saj: morale e fizike, individuale e shoqërore, problemet e trupit dhe të shpirtit, seksit dhe ekonomisë, moralit dhe estetikës – krahas me problemet e shërbimit hyjnor dhe të teologjisë – e kanë vendin e tyre legjitim në mësimet e Pejgamberit a.s. Ai neve na ka ofruar vizionin e shoqërisë së drejtë dhe tipin e njeriut të tillë, i cili e përfaqëson atë shoqëri. Na është dhënë skica themelore e strukturës politike – vetëm skica për shkak se detajet e nevojave ekonomike e politike njerëzore janë të lidhura me kohën dhe të ndryshueshme – si dhe skica e të drejtave personale dhe obligimeve shoqërore, në të cilën janë paraparë ashtu si duhet të gjitha mundësitë e zhvillimit historik. Dhe siç nuk ka ndarje të realitetit në pjesën “fizike” dhe “spirituale”, nuk ka as mundësi të ndahet në fushën “natyrore” dhe “mbinatyrore”. Për myslimanin çdo gjë që ekziston ose ndodh, është brenda sferës natyrore, ngase natyra është shuma e përgjithshme e krijesave të dukshme e të padukshme, konkrete dhe abstrakte, kurse ligjet e ashtuquajtura natyrore janë vetëm rrugë me të cilat manifestohet vullneti i Zotit. Në një përshkrim të tillë të gjërave nuk mund të ketë konflikt mes pikëpamjeve morale dhe fizike të ekzistencës njerëzore, ato janë të pandashme dhe për këtë njësoj të “justifikueshme”.

E dyta, rolin e diskredituesit të cilin religjioni aq shpesh e ka luajtur në historinë e Evropës, kurrë nuk ka pasur rast të ngjashëm në historinë Islame. Gati, pa asnjë përjashtim eksponentët e mëdhenj të teologjisë dhe të drejtësisë Islame kanë qenë mbrojtësit më xheloz të drejtave njerëzore. Pikërisht ata gjithmonë janë ngritur – shpeshherë me çmim të sakrificave të mëdha personale e nganjëherë madje edhe me martirizim – kundër tiranisë dhe shtypjes dhe në atë mënyrë kanë vendosur pengesën më të madhe dëshirës tiranike të pushtetmbajtësve. Vetëm autoritetit të ylemave të tillë në të kaluarën dhe religjionit i cili i ka frymëzuar ata duhet falënderuar që popujt myslimanë kanë qenë të mbrojtur nga jonjerëzorja dhe mjerimi, që kanë qenë fati i njerëzve të thjeshtë gjatë shumë shekujve në Evropë.

E treta, derisa në Perëndim, gjithmonë ka ekzistuar konflikti mes religjionit dhe shkencës – në një anë i manifestuar në dogmat fantastike irracionale, e nga ana tjetër me ndjekjen barbare të mendimit shkencor dhe të shkencëtarëve nga ana e religjionit deri në kohën moderne – nuk jemi në gjendje për të zbuluar as gjurmën më të vogël të konfliktit mes Islamit dhe shkencës, si në vetë mësimet ashtu në qëndrimin e ylemave myslimanë ndaj shkencëtarëve. Islami jo vetëm që nuk e ka kundërshtuar kurrë shkencën, por ai madje ka bartur në shkencë dhe në punën intelektuale në përgjithësi diç nga shenjtëria e shërbimit hyjnor. Në kontrastin e qartë me faktin historik për djegien dhe torturimin e shkencëtarëve, shkatërrimin e pamëshirshëm të aq veprave shkencore, shtrëngimin e mendimit të pavarur në çdo lëmi të jetës – në kontrast me këto fakte të tmerrshme, historia nuk afron as një të vetmin shembull që ndonjë shkencëtar (çfarëdo qoftë) të ketë qenë i ndjekur nën drejtimin mysliman, për shkak të zbulimeve të tij. Ndjekje të teologëve ka pasur (tentim të presionit të kohëpaskohshëm në njerëzit të cilët ishin shmangur nga teologjia e atëhershme tradicionale) por ndjekje të shkencëtarëve asnjëherë për shkak se Islami ka mbjellë te pasuesit e vet respektin më të madh ndaj mësimin dhe ka bërë “kërkimin e diturisë detyrë të shenjtë për çdo mysliman”. Prandaj nuk është rastësi që shumë pionierë të shkencës myslimane, emrat e të cilëve janë bërë fjalë të përditshme në tërë botën, kanë qenë në të

njëjtën kohë edhe teologë të përmendur. Ka mjaftuar t’ia kthejnë sytë e tyre Kur’anit dhe Syneetit, dhe ta gjejnë se përvetësimi i njohurive shkencore faktikisht është madhërim i Zotit të tyre. Kur e lexojnë thënien e Pejgamberit “Zoti nuk krijon kurrfarë sëmundje dhe në të njëjtën kohë të mos e krijojë edhe ilaçin por të “ata e kuptojnë se me hulumtimin e ilaçeve të panjohura, do t’i kontribuojnë plotësisht të vullnetit të Zotit, andaj hulumtimet medicinale janë veshur me detyrën e shenjtë religjioze. Me leximin e ajetit: “Kemi krijuar nga uji çdo gjë të gjallë” (21/30) dhe në përpjekjet e tyre për të depërtuar në thellësi të këtyre fjalëve, ata kanë filluar t’i studiojnë organizmat e gjallë – dhe kanë themeluar shkencën e biologjisë. Kur’ani ka treguar për harmonin e yjeve dhe lëvizjet e tyre si argument i madhërimin të Krijuesit të tyre – dhe për këtë myslimanët e kanë marrë me entuziazëm astronominë dhe matematikën, të cilat në religjionet tjera gjenden vetëm në lutje. Në të njëjtën mënyrë ata i janë qasur filozofisë, teologjisë dhe të gjitha shkencave, në të cilat gjeniu mysliman i ka lënë monumentet më të përhershme të tij.

Në ato kohë të largëta, çdo mysliman ka qenë i mësuar në pikëpamjen se “dijetari shkon rrugës së Zotit” sa bukur është shprehur Pejgamberi ynë. Të panumërta janë rastet e nderimit më të lartë, të cilin e kanë treguar sunduesit e myslimanëve dhe shoqëria myslimane ndaj hulumtuesve të vërtetës shkencore si dhe u është ofruar shtytja më e madhe praktike hulumtimeve shkencore. Gjatë tërë periudhës krijuese të historisë Islame – do të thotë gjatë kohës së pesë shekujve të parë pas Hixhretit – shkencën nuk ka pasur mbrojtës më të madh se civilizimi mysliman, as vend më të sigurt se tokat në të cilat Islami ka qenë në pushtet. Me një fjalë pikërisht Islami u ka dhënë shtytje të arritura kulturore, të cilat paraqesin një rëndësi ndërfaqet më të lavidshme të historisë së njerëzimit, ai ka dhënë shtytje duke thënë: “Po” jetës – e “Jo” asketizmit, “Po” mendjes, - e “Jo” prapambeturisë, “Po” aksionit, e “Jo” ndejës qetë.

Analiza e një kundërshtimi

Të shohin tani se si mendimtarët perëndimorë formojnë kundërshtimin modern të religjionit.

“Duhet pranuar se kritika moderne e religjioneve të mëdha botërore nuk është tërësisht e pabazë. Absolutizmi i tyre intelektual dhe koncentrimi i tyre në idetë metafizike ka synuar ta kthejë shpirtin njerëzor nga bota materiale dhe nga aktiviteti praktik shoqëror. Por, ky preokupim me të Amshueshmin e Absolutin dhe “fryma e asaj bote” të cilën ai (religjioni) e lind, është antipatikë për mendimin modern pasi që ka të ngjarë se përfundimisht i rrënon vlerat dhe rëndësinë e diturisë relative – dhe vetë jetën njerëzore. Shekulli i tashëm, duket se kërkon religjionin i cili do të ishte shtytje në aksion dhe arsytim të përparimit material dhe shoqëror, i cili është arritje e mrekullueshme e dy shekujve të fundit”. (Christopher Dawson: Progresi dhe religjioni).

Nëse tani me paanësi e analizojnë këtë akuzë kundër religjionit e gjejmë se ajo fjalë për fjalë është me vend dhe pëlqen me religjionet mistike – por sigurisht jo për Islamin. Në realitet citati i lartpërmendur, indirekt, vërteton tërë atë që Islami e mbron. Derisa padyshim, ka mjaft “absolutizëm intelektual” në disa religjione, nuk takojmë asgjë të llojit të tillë në Islam. Përkundrazi, të gjitha kuptimet e tij etike themelohen në thirrjen në mendjen e thjeshtë, mendja e jo ndjenja mistike të parashihet si rrugë e drejtë e religjionit (çka është në kundërshtim me atë që mund ta thonë disa nga sufijtë tanë ezoterikë)... Mandej Islami nuk është “koncentruar në idetë metafizike” po përkundrazi, tërë metafizikën e kufizon në një mësim: Zoti ekziston – plotësisht i vetëmjaftueshëm i gjithëfuqishëm, i drejtë e i mëshirshëm. Të gjitha hipotezat tjera mbi “atributet – cilësitë” e Tij janë të mjegullta, lojë fëmijësh. Ato mund të jenë argëtim spekulativ i teologëve myslimanë në një mijë vjetet e kaluara, dhe padyshim, as më së paku nuk janë të lidhura me mësimet origjinale islame.

Pastaj, dimë se Islami nuk synon “ta kthejë shpirtin njerëzor nga bota materiale dhe nga aktiviteti praktik shoqëror”, por, përkundrazi,

insiston në atë se kjo botë materiale është pamje pozitive e krijimit, prandaj aktivitetin shoqëror - d.t.th., aktivitetin e njeriut për t'i plotësuar kushtet e veta jetësore - e shndërron në pjesë përbërëse të kësaj kërkesë religjioze. Islami pasi që nuk është i preokupuar me të “Amshueshmin dhe Absolutin” siç e pamë, theksin më të madhe e vë në vlerën e mësimin shkencor dhe në vetë jetën njerëzore, kështu që ofron: “shtytjen në aksion dhe në arsyetimin e progresit material e shoqëror”, të cilën shkrimtari i lartcekur e përmend si kërkesë themelore të kohës së sotme, dhe të cilën ai duke shpjeguar gabimisht historinë – beson se është “arritje e mrekullueshme” e Perëndimit modern.

Shkurt, nuk ka konflikt as nuk ka pasur kurrë mes shkencës dhe Islamit – për shkak të thjeshtë, ngase nuk ka konflikt në mes natyrës njerëzore dhe Islamit, mësimet e të cilit vënë theks pozitiv në të gjitha manifestimet jetësore – jetës trupore e shpirtërore dhe jetës së organizimit shoqëror – duke i ofruar në këtë mënyrë shtytjen më të madhe të mundshme dëshirës së njeriut drejt të vërtetës dhe lumturisë.

Shprehja “Religjioni është çështje e së kaluarës” në esencën e saj është shprehje e botës perëndimore. Ajo në botën Islame nuk ka kurrfarë domethënie. Vetëm shkurtpamësia e atyre që janë mësuar për ta konsideruar civilizimin perëndimor si Civilizim (me “C” të madhe) ka mundësuar të besohet se kritika perëndimore e religjionit – e diktuar nga përvojat e Perëndimit - mund të përdoret njësoj edhe për Islamin dhe parimet e tij, sepse nuk jemi në gjendje të vërejmë se është gjetur e mangët cilado nga parimet themelore të Islamit para mendimit të nevojave themelore të njerëzimit.

Marrë nga: Takvim 1975, Sarajevë

Përktheu: Hajrullah Hoxha

Muhamed Esad

IS RELIGION AN ISSUE OF THE PAST?

(Summary)

During thousands of years, since the early origins of human consciousness, religion was a powerful force, which led mankind towards the unknown.

Religion was not the only driving force. Famine was the second, whereas human ambitions were the third. Yet, during history, religion was always on the top, be it for good or for bad. In its name, kingdoms have been created and nations have been born and kingdoms have been destroyed and nations have ceased to be. Its magical words have elevated people to the most magnificent heights of love and self-sacrifice – while others have committed despised acts of tyranny. Religion has granted happiness to many and has pushed others to hate life as a deception.

محمد أسد

هل الدين شأن الماضي فقط؟

(خلاصة البحث)

منذ آلاف السنين و بدايات و عى الانسان عن حقائق هذا الكون كان الدين هو القوة الجاذبة نحو مصير مجهول. هو لم يكن القوة الوحيدة المتحركة، الجوع كانت القوة الثانية و كان طبعه الانسانى القوة الثالثة. و لكن يمكن القول بان الدين خلال تاريخه الطويل كانت القوة الرئيسية سواء في الخير أو الشر، باسمه تم تكوين دولة و تم ايجاد شعوب و تم اعمار هذه الدول و ذوبان الشعوب. ان كلمة الدين السمحة هي التي رفعت الشعوب إلى أقصى درجات المحبة و التضحية و هناك من قام باسم الدين بشن حروب شرسة و عدوانيه على شعوب ضعيفة.

AKTUALITETE

Esh-shejh Fevzi Zefzafi

ISLAMI - FE E DIALOGUT DHE QYTETËRIMIT

Forca e padrejtësisë mbi Lindjen në përgjithësi dhe mbi Islamin në veçanti kanë ndikuar që Islami të mbajë barrën e ideve raciste dhe parimeve shkatërruese. Ide apo parime që dallojnë mes njerëzve, që nxisin disa të ngrihen mbi të tjerët, që prishin peshoren e drejtësisë në jetë. Për më tepër ato mohojnë të drejtat e të dobtëve e të varfëve përballë të fortëve e të pasurve.

Po të zhvishemi nga pasionet dhe paragjykimet, nga lidhjet tona rajonale dhe gjeografike dhe të lëmë mënjane besimin fetar e të shohim thjesht dhe drejt larg çdo fanatizmi e ndikimi, do të shohim që të gjitha idetë që shfaqen në botë në ditët tona shkaktojnë përçarje e konflikte në shoqërinë njerëzore. Ndërsa qëndrimi i vërtetë i Islamit është dialogu, dhe ky qëndrim na fton në të pranojmë parimet e Fesë Islame që janë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. Ato bashkojnë dijet fetare me ato materiale, janë të hapura, pranojnë bashkëpunim me të tjerët për të realizuar çdo gjë që është e mirë për njerëzimin. Po të kuptojmë mirë këto parime, do ta kemi më lehtë të konfirmojmë se Feja Islame e mbështet dialogun fetar me rrugë paqësore dhe logjike. Me këtë dialog ajo synon të krijojë ura të forta me fetë e tjera pa ndonjë përplasje, ndryshe nga Teoria e përplasjes së kulturave e qytetëri-

meve, të cilën e përhapin ata që mendojnë në domosdoshmërinë e mbisundimit të civilizimit të ri ndaj atij të vjetër. Mirëpo, po të shohim edhe te fetë tjera qiellore, te tekstet e tyre që kanë shpëtuar nga devijimet dhe keqinterpretimet, do të gjejmë se ato thërrasin për të mirën e njerëzimit, ndalojnë shkatërrimin, padrejtësinë, mohimin e të drejtave të të tjerëve. Më qartë në elementet morale të këtyre feve nuk gjejmë ndonjë dallim që vlen të përmendet. Po të dinte bashkëbiseduesi fetar këtë parim dhe të besojë në të do të pranonte kolegun e tij me kënaqësi, me nderim, me një bashkëpunim serioz për paraqitjen e së vërtetës dhe përforcimin e saj.

Prandaj, nëse thirrësit e ideve apo teorive konfliktuoze do të zhvisheshin nga idetë e tyre raciste dhe të ftonin në vëllazërim të gjinisë njerëzore, të ngritur mbi drejtësinë, barazinë, ndihmesën e të varfëve, përkrahjen e të dobtëve, do të kontribuonin pozitivisht në lumturinë e tyre. Ata do t'i largonin botës fatkeqësinë dhe mjerimin që shkaktojnë këto ide, të cilat çojnë në përçarje dhe krijojnë mosmarrëveshje, urrejtje, armiqësi mes njerëzve, të cilët në origjinë janë vëllezër prej një babe e një nëne.

Islami refuzon terrorizmin dhe ndalon agresionin

Feja Islame e ka respektuar njeriun dhe e ka bërë objekt nderimi dhe shenjtërimi. Ajo e konsideron atë si vetë jeta dhe e sheh me një aspekt të gjithanshëm pa dallim race, ngjyre apo gjinie. Ajo ndalon sulmin ndaj njeriut vetëm me të drejtë (vetëm kur ai rrezikon shoqërinë duke bërë krime) dhe e konsideron vrasjen e një njeriu si vrasje të mbarë njerëzimit. Allahu xh.sh. thotë në Kur'an: *“Kush vret një njeri që nuk ka vrarë kënd apo nuk ka bërë shkatërrim në tokë, është sikur ka vrarë gjithë njerëzit”* [5:32]. Allahu i madhërishtëm në një ajet tjetër thotë: *“Dhe mos vritni njeriun që e ka ndaluar Allahu vetëm se me të drejtë, kështu ju porosit ju në mënyrë që të mendoni”* [6:151]. Allahu xh.sh. e ka shtrënguar dënimin për atë që bën këtë krim (vrasjen e njeriut) në ajetin që vijon: *“Dhe kush vret një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehenemi përgjithmonë në të, zemëri-*

mi i Allahut është mbi të, mallkimi i Tij dhe kemi përgatitur për të një dënim të madh" [4:93].

Pas kësaj Feja Islame mbron pronën private të individit dhe nderin e tij. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë:

"I ndalohet myslimanit ndaj myslimanit gjaku i tij, nderi i tij dhe pasuria e tij" [Imam Ahmed vëll.2, fq. 491], *"Mysliman është ai që myslimanët janë të sigurt nga gjuha dhe dora e tij"* [Buhari vëll.1 fq. 9]. Ndalimi që ka bërë Profeti a.s. ndaj agresionit është i përgjithshëm, ai përfshin myslimanin dhe jomyslimanin edhe ajetet kur'anore që përmendëm më sipër hapur dhe qartazi ndalojnë agresionin ndaj njeriut i çfarëdo lloji qoftë ai. Me këtë, Feja Islame i ka garantuar njeriut paqen dhe qetësinë që të jetë i lirë për punë dhe prodhim në jetën e tij. Për të përforcuar kuptimin e bashkëpunimit mes njerëzve dhe për të përhapur shpirtin e dashurisë dhe vëllazërimit mes tyre. I Dërguari i Allahut a.s. ka paralajmëruar nga agresioni ndaj fqinjit ose lëndimin e tij qoftë edhe me fjalë. Rezultatet e këtij paralajmërimi kanë arritur deri në mohimin e besimit për atë që dëmton apo lëndon fqinjin. Ka thënë Pejgamberi a.s: *"Pasha Allahun, pasha Allahun, pasha Allahun, nuk ka besuar. I thanë kush o I dërguar i Allahut? Ai tha: "Ai, i cili fqinji i tij nuk është i sigurt nga sherri i tij"* [Buhari vëll.8, fq.12].

Nëse marrëdhëniet e individit me individin në shoqërinë Islame janë përcaktuar dhe përshkruar nga këto lidhje të cilat sigurojnë paqen, sigurinë, besën, qetësinë e individit dhe familjes, kjo do të thotë se feja Islame ka themeluar një shoqëri të shëndoshë ku mbizotëron paqja, harmonia, dashuria, lidhja, bashkëpunimi dhe koordinimi i plotë mes të drejtave dhe detyrave.

Pas kësaj feja Islame u drejton vëmendjen myslimanëve se shoqëria e tyre nuk është gjë tjetër veçse një pjese e shoqërisë botërore, pra ndaj duhet të mos jetojnë të veçuar nga shoqëritë e tjera, Allahu xh.sh. thotë në Kur'an: **"O ju njerëz, ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre, ju kemi bërë juve popuj e fise që të njiheni mes vete. Më i miri prej jush tek Allahu është më i devotshmi..."** [49:13].

Me të vërtetë Islami është fe e paqes, përshëndetja e Islamit është Selam-Paqe. Me të myslimani përshëndet të tjerët, e përsërit atë çdo

ditë disa herë sa përshëndet apo takohet me dikë. I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. ka thënë: *"Nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni, nuk do të besoni derisa të doni njëri-tjetrit, a doni t'ju tregoj diçka që nëse e bëni atë atëherë duheni mes vete? Thanë po, e ai tha: "Përhapeni selamin mes jush"* [Muxhmea Zevaid vëll.8, fq. 3]. Paqja në Fenë Islame është baza dhe origjina, ndërsa lufta është një përjashtim që e imponojnë kushtet e vetëmbrojtjes, thotë Allahu në Kur'an: **"Luftoni në rrugë të Allahut ata të cilët ju luftojnë juve dhe mos e teproni (mos kaloni kufijtë). Me të vërtetë Allahu nuk i do ata që e teprojnë"** [2:190]. Prej kujdesit të madh që paraqet Islami për paqen dhe urrejtja e tij për luftën, është kërkesa që ai u drejton myslimanëve ta ndalin luftën, nëse dorëzohen agresorët ose shpallin fundin e luftës nga ana e tyre, thotë Allahu xh.sh: **"Nëse anojnë nga paqja ano për të dhe mbështetu Allahut, me të vërtetë Ai dëgjon dhe është i ditur"** [8:61]. Megjithëse Islami e ka lejuar luftën në raste të veçanta, si vetëmbrojtje dhe kjo është një e drejtë e ligjshme në të gjitha ligjet dhe zakonet, ai ka kërkuar prej myslimanëve që luftën ta zhvillojnë vetëm me ata që kapin armët dhe ka ndaluar nga vrasja e të moshuarve, grave dhe fëmijëve. Ai ka ndaluar shkatërrimin e të mbjellave, prerjen e pemëve frytdhënëse madje dhe prerjen e kafshëve vetëm aq sa është e domosdoshme për ushqim. Argumenti më i mirë për këtë është porosia e Halifit të parë Ebu Bekr es-Siddik që i ka dhënë ushtrisë myslimane të udhëhequr nga Usame bin Zejd.

Nuk di fe më njerëzore, më të mëshirshme, më të drejtë, më tolerante me armiqtë e saj, të cilët e luftojnë atë sesa feja Islame.

(Marrë nga revista: *"Mexhel-letu Al-Azhar"*)
Përktheu nga arabishtja: **Admir Temja**

Esh-shejh Fevzi Zefzafi

ISLAM – A RELIGION OF DIALOGUE AND CIVILIZATION

(Summary)

The prejudices against the East in general and Islam in particular have had as a result the birth of racist ideas towards Islam. Ideas and principles which distinguish between people, which promote certain categories of people as more worthy than others, which destroy the equilibrium of the scales of justice in life. Furthermore, they deny the rights of the weak and poor as opposed to the rich and powerful.

الشيخ فوزي زفزاف

الاسلام دين الحوار و الحضارة

(خلاصة البحث)

ان الهجوم المستمر الذي تعرض له الشرق و الاسلام بصفة خاصة جعله بحمل عبيء الافكار العنصرية و المبادئ الهدامة.
هذه الافكار و المبادئ التي تفرق بين الناس و التي تحرض على رفع بعضهم على بعض و تخل ميزان العدالة في الحياة، بل أكثر من ذلك هذه الافكار قد لا تعترف بحقوق الضعفاء و الفقراء مقابل الاقوياء و الاغنياء.

NUMIZMATIKË

*Hatim Et-Tahavi**

MONEDHA ISLAME - ANGLEZE - ARGUMENTET DHE QËLLIMET

Mbreti anglez Offa (757-796), ishte mjaft i përfolur për luftërat që zhvilloi për bashkimin e popullit anglez në shekujt e mesjetës, por ai ishte i njohur edhe për sukseset e tij ekonomike, të cilat i ndihmuan të arriturat politike dhe ushtarake të tij. Kështu ky mbret anglez, krijoi lidhje tregtare të forta me myslimanët e Andaluzisë dhe me Evropën krishtere, dhe sidomos me perandorin Sharleman, me gjithë kritikën e këtij të fundit ndaj mbretit Offa dhe kritikave të tij të shumta në llogari të kishës.

Që nga hipja e mbretit Offa në fron të mbretërisë angleze të Mercia-s në vitin 757, ai kishte nxjerrë një urdhër për farkimin e monedhave të reja, të cilat në avers kishin të farkuar emrin e tij, kurse në revers simbolin e kryqit. Po në këtë kohë ai kishte urdhëruar që të farkohej një dinar i arit me simbolin e *Dëshmisë islame (shahadetit)*, duke i bashkëngjitur (duke vënë) edhe emrin e mbretit në gjuhën latine - Offa Rex. Ky dinar karakterizohej me veçori të posaçme, përse edhe që bërë i veçantë ndër llojin e tij, krahasuar me gjitha monedhat krishtere që farkoheshin në Evropën mesjetare.

Ky dinar, që gjendet në Muzeun e Britanisë në Londër, - me ca dallime fare të thjeshta në disa shkronja, i ngjan dinarit abasid, i cili gjendet në Muzeun e Artit Islam në Kajro.

Ndërsa disa historianë evropianë përpiqen të gjejnë një shpjegim praktik se për ç'arsye mbreti anglez kishte farkuar një monedhë islame, disa hulumtues islamë ndërkaq, përpiqen ta paraqesin mbretin Offa se gjoja ai ishte i bindur në Islam.

Ç'është e drejta, dinari i mbretit anglez Offa ka shkaktuar polemika të shumta gjatë studimeve dhe hulumtimeve të ndryshme për historinë mesjetare të Anglisë në veçanti dhe të Evropës në përgjithësi. Në këta rreshta do të përpiqemi të dalim me një përfundim a rezultat rreth kësaj çështjeje.

Disa historianë evropianë, në krye të tyre historiani Stenton, theksojnë se shkak për ekzistimin e këtij dinari të farkuar në formë të dinarit islam, të njohur në tregtinë islame në mesjetë, - kishte qenë qëllimi që me shtypjen e këtij dinari të bëhej një dallim nga mbretërit e tjerë të Evropës.

Disa historianë të tjerë mendojnë se qëllimi i mbretit anglez kishte qenë që me farkimin e këtij dinari të shfaqte mospajtimet e tij me politikën e papatit dhe për t'i dhënë atij një grusht të rëndë moral. Andaj, për t'u bërë atyre një provokim të madh shpirtëror dhe për t'i sfiduar ata, ai kishte farkuar këtë dinar me simbolin e *Dëshmisë islame (shahadetit)*.

Disa të tjerë ndërkaq thonë se dinari në fjalë ishte një falsifikim dhe se mbreti Offa nuk e kishte shtypur fare atë dinar. Të gjithë ata historianë evropianë që dyshojnë në formën e dinarit islam të mbretit anglez, mendojnë se qëllimi i farkimit të kësaj monedhe ka qenë për shkak të tregtisë së jashtme me myslimanët e Andaluzisë dhe me myslimanët e Lindjes së Mesme, të cilët përdornin dinarin abasid. Këtë mendim e shfaqti historiani nga Nadoja, Blunt.

Përveç këtyre, Aziz Suriyat Atije mendon se farkimi i monedhës së mbretit Offa në formë të dinarit islam, dëshmon vetëm një gjë: Se sa thellë kishte depërtuar tregtia dhe monedha islame në tregun botëror të asaj kohe.

Nga ana tjetër, disa hulumtues myslimanë mendojnë se mbreti anglez Offa kishte pranuar fenë islame dhe se pikërisht ky qe shkaku i vetëm dhe logjik, që e kishte shtyrë këtë mbret që të farkonte monedhën angleze në formë të njëjtë me dinarin islam-abasid. Këta studiues kanë argumente të shumta, mbase edhe emocionale njëkohësisht që çojnë në nxjerrjen e përfundimit a të rezultatit për këtë çështjeje.

Këta studiues (shih Mustafa Kenani) mendojnë se burimet dhe dokumentet e kohës dhe ato të më vonshme, që bëjnë fjalë për mbretin Offa, nuk dëftojnë dot asgjë për këtë dinar, ndonëse kjo ishte një ngjarje e vërtetë dhe, duke iu falënderuar shkencës së zhvilluar, është një gjë fare e njohur. Për më tepër, thonë ata, historianët bashkëkohorë, duke qenë zotërues të një kulture të gjerë, shumë lehtë do të mund t'i lexonin fjalët arabe dhe simbolin e *Njësimit islam* të farkuar në këtë dinar dhe jo *a priori* të injoronin qëllimin e farkimit të tij.

Një pakicë e historianëve evropianë ndërkaq, kur bëjnë fjalë për monedhën e mbretit Offa, flasin pa ndonjë studim a përpjekje shkencore për këtë çështje.

Ndërkaq, një pjesë e hulumtuesve myslimanë kur flasin për këtë dinar mendojnë se ai erdhi si rezultat i kundërshtimit të kishës dhe papatit nga ana e mbretit Offa, i cili së bashku me mbretin Sharleman qenë marrë vesh që të shkëputeshin nga kisha. Prandaj, mendojnë ata, ndoshta pikërisht për këtë arsye është bërë edhe fshehja e të gjitha dokumenteve mesjetare për mbretin Offa, duke i lënë vetëm ato dokumente që kishin të bënin me mbretërit e tjerë anglezë. Kjo mbase ka ndodh si rrjedhojë e vendimit të kishës angleze (me nxitjen e papatit) për grumbullimin e të gjitha dokumenteve të kohës së mbretit Offa, që ta hiqnin qafe atë njëherë e përgjithmonë.

Këta hulumtues po ashtu thonë se të gjitha burimet bashkëkohore angleze që bëjnë fjalë për mbretin Offa nuk thonë të paktën një fjalë të vetme për shkaqet e vdekjes së papritur të tij në vitin 796, ndonëse burimet e vonshme thonë se mbreti Offa nuk ishte varrosur sipas protokolleve mbretërore të mbretërve anglezë në Katedralen e Madhe, siç rëndom varroseshin të gjithë mbretërit e tjerë anglezë, ose të paktën të ishte varrosur në kryeqendër; por ai ishte varrosur në një ndërtesë mo-

deste në një skaj të lumit në qytetin Bradford. Kjo, komentojnë këta hulumtues, ndodhi për shkak se Kisha ishte fare mirë në dijeni se mbreti Offa kishte pranuar fenë islame, prandaj pikërisht për këtë arsye ajo nuk kishte marrë guximin dhe nuk kishte pranuar që atë ta varrosnin në Katedralen e Madhe, siç e parashihte krishterimi.

Kështu këta historianë dhe hulumtues janë mbështetur në argumente logjike në komentimin e kësaj ngjarjeje historike, e cila ka shkakuar dhe vazhdon të shkaktojë polemika dhe thashetheme të shumta. Këta hulumtues theksojnë edhe se nuk është e logjikshme që mbreti anglez Offa, që ishte kundërshtar i Kishës dhe papatit, të farkonte një monedhë, në të cilën do të shkruante në mënyrë decisive fjalët arabe-islame: "*La ilahe il-lallah Muhammedun resulull-llah*", *d.t.th.* "*Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Muhammedi është i dërguar i Tij*", e të mos kishte pranuar vërtet fenë islame.

A thua vallë, çfarë do ta shtynte një mbret të krishterë që të bënte një gjë të tillë?!

Larg çështjes së bindjes së mbretit Offa në Islam dhe si hakmarrje ndaj ballafaqimit me kishën dhe papatin, disa nga historianët theksojnë se marrëdhëniet politike dhe tregtare të halifatit abasid ndikuan që në mbretërinë anglezë të Merci-as, krahas shumë tregtarë myslimanë, të dërgohen edhe misionarë zyrtarë islamë. Mbase, këta tregtarë myslimanë luajtën rolin e tyre historik dhe përveç profesionit të tyre të rëndomtë, ata kishin punuar edhe në paraqitjen e Islamit te mbreti anglez Offa, i cili, nga që së bashku me Shalemanin ishte në konflikt me kishën, mund edhe ta ketë pranuar Islamin.

Në të vërtetë, heshtja e burimeve angleze dhe evropiane të kohës për mbretin Offa dhe dinarin e tij në të cilin ai kishte farkuar *shahadetin/dëshminë islame*, si dhe zhdukja e dokumenteve të kohës së tij, më pastaj edhe vendi dhe mënyra e varrimit të tij, janë çështje që vërtet të shpijnë në dyshim.

Nga ana tjetër, edhe heshtja e burimeve islame (abaside dhe emevite në Andaluzi) për përqaftimin e Islamit nga ana e mbretit anglez Offa si dhe mospublikimi i mbishkrimit të farkuar në dinarin islam në

kohën kur ishte e nevojshme që të flitej për të dhe ai të bëhej publik, janë çështje që të shpijnë në dyshim dhe luhatje.

Një përgjigje e pjesshme do të kishte qenë edhe kjo: Burimet bashkëkohore islame kishin heshtur po ashtu edhe për sa u përket marrëdhënieve të halifit *Harun err-Rreshid* dhe mbretit Sharleman, marrëdhënie këto të cilat i përmendin vetëm burimet franceze (shih Einhar, historian i Sharlemanit).

Me heshtjen e burimeve angleze dhe franceze, pastaj edhe me heshtjen e burimeve të kishës dhe atyre islame emevite dhe abaside, kjo çështje vështirë se mund të kuptohet, përveç nëse tumirim mendimin se kemi të bëjmë me ndonjë komplot.

Në fund fare, të theksojmë edhe se çështja e armiqësive midis mbretërve krishterë dhe papatit katolik ka qenë çështje e rëndomtë që është përsëritur me dhjetëra herë në historinë mesjetare të Evropës.

Për sa i takon të ashtuquajturit konflikt laik, e që është një çështje që nuk mund të anashkalohet në rastin tonë, sepse kur bëjmë fjalë për përqaftimin e Islamit nga mbreti anglez Offa dhe i cili konsiderohej koka e kishës angleze, ndodh që ai ta ketë pranuar Islamit si fe zyrtare për vetveten dhe popullin e tij, por meqë nuk posedojmë argumente historike, e siç e dimë, historia kërkon dokumentimin e ngjarjeve, qoftë edhe një dokument të vetëm, atëherë ajo nuk mund të jetë historik. Mosprezantimi qoftë edhe i një dokumenti të vetëm nga dhjetëra historianë bashkëkohorë evropianë dhe myslimanë në punimet e tyre, na bëjnë të dyshojmë për përqaftimin e Islamit nga mbreti Offa, me gjithë prezantimin e dinarit të tij si argument i heshtur dhe me gjithë paraqitjen e Shahadetit në monedhën angleze.

* Autori është profesor i historisë së shekujve të mesëm-Mesjetës në Universitetin Zakazik në Egjip

Marrë nga: www.daralhayat.com/kulture/11.02.2006

Përktheu nga gj. arabe:
S. Mehmeti

Hatim Et-Tahavi

ISLAMIC-ENGLISH COINAGE

Mercian King Offa (757-796) was well-known for the wars he waged for the unification of the Anglo-Saxons in the middle ages. Furthermore, he was well-known for his economic success, which went alongside his political and military achievements. King Offa established strong trade ties with Moslems in Andalusia, with Europe, and in particular with Emperor Charlemagne.

حاتم الطحاوي

ملة إسلامية إنكليزية: الدلالة و المغزي

(خلاصة البحث)

قام الملك الانكليزي أوفاء ٧٩٦-٧٥٧ المثير للجدل لنحوض الكثير من المعارك من أجل وحدة الامة الانكليزية في العصور الوسطى كما اشتهر بنجاحاته الاقتصادية التي حمت انجازاته السياسية و العسكرية. و هكذا عقد الملك الانكليزي علاقات تجارية و طيدة مع المسلمين في الاندلس و مع أوربا المسيحية و خصوصا مع الامبراطور على رغم انتقاد الاخير لأراء الملك أوفاء و تحججه على الكنيسة.

RECENSION

Prof. dr. Muhamet Pirraku

GYLEN - PËRMENDORE E RE E CIVILIZIMIT NJERËZOR

Një sentencë shekullore sak-tëson: Në kohën e vet asnjë profet nuk ka qenë i pranueshëm në vendin e tij. Në këtë përvojë, të themi gjithënjëzore, bën përjashtim, së paku, turku i kohës sonë, M. Fethullah Gylen, ndjekësi i përkorë i mësimëve dhe i përvojës islame të Pejgamberit Muhammed - Paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi Të!

U lind në Erzurum të Turqisë Lindore, më 1941. Mësimet themelore edukative dhe shpirtërore i mori nga teologët mistikë islamë më të shquar të kohës. Njëkohësisht studioi shkencat shoqë-

rore dhe natyrore. Meqë kishte aftësi të mëdha autodidakte, në mësim dhe studime eci shumë para moshatarëve, i përkushtuar për mision intelektual. Në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, pasi dha provimet me sukses të dalluar, u lauria me diplomën e predikuesit zyrtar dhe u emërua vaiz në Izmir, qytet ky i treti në Turqi për nga madhësia dhe rëndësia.

Periodha e ngritjes së Gylenit i përkiste kohës së errësirës laike të trazuar të Republikës së Turqisë, ndaj mendimtari, sot krenari e kombit turk, me përpjekje disidente u skalit dhe u faktorizua në

përmendore të mbrojtur me autoritetin e vet. Në ligjëratat në xhami, në ndeja rasti, në tubime shoqërore të njerëzve të besueshëm, apostrofonte skamjen, varfërinë, pozitën e rëndë sociale të masave dhe dukuritë degjeneruese të moralit individual e shoqëror që mbytnin Turqinë në anarki dhe mjerim. Besnik i kredos se, rinia është e ardhmja e kombit, i kushtoi rëndësi të madhe punës me nxënës, me studentë dhe me intelektualët me peshë në jetën edukative, arsimore, kulturore, politike dhe ekonomike të Turqisë. Më 1960, si nëntëmbëdhjetëvjeçar, doli hapur me kërkesat për reformë shkollore edukative universale, e cila do të siguronte ndriçimin intelektual dhe shpirtëror të rinisë dhe do të demokratizonte shoqërinë turke.

Veprimtari fenomen, Fethullah Gylen, Lëvizjes, së cilës po i vinte themele, nuk i vuri emër fare dhe thjesht e quajti "Izmet" (Shërbim) për popullin dhe Zotin. Korifeun e karakterizoi morali islam, besimi i kulluar në Zotin, adhurimi ndaj profetëve dhe dije-tarëve, sinqeriteti, dashamirësia, vullneti, këmbëngulësia, njerëzorja, dija, guximi, përkorësia, sa-

krifca. Kurrë nuk u martua dhe as bëri pasuri, i tëri iu shugurua diturisë në themele të kombit, të Islamit, të paqes, të njerëzimit. Ky përkushtim është dëshmuar fuqimisht në biografinë: "Bota ime e vogël" (Küçük Dünyam), botuar më 1995, e cila ka përrjetuar 50 ribotime.

I mbështetur në të arriturat e diturive ekzakte, si një mësues shpirtëror i pashoq, nxiste të rinjtë, veçanërisht studentët, të mësonin, të studionin dhe të vënin drejtpeshimin mes vlerave materiale dhe të atyre shpirtërore. Kështu, modeli i mësimi Gylen, thënë me fjalët e M. Enes Erge-ne, "ishte i përshtatshëm, i hapur në të dyja anët në pafundësi. Aty as është fundi i kapërcimeve shpirtërore, as kufiri i përkushtimit material-jetësor, ose i vetëflimit". Si novator dhe reformator shoqëror i kombit turk, në mësimet e veta i trupëzoi në një: të kaluarën osmane të ndritshme, të arriturat perëndimore shkencore dhe mësimet hyjnore nga burimet e feve të shpallura. Diagnostifikimi i Gylenit se, Turqia ka tre armi-q kryesorë: injorancën, varfërinë dhe përçarjen, me shpejtësi u pranua si mësim Mesihiu për

kombin, ndaj sa vinte dhe mirë-kuptohej qortimi i Tij, se denigrimi i moralit të shoqërisë turke deri në degjenerim fatal, ishte pasojë e dhënies së turqve pas pamjes së jashtme të Islamit, duke i lënë margaritarët e brendshëm të tij. Një sentencë thotë: "Pa të ndihmuar era nuk mund ta kallësh një mal". Ligjëratat e tij do të incizohen nga aderuesit dhe do të barten nga një mjedis në tjetrin.

Andaj, mësimet e Gylenit sa erdhi dhe u bënë platformë për lëvizjen edukative, arsimore dhe shkencore në themele të kërkesës madhore për ripërtëritjen dhe faktorizimin e kombit turk, të mbështetur në katër shtyllat themelare: fenë, gjuhën, historinë dhe mëmëdheun, si shenjtëri hyjnore. Për ta arritur këtë qëllim duheshin njerëz të shkolluar, të moralshëm, patriotë, fetarë të përkorë, besnikë kredos së Gylenit: E ardhmja e kombit mbështetet mbi orbitën e dijës. Këtë fitore Gylen do ta mbështesë në rolin e edukatorit. Sipas tij, mësues mund të bëhet akëcili i diplomuar në fakultet, kurse edukatorit i duhej edhe përkushtimi i një të ndriçuari fetarisht.

Për ta plotësuar këtë kërkesë, i mbështetur në shumë përkrahës nga radhët akademike, më 1966, në moshën njëzet e pesëvjeçare, filloi me kurset për përgatitjen e maturantëve për provimet pranuese në universitetet vendore dhe botërore, për studime në matematikë, kimi, fizikë, medicinë, shkencat teknike, natyrore dhe fetare. Kuadrot e diplomuara në universitete, në vijimësi, do të vihen në mbështetje të Misionit Gylen, i cili sa vjen dhe do të konsiderohet mësues shpirtëror i miliona turqve, nga të cilët do të njihet dhe adhurohet vetëm me epitetin Hoxha Efendi, pra Mësues, njëri ky nga atributet e Zotit. Sipas disa të dhënave, mbi dyzet për qind e auditorit në vaizet e tij, ligjërimin e Hoxha Efendisë e përcjellin me lot e ngashërime. Qartë, konsiderohet personalitet i pritur me shumëtribute të njeriut të shenjtë dhe të profetëve.

Detyrën e vaizit Gylen e la në moshën dyzetvjeçare, më 1981. Doli në pension, për t'iu përkushtuar i tëri përhapjes së "Izmet-it". Tashti si predikues nderi në xhamitë më të mëdha të Turqisë dhe si mendimtar i lirë, udhëtoi nga një vend në tjetrin, predikoi

për shtresat e ulëta të shoqërisë dhe ligjëroi në tubimet masive të rinisë shkolllore, universitare dhe punëtore në ambiente të hapura. Kështu, në vijimësi, me durim e vendosmëri, u hapi shtigje mendimeve të guximshme edhe për nevojën e dialogut dhe tolerancës ndërfaqetare, në rend të parë për balancimin e interesave të krishtera dhe islame dhe për unifikimin e civilizimit njerëzor mbi parimet e feve të shpallura dhe të të arriturave të shkencës.

Lëvizja Gylen, e cila në qarqet e veprimtarëve dhe të donatorëve të saj njihet, gjithnjë, vetëm me emrin që përfytyron përkushtimin shpirtëror "Izmet", do të finanohet vullnetarisht, nga miliona turq, biznesmen të mesëm e magnatë industrialë. Numri i donatorëve është në rritje të vazhdueshme. Fryti i parë, më i madh, i "Izmet-it" ishte hapja e Kolegjit "Fatih", më 1979, në Stamboll, lice ky i sistemit konviktor modern. Pas tij, në Stamboll dhe në qytetet e tjera të Turqisë, dhe në botë, do të hapën kolegje me pajisje mësimore e komfore të pajisjes me magjinueshëm. Ato janë shkolla të hapura, internacionale. Lëvizja Gylen sot ka nga një, dy, tri e më

shumë shkolla në 92 vende. Më saktë, në 110 shtete ka shkolla dhe fonde për kulturë dhe arsim, madje edhe atje ku nuk ka shërbime konsullare turke. Kështu, Lëvizja Gylen u bë ylberi më gjigant që lidh cepat e civilizimeve botërore.

Mësimi në licetë e Lëvizjes Gylen zhvillohet në gjuhën angleze, kurse gjuha turke mësohet si e dytë. Lënda për fenë, brenda Turqisë, mbulohet vetëm me një orë mësimi në javë, sikurse edhe në shkollat shtetërore, kurse edukimi dhe praktika fetare përsoset në konvikte. Nxënësit e kolegjeve gyliane vazhdimisht i arrijnë vendet e para në garat mësimore në nivel të vendit, kurse në garat ndërkombëtare ata Turqisë i sjellin medalje të çmuara. Nxënësit e këtyre shkollave, në akëcilin shtet qofshin, pa vështirësi i kalojnë provimet kualifikuese për praninë në universitete.

Një zhvillim dhe përhapje të marramendës Lëvizja "Shërbimi" e arriti dhe po e korrë, falë organeve të Lëvizjes. Realisht, meqë Flamurtari Gylen ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e intelektualëve krijues dhe të mediave, për sukseset e Lëvizjes, më 1994, i

bashkoi forcat intelektuale në asociacionin “Fondacioni i Shkrimtarëve dhe i Gazetarëve”, në gjirin e të cilit ngrii “Akademinë e Studimeve Islame”. Së shpejti, njërin pas tjetrit, ngrii organet: gazetën ditore “Zaman” (Koha), agjencinë e lajmeve “Cihan” (Bota), televizionin “Samanyolu” (Gjithësia), javoren politike “Aksion” (Aksioni), mujoren shoqërore dhe shkencore “ZıZıntı” (Burimi), tremujoren fetare “Ye-ni Ümit” (Shpresa), mandej revistën për letërsi e mendim filozofik: “Yağmur” (Shiu) dhe “The Fountain” (Fontana).

Në këto organe mësuesi shpirtëror, Hoxha Efendi, botoi kryeartikuj e shkrime, të cilat do të shërbejnë si platformë për të drejtuar zhvillimin e mendimit shpirtëror dhe popullor në Turqi. Në vitin 1996, në Stamboll, “Izmet” e hapi Universitetin “Fatih”, i cili është në rritje të vazhdueshme. Ambienti studimor, pajisjet e kabineteve me mjete mësimore, është modern i pakonkurrencë. Vetëm katedrat për kimi dhe fizikë kanë 15 laboratorë, fjalë e fundit e shkencës. Lëvizja Gylen aktualisht ka gjashtë universitete moderne në botë, ku mësimi

zhvillohet në gjuhën angleze, kurse gjuha turke mësohet si gjuhë e huaj. Edhe në këtë shkallë të shkollimit të lartë, mësimi i edukatës fetare realizohet në ambientet konviktore. Sipas njohurive të Dr. Rexhep Efendi Bojes, Lëvizja arsimore-shkencore e Mulla Fethullah Gulenit në kapërcyellin nga shekulli XX në shekullin XXI kishte rreth 400 mijë studentë. Të themi edhe këtë: Në licetë dhe fakultetet gjyane, në Stamboll, syri nuk ta kap asnjë përmjet femre të zhveshur, asnjë qift të droguar.

Në mësimet filozofike të Hoxha Efendisë bota e sotme shikohet si një fshat i madh, global. Të tillë e ka përmbledhur botën përparimi i shkencave teknike, tregut i përbashkët, telekomunikacionit ndërplanetar, ndaj shekullin XXI Gylen e pandeh si shekull të pritur të mbretërisë së tolerancës dhe të dialogut ndërfe-tar dhe ndëretnik, që do të shpjerë në ngjizjen e njësisë së civilizimit botëror unik mbi parimet e përbashkëta të feve hyjnore. Gylen, kështu, atakoi fuqimisht tezat e hebreat amerikan Hantington, për “përplasjen e civilizimeve” në shekullin XXI. Për t’i

hapur hulli këtij projekti Gylen vuri kontakte dialoguese ndërfe-tare brenda Turqisë, pikërisht me patrikun e Fanarit, me patrikun armen dhe me Kryerabinin hebre, mandej me ambasadorin e Vatikanit për Turqi, me arqipeshkvin e Nju-Jorkut, me presidentin e “Lidhjes kundër dezinformimeve”, me Kryerabinin e Jerusalemit, me kardinalë katolikë në Romë, e me të tjerë.

I një rëndësie të veçantë për kthesë historike ishte takimi i Gylenit me Papa Gjon Pali II, më 8 shkurt 1998, në Vatikan. Në letrën që i la Papës, mesazh i një përfaqësuesi të denjë për komunitetin islam në përgjithësi, i nënshkruar - “Shërbëtor i përvuajtur i Zotit”, do të saktësojë: “Ne jemi këtu për t’u bërë pjesë e misionit të pandërprerë të Këshillit Papnuer për Dialog Ndërfetar, të themeluar nga Papa Pavli VI. Ne dëshirojmë ta shohim këtë mision të kryer.”

Në dokument, më tutje, janë sjellë përfundime të drejta shkencore, ide dhe inicime programatike për paqen hyjnore për njerëzit të bashkuar përreth Njëshit, secili me fenë e tij. Dhe pasi do të konstatojë se “Islami ka qe-

në një fe e keqkuptuar dhe për këtë përgjithësisht kanë përgjegjësi myslimanët”, do të apelojë: “Bota islame duhet ta mirëpresë oportunitetin e një dialogu që do të punojë për çrrënjosjen e koncepteve të gabuara shumëshekullore rreth Islamit”.

Mbështetjen kryesore për të kurorëzuar dialogun midis feve, për paqe hyjnore në Tokë, Gylen e mbështeti në lidhjen që duhej të çelnicosej midis fesë dhe shkencës. “Njerëzimi, kohë pas kohe, ka mohuar fenë në emër të shkencës dhe ka mohuar shkencën në emër të fesë, duke nxjerrë në pah dy pamje prezente konfliktuale. Të gjitha dijet i përkasin Zotit dhe feja është prej Zotit. Atëherë si mund të jenë ato në konflikt?”

Vërtet, Letra e Gylenit lënë Papës është e tëra program vepri-mi për unitet për paqe gjithënjë-rëzore. Midis tjerash, vuri në spikamë kërkesën krejt origjinale për ngritjen e “një universiteti të pavarur me një program mësimor të përgjithshëm që do të plotësojë të gjitha nevojat e të tre besimeve”. Ky institucion të ngrihej në Harran (të provincës së Urfas), që konsiderohet “si vendlindja e profetit Ibrahim, i cili konside-

rohet të jetë baba i tri feve të mëdha"- hebraizmit, krishterimit dhe Islamit.

Kështu, M. Fethullah Gylen, sot mund të quhet pionier i dialogut ndërfaqetar dhe dashamir i paqes. Në studimin "Domosdoshmëria e dialogut ndërfaqetar", të mbajtur në Parlamentin e Feve Botërore në Keip Taun, më 1-8 dhjetor 1999, midis tjerash, ritheksoi: "Dialogu është një domosdoshmëri!"

Dhe, i një rëndësie tërësisht të veçantë është Mesazhi i Gylenit për popullin amerikan, lidhur me sulmin terrorist në "Kullat Binjake", më 11 shtator 2001, në të cilin theksonte: "Unë dua ta bëj të qartë që çdo aktivitet terrorist, nuk ka rëndësi nga kush është ndërmarrë ose për çfarë qëllimi, është një goditje e rëndë për paqen, demokracinë dhe njerëzimin". Në vazhdim, konstatonte: "Ju lutem, më lini t'ju siguroj që Islami nuk e pranon terrorizmin në asnjë formë".

Si një misionar përfaqësues i të gjithë myslimanëve, u apelonte SHBA-ve të vepronin me gjakftohtësi, të shqyrtonin shkaqet që mund të cytnin individët ose grupet për akte terroriste dhe të ki-

nin parasysh faktin se "dëmtimi i masave të pafajshme me qëllim ndëshkimin e pak njerëzve të fajshëm nuk është në dobi të tyre". Nga ana tjetër, vëllezërve të bashkësisë fetare u vinte në pah, qartë: "Terrorizmi nuk mund të shfrytëzohet për të arritur ndonjë qëllim islam. Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman i vërtetë nuk mund të jetë terrorist".

Frymë, porosi dhe udhëzime të tilla, xhade për ardhmëninë e njerëzimit, ngërthen vepra kolosale e M. Fethullah Gylenit, e mirë kulturore shumë e rëndësishme për kulturën e kombit turk në veçanti dhe për mendimin islam në përgjithësi. Bibliotekën Gylen në "Akademine për Studime Islame" aktualisht e përbëjnë mbi dyzet vepra, krahas qindra artikujve të botuar dhe të mijëra fono e video kasetave dhe CD-ve me ligjëratat për Islamin, edukatën, etikën, arsimin, shoqërinë dhe njerëzimin. Një aktiv i tërë studiuesish punojnë në këtë bibliotekë - për afirmimin e veprës Gylen. Shumë vepra të Gylenit janë përkthyer në gjuhët botërore: anglisht, gjermanisht, rusisht, japonisht, indonezisht, spanjollisht e

të tjera. Në gjuhën shqipe, deri tashti, në duar të lexuesve janë dymbëdhjetë sosh. Njëra prej tyre është "DRITË E PASHUAR", të cilën po e përruron sot Fondacioni "Atmosfera" i Lëvizjes Gylen.

Ndonëse e zgjata tepër, më lejoni të përmbledh. Në anëshkrimin tim në fund të librit, më 11 tetor 2005, kam konstatuar: "Një libër i shkëlqyer me analizë thelbësore për Muhammedin a.s. Libër për çdo shqiptar. Autori është veçse një gjeni që shkroi për të Dërguarin e Allahut për njerëzimin".

Lexuesi i kujdesshëm i kësaj vepre do të shohë se autori, me një shkathtësi mendimi e lehtësi shkrimi, i ka saktësuar dhe i ka ndriçuar me ajete, hadithe dhe mendime filozofike botërore, më se 70 attribute të Profetit Islam: Agimi i Pritur, Bari i Bujarëve, Besniku i portës së të vërtetës, Bilbili i famshëm, Bujar, Burimi më i pastër i të pastërve, Diell, Dielli i diejve, Drita e syve tanë, Emiri i myslimanëve, I besueshëm, I dërguari i Allahut, I dërguari i Madh, Kandil në qiellin e njerëzimit, Komandant ushtarak, Krenaria e njerëzimit, Kryefa-

miljar i shkëlqyeshëm, Lajmëtar i Besnik, Margaritar i fjalës dritëdhënëse, Margaritari i Pashoq, Mbret i Shprehjes, Mbreti i Fjalës, Mbreti i Mbretërve, Mbreti i ndjenjave, Mbreti i Profetëve, Mbreti i zemrave, Mbreti që kurorëzon diejt, Më bujari i njerëzve, Me cilësinë e një dielli, Më i bukuri i njerëzve, Më i guximshëm i njerëzve, Më i ndjeshmi ndër të ndjeshmit, Mëshira Universale, Mjeshtër i luftës, Model i Allahut, Ndihmësi i Madh, Një bilbil që u kompozonte ilahi trëndafilave të lulishtes së Zotit, Një njeri fytyrëdiell, Njeri i programuar për gjëra të bukura, Njeriu i edukatës, i masës dhe i seriozitetit, Njeriu i paqes e i qetësisë, Njeriu i principialitetit, Njeriu i sigurisë e i besueshmërisë, Njeriu i vullnetarizmit e i sakrificës, Njeriu që u përfton vlerë gjerave, Oqeani i kulluar i Profetëve, Pëllumbi i profetëve, Përfaqësues i Zotit, Përmendorja e Mëshirës, Prijës e mësues mrekullisht i përsosur, Profet i të Dy Botëve, Profeti i Dhimshurisë, Profeti i Lartë, Profeti i mëshirës, Profeti i profetëve, Qiri, Ripërtëritës i kauzës së profetëve, Shembulli i Përgjith-

shëm, Shpirti i Gjallë Muhammedian, Sovrani i zemrave, Thesari i diturisë hyjnore, Udhëheqës ushtarak i shkëlqyer, Udhëzuesi i Përsosur, Zemra më e pastër ndër të pastrat, Zotëria i Gjithësisë, Zotëria i Kohës e i Hapësirës, Zotëria i Zotërinjve.

Rëndësia e veprës së gjithmbarshme të mësuesit shpirtëror, M. Fethullah Gylen është e shumëfishtë: për kombin turk, për komunitetin islam dhe për njerëzimin. Për këtu të mjaftohemi vetëm me tri përfundime: Dihet se ushtaraku Kemail Atatürk, gjak turko-shqiptar ballkanas, e siguroi trupin e kombit turk, ndërkaq Gylen, turk anadollas, po ia fisnikëron shpirtin këtij kombi aziatiko-evopian. Njëkohësisht, Gylen është misionari dhe avokati më i suksesshëm i Islamit dhe personaliteti, ndoshta i vetmi në histori, i cili për të gjallët e vet ka lidhur, pa dhunë, pa mito, vetëm me fuqinë e bindjes, rreth një platforme të mendimit dhe të veprimit mijëra autoritete botërore të përkatësive të ndryshme etni-

ke, fetare e politike dhe qindra miliona myslimanë.

Së këndejmi rezultoi fakti që “Simpoziumi i Heronjve të Paqes” në Universitetin Augustinian të Teksasit, më 1-13 prill 2003, emrin e M.Fethullah Gylenit ta radhisë në listën e heronjve bashkëkohorë të paqes për periudhën 5000-vjeçare të njerëzimit, pikërisht në lagjen e Jezusit, Budës, Mohandas Gandit, Martin Luter Kingut dhe Nënë Terezës. Kjo është fitore për kthesë historike për kombin turk, për komunitetin islam dhe për njerëzimin në përgjithësi.

Modeli Gylen është më së i rëndësishëm, shumë natyror jetësor, për kombin shqiptar modern. Sipas Dr. Rexhep Efendi Bojës, i cili, më se tri herë ka qenë mysafir personal i Gylenit, Haxha Efendi është mik i madh i popullit shqiptar dhe në ligjëratat e tij para studentëve, përpos të tjerash, ka afirmuar përpjekjet për lirinë e Kosovës në periudhën e luftës çlirimtare të UÇK-së.

RECENSION

**DRITË E PASHUAR - hz.Muhammedi s.a.v, 1.
M.Fathullah Gylen, Tiranë, 2004, fq. 472. përktheu
nga origjinali Dr. Mit`hat Hoxha
Qasje e re ndaj haditheve të Muhammedit a.s.**

Gjykuar sipas titullit që mban numrin një, duhet pritur që kjo vepër e Hoxha F.Gylenit të pasohet nga vëllime tjera. Libri i parë, për të cilin bëhet fjalë këtu, është botim i vitit 2004 në Tiranë, dhe trajton disa tema nga jeta e Pejgamberit Muhammed a.s.

Hapet me një prezantim për jetën dhe veprimtarinë e Hoxha Gylenit: *Një jetë kushtuar paqes dhe lumturisë së njeriut*, të shkruar, sipas të gjitha gjasave nga botuesi në gjuhën shqipe, kurse pas kësaj vjen fjala e autorit, e cila këtu është vënë si Hyrje, fq.5-18.

Në vazhdim vijnë temat bosht: Profeti u dërgua si mëshirë për botën; Edhe para progetësisë ai pati jetuar si profet; Udhëtimet; Profeti i paralajmëruar dhe i pritur; Ai është njeriu i dimensioneve të veçanta; Qëllimi i dërgimit të profetëve; Veçoritë e profetëve; Atributet e profetëve; Njoftime të fshehta; Amaneti dhe besueshmëria; Thirrje udhëheqëse të shteteve; Zgjuarsia e profetit tonë; Analizë e një tufë hadithesh; Profeti i mëshirës... dhe tema e fundit Mirësia, Bujaria dhe thjeshtësia e tij, fq.439.,

pas së cilës vjen Përmbajtja e librit.

Secila nga këto tema bosht është e ndarë në disa nëntema, në të cilat Mulla F.Gylen përpunon me mjeshtri të rrallë çështje me interes, nga të cilat lexuesi shqiptar pajiset me dijeni për jetën dhe praktikën e Muhammedit a.s.

I tërë libri: **Muhammedi a.s. "Dritë e pashuar"**, e F. Gylenit, është i mbështetur në hadithet e Pejgamberit Muhammed, por aty këtu ka ilustrime edhe nga Kur`ani.

Emri i Mulla Fet`hullah Gylenit i ka kaluar kufijtë e Turqisë dhe është bërë sinonim i liderit për një organizim të jetës islame, në radhë të parë në Turqi dhe jo vetëm në Turqi. Ai komunikon me miliona dashamirës të interesuar për organizimin më të mirë të jetës islame nga mbarë bota.

Me angazhimin e fondacionit turk për arsim dhe kulturë "Atmosfera" që vepron në Kosovë, aktiviteti i Hoxha F.Gylenit ka arritur edhe në Kosovë. Falë harmonizimit të veprimeve të shtëpisë botuese "Prizmi" nga Tirana, me subjektet përgjegjës në Turqi, siç është përkthyesi dr. Mithat Hoxha, fondacioni "At-

mosfera" etj., para lexuesit shqiptar sjell veprën: **"Dritë e pashuar"** - hz.Muhammedi s.a.v. libri 1.

Ky libër përbëhet prej disa kapitujsh me përmbajtje interesante për lexuesin shqiptar, porse unë këtu jam ndalur më së shumti në kapitujt: *Analizë e një tufe hadithesh, Profeti i mëshirës, Bujaria dhe thjeshtësia* e tij, të cilët ngërthejnë në vete nga disa nënkapituj.

Libri që e kemi në duar është fryt i angazhimeve të palodhshme të hoxhë F.Gylenit dhe mundit që ka bërë në takimet e shumta me studentë e studiues të fushave të ndryshme në periudha të ndryshme kohore dhe në vende të ndryshme. Sqarimet, propozimet e zgjidhjet që i ka afruar ai, në mbështetje të Kur`anit dhe hadithit janë bërë kanun për ata besimtarë që besojnë Kur`anin dhe hadithin. Për këtë sukses meritë e veçantë i takon edhe hoxhë F.Gylenit, i cili me metodën e vet për të prezantuar ajetet e Kur`anit dhe hadithet e Muhammedit a.s. para auditorit, e tani edhe përpara lexuesit shqiptar, ka arritur që të

bëhet shumë tërheqës për opinionin shqiptar.

Ai, ashtu siç është vetë i bindur se porosinë e Muhammedit a.s. janë një burim i pashtershëm, apo siç shprehet ai dritë e pashuar, ka arritur të bindë edhe opinionin islam që të mos shmanget nga kjo bindje.

E veçanta e këtij libri është se Gyleni ka një qasje të re për afri-min e haditheve para opinionit dhe kjo është, me siguri, faktori që i siguron atij suksesin e pakontestueshëm dhe nxit opinionin që veprat e tij t'i lexojë pa përtesë dhe me kureshtje.

Qasja e H.Gylenit ndaj haditheve për t'i bërë më të kapshëm për lexuesit është shumëdimensionale. Këtu nga ajo qasje kemi veçuar dimensionin historik dhe psikologjik.

Hoxha F.Gylen në këtë botim nuk e ka ndjekur metodën të cilën e praktikojnë edhe sot pjesa dërrmuese e vaizëve, në xhami apo në raste tjera, që fillojnë me Hadithin dhe pastaj e komentojnë atë hadith, duke marrë disa herë për ilustrim edhe tjera burime, madje edhe ajete të Kur'anit. H.Gyleni një herë e trajton çështjen konkrete dhe pastaj, pasi të

jetë përgatitur lexuesi të pranojë porosinë e atij trajtimi, H.Gyleni i sjell hadithin e Muhammedit a.s. Ai për shembull, kur flet për namazin bën një shpjegim paraprak shumë të gjatë, me çka arrihet një efekt psikologjik te lexuesi, për t'i thënë, në fund, se Muhammedi a.s. ka thënë: الصلاة عماد الدين “*Namazi është shtylla e besimit*”

Në jetën e njeriut, namazi është një faktor i rëndësishëm, baza e të cilit është mbështetur në miraxh, vazhdon hoxha Gylen. Namazi e vë në lëvizje anijen e fesë. Pa namaz është e pamundur që feja të qëndrojë në këmbë kohë të gjatë (fq.353.)

Ai kështu vepron edhe atëherë kur e përshkruan shpërblimin e një femre të pamoralshme, vetëm për shkak të mëshirës së saj që e shprehu ndaj një qeni të etshëm:

Allahu, për shkak të një qeni, e fali një grua të pamoralshme dhe e futi në xhennet. Qeni po kuiste në anë të një pusi me gjuhën e varur nga etja e madhe. Gruaja në fjalë, që mu në ato çaste po kalonte aty pari, e pa gjendjen e qenit dhe nuk mundi të durojë. U afrua menjëherë, hoqi qemerin nga beli, e lidhi me

të këpucën, nxori me të ujë nga pusi dhe i dha qenit për të pirë. Dhe qeni shpëtoi. Ja, pra, kjo sjellje ndaj një qeni u bë pretekst për faljen e gruas, të cilën Allahu e çoi në xhennet (fq.402).

Gjithashtu edhe ndëshkimin e një femre tjetër, e cila nga zemërgursia e saj e kishte lënë një mace pa ushqim dhe pa ujë derisa ajo ngordhi:

Një grua hyri në xhehennem për shkak të një maceje. As i jepte për të ngrënë gruaaja macës, as për të pirë dhe as e lëshonte të lirë. Dhe, kështu, macja ngordhi. Edhe gruaaja për këtë shkak hyri në xhehennem.

Për ta ilustruar qëllimin e ajetit të Kur'anit kerimit, në të cilin thuhet se Muhammedi a.s. është dërguar mëshirë për tëra krijesat, jo vetëm për njerëzit, F. Gylen ka sjellë edhe rrëfimin vijues.

Myslimanët po ktheheshin nga një luftë. Në kohën e pushimit, disa nga pasuesit shohin një fole zogjsh, i marrin zogjtë e vegjël dhe i përkëdhelnin. Pikërisht në atë kohë vjen e ëma e zogjve, i sheh zogjtë në duart e këtyre njerëzve dhe fillon të përpiket e të silltet rreth tyre. Kur u njoftua Profeti për këtë, zemërohet shu-

më dhe urdhëron që zogjtë menjëherë të lëshohen në fole.

Hoxha Gyleni nuk është i ngurtë në metodologjinë e tij të trajtimit të temave të ndryshme. Ndonjë herë edhe ky e fillon bisedën me hadith, si për shembull, në rastin kur shqyrton përgjegjësinë e masës, e cila e zgjedh pri-jësin e vet dhe reflektimin e asaj udhëheqje te të udhëhequrit.

Gyleni nën titullin: *Si të jeni, ashtu do të qeveriseni*, është mbështetur plotësisht në hadithin e Muhammedit a.s dhe e fillon:

“Në një tjetër hadith, Profeti ynë (s.a.v.) urdhëron e thotë:

Si të jeni, ashtu qeveriseni!” (fq.303), ...dhe pastaj vazhdon shpjegimin e këtij hadithi.

Ç`të jetë cilësia juaj, do të jetë edhe e atyre që keni në krye. Ç`lloj burimi të jeni, edhe ata që keni në krye do të jenë prodhim i atij burimi. ...

Së pari ky hadith u thotë masës që ndodhet nën administrim ose qeverisje, se ata janë shumë të rëndësishëm. Sepse njerëzit që do të vijnë në krye të tyre, janë të detyruar të trokasin në portën e tyre pavarësisht nga ç`rrugë do të nisen. Me fjalë të tjera, masa është ajo që do t`iu

japë trajtë administratorëve....esenciale është konstrukti moral i njerëzve që administrohen... (fq. 304)

Hoxha F.Gyleni në këtë vëllim, raportin: **Udhëheqës - i udhëhequr**, e trajton edhe më në hollësi, aty ku flet për të drejtat e Zotit, të shtetit dhe të fesë. Në këtë kontekst ato të drejta radhiten kështu: *E para*, takvaja, e drejta e Zotit. *E dyta*, dëgjimi dhe bindja që është e drejta e atyre që drejtojnë shtetin. *E treta* lidhja fort pas sunnetit, traditës profetike, që është e drejta e fesë.

Këtu Gyleni, në bazë të haditheve të Muhammedit a.s. nxjerr përfundimin se "... rruga për në postin e halifit është e hapur për këdo. Po deshi populli, mund të sjellë në krye të shtetit edhe një zezak. Dhe pasi të bëhet kjo, çdo njeri është i detyruar t'i bindet atij".

Mirëpo, e tërë kjo duhet të jetë në harmoni me ajetin 58 të surës Nisa, të cilën Gyleni e ka shpjeguar në faqen 204. Pas rrëfimit për marrjen e çelësave të Qabes, Gyleni sjell hadithin e Muhammedit a.s. kur thotë: "*Kur të humbas amaneti, pritni kiame-tin*". Kur e pyetën sahabet: "*O i*

Dërguar i All-llahut, si humbet amaneti"? Ai u përgjigj: "*Kur puna i jepet atij që nuk është kompetent*"!

Në këtë pjesë të librit: *Muhammedi, dritë e pashuar...* autori trajton një mori temash, si: *Njeriu është një udhëtar, Njeriu rri me atë që do, Si të jeni ashtu do të qeveriseni, Aktet janë sipas njetit, Belaja e dorës dhe e gjuhës, Durimi, Llojet e durimit, Tri të drejta: E drejta e Zotit, e shtetit dhe e fesë, Kundërshtimi i nënës, Dhembshuri edhe për kafshët, etj., nga të cilët lexuesi do të pajiset me informim dhe edukim të denjë për një besimtar të tipit, si e quan Hoxha Gyleni: Besimtar të përgjegjës.*

Ky botim i realizuar në gjuhën shqipe është një pasuri e pashtershme për lexuesin shqiptar. Ndonjë e metë, që janë të pranishme në çdo botim, nuk ia ulin vlerën këtij botimi, aq më pak veprës së Fetullah Gylenit.

Ai duke përmbyllur shkrimin e tij të rastit për këtë botim, që vjen në fillim, si Hyrje shprehet kështu:

"Ç'është e vërteta, çdo fjalë që flet për të, është e bukur, diçka që s'është e bukur duhet t'i li-

het shprehjes dhe stilit. Nëse do të ketë të meta të shprehjes e të stilit, ato më përkasin tërësisht mua. Kurse ato që i përkasin Zotërisë së Gjithësisë, janë vetëm e vetëm të bukura!"

Ky konstatim na obligon të përmendim disa lëshime, të cilat i përkasin përkthyesit dhe botuesit në gjuhën shqipe.

Meqë literatura islame në gjuhën shqipe është në një fazë kur po harmonizohen kriteret, që do të jenë në shërbim të stabilizimit të terminologjisë islame, këtu do të përmend disa lëshime, të cilat hasen edhe në botime tjera të teksteve islame në gjuhën shqipe.

Për shembull termi kalif nuk ka vend në terminologjinë islame, është imponuar nga qarqe jo islame, prandaj duhet të zëvendësohet me termin halif. Gjithashtu, njëllë sikur që është vepruar me emrin *Muhammed*, duhet vepruar edhe me emrin *All-llah*, sepse në këtë botim emri, ashtu siç është shkruar: Allah, paraqet një shkallë të deformimit, dhe në të njëjtën kohë mosrespekt ndaj emrit të përveçëm, i cili në origjinal shkruhet dhe lexohet *All-llah*.

Në botimin konkret, ndryshimi i titullit nga kopertina me atë në faqen e brendshme, f. 1,3 dhe 4, sikur e zbeh kuptimin e titullit dhe e bën të paqartë për lexuesit e painformuar sa duhet. Krahaso titullin nga kopertina me atë përbrenda: M.F. Gylen Dritë e pashuar, që është edhe në faqen 4, M.F.Gylen Sonsuz Nur-1. Mendoj se, sipas natyrës së gjuhës shqipe, titulli duhet të jetë: **H.z. Muhammedi s.a.v. Dritë e pashuar**.

Sado që titulli i librit në gjuhën shqipe "*Dritë e pashuar*", nuk është titull besnik i origjinalit – sipas origjinalit do të ishte "*Dritë e pafund*" – e mbulon tërësisht përmbajtjen dhe porositë e këtij libri.

Disa nga lëshimet, për të cilat mendoj se edhe përkthyesi edhe botuesi në gjuhën shqipe, duhet të jenë më të kujdesshëm për shkak të formimit të një terminologjie islame më korrekte dhe më stabile, do të ishin si vijon:

Shprehjet dhe fjalët: *mistikë islame*, (fq.1), *shkolla e h.z. Muhammedit*, (fq.7), *nxënësi i të dërguarit*, (fq.235), *seancë*, (fq.356), *kalif* (371) etj., nuk duhen përdorur në tekste të kësaj natyre, re-

spektivisht në tekstet islame në gjuhën shqipe. Në ribotimin eventual është më drejt të përdoret: *sufizëm islam, tradita e Muhammedit a.s., ashab, simpatizues i të dërguarit, rukne* ose pjesë përbërëse e namazit.

Kështu i shmanget keqinterpretimit nga ndonjë qëllimkeq, i cili këto shprehje mund t'i plasojë sikur Muhammedi a.s. paska qenë mësues dhe se paska pasur ndonjë shkollë. Misticizmi nuk është karakteristikë e Fesë Islame, mistifikimi është rezultat i gërshetimit të paganizmit me krishterimin. Edhe seanca nënkupton tjetër proces, i cili organizohet nga struktura të institucioneve të ndryshme, si gjyqësore, mjekësore etj. kurse *rukne* është term islam që përdoret për fazat e ndryshme të kryerjes së namazit, si: *Kijam, ruku, tehijjat* etj.

Pavarësisht nga ndonjë lëshim, gjë që është veti njerëzore, për këtë jemi të gjithë të vetëdij-

shëm, vepra e Fet`hullah Gylenit: Muhammedi a.s. Dritë e pashuar, plotëson një zbrazëti në literaturën islame shqiptare, për ç'gjë meritojnë mirënjohje dhe lëvdatë realizuesit në gjuhën shqipe, përkthyesi, botuesit etj., si edhe fondacioni "Atmosfera", i cili ka kontribuar që ky botim të gjendet edhe në hapësirën e Kosovës.

Kjo vepër e F.Gylenit është gatuar me brumë të Kur`anit dhe hadithit. Autori është shërbyer me koleksionet më të besueshme të haditheve të Pejgamberit Muhammed a.s. si: Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi etj.

Njerëzit që punojnë gabojnë, por ata përmirësohen, ata që nuk punojnë bëjnë gabimin më të madh dhe ata nuk kanë mundësi ta kuptojnë gabimin e vet, aq më pak ta përmirësojnë.

Dr. Feti Mehdiu

RECENSION

Mr. Qemajl Morina

"DRITË E PASHUAR" HZ. MUHAMEDI" (S.A.V.)

**Autor: M. Fethullah Gylen, Botim: janar 2004, Tiranë
Përktheu nga origjinali: Dr. Mithat Hoxha**

Libri, "Dritë e pashuar" hz. Muhamedi" (s.a.v.), i autorit M. Fethullah Gylenit, përrurimin e të cilit po e bëjmë sot, është ndër librat më të mirë dhe më gjithëpërfshirës, që janë shkruar kohëve të fundit në botën islame. Prandaj, me përkthimin e tij në gjuhën shqipe, biblioteka shqiptare është pasuruar me një margaritar të çmuar nga jeta dhe vepra e Pejgamberit tanë të dashur Muhamedit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të. Në mënyrën e shtjellimit të ngjarjeve dhe tema-

tikës, ky libër ka ngjashmëri me librin e Imam Vehbi Ismailit, "Profeti Islam", i botuar në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar.

Thënë realisht, personaliteti i Muhamedit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, vazhdimisht, gjatë historisë islame, ishte objekt studimi, interesimi, imitimi, si dhe shembull tipik i zbatimit në jetë të veprimeve dhe sjelljeve të tij. Si mos të jetë kështu kur edhe vetë Kur'ani, libri i shenjtë i myslimanëve për të tho-

të: *"Ti o (Muhamed) je në piedestalin më të lartë të moralit"*, si dhe ajeti tjetër *"dhe ju në të dërguarin e Allahut keni shembullin më të mirë"*. Kurse vetë Pejgamberi a.s. thotë: *"Jam dërguar t'jua plotësoj fisnikërinë e moralit"*.

Nga ana tjetër, ne myslimanët e dimë se Sunneti është burim i dytë i jurisprudencës islame menjëherë pas Kur'anit. Prandaj, duke u nisur nga këto premisa, dijetarët myslimanë u kushtuan rëndësi shumë të madhe veprave, sjelljeve dhe thënieve të Pejgamberit a.s. Për këtë edhe u shkruan libra të shumtë, të cilët spikaten të gjitha anët e jetës, veprave dhe thënieve të Muhamedit a.s..

Autori, librin e tij "Dritë e pashuar hz. Muhamedi (s.a.v.) kryesisht e mbështet në Kur'anin famëlartë dhe në literaturën burimore të autorëve myslimanë siç janë: ibnu Hishami, autori i parë i Biografsë së Pejgamberit a.s., pastaj Muhamed bin Sa'di, ibnu Kethiri, Buhariu, Muslimi, ibnu Haxheri e shumë autorë tjerë të njohur të shkencave islame. Gjë që kjo i jep një vlerë të veçantë këtij libri, por në të njëjtën kohë nuk mund të mohohet fakti se ky

libër përmban një dozë të madhe të misticizmit islam, gjë që edhe kjo pritet prej një autori, siç është Fethullah Gyleni.

Pjesën e parë të librit, autori ia kushton kryesisht, biografisë së Pejgamberit a.s., dhe jetës së tij në periudhën para shpalljes dhe virtyeteve të larta, me të cilat ai ishte pajisur. Ai tërë këtë periudhë të gjatë kohore e përfshin me një fjali kur thotë: "Edhe para profetësisë ai pati jetuar si profet".

Pjesa tjetër e librit kryesisht bën fjalë për shpalljen, kumtimin e saj me përpikëri, adhurimet në Islam, si dhe obligimet tjera, të cilat përbëjnë edhe esencën e Islamit. Për të arritur në universalitetin e thirrjes së Pejgamberit a.s., dhe dërgimin e tij mëshirë për të gjitha krijesat .

Ai ishte krenaria e njerëzimit. Që prej katërmbëdhjetë shekujsh, gjenitë më të mëdhenj dhe filozofët gjigantë me përmasa botërore si dhe shumë e shumë teorecientë e mendimtarë, kanë ndenjur të përulur nën hijen e tij duke i thënë: "Ti je njeri për të cilin ne krenohemi që i përkasim"!..

Madhësisë së tij i mjafton qoftë edhe kaq që ne, në kohën

tonë, pas kaq e kaq lëngatash, në të katër anët e planetit, dëgjojmë ende sot tek përhapet nga minaret thirrja “Eshhedu ene Muhameden Resulullah”. (Dëshmoj se Muhamedi është i dërguari i Allahut”.

Po, koha plaket e thinjet, disa mendime vjetrohën e humbasin vlerë, kurse Muhamedi a.s., në zemrat e besimtarëve, si një gonxhe që çel nga pak e më shumë çdo ditë, ripërtërihet e bëhet çdo ditë edhe më e freskët. Ndërkohë që shumë “izma”-ve, pa kaluar ndoshta edhe vetëm pak dekadë u del moda. Shohim ditëve të xhuma që xhamitë janë të vogla për të zënë besimtarët që shkojnë për ta falur namazin e xhumasë, të cilët kryesisht janë të rinj. Shtrohet pyetja, cila është ajo fuqi që i tërheq ata?!

Nga ky libër, lexuesi përveç tjerash, mund të pajiset edhe me sa vijon:

*Në të shohim portretin e Pejgamberit, njeriun që u shkruan mbretërve dhe perandorëve të asaj kohe, duke kërkuar prej tyre që të braktisin mashtrimin e tyre të rrejshëm. Shohim se si dëgjon, me kënaqësi dhe dashamirësi, fjalët e një beduini të zbatshur, i cili i drejtohet atij

me një vrazhdësi “Ve pro me drejtësi, o Muhamed, sepse kjo nuk është pasuria jote as pasuria e babait tënd”!!!

* E shohim të devotshmin dhe pendestarin që qëndron në namazin e tij, lexon një sure të gjatë të Kur’anit me kënaqësi dhe përkushtim. Këtë kënaqësi, ai nuk do ta ndërronte, sikur t’ia mbushnin tërë sipërfaqen e tokës me kurora ari. Por, nuk shkon pak dhe ai dëgjon vajin e një foshnje, nëna e të cilit po falej pas Pejgamberit në xhami. Për hir të tij ai sakrifikon kënaqësinë e tij më të madhe dhe përfundon namazin me shpejtësi, në shenjë mëshire për foshnjën, që qante dhe thërriste nënën e vet me vajin e tij.

* Shohim njeriun, para të cilit qëndruan – të përlulur të gjithë ata që e urrejtën dhe nuk lanë mjet pa e luftuar për vite me radhë. Masakruan xhenazen e xhaxhait të tij, shehid – Hamzait – duke i ngrënë mushkëritë e tij me një barbarizëm të paparë. Megjithatë, ai u thotë: “Shkoni, jeni të lirë”!!

* Shohim njeriun që mblidhte dru për shokët e tij, në një prej udhëtimeve, për të ndezur

zjarr, që të përgatisnin ushqim..!

* Shohim njeriun që po dridhej, kur pa kafshën mbi shpinën e së cilës ishte ngarkuar më tepër se pesha që kishte fuqi të bartte..!!!

* Shohim njeriun që milte delet, qepte rrobat dhe rregullonte nallanet e tij.

* Shohim njeriun që qëndron në turmën e njerëzve dhe, me zërin më të lartë, thërrret:” “Nëse dikujt i kam mëshuar ndonjë kamxhik në shpinën e tij, ja kjo është shpina ime, le të marrë hak”!!

* Ja pra - ky është njeriu - në shkallën më të bukur, më të lartë dhe më të përkryer që mund të arrijë njeriu.

Pejgamberi ynë pati edhe veçori **njerëzore**, të cilat i përfaqësoi në shkallën më të lartë, dhe me të cilat na u bë udhëzues edhe neve. Për shembull, ai qe një kryetar familjeje i shkëlqyer.

Ai ishte një udhëheqës ushtarak i shkëlqyer, një mjeshtër i luftës. Me një grusht njerëzish që bënin dritë përreth, ai pati rrafshuar për tokë frontet e mbretërve që i patën shpallur luftë botës.

Gjithashtu, ai pati qenë njeriu që qe dashur nga shokët e tij në përmasa që nuk do t’i mundësohen e nuk do t’i takojnë asnjë njeriu. Për shembull në mbarim të luftës “Ma-u Rexh”, kur Hubejb bin Adijji, qe vënë në tryezën e ekzekutimit prej heretikëve të çmendur me zjarrin e hakmarrjes, qe vënë para një alternative të tillë: “A do të deshe që në këtë çast, në vendin tënd të ekzekutohej Muhamedi? Dhe përgjigjja e tij pati qenë e prerë, e qartë dhe e pathyeshme: “Jo vallahi, nuk do të pranoja që, në këmbim të shpëtimit tim, t’i ngulej atij qoftë edhe një gjemb në këmbë!”

Dhe ja një tablo tjetër kënaqësie për zemrën e çdo njeriu që ende beson, megjithëse nga ngjarja në fjalë kanë kaluar shekuj. Ishte lufta e Uhudit. Zonja Sumejra, dëgjon se i Dërguari i Allahut ka rënë dëshmor, e ndalon vrapin në rrëzë të malit Uhud dhe, ndërsa nuk interesohet aspak tek i tregojnë kufomat e të atit, burrit, e djemve të rënë dëshmorë, vazhdon ta kërkojë në çdo vend Profetin duke mërmëritur: “Ç’u bë me të Dërguarin e Allahut?” Pastaj, në një çast, kur i tregojnë se ku ndodhet, shkon, i bie para

këmbëve dhe i thotë: “Pasi që ti je gjallë, të gjitha fatkeqësitë më lehtësohen, o i Dërguari i Allahut”. Ja të tillë vend pati zënë ai ndër zemrat!

Ai ishte një njeri që i zgjidhte të gjitha problemet e jetës shoqërore me lehtësi. Bernard Shou që ka jetuar 13 shekuj pas Profetit, me fjalët e mëposhtme, është vetëm njëri prej qindra kundërshtarëve të tij, që e pranojnë këtë të vërtetë: **“Sa nevojë ka njerëzimi në shekullin tonë të grumbu-**

llimit të problemeve njëri përmbi tjetrin për Muhamedin, që zgjidhte të gjithë vështirësitë me lehtësinë e pirjes së një kafeje!”

Ne myslimanët, pasuesit e këtij peygamberi me këto virtytet aq të larta, kemi nevojë më shumë se asnjëherë më parë, të ndjekim rrugën dhe shëmbëlltyrën e tij. Libri që sot po promovohet është një udhërrëfyes shumë i mirë që mund të na ndihmojë në këtë drejtim.

RECENSION

Fjalë promovimi për veprën "Dritë e pashuar" të autorit Fetullah Gylen

VEPËR QË NA E BËN MË TË DASHUR FIGURËN E PEJGAMBERIT TONË, MUHAMEDIT A.S.

Libri me karakter monografik, "Dritë e pashuar" e dijetarit të shquar Fetullah Gylen, tematizon rrugën e papërsëritshme jetësore, veprën monumentale dhe mesazhin shpëtimtar që la pas vetes, njeriu më i zgjedhur i njerëzimit, pejgamberi i fundit, Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të.

Duke qenë libër që i kushtohet profetit të fundit që erdhi si mëshirë e madhe e Krijuesit të Botëve për njerëzimin, "Dritë e pashuar", është e shkruar me shumë dashuri njerëzore dhe me shumë frymëzim intelektual e

poetik. Edhe në rastin e autorit të kësaj vepre, Fetullah Gylenit, vlen ajo që ka thënë dijetari i njohur, David Benxhamin Keldani alias Abdulahad Davudi lidhur me rolin prej udhërrëfyese të pejgamberit Muhamed. Keldani thotë se "në çastin që unë besova në Njëshmërinë Absolute të Zotit, Apostulli i Tij, Muhamedi, u bë shembull për qëndrimin dhe sjelljen time". Pra, edhe Gyleni e konsideron model ideal jetën dhe veprën e Muhamedit, ashtu që edhe studimi i tij është një përpjekje për ta artikuluar atë ideal të jetës dhe të besimit.

Prej këndeje e ka burimin stili poetik, që e përshkon këtë vepër. Autori Fetullah Gylen e ka kombinuar talentin e poetit me dijen e studiuesit, duke na e dhënë një vepër që lexohet me shumë kurreshtje dhe me një frymë.

Stili poetik shfaqet me anë figurash stilistike, me anë përshkrimesh poetike dhe me perceptime që e kanë dimensionin brilant poetik. Edhe vetë titulli, "Dritë e pashuar", në fakt është një metaforë poetike, e cila e përtafron figurën dhe veprën e protagonistit të vet me një fuqi kozmike, që bën dritë të përjetshme.

Duke qenë një thirrës konsekuent dhe një aktivist i paepur i besimit Islam, autori e ka për zemër edhe stilin retorik, i cili e bën më të afërt lidhjen mes folësit dhe auditorit. Edhe kjo frymë e komunikimit retorik me synim të ndikimit direkt, është prezente në këtë vepër, me ç'gjë ajo fiton një shkallë më të lartë të komunikimit. Rrjedhimisht, vepra është larg ftohtësisë akademike. Kësisoj, vepra "Dritë e pashuar" lë shumë mbresa autoriale, të cilat shumë herë e dominojnë informacionin. Edhe kjo mënyrë e shkrimit ka të bëjë me dëshirën e

autorit që të ndikojë mbi publikun me anën e ndjenjave dhe të efekteve psikologjike, mbase duke e ditur se publiku i ka të njohura informatat themelore për jetën dhe veprën e profetit Muhamed dhe se i duhen më shumë sugjerime komentuese dhe vlerësuese. Kjo mënyrë e trajtimit, më tutje e shpalos tonin glorifikues të autorit ndaj protagonistit të veprës, me ç'rast stili poetik zë vend dominant.

Në planin e ndërtimit, vepra "Dritë e pashuar" nuk e ndjek detyrimisht rendin kronologjik të ngjarjeve. Edhe pse e filluar nga paralajmërimet në librat e shenjtë për ardhjen e profetit të fundit, pastaj fëmijërinë e tij, vepra rikthehet te diskutimi i shkaqeve për dërgimin e profetëve në këtë botë nga Krijuesi, te veçoritë e profetëve, me ç'rast jepet dëshmi plotësuese e dijeve më të thella të autorit për tërë problematiken fetare.

Analiza e një tufe hadithesh po ashtu paraqet një plotësim të trajtimit të figurës dhe të veprës së Muhamedit a.s., duke e dhënë edhe më të plotë e më mbresëlënëse. Vepra "Dritë e pashuar" me këtë qasje rikthehet në shtratin e

dijeve dhe komentimeve tradicionale për jetën dhe veprën e Muhamedit a.s.

Marrë në përgjithësi, kjo veper për na e bën më të afërt e më të dashur figurën e peygamberit tonë, Muhamedit a.s., për ç'gjë ka merita edhe përkthyesi Dr. Mithat Hoxha, që ka dhënë një përkthim elegant, dhe me fuqi të

shkëlqyeshme shprehëse, duke e dhënë edhe një provë të re për aftësinë dhe bukurinë fantastike të gjuhës shqipe, e cila është e aftë të përballojë edhe stile komplekse si stili i Dr. Fetullah Gylenit.

Dr. Milazim Krasniqi

Një version të bibliografisë së punimeve të Haxhi Sherifit, e patëm botuar në revistën “Studime Orientale” nr. 1/2001, mirëpo pas botimit kam vërejtur se që atëherë nuk kemi arritur t’i përfshinim të gjitha punimet, sidomos ato të botuar në “Buletin”, kjo mbase që edhe arsyeja kryesore për botimin e versionit të plotësuar

BIBLIOGRAFI

Ramadan Shkodra

BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE TË H. SHERIF AHMETIT (version i plotësuar)

Të nderuar lexues!

Në këtë numër të revistës “Edukata Islame”, po sjellim Bibliografinë e punimeve të alimit e dijetarit tanë të shquar, që njëherësh është edhe themelues i publicistikës islame në gjuhën shqipe pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, Haxhi Sherif ef. Ahmeti.

Në këtë bibliografi janë paraqitur 190 zëra bibliografik që pasqyrojnë kontributin monumental të H. Sherifit, botuar në periodikun islam për më tepër se dy dekada.

Përveç zërave të botuar në periodikun islam, në këtë bibliografi janë përfshirë edhe botimet e veçanta që zënë fill në vitin 1968, me botimin e Ilmihalit, të përkthyer nga gjuha boshnjake.

Në këtë bibliografi kemi paraqitur vetëm botimet e para, kurse ribotimet e mundshme, qofshin në periodikë, qofshin në botime të veçanta, i kemi shënuar në fusnotë.

Në zërat bibliografik të botuara në periodikun islam, janë paraqitur fillimisht ata të botuar në Takvim, pastaj në Edukatën Islame, e kështu me radhë.

1968

1. Fejzulla HAXHIBAJRIQ: *ILMIHAL, (THEMELET E FESË ISLAME)*¹, botoi: **Kryesia e Bashkësisë së Fesë Islame të Jugosllavisë**, Prishtinë 1968, f. 76.

1969

2. *AKAIDUL ISLAM*; skriptë për klasën e I të medresesë së mesme “Alauddin”, **botoi: M.M “ALAUDDIN”**, Prishtinë, f. 35.
3. *AKAIDUL ISLAM*; skriptë për klasën e II të medresesë së mesme “Alauddin”, **botoi: M.M “ALAUDDIN”**, Prishtinë, f. 49.
4. *ILMUL KELAM*; skriptë për klasën e III të medresesë së mesme “Alauddin”, **botoi: M.M “ALAUDDIN”**, Prishtinë, f. 57.

1970

5. *MUHAMEDI A.S., BOTA NË PERIUHDHËN E LAJMËRIMIT TË TIJ*; **Buletini**, (prill-qershor 1970), fq.15.
6. *EBU EALA EL MEVDUDI: ISLAM (PSE U QUJT FEJA JONË ISLAME)*; **Buletin (korrik –shtator 1970)**, fq.1-5.
7. *KUR’ANI DHE PROBLEMET E JETËS (ANGAZHIMI PËR PAJTIMIN E PALËVE NË KONFLIKT)*; po aty fq. 6-10.
8. *BEJTUL MUKADDESE*², po aty fq. 11-17.
9. *FEJA ISLAME DHE SHKENCA*³; po aty fq. 18-25.
10. Islami dhe Dituria; **Buletini; tetor-dhjetor 1970**, fq. 1-4.

¹ Përktheu dhe përshtati

² Përkthim nga arabishtja

³ Përkthim nga Glasnik-u (gjuha boshnjake).

11. *EBU-L- XHMIM, MBI NJË SHKRESEË, Buletini*, (tetor-dhjetor), f. 11-19.
12. *AHMARRJA; Takvim⁴ për vitin 1970-1389/90*, fq. 30-37.

1971

13. *BAJRAMI DHE KURBANI; Takvim për vitin 1971-1390/91*.
14. *KUSHTET DHE DISPOZITAT E FESË ISLAME; Takvim për vitin 1971-1390/91*.
15. *PREZANTIMI I ZOTIT XH.SH. NË NATYRË DHE PROÇESE; Edukata Islame nr. 1/1971*, fq. 6-9.
16. *PROFETI –PEJGAMBERI MUHAMED KËSHILLON*; po aty, fq. 10-13.
17. *ISLAMI ËSHTË DITURI E KULTURE*, po aty fq. 14-18.
18. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES “VEL ASRI”; Edukata Islame⁵ nr. 2/1971*, fq. 3-9.
19. *PROFETI MUHAMED KËSHILLON*; po aty fq. 19-21.
20. *SHKOLLIMI-ARSIMIMI I FEMRËS DHE ISLAMI*; po aty fq. 42-45.
21. *MIRË SE NA VJEN MUAJ I MADH I ARSIMIT ISLAM!; Edukata Islame nr. 3/1971*, fq. 3-7.
22. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES “EL-FATIHA”; po aty fq. 8-16*.

⁴ Publikim vjetor, botohet në Prishtinë prej vitit 1970, nga shoqata e Ylemave të Kosovës, ndërsa nga viti 1997 nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

⁵ Revistë fetare tre mujore organ i Këshillit Ekzekutiv të Shoqatës së Ylemave të Kosovës, botohet në Prishtinë

1972

23. *EDUKIMI ISLAM; Takvim për vitin 1972, hixhrij 1391/92*, fq. 34-45.
24. *STATISTIKA E BESIMTARVE TË FESË ISLAME NË BOTË; po aty fq. 43-50*.
25. *KOMENT I AJETIT “INEDDINE INDALL-LLAHIL ISLAM”; Edukata Islame nr. 4/1972*, fq. 3-8.
26. *ALI IBNI EBI TALIB DHE DREJTËSIA E GJYGJIT ISLAM⁶*; po aty fq. 36-41.
27. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES “IHLAS”; Edukata Islame” nr. 5/1972*, fq. 3-9.
28. *DISA FJALË MBI PEJGAMBERIN E FESË ISLAME*, po aty fq. 10-16.
29. Abdullbeidë SAKAR “*LITARI I DRUNJT*”⁷; po aty fq. 56-57.
30. *KOMENT I AJETIT “REBENA ATINA FIDDUNJA HASENETEN VE FIL AHIRETI HASENETEN VE KINA ADHABENAR”; Edukata Islame nr. 6/1972*, fq. 3-10.
31. *GJURMAVE TË ARTIKULLIT TË SHKRUAR NGA PROF. FEHMI KELMENDI, E TË BOTUAR NË REVISTËN MUJORE “FJALA” NR. 29/A*, (reagim); po aty fq. 42-47.

1973

32. Abutevab JUSUF: “*BISMIL-LAHI*”⁸; **Takvim për vitin 1973 hixhrij 1392/93**, fq. 53-55.
33. *KUSH JANË PRINDRIT?*; po aty fq. 56-58.
34. *TË KEQIT I MJAFTON E KEQJA E VET*⁹; po aty fq. 59-60.
35. *IMANI-IBADETET DHE DOBIA E TYRE NË SJELLJET E BESIMTARIT; Edukata Islame nr. 7/1973*, fq. 6-11.

⁶ Përkthim, nuk është dhënë emri i autorit

⁷ Tregim i përkthyer

⁸ Përkthim

⁹ Përkthim, edhe këtu nuk është dhënë emri i autorit

36. *I SMUARI ËSHTË NËN HIJEN E MËSHIRËS SË ZOTIT*; po aty fq. 39-42.
37. *U ARRIT AJO PËR ÇKA U SHPRESUA*¹⁰; po aty fq. 71-72.
38. *DREJTËSIA NË ISLAM*; **Edukata Islame nr. 8/1973**, fq. 3-10.
39. *MREKULLIA E KUR'ANIT FAMËLARTË*; po aty fq. 35-41.
40. *NDOSHA E DINI*¹¹; po aty fq. 70-74.

1974

41. *HUTBETUL VEDAË* (fjalimi lamtumirës i Muhamedit a.s.); **Takvim për vitin 1974 hixhrij 1393/94**, fq. 36-40.
42. *GRUAJA NË FENË ISLAME*; po aty fq. 54-58.
43. *DUAJA-LUTJA*; po aty fq. 62-65.
44. *MËSIMET TË CILAT LYPSET ME I DITË MBI KUR'ANIN*; po aty fq. 68-71.
45. *PSE TË BESOJMË?*; **Edukata Islame nr. 9-10/1974**, fq. 3-8.
46. Abdul Mun'in En Nemr: *SI TA KUPTOJMË ISLAMIZMIN?*¹², fq. 16-22.
47. *KOMENT I AJETIT "O JU NJERËZ, NE U KRIJUAM PREJ NJË MASHKULLI DHE NJË FEMRE, U BËMË QË TË JETONI NË BASHKËSI-KOMBE E FISE..."*; **Edukata Islame nr. 11-12/1974, fq.3-7**.
48. *ALL-LLAHU EKBER-ZOTI ËSHTË MË I MADHI*¹³; po aty fq. 37-41.
49. *E PARA E BIJAVA TË PEJGAMBERIT A.S. (ZONJA ZEJNEB R.A.)*; po aty fq. 59-64.

¹⁰ Shënim me rastin e diplomimit të gjeneratës së VI të maturantëve të M.M. "Alauddin" në Prishtinë

¹¹ Shënim për fillimin e ndërtimit të godinës së re të medresesë së mesme "Alauddin" në Prishtinë

¹² Përkthim

¹³ Koment për sintagmën All-llahu Ekber

1975

50. *PROFETI –PEJGAMBERI MUHAMED KËSHILLON*; **Takvimi për vitin 1975, hixhrij 1394/95**, fq. 77-81.
51. *KOMENT PËR AJETIN "DHE FALE NAMAZIN ME SIGURI NAMAZI LARGON PREJ IMORALITETIT DHE PREJ PUNËS SË SHËMTUAR, POR TË PËRKUJTON....."*; **Edukata Islame nr. 13/1975**, fq. 3-6.
52. *-PENDIMI (TEVBE)*; po aty, fq. 43-46.
53. *-BESIMTARËT E ZOTIT DHE TË DËRGUARIT E TIJ*; **Edukata Islame nr. 14/1975**, fq. 3-6.
54. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 183 TË SURES EL-BEKARE*; po aty, fq. 7-10.
55. *SHKOLLAT FETARO-FILOZOFIKE NË FENË ISLAME - (I)*; po aty fq. 48-52.
56. *PËRKUJTIMI NDAJ BESIMIT-IMANIT*; po aty fq. 53-56.

1976

57. *SI VËRTETON HERAKLIU MBI PROFETËSINË E MUHAMEDIT A.S.*; **Takvim 1976 hixhrij 1396**, fq. 82-88.
58. Dr. Ahmed SHEVKI: *TË NDEZURIT E DUHANIT (NË PIKËPAMJE HISTORIKE, SHKENCORE, MEDICINALE DHE FETARE*¹⁴); po aty fq. 110-116.
59. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES KEVETHER*; **Edukata Islame nr. 15-16/1976**, fq. 3-5.
60. *QABEJA DHE HAXHI-(I)*; po aty fq. 45-50.
61. *PËR TË FOLË MBI FENË!*¹⁵; po aty fq. 51-53.
62. *SHKOLLAT FETARO FILOZOFIKE NË FENË ISLAME (II) HA-VARIXHËT*; po aty fq. 59-62.
63. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË XHUMASË "O JU QË KENI BESUAR, KUR TË THIRRET PËR NAMAZ DITËN E*

¹⁴ Përkthim, i njëjti është botuar edhe në revistën "Edukata Islame" nr. 15-16/1976 fq. 68-72

¹⁵ Vështrim

- XHUMA SHKONI NË PËRKUJTIMIN E ZOTI*”; **Edukata Islame nr. 17/1976**, fq. 3-8.
64. *BISEDË ME HAXHI ISMAIL EFENDI HAKIUN, KRYETAR I BI PËR RSS*; po aty fq. 9-14.
65. *QABEJA DHE HAXHI (II) (BAZAT E OBLIGIMIT PËR HAXH)*; po aty fq. 49-53.
66. *SHKOLLAT FETARO FILOZOFIKE NË FENË ISLAME (III) SHIJTË-IDEJA THEOKRATIKE*; po aty fq. 54-60.
67. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 129 TË SURES EL BEKARE*; **Edukata Islame nr.18/1976**, fq. 3-7.
68. *PUNA E PËRBASHKËT ËSHTË GJITHËNJË E FRYTSHME*; po aty, fq. 34-36.
69. *HAXHI DHE QABEJA (III)*, po aty, fq. 57-65.
70. *SHKOLLAT FETARO-FILOZOFIKE NË FENË ISLAME (IV) EL-MURXHIATU (SKEPTIKËT)*; po aty, fq.66-69.
71. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT 129 TË SURES EL-BEKARE*; **Edukata Islame nr. 18/1976**, fq. 3-7.
72. *PUNA E PËRBASHKËT ËSHTË GJITHNJË E FRYTSHME*; po aty fq. 34-36.
73. *HAXHI DHE QABEJA (III)*, po aty fq. 57-65.
74. *SHKOLLAT FETARO-FILOZOFIKE NË FENË ISLAME (IV), EL –MURXHIATU (SKEPTIKËT)*; po aty, fq. 66-69.

1977

75. *RRETH MREKULLISË SË KUR’ANIT*; **Takvim/Kalendar 1397-1977**, fq. 77-84.
76. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETEVE 1-4 TË SURES EL-BEKARE*; **Edukata Islame nr. 19/1977**, fq.3-8.
77. *LEXO, ËSHTË ÇELS I KULTURËS SË LINDJES DHE TË PERË-NDIMT, NUK ËSHTË HELM PËR NJERËZIMIN*; po aty, fq. 20-24.
78. *DITËLINDJET DHE DITËT E ZOTIT (VËSHTRIM PËR DATË-LINDJEN E PEJGAMBERIT)*; po aty fq. 29-32.

79. *SHKOLLAT FETARO-FILOZOFIKE NË FENË ISLAME (V) EL-MUTEZITU*; po aty fq. 36-40.
80. *RAMAZANI MUAJ I KUR’ANIT*; **Edukata Islame nr. 20/1077**, fq 3-9.
81. *FEJA KA LINDUR BASHKË ME NJERIUN*; po aty fq. 30-37.
82. *SHEMBËLLTYRA E MUHAMEDIT A.S.*; **Edukata Islame nr. 21**, fq 3-8.
83. *FEJA ISLAME NË ZGJIDHJEN DHE RREGULLIMIN E ÇËSHTJEVE NDËRNJERZORE*; po aty, fq. 17-23.
84. Vehidudin Hanë, *ARGUMENTET MBI AHIRETIN (I)*¹⁶; po aty fq. 35-43.
85. *ABDULLA BIN AMËR BIN ASS, AS-HAB I FAMSHËM*; po aty fq. 57-61.

1978

86. *EMRAT ME ORIGJINË TË ORIENTIT DHE DOMETHËNIA E TYRE*, **Takvim 1978**, fq. 37-72.
87. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES FELEK*; **Edukata Islame nr. 22/1978**, fq. 3-7.
88. *NJOHURI NGA LËMIA E FESË ISLAME (PEJGAMBERËT, LIBRAT, MREKULLITË)*; po aty, fq. 29-35.
89. Vehidudin HANË; *ARGUMENTET MBI AHIRETIN (II)*; po aty, fq. 45-49.

1979

90. *JETA E NJERIUT ËSHTË E SHEJTË!*, **Takvim-Kalendar 1979-1399**, fq. 96-109.
91. *TRYEZA E LEXUESVE*; po aty fq. 110-112.
92. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETUL KURSISË*; **Edukata Islame nr. 23/1979**, fq. 3-9.

¹⁶ Përkthim

93. Vehidudin HAN, *ARGUMENTET MBI AHIRETIN (III) NEVOJA PËR AHIRETIN*; po aty fq. 26-31.
94. MUHAMEDI, ISAJA DHE MUSAJA JANË TË DËRGUAR TË ZOTIT!; po aty fq. 50-51.
95. PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT “NE DO TË BËJMË TË MUNDUR ATYRE (NJERËZVE) TË SHOHIN.....”; **Edukata Islame nr. 24/1979**, fq. 3-8.
96. Vehidudin HAN, *ARGUMENTET MBI AHIRETIN (IV) NEVOJA MORALE*; po aty, fq. 31-36.
97. PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 72 TË SURES AHZABË, **Edukata Islame nr. 25/1979**, fq. 3-8.
98. NË PRISHTINËN E BUKUR EDHE MEDRESEJA E RE “ALAUDDIN”¹⁷; po aty, fq. 9-12.
99. TESAVVUFI NË VENDIN TONË; po aty fq. 48-52.

1980

100. *BESIMI NË ZOTIN E MADHËRUAR*; **Takvim 1400- Kalendar 1980**, fq. 56-72.
101. *FE DO TË THOTË: BESIM DHE VEPRIM*; po aty, fq. 73-83.
102. *ARGUMENTIMI MBI AHIRETIN*¹⁸; po aty fq. 98-123.
103. *ISRAJA DHE MIRAXHI*; **Edukata Islame nr. 26/1980**, fq. 3-10.
104. *MUHAMEDI NË MESIN E KINEZVE*¹⁹; po aty, fq. 45-52.
105. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES EL-KADËR*; **Edukata Islame nr. 27/1980**, fq. 13-19.
106. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT “NE NUK DËRGUAM ASNJË PEJGAMBER PARA TEJE....”*; **Edukata Islame nr. 28-29/1980**, fq. 3-9.
107. *TESAVVUFI*²⁰; po aty, fq. 36-42.

¹⁷ Shënim për ndërtimin e godinës së medresesë

¹⁸ Përkthim

¹⁹ Përkthim

²⁰ I njëjti është botuar edhe në Takvim1401-Kalendar 1981, fq. 57-62

1981

108. *SHPALLJA-KUR’ANI, PRANIMI I SHPALLJES DHE ESENCA E SHPALLJES*; **Takvim 1401-Kalendar 1981**, fq. 34-38.
109. *TË DËRGUARIT E ZOTIT (PEJGAMBERËT)*; po aty fq. 39-51.
110. *SHËMBËLLTYRA E MUHAMEDIT A.S.*; po aty fq. 46-51.
111. *FEJA – A MOS ËSHTË GJË E VJETRUAR?*; po aty, fq. 63-88.
112. *ORIGJINA E NJERËZIMIT DHE RESPEKTIMI I FAREFISIT*; **Edukata Islame nr. 30/1981**, fq. 9-14.
113. Abdutevab JUSUF: *ZEMRA E NËNËS*²¹, po aty, fq. 61-63.
114. *SHERIATI NË MES BESIMIT DHE VEPRIMIT*, **Edukata Islame, nr. 31-32/1981**, fq. 3-9.
115. *AKAID*, dispensë për klasën e I të medresesë së mesme “Alauddin, botoi: M.M. “ALAUDDIN”, Prishtinë, f. 58.
116. *AKAID*, dispensë për klasën e II të medresesë së mesme “Alauddin, botoi: M.M “ALAUDDIN”, Prishtinë, f. 70.
117. *AKAID*, dispensë për klasën e III të medresesë së mesme “Alauddin, botoi: M.M “ALAUDDIN”, Prishtinë, f. 71.

1982

118. *DYNJAJA (PO-JO) E MALLKUAR!*; **Takvim 1402-Kalendar 1982**, fq. 56-76.
119. *VEQORITË E FESË SË VËRTET*; po aty, 92-96.
120. *NJERIU, PO ATY*; fq. 104-110.
121. *Mahmud Riju MIJ: ISLAMIZIMI NË RUMANI*²²; po aty 149-152.
122. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 59 TË SURES NISA*; **Edukata Islame nr. 33-34/1982**, fq. 3-8.
123. *ISLAMIZMI DHE MARRËDHËNIET NDËRNJERËZORE*; po aty, fq. 30-32.
124. *NGUSHËLLIMI (E PAMJA-TA’ZIJE)*; po aty, fq. 60-63.

²¹ Tregim didaktik përkthyer, (i njëjti është botuar edhe në Takvim 1402-Kalendar 1982, fq. 126-129)

²² Përkthim

125. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 125 TË SURES NAHËL*; **Edukata Islame nr. 35-36/1982**, fq. 3-9.
126. *NGA KOMISIONI PËR PËRKTHIMIN E KUR'ANIT*²³; po aty, fq. 56.
127. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI (I) AJETET 1-25 TË SURES EL-BEKARE*; po aty fq. 57-60.
128. *KONFERENCA E DYTË NDËRKOMBËTARE MBI "DAVEN ISLAME DHE BOTËN BASHKËKOHORE"*²⁴; po aty fq. 64-66.

1983

129. *SURE JASIN*; **Takvim 1403-Kalendar 1983**, fq. 36-53.
130. *ISLAMIZMI DREJTËSI E PËRSOSUR*; po aty fq. 96-106.
131. *KALAVESHI I RRUSHIT*²⁵; po aty fq. 12-118.
132. *MERITA E ISLAMIZMIT PËR AFRIM MES NJERËZVE*; **Edukata Islame nr. 37-38/1983**, fq. 3-7.
133. *MEDRESEJA "ALAUDDIN"*²⁶; po aty, fq. 57-60
134. *TERMIDHIU*; po aty, fq. 65-67.
135. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI(II) - KAPTINA II, PËRKTHIM I AJETEVE 26-60 TË SURES BEKARE*; po aty fq. 73-78.

1984

136. *FEJA KA LINDUR BASHKË ME NJERIUN*; **Takvim 1404-Kalendar 1984**, fq. 36-46.
137. *FEJA ISLAME NË ZGJIDHJEN DHE RREGULLIMIN E ÇË-SHTJEVE NDËRNJERËZORE*, po aty fq. 103-106.
138. *MUHAMEDI A.S. ËSHTË SHEMBULL I VIRTYTEVE MORALE*; **Edukata Islame nr. 39/1984**, fq. 3-8.
139. *FJALA*; po aty, fq. 37-44.

²³ Informatë.

²⁴ Informatë.

²⁵ Tregim didaktik i përkthyer, nuk është emri i autorit.

²⁶ Vështrim kronologjik historikut të medresesë.

140. *MEVLUDI (MANIFESTIM PËR DITËLINDJEN E MUHAMEDIT A.S.)*; po aty, fq. 45-50.
141. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI(III) -KAPTINA II, AJETET 61-120 TË SURES BEKARE*; po aty fq. 55-63.
142. *AFËRIMI TE ZOTI XH.SH.*; **Edukata Islame nr. 40/1984**, fq. 3-10.
143. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI (IV) -KAPTINA II, AJETET 121-200 TË SURES BEKARE*; po aty fq. 60-74.
144. *TELKINI*²⁷; po aty, fq. 75-78.
145. Tahir efendi POPOVA; *MEVLUDI*²⁸; Prishtinë, f. 36.

1985

146. *BESIMI NË ZOTIN XH.SH.*; **Takvim 1405-Kalendar 1985**, fq. 36-52.
147. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I SURES EZ ZIL ZALE*²⁹; **Edukata Islame, nr. 41-42/1985**, fq. 3-11.
148. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI(V) -KAPTINA II, AJETET 201-286 TË SURES BEKARE*; po aty fq. 60-78.
149. *PËRGJEGJËSIA E NJERIUT*; **Edukata Islame nr. 43/1985**, fq. 3-9.
150. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI (VI) - KAPTINA III, AJETET 1-51 TË SURES ALI IMRAN*; po aty fq.10 -21.

1986

151. *PËRKTHIM DHE KOMENTIM I AJETIT TË 78 TË SURES NAHLË*; **Edukata Islame nr. 44-45/1986**, fq. 3-8.
152. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI(VII) -KAPTINA III, AJETET 52-103 TË SURES ALI IMRAN*; po aty fq. 9-19.

²⁷ Vështrim për Tallkinin.

²⁸ E transkriptoi dhe e adaptoi pjesërisht në gjuhën e njësuar shqipe.

²⁹ i njëjti punim për këtë sure është botuar edhe në Takvim 1406-Kalendar 1986, fq. 55-67.

153. *I DËRGUARI I ZOTIT XH.SH.*³⁰; po aty, fq. 106-108.
154. *KUR'ANI ËSHTË LIBËR I FESË*; **Edukata Islame nr 46-47/1986**, fq. 3-8.
155. *PËRKTHIM NGA KUR'ANI (VIII) - KAPTINA III, AJETET 104-155 TË SURES ALI IMRAN*; po aty fq. 9-19.
156. *Muhamed Ali SABUNI: NJOHURI LIDHUR ME KUR'ANIN*³¹; **Dituria Islame**³² **nr. 1 qershor 1986**, fq. 4-6.
157. *Muhamed Ali SABUNI: NJOHURI LIDHUR ME KUR'ANIN (2)*; **Dituria Islame nr. 2 shtator 1986**, fq.8-11.

1987

158. *ITATI ZOTIT XH.SH DHE TË DËRGUARIT E TIJ*; **Takvim 1407/8-Kalendar 1987**, fq. 50-60.
159. *KUSH JE TI?*; **Edukata Islame nr. 48-49/1987**, fq. 7-12.
160. *Përkthim nga Kur'ani(IX) - Kaptina III, ajetet 156-200 të sures Ali Imran*; po aty fq. 85-88.
161. *ÇKA DËSHIRON FEJA PREJ NJERIUT?*; **Dituria Islame nr. 4-5 janar qershor 1987**, fq. 5-6.
162. *MUHAMEDI A.S. PEJGAMBER DHE BASHKËSHORT*; **Dituria Islame nr. 6 korrik-shtator 1987**, fq. 5-12.
163. *RRETH BOTËS SË XHINVE*; **Dituria Islame nr. 7 tetor-dhjetor 1987**, fq. 8-11.

1988

164. *EMRAT QË PËRDOREN NDËR BESIMTARËT E FESË ISLAME*; **Takvim 1408-9/ 1988**, fq. 144-175.
165. *UDHËZIME ISLAME (RRETH PËRGATITJES SË TË VDEKURIT)*, po aty fq. 133-143.

³⁰ Vështrim rreth përdorimit të fjalës profet në literaturën islame në gjuhën shqipe

³¹ Përktheu dhe përshtati

³² Revistë e përmuajshme, botohet në Prishtinë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

166. *KUR'ANI, PËRKTHIM ME KOMENTIM, përktheu dhe komentoi, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame për RSS, Prishtinë, f. 904*³³.
167. *KURBANI*; **Dituria Islame nr. 8/9 janar qershor 1988**, fq. 3-6.

1989

168. *PËRKTHIM ME KOMENT I SURES JASIN*; **Takvim 1409/10-Kalendar 1989**, fq. 61-87.
169. *RAMAZANI MUAJ I BEKUAR*; **Dituria Islame nr. 12 janar-mars 1989**, fq. 3-5.
170. *RRYMA QË NUK PËRKOJNË ME MËSIMET ISLAME*; po aty fq. 14-17.
171. *HAJRATET DHE BID'ATET*, po aty fq. 39-41.
172. *KUR'ANI FAMËLARTË (SYNIMET DHE SHPREHJA E TIJ)*; **Dituria Islame nr. 13/14 prill-shtator 1989**, fq. 4-7.
173. *RRYMA QË NUK PËRKOJNË ME MËSIMET ISLAME (2)*; po aty fq. 28-31.

1990

174. *Qabeja dhe Haxhi*; **Takvim 1410/11 Kalendar 1990**, fq. 103-126.
175. *Muhaned Muteveli SHARAVI: SHPJEGIM I DOMETHËNI-EVE TË AJETEVE TË KUR'ANIT RRETH ISAIT A.S.*, **Dituria Islame nr. 15/16 korrik 1990**, fq. 11-13.

³³ Përkthimi dhe komentim i Kuranit nga Haxhi Sherfi Ahmeti është ndër librat më të botuar ndonjëherë në gjuhën shqipe e si i tillë është edhe ndër libra më të përhapur në të gjitha trojet shqiptare si dhe në diasporë. Është ribotuar në Kajro më 1992 nga El-Zahra PER informacionin Arab, pastaj po në Kajro 1993, nga Islamic Relief, ndërsa në Medinë më 1993 (1415 h) është ribotuar në 1 milion copë në Kompleksin e Mbretit Fehd për shtypjen e Kuranit të Ndershëm. Është ribotuar edhe në Prishtinë më 1987 nga WAMY si dhe në Medinë (Kompleksi i Mbretit Fehd për shtypjen e Kuranit të Ndershëm) më 2003.

176. *BOTA E KRIJUAR PËR NJERIUN*; **Dituria Islame nr. 18 tetor 1990**, fq. 5-7.

1991

177. *RRUGA E QËLLUAR DHE RRUGA E GABUAR (HIDAJET DHE DALALET)*; **Dituria Islame nr. 22/23 shkurt-mars 199**, fq. 10-12.
178. *Ç'NEVOJË KA NJERIU PËR BESIM TË DREJTË-PËR FE?*; **Dituria Islame nr. 24 prill 1991**, fq. 30-32.
179. *RAMAZANI*³⁴; **Dituria Islame (numër i jashtëzakonshëm kushtuar Ramazanit) prill 1991**, fq. 12-13.
180. *ARDHJA E MUHAMEDIT A.S. PEJGAMBER, MËSHIRË PËR TËRË BOTËN*; **Dituria Islame nr. 30/31 tetor-nëntor 1991**, fq. 16-17.

1992

181. *DISA SQARIME RRETH KUPTIMIT TË TERMAVE IMAN, ISLAM, DINË*; **Dituria Islame, nr. 36 prill 1992**, fq. 31.
182. *TË DËRGUIARIT NGA ALLAHU ISHIN MESHKUI*; **Dituria Islame nr. 39 korrik 1992**, fq. 11-12.
183. *PEZMATIM PO, POR ME ARSYE DHE PA TENDENCË*³⁵; **Dituria Islame nr. 40 gusht 1992**, fq. 32.

1993

184. *NJERËZIT DHE NDARJA E TYRE NË FE!*; **Dituria Islame nr. 45 janar 1993**, fq. 5-6.
185. *RAMAZANI MUAJ I IBADETIT, I ARSIMIT DHE I EDUKIMIT*; **Dituria Islame nr. 46 shkurt 1993**, fq. 5-6.
186. *HIXHRETI DATË VENDIMTARE NË HISTORINË ISLAME*; **Dituria Islame nr. 50 qershor-korrik 1993**, fq. 10-12.

³⁴ I njëjti është ribotuar nga Dituria Islame nr. 137/2001, fq. 4-6.

³⁵ Kundër reagim.

1994

187. *MUHAMED SALIH: "...DO TË THOTË ATË QË E GËZON*³⁶"; **Dituria Islame nr. 54 janar 1994**, fq. 26-27.

1995

188. *LEGJISLATURA ISLAME DHE DREJTIMIT (SHERIATI ISLAM DHE MEDHHEBET)*; **Takvim1415/16-Kalendar 1995**, fq. 33-44.
189. *EMRAT QË PËRDOREN NDËR BESIMTARË TË FESË ISLAME DHE DOMETHËNIA E TYRE*; po aty fq. 95-125.
190. *KOMENTE DHE MENDIME ISLAME*; **botoi: SH.B. "Lidhja", Prishtinë**, f. 399³⁷.

³⁶ Përkthim.

³⁷ Është ribotuar nga i njëjti botues më 2002.

NGA TRADITA

Prof. dr. Feti Mehdiu

HAFIZËT TANË GJATË HISTORISË - VIII*

MUFTINIA E SHKUPIT

Emri e mbiemri	Viti i lindjes	vendi i lindjes	v.hfz.	te cili hafiz
hfz. Arzije S. Muharemi	1976	Shkup	1997	Hfz. Taipi
hfz. Abdulgani				
hfz. Abdulkërim Idrizi				
hfz. Adurrahman Ragip	1957		1967	
hfz. Abdullah V.Guta	1947	Shkup	1966	
hfz. Adnan R. Elmazi	1979	Studenëan	1995	Hfz. A.Kerimi
hfz. Adnan Ismaili		Dllëga		
hfz. Afijet S. Rushiti	1977	Studenëan	1996	Hfz. Sadeti
hfz. Ali ef. Ibrahim		Shkup		
hfz. Ali ef. Mehmeti	1916			
hfz. Adem Ibrahim	1945			
hfz. Atullah Q.Aliu		Batincë		
hfz. Aziz Kaçaniku	1885	Stagovë		

* *Lexues të nderuar,*

Në numrin 78 të revistës tonë, në artikullin Hafizët tanë... VI, faqe 279 na është përvjedhur, gabimisht, teksti i pa korrigjuar dhe i mangët për hafizët e Shkupit. U kërkohet falje lexuesëve dhe autorit për atë lëshim.

Në vijim sjellim tekstin e kompletuar.

Ju falënderojmë për mirëkuptim!

Redaksia

hfz. Bajram R. Bajrami	1957	Studenëan	1971	Hfz. Kurtishi
hfz. Bedri Hamidi	1895			Në Kairo
hfz. Bekir				
hfz. Bexhet Idrizi	1920			
hfz. Emine Sh. Emine	1984	Studenëan	1999	Hfz. A.Kerimi
hfz. Emine S. Sadiku	1977	Studenëan	1992	Hfz. Abdullahi
hfz. Ekremi	1926	Nikushtak	1939	
hfz. Faredin R. Rexhepi	1980	Shkup	1994	Hfz. Taipi
hfz. Fatime Sh. Sefa	1974	Shkup	1994	Hfz. Taipi
hfz. Fatime Sh. Alioska	1980	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Farije A. Emine	1981	Studenëan	1999	Hfz. A.Kerimi
hfz. Fejzullah				
hfz. Gjylsime Q. Qaili	1974	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Halil Selmanoski		Shkup		
hfz. Halil Zeqiri				
hfz. Hasan M. Hasani		Bojanë		Hfz. Nevzati
hfz. Hasan Neshati				
hfz. Hasip A. Jahja	1961	Studenëan	1978	Hfz. Halidi
hfz. Hasibe E. Abdullahu	1985	Studenëan	2001	Hfz. Xhelili
hfz. Hatixhe S. Sadiku	1976	Studenëan	1992	Hfz. A.Kerimi
hfz. Hysejn H. Mustafa	1830			
hfz. Ibrahim				
hfz. Idriz I. Idrizi	1936	Shkup	1948	Hfz. Ibrahim
hfz. Idriz Sadullahi	1947	Shkup		
hfz. Ilzan S. Rrahmani	1977	Studenëan	1998	Hfz. Rexhija
hfz. Ismet H. Jusufi	1944	Studenëan	1961	Hfz. Jusufi
hfz. Irfani...	1902	Shkup		
hfz. Isa Sh. Muça	1981	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Imer Xh. Vejseli	1962	Studenëan	1979	m.Jakupi
hfz. Imer M. Mustafa	1968	Shkup	1982	Hfz. Idrizi
hfz. Izair Demiri				
hfz. Izeme A. Sadiku	1977	Studenëan	1992	Hfz. A.Kerimi
hfz. Jashar Ibrahim	1955		1969	
hfz. Jusufi	1880	Shkup		
hfz. Jusuf J. Jakupi	1947	Studenëan	1964	m.Hakiu
hfz. Jusuf A. Kurtishi	1936	Studenëan	1950	m.Izairi
hfz. Kamil Abazi		Shkup		
hfz. Kasem Sejfullah		Shkup		
hfz. Lejla Z. Alili	1979	Shkup	1994	Hfz. Taipi
hfz. Llukman Sh. Shaqiri	1978	Shkup	1994	Hfz. Taipi
hfz. Magfire R. Hajdari	1982	Shkup	1996	Hfz. Sadati
hfz. Miftari	1895			
hfz. Mehmed Halili	1818			
hfz. Mervan J. Muhamedi	1981	Shishovë	1997	Hfz. Bexheti
hfz. Metin F. Xhelili	1980	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Mustafa N. Hasani	1952	Bojanë	1976	Hfz. Nevzati
hfz. Mustafa H. Jashari	1953	Studenëan	1970	Hfz. Jusufi

hfz. Munever M. Lutfiu	1979	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Muharem Bakiu				
hfz. Murteza M.Halili				
hfz. Nasibe I. Ademi	1977	Studenica	1992	Hfz. Abdullahu
hfz. Nehal S. Xhemaili	1977	Straçincë	1994	Hfz. Taipi
hfz. Nehal M. Bajrami		Straçincë		
hfz. Nexhla J. Idrizi	1984	Shkup	1998	Hfz. Abdullahu
hfz. Nevzat M.Hasani	1911	Bojanë		
hfz. Neriman I. Bajrami	1981	Studenica	1992	Hfz. Abdullahu
hfz. Nuhiu Veliu		Shkup		
hfz. Nurten H. Nazim	1980	Shkup	1997	Hfz. Taipi
hfz. Qahil Jusufi	1925		1938	
hfz. Qerimi	1882	Shkup		
hfz. Ramadan B.Iseni	1979	Shkup	1996	Hfz. Taipi
hfz. Rauf S. Bakiu	1946	Nikushtan	1965	
hfz. Rashid		Shkup		
hfz. Rexhail Sh. Imeri	1979	Nikushtan	1995	
hfz. Rexhije Rrahmani				
hfz. Rexhep D.Nuredini	1952	Sullar e P.	1973	
hfz. Resi	1925	Shkup	1935	
hfz. Ridvan A. Ajdari				
hfz. Sadat Ademi				
hfz. Sadudin Ragip	1957	Shkup	1967	
hfz. Sami Nebi		Nikushtan		
hfz. Sami Jusufi	1920	Shkup		
hfz. Sait Ramani	1918		1935	
hfz. Sadullah	1910			
hfz. Selvie I. Dardhishta	1977	Shkup	1994	Hfz. Taipi
hfz. Suhejb S. Xhemaili	1980	Shkup	1995	Hfz. Taipi
hfz. Sulejman		Shkup		
hfz. Shaban Salih	1870	Shkup		
hfz. Shaip...	1895			Në Kairo
hfz. Shaip Nafizi	1925		1938	
hfz. Shafi O.Osmani	1957	Sullar e P.	1973	
hfz. Shefket N. Imeri	1950	Studenica	1968	Hfz. Veliu
hfz. Shefki Ibrahim	1921	Shkup	1937	
hfz. Sherif Osmani		Shkup		
hfz. Sheval S.Sulejmani	1958	Sullar	1973	m.Hazbiu
hfz. Taip Aliu		Batincë		
hfz. Vahid Shabani	1943	Shkup		
hfz. Veli J.Ibrahimi	1922	Studenica	1931	
hfz. Vildan E.Abdullahu	1986	Studenica	2001	Hfz. Xhelili
hfz. Zekie I. Demiri	1941	Studenica	1958	Hfz. Izairi
hfz. Zija N. Demiri	1953	Studenica	1968	Hfz. Izairi
hfz. Zekerija				
hfz. Zuhdi Sulejmani		Shkup		
hfz. Zulbehar Ibrahim		Shkup		

hfz. Zylejha Jashari	1985	Studenica	2000	Hfz. Ismati
hfz. Xhelal Z. Zeqiri	1980	Studenica	1995	Hfz. A.Kerimi
hfz. Xhemal I. Shabani	1957	Studenica	1974	Hfz. Kurtishi
hfz. Xhelil Shabani				
hfz. Xhemile D. Ramadani	1978	Shkup	1997	hfz. Taipi

PËRMBAJTJA

<i>Qemajl Morina</i> Ibnu Halduni themelues i sociologjisë moderne	5
<i>Orhan Bislimaj</i> “Ehlu’s-sunneti ve’l xhemaati”	15
<i>Osman Mehmeti</i> Vështrim kutubhaneve dhe zhvillimit të tyre në Kosovë.....	41
<i>Mr. Aliriza Selmani</i> Një dokument me rëndësi mbi pronat e patundshme vakëfnore të rrethit të Gjilanit në prag të Luftës së Dytë Botërore.....	67
<i>Nehat Krasniqi</i> Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam në trojet shqiptare gjatë Periudhës Osmane.....	95
<i>Nexhat Ibrahim</i> Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në mesjetë	123
<i>Akad. Jashar Rexhepagiq</i> Terminologjia islame në një nga veprat më të reja në gjuhën kroate	143
<i>Dr. Pajazit Nushi</i> Termi “shpirt” dhe derivatet konceptuale e gjuhësore të tij në psikologjinë e fesë islame	161
<i>Fitim Flugaj</i> Mehmet Ali Pasha, personalitet shumëdimensional	177
Islami në Andaluzi.....	187
Islami në SHBA	211
Restaurimi i xhamisë së Hadumit në Gjakovë.....	243
<i>Avni Aliu</i> Mësohu të jetosh me besim në Allahun	251

<i>Hans Kristian Anderson</i> Një tregim danez për ditëlindjen e profetit Muhamed	279
<i>Muhamed Esad</i> A është religjioni çështje e së kaluarës?	291
<i>Esh-shejh Fevzi Zefzafi</i> Islami - fe e dialogut dhe qytetërimit.....	307
<i>Hatim Et-Tahavi</i> Monedha islame - angleze - argumentet dhe qëllimet.....	313
<i>Prof. dr. Muhamet Pirraku</i> Gylen - përmendore e re e civilizimit njerëzor	319
<i>Dr. Feti Mehdiu</i> Dritë e pashuar - hz.Muhammedi s.a.v	329
<i>Mr. Qemajl Morina</i> "Dritë e pashuar" hz. Muhamedi" (s.a.v.).....	337
<i>Dr. Milazim Krasniqi</i> Vepër që na e bën më të dashur figurën e pejgamberit tonë, Muhamedit a.s.	343
<i>Ramadan Shkodra</i> Bibliografi e punimeve të h. Hherif Ahmetit (version i plotësuar).....	347
<i>Prof. dr. Feti Mehdiu</i> Hafizët tanë gjatë historisë – VIII.....	363
Përmbajtja	367